

**PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE
TË GJYKATËS EUROPIANE
PËR TË DREJTAT E NJERIUT
KUNDËR SHQIPËRISË**


Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Qershor 2010

© i këtij botimi Qendra e Publikimeve Zyrtare

ISBN 978 – 99928 –01– 002 - 5

*Varianti zyrtar i vendimeve gjendet në dy gjuhë anglisht/frengjisht në website zyrtar
të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut
www.echr.coe.int*



EUROPEAN COURT OF HUMAN RIGHTS
COUR EUROPÉENNE DES DROITS DE L'HOMME

1959 • 50 • 2009

KËSHILLI I EUROPËS

GJYKATA EUROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

SEKSIONI I KATËRT

Treguesi i lëndës

ÇËSHTJA “GJONBOÇARI ETJ. KUNDËR SHQIPËRISË” (PRANUESHMËRIA)	5
ÇËSHTJA “GJONBOÇARI ETJ. KUNDËR SHQIPËRISË”	12
ÇËSHTJA “DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË KUNDËR SHQIPËRISË” (PRANUESHMËRIA)	25
ÇËSHTJA “NIKOLAUS DHE JURGEN TRESKA KUNDËR SHQIPËRISË DHE ITALISË”	30
ÇËSHTJA “AGIM HYSI KUNDËR SHQIPËRISË”	44
ÇËSHTJA “QUFAJ CO. SHPK KUNDËR SHQIPËRISË” (PRANUESHMËRIA)	48
ÇËSHTJA “QUFAJ CO. SHPK KUNDËR SHQIPËRISË”	54
ÇËSHTJA “NAUMOV KUNDËR SHQIPËRISË”	62
ÇËSHTJA “BESHIRI ETJ. KUNDËR SHQIPËRISË”	67
ÇËSHTJA “BAJRAMI KUNDËR SHQIPËRISË” (THEMELI)	81
ÇËSHTJA “BAJRAMI KUNDËR SHQIPËRISË” (RISHIKIM)	90
ÇËSHTJA “RAMADHI DHE TË TJERË KUNDËR SHQIPËRISË”	92
ÇËSHTJA “DRIZA KUNDËR SHQIPËRISË”	107
ÇËSHTJA “MARINI KUNDËR SHQIPËRISË”	126
ÇËSHTJA “HAMZARAJ KUNDËR SHQIPËRISË” (NR.1)	147
ÇËSHTJA “NURI KUNDËR SHQIPËRISË”	153
ÇËSHTJA “DAUTI KUNDËR SHQIPËRISË”	158
ÇËSHTJA “VRIONI DHE TË TJERËT KUNDËR SHQIPËRISË”	165
ÇËSHTJA “VRIONI E TË TJERË KUNDËR SHQIPËRISË DHE ITALISË”	176
ÇËSHTJA “GJYLI KUNDËR SHQIPËRISË”	187
ÇËSHTJA AFERDITA HAMZARAJ KUNDËR SHQIPËRISË (NR. 2)	197
ÇËSHTJA “ZYFLLI KUNDËR SHQIPËRISË”	200
ÇËSHTJA “BALLIU KUNDËR SHQIPËRISË” (PRANUESHMËRIA)	204
ÇËSHTJA “BALLIU KUNDËR SHQIPËRISË”	211
ÇËSHTJA “DYBEKU KUNDËR SHQIPËRISË”	212
ÇËSHTJA “XHERAJ KUNDËR SHQIPËRISË”	230
ÇËSHTJA “GRORI KUNDËR SHQIPËRISË”	241
ÇËSHTJA “ALI TELHAI KUNDËR SHQIPËRISË”	267
ÇËSHTJA “ALI DHE SHKËLQIM SUFJA KUNDËR SHQIPËRISË”	270
ÇËSHTJA “BUSHATI DHE TË TJERËT KUNDËR SHQIPËRISË”	272
ÇËSHTJA “QEMAL GURGAJ DHE TË TJERË KUNDËR SHQIPËRISË”	282
ÇËSHTJA “QERIM JAKUPI KUNDËR SHQIPËRISË”	284
ÇËSHTJA “CAKA K. KUNDËR SHQIPËRISË”	291
ÇËSHTJA “MULLAI DHE TË TJERË KUNDËR SHQIPËRISË”	306
ÇËSHTJA “LASKA DHE LIKA KUNDËR SHQIPËRISË”	320
ÇËSHTJA “VEZIR PLEPI, FERSILET PLEPI DHE MIAFTONI ZEKA KUNDËR SHQIPËRISË DHE GREQISË”	331

VENDIM MBI PRANUESHMËRINË
(Ankimi Nr. 10508/02)
ÇËSHTJA “GJONBOÇARI ETJ. KUNDËR SHQIPËRISË” (Pranueshmëria)

STRASBURG
31 mars 2005

Ky vendim do të marrë formë të prerë në rrethanat e përcaktuara në nenin 44 § 2 të Konventës. Ai mund t'i nënshtrohet rishikimit redaktues.

Kjo çështje trajton mosekzekutimin e vendimit të Gjykatës së Lartë datë 06/03/2003, që urdhëronte Komisioni e kthimit dhe kompensimit të Pronave të merrte një vendim lidhur me kërkesat e ankuesve për tokën që kishin trashëguar dhe që u ishte konfiskuar gjatë regjimit komunist (shkelje e Nenit 6.1 të Konventës). Çështja trajton kohëzgjatjen e tre procedimeve mbi pretendimet e ankuesve për pasuritë e paluajtshme. Gjykata Evropiane tërheq vëmendjen se sistemi gjyqësor ka dështuar në menaxhimin pikërisht të shtimit të procedimeve mbi të njëjtën çështje kur ato mund të ndërthuren së bashku. Lidhur me mungesën e një mjeti efektiv, kjo shkelje vjen si pasojë e mungesës së një parashikimi ligjor në ligjin e brendshëm ku ankuesit mund të kishin siguruar rivendosje të së drejtës kundër tejzgjatjes së procedimeve. Gjykata pohon se në lidhje me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore që vendosin detyrime monetare ndaj një shteti, shteti nuk duhet t'i kërkojë personit ndaj të cilit është debitor, të iniciojë procedura të ekzekutimit të vendimit, me qëllim kompensimin e shumës së caktuar.

Në çështjen Gjonboçari kundër Shqipërisë

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i katërt), e mbledhur më 31 mars 2005, me trup gjykues të përbërë nga:

z. Nikolas BRATZA *Kryetar*
z. G. BONELLO
z. M.PELLONPÄÄ
z. K.TRAJA
z. L.GARLICKI
z. J.BORREGO BORREGO
znj.MIJOVIĆ

duke marrë në konsideratë kërkesën e mësipërme, depozituar më 6 korrik 2001, pas shqyrtimit, vendos si më poshtë:

FAKTET

Ankuesit, z. Agron Gjonboçari, z. Midat Gjonboçari, z. Agim Gjonboçari, z. Gjon Gjonboçari, znj. Hava Veizaj, z. Arben Boçari dhe z. Gëzim Boçari, janë shtetas shqiptarë të cilët kanë lindur përkatësisht më 1939, 1927, 1934, 1931, 1924, 1949 dhe 1949. Ata banojnë në Tiranë dhe Vlorë, Shqipëri. Ata përfaqësohen para Gjykatës nga z. G. Boçari, një nga ankuesit.

A. Rrethanat e çështjes

Sipas parashtrimit të ankuesve, rrethanat e çështjes mund të përmbledhen si më poshtë:

Ankimi ka të bëjë me proceset që lidhen me kompensimin e pronave, të cilat u konfiskuan gjatë periudhës komuniste.

1. Proceset mbi kompensimin e pronave për ankuesit

Prindërit e ankuesve kishin në pronësi disa ngastra toke që në total mund të llogariten në 132 hektarë tokë, të cilat u konfiskuan nga regjimi komunist. Këto ngastra gjenden në qarkun e Vlorës, në bregdetin jugor të Shqipërisë.

Në datën 30 mars 1994, në bazë të ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronave, ankuesit depozituan një kërkesë në Komisionin për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave në Vlorë.

Në datën 27 gusht 1996, Komisioni i Vlorës u njohu ankuesve si pronë, 14 hektarë (2 hektarë për person) nga toka që u qe konfiskuar prindërve të tyre. Vendimi u firmos nga katër prej shtatë anëtarëve të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Vlorë.

Në bazë të vendimit të komisionit, ankuesit regjistruan pronën e tyre në Regjistrin e Tokave, Vlorë, (Kadastër) në një datë të papërcaktuar.

Në 28 dhjetor 1998, ata i bënë kërkesë Komisionit të Vlorës për lëshimin e një dokumenti të ri, i cili do të përputhej me kërkesat e ligjit.

Me shkresën nr.76, datë 6 janar 1999, Kryetari i Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Vlorë iu kthen përgjigje ankuesve duke i informuar ata, se Komisioni tashmë e kishte marrë vendimin mbi statusin e pronës së tyre, me vendimin e datës 27 gusht 1996, i cili i njihte ankuesit si pronarë të ligjshëm të pronave. Gjithashtu, ai pohoi se në bazë të ligjeve në fuqi të asaj kohe, ndreqja e dokumenteve zyrtare të Komisionit, u takonte gjykatave.

2. Procedimet gjyqësore me Ministrinë e Turizmit si palë

Më 25 nëntor 1996, Ministria e Turizmit, me vendimin nr. 20/2, lëshoi me qira për A.L. një ngastër toke, për t'u përdorur për turizëm, brenda pronës, e cila u qe njohur ankuesve nga Komisioni i Vlorës.

Në datën 29 dhjetor 1997, ankuesit paraqitën një padi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku kërkonin anulimin e vendimit të Ministrisë.

Në datën 17 shkurt 1998, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, anuloi vendimin e Ministrisë me arsyetimin se transaksioni kishte të bënte me një pronë private.

Në datën 16 qershor 1998, Gjykata e Apelit Tiranë, prishi vendimin e Gjykatës së Rrethit dhe njohu si të vlefshëm dekreten e Ministrisë, duke deklaruar se vendimi i Komisionit kishte qenë i paligjshëm për arsye se nuk përputhej me kërkesat ligjore; si rrjedhim kërkesit nuk mund të pretendonin të drejtat mbi pasurinë.

Në datën 10 qershor 1999, pas rekursit të vendimit nga ana e kërkesve, Gjykata e Lartë e prishi vendimin e Gjykatës së Apelit të datës 16 qershor 1998 si të paarsyetuar dhe e dërgoi çështjen për rigjykim në Gjykatën e Apelit.

Në datën 10 nëntor 1999, Gjykata e Apelit Tiranë, gjatë procesit të rigjyimit, rrëzoi padinë e ankuesve me arsyetimin se padia civile e depozituar në Gjykatën e Rrethit në datën 29 dhjetor 1997, është paraqitur pasi kishte kaluar afatin njëmuor të depozitimit.

Në datën 17 janar 2001, Gjykata e Lartë la në fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit.

3. Procedurat mbi kthimin e pronës për K.B.

Ndërkohë, në datën 9 tetor 1997, Komisioni i Vlorës i cakton K.B. (Nënës së A.L.), si kompensim, të njëjtën ngastër toke, e cila gjendet në pronën e ankuesve, të cilën Ministria e Turizmit e kishte lëshuar me qira për A.L.-në.

Në një datë të pacaktuar, K.B.-ja ia dhuron tokën djalit të saj A.L.- së.

Me urdhrin nr.3, datë 11 qershor 1999, në bazë të një kërkesë nga A.L., Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Vlorë, iu heq statusin e pronarit ankuesve të ngastrës së mësipërme të tokës dhe regjistron si pronar të ligjshëm A.L.-në.

4. Proceset gjyqësore me A.L. si palë

Në datën 13 dhjetor 1999, në bazë të padisë së paraqitur nga A.L., Gjykata e Rrethit Vlorë, shpalli të paligjshëm vendimin e datës 27 gusht 1996, të marrë nga Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Vlorë, ku ngastra e tokës iu njoh ankuesve si pronë, me arsyetimin se vendimi nuk është lëshuar në përputhje me kërkesat ligjore.

Në datën 17 mars 2000, Gjykata e Apelit Vlorë, mbështeti arsyetimin e Gjykatës së Rrethit, duke pohuar gjithashtu se Komisioni i Vlorës i ka tejkaluar kompetencat e tij ligjore në marrjen e vendimeve, në lidhje me pronat të cilat shteti i ka caktuar për qëllime turistike.

Në datën 17 janar 2001, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë konfirmoi se vendimi i Komisionit të Vlorës në favor të ankuesve ishte i pavlefshëm, me arsyetimin se nuk është lëshuar në përputhje me kërkesat ligjore; si rrjedhim, vendimi i Komisionit të Vlorës nuk ka vlerë për kërkesit apo për të tjerët. Gjykata e Lartë, prishi vendimin e dhënë nga Gjykatat e mësipërme dhe vendosi pushimin e çështjes.

5. Proceset ligjore me Komisionin e Vlorës

a) Procedurat e zakonshme

Në datën 18 prill 2000, ankuesit depozituan një padi në Gjykatën e Rrethit Vlorë, duke pretenduar që vendimi i Komisionit të Vlorës i datës 9 tetor 1997 ishte i pavlefshëm dhe i kërkuan gjykatës të rregullojë vendimin e Komisionit të marrë në datën 27 gusht 1996, pasi ishte firmosur nga katër prej shtatë anëtarëve të Komisionit.

Në datën 6 shkurt 2001, Gjykata e Rrethit Vlorë, nuk pranoi të shqyrtonte padinë e ankuesve me arsyetimin se vendimi i komisionit të Vlorës datë 27 gusht 1996 ka qenë shpallur i pavlefshëm me vendim të Gjykatës së Rrethit Vlorë, datë 13 dhjetor 1999.

Në datën 25 maj 2001, Gjykata e Apelit Vlorë, pasi shqyrtoi kërkesën e ankuesve përsa i përket mospërputhjes me kërkesat ligjore të vendimit të Komisionit, datë 27 gusht 1996, vendosi të mos pranojë ankimin, me arsyetimin se një veprim i parregullt edhe pse nuk konsiderohet i pavlefshëm ligjërisht, nuk do të ketë ndonjë efekt ligjor. Përfundimisht, gjykata nuk e pranoi ankesën e ankuesve mbi pavlefshmërinë e vendimit të komisionit të datës 9 tetor 1997, me arsyetimin se ishte e pabazuar. Rrjedhimisht, gjykata la në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit.

Në 6 mars 2003, në bazë të rekursit të bërë nga ana e ankuesve, Gjykata e Lartë prishi vendimet e Gjykatave të Rrethit dhe të Apelit. Për më tepër, Gjykata e Lartë mbajti qëndrimin se Komisioni i Vlorës duhet të nxirrte një vendim mbi statusin e pronësisë së ankuesve në përputhje me kërkesat ligjore. Përfundimisht, gjykata nuk pranoi të shqyrtojë kërkesën e ankuesve për të deklaruar të pavlefshëm vendimin e Komisionit të Vlorës, datë 9 tetor 1997, me arsyetimin se ai ishte nxjerrë në përgjigje të pretendimeve të ankuesve mbi pronën.

Dy anëtarë të kolegjit të Gjykatës së Lartë që vendosën mbi gjykimin e sipërpërmendur, TH.K. dhe N.K., ishin gjithashtu pjesë e trupit gjykues në vendimin e datës 17 janar 2001 të Gjykatës së Lartë.

b) Procedurat e ekzekutimit

Në datën 14 prill 2004, Gjykata e Rrethit Vlorë nxori një urdhër ekzekutimi për Komisionin e Vlorës, duke e udhëzuar të ekzekutonte vendimin e Gjykatës së Lartë, datë 6 mars 2003.

Në datën 19 tetor 2004, ankuesit informuan Zyrën e Regjistrimit se vendimi i Gjykatës së Lartë ende nuk ishte ekzekutuar nga Komisioni i Vlorës.

Çështjet e tyre mbi pronësinë ende nuk janë zgjidhur.

B. Legjislacioni i brendshëm përkatës

1. Pjesët përkatëse të Kushtetutës së Shqipërisë vijojnë si më poshtë:

Neni 42, paragrafi 2

“Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.”

Neni 142 paragrafi 3

“Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore.”

2. Ligji për kthimin dhe kompensimin e pronave nr. 7698 datë 15 prill 1993, ndryshuar me ligjin 8084/ 1996, parashikon përkatësisht:

Neni 4, paragrafi 1

U njihet e drejta e pronësisë dhe u kthehen ose u kompensohen në natyrë ish - pronarëve apo trashëgimtarëve të tyre ligjorë, pronat në formën e kullotës, livadhit, tokës pyjore, apo tokës bujqësore dhe jobujqësore të patrajtuar nga ligji nr. 7501, datë 19.7.1991 "Për tokën", që janë në

pronësi të shtetit, kur këto prona do të tjetërsohen në truall duke u përfshirë brenda sipërfaqes së vijave të reja kufizuese ndërtimore të qendrave të banuara. Masa e kthimit ose e kompensimit në natyrë bëhet e plotë, por në të gjitha rastet jo më shumë se 10 000 m²", sipas përcaktimit të bërë në paragrafin e katërt të nenit 1 të dekretit nr. 8084, datë 7 mars 1996".

PRETENDIMET

1. Duke u bazuar në nenin 6, paragrafi 1 i Konventës, ankuesit u ankuan se procedurat kanë qenë të parregullta në disa drejtime, kryesisht përsa i takon kohëzgjatjes së procesit, mungesës së paanësisë së gjykatave dhe neglizhencës së autoriteteve për të ekzekutuar vendimin përfundimtar; gjithashtu ata pretenduan se ishin shkelur parimet e "rendit ligjor" dhe "sigurisë juridike".

2. Në bazë të nenit 13 të Konventës, si edhe nenit 6 paragrafi 1, ankuesit pretenduan se ata nuk kishin mjete juridike efektive në lidhje me tejzgjatjen e procesit.

3. Ankuesit pretenduan një shkelje në bazë të nenit 1 të protokollit nr.1, marrë në veçanti dhe së bashku me nenin 14 të Konventës.

4. Përfundimisht, ankuesit u mbështetën në nenet 17 dhe 18 të Konventës, në lidhje me kërkesën e tyre, bazuar në nenin 1 të protokollit nr.1.

E DREJTA

1. Mbështetur në nenin 6, paragrafin 1 të Konventës, ankuesit pretenduan për një proces të parregullt. Në lidhje me këtë, neni 6, paragrafi 1 interpretohet si më poshtë:

"Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile..."

Ankuesit parashtuan se gjykatat e brendshme dështuan në respektimin e rendit ligjor dhe garancinë e ligjit, duke pretenduar që vendimet e gjykatave përsa i takon çështjes së tyre kanë çuar në krijimin e një situatë konfuze në lidhje me të drejtat e tyre mbi pronën.

a) Gjykata rikujton se nuk është funksioni i saj të zëvendësojë vlerësimin e fakteve dhe provave të saj me ato të gjykatave vendase apo të veprojë si një shkallë e katërt apelimi, e cila do të ndërhyjë në mënyrë të përgjithshme, bazuar në faktin se një gjykatë e brendshme ka marrë një vendim të gabuar (shih, mes shumë shembujve të tjerë, *Edwards v the United Kingdom*, Vendim datë 16 dhjetor 1992, Seria A nr. 247-B, parag. 34, shih gjithashtu *Garcia Ruiz v Spain* [GC], nr. 30544/96, paragrafët 28-29, EHCR 1999-I).

Rrjedhimisht, ky ankim është haptazi i pabazuar dhe duhet të mos pranohet në bazë të nenit 35, paragrafët 3 dhe 4 të Konventës.

b) Ankuesit pretenduan se duke mos zbatuar vendimin e Gjykatës së Lartë, datë 6 mars 2003, autoritetet shqiptare kanë hequr efektin e dobishëm të dispozitave të nenit 6 të Konventës.

Gjykata konsideron se nuk mundet që vetëm në bazë të informacionit që permban dosja për këtë çështje, të vendosë për pranueshmërinë e këtij ankimi dhe si pasojë, është e domosdoshme, në përputhje me Nenin 54/2 (b) të Rregullores së Gjykatës, të lajmërojë palën shqiptare lidhur me këtë.

c) Ankuesit pretenduan se disa procese në lidhje me pretendimet e tyre civile e kanë kaluar kërkesën e "afatit të arsyeshëm".

Ata vërejtën se gjykatat e brendshme kanë shqyrtuar çështjet e tyre në tre lloje procesesh. Procesi i parë filloi në datën 29 dhjetor 1997, kur ankuesit depozituan një kërkesë në Gjykatën e Rrethit dhe që përfundoi me vendimin e Gjykatës së Lartë, datë 17 janar 2001. I dyti filloi në një datë të papërcaktuar para datës 13 dhjetor 1999, kur A.L. paraqiti një padi civile në Gjykatën e Rrethit dhe përfundoi në datën 17 janar 2001. Procesi i tretë filloi në datën 18 prill 2000, kur ankuesit depozituan një padi në Gjykatën e Rrethit Vlorë dhe përfundoi me vendimin e formës së prerë marrë nga Gjykata e Lartë, datë 6 mars 2003 (ky vendim ende nuk është ekzekutuar).

Ankuesit i qëndruan mendimit se gjykatat vendase, duke neglizhuar të dalin me një vendim sa i takon vlefshmërisë së vendimit të Komisionit dhënë në favor të tyre që në procesin e parë, kanë tejkaluar kriterin e "afatit të arsyeshëm" për të vendosur rreth një çështjeje jokomplekse si çështja në fjalë, e cila kishte të bënte me pavlefshmërinë e një akti nga pikëpamja e formës.

Gjykata konsideron se nuk është e mundur, që në bazë të dosjes së çështjes, të vendosë mbi pranueshmërinë e këtij ankimi dhe si pasojë, është e domosdoshme, në përputhje me nenin 54/ 2 (b) të rregullores së Gjykatës, të lajmërojë palën shqiptare lidhur me këtë.

d) Gjithashtu, ankuesit bënë ankesë në bazë të këtij neni në lidhje me mungesën e paanshmërisë në kolegjet e Gjykatës së Lartë, për arsye se dy nga gjyqtarët (Th.K. dhe N.K.), të cilët morën pjesë në vendimin e datës 17 janar 2001, morën pjesë gjithashtu në trupin gjykues në vendimin e datës 6 mars 2003.

Gjykata rikujton se paanësia, në kuptimin e nenit 6/ 1, duhet të përcaktohet në përputhje me një test subjektiv, që nënkupton bindjen personale të një gjyqtari të veçantë për një çështje të caktuar dhe gjithashtu në përputhje me një test objektiv që nënkupton të siguarit se gjyqtari ka ofruar garancitë e mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm në këtë drejtim (shih Hauschildt v Denmark, vendimi datë 24 maj 1989, Series A no. 255, p. 154, p.21, § 46, Fey v Austria, vendimi datë 24 shkurt 1993, Series A no. 255, p. 12, § 28, Gautrin et al v France, vendimi datë 20 maj 1998, Raportet 1998-III, pp.1030-31, paragrafi 58).

Përsa i takon testit subjektiv, paanësia e gjyqtarit në fjalë duhet të prezumohet derisa të ketë prova që dëshmojnë të kundërtën (shih Padovani v Italy, vendimi i datës 26 shkurt 1993, Series A no. 257-B, p.20, paragrafi 26). Testi objektiv konsiston në përcaktimin nëse edhe pa marrë parasysh sjelljen e gjyqtarit ekzistojnë fakte bindëse, të cilat ngjallin dyshime përsa i takon paanësisë së tij. Në këtë drejtim, edhe sjelljet e jashtme mund të kenë një farë rëndësie. Ajo që përbën thelbin në fakt ka të bëjë me detyrimin e gjykatave për të ngjallur besimin e publikut në një shoqëri demokratike. Për rrjedhojë, kur shqyrtohet nëse në një çështje të caktuar ekziston një arsye e ligjshme për të dyshuar se një gjyqtar i caktuar nuk është i paanshëm, këndvështrimi i atyre që pretendojnë lidhur me mungesën e paanësisë së tij është rëndësishëm, por jo vendimtar. Vendimtar mbetet përcaktimi nëse dyshimi mbi paanësinë është objektivisht i justifikueshëm. (Shih Delage and Magistrello v France (dec.) no. 40028/98, ECHR 2002-II).

Në këtë çështje, ankuesit debatuan mbi paanësinë subjektive dhe objektive të dy gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, në mënyrë të veçantë pjesëmarrjen e tyre në dy kolegjet që vendosën mbi statusin e pronës së ankuesve.

Përsa i takon paanësisë personale të të dy gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, Gjykata nuk gjen ndonjë provë për të vërtetuar pretendimet e ankuesve.

Lidhur me paanësinë objektive, gjykata tashmë ka konkluduar se fakti i thjeshtë që gjyqtari ka marrë vendim, në vetvete nuk mjafton për të mbështetur dyshimet rreth paanësisë së tij. Ajo që ka rëndësi është qëllimi dhe natyra e veprimeve që kryen ai gjatë procesit gjyqësor. Në të njëjtën mënyrë, njohuritë e detajuara të gjyqtarit mbi çështjen, nuk përbëjnë ndonjë shkak për të dyshuar mbi paanshmërinë e tij gjatë marrjes së vendimit në themel. Së fundmi, as shqyrtimi paraprak i një informacioni të disponueshëm nuk do të thotë që paragjykohe shqyrtimi përfundimtar i çështjes (shih mutatis mutandis, Hauschildt v Denmark, vendimi i datës 24 maj 1989, Series A nr. 154, fq. 22 paragrafi 50; Norties v Neitherslands (Neriter v Holland), vendimi datë 24 gusht 1993, Series A nr.267, fq. 15 paragrafi 33; dhe Saraiva de Carvalho v Portugal, vendimi i datës 22 prill 1994, Series A nr. 286-B, fq.38, paragrafi 35).

Në lidhje me këtë, në çështjen konkrete, Gjykata nuk konstaton se veprimet e gjyqtarëve në fjalë kanë minuar garancinë e paanësisë së Gjykatës së Lartë. Fakti i vetëm se gjyqtarët në fjalë kanë marrë pjesë në të dy kolegjet vendimmarrëse nuk ka ndikuar në paanësinë e Gjykatës së Lartë, duke ditur që vendimi i fundit është dhënë në favor të ankuesve.

Duke pasur parasysh, sa më lart, Gjykata nxjerr si konkluzion se shqetësimi i ankuesve nuk justifikohet objektivisht për çështjen në fjalë.

Si pasojë, përsa i takon mungesës së pretenduar të njëanshmërisë, kjo kërkesë nuk pranohet pasi është haptazi e pabazuar, sipas nenit 35/3 dhe 4 të Konventës.

2. Në bazë të nenit 13 të Konventës, lidhur me nenin 6/1, ankuesit argumentuan se ata nuk kanë pasur asnjë mjet juridik përsa i takon tejzgjatjes se procedurave. Neni 13, në pjesët e tij përkatëse, shprehet si më poshtë:

“Çdo person, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e njohura në këtë Konventë, ka të drejtë të bëjë ankim efektiv tek një organ i vendit të tij, edhe kur shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare”.

Në këtë vështrim, Gjykata tërheq vëmendjen se neni 13 i Konventës është interpretuar si kërkesë për një ankim efektiv në ligjin e brendshëm vetëm në drejtim të ankesave të cilat mund të konsiderohen “të debatueshme” në kuptimin e Konventës (shih Boyle and Rice v the United Kingdom, vendimi i dates 27 prill 1988, Seritë A no. 131, paragrafi 52).

Përsa kohë që ankuesit pretendojnë se atyre u është mohuar e drejta për një ankim efektiv, në bazë të nenit 6/ 1 të Konventës lidhur me kohëzgjatjen e procesit, gjykata çmon se duke u bazuar në dosjen e çështjes, nuk mund të vendosë për pranimin e kësaj ankese dhe për pasojë, është e domosdoshme, në përputhje me nenin 54/ 2 (b) të rregullores së Gjykatës, që të njoftohet pala shqiptare për këtë.

3. Ankuesit pretenduan se ata ishin viktimë të shkeljes së nenit 1 të protokollit nr.1 të Konventës, marrë në veçanti dhe së bashku me nenin 14 të Konventës.

Neni 1 i protokollit 1 parashikon:

“Çdo person fizik dhe juridik ka të drejtën që t’i respektohet pasuria e tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare”.

Dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e shteteve për të zbatuar ligjet që ato i quajnë të domosdoshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagesën e taksave, ose të kontributeve të tjera, ose të gjobave.

Neni 14 i Konventës parashikon:

“Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të njohura në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla, si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër”.

Ankuesit pretenduan se janë privuar nga e drejta për pronën, pasi autoritetet lokale fillimisht ia njohën atyre pronën e prindërve të tyre dhe më pas e transferuan atë tek palët e treta. Për më tepër, ata parashtruan se duke pritur zgjidhje përfundimtare të procedurave të mbështetura në kërkesën e tyre për kompensim, efektivisht iu është privuar e drejta e tyre e pronës.

Përfundimisht, ankuesit pohuan se autoritetet lokale i kanë diskriminuar për shkak të vendndodhjes të favorshme në bregdetin shqiptar të pronës në fjalë.

Gjykata çmon se duke u bazuar në dosjen e çështjes, nuk mund të vendosë për pranimin e këtij pretendimi dhe për pasojë, është e domosdoshme, në përputhje me nenin 54 / 2 (b) të rregullores së Gjykatës, të njoftohet pala shqiptare për këtë.

4. Përfundimisht, ankuesit pretenduan për një shkelje të të drejtave të tyre, të garantuara sipas nenit 17 dhe 18 të Konventës, në lidhje me pretendimet e tyre sipas nenit 1 të protokollit nr.1.

Neni 17 vijon si më poshtë:

“Asnjë nga dispozitat e kësaj Konvente nuk mund të interpretohet se i jep një shteti, grupimi ose individ, të drejtë që të ndërmarrë ndonjë veprimtari ose të kryejnë ndonjë akt që synon cenimin e të drejtave ose lirive të njohura në këtë Konventë, ose kufizime më të gjera të këtyre të drejtave ose lirive të parashikuara gjithashtu në këtë Konventë”.

Neni 18 vijon si më poshtë:

“Kufizimet që, në bazë të kësaj Konvente, u bëhen të drejtave dhe lirive të sipërpërmendura mund të zbatohen veçse për qëllimin për të cilin janë parashikuar”.

Gjykata konstaton se përsa kohë kjo pjesë e ankimit është e mbështetur dhe është në kompetencën e saj, faktet e çështjes nuk përbëjnë ndonjë shkelje të dispozitave të kësaj Konvente.

Për rrjedhojë, këto pretendime duhet të mos pranohen pasi janë haptazi të pabazuara, në bazë të nenit 35 / 3 dhe 4 të Konventës.

Për këto arsye, Gjykata njëzëri

Vendos të pezullojë shqyrtimin e pretendimeve të ankuesve, bazuar në nenin 6/1 të Konventës, përsa i takon neglizhencës së autoriteteve kombëtare për të ekzekutuar një vendim të formës së prerë dhe kohëzgjatjes së procesit civil, pretendimeve të ankuesve, bazuar në nenin 13 të Konventës dhe nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës, marrë veçmas dhe së bashku me nenin 14 të Konventës,

Deklaron të papranueshme pjesën e mbetur të kërkesës.

Michael O' BOYLE
Regjistruues

Nikolas BRATZA
Kryetar

VENDIM
(Ankimi nr .10508/02)
ÇËSHTJA “GJONBOÇARI ETJ. KUNDËR SHQIPËRISË”

STRASBURG
23 tetor 2007

Përfundimtar
31.03.2008

Në çështjen “Gjon Boçari e të tjerë kundër Shqipërisë”

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (seksioni i katërt), në cilësinë e një Dhome, e përbërë prej:

Sir Nicolas Bratza, Kryetar

Z. J.Casadevall

Z. G.Bonello

Z. K.Traja

Z. S Pavlovski

Z. J.Sikuta

Znj. P.Hirvela, të gjithë gjyqtarë

dhe z. T.Learly, sekretar i seksionit,

pasi kanë vendosur privatisht më datë 2 tetor 2007,

kanë marrë në po të njëjtën ditë vendimin e mëposhtëm:

PROCEDURA:

1. Çështja e ka origjinën e saj nga një ankim (nr.10508/02) kundër Republikës së Shqipërisë, aplikuar në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa) nga shtatë shtetas shqiptarë, z.Agron GjonBoçari, z.Midat Gjonbocari, z.Agim Gjonboçari, Z.Gjon Gjonboçari, znj.Hava Veizaj, z.Arben Boçari dhe z.Gëzim Boçari (ankuesit), në datën 6 korrik 2001.

2. Ankuesit, të cilëve u është dhënë ndihmë ligjore, janë përfaqësuar nga z.Sokol Luci, avokat në Tiranë. Pala shqiptare (pala shtetërore) është përfaqësuar nga agjentët e saj z.S.Puto dhe znj. S.Mëneri, në Ministrinë e Punëve të Jashtme.

3. Ankuesit u ankuan sipas neneve 6 §1, vetëm dhe në bashkim me nenin 13 të Konventës, lidhur me dështimin e autoriteteve për të ekzekutuar një vendim gjyqësor të formës së prerë, që urdhëronte marrjen e një vendimi administrativ. Për më tepër, ato argumentuan se disa procedura gjyqësore për shqyrtimin e së drejtës së tyre të pronësisë, kanë tejkaluar kërkesën për një afat të arsyeshëm, si dhe nuk kanë pasur mjete efektive të ankimit për këtë qëllim. Së fundmi, ankuesit u ankuan në bazë të nenit 1 të protokollit nr.1 të Konventës, i marrë veç dhe në lidhje me nenin 14 të Konventës, për shkeljen e të drejtave të tyre të pronësisë.

4. Më 31 mars 2005, Gjykata deklaroi këtë aplikim si pjesërisht të papranueshëm dhe vendosi t'i komunikojë palës shtetërore disa pretendime sipas nenit 6 § 1 (në lidhje me mosekzekutimin e një vendimi të formës së prerë, si dhe kohëzgjatjen e procedurave) i marrë së bashku me nenin 13 të Konventës, nenin 1 të protokollit nr.1 dhe në lidhje me nenin 14 të Konventës. Sipas dispozitave të nenit 29 § 3 të Konventës, më 6 shkurt 2007, ajo vendosi shqyrtimin e themelit dhe pranueshmërisë së çështjes në të njëjtën kohë.

FAKTET

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

5. Ankuesit, të cilët janë të gjithë vëllezër e motra, kanë lindur përkatësisht më 1939, 1927, 1934, 1931, 1924, 1949 dhe 1949. Ata jetojnë në Tiranë dhe në Vlorë.

A. Procedurat në lidhje me ligjin për pronat

6. Gjatë regjimit komunist, shumë prona të zotëruara nga prindërit e ankuesve u konfiskuan nga autoritetet kundrejt asnjë kompensimi. Prona në një masë totale prej 132 hektarë lokalizohej në rajonin e Vlorës në bregdetin jugor shqiptar.

7. Më 30 mars 1994, ankuesit depozituan një kërkesë në bazë të ligjit të pronës në Komisionin e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Vlorë (Komisioni i Vlorës) me anë të së cilës kërkonin kthimin fizik të pronës së tyre.

8. Më 27 gusht 1996, Komisioni i Vlorës u caktoi ankuesve së bashku, si bashkëpronarë, 14 ha (2 ha për person) të pronës në fjalë (prona në fjalë). Vendimi u nënshkrua nga 4 prej shtatë anëtarëve të Komisionit të Vlorës.

9. Pavarësisht nga kjo, bazuar në vendimin e Komisionit, në një datë të paspecifikuar, ankuesit e regjistruan pronën e tyre respektivisht në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë.

10. Më 28 dhjetor 1998 ata kërkuan pranë Komisionit të Vlorës lëshimin e një dokumenti të ri në përputhje me kërkesat formale ligjore, i cili të ishte i nënshkruar nga të gjithë anëtarët e Komisionit.

11. Më 6 janar 1999, me anë të dokumentit nr.76, Kryetari i Komisionit të Vlorës iu përgjigj ankuesve, duke i informuar se Komisioni tashmë e kishte konfirmuar titullin e tyre të pronësisë në vendimin e tij datë 27 gusht 1996. Për çdo rast, në zbatim të ligjeve në fuqi në kohën materiale në fjalë, kompetenca për korrigjimin formal të dokumenteve të Komisionit i takonte gjykatave.

B. Procedurat me Ministrinë e Turizmit si palë

12. Më 25 nëntor 1996, Ministria e Turizmit, me anë të një dekreti nr.20/2 (dekreti), i dha me qira A.L. një pjesë toke (pjesë e pronës së ankuesve) për qëllime biznesi.

13. Më 29 dhjetor 1997, ankuesit paraqitën ankimin e tyre përpara Gjykatës së Tiranës për ta rrëzuar këtë dekret.

14. Më 17 shkurt 1998, Gjykata e Tiranës e anuloi dekretin, bazuar në faktin se transaksioni kishte të bënte me një pronë private.

15. Më 16 qershor 1998 Gjykata e Apelit Tiranë e rrëzoi vendimin e Gjykatës së Rrethit dhe ruajti vlefshmërinë e dekretit, duke deklaruar se vendimi i Komisionit i datës 27 gusht 1996 ishte i pavlefshëm për faktin se nuk ishte nxjerrë në përputhje me kërkesat formale. Rrjedhimisht, ankuesit nuk mund të pretendonin për titull pronësie mbi pronën në fjalë.

16. Më 10 qershor 1999, pasi çështja ishte apeluar nga ankuesit, Gjykata e Lartë e rrëzoi gjykimin e Gjykatës së Apelit të datës 16 qershor 1998, me arsyetimin se vendimi ishte jologjik dhe e dërgoi çështjen sërish për rigjykim në Gjykatën e Apelit.

17. Më 10 nëntor 1999, Gjykata e Apelit Tiranë, pasi e kishte kaluar në seancë gjyqësore çështjen, e refuzoi kërkesën e ankuesve, duke arsyetuar se kërkesa ishte depozituar për gjykim në gjykatën e rrethit pasi afati njëmuor që parashikonte ligji kishte mbaruar.

18. Më 17 janar 2001, Gjykata e Lartë e ruajti në fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit.

C. Procedurat mbi kthimin e pronës K.B.

19. Ndërkohë, më 9 tetor 1997, Komisioni i Vlorës i njohu K.B.-nëna e A.L.-si kompensim, të njëjtën pjesë trualli që Ministria i kishte dhënë për arsye simulimi më parë djalit të saj.

20. Në një datë të paspecifikuar, K.B. ia dhuroi tokën djalit të saj.

21. Në bazë të kërkesës së A.L. me anë të urdhrin nr.3, datë 11 qershor 1999, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë, e fshihi titullin e pronësisë së ankuesit për këtë pjesë trualli dhe regjistroi A.L. si pronarin e saj.

D. Procedurat me A.L. si palë

22. Më 13 dhjetor 1999, në vijim të një padie civile të ngritur nga A.L., Gjykata e Rrethit Vlorë e deklaroi nul dhe rrëzoi vendimin e Komisionit të Vlorës të datës 27 gusht 1996 që njihte pronësinë e ankuesve për këtë pjesë trualli, duke arsyetuar se nuk ishte lëshuar në përputhje me kërkesat formale të ligjit (shih të dhënat e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë të datës 16 qershor 1998).

23. Më 17 mars 2000, Gjykata e Apelit Vlorë ruajti në fuqi vendimin dhe arsyetimin e gjykatës së rrethit, duke shtuar se Komisioni i Vlorës e kishte tejkaluar juridiksionin e vet duke marrë vendime mbi pronat, të cilat shteti i kishte destinuar për qëllime biznesi.

24. Më 17 janar 2001, Gjykata e Lartë konfirmoi se vendimi i Komisionit të Vlorës ishte nul dhe i pavlefshëm, pasi nuk ishte lëshuar në përputhje me kërkesat formale të ligjit. Rrjedhimisht, nuk kishte më efekt përsa i përket ankuesve ose palëve të treta. Pavarësisht nga kjo, gjykata i rrëzoi vendimet e dhëna në shkallën e parë dhe të dytë dhe i ndërpreu procedurat.

E. Procedurat me Komisionin e Vlorës si palë

1. Procedura të zakonshme

25. Më 18 prill 2000, ankuesit nisën procedurat me Gjykatën e Vlorës, duke kërkuar anulimin e vendimit të Komisionit të Vlorës në favor të K.B. Më 6 shkurt 2001, Gjykata e Rrethit Vlorë e rrëzoi kërkesën e ankuesve duke qënë se vendimi i Komisionit të Vlorës në favor të tyre, ishte deklaruar nul dhe i pavlefshëm me anë të vendimit të Gjykatës së Rrethit Vlorë, datë 13 dhjetor 1999.

26. Më 25 maj 2001, Gjykata e Apelit Vlorë, pas shqyrtimit të apelit të ankuesve, refuzoi argumentet e këtyre të fundit mbi pavlefshmërinë e vendimit të Komisionit që i njihte pronën K.B., duke u shprehur se ishte i pabazuar. Ajo refuzoi gjithashtu, kërkesën e tyre të dytë, duke vlerësuar se një akt i parregullt, edhe pse nuk konsiderohet formalisht i pavlefshëm, siç është në këtë rast, nuk duhet të ketë asnjë efekt ligjor.

27. Më 6 mars 2003, Gjykata e Lartë rrëzoi pjesërisht vendimet e shkallës së parë dhe shkallës së dytë. Ajo nuk pranoi kërkesën e ankuesve për të deklaruar se vendimi i Komisionit të Vlorës, që i njeht të drejtën e pronës mbi truallin K.B., ishte nul dhe i pavlefshëm, me argumentimin se pavlefshmëria e tij mund të vendosej vetëm në rast se në vend të tij merrej një vendim ku të njiheshin të drejtat e ankuesve mbi pronën. Ky vendim urdhëroi Komisionin e Vlorës për të lëshuar një vendim *vis-a-vis* ankuesve, në përputhje me kërkesat formale të ligjit.

1. Procedurat e ekzekutimit

28. Më 14 prill 2004, Gjykata e Rrethit Vlorë, mbi bazën e kërkesës së ankuesve, lëshoi një urdhër ekzekutimi, që e detyronte Komisionin e Vlorës të vepronte në përputhje me vendimin e Gjykatës së Lartë të datës 6 mars 2003.

29. Më 10 maj dhe 2 shtator 2004, Komisioni informoi Zyrën e Përmbartimit se nuk kishte zbatuar detyrimin sipas vendimit të Gjykatës së Lartë, për shkak se ankuesit nuk arritën të paraqesin dokumentet e nevojshme për të mundësuar marrjen e një vendimi korrekt në përputhje me kërkesat e ligjit.

30. Më 27 gusht 2004, Zyra e Përmbartimit edhe i rikujtoi përsëri Komisionit të Vlorës që të kishte në vëmendje ekzekutimin e urdhrit, të lëshuar më 14 prill 2004.

31. Më 12 maj dhe 6 shtator 2004, Zyra e Përmbartimit i ftoi ankuesit t'i zbatonin kërkesat e Komisionit dhe të paraqisnin dokumentet në lidhje me pretendimet e tyre të pronësisë.

32. Më tej, ankuesit informuan Zyrën e Përmbartimit dhe Komisionin e Vlorës se ata i kishin paraqitur dokumentet e nevojshme në kohën kur Komisioni kishte marrë vendimin në vitin 1996. Për më tepër, ata hezitoin të paraqisnin dokumentet që i ishin kërkuar, përderisa nuk kishin pranuar sugjerimin që rasti i tyre të rimerrej në shqyrtim. Sipas opinionit të tyre, vendimi i Gjykatës së Lartë kërkonte vetëm formalizimin e vendimit të vitit 1996.

33. Më 29 maj 2006, Komisioni i Vlorës vendosi të mos shqyrtonte rastin për mungesë të theksuar të dokumentacionit dhe më 30 nëntor 2006 e dërgoi çështjen për rivlerësim në Komitetin Kombëtar të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

34. Më 5 prill 2007, Komiteti Kombëtar, tashmë i njohur si Agjencia Shtetërore e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (Agjencia), informoi ankuesit se, pavarësisht se dosja e Komisionit në fakt ishte plotësuar, vendosi pezullimin e procedurave derisa Qeveria të realizojë planet e duhura për vlerësimin e pronës.

II. LIGJI PËRKATËS VENDAS

A. Kushtetuta

35. Kushtetuta shqiptare, lidhur me këtë, citon sa më poshtë:

Neni 41

1. E drejta e pronës private është e garantuar.
2. Prona fitohet me dhurim, me trashëgimi, me blerje dhe me çdo mënyrë tjetër klasike të parashikuar në Kodin Civil.
3. Ligji mund të parashikojë shpronësime ose kufizime në ushtrimin e së drejtës së pronës vetëm për interesa publike.
4. Shpronësimet ose ato kufizime të së drejtës së pronës që barazohen me shpronësimin, lejohen vetëm përkundrejt një shpërblimi të drejtë.
5. Për mosmarrëveshjet lidhur me masën e shpërblimit mund të bëhet ankim në gjykatë.

Neni 42 §2

Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetuese dhe ligjore ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.”.

Neni 142 §3

Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore.”.

Neni 131

Gjykata Kushtetuese vendos përf) gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

Neni 181

1. Kuvendi, brenda dy deri tre vjetëve nga hyrja në fuqi e kësaj Kushtetute, nxjerr ligje për rregullimin e drejtë të çështjeve të ndryshme që lidhen me shpronësimet dhe konfiskimet e kryera para miratimit të kësaj Kushtetute, duke u udhëhequr nga kriteret e nenit 41.

2. Ligjet dhe aktet e tjera normative të miratuara para datës së hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute dhe që kanë të bëjnë me shpronësimet dhe konfiskimet, do të zbatohen kur nuk vijnë në kundërshtim me të.”.

B. Ligji i kthimit dhe kompensimit të pronave (ligji nr.7698 i datës 15 prill 1993, i amenduar me ligjet nr.7736 dhe nr.7765 të vitit 1993, ligjet nr.7808 dhe nr.7879 të vitit 1994, ligji nr.7916 i vitit 1995, ligji nr.8084 i vitit 1996 dhe i abroguar nga ligji nr.9235 i datës 29 korrik 2004 dhe së fundmi i amenduar nga ligji nr.9388 i vitit 2005 dhe ligji nr.9583 i vitit 2006).

36. Ligji mbi kthimin dhe kompensimin e pronave ka pësuar një sërë ndryshimesh gjatë katërmëdhjetë viteve të fundit. Ndryshimet kryesore për ligjin e parë të pronësisë të vitit 1993 erdhën si rezultat i dy ligjeve, të cilat hynë në fuqi respektivisht në vitet 2004 dhe 2006. Prandaj, këtej e tutje do t'i referohemi respektivisht si ligji i pronës i vitit 1993, ligji i pronës i 2004 dhe ligji i pronës i vitit 2006. Dispozitat përkatëse të secilit nga këto ligje janë përmbledhur si më poshtë vijon:

1. Ligji i pronës i 1993

37. Sipas ligjit të vitit 1993, ish-pronarët e shpronësuar nga regjimi i asaj kohe dhe trashëgimtarët e tyre kishin të drejtën e pretendimit të pronësisë mbi pronat e tyre origjinale. Me vendosjen e pronësisë, atyre iu njoh e drejta për të marrë pronën në formën e pasurisë së paluajtshme ose me anë të kompensimit në natyrë (në një maksimum prej 10,000 m²) ose në vlerë në rast se plotësohej njëri prej këtyre kushteve: nëse prona e pretenduar ishte: 1. lëndinë, kullotë, tokë pyjore, bujqësore ose jobujqësore; 2. nuk ishte subjekt i ligjit nr.7501 të datës 19 korrik 1991; 3. ishte e zotëruar nga shteti; 4. ishte projektuar si e përshtatshme për ndërtim dhe ndodhej brenda vijave kufizuese të një rrethi.

Seksioni 16 i ligjit parashikon format e kompensimit si më poshtë, për pronën që nuk mund të kthehej: a) detyrime shtetërore, ekuivalente me kompensimin e zotëruar, si dhe një opsion i blerjes së aksioneve në ndërmarrje shtetërore të privatizuara nga Qeveria ose në aktivitete të tjera nëpërmjet lëshimit të huave; b) një pjesë toke ekuivalente ose zonë ndërtimi pranë një zone urbane, në përputhje me rregullat e përgjithshme të zhvillimit urban; c) një pjesë toke ekuivalente në një zonë turistike, në përputhje me rregullat e përgjithshme të zhvillimit urban. Këshilli i Ministrave kishte autoritetin të përcaktonte rregulla të detajuara për hartimin e metodave dhe vendosjen e afateve kohore limit për marrjen e një kompensimi të tillë.

38. Për më tepër, ligji i vitit 1993 krijoi Komisionin e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave si organin kompetent administrativ, që do të merrej me pretendimet e ish-pronarëve në lidhje me kthimin dhe kompensimin e pronave të tyre. Gjithsesi, ky ligj nuk parashikonte një afat kohor brenda të cilit do të apelohej vendimi, në mënyrë që të evitonte bërjen e tij të detyrueshëm.

2. Ligji mbi pronën i vitit 2004

39. Ligji mbi pronën i vitit 2004, i cili anulonte ligjin e mëparshëm, parashikonte dy forma të kthimit të pronave të paluajtshme, që do të thotë kthimin sipas disa kushteve të caktuara të pronës origjinale dhe kompensimin në rast të pamundësisë nga ana e autoriteteve për të kthyer pronën origjinale. Kthimi nuk ishte i kufizuar në masë. Ligji parashikonte pesë forma të kompensimit: a) pronë të së njëjtës natyrë; b) pronën të çdo natyre tjetër; c) aksione në kompani të zotëruara nga shteti; d) vlera e pronave të zotëruara nga shteti në proces privatizimi; dhe e) një shumë parash që i korrespondojnë vlerës së atribuar pronës në kohën e marrjes së vendimit (seksioni 11). Ky ligj krijoi Komitetin Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave, të përbërë prej pesë anëtarësh të zgjedhur nga Parlamenti. Roli i tij ishte të vendosë mbi ligjshmërinë e vendimeve të komisioneve lokale mbi pretendimet për kthimin dhe kompensimin e pronave (seksionet 15 dhe 17). Këshilli i Ministrave përcakton rregullat dhe kriteret e tyre (seksioni 13).

40. Seksioni 19 parashikon ekzekutimin e vendimeve që njihnin të drejtën e kompensimit brenda gjashtë muajve të parë të çdo viti financiar. Me hyrjen e tij në fuqi, personat që mund të pretendonin kthimin ose kompensimin e pronave të tyre, duhet të depozitonin kërkesat e tyre pranë komitetit rajonal brenda 31 dhjetorit 2007. Ligji i njihte komitetit kompetencën për të vendosur mbi njërën nga format e kompensimit, por ankuesit nga ana tjetër mund ta shprehnin me shkrim preferencën e tyre mbi formën e kompensimit. Vendimi i komisionit lokal mund të apelohej në komitetin shtetëror (seksioni 20) dhe nëpërmjet gjykatave të faktit brenda tridhjetë ditëve nga data e lëshimit të vendimit.

41. Më 28 prill 2005, Parlamenti adoptoi një ligj, në të cilin përcaktonte metodën me të cilën duhet të vlerësohej prona e paluajtshme për qëllime kompensimi. Implementimi i saj iu la Komitetit Shtetëror për Kompensimin dhe Kthimin e Pronave, i cili duhej të siguronte hartat e duhura për vlerësimin e pronave.

42. Me qëllim që të zbatoheshin vendimet e komisioneve që njihnin kompensimin në para, seksioni 23 i ligjit të vitit 2004 parashikon vendosjen e një fondi 10-vjeçar të kompensimit të pronës, qëllimi i të cilit ishte siguri i mbështetjes financiare për këto kompensime. Ligji i vitit 2004 u mbikëqyr nga të dyja gjykatat, ajo Kushtetuese dhe Gjykata e Lartë.

Më 24 mars 2005, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arritën në përfundimin se ligji mbi pronën i vitit 2004 nuk kishte asnjë efekt prapaveprues dhe se dispozitat e tij, nuk mund të

kishin asnjë efekt mbi të drejtat e pronësisë të njohura nga vendimet administrative ose ato gjyqësore, të lëshuara përpara hyrjes së tij në fuqi.

3. Ligji mbi pronën i vitit 2006

43. Më 17 korrik 2006, ligji mbi pronën i vitit 2004 u amendua me anë të ligjit mbi pronën të vitit 2006, hyrë në fuqi më 17 gusht 2006. Ai parashikon, *inter alia*, themelimin e Agjencisë për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave si një organ i ri kompetent për të vendosur lidhur me pretendimet e kthimit dhe kompenimit të pronave (seksioni 15). Ligji i ri shfuqizoi seksionet 11 §2; 19 dhe 20 të ligjit të mëparshëm, i cili, *inter alia*, parashikon procedurat për ekzekutimin e vendimeve të cilat njihnin kompensimin e ish-pronarëve.

E DREJTA

1. PRETENDIMET PËR SHKELJEN E NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS

44. Ankuesit pretenduan për shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës sa i takon mosekzekutimit të një vendimi përfundimtar dhe tejzgjatjen e procedurave civile. Në lidhje me sa më sipër, neni 6 § 1 citon si më poshtë vijon:

“Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur, e paanshme, e krijuar ligjërisht..., e cila do të vendosë qoftë për mosmarrëveshjet mbi të drejtat dhe detyrimet e tij me karakter civil,.....”.

45. Gjykata vlerëson se ndërkohë që të dyja pretendimet kishin të bënin me të njëjtën situatë faktike, çështjet e Konventës janë krejtësisht të ndryshme dhe kërkojnë një vlerësim të veçantë.

A. Pretendimi për mosekzekutimin e një vendimi gjyqësor final

1. *Pranueshmëria*

46. Gjykata vlerëson se ky pretendim është i bazuar sipas kuptimit të nenit 35 § 3 të Konventës. Më tej ajo vëren se nuk është i papranueshëm mbi baza të tjera. Prandaj, për këtë arsye e deklaroi si të pranueshëm.

2. *Meritat*

a) Komentet dhe vëzhgimet e palëve

47. Ankuesit argumentuan se autoritetet shqiptare, duke mos ekzekutuar vendimin e Gjykatës së Lartë të datës 3 mars 2003, kanë mohuar efektin real të të drejtave të tyre sipas parashikimeve të nenit 6 të Konventës.

48. Pala shqiptare kundërshtoi argumentet e parashtruara nga ankuesit. Ata argumentuan se me qëllim zbatimin e vendimit, Zyra e Përmbartimit dhe Komisioni i Vlorës i kërkuar ankuesve të paraqesin dokumentet e nevojshme. Sipas opinionit të tyre, shteti nuk mund të konsiderohej përgjegjës për mungesën e dëshirës për të bashkëvepruar nga ankuesit me autoritetet. Përderisa autoritetet vendase ndërmorën të gjitha masat e nevojshme, ata nuk mund të fajsoheshin për vonesën. Së fundmi, ata parashtruan se si rezultat i vendimit të Komisionit të Vlorës të datës 29 maj 2006, autoritetet kishin respektuar detyrimin e tyre për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës së Lartë të datës 6 mars 2003.

49. Ankuesit nuk ranë dakord. Ata komentuan se, me qëllim që të pajtoheshin me vendimin e Gjykatës së Lartë, Komisionit të Vlorës i duhej thjesht të nxirrte një dokument të ri në përputhje me kërkesat formale të ligjit, në vend që të vendoste *ex novo* mbi të drejtat e tyre të pronësisë mbi truallin në fjalë.

50. Ankuesit iu përmbajtën faktit se që prej vitit 2003 e deri tani kishin ndodhur shumë ndryshime legjislative në ligjin mbi kthimin dhe kompensimin e pronave e si rezultat i të cilave ato nuk duhej të ngarkoheshin për riformulimin e pretendimeve të tyre dhe/ose të siguronin dokumente të tjera. Është përgjegjësi e autoriteteve vendase për të vendosur në lidhje me pretendimet e tyre, në kohë dhe në zbatim të ligjeve në fuqi në vitin 1996. Ankuesit vlerësuan se kërkesa e autoriteteve për të paraqitur dokumente të reja ishte një përpjekje për t’iu shmangur zbatimit të vendimit përfundimtar të Gjykatës së Lartë për rastin e tyre. Ato e mbështetën këtë argument në perifraximin e vendimit të Agjencisë, që njihte faktin se dosja ishte e kompletuar dhe gati për gjykim. Së fundmi, ata konkluduan se çështja e të drejtave të tyre mbi pronën nuk kishte gjetur zgjidhje ende.

b) *Vlerësimi i gjykatës*

51. Gjykata rithekson se neni 6 § 1 i siguron çdo njeriu të drejtën për të ngritur pretendime lidhur me të drejtat dhe detyrimet e tyre civile përpara një gjykate apo trupi gjykues. Në këtë mënyrë, ajo mishëron të drejtën për t'iu drejtuar një gjykate", një aspekt të së cilës e përbën e drejta për akses, që nënkupton të drejtën për të iniciuar procedurat gjyqësore për çështjet civile. Gjithsesi, kjo e drejtë do të mbetet iluzive nëse sistemi ligjor i një pale shtetërore kontraktuese do të lejonte që një vendim gjyqësor përfundimtar të mbetet joveprues në dëm të njërës Palë. Do të ishte e pakonceptueshme që neni 6 § 1 të parashikonte në detaje të gjitha garancitë procedurale që i njihen palëve ndërgjyqëse, - mbi procedurat gjyqësore të drejta, publike dhe të shpejta duke lënë jashtë mbrojtjen e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore. Për të interpretuar nenin 6 si një dispozitë që ka lidhje ekskluzivisht me aksesin në gjykatë dhe rregullimin e procedurave, në të vërtetë do të çonte në situata të tilla që bien ndesh me parimin e zbatimit të ligjit, të cilin shtetet palë e kanë pranuar që në momentin kur kanë ratifikuar Konventën. "Ekzekutimi i vendimit gjyqësor i dhënë nga një gjykatë, duhet të konsiderohet si pjesë përbërëse e "procesit gjyqësor" sipas qëllimit të nenit 6. Vonesat në ekzekutimin e vendimit gjyqësor mund të justifikohen në rrethana të caktuara, por nuk duhet të jenë të tilla që të dëmtojnë thelbin e së drejtës që garanton neni 6 § 1 (shih midis Hornsby kundër Greqisë, vendimi i 19 marsit 1997, raporte të gjykimeve dhe vendimeve 1997-II, p.510, § 40; Jasiuniene kundër Lituanisë, nr.41510/98, § 27, 6 mars 2003; Qufaj Co sh.p.k. kundër Shqipërisë, nr.54268/00, §38, 18 nëntor 2004; Beshiri dhe të tjerë kundër Shqipërisë, nr.7352/03, § 60, 22 gusht 2006).

52. Gjykata vëren se vendimi i Gjykatës së Lartë, datë 6 mars 2003, i ngarkoi Komisionit të Vlorës detyrën për të lëshuar një vendim *vis-a-vis* për ankuesit konform me kërkesat formale të ligjit. Më tej vëzhgon se, më 10 mars 2004, Komisioni u kërkoi ankuesve të paraqesin dokumente të reja në mënyrë që mundësonte marrjen e një vendimi të ri. Më 29 maj 2006, duke qenë se ankuesit e kishin plotësuar dosjen e tyre, Komisioni i Vlorës e referoi çështjen në organin kompetent vendas, tek Agjencia. Më 5 prill 2007, Agjencia jo vetëm që nuk vendosi nëse pozicioni i ankuesve ishte korrekt, por gjithashtu i pezulloi procedurat derisa Qeveria të kishte adoptuar planet e duhura për vlerësimin e pronësisë.

53. Gjykata vëren se vendimi i Gjykatës së Lartë i datës 6 mars 2003 nuk ishte ekzekutuar mbi mëse 4 vjet nga data e marrjes së tij. Në të vërtetë, e gjithë çështja kishte mbetur pezull në pritje të veprimeve të nevojshme nga ana e palës shqiptare. Ajo merr në konsideratë faktin se, edhe pse kundërshtimi i ankuesve për të paraqitur dokumentet e kërkuara nga Komisioni mund të ketë ndikuar në tejzgjatjen e ekzekutimit, ajo nuk mund t'i çlirojë autoritetet nga detyrimi për të ekzekutuar një vendim gjyqësor të formës së prerë, të paktën jo në rastin konkret kur një autoritet më i lartë ka përligjur pozicionin e ankuesve.

54. Në lidhje me sa më sipër, Gjykata vlerëson se çështja nuk demonstroi asnjë justifikim për moszekutimin e vendimit të datës 6 mars 2003.

55. Prandaj, nga kjo pikëpamje, ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës.

B. Kohëzgjatja e procedurave

1. Pranueshmëria

56. Gjykata vlerëson se ky ankim nuk është haptazi i pabazuar sipas kuptimit të nenit 35 § 3 të Konventës. Më tej, ajo vlerëson se çështja nuk është e papranueshme nga çdo pikëpamje tjetër. Prandaj, për këtë arsye duhet të deklarohet si e pranueshme.

2. Meritat

a) Parashtrimet e palëve

57. Ankuesit pretenduan se disa nga setet e procedurave civile në të cilat ata ishin palë e kishin tejkaluar "afatin e arsyeshëm kohor" sipas kërkesave të nenit 6 § 1 të Konventës. Ata pohuan se dështimi i gjykatave vendase për të gjykuar vlefshmërinë dhe/ose formalizimin e vendimit të Komisionit, nuk u mor në konsideratë për shqyrtim në stadin e parë të procedurave. Ata parashtruan se nuk ishte një rast kompleks, përderisa ajo kishte të bënte me pavlefshmërinë e një akti për shkak të mangësive formale të ligjit.

58. Qeveria argumentoi se tri setet e procedurave nuk kishin lidhje me njëra-tjetrën. Sipas tyre, shqyrtimi i periudhës kohore duhej bërë për secilin set të procedurave më vete. Ata pranuan gjithashtu se, duke vlerësuar mbi kohëzgjatjen e secilit set të procedurave, instancat gjyqësore të përfshira, kompleksitetin e çështjes dhe numrin e palëve ndërgjygjëse që pretendonin se kishin interesa pronësie mbi pronën në fjalë, kohëzgjatja në tërësi e procedurave nuk e tejkalonte kohën e arsyeshme sipas kërkesave të nenit 6 § 1. Për më tepër, ato parashtruan se sjellja e ankuesve nga ana tjetër përbënte pjesërisht shkakun e vonësës. Veçanërisht i referohen dëshirës së tyre për të iniciuar procedura paralele gjykimesh me objekte të ndryshme pretendimesh, si dhe mungesës së dëshirës për të bashkëpunuar me autoritetet për paraqitjen e dokumenteve të nevojshme gjatë fazës së ekzekutimit.

b) Vlerësimi i gjykatës

i) Periudha që duhet marrë në konsideratë

59. Përsa është e vërtetë se tri setet e procedurave kishin të bënë me titullin e ankuesve mbi të njëjtën pronë dhe autoritetet gjyqësore mund t'i kishin bashkuar këto procedime, sidoqoftë palët në këto procedime ishin të ndryshme dhe i referoheshin argumenteve të ndryshme ligjore. Gjykata nuk e vlerëson se shqyrtimi i periudhës kohore duhet bërë duke marrë parasysh kohëzgjatjen e të gjitha procedimeve. Gjithsesi, menaxhimi nga ana e autoriteteve për çdo set të procedurave do të shqyrtohet në paragrafin 65 më poshtë.

60. Seti i parë filloi më 29 dhjetor 1997 dhe përfundoi me vendimin e Gjykatës së Lartë të datës 17 janar 2001 prandaj ai zgjati tre vjet në pesë instanca të ndryshme. Seti i dytë filloi në një datë të paspecifikuar të paktën përpara 13 dhjetorit 1999 dhe përfundoi më 17 janar 2001; kështu që ai zgjati së paku një vit në tri instanca të ndryshme. Seti i tretë i procedurave filloi më 18 prill 2000 dhe procedurat e ekzekutimit (vendimi i formës së prerë i Gjykatës së Lartë të datës 6 mars 2003) janë ende të mbetura pezull; ky set ka zgjatur mbi shtatë vjet dhe pesë muaj deri tani.

ii) Kriteria të aplikueshme

61. Gjykata rithekson se vlerësimi i kohëzgjatjes së arsyeshme të procedurave mund të bëhet vetëm në dritën e rrethanave të çështjes dhe referuar kriterëve të mëposhtme; kompleksiteti i çështjes, sjellja e ankuesve dhe autoriteteve relevante, si dhe çfarë qëllimesh kishin ankuesit në konfliktin gjyqësor (shih, midis shumë autoriteteve të tjera, Frydlender kundër Francës (GC), nr.30979/96 § 43, ECHR 2000-VII).

iii) Aplikimi i kriterëve në rastin konkret

62. Duke pasur në vëmendje kriteret e sipërpërmendura, gjykata nuk vlerëson se kohëzgjatja e setit të parë, ashtu dhe setit të dytë të procedurave, përbën shkelje të kërkesave për kohëzgjatje të arsyeshme sipas nenit 6 § 1 të Konventës.

63. Gjykata nuk vlerëson se seti i tretë i procedurave ishte kompleks; ai kishte lidhje me heqjen e efekteve ligjore të titullit të pronësisë në fjalë, për shkak se vendimi i Komisionit nuk ishte firmosur siç duhej, një qëndrim ky i përsëritur tri herë në instanca të ndryshme dhe në procedura të ndryshme.

64. Në lidhje me sjelljen e ankuesve, gjykata vlerëson se ato nuk mund të ngarkohen me faj se kanë shkaktuar një vonesë të panevojshme. Duke pasur në vëmendje sa u parashtrua më lart (paragrafi 52-54), ato nuk mund të konsiderohen përgjegjës për vonesat në procedurat e ekzekutimit përderisa pozicioni i tyre në lidhje me paraqitjen e dokumenteve të tjera u përligj në një periudhë të mëvonshme.

65. Gjykata vëren në lidhje me sjelljen e autoriteteve, se ishin të përfshirë në të tri instancat gjyqësore. Gjykatat vendase nuk mund të thuhet se kanë qenë joaktive. Megjithatë, pavarësisht nga kjo, janë dashur shtatë vjet për të vendosur mbi titullin e ankuesve në lidhje me pronën dhe se kjo çështje nuk është vendosur akoma. Një situatë e tillë e çoi gjykatën në vlerësimin se ka shkelje të nenit 6 § 1 në lidhje me mosekzekutimin e vendimit të datës 6 mars 2003 (shih paragrafin 55 më sipër).

66. Për më tepër, duke pasur në vëmendje procedurat e shumta, gjykata do ta vlerësojë mënyrën e organizimit të secilit set procedurash. Të tri setet e procedurave lidhen me çështjen e vlefshmërisë së titullit të ankuesve mbi pronën respektivisht. Autoritetet ia dhanë këtë pronë

fillimisht ankuesve, më pas A.L. nëpërmjet një kontrate qiraje dhe në fund nënës së A.L. Për mëtej, duket sikur iniciimi i procedurave të ndara kishte për qëllim shmangien nga përfundimet e mëparshme të gjykatave. Gjykatat vendase ishin të vetëdijshme për procedurat paralele, përderisa ato i referoheshin shpesh herë (shih paragrafët 15,22 dhe 26). Ajo çfarë është më e rëndësishme është se do të kishte qenë ligjërish korrekte nëse do të bashkoheshin të gjitha procedurat. Gjykata vlerëson se një menaxhim më i mirë i të gjitha procedurave paralelisht të ndërlydhura mund të kishte kontribuar pozitivisht në përsheptimin e zgjidhjes së titullit të ankuesve. Për gjykatën, ekzistenca e procedurave të mëparshme që ngrenë të njëjtat çështje ligjore duhet të merret parasysh në vlerësimin nëse kohëzgjatja e setit të tretë të procedurave ishte e arsyeshme.

67. Bazuar në këtë fakt, gjykata rikujton sipas nenit 6 të Konventës se çdo njeri ka të drejtën e një vendimi gjyqësor përfundimtar, brenda një kohe të arsyeshme, për gjykimin e çështjeve mbi të drejtat dhe detyrimet civile. Shtetet palë janë të detyruara të modifikojnë sistemet e tyre ligjore në mënyrë që të lejojnë gjykatat të përshtasin praktikën e tyre sipas kësaj kërkesë të Konventës (shih Union Alimentaria Sanders S.A, kundër Spanjës, vendimi i 7 korrikut 1989, seria A, nr.157, pp.14-15, &38). Gjykata thekson se është detyrë e gjykatave vendase identifikimi i procedimeve relevante dhe, kur është e nevojshme, bashkimi i tyre, pezullimi ose refuzimi për të iniciuar procedura të reja të mëvonshme mbi të njëjtën çështje. Duke pasur në vëmendje kohëzgjatjen e të gjitha procedimeve në tërësi, vendimin e Agjencisë për t'i pezulluar procedurat (shih paragrafin 34 më lart) dhe dështimin e autoriteteve gjyqësore për bashkimin e procedurave me të njëjtin objekt, gjykata vlerëson se kohëzgjatja e setit të tretë të procedurave nuk është konform me kërkesat e nenit 6 të Konventës.

68. Për të gjitha arsyet e mësipërme, ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje me këtë aspekt.

II. PPRETENDIMI I NENIT 13 TË KONVENTËS

69. Sipas nenit 13 të Konventës, ankuesit argumentuan se ata nuk kishin asnjë mjet efektiv lidhur me pretendimet e tyre sipas nenit 6 § 1 të Konventës. Neni 13 parashikon si më poshtë:

“Çdo person, të cilit i kanë shkelur të drejtat dhe liritë e njohura në këtë Konventë, ka të drejtë të paraqesë një ankim efektiv përpara një instance kombëtare, edhe kur kjo shkelje ka qenë kryer nga persona që veprojnë brenda ushtrimit të funksioneve të tyre zyrtare.”.

A. Pranueshmëria

70. Gjykata vlerëson se ky pretendim nuk është haptazi i pabazuar sipas kuptimit të nenit 35 § 3 të Konventës. Më tej ajo vlerëson se nuk është i papranueshëm nga çdo pikëpamje tjetër. Prandaj, duhet të deklarohet si i pranueshëm.

B. Meritat

1. Parashtrimet e palëve

71. Pala shtetërore e kundërshtoi këndvështrimin e ankuesve. Ata vunë re se sistemi ligjor shqiptar nuk parashikonte një mjet efektiv të veçantë që të mundësonte ankuesit të trajtonin çështjen e kohëzgjatjes së procedurave. Kjo ndodh dhe për faktin se tejzgjatja e procedurave nuk ishte një tipar karakteristik i sistemit gjyqësor shqiptar dhe, për çdo rast, jurisprudenca e gjykatës nuk i detyron shtetet të krijojnë mjete të reja efektive. Për më tepër, pala shqiptare vëren se ankuesit mund të ishin ankuar në lidhje me tejzgjatjen pa arsye të procedurave përpara gjykatave vendase dhe të siguronin adresimin e çështjes së tyre.

72. Ankuesit, *inter alia*, argumentuan se nuk kishin në dispozicion asnjë mjet efektiv ligjor me anë të të cilit të pretendonin për tejzgjatje të procedurave.

2. Vlerësimi i gjykatës

73. Gjykata ka shqyrtuar më lart pretendimin e ankuesve mbi mosekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Ajo vëren në këtë respekt se pretendimi i ankuesve sipas nenit 13 është kryesisht i bazuar në mangësitë e konstatuara për krijimin e garancive procedurale, gjatë trajtimit të shkeljeve të gjetura sipas nenit 6 (shih *mutatis mutandis*, British-American Tobacco Company Ltd kundër Holandës, vendimi i 20 nëntorit 1995, seria A, nr.331, p.29, § 91). Në këto kushte, gjykata vlerëson se nuk është e nevojshme të shqyrtojë këtë aspekt të ankesës sipas nenit 13.

74. Në lidhje me pretendimin e ankuesve për mungesë të mjeteve efektive lidhur me shqyrtimin e tejzgjatjes së procedurave, gjykata rithekson se neni 13 garanton një zgjidhje efektive përpara autoriteteve vendase për shkelje të nenit 6 § 1 për të shqyrtuar çështjen brenda një kohe të arsyeshme (shih Kudla kundër Polonisë (GC), nr.30210/96, § 156, ECHR 2000-XI).

75. Siç është vendosur edhe në jurisprudencën e saj, gjykata rithekson se mjetet efektive në dispozicion të palëve ndërgjyqëse në një sistem gjyqësor vendas për ngritjen e pretendimeve rreth tejzgjatjes së procedurave janë “efektive”, sipas kuptimit të nenit 13 të Konventës, nëse ato “parandalojnë” shkeljen e pretenduar ose vazhdimin e saj, ose sigurojnë një adresim të përshtatshëm për çdo shkelje të mundshme që tashmë ka ndodhur (shih Kudla ibid., § 158). Prandaj neni 13 ofron një alternativë: një mjet ankimi është efektiv nëse mund të përdoret ose për të përshpejtuar marrjen e një vendimi nga gjykatat që shqyrtojnë çështjen, ose për t’u siguruar palëve ndërgjyqëse një adresim të përshtatshëm për vonesat që kanë ndodhur tashmë (shih Kudla ibid., § 159: Mifsud kundër Francës (GC), nr.57220/00, § 17, ECHR 2002-VIII).

76. Gjithsesi, ashtu siç gjykata ka theksuar së fundmi, zgjidhja më e mirë në terma absolutë është pa dyshim, si në shumë sfera të tjera, parandalimi i saj. Atje ku sistemi gjyqësor ka mangësi në lidhje me kërkesën mbi kohëzgjatjen e procedurave sipas nenit 6 § 1 të Konventës, krijimi i një mjeti ankimi për të përshpejtuar procedurat me qëllim parandalimin e tejzgjatjes së tyre është zgjidhja më e mirë. Ky mjet ankimi do të ofronte pa diskutim një avantazh mbi një mjet ankimi që rregullon vetëm kompensimin, meqenëse ai parandalon shkelje të mëtejshme në lidhje me të njëjtin set të procedurave, pra nuk rregullon shkeljen thjesht a *posteriori* siç ndodh me një mjet ankimi me qëllim kompensimin. Disa shtete e kanë kuptuar situatën në mënyrë perfekte, duke zgjedhur kombinimin e dy tipeve të mjeteve të ankimit, njëra e krijuar për përshpejtimin e procedurave dhe tjetra për të rregulluar kompensimin (shih Scordino kundër Italisë, nr.GC 36813/97, § 183, 186, ECHR 2006).

77. Duke iu kthyer rastit konkret, gjykata vëren, ashtu siç edhe pala shqiptare ka pranuar, se sistemi ligjor shqiptar përveç ankesave lidhur me të drejtat kushtetuese, nuk parashikon një mjet ankimi të veçantë, ashtu sikurse në çështjen e Kudla të gjykatës (e cituar më lart), të cilën ankuesit mund ta kishin përdorur me qëllim adresimin e pretendimeve të tyre për tejzgjatjen e procedurave.

78. Pohimi i tyre se tejzgjatja e procedurave nuk përbën problem në sistemin vendas është i pabazuar dhe, për çdo rast, nuk është përgjigje e ankesës së ankuesve mbi tejzgjatjen e procedurave, të cilën gjykata e gjen si të paarsyeshme.

79. Sa i takon ankesave mbi të drejtat kushtetuese në zbatim të nenit 131 të Kushtetutës, gjykata vëren se sipas kësaj dispozite individët mund të paraqesin një ankesë pranë Gjykatës Kushtetuese, nëse dhe kur ata pretendojnë një shkelje të nenit 6 të Konventës. Një ankesë e tillë do të shqyrtohet nga gjykata në fjalë vetëm pasi janë shterruar mjetet e ankimit në gjykatat me të ulëta, pavarësisht nga vonesat e mëtejshme që mund të shkaktojnë kjo.

80. Gjykata vëren më tej se edhe pse në teori Gjykata Kushtetuese mund të ofrojë adresim të përshtatshëm të ankesave për tejzgjatje të procedurave, pala shqiptare nuk ka siguruar asnjë rast të Gjykatës Kushtetuese, në të cilin kjo ka vendosur mbi tejzgjatjen e procedurave. Ndërkohë nuk është në kompetencën e Gjykatës të vendosë lidhur me një çështje të ligjit vendas që është e pazgjidhur akoma, (shih *mutatis mutandis*, De Jong, Baljet dhe Van den Brink kundër Holandës, vendimi i 22 majit 1984, seria A nr.77 p.19, §39 dhe Horvat kundër Kroacisë, nr.51585/99, § 44, ECHR 2001 - VIII), mungesa e ndonjë praktike lidhur me këtë rast tregon se sa i pasigurtë është një mjet efektiv i tillë në praktikë.

81. Lidhur me sa më sipër, Gjykata vlerëson se nuk ka një evidencë që ankimi sipas nenit 131 të Kushtetutës, mund të konsiderohet me një siguri të mjaftueshme, se përbën një mjet efektiv ankimi për pretendimet e ankuesve lidhur me tejzgjatjen e procedurave.

82. Në këtë kuptim, Gjykata çmon se në rastin konkret ka pasur një shkelje të nenit 13 të Konventës, për shkak se ankuesit nuk kanë pasur asnjë mjet ankimi me anë të të cilit të pretendonin të drejtat për “një proces gjyqësor brenda një kohe të arsyeshme”, ashtu siç garantohet nga neni 6 § 1 i Konventës.

III. PRETENDIMET PËR SHKELJE TË NENIT 1 TË PROTOKOLLIT NR.1 TË KONVENTËS NË BASHKIM ME NENIN 14 TË KONVENTËS

83. Ankuesit pretenduan se ishin viktima të shkeljes së nenit 1 të protokollit nr.1 të Konventës, të marra veç dhe në lidhje me nenin 14 të Konventës.

84. Neni 1 i protokollit 1 parashikon se: “çdo person fizik dhe juridik ka të drejtë për respektimin e pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, veçse për arsye të dobisë publike dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare”.

Dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e shteteve për të zbatuar ligjet që ato i quajnë të domosdoshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagesën e taksave, ose të kontributeve të tjera, ose të gjobave.

85. Neni 14 i Konventës parashikon:

“Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të njohura në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, opinionet publike dhe çdo opinion tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër”.

86. Pala shqiptare e kundërshtoi pretendimin e ankuesve. Ata parashtruan që vendimi i Komisionit të Vlorës i vitit 1996 nuk i investoi ato me titull mbi pronat respektive meqënëse vendimi i Komisionit ishte i pavlefshëm. Rrjedhimisht, duke pasur në vëmendje refuzimin e ankuesve për të paraqitur dokumente që mund të kishin mundësuar Komisionin të merrte një vendim mbi titullin, nuk mund të vlerësohet se ankuesit kanë të drejta pronësie të garantuara sipas këtij neni.

87. Ankuesit u ankuan se atyre iu ishte mohuar e drejta e posedimit të pronës, duke qenë se autoritetet lokale fillimisht ia dhanë atyre pronën e prindërve të tyre dhe më pas ia transferuan këtë pronë palëve të treta. Për më tepër, ata parashtruan se, duke lënë pezull marrjen e një vendimi përfundimtar mbi kërkesën e tyre për kthimin e pronës, ata ishin penguar efektivisht të shisnin pronën e tyre.

88. Gjykata rikujton, referuar jurisprudencës së saj, se “pronat” sipas kuptimit të nenit 1 të protokollit nr.1 mund të jenë “prona ekzistuese” ose asete, përfshirë këtu pretendime, mbi të cilat aplikanti mund të argumentojë se ai ose ajo ka së paku një “pritshmëri legjitime” për të përfutur gëzim paqësor të së drejtës së tij mbi pronën. Në kontrast me këtë, vetëm shpresa për të njohur mbijetesën e një të drejte të vjetër pronësie, e cila ishte e pamundur të zbatohet në mënyrë efektive prej shumë kohësh, nuk mund të konsiderohet si “pronë” sipas kuptimit të nenit 1 të protokollit nr.1, po ashtu as edhe një pretendim kushtëzues që vjen si rrjedhojë e mospërmbushjes së një kushti (shih *Malhouse kundër Republikës Çeke* (vendimi) GC nr.33071/96, 13 dhjetor 2000, ECHR 2000-XII dhe *Gratzinger dhe Gratzingerova kundër Republikës Çeke* (vendim) GC nr.39794/98 § 69, ECHR 2002-VII, me referenca të tjera; shih gjithashtu edhe çështjen *Kopecky*, në të cilën pretendimet e pronësisë së ankuesve nuk u konsiderua si një “pronë ekzistuese” (*Kopecky kundër Sllovakisë*, nr.44912/98 GC).

89. Për çështjen në fjalë, ankuesit u bazuan në pretendimet e tyre për rikthim sipas dispozitave të ligjit mbi pronat. Nuk sugjerohet që titulli i pronësisë që ata synonin të rifitonin, të mund t’u jepej pa ndërhyrjen e gjykatave. Interesi i pronësisë i shprehur nga ankuesit mbetet gjithashtu në natyrën e pretendimit dhe rrjedhimisht nuk mund të cilësohet si një “pronë ekzistuese” sipas kuptimit të jurisprudencës së Gjykatës.

90. Në dritën e jurisprudencës së saj, Gjykata nuk parashikon ekzistencën e “një mosmarrëveshjeje të vërtetë” ose “të një pretendimi të diskutueshëm” si kriter për të vendosur nëse ka “një pritshmëri legjitime” të mbrojtur nga neni 1 i protokollit nr.1. Gjykata nisat nga vështrimi se në rastet kur interesi i pronësisë është në natyrën e një pretendimi, mund të konsiderohet si një “aset” vetëm nëse ka një bazë të mjaftueshme në ligjin vendas, për shembull kur është krijuar një praktikë në gjykatat vendase, të cilat e konfirmojnë atë (shih çështjen e *Kopecky kundër Sllovakisë*, të cituar më lart).

91. Në veçanti, Gjykata vëren se gjykatat vendase, të cilat kanë vendosur mbi çështjen në instancën më të lartë, çmuan se pretendimi i ankuesve për kthimin e pronave të prindërve të tyre varej nga lëshimi i një dokumenti të ri, i cili i përmbushte kërkesat formale të ligjit. Vendimi i Gjykatës së Lartë nuk i ka investuar ankuesit me një të drejtë të zbatueshme për rikthimin e pronës së tyre (Shih *mutatis mutandis*, Stran Greek refineries dhe Stratis Andreadis kundër Greqisë, vendimi i 9 dhjetorit 1994, seria A, nr.301-B, p. 84 § 59). Për këtë arsye, vendimi nuk gjeneronte mjaftueshëm, interesa pronësie që cilësojnë një “aset”.

92. Për më tepër, duke vlerësuar se prona e pretenduar nga ankuesit i ishte dhënë tashmë K.B. (shih paragrafin 10 më sipër) dhe se gjykatat vendase ngarkuan Komisionin e Vlorës për marrjen e një vendimi për zgjidhjen e mosmarrëveshjes (shih paragrafin 27 më sipër), besimi se vendimi i ri i këtij organi administrativ, lëshuar konform me kërkesat formale ligjore, do të ishte në favor të ankuesve, nuk mund të konsiderohet si një formë pritshmërie e legjitimuar sipas nenit 1 të protokollit nr.1.

1. Gjykata rikujton se ka një ndryshim midis shpresës së rikthimit të pronës, sado e kuptueshme mund të jetë kjo shpresë, dhe ndaj një pritshmërie legjitime, e cila duhet të jetë e një natyre më konkrete se një shpresë e vakët dhe duhet të jetë e bazuar në dispozita ligjore ose në një akt ligjor siç është rasti i një vendimi gjyqësor (shih Pressos Compania Naviera S.A. dhe të tjerët kundër Belgjikës, gjykimi i 20 nëntorit 1995, seria A, nr.332, faqe 23, § 38).

93. Në këto kushte të tilla, Gjykata vlerëson se, në kontekstin e pretendimeve të tyre për rikthimin e pronës, ankuesit nuk kishin asnjë “pronë” sipas kuptimit të fjalisë së parë të nenit 1 protokollit nr.1. Garancitë e kësaj dispozite nuk përputhen me rastin në fjalë. Më tej, Gjykata vlerëson se kjo pjesë e ankimit rrjedhimisht duhet të rrëzohet si e pambështetur *ratione materiae* me parashikimet e Konventës, në zbatim të nenit 35 § 3 dhe 4 të Konventës.

94. Ankuesit pretendonin se autoritetet lokale i kishin diskriminuar në lidhje me vendndodhjen e lakmueshme të pronës në fjalë.

95. Duke pasur në vëmendje përfundimin e arritur sa më sipër, se neni 1 i protokollit nr.1 nuk është i aplikueshëm, Gjykata vlerëson se neni 14 nuk mund të zbatohet në lidhje me këtë ankim (shih *mutatis mutandis*, Polacek dhe Polackova kundër Republikës Çeke (vendimi) GC, nr.38645/97, § 61-70, 10 korrik 2002; Beshiri dhe të tjerët kundër Shqipërisë nr.7352/03, §91, 22 gusht 2006).

96. Më tej, ajo vazhdon se ky pretendim duhet të rrëzohet në përputhje me nenin 35 § 3 dhe 4 të Konventës.

IV. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

97. Neni 41 i Konventës citon se:

“Nëse Gjykata vëren se ka pasur një shkelje të Konventës ose të protokolleve, dhe nëse ligji i brendshëm i Palës së Lartë Kontraktuese në fjalë lejon një riparim pjesor që të kryhet, Gjykata do të mundësojë që pala e dëmtuar të dalë me rezultate sa më të kënaqshme.”.

A. DËMI

98. Ankuesit pretenduan shumën 2,742,774 euro në lidhje me dëmin financiar dhe 51,000 euro në lidhje me dëmin moral. Ata u bazuan në një raport vlerësimi të ekspertit, me qëllim përcaktimin e vlerës totale të pronave të pretenduara prej tyre, si dhe të fitimit të munguar.

99. Pala shqiptare i kontestoi pretendimet e ankuesve.

100. Gjykata vëren se detyrimi i shtetit për zbatimin e vendimit të datës 6 mars 2003 nuk has kundështim. Rrjedhimisht, ankuesit janë ende në kohë për të fituar të drejtat e tyre të pronësisë në lidhje me pjesën e truallit të përcaktuar. Gjykata tërheq vëmendjen se forma më e mirë e adresimit në respekt të nenit 6 është sigurimi i ankuesit sa më shpejt të jetë e mundur, se është vënë në pozita ku kërkesat e tij në lidhje me nenin 6 i janë hedhur poshtë (shih Piersack kundër Belgjikës, neni 50, vendimi i 26 tetorit 1984, seria A, nr.84, faqe 16, § 12, dhe *mutatis mutandis*, Gencel kundër Turqisë, nr.53431/99, § 27, 23 tetor 2003). E njëjta gjë paraqitet në rastin në fjalë, sidomos nga pikëpamja e shkeljeve të konstatuara dhe përfundimet e Gjykatës mbi vendimet e mëparshme me palë Shqipërinë (shih Qufaj Co sh.p.k. të cituar më lart, §54-59, dhe *mutatis mutandis*, Beshiri dhe të tjerët, të cituar më poshtë § 109).

101. Prandaj ajo vlerëson se pala shqiptare duhet të sigurojë, nëpërmjet mjeteve të përshtatshme dhe me shpejtësi, ekzekutimin e vendimit përfundimtar të gjykatës vendase (shih midis autoriteteve të tjera teteriny kundër Rusisë nr.11913/03 § 56, 30 qershor 2005, Apostol kundër Gjeorgjisë, nr.40765/02, § 72-73, ECHR 2006).

102. Duke marrë parasysh sa më sipër dhe të gjitha rrethanat relevante, në veçanti faktin se Gjykata nuk ka gjetur një shkelje të nenit 1 të protokollit nr.1, ajo nuk spikat ndonjë lidhje midis shkeljeve të gjetura (neni 61 në aspektin e moszbatimit të vendimit final dhe kohëzgjatjes së procedurave) dhe dëmit financiar të pretenduar. Për rrjedhojë Gjykata e refuzon këtë pretendim.

103. Gjykata gjithsesi vlerëson faktin se ankuesit duhet të jenë ndjerë të dhunuar dhe stresuar në lidhje me natyrën e shkeljes së neneve 6 § 1 dhe 13 të Konventës. Duke vendosur në baza të barabarta, i jep çdo aplikanti një dëmshpërblim prej 7,000 eurosh secilit në lidhje me dëmin moral.

C. Kosto dhe shpenzime

104. Ankuesit të cilët morën 850 euro si ndihmë ligjore nga Këshilli i Europës në lidhje me prezantimin e çështjes së tyre, kërkuan si shtesë 6,000 euro për kostot dhe shpenzimet e kryera përpara gjykatave vendase dhe përpara Gjykatës, nuk sollën një paraqitje të detajuar për të mbështetur pretendimin e tyre mbi kostot dhe shpenzimet.

105. Pala shqiptare e kundërshtoi pretendimin e tyre.

106. Gjykata vuri re se nuk kishte prova të mjaftueshme në dokumente ku të vërtetohej se shpenzimet e pretenduara ishin faktikisht reale. Për rrjedhojë, Gjykata, nuk do të japë asnjë dëmshpërblim në lidhje me këtë pretendim.

D. INTERESI I MUNGUAR

107. Gjykata e vlerëson si të përshtatshme që interesi i munguar duhet të bazohet në kursin monetar të Bankës së Europës Qendrore, së cilës i duhet t'i shtohen edhe tri për qind pikë.

PËR KËTË ARSYE, GJYKATA NJËZËRI:

1. Deklaron ankimet sipas nenit 6 §1 (në lidhje me zbatimin e vendimit final, datë 6 mars 2003 dhe tejzgjatjen e procedurave) të marra veç dhe bashkë me nenin 13 të Konventës si të pranueshme dhe pjesën tjetër të ankimit, si të papranueshme.

2. Vendos se ka pasur shkelje të nenit 6 §1 të Konventës, në lidhje me mosekzekutimin e vendimit final, datë 6 mars 2003.

3. Vendos se ka pasur shkelje të nenit 6 §1, përse i përket tejzgjatjes së setit të tretë të procedurave.

4. Vendos se nuk është nevoja të shqyrtohet ankimi sipas nenit 13 të Konventës, në lidhje me nenin 6 §1, përse i përket mosekzekutimit të vendimit final, datë 6 mars 2003.

5. Vendos se ka pasur shkelje të nenit 13 në lidhje me nenin 6 § 1 të Konventës, përse i përket tejzgjatjes së setit të tretë të procedurave.

6. Vendos se:

a) Pala përgjegjëse duhet t'i paguajë çdo ankuesi, brenda tre muajve nga data kur vendimi bëhet final në përputhje me nenin 44 § 2 të Konventës, shumën prej 7,000 eurosh në lidhje me dëmin moral për shkeljet e konstatuara, të cilat do të konvertohen në monedhën vendase të shtetit përgjegjës sipas kursit të aplikuar në datën e vendosjes së saj, plus edhe ndonjë taksë të mundshme që mund të ngarkohet;

b) Pas mbarimit të afatit tremujor, në rast mospagese, do të paguhet një interes i thjeshtë mbi shumën e mësipërme në një masë të barabartë me kursin monetar të Bankës së Europës Qendrore, për periudhën e mbarimit të afatit plus tre për qind pikë.

7. Rrëzon njëzëri pjesën tjetër të pretendimit të ankuesve për një shpërblim të drejtë.

Është hartuar në gjuhën angleze dhe është njoftuar me shkrim, më datë 23 tetor 2007, sipas rregullit 77 §§ 2 dhe 3 të rregullores së Gjykatës.

VENDIM MBI PRANUESHMËRINË
(Ankimi nr. 17029/05)
ÇËSHTJA “DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË KUNDËR SHQIPËRISË”
(Pranueshmëria)

STRASBURG
31 MARS 2005

Në këtë çështje Dhoma Kombëtare e Noterisë është ankuar në Gjykatën Evropiane duke pretenduar se ligji në fuqi në Shqipëri nuk siguron të drejtat e saj sipas nenit 11 të Konventës. Ajo gjithashtu u mbështet në nenin 14 të Konventës për atë që heqja e një leje veprimtarie të një noteri në moshën 65 vjeç i diskriminonte ata përkundrejt profesioneve të tjera të lira. Mbas një analize të detajuar të ligjit shqiptar, Gjykata ka arritur në përfundimin se Dhoma Kombëtare e Noterisë dhe dhomat e noterisë në nivel rrethi nuk mund të quhen si shoqata në kuptim të nenit 11 të Konventës.

Në këto rrethana, Gjykata ka konkluduar se ankesa e organizatës aplikuese është jashtë qëllimit të nenit 11 të Konventës dhe se kjo pjesë e kërkesës është hedhur poshtë, duke qenë se nuk është në përputhje racione materiae me dispozitat e Konventës, në përputhje me nenin 35 §§ 3 dhe 4. Për sa i përket asaj që organizata aplikuese mbështetet gjithashtu në nenin 14 të Konventës, Gjykata ka vërejtur se kjo dispozitë nuk ka një qenësi të pavarur, por plotëson dispozitat e tjera thelbësore të Konventës.

Në çështjen Dhoma Kombëtare e Noterisë kundër Shqipërisë

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (seksioni i katërt), mbledhur në datën 6 maj 2008, si dhomë e përbërë nga:

Nicolas Bratza, *Kryetar*
Lech Garlicki
Ljiljana Mijovic
David Thor Bjorgvinsson
Jan Sikuta
Paivi Hirvela,
Mihai Poalelungi, *gjyqtarë*
dhe Fatos Araci, *zëvendësregjistrues i seksionit*,
duke pasur parasysh ankimin e mësipërm të paraqitur më 3 maj 2005,
duke diskutuar çështjen, ka vendosur si vijon:

FAKTET

Aplikanti është Dhoma Kombëtare e Noterisë së Shqipërisë (organizata aplikuese). Organizata aplikuese përfaqësohet përpara Gjykatës nga kryetarja e saj dhe përfaqësuese, znj. Sh. Kurti.

A. Rrethanat e rastit

Faktet e rastit, siç janë paraqitur nga organizata aplikuese, mund të përmbliidhen si vijon:

Organizata aplikuese u ngrit në bazë të ligjit nr.7829, datë 1 qershor 1994 (ligji për noterinë), i cili u ndryshua nga ligji nr.8790 i datës 10 maj 2001 dhe ligji nr.9216 i datës 1 prill 2004.

Përpara vitit 1994, një noter publik në Shqipëri quhej si një nëpunës publik dhe roli e profesioni i noterit nuk njiheshin si një profesion i lirë.

Në një datë të papërcaktuar me hollësi, organizata aplikuese u bë anëtare e Bashkimit Ndërkombëtar të Noterëve Latinë (Union Internacional del Notariado Latino, UINL).

Procedimet në gjykatat brenda vendit

Në një datë të papërcaktuar me hollësi, organizata aplikuese paraqiti një ankesë kushtetuese përpara Gjykatës Kushtetuese, duke u ankuar se ligji nr.9216, datë 1 prill 2004 ishte në kundërshtim me Kushtetutën. Sipas organizatës aplikuese, ligji i jepte Ministrit të Drejtësisë kontroll mbi ushtrimin e profesionit të noterit, çka nuk ishte në përputhje me natyrën e profesioneve të lira, duke cenuar në këtë mënyrë të drejtat e saj për lirinë e mbledhjes. Ajo argumenton se karakteri i organizatës së saj ishte i ngjashëm me atë të organizatave që nuk kanë qëllim fitimi. Ajo ishte e mendimit se ligji i ri kishte vënë në zbatim rregulla të zbatueshme ndaj nëpunësve publikë të shërbimit civil edhe për noterinë. Në veçanti, seksionet 6 § 6, 7(f), 9 § 3, 13 § § 3 dhe 5, 14 § 3, si edhe 20 § 5 parashikonin që vendimet më të rëndësishme të marra nga Dhoma Kombëtare e Noterisë të miratoheshin nga ministri i Drejtësisë, duke e zhveshur kështu atë nga fuqitë e veta vendimmarrëse dhe duke cenuar pavarësinë e saj. Sipas organizatës aplikuese, ligji i jep ministrit të Drejtësisë pushtete që janë përtej rolit të tij mbikëqyrës, duke ia nënshtuar noterët varësisë hierarkike. Së fundmi, organizata aplikuese kundërshtoi kufirin e moshës së vendosur nga ligji mbi ushtrimin e profesionit të noterit, sepse është në mospërputhje me parimin e ushtrimit të profesioneve të lira.

Më 19 janar 2005, Gjykata Kushtetuese e hodhi poshtë ankesën e organizatës aplikuese dhe pohoi kushtetutshmërinë e ligjit të kundërshtuar. Gjykata vlerësoi se baza për kufizimet mbi ushtrimin e profesionit të noterit, në kundërshtim me profesionet e tjera të lira, duhet të gjendet në pasojat publike të veprimeve të noterëve, si edhe në kontrollin që shteti kishte nevojë të ushtronte mbi shërbimet e noterëve, me qëllim që të garantonte interesin e bashkësisë.

B. Ligji dhe praktika përkatëse e vendit

1. Kushtetuta shqiptare, në pjesët e saj përkatëse, lexon si vijon:

Neni 131

“Gjykata Kushtetuese vendos për:

a) pajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare, siç parashikohet në nenin 122;”

Neni 134 §§ 1 (f) dhe 2

“1. Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje vetëm me kërkesë të: ... f) partive politike dhe organizatave të tjera; ...

2. Subjektet e parashikuara nga nënparagrafët ... f ... të paragrafit 1 të këtij neni mund të bëjnë kërkesë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre.”.

2. Ligji për noterinë (ligji nr.7829 i 1 qershorit 1994, ndryshuar nga ligji nr.8790 i 10 majit 2001 dhe ligji nr.9216 i 1 prillit 2004).

Në përputhje me ligjin për noterinë të vitit 1994, i ndryshuar në vitin 2001, profesioni i noterit në Shqipëri u quajt një profesion i lirë dhe noterët, në ushtrimin e profesionit të tyre, ishin të pavarur dhe të detyruar vetëm nga normat ligjore në fuqi. Për qëllimin e ushtrimit të detyrave të tij, një noter ishte i barasvlefshëm me një nëpunës të shërbimit civil publik dhe gëzonte mbrojtje sipas ligjit.

Ligji parashikon strukturën dhe organet e profesionit të noterisë. Ai parashikon që noterët të organizohen në nivel rrethi dhe nivel kombëtar. Të gjithë noterët praktikantë të angazhuar, përfshirë brenda një rrethi, duhet të jenë anëtarë të dhomës së noterisë për atë rreth. Ligji parashikon se dhoma e noterisë është një entitet dhe si e tillë duhet të regjistrohet në përputhje me procedurat e parashikuara për të regjistruar një entitet ligjor. Organet drejtuese të dhomave të noterisë në nivel rrethi janë mbledhja e përgjithshme e të gjithë noterëve praktikantë në atë rreth dhe këshilli i dhomave të noterisë. Ligji parashikon me hollësi fuqitë e secilit nga këto organe. Masa disiplinore, të tilla si: një vërejtje, vërejtje me paralajmërim për shkarkim apo edhe një gjobë, merren nga dhomat e noterëve në nivel rrethi. Masa disiplinore e shkarkimit merret nga ministri i Drejtësisë.

Neni 36 i ligjit rregullon Dhomën Kombëtare të Noterëve, e cila përbëhet nga noterët e zgjedhur nga mbledhja e përgjithshme e dhomave të noterisë në nivel rrethi. Organet qendrore të Dhomës Kombëtare të Noterisë janë mbledhja e përgjithshme e përfaqësuesve të dhomave të noterisë në nivel rrethi, këshilli kombëtar dhe kryetari. Detyrat e kryetarit dhe të këshillit kombëtar përcaktohen në statutin e Dhomës Kombëtare të Noterisë, i cili miratohet nga mbledhja e saj e përgjithshme. Ligji përcakton detyrat në vijim si më kryesoret e kryetarit të Dhomës Kombëtare të Noterisë: a) të bashkërendojë veprimtarinë e të gjitha dhomave të noterisë që veprojnë në nivel rrethi; b) të përfaqësojë dhe mbrojë interesat e dhomave të noterisë në nivel rrethi përpara autoriteteve shtetërore dhe institucioneve të tjera; c) të hartojë një Kod të Etikës Profesionale për t'u miratuar nga ministri i Drejtësisë; d) të miratojë një statut tip të dhomave të noterisë në nivel rrethi, si edhe rregullat e tyre të brendshme të procedurës; e) të hartojë dhe të përditësojë regjistrat kombëtarë dhe rajonalë të noterëve; dhe f) të përcaktojë shumën e fondeve për t'u livruar këshillit kombëtar për kryerjen e detyrave të tij.

Ligji përshkruan procedurën për të hyrë e për të praktikuar profesionin e noterit. Kështu, përpara përfshirjes në praktikën private, një noter duhet t'i nënshtrohet një provimi hyrës, organizimi i përgjithshëm i të cilit bëhet drejtpërdrejt nga ministri i Drejtësisë. Një noter duhet gjithashtu të përfitojë një leje veprimtarie të lëshuar nga ministri i Drejtësisë përpara hyrjes në praktikën profesionale. Caktimi, transferimi dhe shkarkimi i një noteri nga detyra bëhen me urdhër të ministrit të Drejtësisë. Përpara fillimit të detyrës së tyre, noterët bëjnë një betim para ministrit të Drejtësisë apo para një personi të autorizuar në mënyrën e duhur nga ministri. Sipas ligjit të vitit 1994, largimi nga detyra i noterit nuk kushtëzohet nga mosha.

Ligji ka gjithashtu dispozita që rregullojnë, ndër të tjera, të drejtat dhe detyrimet e noterëve. Ministria e Drejtësisë, duke mbajtur parasysh mendimin e Ministrisë së Financave dhe të Dhomës Kombëtare të Noterisë, përcakton listën e tarifave noteriale. Neni 14 përcakton se Ministria e Drejtësisë mbikëqyr përmbushjen (ligjore) të detyrave nga noterët.

Në vitin 2004, Kuvendi miratoi ligjin nr.9216, datë 1 prill 2004, i cili ndryshoi shumë nene të ligjit mbi noterinë. Në veçanti, ligji i ri fuqizoi rolin e ministrit të Drejtësisë. Nenet 6 § 6, 7 (f), 9 § 3, 13 §§ 3 dhe 5, 14 § 3 dhe 20 § 5 parashikojnë që vendimet më të rëndësishme të merren nga ministri i Drejtësisë, duke mbajtur parasysh mendimin me shkrim të Dhomës Kombëtare të Noterisë. Më kryesorja, ai përcakton se transferimi i një noteri në një rreth tjetër duhet të autorizohet nga ministri i Drejtësisë. Ai i jep ministrit të Drejtësisë fuqinë që të nisë procedime disiplinore dhe për të vendosur mbi masat disiplinore që duhen marrë, edhe pse dhoma e avokatisë mund të kundërshtojë që të vërë në zbatim një masë të tillë.

Neni 6 fut një kufi maksimal moshe për profesionin e noterit. Një leje veprimtarie e një noteri do të hiqet kur noteri arrin moshën 65 vjeç.

ANKESA

Organizata aplikuese u ankua duke pretenduar se ligji në fuqi në Shqipëri në atë kohë nuk siguronte të drejtat e saj sipas nenit 11 të Konventës. Ajo gjithashtu u mbështet në nenin 14 të Konventës për atë që heqja e një leje veprimtarie të një noteri në moshën 65 vjeç i diskriminonte ata përkundrejt profesioneve të tjera të lira.

LIGJI

Organizata aplikuese u ankua, sipas nenit 11 të Konventës, se roli i fuqizuar i ministrit të Drejtësisë ndërhynte në mënyrë të pajustificuar me të drejtën e saj për lirinë e organizimit në shoqata. Ajo u mbështet gjithashtu në nenin 14 të Konventës për sa i përket ndryshimit të shpërpjesëtuar në trajtimin e tyre në krahasim me profesionet e tjera të lira, mbi bazën e caktimit të detyrueshëm të një moshe ligjore për tërheqjen nga detyra e dalje në pension nga ligji i vitit 2004.

Neni 11 parashikon:

“1. Çdo person gëzon të drejtën e lirisë së tubimit paqësor dhe të organizimit, duke përfshirë të drejtën e themelimit, me të tjerë, të sindikatave dhe të pjesëmarrjes në to për mbrojtjen e interesave të tij.

2. Ushtrimi i këtyre të drejtave nuk mund t'i nënshtrohet kufizimeve të tjera nga ato të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike në interes të sigurisë

kombëtare apo të sigurisë publike, për parandalimin e çrregullimeve apo krimeve, për mbrojtjen e shëndetit ose moralit, apo për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve. Ky nen nuk ndalon kufizime të ligjshme të ushtrimit të këtyre të drejtave nga pjesëtarë të forcave të armatosura, të policisë ose të administratës shtetërore.”

Neni 14 parashikon:

- “Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të njohura në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një pakicë kombëtare, pasuria, lindja ose çdo gjendje tjetër.” .

Gjykata vëren se kjo kërkesë nuk është bërë nga individë, por nga një organizatë (krahaso me O.V.R. kundër Ruisë (dec.), nr. 44319/98, GjEDNj 2001 – V). Gjykata vëren më tej nuk kërkohet që të shqyrtohet nëse organizata aplikuese ka pozitën e përshtatshme për të paraqitur ankesat e saj siç kërkohet nga neni 34 i Konventës, duke qenë se kërkesa është gjithsesi e papranueshme për arsyet e përcaktuara më poshtë.

Çështja e parë që duhet të përcaktojë Gjykata është nëse dhomat e noterisë janë shoqata për qëllime të nenit 11 të Konventës (*shih rastin Le Compte, Van Leuven dhe De Meyere kundër Belgjikës*, gjykimi i datës 23 qershor 1981, seritë A nr. 43, faqe 26 – 27, paragrafët 62 – 66).

Organizata aplikuese parashtroi se profesioni i noterit i bashkëlidhej një shërbimi ligjor privat. Ajo argumentoi se statusi i një noteri nuk mund të barasvlerësohej me atë të një nëpunësi të shërbimit civil. Ajo njehej se një noter plotësonte një funksion ligjor publik. Ky funksion i është dhënë noterit nga ligji dhe rregullohej drejtpërdrejt nga shteti në vend që të ishte një funksion “i deleguar”.

Gjykata vëren që në fillim se institucionet e Konventës kanë mbajtur gjithnjë qëndrimin se organet rregulluese të profesioneve të lira nuk janë shoqata në kuptimin e nenit 11 të Konventës (*shih rastin Le Compte, Van Leuven dhe De Meyere kundër Belgjikës*, cituar më lart, faqe 26 – 27, paragrafët 64-65, për sa i përket Urdhrit Belg të Mjekëve – Belgian Ordre des Medecins; *Revert dhe Legallais kundër Francës*, nr. 14331/88 dhe 14332/88, vendimin e Komisionit të datës 8 shtator 1989, vendime dhe Raporte (DR) 62, faqe 309, për sa i përket Urdhrit Francez të Arkitektëve – *French Ordre des Architectes; A dhe të Tjerët kundër Spanjës*, nr. 13750/88, vendimin e Komisionit i datës 2 korrik 1990, DR 66, faqe 188, në lidhje me Dhomen Spanjolle të Avokatisë; *Vialas Simon kundër Spanjës*, nr. 16685/90, vendimi i Komisionit i datës 8 korrik 1992, i paraportuar, në lidhje me Urdhrin Spanjoll të Mjekëve – Spanish Ordre des Medecins; O.V.R. kundër Ruisë (dec.), nr. 44319/98, GjEDNj 2001 – V, në lidhje me dhomat ruse të noterisë; dhe *Popov e të tjerët, Vakarelova, Markov e Bankov kundër Bullgarisë* (dec.)nr. 48047/99 në lidhje me dy organizata profesionale bullgare të dentistëve dhe të doktorëve). Si rregull, synimi i këtyre organeve, siç është përcaktuar nga legjislacioni, është që të rregullojnë dhe nxisin profesionet ndërsa ushtrojnë funksione ligjore publike të rëndësishme për mbrojtjen e vetë publikut. Si rrjedhim, ato nuk mund t’i ngjasojnë shoqatave të së drejtës private apo sindikatave, por mbeten të integruara brenda strukturave të shtetit.

Gjykata duhet të shqyrtojë me hollësi nëse në rastin e tanishëm, Dhoma Kombëtare e Noterisë është një shoqatë që bie brenda fushës së veprimit të nenit 11 të Konventës apo nëse është më tepër një institucion i së drejtës publike, anëtarësia e detyrueshme në të cilën nuk përbën një ndërhyrje me lirinë e organizimit në shoqata të aplikantit.

Gjykata vëren se, në mënyrë shumë të ngjashme me Urdhrin Belg të Mjekëve, organizata aplikuese u themelua jo nga individë, por nga ligjvënësi. Ajo ndjek një qëllim, i cili është në interesin e përgjithshëm-pikërisht pohimin e origjinalitetit të fakteve dhe kontratave ligjore duke ushtruar, sipas legjislacionit përkatës, një formë të kontrollit publik mbi praktikën e profesionit të noterit. Brenda kontekstit të këtij funksioni të fundit, organizatës aplikuese i kërkohet të mbajë një regjistër të noterëve praktikantë. Ajo vishet me pushtete si administrative, ashtu edhe rregullatore.

Për sa i përket strukturës së organizatës aplikuese, Gjykata vëren se ajo përshkruhet me hollësi në ligjin për noterinë. Ligji përcakton strukturën dhe funksionet e organeve qendrore si në nivel kombëtar, ashtu edhe në nivel vendor, si edhe anëtarësinë në ato organe.

Për sa i përket anëtarësisë në organizatën aplikuese, Gjykata vëren se ajo përfshin përfaqësues të dhomave të noterisë në rrethe, anëtarësia e detyrueshme e të cilëve ka prejardhjen në një vendim individual për të praktikuar një profesion, i cili nga natyra e tij kërkon një rregullim ligjor të posaçëm.

Duke pasur parasysh gjithë sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se Dhoma Kombëtare e Noterisë dhe dhomat e noterisë në nivel rrethi nuk mund të quhen si shoqata në kuptim të nenit 11 të Konventës.

Në këto rrethana, Gjykata arrin në përfundimin se ankesa e organizatës aplikuese është jashtë qëllimit të nenit 11 të Konventës dhe se kjo pjesë e kërkesës duhet të hidhet poshtë, duke qenë se nuk është në përputhje *ratione materiae* me dispozitat e Konventës, në përputhje me nenin 35 §§ 3 dhe 4.

Për sa i përket asaj që organizata aplikuese mbështetet gjithashtu në nenin 14 të Konventës, Gjykata vëren se kjo dispozitë nuk ka një qenësi të pavarur, por plotëson dispozitat e tjera thelbësore të Konventës (shih *Gaygusuz* kundër *Austriës*, gjykimi i 16 shtatorit 1996 *Raporte të Gjykimeve dhe Vendimeve* 1996 – IV, faqe 1141, § 36). Duke qenë se Gjykata ka mbajtur qëndrimin më lart, se ankesa e ankuesit nuk është në përputhje me nenin 11 të Konventës, ajo nuk mund të shqyrtojë çfarëdo lidhje të qëllimshme me nenin 14.

Në përputhje me këtë, kjo pjesë e kërkesës nuk është në përputhje *ratione materiae* me dispozitat e Konventës dhe duhet të hidhet poshtë në përputhje me nenin 35 §§ 3 dhe 4.

Për këto arsye, Gjykata, njëzëri:

- E shpall kërkesën të papranueshme.

Fatos Araci
Zëvendësregjistruar

Nikolas Bratza
Kryetar

VENDIM MBI PRANUESHMËRINË
(Ankimi nr. 26937/04)
ÇËSHTJA “NIKOLAUS DHE JURGEN TRESKA KUNDËR SHQIPËRISË DHE ITALISË”

STRASBURG
29 Qershor 2006

Kjo çështje ka të bëjë me të drejtën për t’iu drejtuar Gjykatës të marrë së bashku me nenin 13 dhe nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës.

Lidhur me Italinë – Gjykata Evropiane konstaton se, në parim, i takon autoriteteve të brendshme, sidomos gjykatave, të zgjidhin problemet e interpretimit të legjislacionit të brendshëm. Roli i Gjykatës është i kufizuar për të përcaktuar, nëse procesi në tërësi, përfshirë këtu edhe atë të marrjes së provave është i rregullt. Neni 35 paragrafi 1 i Konventës kërkon që ankimet e brendshme që më pas i drejtohen Gjykatës Evropiane, të paktën nga pikëpamja e përmbajtjes dhe formës duhet të jenë konform kërkesave ligjore të parashikuara nga legjislacioni i brendshëm. Prandaj ankuesi duhet të paraqiste më parë ankesën e tij para Gjykatës së Kasacionit të Italisë.

Gjykata Evropiane konstaton se, lidhur me mundësinë e vënies para përgjegjësisë ndërkombëtare të shteteve mbi bazën e Konventës, më parë duhet përcaktuar nëse ankuesit ndodheshin “nën juridiksionin” e shtetit italian, kompetenca juridiksionale e shteteve është kryesisht territoriale, dhe në raste tejet të rralla mund të ketë kompetencë përjashtimisht jashtë-territoriale. Në rastin konkret ankuesit nuk mund të përfshihen nën juridiksionin italian, pasi proceset u shqyrtuan para gjykatave shqiptare në territor shqiptar, për pasojë Italia nuk mund të quhet përgjegjëse.

Lidhur me Shqipërinë – Ankuesit pretenduan shkeljen e nenit 6 § 1 të marrë së bashku me nenin 13 të Konventës sa i përket mos-ekzekutimit të vendimit të gjykatave të brendshme që u mundësonin gëzimin e pasurisë së kthyer.

Gjykata konstatoi se garancitë procedurale për procesin e rregullt, publik dhe të shpejtë, nuk do të kishin kuptim po të mungonte e drejta për akses në gjykatë. Neni 6 § 1 i garanton çdo personi të drejtën për të paraqitur para një gjykate pretendimet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij civile.

Në çështje konkrete pasuria që u ishte kthyer ankuesve me vendimin të KKK-Pronave ishte e caktuar si “lokal i misionit”, sipas kuptimit të nenit 1 të Konventës së Vjenës mbi Marrëdhëniet Diplomatike. Gjykata vlerëson se masat e marra nga Palët e Larta Kontraktuese në zbatim të rregullave të njohura të së drejtës ndërkombëtare mbi imunitetin shtetëror nuk mund të konsiderohen sikur vendosin në tërësi një kufizim të shpërpjestuar të së drejtës për akses në gjykatë. Prandaj duke marrë parasysh rregullat e së drejtës ndërkombëtare të përcaktuara më sipër, nuk mund t’i kërkohet palës shqiptare të nëpërkëmbë, kundër vullnetit të vet, rregullin e imunitetit shtetëror. Rrjedhimisht vendimet e gjykatave kombëtare që kanë refuzuar të urdhërojnë autoritetet për të marrë masa shtrënguese për sa i takon pronës së zotëruar nga Ambasada Italiane në Shqipëri dhe gjithashtu mosekzekutimi i vendimit të gjykatës, datë 24 prill 1997, mund të konsiderohet si një kufizim i justifikuar mbi të drejtën e ankuesve për akses në gjykatë.

Lidhur me ankimin për shkelje të së drejtës së pronësisë, Gjykata vëren se ankimi për nenin 1 të Protokollit 1, përbëhet nga tre aspekte të dallueshme: i pari ka të bëjë me paligjshmërinë e pretenduar për transferimin e pronës Qeverisë Italiane; i dyti ka të bëjë me përvetësimin e paligjshëm nga ana e palës shqiptare të fitimit të siguruar nga shitja e pasurisë së ankuesve; aspekti i tretë ka të bëjë me dështimin e autoriteteve shqiptare për t'u garantuar ankuesve gëzim të pasurisë së tyre, kthyer nëpërmjet vendimeve administrative dhe gjyqësore. Gjykata vëren se transaksioni midis palës shqiptare dhe palës italiane, të cilin ankuesit e quajnë të pavlefshëm, u krye në vitin 1991, me fjalë të tjera para 2 tetorit të vitit 1996, datë në të cilën Shqipëria ratifikoi Konventën dhe Protokollin 1 të saj. Për pasojë, kjo pjesë e ankimit është e papajtueshme *ratione temporis* me dispozitat e Konventës. Gjykata vlerëson se vendimi administrativ i KKK Pronave dhe vendimi pasues i gjykatës, u njeh të drejta mbi pasurinë e paluajtshme përbëjnë pretendim, që mund të thuhet se është i argumentuar për t'u kualifikuar si një "aset", i cili kërkon mbrojtjen e nenit 1 të Protokollit 1. Për sa kohë vendimi ka marrë formë të prerë, ai përbën titull ekzekutiv për pronën, të cilin ankuesit mund ta përdornin si bazë për të regjistruar pronën në regjistrin e pasurive si pronë të tyre, pa filluar proceset e mëtejshme administrative dhe gjyqësore, ndaj vendimi duhet të konsiderohet se gjeneron një shpresë të ligjshme të bazuar lidhur me të drejtën e pronës.

Në çështjen konkrete, Gjykata ka konstatuar tashmë se refuzimi i kërkesës së ankuesve nga autoritetet kombëtare për të lëshuar një urdhër ekzekutimi të vendimeve administrative dhe të gjykatës në favor të tyre, nuk përbën një kufizim të shpërpjesëtuar mbi të drejtën e aksesit në gjykatë, sipas nenit 6, paragrafi 1 i Konventës. Gjykata nuk ka dyshim se mosveprimi nga ana e autoriteteve shqiptare për të marrë masa ekzekutuese, ishte "në interes të përgjithshëm", për sa i përket nevojës për të shmangur prishjen e marrëdhënieve midis Shqipërisë dhe Italisë, pengimin e mirëfunksionimit të atij misioni diplomatik shtetëror në Shqipëri.

Në çështjen Nikolaus dhe Jurgen Treska kundër Shqipërisë dhe Italisë

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i tretë), i mbledhur më 29 qershor 2006, me trup gjykues të përbërë nga:

z. B.M. ZUPANČIČ, *Kryetar*

z. J. HEDIGAN

z. L. CAFLISCH

z. K. TRAJA

z. V. ZAGREBELSKY

znj. A. GYULUMYAN

z. E. MYJER, gjykatës,

dhe z. V. BERGER, regjistruar i seksionit,

duke pasur parasysh kërkesën e sipërcituar, depozituar më 4 korrik 2000,

duke pasur parasysh informacionin mbi faktet e parashtruara nga pala shqiptare, me kërkesë të Gjyqtarit Relator, në bazë të nenit 49 paragrafi 2 (a) i rregullores së Gjykatës dhe komenteve të bëra në përgjigje të pretendimeve të parashtruara nga ankuesit, pas shqyrtimit vendosi si më poshtë:

FAKTET

Ankuesit, Nikolaus dhe Jurgen Treska janë shtetas shqiptarë, lindur respektivisht në vitin 1934 dhe 1941 dhe banorë të Durrësit. Ata përfaqësohen para gjykatës nga z. M. Lana, avokat, i cili ushtron profesionin e tij në Romë.

A. Rrethanat e çështjes

Siç janë parashtruar nga ana e ankuesve dhe nga pala italiane dhe shqiptare, rrethanat e çështjes, në bazë të nenit 49 paragrafi 2 (a) të rregullores së Gjykatës, mund të përmbliken si më poshtë:

1. Parashtrimet e ankuesve

a) Historiku i çështjes

Në vitin 1950, vila e babait të ankuesve dhe toka ngjitur me të, u konfiskuan nga regjimi pa u kompensuar. Në një datë të papërcaktuar, vilës iu ndërtua një shtesë nga ana e shtetit.

Në një datë të papërcaktuar, Qeveria Italiane vuri në dijeni Qeverinë Shqiptare për qëllimin e saj në blerjen e godinës së misionit italian në Shqipëri. Në përputhje me rrethanat, ata i kërkuan qeverisë shqiptare të vendoste në dispozicion të tyre, oferta të ndryshme për blerjen.

Në datën 1 korrik 1991, Ambasada Italiane në Shqipëri arriti një marrëveshje për blerjen e dy godinave. Njëra prej godinave, përcaktuar për t'u përdorur si rezidencë private e kreut të misionit, ishte vila e atit të tyre, e konfiskuar në mënyrë të paligjshme.

Në datën 5 gusht 1991, ankuesit informuan Ambasadorin Italian në Tiranë për pretendimet e tyre të pronësisë mbi vilën, në lidhje me faktin se ajo ishte konfiskuar në mënyrë të paligjshme nga babai i tyre.

Transaksioni u përfundua nëpërmjet një marrëveshjeje ndërshtetërore, e vërtetuar me shkëmbime të notave verbale mes dy qeverive.

Sipas dispozitave të ligjit shqiptar të asaj kohe, toka nuk tjetërsohej; si rrjedhim Qeveria Shqiptare transferoi për Qeverinë Italiane vetëm të drejtën e pronësisë mbi ndërtesën.

Të drejtat përkatëse të pronësisë nuk u regjistruan në zyrën e regjistrimit të pasurive në Tiranë.

b) Procesi gjyqësor lidhur me kthimin e pronave

Në një datë të papërcaktuar, ankuesit filluan një proces civil në Gjykatën e Rrethit Tiranë, duke pretenduar të drejtat e pronësisë së tyre mbi pasurinë e konfiskuar në mënyrë të paligjshme.

Në datën 9 shtator 1992, Gjykata e Rrethit Tiranë u njohu ankuesve të drejtën mbi vilën e atit të tyre dhe urdhëroi Ministrinë e Punëve të Jashtme të bënte të mundur që ankuesit të merrnin në zotërim pronën e sipërpërmendur. Vendimi mori formë të prerë, pasi Ministria e Jashtme nuk e ankimoi më tej atë.

c) Procedurat administrative lidhur me kthimin e pronave

Në bazë të ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronave (Ligji për pronat), ankuesit paraqitën kërkesë në Komisionin e Tiranës për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave, duke pretenduar të drejtën mbi pronën e të atit të tyre.

Në datën 17 dhjetor 1994 Komisioni, duke konstatuar paligjshmërinë e konfiskimit të pasurisë, u njohu atyre vilën dhe ngastrën e tokës ngjitur me të me sip. 2,573 metra katrorë.

Për më tepër, gjykata u njohu ankuesve të drejtën mbi shtesën e ndërtesës së vilës, sipas nenit 13 të ligjit të pronave, ku shpenzimet e bëra nga shteti mbi ndryshimet strukturore dhe shtesat e ndërtesës fillestare ishin më pak, se njëzet për qind (20%) të vlerës fillestare të pronës.

Meqë ishte e pamundur që ankuesit të merrnin gjithë pjesën fillestare të tokës që u ishte njohur atyre, Komisioni ishte i mendimit që shteti kishte detyrim t'i kompensonte ata, në bazë të ligjit të pronësisë për një ngastër toke me sip. 290 metra katrorë dhe urdhëroi kthimin në natyrë të tokës me sip. 2,283 metra katrorë.

Përfundimisht, Komisioni urdhëroi që e drejta e pronësisë e ankuesve të regjistrohet në zyrën e regjistrimit të pasurive.

Gjithashtu, ankuesit u pajisën me një certifikatë regjistrimi pasurie lëshuar nga zyra e regjistrimit të pasurive, regjistrimi nr. 5401, datë 20 dhjetor 1994.

Në përgjigje të kërkesave të ankuesve për kthim të pasurisë së tyre, në datën 20 janar 1995, Ambasadori Italian në Shqipëri i vuri në dijeni ata se pretendimet e tyre për pasurinë lidhur me ambientet e Ambasadës Italiane, duhet t'i zgjidhnin me autoritetet shqiptare.

Në një datë të papërcaktuar, ankuesit ngritën padi kundër Ambasadës Italiane në Shqipëri para Gjykatës së Rrethit Tiranë, me qëllim për të rimarrë në pronësi pasurinë e tyre.

Në datën 31 tetor 2000, Gjykata e Rrethit Tiranë konkludoi se nuk kishte juridiksion për ta trajtuar këtë çështje.

d) Proceset gjyqësore lidhur me tokën e përmasave 2,283 m²

i) Proceset në juridiksionin shqiptar

Në një datë të papërcaktuar ankuesit ngritën padi në Gjykatën e Rrethit Tiranë, ku kërkonin që Ambasada Italiane në Tiranë të paguante për ta dëmin, për shkak të zënies së sipërfaqes së tokës me përmasa 2,283 metra katrorë.

Procesi u shty disa herë nga Gjykata e Rrethit për shkak të mungesës së përfaqësuesit të Ambasadës Italiane në Tiranë.

Në datën 24 prill 1997, Gjykata e Rrethit Tiranë, në mungesë të përfaqësuesit të Ambasadës Italiane, urdhëroi Ambasadën që t'u paguajë ankuesve një tarifë mujore qiraje, në shumën 3,424 dollarë amerikanë, për përdorimin e tokës prej 2,283 metra katrorë. Vendimi mori formë të prerë dhe u bë i detyrueshëm në datën 2 qershor 1997.

Në datën 10 qershor 1997, Gjykata e Rrethit Tiranë, në procedurat ekzekutuese, nxori një urdhër gjyqësor për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës së Tiranës, datë 24 prill 1997.

Në datën 29 maj 1998 dhe 8 nëntor 1999, pasi Ambasada Italiane në Shqipëri neglizhoi ekzekutimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit, datë 24 prill 1997, ankuesit depozituan dy ankime në Gjykatën Kushtetuese, duke kërkuar ekzekutimin e vendimit të formës së prerë nga ana e autoriteteve shqiptare.

Në datën 27 tetor 1998, Gjykata Kushtetuese nuk pranoi të shqyrtonte ankimin e parë, me arsyetimin se kërkuuesit nuk kanë shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, me qëllim që të kundërshtonin pasivitetin e zyrës së përmbarimit.

Në datën 10 mars 2000, Gjykata Kushtetuese nuk pranoi ankimimin e dytë, me arsyetimin se imuniteti i Ambasadës Italiane dhe paprekshmëria e ambienteve të saj, na çon në një rrethanë ku vendimi i Gjykatës së Rrethit Tiranë nuk mund të zbatohet në praktikë.

ii) Proceset në juridiksionin italian

Në datën 18 qershor 2003, me qëllim njohjen dhe ekzekutimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Tiranë, datë 24 prill 1997, nga ana e gjykatave italiane, ankuesit aplikuan në Gjykatën e Apelit Romë për lëshimin e një urdhri ekzekutimi (delibazione).

Vendimi i Gjykatës së Apelit Romë, datë 22 dhjetor 2004, komunikuar ankuesve më 24 janar 2005, rrëzoi kërkesën e ankuesve, pasi proceset në Gjykatën e Rrethit Tiranë që çuan në marrjen e vendimit të datës 24 prill 1997, janë kryer në shkelje të parimit të barazisë së palëve; kërkesë kjo, themelore në njohjen e një vendimi të huaj në Itali. Sipas gjykatës, duke dërguar njoftime afatshkurtra dhe të ngatërruara lidhur me seancat gjyqësore, gjykatat shqiptare i kanë mohuar Ambasadës Italiane në Shqipëri të drejtën për të parashtruar çështjen në mënyrë efektive dhe të përfitojë nga parimi i barazisë së palëve në proces.

Ankuesit, duke parashikuar një rekurs jo në favor të tyre, nuk ankimuan vendimin e Gjykatës së Apelit Romë, datë 22 dhjetor 2004.

2. Parashtrimet e palës italiane

Në vijim të një kërkesë për informacion mbi faktet, sipas nenit 49, paragrafi 2 (a) i rregullores së Gjykatës, pala italiane, në datën 7 prill 2005, duke pasur parasysh faktin se ambientet e Ambasadës Italiane në Shqipëri janë blerë në mënyrë të ligjshme, i kundërshtoi pretendimet e ankuesve mbi pronësinë *sine titulo*.

Ata pohuan se ligjshmëria e së drejtës së pronësisë mbi ambientet e Ambasadës Italiane në Shqipëri vjen si rezultat i një marrëveshjeje ndërkombëtare të vlefshme mes dy vendeve.

Për më tepër, ata deklaruan se vendimi i Gjykatës Shqiptare, i cili ka vendosur detyrimin e Ambasadës për të paguar një tarifë qiraje në favor të ankuesve për përdorimin e pronës së tyre, nuk ka efekte detyruese në Itali; në fakt, Gjykata e Rrethit Romë nuk e ka pranuar kërkesën e kërkuuesve për njohjen e vendimit të sipërpërmendur në Itali.

3.Parashtrimet e palës shqiptare

Në vijim të një kërkesë për informacion mbi faktet sipas nenit 49, paragrafi 2 (a) i rregullores së Gjykatës, pala shqiptare deklaroi në datën 6 prill 2005 se në vitin 1991, në bazë të një kërkesë të Ambasadës Italiane në Shqipëri, Qeveria Shqiptare vendosi në dispozicion të saj, tri ambiente pronë shtetërore. Ambasada Italiane në Shqipëri bleu dy godinat, njëra prej të cilave kishte qenë ish- pronë e të atit të ankuesve. Marrëveshja u quajt e vlefshme në datën 1 korrik 1991, me anë të shkëmbimit të “notave verbale”.

Në datën 5 nëntor 1991, nëpërmjet notës verbale nr. 2183, Ministria shqiptare e Punëve të Jashtme i transmetoi Ambasadës Italiane në Shqipëri, hartat topografike të pasurive të blera dhe konfirmoi ligjshmërinë e pronësisë mbi pronat.

Sipas palës shqiptare, në datën 2 mars 1994, me vendimin nr. 108, Këshilli i Ministrave të Shqipërisë autorizoi Ministrinë e Punëve të Jashtme të përdorë të ardhurat nga transaksioni (një shumë e përgjithshme rreth 1 936 713,37 euro) për blerjen e ambienteve të Ambasadës Shqiptare në Romë.

B. Legjislacioni i brendshëm dhe ndërkombëtar përkatës

1. Ligji ndërkombëtar përkatës

a) Konventa e Vjenës mbi Marrëdhëniet Diplomatike 1961 (hyrë në fuqi në lidhje me Shqipërinë në datën 8 Shkurt 1998)

Neni 1

“Për qëllimet e kësaj Konvente, shprehjet që vijojnë kuptohen siç përcaktohet më poshtë: i) shprehja “lokalet e misionit” tregon ndërtesat ose pjesët e ndërtesave dhe terrenin rreth e rrotull që përdoren për qëllimet e misionit, duke përfshirë edhe rezidencën e shefit të misionit, cilidoqoftë pronari i tyre.”

Neni 22

“1. Lokalet e misionit janë të paprekshme. Agjentëve të shtetit pritës nuk u lejohet të hyjnë brenda, veçse me pëlqimin e shefit të misionit.

2. Shteti pritës ka detyrimin e posaçëm që të marrë gjitha masat e përshtatshme, me qëllim që të ndalojë shkeljen ose dëmtimin e lokaleve të misionit, si dhe prishjen e qetësisë së misionit ose cenimin e dinjitetit të tij.

3. Lokalet e misionit, pajisjet e tyre dhe sendet e tjera që ndodhen aty, si dhe mjetet e transportit të misionit nuk mund të jenë objekt i asnjë kontrolli, rekuizimi, vënie dorë ose masa ekzekutimi”.

b) Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi Imunitetet Juridiksionale të Shteteve dhe Pasurive të Tyre (Rezoluta e adoptuar nga Asambleja e Përgjithshme 59/38, datë 2 dhjetor 2004).

Në përputhje me nenet 28 dhe 33 të saj, Konventa u hap për nënshkrim nga data 17 janar 2005 dhe do të mbetet e hapur për nënshkrim deri më 17 janar 2007. Si Shqipëria dhe Italia nuk e kanë firmosur. Në pjesët e saj përkatëse Konventa, citon si më poshtë:

Neni 5: Imunitetet shtetërore

“Një shtet gëzon imunitet në lidhje me territorin dhe pasurinë e tij, nga juridiksioni gjykatave të një shteti tjetër në zbatim të dispozitave të kësaj Konvente”.

Neni 6: Modalitetet për të zbatuar imunitetin shtetëror

1. “Një shtet do të respektojë imunitetin shtetëror, në zbatim të nenit 5, duke iu shmangur ushtrimit të juridiksionit të gjykatave të tij në një proces gjyqësor kundër një shteti tjetër, dhe për

këtë qëllim do të garantojë që gjykatat të vendosin me iniciativë të tyre që imuniteti i shtetit tjetër duhet të respektohet në zbatim të nenit 5.”

2. Një proces para gjykatës së një shteti do të konsiderohet i filluar kundër një shteti tjetër, nëse ky i fundit: a) është caktuar si palë në atë proces; ose b) nuk është caktuar si palë në proces, por procesi në të vërtetë kërkon të cenojë pronën, të drejtat, interesat apo aktivitetet e shtetit tjetër”.

Neni 13: Zotërimi, pronësia dhe përdorimi i pasurisë

“Vetëm në rastet kur parashikohet ndryshe mes shteteve të interesuara, një shtet nuk mund të kërkojë imunitet nga juridiksioni i gjykatave të një shteti tjetër, i cili është kompetent në procesin që lidhet me përcaktimin e: a) çdo të drejte apo interesi të shtetit që ka në pronësi apo përdorim pasurie të paluajtshme që ndodhet në shtetin palë në Konventë apo çdo detyrim të shtetit që del nga interesat e tij në lidhje me këto pasuri; b) çdo të drejtë apo interes të shtetit për pasurinë e luajtshme apo të paluajtshme që del për arsye të trashëgimisë, dhuratës apo bona vacantia; ose c) çdo të drejtë apo interes të shtetit në administrimin e pasurisë, të tillë si pasuri trustesh, prona e një falimenti apo pasuria e një kompanie në rastin kur ajo likuidohet”.

Neni 19: Imuniteti shtetëror ndaj masave shtrënguese pas marrjes së vendimit

Pas marrjes së vendimit, asnjë masë shtrënguese, e tillë si sekuestrimi, bllokimi apo konfiskimi i pasurisë së një shteti, nuk mund të merret në një proces para një gjykate të shtetit tjetër, me përjashtim të rastit kur: a) Shteti ka dhënë shprehimisht pëlqimin për marrjen e masave të tilla, të përcaktuara nga: i) marrëveshjet ndërkombëtare; ii) një marrëveshje arbitrazhi ose një kontratë me shkrim; ose iii) një deklaratë para një gjykate ose një njoftimi me shkrim pas ngritjes së një debati mes palëve; ose b) Shteti ka akorduar apo ka caktuar pronën për të përmbushur pretendimin, i cili është objekt i këtij procesi; ose c) është vendosur që prona të përdoret për një qëllim të posaçëm apo është menduar për t’u përdorur nga shteti për qëllime të tjera, të ndryshme nga ato qeveritare jotregtare dhe kur prona gjendet në territorin e Shtetit palë në Konventë, duke pasur parasysh që masat shtrënguese pas marrjes së vendimit mund të merren vetëm ndaj pronës që ka lidhje me subjektin kundër të cilit është drejtuar procesi.”

2. Legjislacioni relevant i brendshëm i Shqipërisë

a) Kushtetuta

Neni 42 (2)

2. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

Neni 122

1. Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji. Ndryshimi, plotësimi dhe shfuqizimi i ligjeve të miratuara me shumicën e të gjithë anëtarëve të Kuvendit për efekt të ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare bëhet me të njëjtën shumicë.

2. Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të.

3. Normat e nxjerra prej një organizate ndërkombëtare kanë epërsi, në rast konflikti, mbi të drejtën e vendit, kur në marrëveshjen e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë për pjesëmarrjen në atë organizatë, parashikohet shprehimisht zbatimi i drejtpërdrejtë i normave të nxjerra prej asaj.

Neni 131

Gjykata Kushtetuese vendos për: f) gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

Neni 142 (3)

3. Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore.

b) Ligji për kthimin dhe kompensimin e pronave (Ligji nr.7698, datë 15 prill 1993, ndryshuar me ligjin nr.8084 në vitin 1996 dhe shfuqizuar me ligjin nr.9235, datë 29 korrik 2004)

Ligji për kthimin dhe kompensimin e pronave ka pësuar disa ndryshime gjatë dhjetë viteve të fundit.

Ligji i ri për pronat, miratuar në vitin 2004, parashikon dy forma të kthimit të pronave; d.m.th. kthimin e pronës sipas rrethanave të caktuara dhe kompensimin, në rastet kur është e pamundur që autoritetet të kthejnë pronën. Ligji parashikon pesë forma të kompensimit: a) me pronë të të njëjtit lloj; b) me pronë të çdo lloji tjetër, c) aksione në kompanitë në pronësi të shtetit; d) me vlerën e një pasurie shtetërore në procesin e privatizimit, e) me një shumë parash (neni 11).

Ligji i pronave i vitit 1993 (Ligji nr. 7698, datë 15 prill 1993, ndryshuar me ligjin nr. 8084 në vitin 1996), siç ka qenë në fuqi në atë kohë, në pjesët përkatëse, thotë:

Neni 4 (1)

"U njihet e drejta e pronësisë dhe u kthehen ose kompensohen në natyrë ish - pronarëve apo trashëgimtarëve të tyre ligjorë, pronat në formën e kullotës, livadhit, tokës pyjore, apo tokës bujqësore dhe jobujqësore të patrajtuar nga ligji nr. 7501, datë 19.7.1991 "Për tokën", që janë në pronësi të shtetit, kur këto prona do të tjetërsohen në truall duke u përfshirë brenda sipërfaqes së vijave të reja kufizuese ndërtimore të qendrave të banuara. Masa e kthimit ose e kompensimit në natyrë bëhet e plotë, por në të gjitha rastet jo më shumë se 10 000 m²", sipas përcaktimit të bërë në paragrafin e katërt të nenit 1 të dekretit nr. 1359 të datës 5 shkurt 1996, amenduar me ligjin nr. 8084 të datës 7 mars 1996."

Neni 13

Kur në objektin ish-pronë private vlefte e shpenzimeve të kryera përbën 20 deri në 50 për qind të vlefës së objektit, ai mund të kalojë në pronësi të ish-pronarit, pasi të jetë shlyer nga ana e tij kundërvlefte e mësipërme, mbi 20 për qind, e llogaritur në bazë të çmimeve të ndërtimit në kohën e rikthimit të pronës. Kur vlera e shpenzimeve të kryera është mbi 50 për qind të vlerës së objektit, objekti mbetet në bashkëpronësi.

Mosmarrëveshjet midis palëve zgjidhen në rrugë gjyqësore.

Neni 16

Kur trojet janë zënë me ndërtime të përhershme, pronarët kompensohen me kufijtë e shpronësimit, me mënyrat e mëposhtme:

a) me obligacione shtetërore, që do të përdoren sipas vlerës ekuivalente dhe me përparësi në marrëdhënie me shtetin si në procesin e privatizimit të objekteve shtetërore e në veprimtari të tjera që kryhen me kredi.

b) me sipërfaqe trojesh ekuivalente pranë qendrave të banuara në përputhje me planet rregullues të përgjithshëm, por jo më shumë se 5000 m²;

c) me sipërfaqe ekuivalente në zonat turistike, në përputhje me planet rregullues të përgjithshëm, por jo më shumë se 5000 m².

Pjesa tjetër, për pikat b dhe c do të kompensohet sipas mënyrave të tjera të parashikuara në këtë ligj.

3. Legjislacioni italian përkatës

Neni 64 i ligjit nr. 218, datë 31 maj 1995 (Reforma e sistemit italian në të Drejtën Ndërkombëtare Private) parashikon që vendimi i një gjykate të huaj do të njihet në Itali pa një proces në themel, nëse përmbushen kërkesat e mëposhtme:

“ a) Vendimi të jetë dhënë nga një gjykatë kompetente; b) pala kundërshtare është informuar në kohën e duhur lidhur me padinë civile në përputhje me ligjet e brendshme të shtetit ku është kryer procesi dhe që garancitë e të drejtave të mbrojtjes nuk janë shkelur; c) palët në proces janë njoftuar rregullisht për seancën gjyqësore ose janë deklaruar në mungesë, sipas ligjeve të shtetit në të cilin është kryer procesi; d) vendimi ka marrë formë të prerë në bazë të ligjeve të shtetit, ku vendimi është shpallur; e) nuk përmban dispozita, të cilat vijnë në kundërshtim me vendimin e formës së prerë dhënë nga gjyqtari italian; f) nuk po vazhdon në Itali i njëjti proces për të njëjtën çështje dhe mes palëve të njëjta; g) vendimi nuk përmban dispozita, të cilat vijnë në kundërshtim me parimet e rendit ligjor të zbatuara nga shteti italian.

ANKESA

1. Referuar nenit 6, prg 1 dhe nenit 13 të Konventës, ankuesit pretenduan se u ishte cenuar e drejta për akses në gjykatë, përse gjykata italiane rrëzoi kërkesën e tyre me objekt nxjerrjen e një urdhri-ekzekutimi të vendimit të gjykatës shqiptare.

2. Ankuesit u ankuan në bazë të nenit 6, paragrafi 1 dhe nenit 13 për neglizhencën e autoriteteve shqiptare për të ekzekutuar vendimet e gjykatave dhe për t'u mundësuar atyre zotërimin e pronës së kthyer.

3. Ankuesit pretenduan se duke zotëruar pronën e tyre *sine titulo* (tokën dhe ndërtesën shtesë) dhe duke kërkuar imunitet para gjykatave shqiptare, autoritetet italiane kanë cenuar të drejtën e tyre për të gëzuar lirisht pronën, siç është garantuar nga neni 1 i Protokollit të Parë Shtesë.

4. Së fundmi, ankuesit pretenduan se autoritetet shqiptare, duke shitur pronën e tyre, i kanë shpronësuar ata *de facto*, pa i kompensuar, duke shkelur kështu nenin 1 të Protokollit të Parë Shtesë të Konventës. Ata pohuan më tej se pamundësia për të ekzekutuar vendimet në favor të tyre, ka çuar në shkelje të së drejtës së pronës, sipas nenit 1 të Protokollit të Parë Shtesë.

E DREJTA

Ankuesit kanë parashtruar ankime - në bazë të nenit 6 paragrafi 1 të marrë së bashku me nenin 13 të Konventës dhe nenin 1 të Protokollit të Parë Shtesë - kundër Italisë dhe Shqipërisë.

Neni 6 paragrafi 1 parashikon si më poshtë:

“Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht,...nga një gjykatë..., e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet mbi të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile...”

Neni 13 parashikon si më poshtë:

“Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e njohura në këtë Konventë, ka të drejtë të bëjë ankim efektiv tek një organ i vendit të tij, edhe kur shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare”.

Neni 1 i protokollit nr.1 thotë si më poshtë:

“Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën që t'i respektohet pasuria e tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e shteteve për të nxjerrë ligje, që ato i gjykojnë të domosdoshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve të tjera, ose të jobave”.

1. Lidhur me ankimet kundër Italisë

a) Ankesa në bazë të nenit 6 (1) dhe 13 të Konventës

i) Parashtrimet e ankuesve

Duke mbajtur parasysh vendimin e Gjykatës së Apelit Romë, ankuesit pretenduan se rrethanat e çështjes nxorën në pah shkelje të së drejtës së tyre për t'u dëgjuar para gjykatës, garantuar nga neni 6 i Konventës. Ata i qëndruan mendimit se Gjykata e Apelit, Romë, e ka interpretuar në mënyrë të gabuar pretendimin e Ambasadorit Italian në Shqipëri se fakti që ai gëzonte imunitet në juridiksionin shqiptar, përbënte një pengesë për të paraqitur çështjen në mënyrë efikase para gjykatës shqiptare dhe për të siguruar barazinë e palëve në proces. Së fundi, ata argumentuan se ata nuk kishin zgjidhje juridike efektive në lidhje me shkeljen e pretenduar (neni 13 i Konventës).

ii) Vlerësimi i gjykatës

Pikësëpari, Gjykata rikujton se nuk është detyra e saj të zëvendësojë gjykatat e brendshme. I takon kryesisht autoriteteve kombëtare, sidomos gjykatave, të zgjidhin problemet e interpretimit të legjislacionit të brendshëm (shih *Eficaciones March Gallego S.A v Spain*,. Vendimi datë 19 shkurt 1998, Raportet mbi gjykimet dhe vendimet 1998-I, p. 290 paragrafi 33). Roli i Gjykatës është i kufizuar për të përcaktuar, nëse procesi në tërësi, përfshirë këtu edhe marrjen e provave, është i rregullt (shih *mutatis mutandis*, *Edwards v the United Kingdom*, vendimi i datës 16 dhjetor 1992, Seritë A nr. 247-B, f. 34-35, paragrafi 34).

Për më tepër, neni 35, paragrafi 1, kërkon që ankimet, të cilat më pas paraqiten në Gjykatë, të paraqiten më parë - të paktën nga pikëpamja e përmbajtjes dhe formës konform kërkesave ligjore të parashikuara nga legjislacioni i brendshëm - para një organi kompetent dhe jo që ankimi të vijojë pas shterimit të mjeteve juridike të papërshtatshme dhe joefektive. (Shih *Aksoy v Turkey*, vendimi i datës 18 dhjetor 1996, Raportet 1996-VI, f. 2275-76, §§ 51-52, dhe *Akdivar et al v Turkey*, vendim i datës 16 shtator 1996, Raportet mbi gjykimet dhe vendimet, 1996-VI, f. 1210, §§ 65-67). Është përcaktuar gjithashtu, se thjesht një dyshim përse i përket perspektivës së çështjes nuk është i mjaftueshëm për të përjashtuar një ankues nga detyrimi i tij për t'u ankuar në organet kompetente vendase (shih *Whiteside v the United Kingdom*, vendimi i datës 7 mars 1994, kërkesa nr. 20357/92, DR 76, f.80).

Duke marrë parasysh sa më sipër, Gjykata vlerëson se, bazuar në nenin 35, paragrafi 1 i Konventës, ankuesit duhet të depozitonin ankesën e sipërpërmendur në Gjykatën Italiane të Kasacionit, me qëllim vendosjen në vend të shkeljeve të sipërcituara. Për më tepër, Gjykata nuk gjen asnjë rrethanë përjashtuese, e cila do t'i shmangë ata nga detyrimi i shterimit të mjetit juridik të brendshëm, të përmendur më lart.

Për pasojë, kjo ankesë nuk duhet pranuar, bazuar në nenin 35, paragrafët 3 dhe 4 të Konventës për shkak të moshterimit të mjeteve juridike të brendshme.

Duke pasur parasysh përfundimet lidhur me pretendimet e ankuesve, në bazë të nenit 6, paragrafi 1 i Konventës, Gjykata vlerëson se ankuesit nuk i kanë provuar pretendimet e tyre në mbështetje të nenit 13. Për pasojë, kjo ankesë është haptazi e pabazuar dhe duhet të rrëzohet në përputhje me nenin 35, paragrafët 3 dhe 4 të Konventës.

b) Pretendimet në kuadër të nenit 1 të Protokollit të Parë Shtesë

i) Parashtrimet e ankuesve

Ankuesit pretenduan se Qeveria Italiane mban përgjegjësi, pasi ajo e dinte ose duhej ta dinte, që ambientet e blera nga shteti shqiptar ishin prona të konfiskuara dhe të pakompensuara. Për më tepër, Qeveria Italiane ka qenë e ndërgjegjshme se në vitin 1991 kuadri ligjor për kthimin dhe kompensimin e pronave për ish-pronarët ishte duke u përgatitur dhe përsëri ajo vazhdoi të kërkonte imunitet në kohën kur mund të kishte hequr dorë prej tij.

Kështu, me blerjen e pronës, Italia, e cila në atë kohë kishte ratifikuar Konventën dhe Protokollin e Parë Shtesë, nuk ka respektuar të drejtën e pronës, duke shkelur përgjegjësitë e pranuar në bazë të kësaj Konvente.

Sipas ankuesve, përgjegjësitë e shteteve kontraktuese vazhdojnë madje edhe pasi ato pranojnë detyrime të tjera ndërkombëtare, pas hyrjes në fuqi të Konventës dhe Protokolleve të saj.

Do të ishte e papajtueshme me objektin dhe qëllimin e Konventës, nëse shtetet kontraktuese, duke pranuar detyrime të tilla, do të çliroheshin automatikisht nga përgjegjësitë e parashikuara në Konventë (shih *Bosphorus Haca Yollary Turizm ve Ticaret Anonim Sirketi v Ireland* [GC], nr. 45036/98, §§ 153 dhe 154 ECHR 2005).

Në lidhje me këtë, i takon Gjykatës të verifikojë nëse masat e ndërmarra nga shteti, në përputhje me detyrimet ndërkombëtare, pajtohen me Konventën dhe protokollet e saj (shih *Matthews v the United Kingdom* [GC], Nr. 24833/94, ECHR 1999-I; *Al-Adsani v the United Kingdom* [GC], nr. 35763/97, ECHR 2001-XI; *Slivenko v Letonia* [GC], nr. 48321/99, § 120, ECHR 2003-X).

Për më tepër, ankuesit pretenduan se duke zotëruar pronën e tyre (tokën me përmasa 2,283 metra katrorë dhe shtesën, që i është bërë vilës, të cilat nuk kanë qenë objekt i marrëveshjes dypalëshe mes Shqipërisë dhe Italisë, në vitin 1991) *sine titulo*, autoritetet italiane kanë shkelur të drejtën e tyre të pronësisë, garantuar nga neni 1 i Protokollit të Parë Shtesë.

Së fundmi, ata u ankuan se Ambasada Italiane, duke kërkuar imunitet, u mohoi atyre mundësinë për të rimarrë pronën e tyre dhe/ose për të përfutur prej saj, duke shkelur kështu haptazi nenin 1 të protokollit nr.1.

ii) Vlerësimi i Gjykatës

Së pari Gjykata duhet të përcaktojë, nëse faktet e kontestuar nga ankuesit janë të tilla, që të vënë para përgjegjësisë shtetin italian, në bazë të parashikimeve të Konventës. Siç është pohuar vazhdimisht, një shtet mban përgjegjësi nëse një shkelje e të drejtave dhe lirive parashikuar në Konventë, vjen si rezultat i shkeljes së nenit 1, sipas të cilit “Palët e Larta Kontraktuese i njohin çdo njeriu, që përfshihet në juridiksionin e tyre, të drejtat dhe liritë e përcaktuara në titullin I të kësaj Konvente”. (shih *Costello-Roberts v the United Kingdom*, vendimi i datës 25 mars 1993, Seritë A nr. 247-C, f.57, §§ 25-26).

Për pasojë, Gjykata duhet të përcaktojë nëse ankuesit ishin “në juridiksionin” e shtetit italian, në kuptim të kësaj dispozite. Me fjalë të tjera, duhet të përcaktohet nëse: pavarësisht faktit se procesi në shqyrtim nuk u zhvillua në shtetin në fjalë, Italia përsëri mund të mbajë përgjegjësi për rezultatet e tij; si dhe për pamundësinë e pretenduar lidhur me ekzekutimin e vendimeve të autoriteteve shqiptare në favor të ankuesve.

Gjykata përsërit se nga pikëpamja e së drejtës publike ndërkombëtare, kompetenca juridiksionale e një shteti është kryesisht territoriale. Praktika e Gjykatës tregon se ajo ka njohur vetëm në raste të jashtëzakonshme ushtrimin e juridiksionit ekstraterritorial nga ana e Palës së Lartë Kontraktuese: ajo ka vepruar kështu në rastet kur shteti i paditur, gjatë kontrollit efikas të territorit përkatës dhe të banorëve të vet jashtë vendit si pasojë e pushtimit ushtarak, pëlqimit, ftesës apo pranimi të heshtur të qeverisë së atij territori, ka ushtruar pjesërisht ose plotësisht të gjitha funksionet publike që normalisht duheshin ushtruar (shih *Drozd and Janousek v France and Spain*, vendimi datë 26 qershor 1992, seritë A nr. 240, f. 29, § 91, dhe *Bankovic et al v Belgium and 16 other Contracting States (dec.)* [GC], nr. 52207/99, § 71, ECHR 2001-XII). Edhe kur nuk ushtron kontroll efektiv në një territor jashtë kufijve të tij, shteti përsëri ka një detyrim kategorik, sipas nenit 1 të Konventës për të ndërmarrë masa diplomatike, ekonomike, juridike apo masa të tjera, të cilat janë kompetencë e tij dhe në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, për t’u garantuar ankuesve se të drejtat e tyre janë respektuar në përputhje me Konventën (shih *Ilaşcu et al v Moldova and Russia* [GC] nr. 48787/99, paragrafi 331, ECHR 2004-VII).

Në linjë me këtë përqasje, Gjykata konstaton se pjesëmarrja e një shteti në mbrojtje të procedimeve të filluara ndaj tij në një shtet tjetër, nuk përbën ushtrim të juridiksionit ekstraterritorial (shih *McElhinney v Ireland and the United Kingdom (dec.)* [GC], nr. 31253/96, 9 shkurt 2000).

Gjykata ripohon konkluzionet në çështjen *Kalogeropoulou et al v Greece and Germany* (dec.), nr. 59021/00, ECHR 2002-X). Çështja kishte të bënte me një padi civile ngritur nga ana e ankuesve në gjykatat greke, me objekt kompensimin nga shteti gjerman. Gjykata shpalli se shteti gjerman nuk duhet bërë përgjegjës që Ministri i Drejtësisë refuzoi të lejonte procedurat e ekzekutimit dhe më pas konfirmimin e vendimit të ekzekutimit nga autoritetet greke, përsa ankuesit

nuk arritën të provonin se ata përfshiheshin në juridiksionin gjerman për qëllime të nenit 1 të Konventës.

Në rastin konkret, është e qartë se ankuesit nuk përfshiheshin në juridiksionin italian. Megjithatë, duhet të vërtetohet se Italia nuk ushtroi ndonjë juridiksion mbi ankuesit; proceset në shqyrtim u kryen vetëm në territorin e Shqipërisë; Gjykatat shqiptare ishin të vetmet organe me pushtet sovran mbi kërkuesit; dhe autoritetet italiane nuk kishin ndikim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mbi vendimet e marra nga ana e gjykatave shqiptare.

Fakti që ankuesit informuan Ambasadorin Italian lidhur me pretendimet e tyre mbi të drejtën e pronës dhe se qeveria italiane ka hyrë në marrëveshje për blerjen e ambientit apo se është dhënë një vendim në favor të tyre për të kthyer vilën dhe tokën ngjitur me të dhe se Ambasada informoi ankuesin se ajo e konsideronte veten si pronare e ambienteve, duke përfshirë edhe vilën për të cilën është urdhëruar kthimi për ankuesit, nuk mjafton për t'i përfshirë ata nën juridiksionin e shtetit italian për qëllimet e nenit 1 të Konventës. Asnjë rrethanë tjetër nuk justifikon një konkluzion të ndryshëm.

Për pasojë, Italia nuk mund të mbajë përgjegjësi në lidhje me situatën për të cilën ankuesit janë ankuar; konkretisht për refuzimin e autoriteteve vendase për të ekzekutuar vendimin e gjykatës në favor të tyre, si dhe për vendimet në të cilat gjykatat shqiptare nuk kanë pranuar pretendimin e tyre për marrjen e masave ekzekutuese, me arsyetimin se autoritetet e paditura nuk kishin detyrim për të marrë pjesë në proceset gjyqësore. Pala italiane nuk mund të bëhet përgjegjëse në bazë të nenit 1 të Konventës, as për mospërmblidhje të ndonjërit prej detyrimeve pozitive të shtetit për të garantuar të drejtat e parashikuara në Konventë, siç u pretendua nga ankuesit.

Në vijim të sa u parashtrua më lart Gjykata çmon se ankuesit nuk provuan se ata mund të përfshiheshin “brenda juridiksionit” të shtetit italian. Kjo do të thotë se kjo pjesë e ankimit është *ratione personae* e papajtueshme me dispozitat e Konventës brenda kuptimit të Nenit 35, paragrafi 3 dhe duhet të mos pranohet në përputhje me Nenin 35, paragrafi 4.

2. Lidhur me ankimet kundër Shqipërisë

a) Ankesa në bazë të nenit 6 (1), marrë së bashku me nenin 13 të Konventës

i) Parashtrimet e ankuesve

Ankuesit, në bazë të nenit 6 (1), marrë së bashku me nenin 13 të Konventës, pretenduan, se autoritetet shqiptare neglizhuan të ekzekutonin vendimet e gjykatave dhe t'u mundësonin atyre zotërimin e pasurisë së kthyer.

ii) Vlerësimi i Gjykatës

Sipas praktikës së saj, Gjykata arsyetoi se garancitë procedurale, të parashikuara në nenin 6 lidhur me procesin e rregullt, publik dhe të shpejtë, nuk do të kishin kuptim nëse do të mungonte kushti paraprak për gëzimin e këtyre të drejtave, konkretisht: e drejta për akses në gjykatë. Gjykata evidentoi këtë të drejtë si pjesë të qenësishme të garancive të mishëruara në nenin 6, duke iu referuar parimeve të shtetit të së drejtës dhe shmangies së kompetencave arbitrare që vendosen në themel të pjesës më të madhe të kësaj Konvente. Kështu, neni 6, paragrafi 1 i garanton çdo personi të drejtën për të paraqitur para një gjykate pretendimet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij civile (shih *Golder v the United Kingdom*, vendimi i datës 21 shkurt 1975, Seria A nr. 18, f. 13-18, paragrafët 28-36).

E drejta për akses në gjykatë, pavarësisht se është absolute, mund t'i nënshtrohet kufizimeve; të cilat interferohen, sepse e drejta për t'iu drejtuar gjykatës nga vetë natyra e saj kërkon rregullim nga ana e shtetit. Në këtë drejtim, Shtetet Kontraktuese gëzojnë një shkallë të caktuar vlerësimi, megjithëse i takon Gjykatës për të vendosur përfundimisht, nëse janë respektuar kërkesat e Konventës. Duhet të sigurohet që kufizimet e përdorura të mos pengojnë, apo reduktojnë të drejtën e individit në mënyrë apo në masë të tillë, që të dëmtohet vetë thelbi i së drejtës. Për më tepër, kufizimi nuk mund të jetë në përputhje me nenin 6 (1), nëse nuk i shërben një qëllimi legjitim apo nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme proporcionaliteti, ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të arrihet (shih *Waite and Kennedy v Germany* [GC], nr. 26083/94, ECHR 1999-I, paragrafi 59).

Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse kufizimi ka ardhur si pasojë e një qëllimi legjitim. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se imuniteti sovran është një koncept i së drejtës ndërkombëtare,

dalë nga parimi *par in parem non habet imperium*, me anë të të cilit një shtet nuk mund t'i nënshtrohet juridiksionit të shtetit tjetër. Gjykata çmon se njohja e imunitetit sovran për një shtet në proceset civile përmbush qëllimin legjitim të pajtimit me të drejtën ndërkombëtare për të përkrahur sjelljen e njerëzishme dhe marrëdhëniet e mira mes shteteve, nëpërmjet respektimit të sovranitetit të shtetit tjetër.

Më tej, gjykata duhet të vlerësojë nëse kufizimi ishte në proporcion me qëllimin e ndjekur. Ajo rikujton, se Konventa duhet të interpretohet nën dritën e rregullave të përcaktuara në Konventën e Vjenës, datë 23 maj 1969, mbi Ligjin e Marrëveshjeve dhe se neni 31, paragrafi 3 (c) i kësaj Konvente parashikon se duhet të merret parasysh “çdo rregull relevant i zbatueshëm i së drejtës ndërkombëtare në marrëdhëniet mes palëve”. Konventa, përfshirë dhe nenin 6, nuk mund të interpretohet në boshllëk. Gjykata duhet të jetë e ndërgjegjshme për karakterin e veçantë të Konventës si një marrëveshje e të drejtave të njeriut, dhe gjithashtu duhet të mbajë parasysh rregullat përkatëse të së drejtës ndërkombëtare (shih *mutatis mutandis*, *Loizidou v Turkey*, vendimi i datës 18 dhjetor 1996, Raporte mbi gjykimet dhe vendimet 1996-VI, § 43). Konventa, aq sa është e mundur, duhet të interpretohet në harmoni me rregullat e tjera të së drejtës ndërkombëtare, pjesë e së cilës është, duke përfshirë edhe ato që lidhen me dhënien e imunitetit shtetëror.

Duke u kthyer tek çështja, duket se pasuria që iu kthye ankuesve me vendim të Komisionit, ishte caktuar si rezidencë private e Ambasadorit Italian në Shqipëri dhe në përputhje me rrethanat ajo përbën “*lokalet e misionit*” në kuptimin e nenit 1 të Konventës së Vjenës mbi Marrëdhëniet Diplomatike.

Problemi që ngrihet në këtë çështje është nëse autoritetet shqiptare mund të bëhen përgjegjëse se refuzuan ekzekutimin e vendimit të Gjykatës, datë 27 prill 1997, lidhur me pronën e zënë nga Ambasada Italiane, dhe më konkretisht, faktit që ato nuk ndërmorën veprimet e kërkuara nga ankuesit për të kthyer pronën, e cila u është dhënë me vendim të Komisionit, datë 17 dhjetor 1994.

Në lidhje me këtë, Gjykata vlerëson se masat e marra nga Palët e Larta Kontraktuese në zbatim të rregullave të njohura të së drejtës ndërkombëtare mbi imunitetin shtetëror nuk mund të konsiderohen sikur vendosin në tërësi një kufizim disproporcional të së drejtës për akses në gjykatë, siç është përcaktuar në nenin 6(1). Gjithashtu, Gjykata ka mbajtur qëndrimin se ashtu sikurse e drejta për akses në gjykatë është pjesë e qenësishme e garancisë për një gjykim të drejtë në atë nen, ashtu edhe disa kufizime duhet të konsiderohen të qenësishme, si për shembull kufizimet përgjithësisht të pranueshme nga bashkësia e kombeve si pjesë e doktrinës së imunitetit shtetëror (shih *Al-Adsani v the United Kingdom* [GC], nr. 35763/97, §§ 52-56, ECHR 2001-XI; *Fogarty v the United Kingdom* [GC], nr. 37112/97, § 36, ECHR 2001-XI; dhe *McElhinney v Ireland* [GC], nr. 31253/96, § 37, ECHR 2001-XI, *Manoilescu and Dobrescu v Romania* (dec) nr. 60861/00, ECHR 2005, *Kalogeropoulou et al*, cituar më sipër).

Në rastin konkret, nuk ekziston asnjë arsye që të përlligjë shmangien nga ky konkluzion. Duke marrë parasysh rregullat e së drejtës ndërkombëtare të përcaktuara më sipër, nuk mund t'i kërkohej palës shqiptare të nëpërkëmbë, kundër vullnetit të vet, rregullin e imunitetit shtetëror, i cili është përcaktuar për të garantuar funksionimin më optimal të misioneve diplomatike (ne impediat *legatio*) dhe më gjerësisht, për t'i dhënë shtytë sjelljeve të njerëzishme dhe marrëdhënieve të mira mes shteteve sovraane.

Prandaj, vendimet me anë të të cilave gjykatat kombëtare kanë refuzuar të urdhërojnë autoritetet për të marrë masa shtrënguese përse i takon pronës së zotëruar nga Ambasada Italiane në Shqipëri dhe gjithashtu mosekzekutimi i vendimit të gjykatës, datë 24 prill 1997, mund të konsiderohet si një kufizim i justifikuar mbi të drejtën e ankuesve për akses në gjykatë.

Për pasojë, kjo ankesë duhet të shpallet e papranueshme pasi është haptazi e pabazuar, në përputhje me nenin 35, paragrafët 3 dhe 4 të Konventës.

Përse i takon parashtrimi të ankuesve se nuk kanë pasur mjete juridike efektive për pretendimet e sipërpërmendura, Gjykata ripërsërit se neni 13 zbatohet vetëm në rastet kur individit ka një “pretendim të pranueshëm” se ka qenë viktimë e shkeljes të së drejtës së parashikuar nga Konventa (shih *Boyle and Rice v the United Kingdom*, vendimi i datës 27 prill 1988, Seritë A nr.

131, f. 23, § 52). Gjykata çmon se pretendimi i ankuesve, në mbështetje të nenit 6(1), është haptazi i pabazuar. Ankuesit nuk paraqesin ndonjë “pretendim të pranueshëm” dhe si rrjedhim neni 13 nuk gjen zbatim në këtë çështje.

b) Ankimi sipas nenit 1 të Protokollit të Parë Shtesë

i) Parashtrimet e ankuesve

Ankuesit pretenduan se janë zhveshur nga e drejta e pronës, për shkak se autoritetet shqiptare u kanë transferuar palëve të treta pronën e tyre, në mënyrë të paligjshme. Ata parashtruan se në pritje të një zgjidhjeje përfundimtare të proceseve mbi ankimin e tyre për kthim të pronës, realisht u ndaluan të tjetërsonin pronën e tyre.

Për më tepër, ankuesit argumentuan se përfitimi nga shitja që iu bë pronës së tyre nga ana e palës shqiptare, çoi *de facto* në shpronësimin e tyre, brenda kuptimit të pranuar në praktikën e gjykatës.

ii) Vlerësimi i Gjykatës

Si fillim, Gjykata vëren se ankimi, në mbështetje të nenit 1 të Protokollit të Parë Shtesë, përbëhet nga tre aspekte të dallueshme: i pari ka të bëjë me paligjshmërinë e pretenduar për transferimin e pronës Qeverisë Italiane; i dyti ka të bëjë me përvetësimin e paligjshëm nga ana e palës shqiptare të fitimit të siguruar nga shitja e pasurisë së ankuesve; aspekti i tretë ka të bëjë me dështimin e autoriteteve shqiptare për t’u garantuar ankuesve gëzim të pasurisë së tyre, kthyer nëpërmjet vendimeve administrative dhe gjyqësore.

Për sa i takon pretendimit të ankuesve se transferimi i pronës së të atit të tyre autoriteteve italiane ka qenë i paligjshëm, Gjykata vëren se transaksioni midis palës shqiptare dhe palës italiane, të cilin ankuesit e quajnë të pavlefshëm, u krye në vitin 1991, me fjalë të tjera para 2 tetorit të vitit 1996, datë në të cilën Shqipëria ratifikoi Konventën dhe Protokollin e Parë Shtesë të saj. Për pasojë, kjo pjesë e ankimit është e papajtueshme *ratione temporis* me dispozitat e Konventës dhe duhet të rrëzohet në përputhje me nenin 35 paragrafët 3 dhe 4 i Konventës.

Për sa i takon pretendimit të dytë, Gjykata vëren se ankuesi dështoi në depozitim të pretendimit të mësipërm në gjykatat e brendshme dhe rrjedhimisht, kjo pjesë e ankimit nuk duhet të pranohet në përputhje me nenin 35, paragrafët 1 dhe 4 të Konventës (për mosshkrim të të gjitha mjeteve të brendshme juridike). Si rrjedhim, analiza e ankimit duhet të përqendrohet në dështimin e autoriteteve shqiptare për t’u garantuar ankuesve gëzim të pasurisë së tyre, kthyer me vendim administrativ, datë 17 dhjetor 1994 dhe vendimi i gjykatës, datë 24 prill 1997.

Gjykata vlerëson se vendimi administrativ i Komisionit për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave dhe vendimi pasues i gjykatës, sipas të cilit ankuesve iu njoh e drejta mbi pasurinë e paluajtshme përbëjnë pretendim ndaj Shqipërisë, që mund të thuhet se është i mjaftueshëm për t’u kualifikuar si një “aset”, i cili kërkon mbrojtjen e nenit 1 të Protokollit të Parë Shtesë. Ankuesit nuk u mbështetën vetëm në shpresën e thjeshtë për kthimin e pronës apo ndonjë kërkesë të kushtëzuar, përmbushja e së cilës varej nga përmbushja e kritereve të parashikuara me ligj (në dallim me qëndrimin në *Gratziner and Gratzinergova v the Czech Republic* (dec.) [GC], nr. 39794/98, §§ 71-73, ECHR 2002-VII, dhe *Kopecky v Slovakia* [GC], nr. 44912/98, § 58, ECHR 2004-IX), por një vendim i cili mori formë të prerë, pasi nuk u kundërshtua në gjykatë prej autoriteteve kompetente dhe i cili ishte marrë nga autoritetet administrative kompetente për të urdhëruar kthimin e pronës në bazë të ligjit nr. 7698/1993.

Për më tepër, vendimi administrativ në favor të ankuesve nuk u shfuqizua nga ndonjë vendim gjyqësor i mëpasëm. Përsa kohë vendimi ka marrë formë të prerë, ai përbën titull ekzekutiv për pronën, të cilin ankuesit mund t’a përdornin si bazë për të regjistruar pronën në regjistrin e pasurive si pronë të tyre, pa filluar proceset e mëtejshme administrative dhe gjyqësore. Për pasojë, vendimi duhet të konsiderohet se gjeneron një shpresë të ligjshme të bazuar lidhur me të drejtën e pronës.

Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se ankuesit nuk u ankuan për ndonjë veprim të caktuar të autoriteteve shqiptare, por më tepër për mosveprimin e tyre dhe refuzimin për të ndërmarra hapa për garantimin e kthimit të pronës së tyre. Në të vërtetë, nuk u debatua që ankuesit nuk ishin në gjendje të merrnin në zotërim pronën e tyre, për shkak se autoritetet administrative përkatëse pretenduan që

ata nuk kishin kompetencë për të ndërmarrë veprime të tilla, por për arsye se pretendohet të ishte e pamundur që të filloheshin procedurat e ekzekutimit, pasi ndërtesa në fjalë ishte në pronësi të Ambasadës Italiane në Shqipëri.

Gjykata do të përcaktojë në dritën e parimit të përgjithshëm të së drejtës për pronën, parashikuar në fjalinë e parë të paragrafit të parë të nenit 1 të Protokollit të Parë Shtesë, nëse autoritetet shqiptare, duke u shmangur nga ndërmarrja e veprimeve të pretenduara nga ankuesit, kanë cenuar balancën e drejtë mes kërkesave të interesit të përgjithshëm të komunitetit dhe kërkesave për mbrojtjen e të drejtave themelore të individit (shih, mes shumë autoriteteve të tjera, *Sporrong and Lönnroth v Sweden*, vendim i datës 23 shtator 1982, Seritë A nr. 52, f. 26 § 69).

Në çështjen konkrete, Gjykata ka konstatuar tashmë se refuzimi i kërkesës së ankuesve nga autoritetet kombëtare për një urdhër ekzekutimi të vendimeve administrative dhe të gjykatës në favor të tyre, nuk përbën një kufizim disproporcional mbi të drejtën e aksesit në gjykatë, sipas nenit 6, paragrafi 1 i Konventës. Gjithashtu, ky konstatim është i vlefshëm në shqyrtimin e kësaj ankese.

Duke marrë në konsideratë rrethanat e kësaj çështjeje, gjykata nuk ka dyshim se mosveprimi nga ana e autoriteteve shqiptare për të marrë masa ekzekutive, ishte “në interes të përgjithshëm”, përse i takon nevojës për të shmangur prishjen e marrëdhënieve midis Shqipërisë dhe Italisë, pengimin e mirëfunksionimit të atij misioni diplomatik shtetëror në Shqipëri.

Për më tepër, Italia kishte njoftuar autoritetet shqiptare nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme, se kishte të drejtë pronësie lidhur me ndërtesën në shqyrtim. Megjithatë ankuesit pretenduan se ky titull pronësie ishte i paligjshëm, Gjykata vëren se deri më sot nuk ekziston ndonjë vendim gjykatë i formës së prerë në mbështetje të këtij pretendimi.

Megjithatë Gjykata pranon se mosekzekutimi për një periudhë disave vjetra i vendimeve të formës së prerë dhënë në favor të ankuesve, duhet t’u ketë shkaktuar atyre një ndjenjë padrejtësie dhe zhgënjimi, prapëseprapë ata nuk e kanë humbur pretendimin e tyre kundër Shqipërisë. Gjykata vëren se asnjë gjykatë e brendshme nuk e ka shfuqizuar të drejtën e ankuesve ndaj pronave në fjalë. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se gjykatat kombëtare thjesht kanë refuzuar pretendimin e tyre për ekzekutimin e vendimeve, me arsyetimin se autoritetet shqiptare të paditura u mungonte cilësimi i nevojshëm për të marrë pjesë në gjykime, pa shqyrtuar vlefshmërinë e dokumenteve konfliktuale mbi të drejtën e pronës apo pa i krahasuar ato – për shkak të natyrës ligjore të padisë së ngritur nga ankuesit në gjykatat vendase.

Për më tepër, e drejta e ankuesve për pronën në fjalë, nuk mund të humbasë fuqinë me kalimin e kohës; në të kundërt, në të ardhmen mund të konvertohet në një të drejtë për kompensim që duhet të paguhet nga autoritetet e paditura konform legjislacionit të brendshëm në fuqi mbi kompensimin e ish- pronarëve.

Në të vërtetë, neni 11 i ligjit mbi pronat u njeh ish- pronarëve të drejtën e pronësisë dhe nëse s’është i mundur kthimi në natyrë i pronës, të paktën të merren masa alternative për kompensim në formën e parashikuar nga ligji.

Përderisa kthimi në natyrë i pronës ishte i pamundur, ankuesit kanë të drejtë të kompensohen nga shteti shqiptar, megjithatë ata nuk përfituan nga kompensimi.

Në këto rrethana, fakti që autoritetet shqiptare nuk vepruan për të marrë masa për t’u kthyer pronën ankuesve – me arsyetimin e “interesit të përgjithshëm”, lidhur drejtpërdrejt me respektimin e parimit të imunitetit të shtetit, mishëruar në mënyrë universale në të drejtën ndërkombëtare konvencionale dhe të zakonshme – nuk prish balancën e kërkuar midis mbrojtjes së të drejtave të individit për të drejtën e pronës dhe kërkesat e interesit të përgjithshëm.

Për rrjedhojë, ky ankim duhet të shpallet i papranueshëm si haptazi i pabazuar, në përputhje me nenin 35, paragrafët 3 dhe 4 të Konventës.

Për këto arsye, Gjykata njehzëri

Deklaron kërkesën të papranueshme

Vincent BERGER
Regjistruar

Boštjan ZUPANČIČ
Kryetar

VENDIM MBI PRANUESHMËRINË
(Ankimi nr. 38349/05)
ÇËSHTJA “AGIM HYSI KUNDËR SHQIPËRISË”

Në këtë çështje ankuesi ankohet për zbatimin e nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje me procedurat para gjykatave të brendshme dhe Këshillit të Lartë të Drejtësisë për shkarkimin e gjyqtarëve.

Gjykata mund të shqyrtojë vetëm ankesa në lidhje me të cilat janë shfrytëzuar të gjitha mjetet e brendshme dhe që janë depozituar brenda gjashtë muajsh nga data e vendimit të fundit “përfundimtar” të brendshëm, ajo përsërit se ankimi përpara Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë është një nga mjetet që, në parim, duhen shfrytëzuar në lidhje me çështjet që lindin sipas nenit 6 paragrafi 1 të Konventës.

Në çështjen Agim Hysi kundër Shqipërisë

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (seksioni i katërt), mbledhur në datën 26 shkurt 2008, si Dhomë e përbërë nga:

Nicolas Bratza *Kryetar*
Lech Garlicki
Giovanni Bonello
Ljiljana Mijovic
Jan Sikuta
Paivi Hirvela
Ledi Bianku gjyqtarë

dhe Lawrence Early, regjistruar i seksionit,
- duke pasur parasysh ankimin e mësipërm të paraqitur më 15 tetor 2005,
- duke diskutuar çështjen,
ka vendosur si vijon.

FAKTET

Ankuesi, Z. Agim Hysi, është një shtetar shqiptar i lindur në vitin 1957 e që banon në Tiranë.

A. Rrethanat e rastit

Faktet e rastit, siç janë paraqitur nga palët, mund të përmbledhen si vijon:

1. Procedimet administrative dhe penale kundër ankuesit

Në vitin 1989, ankuesi u caktua si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Vlorë. Në tetor 2001 u hap një hetim disiplinor ndaj tij nga inspektorët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD). Mbi bazën e rezultateve të këtij hetimi, zyrës së prokurorisë iu kërkua të hapte një hetim penal kundër ankuesit. Hetimi u hap në 12 janar 2002. Kjo rezultoi në pezullimin nga puna të ankuesit.

Më 26 prill 2002 prokurori mbylli hetimin penal për mungesë provash. Sidoqoftë, më 27 maj 2002, KLD-ja shkarkoi ankuesin për shkelje të hapura të disiplinës në punë.

2. Procedimet gjyqësore në lidhje me shkarkimin e ankuesit

Më 3 qershor 2002, ankuesi kundërshtoi vendimin e 27 majit 2002, duke depozituar një ankim përpara Gjykatës së Lartë, e cila ishte kompetente për të vlerësuar çështjet si nga ana e fakteve, ashtu edhe nga ana e ligjit. Më 18 nëntor 2002, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë e hodhën poshtë këtë ankim. Më 20 qershor 2003 ankuesi depozitoi një ankesë kushtetuese kundër këtij vendimi. Ai pretendoi për dhunime të të drejtës së tij për një gjykim të ndershëm në procedimet përpara KLD-së dhe përpara Gjykatës së Lartë.

Ankesa kushtetuese e ankuesit u hodh poshtë më 14 korrik 2003 nga ana e Gjykatës Kushtetuese, e cila e gjeti ankesën si të papranueshme dhe deklaroi se:

“(Gjykata Kushtetuese) vendosi që të mos e vendosë këtë rast para një seance plenare për shqyrtim.”.

Asnjë arsye e veçantë nuk u dha për shpalljen e ankesës si të papranueshme (vendimi i parë i papranueshmërisë). Asnjë ankim i mëtejshëm nuk ishte i mundur përtej këtij vendimi. Më 16 nëntor 2004 ankuesi depozitoi një ankesë të re përpara Gjykatës Kushtetuese. Duke iu referuar një numri vendimesh të Gjykatës Kushtetuese të dhëna përpara datës 14 korrik 2003, në të cilat gjykata kishte gjetur shkelje të garancive për një gjykim të ndershtëm, të ngjashme me shkeljet që ai pretendonte se kishin ndodhur në rastin e tij, ankuesi argumentoi se Gjykata Kushtetuese kishte gabuar në vendimin e saj të paarsyetuar të datës 14 korrik 2003. Më 28 prill 2005 Gjykata Kushtetuese e hodhi poshtë këtë ankesë të re, duke qenë se ishte thelbësisht e njëjtë me kërkesën e tij të vitit 2003 (vendimi i dytë i papranueshmërisë).

B. Ligji dhe praktika përkatëse e vendit

1. Dispozitat përkatëse të Kushtetutës shqiptare lexojnë si vijon:

Neni 42, paragrafi 2

Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.”

Neni 142 paragrafi 3

“Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore.”

Neni 131

“Gjykata Kushtetuese vendos për: ... (f) gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave.”

Neni 147

“4. Këshilli i Lartë i Drejtësisë vendos për transferimin e gjyqtarëve, si dhe për përgjegjësinë e tyre disiplinore sipas ligjit. (...)

6. Gjyqtari mund të shkarkohet nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë për kryerjen e një krimi, për paaftësi mendore a fizike, për akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit ose për pamjaftueshmëri profesionale. Kundër këtij vendimi gjyqtari ka të drejtë të ankohet në Gjykatën e Lartë, e cila në këtë rast, vendos me kolegje të bashkuara.”

Neni 141

“Gjykata e Lartë ka juridiksion fillestar dhe rishikues.”.

2. Ligji mbi organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD) (ligji nr.8811, datë 17 maj 2001, ndryshuar me ligjin nr.9448, datë 5 dhjetor 2005).

Ky ligj rregullon anëtarësinë, organizimin, funksionimin dhe përgjegjësitë e KLD-së, i cili drejtohet nga Presidenti i Republikës. Ndërmjet detyrave të tij kryesore, KLD-ja vendos mbi emërimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe atyre të apelit. Ligji rregullon gjithashtu kryerjen e procedimeve disiplinore të ndërmarra ndaj gjykatësve. Sipas ligjit, i takon si detyrë ministrit të Drejtësisë që të kontrollojë gjykatat e shkallës së parë dhe ato të apelit. Ministri i paraqet KLD-së kërkesa për të ndërmarrë procedime disiplinore ndaj gjykatësve nga vetë KLD-ja dhe ky i fundit merr vendimet përkatëse. Ankimi në lidhje me një vendim disiplinor të KLD-së shqyrtohet nga Gjykata e Lartë.

3. Ligji për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë (ligji nr.8436, datë 28 dhjetor 1998).

Kreu V i këtij ligji rregullon përgjegjësinë disiplinore të gjykatësve. Neni 40 parashikon që gjyqtarët të mbajnë përgjegjësi për shkelje të disiplinës dhe kryerjen e akteve apo sjelljeve që diskreditojnë rëndë figurën e tyre dhe autoritetin e drejtësisë.

4. Ligji për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë (ligji nr.8577 i 10 shkurtit 2000).

Neni 30 i këtij ligji lidhet me afatin për paraqitjen e kërkesave përpara Gjykatës Kushtetuese. Kërkesat individuale për shkelje të pretenduara të të drejtave kushtetuese duhet të paraqiten jo më vonë se sa dy vjet nga kryerja e shkeljes. I njëjti afat kohor dyvjeçar zbatohet në rastin e njoftimit të një vendimi nga një autoritet përkatës publik, në vijim të përfundimit të mjeteve ligjore në vend.

Neni 31 parashikon se një shqyrtim paraprak i një ankese kushtetuese bëhet nga një panel prej 3 gjyqtarësh. Nëse një ankese kushtetuese nuk është brenda juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese apo është paraqitur nga një palë e cila nuk ka *locus standi*, paneli do të vendosë për papranueshmërinë e saj. Nëse ankesa kushtetuese është brenda juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese apo është paraqitur nga një palë e cila ka *locus standi*, paneli do të vendosë se ajo do të duhet të shqyrtohet në një seancë plenare, e cila procedon më pas për të shqyrtuar hollësitë e ankesës.

ANKESAT

Ankuesi u ankua në bazë të nenit 6 paragrafi 1, në lidhje me mungesën e arsytimit në të dy vendimet e Gjykatës Kushtetuese dhe në lidhje me procedimet e padrejta përpara Gjykatës së Lartë dhe KLD-së.

E DREJTA

Ankesat e ankuesit, sipas nenit 6 paragrafi 1 të Konventës, lidhen me mungesën e arsytimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese dhe padrejtësinë e procedimeve përpara Gjykatës së Lartë dhe KLD-së.

Neni 6, paragrafi 1 i Konventës, lexon:

“Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar ligjërisht, e cila do të vendosë qoftë për mosmarrëveshjet mbi të drejtat dhe detyrimet e tij me karakter civil, qoftë për bazueshmërinë e çdo akuze të natyrës penale të drejtuar kundër tij. ...”.

Gjykata rikujton se, në përputhje me nenin 35 paragrafi 1 të Konventës, ajo mund të shqyrtojë vetëm ankesa në lidhje me të cilat janë shfrytëzuar të gjitha mjetet e brendshme dhe që janë depozituar brenda gjashtë muajsh nga data e vendimit të fundit “përfundimtar” të brendshëm (*Paul dhe Audrey Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar* (dec.) nr. 46477/99, 7 qershor 2001). Kjo nënkupton vetëm ato mjete të cilat janë normale dhe efikase për t’u marrë parasysh (shih *Fernie kundër Mbretërisë së Bashkuar* (dec.), nr. 14881/04, vendim i datës 5 janar 2006).

Gjykata përsërit se ankimi përpara Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë është një nga mjetet që, në parim, duhen shfrytëzuar në lidhje me çështjet që lindin sipas nenit 6 paragrafi 1 të Konventës (shih rastin *Qufaj Co. Sh.p.k. kundër Shqipërisë*, nr. 54268/00, paragrafi 42, datë 18 nëntor 2004; *Beshiri dhe të Tjerë kundër Shqipërisë*, nr. 7352/03, paragrafi 32, datë 22 gusht 2006).

Në rastin e tanishëm, Gjykata vëren se ankesa e parë kushtetuese e ankuesit e datës 20 qershor 2003 u hodh poshtë si e papranueshme nga Gjykata Kushtetuese më 14 korrik 2003 dhe nuk ka ndonjë hallkë të brendshme të mëtejshme ankimimi ndaj këtij vendimi. Sidoqoftë, ankuesi depozitoi një ankese të re kushtetuese përpara Gjykatës Kushtetuese më 16 nëntor 2004. Ai u bazua te një numër vendimesh të Gjykatës Kushtetuese, duke i kërkuar asaj gjykate që të rishikojë shkeljet kushtetuese ndaj tij dhe t’i japë një arsyetim për vendimin e saj të parë të papranueshmërisë. Ankesa e dytë kushtetuese u hodh poshtë më 28 prill 2005 nga Gjykata Kushtetuese, sepse ishte thelbësisht e njëjtë me ankesën e parë. Asnjë arsye e mëtejshme nuk u dha në lidhje me çështjet e përcaktuara me hollësi, të ngritura nga ankuesi.

Kërkesa ndaj Gjykatës u bë më 15 tetor 2005, saktësisht më pak se gjashtë muaj nga data e vendimit të dytë të Gjykatës Kushtetuese për papranueshmëri, por më shumë se sa gjashtë muaj nga data e vendimit të parë të Gjykatës Kushtetuese për papranueshmëri. Si rrjedhim, duhet përcaktuar se cili vendim përbën vendimin përfundimtar për qëllimet e nenit 35, paragrafi 1 të Konventës.

Gjykata vëren se në kohën në fjalë, ligji për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë nuk ofronte ndonjë parashikim të veçantë për një ankim kundër një vendimi të marrë nga vetë Gjykata Kushtetuese, i cili quhej si përfundimtar.

Gjykata vëren më tej se, në ankesën e tij të dytë kushtetuese, ankuesi u bazua në vendime të Gjykatës Kushtetuese që ishin marrë edhe më përpara paraqitjes së ankesës së tij të parë kushtetuese.

Në dosje nuk ka asnjë tregues që ankuesi të jetë penguar që të përdorë apo t'i referohet kësaj praktike gjyqësore në ankesën e tij të parë në Gjykatën Kushtetuese.

Gjykata është e mendimit se ankesa e dytë e aplikantit ishte në fakt një përpjekje e pasuksesshme për të rihapur procedimet mbi një vendim i cili ka përfituar tashmë fuqi si *res judicata*. Si rrjedhim, ankesa e dytë kushtetuese e ankuesit është e ngjashme me një kërkesë për rihapjen e çështjes.

Gjykata përsërit praktikën e saj gjyqësore, se një kërkesë për rihapje të procedimeve nuk rifillon ecjen e periudhës gjashtëmujore sipas nenit 35 paragrafi 1 të Konventës, përveçse kur ai është i suksesshëm dhe çon në një rihapje të procedimeve (*shih rastin më të fundit Wende dhe Kukowka kundër Polonisë*, nr. 56026/00, paragrafi 48, 10 maj 2007; dhe *Eder kundër Gjermanisë* (dec.), nr. 11816/02, 13 tetor 2005). Duke qenë se ankesa e dytë kushtetuese e ankuesit u hodh poshtë, duke qenë se ishte thelbësisht e njëjtë si ankesa e parë kushtetuese, rezulton se vendimi përfundimtar brenda kuptimit të nenit 35 paragrafi 1 u dha më 14 korrik 2003, çka është më shumë se gjashtë muaj përpara datës në të cilën kërkesa e tanishme t'i dorëzohej Gjykatës. Si pasojë, kërkesa është depozituar jashtë afatit dhe për këtë arsye duhet të hidhet poshtë në përputhje me nenin 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës.

Për këto arsye, Gjykata, njëzëri:

- E shpall kërkesën të papranueshme.

Lawrence Early
Rregjistruar

Nikolas Bratza
Kryetar

VENDIM MBI PRANUESHMËRINË
(Ankimi nr. 54268/00)
ÇËSHTJA “QUFAJ CO. SHPK KUNDËR SHQIPËRISË” (Pranueshmeria)

Ky vendim do të marrë formë të prerë në rrethanat e përcaktuara në nenin 44 § 2 të Konventës. Ai mund t'i nënshtrohet rishikimit redaktues.

Kjo çështje ka të bëjë me shkeljen e të drejtës së ankuesit, person juridik, për të patur një proces të rregullt ligjor si pasojë e dështimit për të ekzekutuar një vendim gjyqësor të formës së prerë. Gjykata Evropiane tërhoqi vëmendjen se ekzekutimi i vendimeve gjyqësore është pjesë përbërëse e “gjykimit” për qëllimet e Nenit 6 dhe se vonesa në ekzekutimin e vendimit mund të çënojë thelbin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor.

Në çështjen Qufaj co SH.P.K kundër Shqipërisë

Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut (Seksioni i tretë), e mbledhur më 2 tetor 2003, me trup gjykues të përbërë nga:

z.G. RESS *Kryetar*
z.I. CABRAL BARRETO
z.P. KÜRIS
z.B. ZUPANČIĆ
z.J. HEDIGAN
znj.M. TSATSA-NIKOLOVSKA
z.K. TRAJA, *gjyqtarë*

z. V. BERGER, *Regjistruer i seksionit*,
duke marrë parasysh ankimin e mësipërm, të depozituar më 26 korrik 1999,
duke marrë parasysh vëzhgimet e paraqitura nga pala shqiptare dhe vëzhgimet në përgjigje të tyre të paraqitura nga ankuesi,
pas shqyrtimit të ankimit, vendos si më poshtë:

FAKTET

Shoqëria ankuese, “Qufaj Co. sh.p.k.”, është një shoqëri me sipërmarrje austrialiano-shqiptare, e themeluar me vendim nr.5883 të Gjykatës së Rrethit Tiranë, të datës 20 korrik 1992, me objekt investimin në fushën e biznesit.

Në gjykatë është përfaqësuar nëpërmjet administratorit të saj, z. Avenir Ballvora, një shtetas shqiptar i lindur më 1957, aktualisht jeton në Montauban (Francë).

A. Rrethanat e çështjes

Faktet e çështjes, siç janë paraqitur nga palët mund të përmbliidhen si më poshtë vijon:

Me vendimin nr.165 të datës 9 qershor 1992, Bashkia e Tiranës i shiti shoqërisë ankuese 15, 788 metra katrorë tokë në një zonë banimi në Tiranë.

Me anë të vendimit nr.174 të datës 15 qershor 1992, Bashkia i dha shoqërisë ankuese lejen urbanistike për të planifikuar ndërtimin e pesëqind apartamenteve. Duke qenë se para se të mund të fillonte projekti, ishte e nevojshme dhe marrja e një leje ndërtimi, shoqëria ankuese i paraqiti bashkisë kërkesën përkatëse, por bashkia për një kohë të gjatë nuk arriti dot të vendoste për çështjen, duke penguar kështu punimet e ndërtimit.

Pasi Bashkia kishte refuzuar të jepte lejen e ndërtimit, shoqëria ankuese filloi procedurat në Gjykatën e Rrethit, Tiranë, duke kërkuar një kompensim prej 60 000 000 lekë (në total) për humbjen. Kërkesa e saj u hodh poshtë me vendimin nr. 4064 të datës 23 qershor 1995.

Në apel, Gjykata e Apelit, Tiranë prishi vendimin e shkallës së parë dhe urdhëroi Bashkinë t'i paguante ankuesit një shumë totale prej 60 000 000 lekë (vendimi nr. 1197 i datës 23 shkurt 1996).

Në mungesë të një rekursi nga Bashkia në Gjykatën e Kasacionit, vendimi i Gjykatës së Apelit mori formë të prerë dhe u bë i ekzekutueshëm.

Më 16 korrik 1996, kryetari i Gjykatës së Kasacionit, në një dokument drejtuar bashkisë, deklaroi se pas hyrjes në fuqi të Kodit të Ri të Procedurës Civile, nuk kishte më të drejtë të fillonte një rishikim mbikëqyrës të ligjshmërisë së vendimeve të gjykatave më të ulta.

Më 16 korrik 1997, shoqëria ankuese i kërkoi Gjykatës së Rrethit, Tiranë, të nxirrte një urdhër për ekzekutimin e shlyerjes së kompensimit.

Më 25 qershor 1998, Gjykata e Rrethit, Tiranë hodhi poshtë një kërkesë të bërë nga bashkia për të rishikuar vendimin nr. 5492 të datës 20 dhjetor 1994 mbi themelin e çështjes, duke mos pasur bazë as në ligj, as në faktin përkatës për të vepruar në këtë mënyrë.

Më 23 korrik 1997, në dokumentin nr. 704/gj të datës 23 korrik 1997, zyra e përmbarimit njoftoi bashkinë se duhet të ekzekutonte vendimin e Gjykatës së Apelit, duke i paguar shoqërisë ankuese një shumë totale prej 60 000 000 lekësh. Megjithatë, bashkia në mënyrë të vazhdueshme refuzoi ta përmbushte këtë detyrim, duke argumentuar se nuk kishte buxhet për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore.

Njëkohësisht, zyra e përmbarimit i kërkoi Arkës së Shtetit dhe Departamentit të Buxhetit të Ministrisë së Financave (institucioni kryesor financiar përgjegjës për këto pagesa) të zbatonte vendimin, duke siguruar fondet e nevojshme (neni 589, paragrafi 2 i Kodit të Procedurës Civile).

Me anë të dokumentit 2018/3 të datës 19 shtator 1997, 2018/5 të datës 7 nëntor 1997 dhe 4670 të 22 shtatorit 1999, Ministria e Financave hodhi poshtë kërkesat e zyrës së përmbarimit, duke argumentuar se neni 589 i Kodit të Procedurës Civile nuk ishte i zbatueshëm në këtë rast. Gjithashtu, edhe ligji për Buxhetin e Shtetit nuk mundësonte financimin për ekzekutimin e këtij vendimi nga buxheti qëndror. Më tej, shtohet se bashkia duhet të kontaktonte me "Distriktin e Thesarit të Degës së Tiranës", duke specifikuar fondin nga i cili duhej të paguhej borxhi dhe pjesën e buxhetit të bashkisë tek i cili duhej të alokohej.

Meqë vendimi nuk u ekzekutua, shoqëria ankuese paraqiti një kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, duke pretenduar se institucionet e qeverisjes vendore ishin të detyruara të garantonin zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhe jo t'i pengonin ato.

Gjykata Kushtetuese hodhi poshtë kërkesën e shoqërisë ankuese, duke deklaruar se "ankesa mund të mos merrej në konsideratë, sepse ekzekutimi i vendimeve të gjykatës është jashtë juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese".

B. Legjislacioni i brendshëm

1. Kushtetuta

Neni 42 § 2

"Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj."

Neni 142 § 3

"Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore".

Neni 63.3

"...

3. Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike.

....."

2. Udhëzimi nr. 1 i nxjerrë nga Ministria e Financave më 13 qershor 1997, sipas Aktit Financiar nr. 1 të datës 13 tetor 1997

Paragrafi 7

“Pagesat që lindin nga vendimet gjyqësore në lidhje me aktivitetin normal të institucioneve buxhetore, do të autorizohen nga kreu i institucionit qendror. Njëkohësisht, kur dëmi për të cilin shteti është përgjegjës, është pasojë e punonjësve publikë që veprojnë *ultra vires* ose nuk janë në gjendje të veprojnë në përputhje me kompetencat e tyre, kreu i institucionit qendror do të marrë masa administrative dhe do të fillojë procedime civile kundër tyre, sipas shkallës së përgjegjësisë së tyre.”

3. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 335 i datës 9 qershor 1998

Paragrafi 2 (e)

“Ministria e Financave me fondin që i vihet në dispozicion në buxhetin e çdo viti, zbaton vendimet gjyqësore që lidhen drejtpërdrejt me detyrimet e Buxhetit të Shtetit dhe jo me detyrimet e institucioneve buxhetore. Në këto vendime përfshihen:

e) Vendime gjyqësore që përcaktojnë shprehimisht detyrimin e shtetit për arsye të tjera të parashikuara me ligj.”

4. Regjistri tregtar dhe ligji i regjistrimit të kompanive nr. 7667/93

Neni 64

Riregjistrimi i shoqërive tregtare të regjistruara

“Shoqëritë tregtare të regjistruara para hyrjes në fuqi të këtij ligji, hollësitë dhe format e të cilave nuk përputhen me të, do të reregjistrohen jo më vonë se gjashtë muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Një kompani që nuk arrin të kërkojë reregjistrimin apo të paraqesë dokumentet e nevojshme, do të çregjistrohet automatikisht nga kjo datë e në vazhdim. Ato mund të aplikojnë për një zgjatje kohore prej tre muajsh, brenda së cilës do t'i përmbahen këtij detyrimi. Kompanitë e reregjistruara do të ruajnë të gjitha të drejtat që ato gëzojnë para reregjistrimit.”

5. Ligji “Për Avokatin e Popullit” (Ligji nr. 8454, datë 4.02.1999)

Neni 25

Personat dhe ligjet jashtë juridiksionit të Avokatit të Popullit do të jenë :

- a) ligjet statutoire dhe akte të tjera ligjore;
- b) urdhrat ushtarake të Forcave të Armatosura;
- c) vendimet e gjykatave.

Pa paragjykuar pikën (c) të këtij neni, Avokati i Popullit do të pranojë ankime, kërkesa, ose njoftime lidhur me shkeljet e të drejtave të njeriut dhe procedurat ligjore. Hetimet e Avokatit të Popullit nuk do të prekin pavarësinë e gjyqësorit në marrjen e vendimeve.

ANKESA

1. Shoqëria ankuese, bazuar në nenin 6 § 1 të Konventës, pretendoi se neglizhenca e autoriteteve shtetërore për të ekzekutuar vendimin e 23 shkurtit 1996, kishte penguar ushtrimin efektiv të të drejtave të saj, duke zhvlerësuar në këtë mënyrë kriteret për një gjykim të drejtë.

2. Ankuesi gjithashtu pretendoi sipas nenit 13 të Konventës, mungesën e mjeteve efektive të ankimit në legjislacionin e brendshëm për të vënë në vend të drejtat e tij. Lidhur me këtë, ankuesi i referohet vendimit të Gjykatës Kushtetuese që refuzoi marrjen në shqyrtim të kërkesës së tij duke e konsideruar jashtë juridiksionit të saj.

3. Së fundi ankuesi pretendoi shkeljen nga autoritetet shqiptare të nenit 14 të Konventës, marrë së bashku me nenin 6.1, duke pretenduar se ishte trajtuar në mënyrë të diferencuar nga kreditorët e tjerë në raste të ngjashme, pa asnjë justifikim.

E DREJTA

Shoqëria kërkuese ankohet bazuar në nenin 6.1, nenin 13, dhe nenin 14 të Konventës, për refuzimin e autoriteteve për të ekzekutuar vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë, datë 23 shkurt 1996. Ajo parashtrohet se si rezultat, nuk ka pasur mjete juridike efektive në legjislacionin e brendshëm, për të mbrojtur të drejtat e saj.

Neni 6.1 parashikon:

“1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht..... nga një gjykatë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile.....”

Neni 13 parashikon:

“Çdo person, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e njohura në këtë Konventë, ka të drejtë të bëjë ankim efektiv tek një organ i vendit të tij, edhe kur shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.

Neni 14 parashikon si më poshtë:

“Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të njohura në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla, si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër.

1. a) Përsa i përket nenit 6.1 të Konventes, pala shqiptare ngre dy kundërshtime paraprake:

i) Pala shqiptare pretendoi që shoqëria ankuese nuk i ka ezauruar të gjitha mjetet e brendshme efektive të ankimit. Ajo argumentoi se ankuesi nuk e ka paraqitur çështjen para Avokatit të Popullit. Gjithashtu, bazuar në ligjin nr.8812, datë 17 maj 2001, shoqëria ankuese mund ta paraqiste çështjen edhe para zyrës së përmbarimit.

Pala shqiptare ka parashtruar se ky ligj parashikon që në rast mosekzekutimi të një vendimi gjyqësor të formës së prerë, zyra e përmbarimit vendos një gjobë prej 50 mijë lekësh (350 euro) ndaj debitorit sipas vendimit gjyqësor. Në këtë mënyrë, autoritetet shqiptare pretenduan se ankuesi nuk e ka ezauruar këtë mjet të ri ankimi.

Shoqëria ankuese kundërshtoi efektivitetin e këtyre dy mjeteve juridike të ankimit, të cilave u referohet pala shqiptare. Përsa i përket institucionit të Avokatit të Popullit, ajo argumentoi se nuk mund të përbëjë një mjet efektiv ankimi, sipas kuptimit të Konventës. Më tej, ajo parashtroi se vetëm vendosja e një gjobe nga ana e zyrës së përmbarimit ndaj debitorit, nuk përmbush qëllimin kryesor të ankuesit, që është ekzekutimi i vendimit të Gjykatës së Apelit, Tiranë.

Për rrjedhojë, ankuesi i deklaroi parashtrimet e palës shqiptare të pabazuara.

Gjykata vlerëson se rregulli për ezaurimin e mjeteve të brendshme të ankimit, sipas nenit 35.1 të Konventës, i detyron ankuesit të përdorin mjetet ligjore që sipas sistemit juridik të brendshëm, janë zakonisht në dispozicion të palëve dhe të mjaftueshme për të vënë në vend të drejtat e shkelura. Ekzistenca e këtyre mjeteve duhet të garantohet si në praktikë, ashtu dhe në teori, përndryshe ato nuk do të ishin në dispozicion të palëve dhe do ta humbisnin efikasitetin. Neni 35.1, gjithashtu kërkon që paraqitja e ankesave në gjykatë, konform kriterëve të parashikuara nga legjislacioni i brendshëm duhet të bëhet përpara organit të duhur vendas, por kjo nuk kërkon që çështja të adresohet me anë të mjeteve që nuk janë të përshtatshme dhe efektive. (shih *Aksoy v. Turkey*, no. 21987/93, §§ 51-52, ECHR 1996-VI, and *Akdivar and Others v. Turkey*, no. 21893/93, §§ 65-67, ECHR 1996-IV).

Përsa i përket mundësisë për t'u ankuar tek Avokati i Popullit, Gjykata vëren se Avokati i Popullit, si një institucion i pavarur nga ekzekutivi, nuk mund të marrë vendime juridikisht të detyrueshme ndaj organeve shtetërore (Ligji nr. 8454, datë 4.2.1999). Në këtë mënyrë, ankimi tek Avokati i Popullit nuk mund të konsiderohet mjet efektiv, sipas kuptimit të nenit 35.1.

Gjykata rithekson se vërtet neni 35.1 i Konventes vendos detyrimin për ezaurimin e mjeteve të brendshme të ankimit, por kjo nuk nënkupton përdorimin e mjeteve jo të duhura dhe jo të përshtatshme të ankimit (shih *Valasinas v. Lithuania*, no. 44558/98, 14.03.2000). Në çështjen

Valasinas, Gjykata vlerësoi se peticioni tek Avokati i Popullit nuk përbën mjet efektiv ankimi, sipas kuptimit të nenit 35.1.

Përsa i përket ankimit tek zyra e përmbarimit, gjykata vëren se shoqëria ankuese, në përputhje me ligjin nr. 8812, datë 17 .05.2001, është ankuar për refuzimin e autoriteteve ekzekutive për të zbatuar urdhërin e gjykatës dhe atë të zyrës së përmbarimit. Megjithatë, edhe një ankim i tillë nuk do t'i mundësonte shoqërisë ankuese ekzekutimin e vendimit në favor të saj. Për më tepër, gjykata vëren se shoqëria ankuese kishte siguruar një urdhër ekzekutimi për vendimin e datës 23 shkurt 1996, në përputhje me kërkesat e procedurës civile vendase, por zyra e përmbarimit nuk kishte qenë në gjendje ta zbatonte atë. Për rrjedhojë, gjykata konkludon se një veprim i tillë do të kishte qenë jo efektiv.

Gjykata vëren se mjetet e ankimit të cilave u referohet pala shqiptare, nuk ishin mjetet e duhura dhe të përshtatshme për të garantuar rivendosjen efektive të së drejtës që pretendohet se është shkelur. Për rrjedhojë, ky kundërshtim paraprak duhet të hidhet poshtë.

ii) Pala shqiptare pretendoi se shoqëria ankuese nuk është shoqëria që gëzon të drejtën për të kërkuar ekzekutimin e vendimit. Shoqëria ankuese Qufaj sh.p.k. është regjistruar si shoqëri tregtare sipas procedurave ligjore, më 2 korrik 1992, me anë të një vendimi të Gjykatës së Rrethit Tiranë dhe është formuar nga Hajdar Qufaj, si president dhe z. Ballvora, si administratori dhe përfaqësuesi ligjor i shoqërisë.

Për më tepër, në zbatim të ligjit “Për shoqëritë tregtare” (Ligji nr. 7638/92) dhe ligjit nr.7667/93 “Për regjistrimin e shoqërive tregtare dhe regjistrin tregtar”, të gjitha shoqërive tregtare iu ishte kërkuar të reregjistroheshin brenda 6 muajve nga data 1 janar 1993, përndryshe ato nuk do të figuronin të regjistruara.

Në rastin konkret, sipas dokumentit të zyrës së regjistrimit të sjellë nga pala shqiptare, Qufaj sh.p.k. nuk e ka bërë reregjistrimin. Për rrjedhojë, pala shqiptare pretendoi se regjistrimi i saj është fshirë automatikisht nga regjistri.

Ashtu siç ishte përcaktuar në vendimin nr. 17 369/97 të Gjykatës së Rrethit Tiranë, shoqëria ankuese nuk ishte regjistruar zyrtarisht deri në 1997. Sipas këtij vendimi, menaxhimi i shoqërisë Qufaj sh.p.k. është realizuar nga z. Ballvora si administrator dhe nga z. Qufaj si ortak.

Sipas palës shqiptare, shoqëria e re Qufaj & co sh.p.k., pala ankuese në gjykatë, nuk është e njëjta shoqëri tregtare me atë që ishte palë në procesin gjyqësor, jo vetëm nisur nga fakti që shoqëria s'ka ekzistuar zyrtarisht nga viti 1993-1997, deri në momentin kur ka bërë reregjistrimin, por gjithashtu edhe për konfigurimin e ri të administrimit të saj.

Lidhur me sa më sipër, pala shqiptare argumentoi se administratori i kompanisë nuk ka autoritet të përfaqësojë një shoqëri, e cila nuk figuron më e regjistruar, si para autoriteteve vendase, ashtu dhe para Gjykatës Europiane. Për rrjedhojë, duke qenë se shoqëria e vjetër ka pushuar së ekzistuari që nga viti 1993, shoqëria ankuese nuk mund të konsiderohet viktimë sipas nenit 34.3 të Konventës.

Ankuesi e kundërshtoi këtë argument, duke deklaruar se Gjykata e Apelit, Tiranë e kishte hedhur poshtë këtë pretendim. Për më tepër, legjislacioni, të cilit autoritetet shtetërore i janë referuar, zbatohet vetëm për shoqëritë që nuk respektonin procedurat formale të regjistrimit dhe jo për shoqërinë e ankuesit. Si rrjedhojë, regjistrimi i tij nuk kishte përfunduar siç pretendonin autoritetet shtetërore. Përveç kësaj, reregjistrimi i 1997-ës u krye si pasojë e riorganizimit të shoqërisë, për shkak të ndryshimit të rrethanave financiare të shoqërisë.

Si rrjedhojë, ankuesi argumentoi që kundërshtimi paraprak i autoriteteve shtetërore është gjithashtu i pambështetur.

Gjykata vëren se shkelja e pretenduar nga shoqëria e ankuesit ka të bëjë me neglizhencën për të ekzekutuar vendimin e 23 shkurtit 1996. Autoritetet shqiptare shpallën vendimin pasi ligjet e përmendura nga autoritetet hynë në fuqi.

Në këtë kuadër, Gjykata vlerëson se kundërshtimi primar i autoriteteve shtetërore, lidhur me mungesën e cilësive të ankuesit për t'u konsideruar si “viktimë”, është i pavend, sepse faktet materiale kanë ndodhur para se detyrimi për reregjistrim të hynte në fuqi.

Përveç kësaj, duke qenë se z. Ballvora ishte dhe vazhdon të jetë administratori i të dy shoqërive, cilësia e tij për të vepruar si përfaqësues ligjor i të dy shoqërive është e pakundërshtueshme.

Për këto arsye, Gjykata vlerëson se edhe kundërshtimet e mësipërme duhet, gjithashtu, të hidhen poshtë.

b) Mbi meritat (themelin), ankuesi pretendoi se refuzimi i autoriteteve shtetërore për të zbatuar vendimin e datës 23 shkurt 1996 të Gjykatës së Apelit, Tiranë kishte penguar ushtrimin efektiv të së drejtës së tij, duke i shndërruar në të pakuptimta kërkesat e nenit 6§1.

Autoritetet shtetërore vërejtën se vendimi i formës së prerë nuk ishte zbatuar si rezultat i rrethanave objektive, si mungesa e fondeve dhe paqartësitë lidhur me kompetencat e autoriteteve shqiptare respektive. Gjithashtu, duke pasur parasysh kaosin ligjor dhe politik, si dhe situatën ekonomiko-shoqërore në Shqipëri, ekzekutimi i vendimit ishte krejtësisht i pamundur. Për më tepër, buxheti shtetëror ishte dhe mbetej i pamjaftueshëm për të përmbushur të gjitha kërkesat lidhur me pagat, sigurimin shëndetësor, arsimimin dhe infrastrukturën.

Duke vlerësuar pretendimet e ankuesit dhe vëzhgimet e autoriteteve shtetërore, Gjykata konstaton se çështje të rëndësishme ngrihen mbi faktet dhe legjislacionin e zbatueshëm, përcaktimi i të cilave kërkon një shqyrtim në themel të çështjes. Kjo pjesë e ankimit nuk mund të konsiderohet haptazi e pabazuar në kuptimin e nenit 35§3 të Konventës. Asnjë arsye tjetër për papranueshmërinë e saj nuk është ngritur.

Shoqëria ankuese argumentoi më tej se nuk ekzistojnë mjete të brendshme efektive për ekzekutimin e vendimit të 23 shkurtit 1996. Në këndvështrimin e saj, ka pasur një shkelje të nenit 13 të Konventës. Në këtë kuadër, ai i referohet vendimit të Gjykatës Kushtetuese, e cila refuzoi të merrte në shqyrtim çështjen, duke e konsideruar jashtë juridiksionit të saj.

Autoritetet shqiptare deklaruan se në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, kërkesa për “një proces të rregullt ligjor”, në kuptimin e nenit 131/f të Kushtetutës Shqiptare, nuk përfshin ekzekutimin e vendimit.

Gjykata vlerëson se neni 6 §1 i Konventës merr përparësi si “lex specialis” për çështjet e mosekzekutimit të vendimeve, kështu që është i panevojshëm shqyrtimi veçmas i çështjes në kuadrin e nenit 13 (shih Jasiuniene v. Lithuania, no.41510/98, § 32, 6 mars 2003).

Në përfundim, ankuesi deklaroi se autoritetet shqiptare kanë shkelur nenin 14 të Konventës, marrë së bashku me nenin 6 § 1, duke qenë se neglizhenca për të ekzekutuar vendimin e Gjykatës së Apelit, Tiranë, erdhi si pasojë e bindjeve politike të anëtarëve të shoqërisë. Ai deklaroi se autoritetet shqiptare preferonin kreditorë të tjerë me formim të ndryshëm politik-shoqëror.

Gjykata vlerëson se shoqëria ankuese nuk arriti të provonte pretendimin e saj që ishte diskriminuar si një kreditor privat në krahasim me kreditorët e tjerë.

Rrjedhimisht, kjo ankesë është haptazi e pabazuar dhe në përputhje me nenin 35 §§ 3 dhe 4 të Konventës, duhet rrëzuar.

Për këto arsye, Gjykata njëzëri,

Deklaron të pranueshme, pa cenuar meritat (themelin) e çështjes, kërkesën e shoqërisë ankuese, lidhur me nenin 6 §1 të Konventës.

Deklaron pjesën e mbetur të ankimit të papranueshme.

Vincent BERGER
Regjistruar

Georg Ress
Kryetar

VENDIM
(Ankimi nr. 54268/00)
ÇËSHTJA “QUFAJ CO. SHPK KUNDËR SHQIPËRISË”

STRASBURG
18 nëntor 2004

Përfundimtar
30.03.2005

Ky vendim do të marrë formë të prerë në rrethanat e përcaktuara në nenin 44 § 2 të Konventës. Ai mund t'i nënshtrohet rishikimit redaktues.

Në çështjen Qufaj Co. sh.p.k. kundër Shqipërisë,

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i tretë¹), me trup gjykues të përbërë nga:

z. G. RESS, *Kryetar*
z. I. CABRAL BARRETO
z. L. CAFLISCH
z. R. TURMEN
z. B. ZUPANCIC
znj. M. TSATSA- NIKOLOVSKA
z. K. TRAJA, gjyqtarë,

dhe z. V. BERGER, regjistruar i seksionit,
pas shqyrtimit me detyrë të mbyllura më 2 tetor 2003 dhe 26 tetor 2004, merr vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua në datën e fundit të përmendur:

PROCEDURA

1. Çështja fillon me ankimin (Nr. 54268/00) kundër Republikës së Shqipërisë, e depozituar në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (“Konventa”) nga një shoqëri shqiptare, Qufaj Co. sh.p.k. (“shoqëria ankuese”), më 26 korrik 1999.

2. Shoqëria ankuese përfaqësohet në Gjykatë, nëpërmjet kryetarit të saj dhe Drejtorit të Njësisë së Menaxhimit, z. Avenir Ballvora. Pala shqiptare u përfaqësua nga agjenti i tyre, z. Sokol Puto.

3. Shoqëria ankuese pretendoi, në veçanti, se dështimi i autoriteteve shqiptare për të ekzekutuar vendimin e formës së prerë, ka shkelur nenin 6 § 1 të kësaj Konvente.

4. Kërkesa u caktua në seksionin e tretë të Gjykatës (Neni 52 § 1 i rregullores së Gjykatës). Brenda këtij seksioni, trupi gjykues që do të merrte në shqyrtim çështjen (neni 27 § 1 i Konventës) është krijuar ashtu siç parashikohet në nenin 26 § 1.

5. Me anë të vendimit të 2 tetorit 2003, Gjykata e deklaroi kërkesën si pjesërisht të pranueshme.

6. Edhe ankuesi, edhe pala shqiptare depozituan vëzhgimet për meritat (themelin) e çështjes (neni 59 § 1). Pasi trupi gjykues vendosi pas konsultimeve me palët, që nuk kërkohej asnjë seancë dëgjimore lidhur me themelin e çështjes (neni 59 § 3 in fine), palët iu përgjigjën me shkrim vëzhgimeve të njëra-tjetrës.

¹ Në përbërjen e tij para datës 1 nëntor 2004

FAKTET

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

7. Shoqëria ankuese “Qufaj Co sh.p.k.” është një kompani shqiptare e themeluar me vendimin nr.5883 të Gjykatës së Rrethit Tiranë, më 20 korrik 1992, me objekt investim në biznesin e ndërtimit.

8. Me vendimin nr.165 të datës 9 qershor 1992, Bashkia e Tiranës i shiti shoqërisë ankuese 15, 788 metra katrorë tokë në një zonë banimi në Tiranë.

9. Me anë të vendimit nr.174 të datës 15 qershor 1992, Bashkia i dha shoqërisë ankuese leje urbanistike për të planifikuar ndërtimin e pesëqind apartamenteve. Duke qenë se para se të mund të fillonte projekti, ishte e nevojshme dhe marrja e një leje ndërtimi, shoqëria ankuese i paraqiti bashkisë kërkesën përkatëse, por bashkia për një kohë të gjatë nuk arriti dot të vendoste për çështjen, duke penguar kështu punimet e ndërtimit.

10. Pasi Bashkia kishte refuzuar të jepte lejen e ndërtimit, shoqëria ankuese inicioi procedurat në Gjykatën e Rrethit, Tiranë, duke kërkuar një kompensim prej 60 000 000 lekë (në total) për humbjen. Kërkesa e saj u hodh poshtë me vendimin nr. 4064 të datës 23 qershor 1995.

11. Në apel, Gjykata e Apelit, Tiranë, anuloi vendimin e shkallës së parë dhe urdhëroi Bashkinë t’i paguante ankuesit një shumë totale prej 60 000 000 lekë (vendimi nr. 1197 i datës 23 shkurt 1996).

12. Në mungesë të një apeli nga Bashkia në Gjykatën e Kasacionit, vendimi i Gjykatës së Apelit mori formë të prerë dhe u bë i zbatueshëm.

13. Më 16 korrik 1996, Kryetari i Gjykatës së Kasacionit, në një dokument drejtuar bashkisë, deklaroi se pas hyrjes në fuqi të Kodit të Ri të Procedurës Civile, nuk kishte më të drejtë të fillonte një rishikim mbikëqyrës të ligjshmërisë së vendimeve të gjykatave më të ulëta.

14. Më 16 korrik 1997, shoqëria ankuese i kërkoi Gjykatës së Rrethit, Tiranë, të nxirrte një urdhër për ekzekutimin e shlyerjes së kompensimit.

15. Më 25 qershor 1998, Gjykata e Rrethit, Tiranë, hodhi poshtë një kërkesë nga bashkia për të rishikuar vendimin nr. 5492 të datës 20 dhjetor 1994 mbi meritat (themelin) e çështjes, duke mos pasur bazë as në ligj, as në faktin përkatës për të vepruar në këtë mënyrë.

16. Më 23 korrik 1997, në dokumentin nr. 704/gj të datës 23 korrik 1997, zyra e përmbarimit njoftoi bashkinë se do ta ekzekutonte vendimin e Gjykatës së Apelit, duke i paguar shoqërisë ankuese një shumë totale prej 60 000 000 lekësh. Megjithatë, bashkia nuk ra dakord, duke refuzuar në mënyrë të vazhdueshme dhe duke argumentuar se nuk kishte buxhet për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore.

17. Njëkohësisht, zyra e përmbarimit i kërkoi Arkës së Shtetit dhe Departamentit të Buxhetit të Ministrisë së Financave (institucioni kryesor financiar përgjegjës për këto pagesa) të ekzekutonte vendimin, duke siguruar fondet e nevojshme (neni 589, paragrafi 2 i Kodit të Procedurës Civile).

18. Me anë të dokumentit 2018/3 të datës 19 shtator 1997, 2018/5 të datës 7 nëntor 1997 dhe 4670 të 22 shtatorit 1999, Ministria e Financave hodhi poshtë kërkesat e zyrës së përmbarimit, duke argumentuar se si neni 589 i Kodit të Procedurës Civile nuk ishte i zbatueshëm, ashtu edhe sipas ligjit të Buxhetit të Shtetit nuk mundësohej financimi nga buxheti qendror për ekzekutimin e vendimit. Gjithashtu shtoej se bashkia duhet të kontaktonte me “Distriktin e Thesarit të Degës së Tiranës”, duke specifikuar fondin nga i cili duhej të paguhej borxhi dhe pjesën e buxhetit të bashkisë tek i cili duhej të alokohej.

19. Meqë vendimi nuk u ekzekutua, shoqëria ankuese i depozitoi procedimet në Gjykatën Kushtetuese, duke pretenduar se institucionet e qeverisjes lokale ishin të detyruara të garantonin ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, për të mos i penguar ato.

20. Gjykata Kushtetuese hodhi poshtë ankesën e shoqërisë ankuese, duke deklaruar se “ankesa nuk merrej në konsideratë, sepse ekzekutimi i vendimeve të gjykatës është jashtë juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese”.

II. LEGJISLACIONI I BRENDSHËM PËRKATËS

A. Kushtetuta

21. Pjesët përkatëse të Kushtetutës Shqiptare vijnë si më poshtë:

Neni 42 § 2

“ Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetuese dhe ligjore, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.”

Neni 142 § 3

“Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore”.

Neni 131

“Gjykata Kushtetuese vendos:

f) gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

B. Kodi Civil

22. Sipas nenit 450 të Kodit Civil “kompensimi për dëmin e shkaktuar nga vonesa në pagesën e një shume të caktuar parash, do të marrë formën e interesit, i cili do të rritet nga dita që debitori ka detyrime të papaguara në monedhën zyrtare të vendit ku duhet të bëhet pagesa. Përqindja e interesit do të përcaktohet me ligj.”

23. Nuk është nxjerrë ende asnjë ligj që parashikon përqindjen e interesit të ligjshëm.

C. Udhëzimi nr. 1 i nxjerrë nga Ministria e Financave më 13 qershor 1997, sipas aktit financiar nr. 1 të datës 13 tetor 1997

24. Pjesa përkatëse e këtij udhëzimi vijon si më poshtë:

Paragrafi 7

“Pagesat që lindin nga vendimet gjyqësore në lidhje me aktivitetin normal të institucioneve buxhetore, do të autorizohen nga kreu i institucionit qendror. Njëkohësisht, kur dëmi për të cilin shteti është përgjegjës është pasojë e punonjësve publikë që veprojnë *ultra vires* ose nuk janë në gjendje të veprojnë në përputhje me kompetencat e tyre, kreu i institucionit qendror do të marrë masa administrative dhe do të fillojë procedime civile kundër tyre, sipas shkallës së përgjegjësisë së tyre.”

D. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 335 i datës 9 qershor 1998

25. Pjesa përkatëse e vendimit parashikon:

Paragrafi 2 (e)

“Ministria e Financave me fondin që i vihet në dispozicion në buxhetin e çdo viti, zbaton vendimet gjyqësore që lidhen drejtpërdrejt me detyrimet e Buxhetit të Shtetit dhe jo me detyrimet e institucioneve buxhetore. Në këto vendime përfshihen:

e) Vendimet gjyqësore që përcaktojnë shprehimisht detyrim të shtetit për shkaqe të tjera të parashikuara në ligje.”

E. Regjistri tregtar dhe ligji i regjistrimit të kompanive nr. 7667/93

26. Neni 64 i ligjit të regjistrimit të kompanive parashikon:

“Shoqëritë tregtare, të regjistruara para hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe që formalitetet e regjistrimit dhe kushtet materiale nuk i kanë në përputhje me këtë ligj, janë të detyruara të regjistrohen jo më vonë se 6 muaj nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji duke respektuar kërkesat e tij. Në qoftë se deri në këtë datë shoqëritë e sipërpërmendura nuk e kanë paraqitur kërkesën për reregjistrim dhe të gjitha dokumentet e kërkuara nga legjislacioni në fuqi, ato do të quhen të prishura automatikisht që nga kjo datë, por mund të kërkojnë në rrugë gjyqësore një shtyrje afati prej tre muajsh për të përmbushur detyrimin e mësipërm. Gjatë reregjistrimit të tyre shoqëritë trashëgojnë gjithë të drejtat e përfituara me rrugë ligjore para aktit të reregjistrimit.”

E DREJTA

I. KUNDËRSHTIMI PARAPRAK I PALËS SHQIPTARE

27. Pala shqiptare përsëriti argumentin e bërë në fazën e pranimi që ankimi duhet rrëzuar meqë shoqëria ankuese nuk ishte shoqëria e autorizuar për ekzekutimin e vendimit përkatës. Ata argumentuan se shoqëria ankuese ka rënë ndesh me formalitetet e regjistrimit, të parashikuara nga legjislacioni në kohën fizike. Për rrjedhojë, meqë shoqëria “e vjetër” ka pushuar së ekzistuari në vitin 1993, shoqëria ankuese nuk ndodhet në pozicionin e një “viktime”, siç kërkohet nga neni 34 § 3 i Konventës.

28. Më tej, pala shqiptare parashtroi se administratori i shoqërisë, z. Ballvora, nuk kishte autoritet të përfaqësonte një kompani të paregjistruar qoftë para autoriteteve shqiptare, ashtu edhe para Gjykatës Europiane.

29. Shoqëria ankuese u mbështet në deklaratat e saj në të njëjtat argumente që kishte parashtruar në përgjigje të vëzhgimeve të palës shqiptare, në fazën e pranimi.

30. Gjykata vëren se pala shqiptare e ka parashtruar këtë kundërshtim paraparak në detaje, në fazën e pranimi.

31. Në vendimin e saj mbi pranueshmërinë të datës 2 tetor 2003, Gjykata përcaktoi se ankuesi ishte “viktimë” brenda kuptimit të neni 34 të Konventës. Ajo çmon se nuk ka arsye për të që të shmanget nga ai vendim.

II. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 6§1 TË KONVENTËS

32. Shoqëria ankuese parashtroi se për shkak të pamundësisë për t’u pajtuar me vendimin e 23 shkurtit 1996, ishte shkelur neni 6 § 1 i Konventës, i cili parashikon:

“Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht,.....nga një gjykatë....., e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile.....”

A. Parashtrimet e palëve

33. Pala shqiptare parashtroi se sipas jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese Shqiptare, ekzekutimi i vendimeve gjyqësore nuk vlerësohej si element përbërës i konceptit të një procesi të rregullt, sipas kuptimit të neneve 42 dhe 131/f të Kushtetutës Shqiptare. Për rrjedhojë, Gjykata Kushtetuese çmoi se çështjet në lidhje me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore ishin jashtë juridiksionit të saj.

34. Pala shqiptare shtoi se neglizhenca për të ekzekutuar vendimin e formës së prerë, ishte rezultat i rrethanave objektive, si mungesa e fondeve, paqartësi në fushat e kompetencës dhe trazirat sociale, legjislative dhe politike në Shqipëri.

35. Shoqëria ankuese pretendoi se deklaratimet e palës shqiptare ishin të pabazuara.

36. Ajo argumentoi se refuzimi i autoriteteve për t’u pajtuar me vendimin e Gjykatës së Apelit të Tiranës të datës 23 shkurt 1996, kishte penguar realizimin efektiv të të drejtave të saj, duke e konsideruar kështu kërkesën e neni 6 § 1 si të pakuptimtë.

37. Shoqëria ankuese vuri në dyshim vullnetin e shtetit për të respektuar detyrimet e tij financiare me përpikmëri. Më tej, pretendoi se mënyra e vetme për t’u siguruar që sasia e kërkuar ishte paguar, ishte sigurimi i shpenzimeve të nevojshme në Buxhetin e Shtetit shqiptar.

B. Vlerësimi i Gjykatës

38. Gjykata pohon se neni 6 § 1 i siguron çdokujt të drejtën për t’u ankuar në gjykatë në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij civile; pra në këtë mënyrë mishëron “të drejtën për proces të rregullt”, - ku e drejta për akses- që është e drejta për të filluar një proces gjyqësor për çështje civile- është njëri prej aspekteve të saj.

Megjithatë, kjo e drejtë do të ishte iluzionare, nëse një sistem ligjor i brendshëm i një shteti anëtar, do të lejonte që një vendim gjyqësor i formës së prerë, të mbetej joveprues në dëm të një pale. Do të ishte e pakonceptueshme që neni 6 § 1 të përshkruajë në detaje garancitë procedurale të njohura palëve në procesin gjyqësor- procedime që duhet të jenë të ndershme, publike dhe të shpejta- pa mbrojtur ekzekutimin e vendimeve gjyqësore. Interpretimi i neni 6, si një nen që ka të bëjë ekskluzivisht me të drejtën e aksesit në gjykatë dhe me zhvillimin e procedurave, do të çonte në

situata të papajtueshme me parimin e shtetit të së drejtës, të cilin shtetet anëtare u angazhuan për ta respektuar, kur ratifikuan Konventën. Ekzekutimi i një vendimi të dhënë nga një gjykatë duhet të konsiderohet si pjesë përbërëse e “procesit të rregullt” sipas qëllimit të nenit 6. Autoritetet shtetërore nuk mund të përmendin mungesën e fondeve si justifikim për të mos respektuar një detyrim financiar që vjen nga një vendim gjyqësor. Pa dyshim, një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta. Megjithatë, vonesa nuk mund të jetë deri në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës së mbrojtur sipas nenit 6 § 1 (shih *Hornsby v Greece*, vendimin e 19 marsit 1997, *Reports of Judgments and Decisions 1997-II*, faqet 510- 511, & 40; dhe *Burdov v Russia*, nr.59498/00, % 34- 35, ECHR 2002-III; shih gjithashtu *Jasiuniene v Lithuania*, nr.41510/98, % 27, 6 mars 2003).

39. Në lidhje me rrethanat e çështjes në fjalë, në mënyrë që të sigurohej ekzekutimi i vendimit të Gjykatës së Apelit të Tiranës, shoqëria ankuese ishte e detyruar të ndiqte procedurat përkatëse të ekzekutimit (shih paragrafët 14- 17 më sipër) ndaj paraqiti kërkesë në Gjykatën Kushtetuese.

40. Gjykata vëren se sistemi ligjor shqiptar ofron mjete juridike të brendshme, për të ankimuar një shkelje të së drejtës për një gjykim të drejtë, mundësi kjo që teorikisht ishte në dispozicion të shoqërisë ankuese. Shoqëria u përpoq pa sukses ta shfrytëzonte këtë mjet, por Gjykata Kushtetuese e rrëzoi kërkesën e saj.

41. Në këtë kuadër, Gjykata vlerëson se e drejta për proces të rregullt ligjor në Shqipëri duhej të ishte interpretuar në mënyrë që të garantonte një mjet juridik efektiv për shkeljet e pretenduara për mosrespektimin e kriterëve të nenit 6 § 1 të Konventës.

42. Kështu, në opinionin e Gjykatës, Gjykata Kushtetuese ishte kompetente të shqyrtonte kërkesën e shoqërisë ankuese në lidhje me mosekzekutimin e një vendimi të formës së prerë, si pjesë të juridiksionit të saj për të siguruar të drejtën për proces të rregullt ligjor.

43. Gjykata vëren se në kohën materiale, shkaku i parashtruar nga autoritetet vendase për neglizhencën e tyre për të zbatuar vendimin, ishte se ato po ndesheshin me vështirësi financiare.

44. Sipas Gjykatës, shoqëria ankuese nuk duhet të ishte privuar nga përfitimi që rrjedh nga vendimi në favor të saj, i cili kishte të bënte me kompensimin për dëmin e shkaktuar nga refuzimi i autoritetit lokal për të dhënë leje ndërtimi, për arsye të vështirësive financiare të pretenduara nga Shteti.

45 Për arsyet e mësipërme, Gjykata çmon se për rrjedhojë ka pasur një shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës.

III. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

46. Neni 41 i Konventës parashikon:

“Nëse Gjykata konstaton shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj, dhe e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese mundëson vetëm ndreqjen e pjesshme të pasojave të shkaktuara nga shkelja, Gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar.”

A. Dëmet

47. Shoqëria ankuese kërkoi një urdhër për ekzekutimin e vendimit të gjykatës vendase dhe vlerësimin e masës së kompensimit për dëme financiare dhe jofinanciare. Ajo mbështetej në një raport ekspertësh për vlerësimin e masës së humbjes së saj.

48. Ajo shpjegoi se kishte pësuar dëm financiar për shkak të humbjes të së drejtës së përdorimit të tokës, si rezultat i refuzimit të autoriteteve për të dhënë leje ndërtimi dhe gjithashtu ka humbur shanse nga 23 qershori 1996, duke përfshirë interesin bankar nga kjo datë e në vazhdim. Nga ana tjetër, shumat e akorduar nga gjykata vendase, plus interesi bankar në përqindjet vendase nga 23 qershori 1996 (data që u paraqit vendimi) e në vazhdim, duhej t'i kishte sjellë shoqërisë përfitime të konsiderueshme.

49. Në tërësi, shoqëria ankuese pretendoi kompensim për humbje financiare në sasinë prej 2 500 000 dollarësh amerikanë.

50. Ajo pretendoi një shpërblim të veçantë të papërcaktuar për humbje jofinanciare.

51. Pala shqiptare gjykoi se pretendimet e shoqërisë ankuese ishin të ekzagjeruara, pasi nuk kishte ndonjë lidhje shkakësore midis shkeljeve të pretenduara dhe sasive të pretenduara për dëm financiar. Ata gjithashtu argumentuan se çdo shpërblim i drejtë që mund t'i jepej shoqërisë ankuese tashmë ishte dhënë nga Gjykata e Apelit e Tiranës dhe qëllimi i vetëm i kërkesës në Gjykatë ishte ankesa rreth neglizhencës për të ekzekutuar atë vendim.

52. Për më tepër, pala shqiptare parashtroi se nuk kishte fakte që shoqëria ankuese kishte vuajtur ndonjë dëm jofinanciar.

53. Në fillim, Gjykata vëren se pretendimi i shoqërisë ankuese për dëm financiar në lidhje me refuzimin e autoriteteve shqiptare për të dhënë leje ndërtimi është *ultra petita* dhe për pasojë e hedh poshtë atë.

54. Në tërësi, Gjykata pohon se në kontekstin e ekzekutimit të vendimeve në përputhje me nenin 46 të Konventës, një vendim në të cilin gjen shkelje, vendos mbi palën shtetërore një detyrim ligjor, për t'i dhënë fund shkeljes dhe për të ndrequr pasojat e saj, në mënyrë të tillë që të përmirësojë sa të jetë e mundur situatën ekzistuese para shkeljes. Nëse, nga ana tjetër, interpretimi nga gjykatat vendase i ligjit vendas ose në veçanti, i konceptit *strictu sensu* të “procesit të rregullt ligjor” në kuptim të nenit 6§1 të Konventës, nuk lejon ose lejon vetëm dëmshpërblimin e pjesshëm për pasojat e shkeljes, neni 41 autorizon gjykatën t'i sigurojë palës së dëmtuar një kompensim sa më të përshtatshëm. Midis të tjerash, një vendim në të cilin gjykata gjen shkelje të Konventës ose të Protokolleve të saj, vendos mbi shtetin palë një detyrim ligjor jo thjesht për t'u paguar personave të interesuar shumë e caktuar për shpërblim të drejtë, por gjithashtu për të përcaktuar, nën monitorimin e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës- masat e përgjithshme dhe/ose nëse është e nevojshme, masat individuale- që duhen adoptuar në sistemin e brendshëm ligjor, në mënyrë që t'i jepet fund shkeljes së konstatuar nga gjykata dhe të realizohet vënia në vend e dëmeve të ardhura nga pasojat e saj, duke përmirësuar sa më shumë të jetë e mundur situatën ekzistuese para se të ndodhte shkelja (shih *mutatis mutandis*, *Maestri v Italy*) (GC), nr. 39748/98, # 47, 17 shkurt 2004; *Mentes and Others v Turkey* (neni 50), vendimi i 24 korrikut 1998, Reports 1998- IV, fq 1695, § 24; dhe *Scozzari and Giunta v Italy* (GC), nos 39221/98 dhe 41963/98, § 249, ECHR 2000- VIII).

55. Shtetet anëtare që janë palë në një çështje, janë parimisht të lira të zgjedhin mjetet me anë të të cilave do të zbatojnë vendimin, në të cilin gjykata ka konstatuar një shkelje. Ky diskrecion në lidhje me mënyrën e ekzekutimit të vendimit, reflekton lirinë e zgjedhjes që i bashkohet detyrimit parësor të shteteve kontraktuese sipas Konventës, për të siguruar të drejtat dhe liritë e garantuara (neni 1). Nëse natyra e shkeljes lejon *restitutio in integrum*, duhet që pala shqiptare ta realizojë atë.

56. Gjykata tashmë ka pranuar se nëse duhet të mbrohen efektivisht të drejtat dhe të krijohet shteti ligjor, autoritetet administrative janë rrjedhimisht të detyruara të ekzekutojnë vendimet e formës së prerë. Kur autoritetet administrative refuzojnë, neglizhojnë ose vonojnë t'i ekzekutojnë këto vendime, garancitë që gëzon një palë e përfshirë në një proces gjyqësor, sipas nenit 6 të Konventës, e humbasin qëllimin e tyre (shih *Hornsby* të cituar më sipër, faqet 510-511, § 40 et seq; *Metaxas v Greece*, nr.8415/02, § § 25 dhe 26, 27 maj 2004).

57. Më specifikisht, Gjykata pohon se në lidhje me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore që vendosin detyrime monetare ndaj një shteti, shteti nuk duhet t'i kërkojë personit ndaj të cilit është debitor, të iniciojë procedura të ekzekutimit të vendimit, me qëllim kompensimin e shumës së caktuar (shih *Metaxas*, siç citohet më sipër § 19).

58. Në këtë rast të veçantë, Gjykata vëren se ndërsa legjislacioni kombëtar e lejon vënien në vend të shkeljeve, është jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese që vendos interpretimin *strictu sensu* të konceptit të “proces i rregullt gjyqësor” sipas kuptimit të nenit 6§1 të Konventës, duke përjashtuar nga ky koncept, dhënien e kompensimit për shkak të mosekzekutimit të një vendimi gjyqësor.

59. Në rrethanat e rastit në fjalë, pagesa e detyrimit të shtetit, sipas vendimit të formës së prerë të Gjykatës së Apelit Tiranë, duhet të kompensojë kompaninë ankuese sa më shumë të jetë e mundur, sa me afër situatës, nëse autoritetet shqiptare do ta kishin zbatuar këtë vendim të formës së prerë. Palës shqiptare i takon të marrë masat e nevojshme për të bërë kompensimin e shoqërisë

ankuese për çdo dëm të shkuar apo të ardhshëm të shkaktuar nga shkelja e Konventës, siç është konstatuar nga Gjykata.

60. Për pasojë, Gjykata çmon se shteti i paditur duhet t'i paguajë shoqërisë ankuese të gjithë shumën e dhënë nga gjykata kombëtare, që është gjithsej 60 000 000 lekë.

61. Për më tepër, Gjykata çmon se neglizhenca për një kohë të gjatë për të paguar sasinë e caktuar nga gjykata vendase dhe vitet e pasigurisë i kanë shkaktuar shoqërisë ankuese pashmangshmërisht dëm, që të paktën qoftë dhe pjesërisht duhet të kompensohet në mënyrën e duhur.

62. Megjithatë, Gjykata nuk mund të spekulojë me përfitimin që do të kishte nxjerrë shoqëria ankuese, duke investuar shumën e dhënë nga gjykata vendase, po të kishte qenë në gjendje të përdorte paratë në përputhje me planet dhe pritshmërinë e saj (Pialopoulos and Others v. Greece (kompensim i drejtë), nr.37095/97, § 17, 27 qershor 2002). Për rrjedhojë, gjykata e çmon të drejtë t'i japë shoqërisë ankuese një shumë që do të përcaktohet drejtësisht për dëmin pasuror.

63. Në lidhje me dëmin jopasuror, Gjykata pranon se shoqëria ankuese ka vuajtur një dëm moral që do të ishte shmangur nëse autoritetet do kishin rënë dakord me vendimin e formës së prerë. Në këtë kontekst, ajo rithekson se një kompanie tregtare mund t'i jepet kompensim për dëmin jopasuror (Comingersoll S. A. v Portugal (GC, nr.35382/97, ECHR 2000-IV, § 35)

64. Duke bërë vlerësimin mbi baza barazie, siç kërkohet nga neni 41 i Konventës, Gjykata i jep shoqërisë ankuese një shumë të menjëhershme dhe të plotë prej 70 000 eurosh, në lidhje me dëmin financiar dhe jofinanciar. Kjo shumë duhet konvertuar në valutën kombëtare të shtetit të paditur në kursin e zbatueshëm në datën e shlyerjes.

B. Kostot dhe shpenzimet

65. Për kostot dhe shpenzimet, shoqëria ankuese pretendon se ka bërë shpenzime të konsiderueshme në marrjen e konsulencës ligjore dhe dokumentet ligjore dhe mbikëqyrëse për t'u përdorur në procedurat e brendshme dhe para Gjykatës. Ajo shtoi se nuk ishte e mundur për të të siguronte një pasqyrë të detajuar. Ajo dha vetëm një faturë që është një llogari prej 2000 eurosh për një raport inspektori, që e ka paraqitur në Gjykatë me vëzhgimet e tij me shkrim në lidhje me shpërblimin e drejtë.

Për rrjedhojë, shoqëria ankuese e la përcaktimin e shumës në gjykimin e Gjykatës.

66. Pala shqiptare pohoi se shoqëria ankuese, e cila nuk ishte përfaqësuar nga një avokat para gjykatës, nuk kishte të drejtë për kosto apo shpenzim.

67. Gjykata vëren se shoqëria ankuese, e cila nuk është përfaqësuar me avokat para Gjykatës, nuk ka dhënë ndonjë detaj të tarifave dhe shpenzimeve të pësura në procedimet e brendshme. Në lidhje me tarifat për procedurat në Strasburg, shuma e përcaktuar në faturën e paraqitur nga shoqëria ankuese (një total prej 2000 eurosh) duket e arsyeshme për Gjykatën, e cila e jep këtë shumë të plotë.

C. Interesi i papaguar

68. Gjykata e çmon të nevojshme që interesi i papaguar duhet të bazohet në tarifën e huadhënies marxhinale të Bankës Qendrore Europiane, së cilës duhet t'i shtohen tre për qind të pikëve.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA VENDOSI NJEZËRI

1. Të hedhë poshtë kundërshtimin paraprak të Qeverisë;
2. Gjykon se ka pasur një shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës;
3. a) Gjykon se pala shqiptare duhet t'i paguajë shoqërisë ankuese, brenda tre muajve nga data në të cilën vendimi merr formë të prerë, sipas nenit 44 § 2 të Konventës, shumat e mëposhtme:
 - i) shumën e caktuar nga Gjykata e Apelit e Tiranës, d.m.th. totalin prej 60 000 000 (gjashtëdhjet milionë) lekë.
 - ii) 70 000 euro (shtatëdhjetë mijë euro) në lidhje me dëmin financiar dhe jofinanciar, për t'u konvertuar në valutën kombëtare të shtetit të paditur në kursin e zbatueshëm në datën e shlyerjes.

iii) 2000 (dy mijë) euro në lidhje me kostot dhe shpenzimet, për t'u konvertuar në valutën kombëtare të shtetit të paditur në kursin e zbatueshëm në datën e shlyerjes.

iv) Çdo taksë që mund të jetë e pagueshme për shumat e mësipërme;

b) që nga skadimi i tre muajve të sipërpërmendur deri në shlyerjen, interesi i thjeshtë do të jetë i pagueshëm për shumat e mësipërme në një përqindje të barabartë me përqindjen e huadhënies marxhinale të Bankës Qendrore Europiane gjatë periudhës së mospagesës, plus tre për qind të pikëve;

4. Hedh poshtë pjesën tjetër të kërkesës së shoqërisë ankuese për shpërblim të drejtë.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 18 nëntor 2004, sipas neneve 77 § § 2 dhe 3 të rregullores së Gjykatës.

Vincent BERGER
Regjistruesi

Georg RESS
Kryetari

VENDIM MBI PRANUESHMËRINË
(Ankimi Nr.10513/03)
ÇËSHTJA “NAUMOV KUNDËR SHQIPËRISË”

STRASBURG
4 Janar 2005

Në këtë çështje ankuesi ankohet në bazë të nenit 5/1 të Konventës për heqjen e lirisë dhe shkelje të nenit 6§1 të Konventës, për procedura të gjata, të padrejta dhe mungesë të pavarësisë dhe paanësisë nga gjykatat vendase në procedimet lidhur me shtetësinë dhe dëbimin e tij. Gjykata ka ripërsëritur se sipas nenit 35/1 të Konventës, ajo shqyrton vetëm ankime, për të cilat janë shteruar mjetet e brendshme të ankimit dhe që janë paraqitur brenda 6 muajve nga data e dhënies së vendimit “përfundimtar” të brendshëm. Në mungesë të një mjeti të përshtatshëm ankimimi ndaj një akti të veçantë, që pretendohet se është në shkelje të Konventës, akti duhet konsideruar si “përfundimtar” me kalimin e afatit 6-mujor nga data e dhënies së tij, që passjell mospranimin e ankimit përtej këtij afati.

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (seksioni i katërt), e mbledhur më 4 janar 2005 si Dhomë e përbërë prej:

Z.Nikolas Bratza President

Z.M.Pelonpaa

Z.R.Maruste

Z.K.Treja

Z.S.Pavlovski

Z.L.Garlicki

Z.J.Sikuta, gjyqtarët

dhe znj.F.Elens-PASSOS, zëvendës regjistruer i seksionit,
duke u mbështetur në aplikimin e mësipërm të depozituar më 3 dhjetor 2002,
duke u mbështetur në vëzhgimet e paraqitura nga qeveria përgjegjëse dhe vëzhgimet e paraqitura nga ankuesi,
pasi ka diskutuar çështjen ka vendosur si më poshtë:

FAKTET

Ankuesi z.Stefan Naumov është një shtetas shqiptar, i cili ka lindur më 1945 dhe jeton në Tiranë (Shqipëri).

A. Rrethanat e çështjes

Faktet e çështjes siç janë paraqitur nga ankuesi mund të përmbledhen si më poshtë:

Ankuesi, një shtetas bullgar, ka qenë Ambasadori Bullgar në Republikën e Shqipërisë nga viti 1990 deri në vitin 1997.

Më 1996 Ministria e Punëve të Jashtme të Bullgarisë filloi procedim ligjor kundër ankuesit si rrjedhojë e të cilave ai u pezullua nga puna me anë të një urdhri të ministrit.

Më 10 shkurt 1997 Gjykata e Lartë e Bullgarisë anuloi urdhrin e ministrit që e pushonte ankuesin nga puna. Në një ditë të papërcaktuar ankuesi u tërhoq nga jeta politike.

Më 1997 ankuesi dhe familja e tij i kërkuan Presidentit të Republikës së Shqipërisë shtetësinë shqiptare. Më 17 prill 1997 Presidenti i Republikës u dha atyre shtetësinë shqiptare.

Më 20 shtator 2001 Presidenti i Republikës së Shqipërisë, i zgjedhur së fundi, në mënyrë *ex officio* ka deklaruar nul dhe të pavlefshëm dekretin e presidentit të datës 17 prill 1997 duke revokuar në këtë mënyrë shtetësinë shqiptare të ankuesit me arsyen se ishte siguruar me anë të dokumenteve të falsifikuara. Sipas dekretit, ankuesi kishte paraqitur dokumente të falsifikuara për të treguar se kundër tij nuk ishte filluar asnjë procedim penal në Bullgari.

Më 2 tetor 2001, rreth orës 9.00 një grup me punonjës policie, disa prej tyre të armatosur, shoqëruan ankuesin, së bashku me gruan e tij, në rajonin e policisë së Tiranës për njoftimin zyrtar të dekretit.

Pas disa orësh pritje, ankuesit i është dhënë një kopje e dekretit të presidentit të datës 20 shtator 2001, me anë të cilit i hiqej shtetësia shqiptare.

Për më tepër, zëvendësshefi i Drejtorisë së Policisë Tiranë urdhëroi verbalisht ankuesin që të largohej nga territori i Shqipërisë më 5 tetor 2001 (d.m.th. brenda tri ditësh) në zbatim të një urdhri dëbimi datë 29 shtator 2001 ose përndryshe do të dëbohej me forcë.

Më 2 tetor 2001 Ministria e Punëve të Brendshme lëshoi një njoftim për shtyp sipas të cilit ankuesi ishte urdhëruar të linte territorin e Shqipërisë më 5 tetor 2001, meqenëse shtetësia shqiptare, që ai kishte fituar me anë të dokumenteve të falsifikuara, i ishte hequr.

Më 4 tetor 2001, policia pa asnjë arsye të dukshme e ndaloi ankuesin dhe familjen e tij të lëvizte nga apartamenti i tyre. Situata u zgjidh me anë të ndërhyrjes së një anëtari të Parlamentit. Më 5 tetor 2001 ankuesi mori një letër nga Drejtoria e Policisë që i kujtonte atij largimin nga territori i Shqipërisë deri në mesnatën e asaj dite.

Procedurat kundër dekretit të Presidentit që revokonin shtetësinë

Më 2 tetor 2001 ankuesi depozitoi një padi në Gjykatën e Rrethit Tiranë duke pretenduar se dekreti i Presidentit i datës 20 shtator 2001, duhej të anulohet si antikushtetues. Për më tepër ai ka kërkuar si masë të përkohshme, që ekzekutimi i urdhrit të dëbimit të pezullohet.

Më 4 tetor 2001 gjykata e rrethit refuzon juridiksionin për shqyrtimin e ankesës së ankuesit dhe përcaktoi Gjykatën Kushtetuese si autoritetin kompetent.

Më 31 dhjetor 2001 Gjykata e Lartë (Kolegji Civil) prishi vendimin e gjykatës së rrethit të datës 4 tetor 2001 dhe e dërgoi çështjen për rigjykim në gjykatën e rrethit si autoritetin kompetent për shqyrtimin e ankimit të ankuesit.

Më 23 dhjetor 2002, pas një viti mosveprimi, gjykata e rrethit në rigjykimin e çështjes, vendosi të anulojë dekretin e Presidentit të datës 20 shtator 2001 si të pambështetur, duke konfirmuar në këtë mënyrë shtetësinë shqiptare të ankuesit.

Procedurat kundër urdhrit të dëbimit dhe urdhrit të policisë

Më 5 tetor 2001 ankuesi depozitoi një padi në gjykatën e rrethit Tiranë duke pretenduar që urdhri i dëbimit i datës 29 shtator 2001 dhe urdhri i policisë i datës 5 tetor 2001 të anuloheshin dhe të hidheshin poshtë.

Në bazë të fakteve të paraqitura nga ankuesi, gjykimi në Gjykatën e Shkallës së Parë ka zgjatur 2 vjet dhe 6 muaj dhe janë zhvilluar 14 seanca dëgjimore. Seancat gjyqësore janë shtyrë në disa raste si rezultat i mungesës së pajustifikuar të këshilltarëve ligjorë të Drejtorisë së Policisë dhe të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Këta të fundit kanë munguar në 13 seanca gjyqësore pa dhënë asnjë arsye.

Më 25 mars 2002 gjykata e rrethit ka pezulluar shqyrtimin e ankimit të ankuesit deri në momentin që gjykata të vendoste mbi vlefshmërinë e dekretit të Presidentit.

Më 7 shkurt 2003 gjykata përfundon gjykimin. Brenda një viti ajo ka zhvilluar 4 seanca dëgjimore dhe në mungesë të përfaqësuesve të autoriteteve, ka vazhduar procedurat vetëm në prezencën e ankuesit.

Më 20 mars 2003, në mungesë të përfaqësuesve të autoriteteve, gjykata e rrethit ka anuluar urdhrin e dëbimit dhe urdhrin e policisë të datës 5 tetor 2001 si të pambështetur në kriteret ligjore.

B. E drejta e brendshme

1. Neni 92 i Kushtetutës së Shqipërisë parashikon që Presidenti i Republikës ka fuqinë të japë dhe të heqë shtetësinë shqiptare në përputhje me ligjin.

2. Pjesa përkatëse e Ligjit Nr. 8389 të datës 5 gusht 1998 mbi dhënien dhe heqjen e shtetësisë shqiptare, shprehet si më poshtë.

Neni 9

Dhënia e shtetësisë me anë të natyralizimit

“Një shtetas i huaj që ka paraqitur një aplikim për përfitimin e shtetësisë shqiptare me anë të natyralizimit duhet të sigurojë nëse i plotëson kërkesat e mëposhtme:

Ai të ketë arritur moshën 18 vjeç; ai ka jetuar në mënyrë të ligjshme në territorin e Republikës së Shqipërisë për jo më pak se 5 vjet të njëpasnjëshme; ai ka të ardhura të mjaftueshme dhe shtëpi banimi; ai nuk ka qenë asnjëherë i dënuar në vendin e tij ose në Republikën e Shqipërisë, ose në një shtet të tretë për një vepër penale për të cilën ligji parashikon vendimin me burgim për jo më pak se 3 vjet. Përfundimisht nga ky rregull bëhet vetëm nëse provohet që vendimi i dënimit është dhënë për arsye politike; ai ka së paku njohuri elementare të gjuhës shqipe; dhe pranimi i tij si një shtetas shqiptar nuk prek sigurinë dhe mbrojtjen e Republikës së Shqipërisë...”

Neni 13

Revokimi i vendimit për dhënien e shtetësisë

“Vendimi për dhënien e shtetësisë shqiptare mund të revokohet nëse provohet që të huajt ose personat pa shtetësi kanë mbështetur në mënyrë të qëllimshme aplikimin e tyre për fitimin e shtetësisë shqiptare mbi të dhëna jo të sakta dhe dokumente të falsifikuara...”

PRETENDIMET

1. Ankuesi ankohet në bazë të nenit 5/1 të Konventës për heqjen e lirisë.
2. Duke u mbështetur në nenin 6/1 të Konventës, ankuesi ankohet për procedura të gjata, të padrejta dhe mungesë të pavarësisë dhe paanësisë në gjykatat vendase në gjykimet lidhur me shtetësinë dhe dëbimin e tij.
3. Ankuesi i referohet nenit 8 të Konventës në lidhje me urdhrin e tij të dëbimit.
4. Mbështetur në nenin 10 të Konventës, ankuesi ankohet për persekutimin që ai ka vuajtur për shkak të bindjeve të tij politike.
5. Së fundi ai pretendon shkelje të nenit 3 të protokollit nr.4 dhe/ose nenit 1 të protokollit 7 të Konventës.

E DREJTA

Ankuesi ankohet për ndalimin e tij të paligjshëm në rajonin e policisë, duke iu referuar nenit 5/1 të Konventës, i cili për aq sa ka lidhje shprehet si më poshtë:

“1. Çdokush ka të drejtën e lirisë dhe sigurisë personale. Askujt nuk mund t'i hiqet liria, me përjashtim të rasteve që vijnë dhe në përputhje me procedurën e parashikuar nga ligji.

(f)...në rastet e arrestimit ose burgimit të rregullt të një personi për të parandaluar hyrjen e paligjshme të tij në një vend ose të një personi ndaj të cilit po kryhet një procedurë dëbimi ose ekstradimi...”

Ankimi i ankuesit sipas kësaj dispozite lidhet me kohën që ai ka kaluar në rajonin e policisë për një afat të papërcaktuar më 2 tetor 2001, e cila sipas tij përbën “heqje të lirisë” sipas kuptimit të nenit 5/1 të Konventës.

Gjykata thekson se sipas nenit 35/1 të Konventës, ajo mund të shqyrtojë vetëm ankime, për të cilat janë shteruar mjetet e brendshme të ankimit dhe të cilat janë paraqitur brenda 6 muajsh nga data e vendimit përfundimtar të brendshëm. Në mungesë të një ankimi të përshtatshëm kundër një akti të veçantë, i cili pretendohet të ketë qenë shkelje e Konventës, data kur është marrë ky akt do të konsiderohet si “përfundimtar”, në kuptim të zbatimit të afatit 6-mujor (shih Valasinas vs.Lithuania, nr.44558/98, 14 mars 2000).

Gjykata, së pari konstaton se ankuesi nuk ka filluar procedura gjyqësore në lidhje me shkeljen e pretenduar të së drejtës së tij sipas nenit 5 të Konventës.

Për më tepër duke pranuar se ankuesi nuk ka ankim ligjor sipas kuptimit të nenit 35/1, lidhur me pretendimin “heqje lirie”, referuar qëndrimin të tij në rajonin e policisë, ngjarjet për të cilat ankohet në këtë rast lidhen me datën 2 tetor 2001, që është më shumë se 6 muaj përpara se

aplikimi të depozitohet në datën 3 dhjetor 2002. Si pasojë kjo pjesë e aplikimit është paraqitur jashtë afatit kohor.

Për rrjedhojë, kjo pjesë e aplikimit duhet të hidhet poshtë, në mbështetje të nenit 35, paragrafët 1 dhe 4 të Konventës.

2. Ankuesi ka pretenduar se ka pasur një numër shkeljesh të nenit 6/1 të Konventës i cili për këtë rast shprehet si më poshtë:

“Për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat civile dhe detyrimet...çdokujt i njihet e drejta për një proces të rregullt...brenda një periudhe kohe të arsyeshme nga një trup gjykues i pavarur dhe i paanshëm i krijuar me ligj...”

Në zbatim të procedurave që lidhen me heqjen e shtetësisë dhe dëbimit, ankuesi ankohet që nuk i është dhënë mundësia për një proces të rregullt gjyqësor, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Për më tepër ankuesi ankohet që kohëzgjatja e procedurave nuk ka qenë në përputhje me kërkesën “kohë të arsyeshme”.

Që në fillim gjykata rithekson se neni 6/1 i Konventës nuk aplikohet për procedurat që rregullojnë shtetësinë e personave dhe/ose hyrjen, qëndrimin dhe dëbimin e të huajve, pasi procedura të tilla nuk përfshijnë “përcaktimin e të drejtave të tij civile apo detyrimet ose ndonjë akuzë penale kundër tij” në kuptimin e nenit 6/1 të Konventës (shih ndërmjet autoriteteve të tjera, S.Sëitcerland nr.13325/87, 15 dhjetor 1988, Soc.k.Kroacisë nr.47 863/9, 29 qershor 2000).

Në kuadrin e këtyre rrethanave, gjykata vëren se neni 6/1 i Konventës nuk zbatohet për procedurat që kanë të bëjnë me heqjen e shtetësisë. Në këtë mënyrë, kjo pjesë e aplikimit duhet të rrëzohet si jo në përputhje me parimin *ratione materiae* e sipas përcaktimeve të Konventës, në zbatim të nenit 35, paragrafët 3 dhe 4 të Konventës.

3. Ankuesi ka parashtruar se autoritetet shqiptare i kanë shkelur të drejtën për të respektuar jetën e tij private dhe të familjes të garantuar nga neni 8 i Konventës, i cili shprehet si më poshtë:

“1. Çdonjëri ka të drejtë që t’i respektohet jeta private dhe familjare....

2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur në një shoqëri demokratike kjo masë është e nevojshme në interesat e sigurisë kombëtare, sigurisë publike ose të mirëqenies ekonomike të vendit, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimeve, për mbrojtjen e shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.”.

Ankuesi ankohet lidhur me publikimin në opinionin publik dhe shpalljen e bërë me këtë rast me anë të shtypit për dëbimin e tij si rrjedhojë e heqjes së shtetësisë së tij shqiptare nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Ankuesi ankohet se ky demaskim duhet konsideruar si shkelje e së drejtës së tij për t’i respektuar jetën e tij private dhe reputacionin e tij, pavarësisht nga ligjshmëria e aktit që i heq atij shtetësinë shqiptare.

Gjykata vëren se, ashtu si në rastin e ankimit të tij për nenin 5 të Konventës, ankuesi nuk ka çelur një procedim gjyqësor në lidhje me shkeljen e pretenduar të së drejtës së tij sipas nenit 8 të Konventës.

Duke presupozuar që ankuesi nuk ka asnjë ankim ligjor për pretendimin e tij lidhur me demaskimin publik për shkak të heqjes së shtetësisë së tij, gjykata vëren se një demaskim i tillë ka ndodhur më 2 tetor 2001, që është më shumë se 6 muaj përpara se aplikimi të depozitohet më 3 dhjetor 2002. Si pasojë kjo pjesë e ankimit është paraqitur jashtë afatit.

Për rrjedhojë, kjo pjesë e aplikimit duhet të hidhet poshtë në zbatim të nenit 35, paragrafët 1 dhe 4 të Konventës.

4. Ankuesi është ankuar se persekutimi që ai ka vuajtur për arsye të bindjeve të tij politike dhe të kaluarës së tij demokratike, është shkelje e nenit 10 të Konventës që shprehet si më poshtë vijon:

“1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë e dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon shtetet nga kërkesa për licencimin e sipërmarrjeve të radiodifuzionit, kinemasë dhe televizionit.

2. Ushtrimi i këtyre lirive që mbartin detyrime dhe përgjegjësi, mund të jetë subjekt i disa formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose penalizimeve siç janë parashikuar nga ligji dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike për mbrojtjen e rendit, parandalimin e krimeve, për mbrojtjen e shëndetit dhe të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të drejtave të të tjerëve për parandalimin e përhapjes së informacionit konfidencial ose për ruajtjen e autoritetit dhe të paanshmërisë së pushtetit gjyqësor.”.

Gjykata vëren se ankuesi nuk ka paraqitur ndonjë provë në mbështetje të pretendimeve të tij. Për rrjedhojë gjykata është e mendimit se ankuesi nuk ka mundur të provojë thëniet e tij dhe të paraqesë një pretendim të argumentuar për shkelje të këtij neni.

Kështu që, ky ankim është haptazi i pabazuar dhe duhet të hidhet poshtë në zbatim të nenit 35, paragrafët 3 dhe 4 të Konventës.

5. Ankuesi ankohet në mënyrë të alternuar se urdhri i dëbimit ka shkelur nenin 3 të Protokollit Nr.4 ose nenin 1 të Protokollit Nr. 7 të Konventës.

Neni 3 i Protokollit Nr. 4 të Konventës në pjesën përkatëse shprehet si më poshtë:

“1. Askush nuk mund të dëbohet me anë të një mase individuale ose kolektive, nga territori i shtetit, shtetas i të cilit është.”.

Neni 1 i Protokollit Nr. 7 të Konventës, në pjesën përkatëse shprehet si më poshtë:

“1. Një i huaj, rezident i ligjshëm në territorin e një shteti nuk mund të dëbohet prej aty, përveçse në rast se zbatohet një vendim i cili është nxjerrë në përputhje me ligjin dhe duhet të ketë mundësi:

- a) të paraqesë arsyet kundër dëbimit të tij,
- b) të kërkojë rishikimin e çështjes së tij,
- c) të përfaqësohet për këtë qëllim përpara autoriteteve kompetente ose një apo disa personave të caktuar nga ky autoritet.

2. Një i huaj mund të dëbohet para se të ushtrohen të drejtat e tij sipas paragrafit 1 (a), (b) dhe (c) të këtij neni, kur një dëbim i tillë është i nevojshëm në interes të rendit publik ose është i bazuar në arsyet e sigurisë kombëtare.”.

Ankuesi pohon se urdhri i dëbimit ishte shkelje e nenit 3 të Protokollit Nr. 4 ose nenit 1 të Protokollit Nr. 7, pasi nuk ishte përcaktuar se kur merrte fuqi ligjore dekreti i Presidentit i datës 20 shtator 2001 që revokonte shtetësinë shqiptare të tij.

Lidhur me ankimin e ankuesit për nenin 3 të Protokollit Nr. 4, gjykata vëren se për arsye të dekretit të Presidentit, datë 20 shtator 2001, ankuesi nuk kishte shtetësi shqiptare në kohën e lëshimit të urdhrit të dëbimit të tij më 29 shtator 2001.

Edhe pse në disa raste revokimi i shtetësisë i ndjekur me dëbim mund të sjellë probleme potenciale sipas nenit 3 të protokollit nr. 4, nisur nga fakti që urdhri i dëbimit nuk është ekzekutuar, gjykata vëren se në rastin konkret nuk ka elemente të shkeljes së këtij neni.

Për rrjedhojë kjo pjesë e aplikimit është haptazi e pabazuar dhe duhet të refuzohet në zbatim të nenit 35, paragrafët 3 dhe 4 të Konventës.

Për sa i përket ankimit të ankuesit sipas nenit 1 të Protokollit Nr. 7, Gjykata vëren se ankuesi asnjëherë nuk u dëbua nga Shqipëria dhe nuk janë ndërmarrë masa për zbatimin forcërisht të urdhrave të policisë të datave 29 shtator dhe 5 tetor 2001. Për më tepër ankuesi ishte në gjendje të paraqesë arsyet kundër dëbimit të tij dhe çështja e tij u rishikua nga gjykatat vendase, të cilat më 20 mars 2003 kanë deklaruar urdhrat të pavlefshëm duke ndjekur anulimin e dekretit të Presidentit që i hiqte shtetësinë shqiptare ankuesit.

Prandaj ankimi i ankuesit sipas nenit 1 të Protokollit Nr. 7 është i papranueshëm dhe haptazi i pabazuar dhe duhet të hidhet poshtë, në përputhje me nenin 35, paragrafët 3 dhe 4 të Konventës.

Për këto arsye, Gjykata njëzëri,
Deklaron aplikimin të papranueshëm.

F.Elens-PASSOS
Zëvendës Regjistrues

Nicolas Bratza
Kryetar

VENDIM
(Ankimi nr. 7352/03)
ÇËSHTJA “BESHIRI ETJ. KUNDËR SHQIPËRISË”

STRASBURG
22 gusht 2006

Ky vendim do të marrë formë të prerë në rrethanat e përcaktuara në nenin 44 § 2 të Konventës. Ai mund t'i nënshtrohet rishikimit redaktues.

Kjo çështje trajton mosekzekutimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë që ka të bëjë me kompensimin për parcelat e tokës që janë konfiskuar gjatë regjimit komunist (shkelje e Nenit 6.1 dhe Nenit 1 të Protokollit 1). Në këtë vendim Gjykata Evropiane ka dhënë disa nga parimet më të rëndësishme të pranuar lidhur me Nenin 6.1 dhe Nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës. Një ankues mund të pretendojë një shkelje të Nenit 1 Protokollit 1, vetëm për sa kohë që vendimet e kundërshtuara kanë pasur lidhje me “pasuritë” e tij brenda kuptimit të kësaj dispozite. “Pasuritë” mund të jenë “pasuri ekzistuese” ose asete, përfshirë pretendime në lidhje me të cilat ankuesi mund të argumentojë se ai ose ajo ka të paktën një “pritshmëri të ligjshme” për të fituar gëzim efektiv të një të drejte për pronën. Gjykata rikujton se mungesa e fondeve nuk mund të justifikojë një neglizhencë nga ana e shtetit për të ekzekutuar një vendim detyrues të formës së prerë për shlyerje borxhi. Gjykata Evropiane kur vlerëson shpërblimin për dëmin, merr parasysh dëmin pasuror, pra humbjen e shkaktuar si rezultat i drejtpërdrejtë i shkeljes së pretenduar si dhe dëmin jopasuror, pra shpërblimin për ankthin, vështirësitë dhe pasigurinë e shkaktuar nga shkelja e vërejtur dhe dëme të tjera jopasurore.

Në çështjen Beshiri etj. kundër Shqipërisë,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i katërt), me dhomë gjykyesetë përbërë prej:

sir. NICOLAS BRATZA *Kryetar*
z. J. CASADEVALL
z. G. BONELLO
z. K. TRAJA
z. S. PAVLOVSKI
z. L. GARLICKI
znj. L. MIJOVIC, gjykatës

dhe z. T.L. EARLY, regjistruar i seksionit,
pas shqyrtimit me detyrë të mbyllura në datën 11 korrik 2006, merr në këtë datë vendimin e mëposhtëm:

PROCEDURA

1. Çështja ka filluar në bazë të ankimit (Nr. 7352/03) kundër Republikës së Shqipërisë drejtuar në Gjykatë, sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (“Konventa”) nga katër vëllezër e motra, të gjithë shtetas shqiptarë, z. Njazi Beshiri, znj. Liri Kaba, znj. Xhilda Koka dhe z. Sair Preza (“ankuesit”) më 16 shkurt 2003.

2. Ankuesit u përfaqësuan nga z. A. Tartari, avokat që e ushtron aktivitetin e tij në Tiranë. Pala shqiptare u përfaqësua nga agjenti i saj, z. S. Puto, nga Ministria e Punëve të Jashtme.

3. Më 3 maj 2005, Gjykata vendosi t’ia komunikonte ankimin palës shqiptare. Sipas dispozitave të nenit 29 § 3 të Konventës, ajo vendosi të shqyrtonte meritat (themelin) e ankimit, si dhe njëkohësisht pranueshmërinë e tij.

FAKTET

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

4. Ankuesit kanë lindur përkatësisht në vitin 1931, 1948, 1954 dhe 1944 dhe jetojnë në Tiranë (Shqipëri) dhe Varese (Itali).

5. I ati i ankuesve ka qenë pronar i një vile me një sipërfaqe prej 42.70 metra katrorë dhe dy parcelash toke afër saj, të matura përkatësisht me afro 46.70 metra katrorë dhe 48.55 metra katrorë. Nga viti 1946 deri në 1978, i ati i ankuesve ia dha me qira vilën të atit të B.N.-së.

6. Në një datë të paspecifikuar, pasi vila ishte e pabanueshme, shteti i dha të atit të kërkuesve një hua të detyrueshme prej 16,204 lekë (Total) për ristrukturimin e vilës.

7. Në vitin 1976, B.N. ndërtoi dy ndërtesa shtesë në parcelën e tokës me matje prej 48.55 metra katrorë. Me anë të një vendimi të datës 23 shkurt 1976, Gjykata e Rrethit, Tiranë, ia alokoi ndërtesat shtesë B.N.-së.

8. Si rezultat i pamundësisë së të atit të ankuesve për të shlyer borxhin, vila u shtetëzua në bazë të vendimit nr.133 të datës 14 korrik 1978. Nga viti 1978 e në vazhdim, familja e B.N.-së vazhdoi të jetonte në vilë si banues në një pronë shtetërore.

A. Procedurat në lidhje me kthimin e pronës

9. Në vitin 1996, sipas ligjit të kthimit dhe kompensimit të pronave ("Ligji i Pronësisë"), ankuesit paraqitën një ankesë pranë Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

10. Më 22 maj 1996, Komisioni i Tiranës duke argumentuar se shtetëzimi i vilës së të atit të ankuesve ishte i paligjshëm, u ktheu atyre vilën (një zonë me sipërfaqe prej 42.70 metra katrorë) dhe parcelën e tokës të matur prej 46.70 metra katrorë, subjekt i shlyerjes së totalit prej 1,204 (që përfaqëson sasinë e papaguar të borxhit të të atit të tyre ndaj shtetit, gjë që kishte çuar në shtetëzimin e pronave). Për sa i përket parcelës së tokës prej 48.55 metra katrorë, në lidhje me investimin e B.N.-së në ndërtesën shtesë, Komisioni mbështeti të drejtën e refuzimit të parë mbi blerjen e tokës.

B. Procedimet gjyqësore

11. Në një datë të paspecifikuar në vitin 1997, B.N., banori i vilës që u ishte alokuar ankuesve, ngriti një padi civile në Gjykatën e Tiranës, duke pretenduar të drejta pronësie mbi vilën dhe parcelën e tokës afër saj. Për më tepër ai pretendoi, se vendimi i Komisionit i datës 22 maj 1996 duhet të deklarohet i pavlefshëm, për sa kohë që ka qenë në shkelje të nenit 13 të Ligjit të Pronësisë.

12. Më 15 korrik 1997, Gjykata e Tiranës e deklaroi vendimin e Komisionit të datës 22 maj 1996 të pavlefshëm. Ajo konkludoi se, sipas raportit të ekspertit, shpenzimet nga shteti dhe i ati i B.N.-së mbi ndryshimet strukturore dhe shtojcat e ndërtesës fillestare arrinin më tepër, sesa 85 % të vlerës fillestare të pronës. Kështu, vendimi i Komisionit ishte në shkelje të nenit 13 të Ligjit të Pronësisë.

13. Më 7 nëntor 1997, Gjykata e Apelit e Tiranës, pasi shqyrtoi apelin e ankuesve, të cilët pretendonin shkelje të së drejtës së pronës, mbështeti vendimin e Gjykatës së Rrethit dhe rrëzoi apelin.

14. Ankuesit u ankuan në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë, i cili më 6 maj 1998 anuloi vendimet e gjykatave të sipërcituara. Kolegji gjykoi se vendimet ishin bazuar mbi raportin e ekspertëve, që nuk ishte logjik dhe përmbante llogaritje të pasakta dhe kështu, e ktheu çështjen për rigjykim.

15. Më 11 prill 2001, Gjykata e Apelit e Tiranës, pasi rigjykoi çështjen, deklaroi vendimin e Komisionit të pavlefshëm. Duke u mbështetur në një raport të ri ekspertësh, ajo konkludoi se shtetëzimi i vilës së të atit të kërkuesve kishte qenë në përputhje me kërkesat e ligjit material në kohën fizike dhe për pasojë, ankuesit nuk mund të përfitonin nga procesi i kthimit të pronave. Për më tepër, gjykata mbështeti të drejtat e pronësisë së ankuesve mbi dy parcelat e tokës afër saj dhe sipas nenit 16 të Ligjit të Pronësisë, vendosi mbi të drejtën e tyre për të marrë kompensim në një prej formave të parashikuara me ligj.

16. Më 15 shkurt 2002, vendimi civil i Gjykatës së Lartë rrëzoi apelin nga ankuesit, si të pabazuar.

C. Procedimet në Gjykatën Kushtetuese

17. Ankuesit paraqitën rekurs pranë Gjykatës Kushtetuese në bazë të nenit 131(f) të Kushtetutës. Ata pretenduan se vendimi i Gjykatës së Lartë dhe vendimi i Gjykatës së Apelit ishin jokushtetues.

18. Më 24 shtator 2002, Gjykata Kushtetuese, në përputhje me nenin 31 të Ligjit të Organizimit dhe Funksionimit të Gjykatës Kushtetuese (Ligji nr. 8577 i datës 10 shkurt 2000), vendosi të deklarojë *de plano* të papranueshëm rekursin, pasi ishte “jashtë juridiksionit”.

D. Kompensimi

19. Nëpërmjet një letre të datës 22 mars 2004, ankuesit informuan Zyrën e Regjistrimit se autoritetet nuk pajtoheshin me vendimin e formës së prerë të datës 11 prill 2001 në lidhje me çështjen e kompensimit.

LEGJISLACIONI DHE PRAKTIKA E BRENDSHME PËRKATËSE

A. Kushtetuta

20. Nga Kushtetuta e Shqipërisë citohet si më poshtë:

Neni 41

“1. E drejta e pronës private është e garantuar.

2. Prona fitohet me dhurim, me trashëgimi, me blerje dhe me çdo mënyrë tjetër klasike të parashikuar në Kodin Civil.

3. Ligji mund të parashikojë shpronësime ose kufizime në ushtrimin e së drejtës së pronës vetëm për interesa publikë.

4. Shpronësimet ose ato kufizime të së drejtës së pronës që barazohen me shpronësimin, lejohen vetëm përkundrejt një shpërblimi të drejtë.

5. Për mosmarrëveshjet lidhur me masën e shpërblimit mund të bëhet ankim në gjykatë”.

Neni 42§2

“ Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.”

Neni 142 § 3

“Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore”.

Neni 131

“Gjykata Kushtetuese vendos për:...

f) gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave”.

Neni 181

“1. Kuvendi, brenda dy deri tre vjetëve nga hyrja në fuqi e kësaj Kushtetute, nxjerr ligje për rregullimin e drejtë të çështjeve të ndryshme që lidhen me shpronësimit dhe konfiskimet e kryera para miratimit të kësaj Kushtetute, duke u udhëhequr nga kriteret e nenit 41.

2. Ligjet dhe aktet e tjera normative të miratuara para datës së hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute dhe që kanë të bëjnë me shpronësimit dhe konfiskimet, do të zbatohen kur nuk vijnë në kundërshtim me të.”

B. Ligji për kthimin dhe kompensimin e pronave (Ligji nr.7698 i datës 15 prill 1993, amenduar me ligjin nr.8084 të vitit 1996 dhe shfuqizuar me ligjin nr.9235 të datës 29 korrik 2004)

21. Ligji për kthimin dhe kompensimin e pronës pësoi disa amendime gjatë dhjetë viteve të shkuara.

22. Ligji i Pronësisë i vitit 1993 (Ligji nr. 7698 i datës 15 prill 1993, amenduar nga ligji nr. 8084 i vitit 1996), në fuqi atë kohë, në pjesën e tij përkatëse citon:

Neni 4(1)

"U njihet e drejta e pronësisë dhe u kthehen ose kompensohen në natyrë ish - pronarëve apo trashëgimtarëve të tyre ligjorë, pronat në formën e kullotës, livadhit, tokës pyjore, apo tokës bujqësore dhe jobujqësore të patrajtuar nga ligji nr. 7501, datë 19.7.1991 "Për tokën", që janë në pronësi të shtetit, kur këto prona do të tjetërsohen në truall duke u përfshirë brenda sipërfaqes së vijave të reja kufizuese ndërtimore të qendrave të banuara. Masa e kthimit ose e kompensimit në natyrë bëhet e plotë, por në të gjitha rastet jo më shumë se 10 000 m², sipas përcaktimit të bërë në paragrafin e katërt të nenit 1 të dekretit nr. 1359 të datës 5 shkurt 1996, amenduar me ligjin nr. 8084 të datës 7 mars 1996."

Neni 13

Kur në objektin ish-pronë private janë kryer nga shteti apo pronari shpenzime për ndryshime në strukturë, shtesa anësore apo shtesa kati etj., objekti i kthehet ish-pronarit pa kundërshtpërblim, kur vlefte e shpenzimeve përbën deri 20 për qind të vlerës së objektit.

Kur në objektin ish-pronë private vlefte e shpenzimeve të kryera përbën 20 deri në 50 për qind të vlefës së objektit, ai mund të kalojë në pronësi të ish-pronarit, pasi të jetë shlyer nga ana e tij kundërvlefte e mësipërme, mbi 20 për qind, e llogaritur në bazë të çmimeve të ndërtimit në kohën e rikthimit të pronës. Kur vlera e shpenzimeve të kryera është mbi 50 për qind e vlerës së objektit, objekti mbetet në bashkëpronësi... Mosmarrëveshjet midis palëve zgjidhen në rrugë gjyqësore.

Neni 16

Kur trojet janë zënë me ndërtime të përhershme, pronarët kompensohen me kufijtë e shpronësimit, me mënyrat e mëposhtme:

a) me obligacione shtetërore, që do të përdoren sipas vlerës ekuivalente dhe me përparësi në marrëdhënie me shtetin si në procesin e privatizimit të objekteve shtetërore e në veprimtari të tjera që kryhen me kredi.

b) me sipërfaqe trojesh ekuivalente pranë qendrave të banuara në përputhje me planet rregulluese të përgjithshme, por jo më shumë se 5000 m²;

c) me sipërfaqe ekuivalente në zonat turistike, në përputhje me planet rregulluese të përgjithshme, por jo më shumë se 5000 m².

Pjesa tjetër, për pikat b dhe c do të kompensohet sipas mënyrave të tjera të parashikuara në këtë ligj.

Këshilli i Ministrave përcakton rregulla më të hollësishme për mënyrat dhe afatet e kryerjes së këtyre kompensimeve.

23. Ligji i ri i Pronave, i dekretuar në vitin 2004, parashikon dy forma të kthimit të pronës, më konkretisht, kthimin në natyrë të pronës, nëse plotësohen disa kushte dhe kompensimin, në rast të pamundësisë nga ana e autoriteteve për të kthyer në natyrë pronën. Ligji parashikon pesë forma kompensimi: a) me një pronë të të njëjtit lloj; b) me një pronë të një lloji tjetër; c) me aksione në kompanitë shtetërore; d) me vlerën e një prone shtetërore në proces privatizimi; e) me një shumë parash (neni 11).

24. Ligji krijoi Komitetin Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave, të përbërë prej pesë anëtarësh të zgjedhur nga Parlamenti. Roli i tij është të vendosë mbi ligjshmërinë e vendimeve të komisioneve lokale. Në nivel lokal, vendimet mbi pretendimet e kthimit dhe kompensimit të pronave duhet të merren nga Komisionet Lokale për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave (neni 15).

25. Në pajtim me ligjin, personat e autorizuar për të kërkuar kthim ose kompensim, duhet të bëjnë një kërkesë për këtë qëllim pranë komisioneve lokale deri më 31 dhjetor 2007 (neni 19). Ligji i jep komitetit diskrecionin për të vendosur se cila prej formave të kompensimit duhet të jepet. Personat e autorizuar duhet të shprehin preferencat e tyre me shkrim në lidhje me formën e kompensimit që duhet të jepet. Vendimi i komisioneve lokale mund të apelohej në Komitetin Shtetëror (neni 11).

26. Me qëllim pajtueshmërinë me vendimet e komisioneve që japin pagesë për kompensim financiar, neni 23 i ligjit të sipërpërmendur, parashikon krijimin e një fondi kompensimi dhjetëvjeçar të pronës, qëllimi i të cilit është sigurimi i ndihmës financiare për këto vendime.

27. Ligji i sipërpërmendur u shqyrtua nga Gjykata Kushtetuese dhe Gjykata e Lartë.

28. Më 24 mars 2005, Gjykata e Lartë, Kolegjet e Bashkuara, konstatoi se Ligji i Pronësisë i vitit 2004 nuk kishte efekt prapaveprues dhe se në këtë mënyrë dispozitat e tij nuk mund të kishin ndikim mbi të drejtat e pronësisë, të njohura nga vendimet administrative ose të gjykatës, të dhëna para hyrjes së tij në fuqi.

29. Në nëntor 2005, Qeveria (e zgjedhur kohët e fundit më 3 korrik 2005) paraqiti në Parlament një projektligj të ri mbi ligjin e kthimit dhe kompensimit të pronave, i cili propozon disa amendime të Ligjit të Pronësisë të vitit 2004. Projektligji, i cili aktualisht është pezulluar pranë Parlamentit, do të diskutohet në muajt e ardhshëm.

I. KUNDËRSHTIMI PARAPRAK I PALËS SHQIPTARE

30. Pala shqiptare arsyetoi se ankimi ishte i papranueshëm, pasi ishte bërë jashtë afatit gjashtëmujor të parashikuar në nenin 35§1 të Konventës. Kështu, për shkak të karakterit diskrecionar të procedimeve në Gjykatën Kushtetuese dhe vendimit të papranueshmërisë *de plano* të kësaj të fundit në çështjen aktuale, rregullimi përfundimtar efektiv brenda kuptimit të kësaj dispozite ishte në fakt vendimi i Gjykatës së Lartë i datës 15 shkurt 2002, ndërsa ankuesit kishin bërë një kërkesë më 16 shkurt 2003.

31. Si përgjigje, duke iu referuar nenit 131 (f) të Kushtetutës dhe praktikës së Gjykatës Kushtetuese, ankuesit u shprehën se me qëllim shterimin e të gjitha mjeteve juridike të brendshme, individët duhet të paraqisnin një ankesë pranë Gjykatës Kushtetuese, nëse pretendonin një shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë. Për më tepër, ankesa në lidhje me moslegjitimitimin e pretenduesit në procedimin përkatës lidhej me konceptin e një seance të ndershme, përcaktuar në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese. Kjo e fundit kishte juridiksionin dhe detyrimin për të shqyrtuar çështjen dhe për të vendosur mbi të, nëse mund të ishte e nevojshme me anë të një vendimi. Kështu, ankuesit pretenduan se ata kishin paraqitur kërkesën pranë Gjykatës në kohë (vendimi i Gjykatës Kushtetuese ishte i datës 24 shtator 2002, edhe pse ishte një vendim papranueshmërie *de plano*).

32. Gjykata nënvizoi përfundimet e saj në vendimin Balliu v Albania (Nr. 74727/01 të datës 30 shtator 2004), ku kishte konkluduar se një ankesë pranë Gjykatës Kushtetuese Shqiptare mund të konsiderohej një mjet juridik efektiv që duhet të përdorej për qëllime të nenit 35 të Konventës, sa herë ngriheshin çështje të procesit të rregullt. Ajo çmoi se nuk ka arsye për të devijuar nga ky konkluzion në rrethanat e kësaj çështjeje.

33. Ankuesit në fakt përdorën këtë mjet juridik. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese është i datës 24 shtator 2002 dhe kërkesit paraqitën kërkesën e tyre më 15 shkurt 2002. Në këtë mënyrë, ata ishin në pajtim me afatin gjashtëmujor, të parashikuar në nenin 35.

34. Për këto arsye, Gjykata hedh poshtë kundërshtimin e palës shqiptare.

II. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 6 § 1 DHE NENIT 13 TË KONVENTËS

35. Ankuesit u ankuan për shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës në disa aspekte. Gjithashtu, ata argumentuan se nuk kishin asnjë mjet juridik të brendshëm në lidhje me shkeljet e pretenduara (neni 13 i Konventës).

Neni 6 § 1, për sa kohë që është i zbatueshëm, vijon si më poshtë:

“Në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile..., çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë”.

Neni 13 parashikon:

“Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e njohura në këtë Konventë, ka të drejtë të bëjë ankim efektiv tek një organ i vendit të tij, edhe kur shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare”.

A. Pranueshmëria

1. Lidhur me rregullsinë e procedimeve

36. Ankuesit u ankuan sipas nenit 6§1 të Konventës për proces të parregullt, duke arsyetuar se B.N. nuk duhej legjitimuar në procedimet e brendshme për të kundërshtuar të drejtat e tyre të pronësisë.

37. Gjykata thekson se nuk është detyra e saj për të zënë vendin e gjykatave kombëtare. Është kryesisht detyra e autoriteteve kombëtare, veçanërisht gjykatave, të zgjidhin problemet e interpretimit të legjislacionit të brendshëm (shih *Edificaciones March Gallego S.A. v Spain*, vendimi i datës 19 shkurt 1998, *Reports of Judgments and Decisions 1998-I*, fq 290, § 33). Roli i Gjykatës kufizohet në vërtetimin nëse procesi i gjykimit në tërësi ishte i rregullt (shih, *mutadis mutandis*, *Edwards v the United Kingdom*, vendimi i datës 16 dhjetor 1992, *Seria A nr. 247-B*, fq 34-35, § 34 dhe *Garcia Ruiz v Spain [GC]*, No 30544/96, § 28, *ECHR 1999-I*).

38. Duke u kthyer te çështja në fjalë, Gjykata çmon se procedimet para gjykatave vendase ishin tërësisht në pajtim me kërkesat e nenit 6§1 të Konventës, pasi lejuan ankuesit të përdornin efektivisht të gjitha të drejtat e tyre procedurale. Gjykatat kombëtare shqyrtuan me kujdes pretendimet e kthimit dhe dhanë vendime të arsyetuara, duke adresuar argumentet e paraqitura nga ankuesit. Gjykata nuk konstaton shenja të ndonjë shkeljeje të nenit 6§1 të Konventës, sipas këtij kreu.

39. Për rrjedhojë, ky ankim është haptazi i pabazuar dhe duhet hedhur poshtë në përputhje me nenin 35 § 3 dhe 4 të Konventës.

40. Për sa i përket parashtrimin të ankuesve, që ata nuk kishin mjete ligjore efektive në dispozicion në lidhje me ankimin e mësipërm, Gjykata thekson se neni 13 zbatohet vetëm kur një individ ka një “pretendim të pranueshëm” se ka qenë viktimë e cenimit të një të drejte, sipas Konventës (shih *Boyle and Rice v. the United Kingdom*, vendimi i datës 27 prill 1988, *Seria A nr. 131*, fq 23§ 52). Gjykata konkludoi më sipër, se ankimi sipas nenit 6§1 është haptazi i pabazuar. Ankuesit nuk kanë një pretendim të pranueshëm, ndaj për këtë arsye neni 13 nuk është i zbatueshëm për çështjen.

41. Për rrjedhojë, kjo pjesë e ankimit është haptazi e pabazuar dhe duhet rrëzuar në përputhje me nenin 35 § 3 dhe 4 të Konventës.

2. Për sa i përket kohëzgjatjes së procedimeve

42. Gjithashtu ankuesit pretenduan për shkelje të nenit 6 § 1, duke pohuar, se pesë vjet për të vendosur në lidhje me pretendimet e pronësisë së tyre nuk mund të konsideroheshin periudhë e arsyeshme e kohëzgjatjes së procedimeve.

43. Gjykata pohon se kohëzgjatja e arsyeshme e procedimeve duhet të vlerësohet në bazë të disa rrethanave specifike të çështjes, si dhe duke pasur parasysh kriteret e përcaktuara në jurisprudencën e Gjykatës, veçanërisht kompleksitetin e çështjes dhe sjelljen e ankuesve dhe autoriteteve përkatëse (shih, midis shumë autoritetesh të tjera, *Frydlander v. France [GC]*, nr. 30979/96, § 43, *ECHR 2000-VII*).

44. Gjykata përsëriti se periudha që duhet marrë në konsideratë ka filluar në një datë të papërcaktuar në vitin 1997, kur B.N. filloi procedime në Gjykatën e Rrethit Tiranë dhe përfunduan më 24 shtator 2002, kur vendimi i Gjykatës Kushtetuese u depozitua në regjistrin e Gjykatës Europiane. Kështu, procesi zgjati rreth pesë vjet dhe tetë muaj në total për gjashtë nivele juridiksioni. Ajo çmoi se çështja në fjalë kishte të bënte me një situatë faktike mjaft komplekse, ku gjykatat duhej të përcaktonin të drejtat e pronësisë së kërkuar, mbi bazën e raporteve komplekse të ekspertëve.

45. Në disa rrethana, periudha totale në çdo nivel juridiksioni nuk mund të konsiderohej e tejzgjatur në mënyrë të pajustificuar. Për më tepër, ankuesit nuk arritën të demonstrojnë se kishte pasur ndonjë periudhë pasiviteti të konsiderueshëm për faj të autoriteteve gjyqësore gjatë zhvillimit të procesit.

46. Për rrjedhojë, kjo pjesë e kërkesës është haptazi e pabazuar dhe duhet rrëzuar në përputhje me nenin 35 § 3 dhe 4 të Konventës.

47. Përsa pretendimet e ankuesve, sipas nenit 13 mund të kuptohen si ankim për mungesë të mjeteve efektive juridike në lidhje me kohëzgjatjen e procesit civil, ku ata janë palë; për të njëjtat arsye të dhëna në paragrafin 40 më sipër, Gjykata konstaton se neni 13 nuk është i zbatueshëm.

48. Për rrjedhojë, kjo ankesë është haptazi e pabazuar dhe duhet rrëzuar në përputhje me nenin 35 § 3 dhe 4 të Konventës.

3. Në lidhje me neglizhencën e pretenduar për ekzekutimin e vendimit gjyqësor

49. Sipas nenit 6 § 1 dhe 13 të Konventës, ankuesit u ankuan rreth neglizhencës së autoriteteve për të përmbushur detyrimet e përcaktuara në vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë të datës 11 prill 2001, në lidhje me çështjen e kompensimit.

50. Pala shqiptare e kundërshtoi këtë argument. Ajo i qëndroi mendimit se kërkesit nuk e pranonin rezultatin e procedimeve që çuan në vendimin e datës 11 prill 2001. Në këto kushte, ata neglizhuan të kërkonin fillimin e procesit të ekzekutimit në Gjykatën e Rrethit, Tiranë, ku do të siguronin daljen e urdhrin me shkrim për zbatimin e vendimit në fjalë. Për më tepër, referuar vëzhgimeve të palës shqiptare, ankuesit gjithashtu nuk kishin përdorur mjetet juridike të parashikuara në Ligjin e ri të Pronësisë (Ligji nr. 9235 i datës 29 korrik 2004) sa i takon kompensimit. Kështu, pretendimi i ankuesve sipas këtij kreu duhej të deklarohet i papranueshëm për neglizhencë të përdorimit të mjeteve juridike të brendshme.

51. Ankuesit kundërshtuan efektivitetin e mjeteve juridike të referuara nga pala shqiptare. Ata argumentuan se Ligji i ri i Pronësisë nuk siguronte mjete juridike në kuptimin e Konventës. Ata vërejtën më tej se të drejtat e tyre të pronësisë ishin përcaktuar në një vendim gjyqësor të formës së prerë dhe se një organ administrativ nuk mund të rishqyrtonte të njëjtën çështje. Së fundi, ata pohuan se nëse gjykatat vendase do të kishin urdhëruar kompensim në një nga format e parashikuara nga ligji, përmbaruesit nuk do të kishin qenë në gjendje ta ekzekutonin atë vendim. Varet nga autoritetet shtetërore implementimi i masave efektive, qoftë nëpërmjet klasifikimit të pronave shtetërore që do të përdoren për kompensim në natyrë, qoftë duke siguruar fonde të mjaftueshme buxhetore për kompensim financiar, me qëllim që kjo mënyrë ndreqjeje të realizohet. Në përfundim, ankuesit i qëndruan mendimit se pala shtetërore deri tani kishte neglizhuar marrjen e hapave efektive për të gjetur zgjidhje në lidhje me çështjen e kompensimit.

52. Gjykata theksoi se rregulli i shterimit të mjeteve juridike të brendshme, referuar nenit 35 § 1 të Konventës, detyron ankuesit të shterojnë mjetet juridike që në sistemin ligjor vendas janë normalisht në dispozicion dhe të mjaftueshme për t'i mundësuar ata të sigurojnë rivendosjen e së drejtës që pretendohet se është shkelur. Mjetet juridike duhet të jenë mjaftueshmërisht të besueshme, si në praktikë dhe në teori. Pa këtë garanci, të cilën është përgjegjësi e shtetit ta sigurojë, këto mjete nuk do të mund të shterohen sipas nevojave dhe do të mbeten jo efektive (shih Vernillo v. France, vendim i datës 20 shkurt 1991, Seria A, nr. 198, fq 11-12, § 27; Aksoy v. Turkey, nr. 21987/93, §§ 51-52, Reports 1996-VI; dhe Akdivar and Others v. Turkey, No 21893/93, §§ 65-67, Reports 1996-IV).

53. Gjykata vlerëson se mjetet juridike të referuara nga pala shqiptare, ishin të pamjaftueshme për vënien në vend të shkeljes së pretenduar.

54. Në veçanti, për sa i përket argumentit të autoriteteve shtetërore në lidhje me neglizhencën e ankuesve për të filluar procedimet e ekzekutimit, Gjykata rithekson se një personi, i cili pajiset me një vendim të ekzekutueshëm kundër shtetit në favorin e tij, nuk mund t'i kërkojë t'u drejtohet organeve përmbarimore për të ekzekutuar vendimin (shih Cocchiarella v. Italy {GC}, nr. 64886/01, § 89, ECHR 2006; Metaxas v. Greece, nr. 8415/02, § 19, 27 maj 2004; Koltsov v. Russia, No 41304/02, § 16, 24 shkurt 2005; dhe Petrushko v. Russia, No 36494/02, § 18, 24 shkurt 2005).

55. Për më tej, për sa i përket kundërshtimit në lidhje me neglizhencën e ankuesve për të përdorur mjetet juridike të parashikuara në Ligjin e ri të Pronësisë, Gjykata vëren se pala shqiptare nuk kishte paraqitur ndonjë fakt për të provuar efektivitetin e këtyre mjeteve. Autoritetet shqiptare nuk provuan se ligji i ri mund të kishte ofruar në të vërtetë ndreqje për ankuesit dhe se shteti mund

të kishte plotësuar efektivisht detyrimin e tij për të paguar kompensim për pronën fillestare, konform vendimit të formës së prerë në favor të ankuesve.

56. Në këtë mënyrë, Gjykata hedh poshtë kundërshtimet e palës shqiptare në lidhje me neglizhencën e ankuesve për të përdorur mjetet e brendshme juridike.

57. Gjykata çmon se kjo pjesë e ankimit nuk është haptazi e pabazuar brenda kuptimit të nenit 35§ 3 të Konventës. Më tej vëren se kjo pjesë nuk është e papranueshme për ndonjë arsye tjetër. Kështu, ajo duhet të deklarohet e pranueshme.

B. Meritat (themeli)

58. Pala shqiptare përsëriti se autoritetet nuk mund të deklaroheshin përgjegjëse për mosekzekutimin e vendimit të dhënë në favor të ankuesve, pasi ekzekutimi i tij varej nga marrja e hapave të nevojshme prej ankuesve, konkretisht duke ngritur një padi që kërkonte ekzekutimin e vendimit. Pala shqiptare iu referua argumenteve të veta të mëparshme mbi përdorimin e mjeteve të brendshme juridike.

59. Ankuesit e kundërshtuan këtë argument.

60. Gjykata përsëriti jurisprudencën e saj në kuptimin që e drejta e aksesit në gjykatë, e garantuar nga neni 6 § 1 i Konventës, do të ishte joreale, nëse sistemi i brendshëm ligjor i një Shteti Palë do të lejonte që një vendim gjyqësor i formës së prerë të mbetej jooperativ, në dëm të njëres palë. Ekzekutimi i një vendimi të dhënë nga një gjykatë duhet të konsiderohet pjesë përbërëse e “procesit të rregullt” për qëllime të nenit 6 (shih, midis të tjerash, *Hornsby v. Greece*, vendimi i datës 19 mars 1997, Reports 1997-II, fq 510-11, §§40 et seq dhe *Metaxas*, cituar më sipër, §25).

61. Gjykata çmon se problemet e përfshira në çështjen e ankuesve janë pjesë e procesit të kalimit nga sistemi i shkuar ligjor komunist dhe regjimi i tij i pronësisë në një rend të pajtueshëm me shtetin ligjor dhe ekonominë e tregut. Ky proces, në vetë natyrën e gjërave, është shoqëruar me vështirësi. Gjykata ka parashtruar në këtë aspekt se Konventa nuk mund të interpretohet si vendosje e detyrimit të përgjithshëm mbi Shtetet Kontraktuese për të kthyer pronën e transferuar në favorin e tyre, para ratifikimit të Konventës (shih *Kopecky v. Slovakia* [GC], No 44912/98, § 35 dhe *von Maltzan and Others v. Germany* (dec.) [GC], No 71916/01, 71917/01 dhe 10260/02, § 74, ECHR 2005-V). Nuk ekziston ndonjë detyrim i përgjithshëm, sipas Konventës për krijimin e procedurave nëpërmjet të cilave mund të kërkohej kthimi i pronave. Megjithatë, kur një Shtet Kontraktues vendos të krijojë procedura ligjore të këtij lloji, ai nuk mund të përjashtohet nga detyrimi për të respektuar të gjitha garancitë përkatëse të parashikuara nga Konventa, veçanërisht në nenin 6 § 1.

62. Gjykata vëren se legjislacioni shqiptar i kohës në fjalë la në diskrecionin e autoriteteve administrative përcaktimin e formës së përshtatshme të kompensimit, për ato raste kur kthimi në natyrë i pronës ishte i pamundur. Kështu, vendimi i Gjykatës së Apelit në rastin konkret, mund të interpretohet si urdhërim i autoriteteve për t’u ofruar ankuesve një formë kompensimi që do t’i zhdëmtonte ata në vend të kthimit të të drejtave të tyre të pronësisë.

63. Gjykata nuk e pranon pikëpamjen e palës shqiptare sa i takon mungesës së interesit nga ana e ankuesve për ekzekutimin e vendimit. Në fakt, ankuesit nuk e pranuan rezultatin e procedimeve, që shpunë në vendimin e datës 11 prill 2001 dhe kërkuan kthimin në natyrë të pronës në vend të kompensimit.

64. Referuar fakteve të çështjes, Gjykata vëren se pas shpalljes së vendimit në vitin 2001, autoritetet neglizhuan t’u ofronin ankuesve ndonjë opsion të përshtatshëm për kompensim, në pajtim me vendimin e formës së prerë të gjykatës (shih, duke bërë krahasimin, *Uzkureliene and Others v. Lithuania*, nr. 62988/00, § 36, të datës 7 prill 2005). Kështu, ankuesit nuk patën asnjë mundësi të shqyrtonin një ofertë kompensimi, në proporcion me kthimin në natyrë të pronës.

65. Për më tepër, Gjykata çmon se pala shqiptare nuk dha ndonjë shpjegim se pse vendimi i datës 11 prill 2001 në favor të ankuesve nuk ishte ekzekutuar për më shumë se pesë vjet pas shpalljes. Nuk ka të dhëna se përmbauesit ose autoritetet administrative të kenë marrë ndonjë masë për t’iu bindur vendimit.

66. Konsideratat e mësipërme janë të mjaftueshme për t'i dhënë mundësi Gjykatës të konstatojë, se duke neglizhuar të marrin masat e nevojshme për të ekzekutuar vendimin e datës 11 prill 2001, autoritetet shqiptare i zhveshën dispozitat e nenit 6§1 të Konventës nga të gjitha efektet e dobishme.

67. Pra, ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës.

68. Gjykata analizoi më sipër pretendimin e ankuesve rreth neglizhencës së autoriteteve për të zbatuar vendimin e formës së prerë, që u njohu atyre një formë kompensimi. Ajo vëren se pretendimi i ankuesve sipas nenit 13, është kryesisht i bazuar në të njëjtën mungesë mbrojtjeje procedurale, e cila u çmua se u bë shkak për shkelje të nenit 6 (shih, *mutadis mutandis*, *British-American Tobacco Company Ltd v. the Netherlands*, vendimi i datës 20 nëntor 1995, Seria A, nr. 331, fq 29, § 91). Në këto rrethana, Gjykata çmon se nuk është e nevojshme të shqyrtojë ankesën ndarazi, sipas nenit 13.

III. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 1 E PROTOKOLLIT NR 1, E MARRË INDIVIDUALISHT DHE NË LIDHJE ME NENIN 14 TË KONVENTËS

69. Ankuesit pretenduan, se u është cenuar e drejta për të gëzuar pronën e trashëguar nga i ati. Ata u mbështetën në nenin 1 të protokollit nr. 1 të Konventës, i cili parashikon:

“Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën që t'i respektohet pasuria e tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e shteteve për të nxjerrë ligje, që ato i gjykojnë të domosdoshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve të tjera, ose të gjobave”.

70. Duke cituar nenin 14 të Konventës, ankuesit deklaruan se të drejtat e tyre në kuadrin e procesit të kthimit ishin cenuar për shkak të statusit të tyre shoqëror. Neni 14 vijon si më poshtë:

“Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të njohura në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla, si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër.”

A. Pranueshmëria

1. Parashtrimet e palëve

71. Pala shqiptare kundërshtoi pretendimet e ankuesve, sipas këtij kreu. Autoritetet argumentuan se meqë vendimi i Komisionit që u kthente ankuesve pasurinë e të atit të tyre ishte përmbysur nga vendimet e gjykatave, ankuesit nuk mund të pretendonin të drejta pronësie mbi vilën. Në këtë mënyrë, duke marrë parasysh vendimin e gjykatës, që kishte vendosur mbi pretendimet e tyre të pronësisë, ankuesit kishin të drejtë të përfitonin prej garancive të ofruara nga neni 1 i protokollit nr. 1, vetëm në lidhje me parcelat e tokës me sipërfaqe përkatësisht 48.55 metra katrorë dhe 46.70 metra katrorë.

72. Në përputhje me dispozitat e legjislacionit të brendshëm, duke qenë e pamundur që atyre t'u kthehej prona fillestare, gjykata kishte mbështetur të drejtat e paditësve për kompensim në një nga format e parashikuara nga neni 16 i Ligjit të Pronave të vitit 1993.

73. Ata parashtruan që ashtu si shumë ish-pronarë në Shqipëri, të cilët kishin vendime detyruese gjykatë që vendosnin për çështjen e kompensimit, as ankuesit nuk mund të fajësonin shtetin për shkak të pasivitetit që ata vetë kishin dëshmuar për të filluar procedurat e ekzekutimit, qoftë në gjykatat shqiptare, qoftë me anë të mjeteve të reja juridike të parashikuara nga Ligji i Pronave i vitit 2004, me qëllim kthimin e pronave të tyre dhe kërkimin e dëmshpërblimit.

74. Ankuesit kundërshtuan parashtrimet e autoriteteve shtetërore.

2. Vlerësimi i Gjykatës

a) Përmbledhje e parimeve përkatëse

75. Gjykata përsëriti parimet e mëposhtme të përcaktuara në jurisprudencën e saj sa i takon nenit 1 të protokollit nr. 1 (shih *von Maltzan etj.*, cituar më sipër dhe *Kopecky*, cituar më sipër, §35).

76. a) Privimi nga e drejta e pronësisë ose nga një e drejtë tjetër *in rem* është në parim një veprim i përkohshëm dhe nuk krijon një situatë të vazhdueshme të “privimit nga një e drejtë” (shih *Malhous v. the Czech Republic* (dec) [GC], No 33071/96, ECHR 2000-XII, me referenca të mëtejshme).

77. b) Neni 1 i protokollit nr.1 nuk garanton të drejtën për të fituar pasuri (shih *Van der Musselle v. Belgium*, vendimi i datës 23 nëntor 1983, Seria A nr. 70, fq 23, § 48 dhe *Slivenko and Others v. Letonia* (dec) [GC], No 48321/99, §121, ECHR 2002-II).

78. c) Një ankues mund të pretendojë një shkelje të nenit 1 të protokollit nr.1, vetëm për sa kohë që vendimet e kundërshtuara kanë pasur lidhje me “pasuritë” e tij brenda kuptimit të kësaj dispozite. “Pasuritë” mund të jenë “pasuri ekzistuese” ose asete, përfshirë pretendime në lidhje me të cilat ankuesi mund të argumentojë se ai ose ajo ka të paktën një “pritshmëri të ligjshme” për të fituar gëzim efektiv të një të drejte për pronën. Duke bërë krahasime, shpresa për njohjen e një të drejte pronësie, e cila ka qenë e pamundur të ushtrohej efektivisht, nuk mund të konsiderohet si “pasuri” brenda kuptimit të nenit 1 të protokollit nr. 1, madje as një pretendim i kushtëzuar që vjen si rezultat i mosplotësimit të kushtit (shih *Prince Hans-Adam II of Liechtenstein v. Germany* [GC], nr. 42527/98, § § 82 dhe 83, ECHR 2001-VIII dhe *Gratzinger and Gratzingerova v. the Czech Republic* (dec) [GC], nr. 39794/98, § 69, ECHR 2002-VII).

79. d) Kur interesi i pronarit ka natyrën e një ankimi, ai mund të konsiderohet si “aset”, vetëm nëse referuar legjislacionit vendas, ky ankim është mjaftueshmërisht i bazuar, p.sh., kur ekziston një praktikë e konsoliduar e gjykatave vendase në mbështetje të tij, ose kur ai (ankimi) mer formën e një vendimi përfundimtar, të ekzekutueshëm në favorin e ankuesit [shih *Draon v. France* [GC], No 1513/03, § 68, i datës 6 tetor 2005 dhe *Burdov v. Russia*, No 59498/00, § 40, ECHR 2002-III).

80. e) Neni 1 i protokollit nr. 1 nuk mund të interpretohet sikur vendos ndonjë detyrim të përgjithshëm mbi Shtetet Kontraktuese për të kthyer pasuritë e transferuara në favor të tyre, para se të ratifikonin Konventën. Neni 1 i protokollit nr. 1 nuk vendos kufizime as mbi lirinë e Shteteve Kontraktuese për të përcaktuar objektin e kthimit të pronës dhe për të përzgjedhur se në çfarë kushtesh bien dakord t’u kthejnë të drejtat e pronës ish-pronarëve (shih *Jantner v. Slovakia*, No 39050/97, § 34, 4 mars 2003).

81. Në veçanti, Shtetet Kontraktuese gëzojnë një shkallë të gjerë vlerësimi sa i takon përjashtimit të kategorive të caktuara të ish-pronarëve nga kjo e drejtë. Kur kategoritë e pronarëve përjashtohen në këtë mënyrë, pretendimet e tyre për kthim nuk mund të shërbejnë si bazë për “pritshmëri të ligjshme”, që kërkon mbrojtjen e nenit 1 të protokollit nr. 1 (shih, midis autoriteteve të tjera, *Gratzinger and Gratzingerova*, cituar më sipër, § § 70-74).

82. Nga ana tjetër, kur një Shtet Kontraktues që ka ratifikuar Konventën, përfshirë Protokollin e Parë Shtesë, dekreton legjislacionin që rregullon kthimin e plotë ose të pjesshëm të pronës së konfiskuar në regjimin e mëparshëm, ky legjislacion mund të konsiderohet si gjenerues i një të drejte të re pronësie, të mbrojtur nga neni 1 i protokollit nr. 1 për personat që i plotësojnë kushtet për të fituar një të drejtë të tillë. E njëjta gjë mund të aplikohet në lidhje me rregullimet ligjore për kthimin ose kompensimin të parashikuara para ratifikimit, nëse ky legjislacion mbetet në fuqi, pas ratifikimit nga Shteti Kontraktues i Protokollit të Parë Shtesë (shih *Broniowski v. Poland* [GC], 31443/96, §125, ECHR 2004-V).

b) Zbatimi i parimeve përkatëse

83. Gjykata vëren se sipas këtij kreu, ankuesit shfaqën pakënaqësi për dy çështje të ndryshme. Së pari, ata u ankuan për një shkelje të të drejtave të tyre të pronësisë mbi vilën. Së dyti, ata u ankuan për një shkelje të të drejtave të tyre të pronësisë, për sa kohë që autoritetet nuk kishin arritur të ekzekutonin vendimin e gjykatës të datës 11 prill 2001. Gjykata do të shqyrtojë ndarazi secilën prej këtyre ankesave.

i) Pretendimet e pronësisë mbi vilën

84. Për sa i përket shkeljes së pretenduar të nenit 1 të Protokollit të Parë Shtesë në lidhje me vilën, Gjykata ripohon se e drejta e kthimit nuk garantohet as në Konventë, as në jurisprudencën e saj.

85. Meqë vila në fjalë u shpronësua në vitin 1978, është e qartë se nuk mund të thuhet, që ankuesit kanë “pasuri ekzistuese” brenda kuptimit të nenit 1 të Protokollit të Parë Shtesë.

86. Kështu, mbetet për t’u shqyrtuar nëse ankuesit mund të kenë ndonjë “pritshmëri të ligjshme” për realizimin e pretendimit të tyre, ndaj kthimit, mbi bazën e parashikimeve të Ligjit të Pronave.

87. Gjykata vëren se në procedimet e ankimuara u ngrit problemi nëse detyrimet që rridhnin nga Ligji i Pronës ishin plotësuar apo jo. Autoritetet gjyqësore konstatuan se kjo çështje nuk lidhej me pretendimet e kërkuarve mbi vilën.

88. Pra, pakënaqësia e ankuesve në themel konsiston në kundërshtimin e konkluzioneve të gjykatave vendase dhe në gabimet që pretendohet se këto autoritete kanë bërë në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të legjislacionit vendas.

89. Gjykata vëren në këtë aspekt se fakti që shteti, nëpërmjet sistemit të tij gjyqësor, siguroi një forum për përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të ankuesve, automatikisht nuk e bën atë përgjegjës në kuptimin e nenit 1 të Protokollit të Parë Shtesë. Në rastin konkret, shteti nuk është përgjegjës për humbje të shkaktuara si rezultat i vendimeve të gjykatave, që cenuan në mënyrë arbitrare apo joproporcionale pronën. Duke pasur parasysh konkluzionet e saj të mësipërme, sipas nenit 6 §1 të Konventës (në lidhje me gjykimin e drejtë) se gjykatat kombëtare proceduan në përputhje me legjislacionin e brendshëm, duke shqyrtuar çështjen e ankuesve në detaje dhe duke dhënë arsye të plota për vendimet e tyre, Gjykata konstaton se vlerësimi i kryer nga gjykatat kombëtare nuk mund të konsiderohet haptazi arbitrar ose i paarsyeshëm.

90. Gjykata çmon se në këtë mënyrë ankuesit nuk mund të kishin “pritshmëri të ligjshme”, bazuar qoftë në dispozitat e Ligjit të Pronave apo vendimin e Komisionit të vitit 1996 që njihte të drejtën e tyre ndaj vilës, për të realizuar pretendimin e tyre për kthimin e vilës. Për pasojë, kjo pjesë e ankimit nuk është e pajtueshme *ratione materiae* me dispozitat e Konventës brenda kuptimit të nenit 35 § 3 dhe duhet të rrëzohet në përputhje me nenin 35§4.

91. Duke marrë në konsideratë faktin që neni 14 i Konventës nuk është i pavarur dhe konkluzionin që neni 1 i Protokollit të Parë Shtesë nuk është i zbatueshëm sipas këtij kreu, Gjykata çmon se neni 14 nuk mund të zbatohet në lidhje me këtë ankim (shih mutadis mutandis, Polacek and Polackova v. the Czech Republic (dec) {GC}, No 38645/97, §§61-70, 10 korrik 2002).

92. Për pasojë, ky ankim duhet të rrëzohet në përputhje me nenin 35 § § 3 dhe 4 të Konventës.

ii) Pretendimet e pronësisë mbi parcelat e tokës

93. Gjykata vëren se ankimi sipas këtij kreu nuk është haptazi i pabazuar brenda kuptimit të nenit 35 § 3 të Konventës. Për më tepër, ajo vëren se nuk ka gjetur ndonjë arsye për të deklaruar këtë pjesë të ankimit si të papranueshme dhe kështu e deklaroi atë të pranueshme.

94. Për sa i përket pretendimit të ankuesve që të drejtat e pronësisë së tyre mbi parcelat e tokës janë shkelur për shkak të statusit të tyre shoqëror në kundërshtim me nenin 14, Gjykata nuk konstaton asnjë shenjë se ankuesit kanë qenë të diskriminuar për arsye të specifikuara në nenin 14 të Konventës. Kështu, pretendimi i tyre, sipas nenit 14 të Konventës marrë së bashku me nenin 1 të Protokollit të Parë Shtesë (për sa i përket pretendimeve të tyre mbi parcelat e tokës) është haptazi i pabazuar dhe duhet të rrëzohet në pajtim me nenin 35 § § 3 dhe 4 të Konventës.

B. Meritat (themeli)

95. Pala shqiptare deklaroi se nuk mbante përgjegjësi për faktin që ankuesit nuk ishin të kënaqur me rezultatin e procedimeve gjyqësore sa u takon pretendimeve për pronën e të atit të tyre në përgjithësi dhe pretendimit të tyre për kthimin në natyrë të pronës në veçanti.

96. Pala shqiptare shtoi se pamundësia për të ekzekutuar vendimet e formës së prerë që jepnin kompensim në kuadër të procesit të kthimit dhe kompensimit të pronave ishte për shkak të rrethanave objektive, si mungesa e fondeve dhe ndikimi i tyre mbi interesin e përgjithshëm të komunitetit.

97. Ankuesit pretenduan se deklaratat e palës shqiptare ishin të pabazuara. Ata parashtruan se shteti ishte përgjegjës për borxhet e papaguara ndaj tyre, të tilla si kompensimi dhe se duke mos arritur të paguante ato borxhe për një kohë të gjatë, shteti i kishte privuar ata nga e drejta për të poseduar realisht pronën, në shkelje të nenit 1 të protokollit nr. 1.

98. Gjykata vëren se ky ankim është i lidhur me atë të shqyrtuar sipas nenit 6 § 1, në lidhje me pamundësinë për të ekzekutuar një vendim të formës së prerë.

99. Gjykata pohon se “pasuritë” mund të jenë “pasuri ekzistuese” ose asete, përfshirë për disa raste të përcaktuara qartë edhe pretendimet. Që një pretendim të konsiderohet “aset” brenda qëllimit të nenit 1 të Protokollit të Parë Shtesë, pretenduesi duhet të provojë që në legjislacionin vendas ekziston një bazë e mjaftueshme, p.sh. që ka një praktikë gjyqësore vendase të konsoliduar në mbështetje të pretendimit të tij, ose që ekziston një vendim gjykate i formës së prerë në favor të pretenduesit. Kur kjo arrihet, mund të hyjë në veprim koncepti i “pritshmërisë së ligjshme” (shih Draon, cituar më sipër, § 65 dhe Burdov, cituar më sipër).

100. Në rastin konkret, është konstatuar tashmë se autoritetet kishin një detyrim sipas vendimit të datës 11 prill 2001 për t’u ofruar ankuesve një formë kompensimi në vend të kthimit në natyrë të dy parcelave të tokës. Për pasojë, ankuesit kishin pretendime të zbatueshme që buronin nga vendimi në fjalë.

101. Gjykata çmon se neglizhenca e autoriteteve për të ekzekutuar vendimin në favor të ankuesve konsiderohet cenim i të drejtës së tyre për gëzimin paqësor të pasurive të tyre në kuptimin e nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës.

102. Duke mos iu bindur vendimit të Gjykatës së Apelit të Tiranës, autoritetet vendase i lanë ankuesit në një gjendje pasigurie për sa u përket shanseve për të rifituar të drejtat e tyre të pronësisë. Për më tepër, për një periudhë të konsiderueshme kohore, autoritetet i privuan ankuesit nga e drejta për t’iu paguar vlera e kompensimit dhe nga gëzimi i zotërimit të parave të tyre. Për sa i përket justifikimit të parashtruar nga pala shqiptare për këtë ndërhyrje, Gjykata rikujton se mungesa e fondeve nuk mund të justifikojë një neglizhencë nga ana e shtetit për të ekzekutuar një vendim detyrues të formës së prerë për shlyerje borxhi (shih Pasteli and Others v. Moldova, nr. 9898/02, 6255/02 dhe 10425/02, § 30, 15 qershor 2004, Voytenko v. Ukraine, No 18966/02, § 55, 29 qershor 2004; Shmalko v. Ukrainë, nr. 60750/00, § 57, 20 korrik 2004).

103. Për pasojë, ka pasur një shkelje të nenit 1 të Protokollit të Parë Shtesë të Konventës lidhur me çështjen e kompensimit.

ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

104. Neni 41 i Konventës parashikon:

Kur Gjykata konstaton shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj, dhe e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese mundëson vetëm ndreqjen e pjesshme të pasojave të shkaktuara nga shkelja, Gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar.

A. Dëmi

105. Ankuesit pretenduan 564 000 euro në lidhje me dëmin pasuror dhe jopasuror. Ata u mbështetën në një raport vlerësimi ekspertësh, për qëllime të përcaktimit të vlerës së përgjithshme të pasurive të atit të tyre dhe humbjen e përfitimeve.

106. Pala shqiptare kundërshtoi pretendimet e ankuesve, meqë në pikëpamjen e saj, kërkesa ishte e papranueshme. Ata nuk paraqitën asnjë argument në lidhje me shumat e pretenduara për dëmin pasuror dhe jopasuror.

107. Gjykata çmon se pretendimi i ankuesve për dëm në lidhje me prona të ndryshme nga ato që u caktohen atyre nga gjykatat lokale, janë *ultra petita* dhe për pasojë, e kundërshton këtë pretendim.

108. Gjykata u referohet konkluzioneve të saj në çështjen *Qufaj k Shqipërisë*, ku parashtrroi se autoritetet shqiptare duhet të merrnin masat e përshtatshme, me qëllim pajtimin me vendimin e formës së prerë dhe të bënin kompensim për ndonjë dëm të shkuar ose të ardhshëm shkaktuar individëve nga neglizhenca. Për më tej, ajo çmoi se në ekzekutim të vendimeve sipas të cilave shteti ishte urdhëruar të kryente një pagesë, një personi i cili disponon një vendim gjyqësor për shlyerje

borxhi nga ana e shtetit në favorin e tij, nuk duhet t'i kërkohej të fillojë procesin e ekzekutimit për të përfituar kompensimin (shih Qufaj Co sh.p.k. v. Albania, nr. 54268/00, § 54-59, 18 nëntor 2004 dhe gjithashtu Metaxas, cituar më sipër, § 49).

109. Gjykata vlerëson se nuk ka arsye për të devijuar nga konkluzioni i saj i mësipërm sa u takon vendimeve përfundimtare, që urdhërojnë kthimin dhe/ose kompensimin e pronave.

110. Gjykata pohon se një vendim nëpërmjet të cilit ajo konkludon se ka pasur shkelje, vendos shtetin e paditur para detyrimit ligjor sipas Konventës për t'i dhënë fund shkeljes dhe për të riparuar pasojat e saj. Nëse legjislacioni i brendshëm mundëson vetëm riparim të pjeshëm të dëmit, neni 41 i Konventës i jep Gjykatës kompetencë për të kompensuar palën e dëmtuar për veprimin apo mosveprimin që çoi, u bë shkak për të konstatuar shkelje. Gjykata gëzon një lloj diskrecioni në ushtrimin e kësaj kompetence, siç provohet edhe nga mbiemri "i drejtë" dhe fraza "nëse është e nevojshme".

111. Midis çështjeve që Gjykata merr parasysh kur vlerësohet kompensimi, janë dëmi pasuror, domethënë, humbja aktualisht e shkaktuar si rezultat i drejtpërdrejtë i shkeljes së pretenduar dhe dëmi jopasuror, domethënë kompensimi për ankthin, vështirësitë dhe pasigurinë e shkaktuar nga shkelja dhe dëme të tjera jopasurore (shih, midis autoriteteve të tjera, Ernestina Zullo v. Italy, nr. 64897/01, § 25, 10 nëntor 2004).

112. Për më tepër, nëse një ose më shumë kategori specifike të dëmit nuk mund të llogariten saktësisht ose nëse dallimi midis dëmit pasuror dhe jopasuror duket i vështirë, Gjykata mund të vendosë të bëjë një vlerësim global (shih Comingersoll v. Portugal [GC], No 35382/97, § 29, ECHR 2000-IV).

113. Në rrethanat e çështjes, gjykata çmon se duke mos pasur mundësi për të marrë masa të përshtatshme për t'u dhënë ankuesve kompensim për pamundësinë për t'u kthyer pronën fillestare në lidhje me dëmin pasuror, shteti duhet t'u paguajë ankuesve një shumë që i korrespondon vlerës aktuale të pronës përkatëse- domethënë, parcelat e tokës që maten përkatësisht me 48.55 metra katrorë dhe 46.70 metra katrorë.

114. Për më tepër, Gjykata çmon se çështjet në fjalë përfshijnë një ndërhyrje serioze në të drejtën e ankuesve për gëzimin paqësor të zotërimeve të tyre, në lidhje me të cilin një shumë parash do të përfaqësonte një kompensim të drejtë për dëmin jopasuror të pësuar.

115. Duke e kryer vlerësimin e saj mbi baza të barabarta, siç kërkohej nga neni 41 i Konventës, Gjykata u jep ankuesve një shumë totale prej 120 000 eurosh në lidhje me dëmin pasuror dhe jopasuror.

Kostot dhe shpenzimet

116. Ankuesit gjithashtu pretenduan 36 000 euro për kostot dhe shpenzimet para gjykatave kombëtare dhe para Gjykatës. Ata nuk dhanë analizë të detajuar për vërtetimin e kostove dhe shpenzimeve të pretendimit të tyre.

117. Pala shqiptare e kundërshtoi pretendimin.

118. Referuar praktikës së Gjykatës, një ankues autorizohet për rimbursimin e kostove dhe shpenzimeve të tij, vetëm për sa kohë që provohet se këto janë shkaktuar në të vërtetë dhe pashmangshmërisht kanë qenë të arsyeshme për sa i përket sasisë.

119. Kostot e pretenduara nuk kanë qenë të bazuara, pasi ankuesit nuk kanë paraqitur detaje në zëra të të gjitha shpenzimeve gjyqësore, postën, telefonatat dhe fotokopjen e dokumenteve.

120. Duke pasur parasysh informacionin që disponon dhe kriteret e përcaktuara më sipër, Gjykata çmon të arsyeshme të japë shumën prej 6000 euro, që mbulon kostot sipas të gjitha kategorive specifike.

Interesi i mospagimit

121. Gjykata çmon të nevojshme që interesi i mospagimit duhet të bazohet në normën marzhinale të huadhënies të Bankës Qendrore Europiane, së cilës duhet t'i shtohen tre pikë për qind.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA NJËZËRI

1. Hedh poshtë kundërshtimet paraprake të palës shqiptare;
 2. I deklaron ankesat në lidhje me nenin 6 § 1 (për sa i përket moszbatimit të një vendimi të formës së prerë), nenin 13 dhe nenin 1 të protokollit nr. 1 të pranueshme dhe pjesën e mbetur të kërkesës, të papranueshme;
 3. Vlerëson se ka pasur një shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës;
 4. Vlerëson se nuk është nevoja të shqyrtohet ankimi sipas nenit 13 të Konventës;
 5. Vlerëson se ka pasur një shkelje të nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës;
 6. Vlerëson se:

Shteti i paditur duhet t’u paguajë ankuesve, brenda tre muajve nga data në të cilën vendimi merr formë të prerë, në pajtim me nenin 44 § 2 të Konventës, sasi të mëposhtme që duhen konvertuar në monedhën vendase të shtetit të paditur, në normën e zbatueshme në datën e shlyerjes, plus ndonjë taksë që mund jetë e tatueshme:

 - 120 000 euro (njëqind e njëzet mijë euro) në lidhje me dëmin pasuror dhe jopasuror;
 - 6000 euro (gjashtë mijë euro) në lidhje me kostot dhe shpenzimet;
 - që nga skadimi i afatit të mësipërm tremujor deri në shlyerje, interesi i thjeshtë do të jetë i pagueshëm mbi shumat e mësipërme në një normë të barabartë me normën marzhinale të huadhënies të Bankës Qendrore Europiane gjatë periudhës së mospagimit, plus tre pikë për qind;
 7. Hedh poshtë pjesën e mbetur të pretendimeve të ankuesve për kompensim të drejtë.
- Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 22 gusht 2006, sipas nenit 77 § § 2 dhe 3 të rregullores së Gjykatës.

T.L. Early
Regjistruer

Nikolas BRATZA
Kryetar

VENDIM
(Ankimi nr. 35853/04)
ÇËSHTJA “BAJRAMI KUNDËR SHQIPËRISË” (THEMELI)

STRASBURG
12 Dhjetor 2006

Ky vendim merr formë të prerë në rrethanat e përcaktuara në nenin 44 § 2 të Konventës. Ai mund t'i nënshtrohet rishikimit redaktues.

Kjo çështje trajton shkeljen e të drejtës së ankuesit për respektimin e jetës familjare si pasojë e dështimit të autoriteteve shqiptare për të marrë masat e nevojshme për të ribashkuar ankuesin me vajzën e tij (shkelje e Nenit 8 të Konventës). Gjykata Evropiane tërheq vëmendjen se detyrimet pozitive që neni 8 i Konventës parashtrohet për sa i përket marrëdhënieve\ ribashkimit të prindit me fëmijën e tij\ saj duhet të interpretohen në lidhje me Konventën e Hagës mbi Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijës e datës 25 tetor 1980.

Në çështjen Bajrami kundër Shqipërisë,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i katërt), me dhomë gjykyesetë përbërë nga:

z. Nicolas BRATZA Kryetar
z. G. BONELLO
z. M. PELLONPAA
z. K. TRAJA
z. L. GARLICKI
z. L. MIJOVIC
z. J. SIKUTA gjykatës
dhe z. T.L. EARLY, regjistruar i seksionit,
pas shqyrtimit me detyrë të mbyllura të çështjes më 10 tetor 2006 dhe më 21 nëntor 2006,
shpall vendimin e mëposhtëm, i cili u mor në datën e fundit të përmendur:

PROCEDURA

1. Çështja e nisur me ankesën (nr. 35853/04) kundër Republikës së Shqipërisë, depozituar në Gjykatë në bazë të nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (“Konventa”) nga një shtetas etnik shqiptar nga Kosova, z. Agim Bajrami (“Ankuesi”), më 27 shtator 2004.

2. Ankuesi u përfaqësua nga znj. E. Murataj, avokate, e cila e ushtronte profesionin në Fier. Pala Shqiptare (“Qeveria”) u përfaqësua nga agjenti i saj, z. S. Puto, nga Ministria Punëve të Jashtme.

3. Më 14 mars 2005 Gjykata vendosi të njoftonte autoritetet shqiptare për ankesën. Sipas dispozitave të nenit 29 § 3 të Konventës, ajo vendosi të shqyrtonte meritat (themelin) e ankimit dhe pranueshmërinë e tij në të njëjtën kohë.

FAKTET

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

4. Ankuesi ka lindur më 1964 dhe jeton në Caralevë, në bashkinë e Shtimës (Kosovë).

5. Më 28 prill 1993 ankuesi u martua me F.M., shtetase shqiptare. Çifti kishte një fëmijë, I.B., i cili kishte lindur më 20 janar 1997. Në vitin 1998 ankuesi dhe F.M. u ndanë.

6. F.M., së bashku me vajzën e saj, u transferuan në shtëpinë e prindërve të saj në Vlorë, Shqipëri.

7. Më 6 maj 1999, bashkëshortja e ankuesit u martua me një person tjetër, duke përdorur dokumente të falsifikuara, pa u divorcuar me ankuesin.

8. Rezulton që më 15 shtator 1999, Gjykata e Rrethit Vlorë anuloi martesën e dytë të F.M.-së. Në një datë të pacaktuar, ajo u martua me H.I., shtetas shqiptar që banonte në Greqi.

9. F.M. udhëtonte shpesh në Greqi, gjatë viteve të martesës së tretë, duke e lënë të bijën për një kohë të gjatë me prindërit e saj në Vlorë, ose duke e marrë në Greqi me vete pa pëlqimin e ankuesit.

10. F.M. dhe prindërit e saj e kishin ndaluar ankuesin të takojë me të bijën. Që pas ndarjes me F.M., ankuesi është lejuar të takohet me të bijën vetëm dy herë, në shtator 2000 dhe maj 2003.

1. Procedurat e divorcit dhe kujdestarisë

11. Më 24 qershor 2003 ankuesi filloi procesin e divorcit në Gjykatën e Rrethit Vlorë.

12. Më 26 qershor 2003 ankuesi i kërkoi policisë së rrethit Vlorë të bllokonte pasaportën e së bijës për faktin se bashkëshortja e tij po planifikonte ta merrte atë në Greqi pa pëlqimin e tij.

13. Pavarësisht nga kërkesa e ankuesit drejtuar policisë së rrethit Vlorë, rezultoi që e shoqja e mori fëmijën në Greqi më 15 janar 2004, duke përdorur një certifikatë zyrtare, ku e bija e ankuesit ishte regjistruar me emrin I.M. dhe përdorte mbiemrin e F.M.-së.

14. E shoqja e ankuesit nuk ishte e pranishme në seancë. I ati i kësaj të fundit dëshmoi në seancë që mbesa e tij ishte në Greqi me të ëmën, e cila banonte atje si refugjate ekonomike.

15. Më 4 shkurt 2004 Gjykata e Rrethit Vlorë vendosi divorcin e palëve. Gjykata i dha ankuesit kujdestarinë e fëmijës, duke marrë në konsideratë mungesën e interesit të bashkëshortes për jetën e fëmijës, paqëndrueshmërinë e vendbanimit të saj dhe periudhat e gjata të ndarjes nga fëmija.

16. Më 19 mars 2004 vendimet e divorcit dhe kujdestarisë morën formë të prerë.

2. Procedurat e ekzekutimit

17. Më 5 prill 2004 Gjykata e Rrethit Vlorë nxori urdhër me shkrim për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Vlorë të 4 shkurtit 2004.

18. Më 13 korrik 2004 zyra e përbarimit në Vlorë e njoftoi ankuesin se ishte e pamundur të zbatonte vendimin, duke qenë se fëmija nuk ndodhej në Shqipëri.

19. Më 15 gusht 2004 dhe 13 janar 2005 ankuesi iu drejtua Ministrisë shqiptare të Drejtësisë të sigurote kthimin e së bijës.

20. Më 11 janar 2005, kur u mor në pyetje nga përbaruesit, i ati i F.M.-së deklaroi se F.M. dhe fëmija jetonin jashtë shtetit dhe se ai nuk kishte dijeni në lidhje me vendndodhjen e tyre. Gjatë periudhës janar -maj 2005, përbaruesit u paraqitën tre herë në shtëpinë e F.M.-së.

21. Në maj 2005, rajoni i policisë së rrethit Selenicë njoftoi përbaruesit se F.M. dhe e bija nuk jetonin në Athinë dhe se i ati i F.M.-së ishte transferuar në Tiranë në një adresë të panjohur.

22. Në korrik 2005 zyra e përbarimit njoftoi ankuesin, se për të vepruar në përputhje me marrëveshjet dypalëshe ndërmjet Shqipërisë dhe Greqisë, ai duhej të paraqiste një kërkesë dhe të jepte adresën e saktë të fëmijës në Greqi.

23. Ankuesi u dërgoi kërkesa të shumta autoriteteve shqiptare, Ambasadës Greke në Shqipëri, Avokatit të Popullit të Shqipërisë dhe Avokatit të Popullit të Kosovës, duke kërkuar ndihmë në sigurimin e ekzekutimit të vendimit të kujdestarisë.

3. Procedim penal për rrëmbim fëmije

24. Më 14 gusht 2004 ankuesi nisi procedimin penal pranë Gjykatës së Rrethit Vlorë kundër ish- bashkëshortes së tij, duke e akuzuar atë për rrëmbim fëmije.

25. Më 13 tetor 2004 Gjykata e Rrethit Vlorë njoftoi Avokatin e Popullit se nuk ishte depozituar asnjë padi në lidhje me rrëmbimin e së bijës së ankuesit.

4. Procedimi penal kundër A.C.

26. Më 15 dhjetor 2003 ankuesi filloi procedimin penal kundër A.C.-së, punonjëse e Zyrës së Gjendjes Civile. Ai e akuzonte atë për falsifikim të dokumenteve të ndryshme që i kishin mundësuar F.M.-së të largonte I.B.-në nga Shqipëria, e veçanërisht për falsifikimin e dokumenteve që e deklarorin bashkëshorten e tij të pamartuar dhe ndërrimin e mbiemrit të së bijës.

27. Më 26 janar 2004 Gjykata e Rrethit Vlorë vendosi të ndërpriste gjykimin.

5. Zhvillimet e fundit

28. Më 22 gusht 2006 autoritetet shqiptare njoftuan zyrën e regjistrit se më 31 mars 2006, Gjykata e Apelit në Vlorë kishte shfuqizuar vendimin e kujdestarisë të 4 shkurtit 2004, me arsyetimin se F.M.-ja nuk ishte njoftuar rregullisht në lidhje me gjykimin për kujdestarinë e të bijës. Kjo gjykatë vendosi t'ia dërgonte çështjen Gjykatës së Rrethit për t'u marrë sërish në shqyrtim dhe si rezultat gjykimi i kujdestarisë ka mbetur ende pezull.

29. Më 23 gusht 2006, në bazë të kërkesës së zyrës së regjistrit, ankuesi deklaroi se ai nuk ishte njoftuar për fillimin e një procesi të ri dhe as për rezultatet e tij.

30. Gjykimi ishte filluar nga avokati i F.M.-së dhe ishte zhvilluar në mungesë të ankuesit.

LEGJISLACIONI PÛRKATËS NDËRKOMBËTAR DHE I BRENDSHËM

A. Legjislacioni ndërkombëtar përkatës

1. Konventa e Hagës mbi Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve

31. Aktualisht, Shqipëria nuk e ka ratifikuar Konventën e Hagës të 25 tetorit 1980 mbi Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve.

2. Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi Të Drejtat e Fëmijëve

32. Neni 11 i Konventës mbi Të Drejtat e Fëmijëve e 20 nëntorit 1989, i ratifikuar nga Shqipëria më 27 shkurt 1992, kërkon nga shtetet palë të marrin masa për të luftuar transferimin e paligjshëm dhe moskthimin e fëmijëve jashtë shtetit. Për këtë qëllim, shtetet duhet të nxitin lidhjen e marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe ose aderimin në marrëveshjet ekzistuese.

3. Marrëveshjet Dypalëshe mbi Ndihmën e Ndërsjellë për Çështjet Civile dhe Penale ndërmjet Greqisë dhe Shqipërisë

33. Kjo Marrëveshje, e nënshkruar më 17 maj 1993, është ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 7760, datë 14 tetor 1993 dhe nga Greqia sipas ligjit nr.2311/1995.

Nenet 2, 3, 23 dhe 24 të Marrëveshjes parashikojnë mundësinë për Ministrinë e Drejtësisë së të dyja Palëve Kontraktuese për të bashkëpunuar për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë në territoret e tyre respektive në lidhje me çështjet civile, familjare dhe tregtare.

B. Legjislacioni dhe praktika përkatëse e brendshme

34. Kodi i Procedurës Civile, i cili rregullon, ndër të tjera, ekzekutimin e vendimeve të formës së prerë, nuk përmban ndonjë dispozitë veçanërisht të zbatueshme për transferimin e kujdestarisë së fëmijëve. Si rezultat, rregullat e përgjithshme procedurale mbi ekzekutimin e vendimeve zbatohen *mutatis mutandis*.

35. Në ato raste kur refuzimi për t'u bindur i një prej prindërve përbën vepër penale, çështja duhet t'i dërgohet organit të ndjekjes penale.

36. Mosrespektimi i vendimit të formës së prerë për kujdestarinë e fëmijës mund të ndëshkohet në bazë të nenit 127 të Kodit Penal.

E DREJTA

I. KUNDËRSHTIMI PARAPRAK I QEVERISË

37. Pala shqiptare pretendoi se ankuesi nuk i kishte ezauruar të gjitha mjetet e mbrojtjes ligjore të brendshme në dispozicion të tij. Ata argumentonin se ankuesi nuk kishte ngritur çështjen e mosveprimit të zyrës së përbarimit pranë Gjykatës së Rrethit Vlorë në përputhje me nenin 610 të Kodit të Procedurës Civile. Në bazë të parashtrimeve të autoriteteve shtetërore, dispozita përkatëse u jep individëve të drejtën të kundërshtojnë veprimet e përbaruesve para Gjykatës së Rrethit. Si rrjedhim, ankuesi nuk ka mundur të përfitojë nga kjo e drejtë, pavarësisht se i ishte drejtuar Ministrisë së Drejtësisë dhe autoriteteve të tjera për mosveprim nga ana e përbaruesve.

38. Ankuesi kundërshtoi efikasitetin e këtij mjeti të brendshëm, në bazë të parashtrimeve të autoriteteve shtetërore. Ai argumentoi se një ankim tjetër nuk do ta arrinte qëllimin e tij kryesor, d.m.th, ta ribashkonte atë me të bijën. Ai theksoi, se gjatë dy viteve që pasuan marrjen e vendimit të kujdestarisë, ai u kishte drejtuar disa kërkesa organeve kompetente. Kjo përfshinte fillimin e procedimit penal për rrëmbimin e fëmijës së tij, si dhe kërkesat e vazhdueshme për ekzekutimin e menjëhershëm të vendimit në interes të së bijës. Si rrjedhim, ankuesi parashtrroi se deklaratat e autoriteteve shtetërore ishin të pabazuara.

39. Gjykata thekson se qëllimi i nenit 35 është t'u ofrojë Shteteve Kontraktuese mundësinë e parandalimit ose vënies në vend të shkeljes së pretenduar kundër tyre, para se këto pretendime t'i paraqiteshin asaj (si për shembull, Hentrich v. France, vendimi i datës 22 Shtator 1994, Seria A nr. 296-A, fq. 18, § 33, dhe Remli v. France, vendimi i datës 23 prill 1996, Reports of Judgments and Decisions 1996-II, f. 571, § 33). Si rezultat, ankimi që duhet të paraqitet në Gjykatë duhet në radhë të parë të paraqitet para gjykatave përkatëse kombëtare, të paktën në përmbajtje, në përputhje me kërkesat formale të së drejtës së vendit dhe brenda afateve të paracaktuara me ligj. Megjithatë, të vetmet mjete të brendshme, që duhet të ezaurohen janë ato që lidhen me shkeljet e supozuara dhe që në të njëjtën kohë janë të mundshme dhe të mjaftueshme. Ekzistenca e mjeteve të tilla të brendshme duhet të jetë mjaft e sigurt, jo vetëm në teori, por dhe në praktikë, dhe nëse nuk janë të tilla, ato nuk ofrojnë aksesin dhe efikasitetin e duhur. Në këtë kuadër, i takon shtetit përkatës të vërtetojë plotësimin e këtyre kushteve të ndryshme (shih, në veçanti, Vernillo v. France, vendimi i datës 20 shkurt 1991, Seria A nr. 198, fq. 11 – 12, § 27, dhe Akdivar and Others v. Turkey, vendimi i datës 16 shtator 1996, Reports 1996-IV, fq. 1210-11, § § 65-68).

40. Gjykata tërheq vëmendjen se ankuesi është ankuar që autoritetet kanë neglizhuar të ndërmarrin masat e nevojshme për të zbuluar vendndodhjen e së bijës, në zbatim të vendimit të kujdestarisë në favor të tij.

41. Në favor të ankuesit u nxor një urdhër gjyqësor për ekzekutimin e vendimit të datës 4 shkurt 2004 në përputhje me kërkesat e procedurave civile të vendit, por përmbaruesit ishin të paaftë ta zbatonin atë, meqenëse e bija e ankuesit nuk gjendej më në Shqipëri.

42. Gjykata konstaton se autoritetet shqiptare nuk kanë mundur të provonin argumentin e tyre që mjeti i brendshëm i sipërpërmendur është i mundshëm dhe i përshtatshëm për të ndrequr shkeljen e pretenduar.

43. Veç kësaj, Gjykata vëren se për një çështje të ngjashme kundër shtetit shqiptar ajo evidentoi se sistemi ligjor shqiptar ishte organizuar në një mënyrë të tillë, që nuk siguron mjete të brendshme efektive kundër veprimeve të përmbaruesve, duke qenë se Gjykata Kushtetuese arsyetonte, se nuk kishte bazën ligjore për të shqyrtuar ankesa lidhur me procedurat e ekzekutimit të vendimeve dhe i deklaronte ato sistematikisht të papranueshme (shih Qufaj Co. sh.p.k. v. Albania, nr. 54268\00, § 41, më 18 nëntor 2004). Në çdo rast, u takonte organeve kompetente të garantonin ekzekutimin e vendimeve gjyqësore duke qenë se janë ato që kanë mjetet e nevojshme ligjore dhe burimet për të zbuluar vendndodhjen e fëmijës dhe për të siguruar kthimin e saj. Në këto rrethana, nuk mund të pretendohet se ankuesi duhej t'u bënte kërkesa të përsëritura përmbaruesve ose të ankohej për mosveprimin e tyre tek një gjykatë për të arritur ekzekutimin e vendimit.

44. Si rrjedhim, Gjykata konkludon që në kohën e duhur, mjetet e brendshme të referuara nga autoritetet shtetërore nuk i ofruan ankuesit perspektivë të arsyeshme suksesi.

45. Prandaj, kundërshtimi paraprak i autoriteteve shtetërore duhet të mos pranohet.

II. SHKELJE TË PRETENDUARA TË NENIT 8 TË KONVENTËS

46. Ankuesi është ankuar se mungesa e efektivitetit të organeve kompetente shqiptare në pamundësinë për të marrë masat e nevojshme për ribashkimin e tij me të bijën në përputhje me vendimin e formës së prerë kishin shkelur të drejtën e tij të respektimit të jetës familjare, sipas nenit 8 të Konventës, i cili parashikon si më poshtë:

1. “Çdo person ka të drejtë që t'i respektohet jeta e tij private dhe familjare, vendbanimi dhe korrespondenca e tij”

2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, vetëm në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur në një shoqëri demokratike, kjo masë është e domosdoshme për sigurimin kombëtar, për sigurimin publik, për mirëqenien ekonomike të vendit, për mbrojtjen e rendit ose për parandalimin e veprave penale, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve.

A. Pranueshmëria

47. Gjykata vëren se ankimi nuk është haptazi i pabazuar sipas kuptimit të nenit 35 § 3 të Konventës. Ajo thekson më tej se ai nuk është i papranueshëm për ndonjë shkak tjetër. Për këtë arsye, duhet të deklarohet i pranueshëm.

B. Meritat (themeli)

1. Parashtrimet e palëve

48. Ankuesi u ankua se organet kompetente kishin neglizhuar të bënin ato përpjekje që pritëshin normalisht prej tyre për të garantuar respektimin e të drejtave të tij. Ai pretendonte gjithashtu që edhe dështimi i organeve kompetente për të përfshirë edhe organet përkatëse greke në ndihmë të gjetjes së vendndodhjes të së bijës bazohej në supozimin e tyre se F.M. dhe bashkëshorti i saj aktual ishin rezidentë të paligjshëm në Greqi dhe nuk mbështetej mbi fakte të bazuara.

49. Autoritetet shqiptare kundërshtuan argumentet e ankuesit. Ato deklaruan se në përputhje me detyrimet pozitive sipas nenit 8 të Konventës, organet kompetente kishin marrë të gjithë hapat e mundshëm në dispozicion të tyre për të bashkuar ankuesin me të bijën. Ata theksuan se në Greqi jetonin afërsisht 500 000 shtetas shqiptarë dhe se gjysma e tyre banonin atje në mënyrë të paligjshme. Prandaj, shteti nuk mund të mbante përgjegjësi për pamundësinë e ankuesit për të dhënë detaje të sakta të vendndodhjes të së bijës dhe për të kërkuar marrjen e masave urgjente para se F.M.-ja të largohej nga Shqipëria, duke marrë edhe fëmijën e saj me vete. Autoritetet shtetërore argumentonin se, meqenëse nuk ishte dhënë adresa e saktë e fëmijës dhe nënës së saj në Greqi, përdorimi i instrumenteve të parashikuara në marrëveshjen dypalëshe ndërmjet Shqipërisë dhe Greqisë kishte qenë jo efikas (shih paragrafin 33 më sipër).

2. Vlerësimi i Gjykatës

a) Parime të përgjithshme

50. Gjykata rithekson se qëllimi kryesor i nenit 8 është të mbrojë individin prej veprimeve arbitrare të autoriteteve publike. Përveç kësaj, ka detyrime pozitive të qenësishme për “respektimin” efektiv të jetës familjare. Në të dy kontekstet duhet të ketë një ekuilibër të drejtë ndërmjet interesave konkurruese të individit dhe komunitetit në tërësi; dhe në të dy kontekstet shteti gëzon një liri të caktuar vlerësimi (shih *Keegan v. Ireland*, vendimi i datës 26 maj 1994, Seria A nr. 290, f. 19, § 49; *Ignaccolo-Zenide v. Romania*, no. 31679/96, § 94, ECHR 2000-I; *Iglesias Gil and A.U.I. v. Spain*, no. 56673/00, § 49, ECHR 2003-V; and *Sylvester v. Austria*, no. 36812/97, 40104/98, § 51, 24 April 2003).

51. Përsa i përket detyrimit të shtetit për të marrë masa pozitive, Gjykata ka arsyetuar vazhdimisht se neni 8 përfshin të drejtën e prindit në marrjen e masave me qëllim ribashkimin e tij me fëmijën dhe detyrimin e organeve shtetërore për të lehtësuar këtë ribashkim (shih, ndër autoritetet e tjera, *Ignaccolo-Zenide*, e përmendur më sipër, § 94; *Iglesias Gil and A.U.I.*, e përmendur më sipër, § 48; dhe *Nuutinen v. Finland*, nr. 32842/96, § 127, ECHR 2000-VIII).

52. Në rastet lidhur me ekzekutimin e vendimeve në fushën e së drejtës familjare, Gjykata ka arsyetuar se kriteri vendimtar është nëse organet kompetente shtetërore kanë marrë të gjitha masat e nevojshme për të lehtësuar ekzekutimin e vendimeve, siç mund të kërkohej në mënyrë të arsyeshme në rrethanat e veçanta të çdo çështjeje (shih *Hokkanen v. Finland*, vendimi i datës 23 shtator 1994, Seria A nr. 299-A, f. 22, § 58; *Ignaccolo-Zenide*, i përmendur më sipër, § 96; *Nuutinen*, siç është përmendur më sipër, § 128; dhe *Sylvester*, përmendur më sipër, § 59).

53. Në çështje të këtij lloji përshtatshmëria e një mase gjykohet nga shpejtësia e ekzekutimit të saj, meqenëse kalimi i kohës mund të ketë pasoja të pandreqshme për marrëdhëniet ndërmjet fëmijës dhe prindit, i cili nuk jeton me të. Gjykata tërheq vëmendjen se neni 11 i Konventës së Hagës mbi Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijës i datës 25 tetor 1980 (ku Shqipëria nuk është palë) kërkon nga organet gjyqësore apo administrative kompetente të veprojnë shpejt, lidhur me procedurat për kthimin e fëmijëve dhe çdo mosveprim që zgjat më shumë se gjashtë javë, mund të çojë në nisjen e një ankimimi për të kërkuar arsyet e vonës (shih *Ignaccolo-Zenide*, i përmendur më sipër, § 102).

54. Gjykata ka arsyetuar gjithashtu se megjithëse masat shtrënguese ndaj fëmijëve nuk janë të dëshirueshme në këtë fushë delikate, përdorimi i sanksioneve nuk duhet të përjashtohet në rast të një sjelljeje të paligjshme nga prindi me të cilin jeton fëmija (shih *Ignaccolo-Zenide*, i përmendur më sipër, § 106).

55. Gjykata thekson se Konventa duhet të zbatohet në përputhje me parimet e së drejtës ndërkombëtare, në veçanti me ato lidhur me mbrojtjen ndërkombëtare të të drejtave të njeriut (shih

Streletz, Kessler and Krenz v. Germany (GC), nos. 34044/96, 35532/97 and 44801/98, § 90, ECHR 2001-II, and *Al-Adsani v. the United Kingdom* [GC], nr. 35763/97, § 55, ECHR 2001-XI). Si rrjedhim, Gjykata arsyeton se detyrimet pozitive që neni 8 i Konventës parashtron për Shtetet Kontraktuese përsa i përket ribashkimit të prindit me fëmijën e tij\ saj duhet të interpretohen në lidhje me Konventën e Hagës të datës 25 tetor 1980 (shih Ignaccolo-Zenide, i përmendur më sipër, § 95).

b) Zbatimi i parimeve të përgjithshme për këtë çështje

56. Gjykata vëren së pari, që marrëdhëniet ndërmjet ankuesit dhe së bijës i përkasin sferës së jetës familjare në bazë të nenit 8 të Konventës.

57. Ngjarjet që po shqyrtohen në këtë rast, në masën që ato bëjnë përgjegjës shtetin e paditur, çojnë qartë në ndërhyrjen në të drejtën e ankuesit për respektimin e jetës familjare, meqenëse neglizhimi për të ekzekutuar vendimin e kujdestarisë dëmtoi gëzimin e pranisë të së bijës.

58. Pavarësisht se nga zhvillimet e fundit procesi i kujdestarisë në fjalë është rihapur dhe është në zhvillim e sipër, Gjykata nënvizon se vendimi i kujdestarisë i 4 shkurtit 2004 ka qenë i vlefshëm dhe mbeti pa u ekzekutuar përafërsisht dy vjet. Prandaj Gjykata duhet të përcaktojë nëse organet kompetente kombëtare morën masat e nevojshme dhe të duhura për të lehtësuar ekzekutimin e vendimit që po shqyrtohet.

59. Lidhur me çështjen aktuale, Gjykata vëren se procedurat e ekzekutimit të vendimit në favor të ankuesit kanë mbetur pezull që në prill 2004. Ajo fillimisht konstaton se kjo situatë nuk është krijuar në asnjë mënyrë për shkak të ankuesit, i cili u është drejtuar organeve shtetërore kompetente për t'i dhënë fund asaj dhe ka marrë masa sistematikisht për të garantuar kthimin e së bijës.

60. Vetëm në prill 2005, më shumë se një vit pas marrjes së vendimit të kujdestarisë, përmbaruesit kërkuar nga policia t'u jepte informacion rreth vendndodhjes së F.M.-së dhe së bijës. Ndërsa të gjitha këto përpjekje për ekzekutimin e vendimit ndodhën brenda një periudhe prej katër muajsh në vitin 2005, nuk mund të vërehet i njëjti kujdes lidhur me periudhën vendimtare menjëherë pas marrjes së vendimit të kujdestarisë. Siç u përmend më sipër, vetëm në janar 2005, përmbaruesit filluan hetimin e vendndodhjes së F.M.-së. Më tej duhet nënvizuar se nuk u mor asnjë masë pas muajit maj 2005.

61. Gjykata vëren se nuk është parashtruar asnjë shpjegim i pranueshëm për të justifikuar këto vonesa. Në mënyrë të ngjashme, nuk është dhënë asnjë shpjegim nga ana e autoriteteve shtetërore për mosveprimin e organeve kompetente kur u siguruan se F.M. jetonte në Greqi. Duhet nënvizuar në këtë aspekt se edhe ankuesi, edhe familja e F.M.-së kishin njoftuar organet kompetente, edhe gjatë seancës së kujdestarisë, se F. M. jetonte në Athinë si emigrante ekonomike.

62. Gjykata konsideron se argumentet e autoriteteve shtetërore për statusin joligjor të F.M.-së në Greqi janë spekulative. Autoritetet nuk morën masa të përpiqeshin të konfirmonin vendndodhjen e F.M.-së dhe të së bijës nga autoritetet greke, një mundësi e garantuar nga marrëveshja dypalëshe ndërmjet dy vendeve.

63. Autoritetet shtetërore pretendonin se pamundësia e ekzekutimit të vendimit në fjalë rezultoi nga fakti se fëmija nuk ishte më në Shqipëri, një situatë e cila ishte shkaktuar pjesërisht nga pamundësia e ankuesit për të kërkuar masa urgjente gjatë procedurave të kujdestarisë.

64. Megjithatë, duket se përpjekjet e ankuesit për të njoftuar autoritetet për rreziqet e rrëmbimit të fëmijës, kishin kaluar pa u vënë re. Gjykata arsyeton se mosveprimi i ankuesit për të kërkuar një masë të ndërmjetme nuk mund të merret për të shfajësuar autoritetet nga detyrimet e tyre përsa i përket ekzekutimit të vendimeve, meqenëse janë ata që ushtrojnë autoritetin publik dhe kanë mjetet në dispozicion për të kapërcyer problemet në fushën e ekzekutimit të vendimeve. Veç kësaj, ankuesi nuk mund të fajësohej pse nuk iu drejtua gjykatave greke, pasi marrëveshja dypalëshe për këtë çështje kërkonte qartë përfshirjen e Ministrive të Drejtësisë të të dyja vendeve në ekzekutimin e vendimeve të kujdestarisë në territorin e tyre (shih paragrafin 33 më sipër). Siç është përmendur dhe më sipër, autoritetet shtetërore nuk kanë shpjeguar për sqarimin e Gjykatës se cilat masa, nëse ka ndonjë, janë marrë në bazë të marrëveshjes për të siguruar kthimin e vajzës së ankuesit nga Greqia të paktën për të gjetur vendndodhjen e F.M.-së.

65. Gjykata vijon se gama e gjerë e masave ligjore që është zbatuar nga autoritetet shqiptare për të vepruar në përputhje me parimet e shtetit ligjor, si dhe traktateve europiane dhe ndërkombëtare, nuk siguron masa efikase për të siguruar ribashkimin e prindërve me fëmijët si në rastin e ngjashëm me atë të ankuesit. Në veçanti, nuk ka mjete të brendshme të veçanta për të parandaluar ose ndëshkuar rastet e rrëmbimit të fëmijëve nga territori i Shqipërisë (shih paragrafët 34 si më sipër). Aktualisht, Shqipëria nuk është Palë në Konventën e sipërpërmendur të Hagës dhe ende nuk e ka zbatuar Konventën e OKB-së mbi të Drejtat e Fëmijëve të datës 20 nëntor 1989 (shih paragrafët 31 dhe 32 si më sipër).

66. Gjykata tërheq vëmendjen se Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut nuk u vendos shteteve detyrimin për t'i ratifikuar konventat ndërkombëtare. Sidoqoftë, ajo u kërkon atyre të marrin të gjitha masat e nevojshme, në zgjedhjen e tyre të lirë, për të siguruar të drejtën e individit, të garantuar nga neni 8 i Konventës dhe në veçanti për të siguruar ribashkimin e prindërve me fëmijët e tyre në përputhje me një vendim të formës së prerë të gjykatës vendase.

67. Pavarësisht nga mosratifikimi i instrumenteve përkatëse ndërkombëtare në këtë fushë nga Shqipëria, Gjykata konstaton se sistemi ligjor shqiptar, në këtë fazë, nuk siguron ndonjë kuadër alternativ që i jep ankuesit mbrojtjen e duhur praktike dhe efektive që kërkohej nga detyrimi pozitiv i shtetit sipas nenit 8 të Konventës.

68. Në rrethanat e kësaj çështjeje, pavarësisht nga marzhi i vlerësimit të shtetit të paditur, Gjykata konkludon se përpjekjet e autoriteteve shqiptare nuk ishin të duhura dhe as efikase për të përmbushur detyrimin e tyre pozitiv sipas nenit 8.

69. Si rrjedhim, është shkelur neni 8 i Konventës.

II. SHKELJET E PRETENDUARA TË NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS

70. Ankuesi u ankua se autoritetet shqiptare nuk mundën të vepronin në përputhje me vendimin e formës së prerë që i garantonte atij kujdestarinë për të bijën. Ai u mbështet në nenin 6 § 1 të Konventës, i cili në pjesët e tij përbërëse nënvizon si më poshtë:

“Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht,...nga një gjykatë..., e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile...”

71. Autoritetet shtetërore e kundërshtuan këtë argument.

72. Gjykata vëren se ky ankim lidhet me atë të shqyrtuar më sipër dhe si rezultat duhet të deklarohet gjithashtu i pranueshëm.

73. Gjykata rithekson ndryshimin në natyrën e interesave në bazë të neneve 6 dhe 8 të Konventës. Ndërsa neni 6 ofron garanci procedurale, që do të thotë “e drejta për t’iu drejtuar një gjykate” në përcaktimin e “të drejtave dhe detyrimeve civile” të individit, Neni 8 i shërben një qëllimi më të plotë, sigurimin e respektit të duhur, ndër të tjera, për jetën familjare. Ndryshimi ndërmjet qëllimit të ndjekur nga garancitë përkatëse të ofruar nga neni 6 dhe 8 mund të justifikojnë, në lidhje me rrethanat të veçanta, shqyrtimin e të njëjtit grup faktesh sipas të dy neneve (shih, për shembull, *McMichael v. The United Kingdom*, vendimi i datës 24 shkurt 1995, Seria A nr. 307-B, f. 57, § 91, dhe *Sylvester*, i përmendur më sipër, § 76).

74. Megjithatë, në rastin konkret dhe duke marrë parasysh konkluzionet lidhur me nenin 8 (shih paragrafin 69 më sipër), Gjykata arsyeton se nuk është e nevojshme të shqyrtohet nëse në rastin konkret ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 (shih, ndër autoritetet e tjera, *Sylvester*, i përmendur më sipër, § 77).

III. SHKELJE TË TJERA TË PRETENDUARA TË KONVENTËS

75. Ankuesi u ankua në bazë të nenit 6 § 1 për dështimin e autoriteteve për të filluar procesin penal kundër A.C., i cili, siç pretendonte ai, kishte falsifikuar dokumentet që kishin ndihmuar ish-bashkëshorten e tij të rrëmbente të bijën. Së fundmi, duke iu referuar falsifikimit të certifikatës së lindjes të së bijës, ankuesi u ankua në bazë të neneve 12, 13, dhe 17, pa dhënë arsyet e duhura.

76. Përsa i përket ankimit të ankuesit sipas nenit 6 § 1, Gjykata thekson se e drejta për të nisur proces penal kundër personave privatë nuk garantohet nga Konventa (shih *X v. the Federal Republic of Germany*, nr.7116\75, vendimi i Komisionit i datës 4 tetor 1976, *Decisions and Reports* 7, f. 91, dhe *B.C. v. Slovakia* (Dhjetor), nr. 11079\02, 14 mars 2006 dhe gjithashtu *Perez v. France*

(GC), nr.47287\99, § 70, ECHR 2004-I). Ajo vijon, se ky ankim nuk përputhet, *ratione materiae*, me dispozitat e Konventës sipas kuptimit që përmban neni 35 § 3 dhe duhet të mos pranohet në përputhje me nenin 35 § 4.

77. Përsa i përket faktit se ankuesi u ankua për shkelje të neneve 12, 13 dhe 17 të Konventës pa dhënë detaje të mëtejshme, Gjykata arsyeton se çështja është tërësisht e pabazuar. Si rrjedhim, ky ankim nuk pranohet dhe çështja duhet të pushohet në përputhje me nenin 35 § § 3 dhe 4 të Konventës, duke qenë se është haptazi e pabazuar.

IV. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

78. Neni 41 i Konventës parashikon:

“Kur Gjykata konstaton shkelje të konventës ose të protokolleve të saj, dhe e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese mundëson vetëm ndreqjen e pjesshme të pasojave të shkaktuara nga shkelja, Gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar.”

A. Dëmi

79. Ankuesi pretendonte 10 000 euro dëmshpërblim (në para), që do të kompensojnë humbjen e tij të pagave dhe mundësive të punës, dhe 15 000 euro dëmshpërblim jomaterial për shqetësimet e shkaktuara si rezultat i pamundësisë së ekzekutimit të vendimit të ribashkimit të tij me të bijën.

80. Autoritetet shtetërore kundërshtuan pretendimet e ankuesit, meqenëse sipas tyre ankimi ishte i papranueshëm. Ata nuk dhanë ndonjë argumentim lidhur me shumën e pretenduar për dëmshpërblim material dhe jomaterial.

81. Gjykata nuk dallon ndonjë lidhje shkakësore ndërmjet shkeljes së evidentuar dhe dëmit material të pretenduar; prandaj ajo e hedh poshtë këtë pretendim.

82. Përsa i përket dëmit jomaterial, Gjykata nuk sheh ndonjë arsye për të mos besuar se ankuesi ka vuajtur si rezultat i mosekzekutimit të vendimit të formës së prerë në fjalë dhe se shpërblimi i drejtë do të kufizohet vetëm me konstatimin e shkeljes.

83. Duke pasur parasysh shumën e dhëna për rastet e krahasueshme (shih, për shembull, Ignaccolo-Zenide, siç u përmend më sipër, § 117; Hokkanen, siç u përmend më sipër, f. 27, § 77; shih gjithashtu, mutatis mutandis, Elsholz v. Germany (GC), nr. 25735\94, § 71, GJEDNJ 2000-VIII, dhe Kutzner v. Germany, nr. 46544\99, § 87, GJEDNJ 2002-I), dhe duke bërë një vlerësim mbi baza të drejta sipas nenit 41, Gjykata cakton shumën prej 15 000 euro për këtë aspekt.

C. Kostot dhe shpenzimet

84. Ankuesi pretendonte gjithashtu 17 000 euro për koston dhe shpenzimet e kryera para gjykatave vendase dhe Gjykatës Europiane.

85. Autoritetet shtetërore nuk shprehën ndonjë qëndrim.

86. Në bazë të praktikës së Gjykatës, një ankues ka të drejtën e rimbursimit të koston së shpenzimeve të tij vetëm për shpenzimet e kryera realisht dhe që kanë qenë të domosdoshme dhe të arsyeshme. Në rastin konkret, duke iu referuar marrjes së informacionit dhe kritereve të shprehura më sipër, Gjykata e konsideron të arsyeshme të japë shumën prej 10 000 euro për të gjitha shpenzimet sipas të gjithë zërave.

D. Interesi i vonuar

87. Gjykata e shikon të arsyeshme që interesi i vonuar duhet të mbështetet brenda kursit të dhënë nga Banka Europiane Qendrore, së cilës i shtohen tre pikë përqindje.

PËR KËTO ARSYE , GJYKATA NJEZËRI

1. Deklaron, ankesat lidhur me nenin 6 § 1 (për mosekzekutimin) dhe nenin 8 të Konventës të pranueshme ndërsa pjesën e mbetur të kërkesës, të papranueshme;

2. Vlerëson se ka pasur shkelje të nenit 8 të Konventës;

3. Vlerëson se nuk ka arsye për të shqyrtuar veçmas ankimin lidhur me nenin 6 § 1 të Konventës;

4. *Vlerëson*

a) që shteti përkatës, në përputhje me nenin 44 § 2 të Konventës, duhet t'i paguajë ankuesit, brenda tre muajve që vendimi merr formë të prerë, shumat e mëposhtme, për t'u konvertuar në valutën vendase të shtetit përkatës, me kursin e këmbimit të zbatueshëm në datën e shlyerjes, plus çdo taksë që mund të jetë e tatueshme.

i) 15 000 euro (pesëmbëdhjetë mijë euro) lidhur me dëmin jopasuror;

ii) 10 000 euro (dhjetë mijë euro) lidhur me koston e shpenzimeve;

b) që nga skadimi i afatit të mësipërm tremujor deri në shlyerje, interesi i thjeshtë do të jetë i pagueshëm mbi shumat e mësipërme në një normë të barabartë me normën marzhinale të huadhënies të Bankës Qendrore Europiane gjatë periudhës së mospagimit, plus tre pikë për qind;

5. Hedh poshtë pjesën e mbetur të kërkesës së ankuesit për shpërblim të drejtë.

6. Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 12 dhjetor 2006, sipas neneve 77 § § 2 dhe 3 të rregullores së Gjykatës.

T.L. EARLY
Regjistruesi

Nicolas BRATZA
Kryetari

**VENDIM
(RISHIKIMI)
(Ankimi nr. 35853/04)**

ÇËSHTJA BAJRAMI k. SHQIPËRISË

**STRASBURG
18 Dhjetor 2007**

**PËRFUNDIMTAR
18/03/2008**

Ky vendim merr formë të prerë në rrethanat e përcaktuara në Nenin 44 § 2 të Konventës. Ai mund t'i nënshtrohet rishikimit redaktues.

Në çështjen Bajrami kundër Shqipërisë (kërkesë për rishikim të vendimit të 12 dhjetorit 2006),

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i katërt), me dhomë gjykuese të përbërë nga:

Z. Nicolas BRATZA *Kryetar*

Z. G. BONELLO

Z. M. PELLONPAA

Z. K. TRAJA

Z. L. GARLICKI

Z. L. MIJOVIC

Z. J. SIKUTA, gjyqtarë

dhe Z.T.L. EARLY regjistruar i seksionit,

pas shqyrtimit me dyer të mbyllura të çështjes më 27 Nëntor 2007,

shpall vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua në atë datë:

PROCEDURA

1. Çështja e ka origjinën në ankesën (nr. 35853/04) kundër Republikës së Shqipërisë paraqitur pranë Gjykatës në bazë të nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore ("Konventa") nga një shqiptar etnik nga Kosova, Z. Agim Bajrami ("ankuesi"), më 27 shtator 2004.

2. Me vendimin e dhënë më 12 dhjetor 2006, Gjykata ka vendosur se kishte pasur shkelje të Nenit 8 të Konventës për shkak të dështimit të autoriteteve për t'i ofruar ankuesit ndonjë kuadër mbrojtës me qëllim që të sigurohej një mbrojtje praktike dhe efektive siç kërkohet nga detyrimi pozitiv i Shtetit që është i sanksionuar në nenin 8, dhe se nuk kishte nevojë për të shqyrtuar veçmas ankesën sipas nenit 6 § 1 të Konventës. Gjykata vendosi gjithashtu për t'i dhënë ankuesit 15.000 € (euro) për dëmin jo-material dhe 10.000 euro për kostot dhe shpenzimet dhe rrëzoi pjesën tjetër të pretendimeve për një shlyerje të drejtë.

3. Më 28 qershor 2007 Qeveria ka informuar Gjykatën se ata kishin marrë dijeni se ankuesi kishte vdekur më 10 Nëntor 2006. Ndaj në përputhje me rrethanat, ajo ka kërkuar rishikimin e vendimit sipas kuptimit të Rregullit 80 § 1 të Rregullores të Gjykatës.

4. Në shtator të 2007 Gjykata ka pranuar kërkesën për rishikim (Rregulli 80 § 1 i Rregullores së Gjykatës) dhe vendosi që t'i japë përfaqësuesit të ankuesit tre javë afat për të paraqitur vërejtje në lidhje me kërkesën e Qeverisë për rishikim. Këto vërejtje kanë mbërritur më 22 tetor 2007.

E DRJETA

KËRKESË PËR RISHIKIM

5. Qeveria kërkoi rishikimin e vendimit të 12 dhjetorit 2006, me arsyetimin se ajo nuk kishte qenë në gjendje për të ekzekutuar atë, sepse ankuesi kishte vdekur para se të merrej vendimi. Sipas Qeverisë, trashëgimtarët e ankuesit duhet të marrin shumat që ishin dhënë për ankuesin që ka ndërruar jetë.

6. Përfaqësuesi i ankuesit ka deklaruar se i ati i ankuesit kishte shprehur dëshirën e tij për të marrë pjesë në ekzekutimin e Vendimit të Gjykatës dhe se ai nuk kishte asnjë vërejtje për të bërë mbi kërkesën për rishikim. Ai nuk iu referua vajzës së vogël të ankuesit, kujdestaria e së cilës ishte subjekt kryesor i procedurave para gjykatave vendase dhe Vendimit të Gjykatës.

7. Gjykata konsideron se Vendimi i 12 dhjetor 2006 duhet të rishikohet në pajtim me Rregullin 80 § 1 të Rregullores së Gjykatës, e cila parashikon se:

"Një palë mund, në rast se zbulon një fakt, i cili për nga natyra e tij ka një ndikim përcaktues dhe që, në momentin kur vendimi ishte dhënë, ishte i panjohur për Gjykatën dhe nuk mund të ishte logjikisht i ditur për palën, mund t'i kërkojë Gjykatës ... të rishikojë atë Vendim.

...

8. Duke pasur parasysh rrethanat, Gjykata konsideron se akordimi i shpërblimit të bërë për ankuesin që ka ndërruar jetë duhet t'i paguhet trashëgimtarit ose trashëgimtarëve të tij të caktuar me vullnetin e tij ose, në qoftë se ka vdekur pa lënë testament, në përputhje me dispozitat e së drejtës së brendshme që rregullon trashëgiminë ligjore. Pika 41 e Vendimit të Gjykatës të datës 12 dhjetor 2006 duhet të rishikohet në përputhje me rrethanat.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA NJËZËRI

1. Vendos të rishikojë vendimin e saj të 12 dhjetorit 2006 në lidhje me zbatimin të Nenit 41 të Konventës;

në përputhje me rrethanat,

2. Vendos

(a) se Shteti i paditur t'i paguajë trashëgimtarit ose trashëgimtarëve të ankuesit, të caktuar me vullnetin e tij ose, në qoftë se ka vdekur pa lënë testament, në përputhje me dispozitat e së drejtës së brendshme që rregullon trashëgiminë ligjore, brenda tre muajve nga data në të cilën vendim i rishikuar të bëhet përfundimtar në përputhje me Nenin 44 § 2 të Konventës, shumat e mëposhtme, që do të konvertohen në monedhën kombëtare të shtetit të paditur sipas kursit në fuqi në datën e shlyerjes plus çdo lloj tatimi që mund të jetë në ngarkim:

(i) EUR 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë euro) në lidhje me dëmin jo-material;

(ii) EUR 10.000 (dhjetë mijë euro) në lidhje me kostot dhe shpenzimet;

(b) që nga data e mbarimit të afatit tre mujor të lartë-përmendur deri në shlyerjen e shumave një interes i thjeshtë do të paguhet mbi shumat e mësipërme sipas një kursi të barabartë me normën marginale të huadhënies të Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mospagimit duke i shtuar tre për qind;

3. Rrëzon pjesën e mbetur të pretendimeve të ankuesit për shlyerje të drejtë.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim në 18 dhjetor 2007, në pajtim me rregullin 77 §§ 2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

T.L. EARLY
Regjistruar

Nicolas BRATZA
Kryetar

VENDIM
(Ankimi nr.38222/02)
ÇËSHTJA “RAMADHI DHE TË TJERË KUNDËR SHQIPËRISË”

STRASBURG
13 NËNTOR 2007

Kjo çështje lidhet me mosekzekutimin e vendimeve administrative dhe atyre gjyqësore të brendshme , që janë të formës së prerë dhe trajtojnë të drejtën e ankuesve për kompensimin e parcelave të tokës të konfiskuara gjatë regjimit komunist. Gjykata Evropiane ka konstatuar se ka patur shkelje të Nenit 6.1 të Konventës si pasojë e mosekzekutimit të vendimit të KKK Pronave Kavajë që konfirmonte të drejtat e pronësisë së ankuesve mbi parcelat e tokës, duke kompensuar nje pjesë dhe vendosur kthimin për pjesën tjetër. Gjykata Evropiane gjithashtu konstatoi se nuk ka një afat ligjor të përcaktuar për të kundërshtuar vendimet e komisionit përpara gjykatave kombëtare apo ndonjë mjet efektiv për ekzekutimin e tyre (shkelje e Nenit 13 në lidhje me Nenin 6.1 të Konventës). Gjithashtu Gjykata Evropiane konstatoi se ka patur ndërhyrje të pajustificuar në të drejtën e ankuesve për gëzimin e qetë të pronës së tyre për shkak të mos kompensimit të tyre për parcelën e parë të tokës dhe kthimin e parcelës së dytë të tokës, gjë që i vuri ankuesit në një gjendje pasigurie në aspekt të realizimit të të drejtave të tyre të pronësisë (shkelje e Nenit 1 Protokollit 1 i Konventës).

Në çështjen Ramadhi dhe të tjerë kundër Shqipërisë,

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (seksioni i katërt), me dhomë gjykyesetë përbërë prej:

z. J.CASADEVALL Kryetar

z. G.BONELLO

z. K.TRAJA

z. L.GARLICKI

znj. L.MIJOVIC

z. J.SIKUTA

znj. P.HIRVELA gjykatës

dhe z.T.L.EARLY regjistruer i seksionit,

pas shqyrtimit me dyer të mbyllura në datën 16 tetor 2007, merr në këtë datë vendimin e mëposhtëm:

PROCEDURA

1. Çështja ka filluar në bazë të ankimit (nr.38222/02) kundër Republikës së Shqipërisë drejtuar në Gjykatë, sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (“Konventa”) nga gjashtë shtetas shqiptarë, z. Shyqyri Ramadhi, z. Remzi Kapidani, znj. Rabiye Ramadhi, znj. Xhemile Ramadhi, z. Dilaver Ramadhi dhe z. Nakib Ramadhi (ankuesit), më 9 tetor 2002. Më 1 korrik 2005, pas vdekjes së znj. Xhemile Ramadhi, vajza e saj, znj. Shpresa Idrizi e zëvendësoi në procedimet para Gjykatës.

2. Ankuesit, të cilëve iu siguroa ndihma ligjore, u përfaqësuan nga znj. O. Muçollari, avokate, që e ushtron aktivitetin e saj në Tiranë. Pala shqiptare u përfaqësua nga agjentët e saj, z. S. Puto dhe znj S. Mëneri, nga Ministria e Punëve të Jashtme.

3. Ankuesit pretenduan për shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës, nenit 13 dhe nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës, për shkak se autoritetet shqiptare kishin neglizhuar në zbatimin e vendimeve të dhëna në bazë të Aktit të Pronësisë dhe ligjit të tokës. Gjithashtu, ankuesit pretenduan shkelje të nenit 14 të Konventës të marrë së bashku me nenin 1 të protokollit nr.1.

4. Më 19 maj 2005, Gjykata vendosi t’ia komunikonte ankimin palës shqiptare. Sipas dispozitave të nenit 29 § 3 të Konventës, ajo vendosi pranueshmërinë dhe shqyrtimin në themel të ankimit.

FAKTET

1.RRETHANAT E ÇËSHTJES

5. Ankuesit, të gjithë motra dhe vëllezër, kanë lindur përkatësisht në vitin 1921, 1916, 1927, 1928, 1934 dhe 1943 dhe jetojnë në Kavajë dhe Durrës, Shqipëri.

6. Gjatë regjimit komunist disa parcela toke dhe dy dyqane, pronë e babait të ankuesve u konfiskuan nga autoritetet shqipëtare pa u kompensuar në vlerë. Prona, me një sipërfaqe në total prej 46 000 m² (toka) dhe 150 m² (dyqani) ("prona përkatëse"), ndodhej në zonën e Kavajës.

A. Procedimet sipas Aktit të Pronësisë në lidhje me dyqanet dhe parcelën e tokës me sipërfaqe prej 15 500 m²

7. Në një datë të paspecifikuar, në bazë të ligjit "Për kthimin dhe kompensimin e pronave", (më poshtë referuar si Akti Pronësisë) ankuesit paraqitën një kërkesë në Komisionin e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ("Komisioni") duke kërkuar rikthimin e pronës së tyre.

8. Më 7 qershor 1995 dhe 20 shtator 1996, Komisioni përkatës i Kavajës ua njohu titullin e pronësisë ankuesve si bashkëpronarë të dy dyqaneve dhe të një parcele toke me një sipërfaqe prej 15 500 m². Në pamundësi për t'u kthyer të gjithë pronën e tyre në tërësi, Komisioni vendosi që ankuesit të marrin në pronësi sipërfaqen prej 10 000 m² të tokës, ndërsa për dy dyqanet dhe sipërfaqen prej 5 500 m² ata do të kompensoheshin, sipas ligjit të Pronësisë. Gjithashtu, Komisioni vendosi të mos shqyrtonte kërkesën e ankuesve për sipërfaqen e tokës prej 30 500, pasi duke qenë tokë bujqësore, nuk ishte në juridiksionin e tij sipas Aktit të Pronësisë (Ligji nr.7501, datë 19 korrik 1991).

9. Në një datë të paspecifikuar, në përputhje me vendimin e Komisionit të Kavajës të datës 20 shtator 1996, ankuesit morën në pronësi parcelën e tokës me sipërfaqe prej 10,000 m².

10. Pavarësisht kërkesave të ankuesve, deri tani, autoritetet shqiptare nuk kanë zbatuar vendimet e Komisionit të datës 7 qershor 1995 dhe 20 qershor 1996, përse i përket kompensimit për dy dyqanet dhe parcelën e tokës me sipërfaqe prej 5 500 m².

B. Procedimet sipas Aktit të Pronësisë në lidhje me parcelën e tokës me sipërfaqe prej 30 500 m²

1.Procedimet para Komisionit të Tokës

11. Në një datë të paspecifikuar, ankuesi paraqiti një kërkesë në komisionin vendor për ndarjen e tokës në komunë ose ndërmarrjen bujqësore të Kavajës (më poshtë referuar si "Komisioni i Tokës"), hallkë e bashkisë së Kavajës, duke pretenduar pronësinë e parcelës së tokës me sipërfaqe prej 30 500 m².

12. Më 11 nëntor 1998, Komisioni i Tokës u njohu të drejtën e pronësisë ankuesve Sh. Ramadhi, R. Kapedani dhe R. Ramadhi ("tre ankuesve të parë") dhe hodhi poshtë pretendimet e ankuesve Xh. Ramadhi, D.Ramadhi dhe N.Ramadhi ("tre ankuesit e fundit") me arsyetimin se tre ankuesit e fundit nuk mund të pretendonin pronësinë e tokës bujqësore, përderisa ata nuk ishin banorë (rezidentë) të zonës ku ndodhej toka.

13. Tre ankuesit e parë regjistruan pronën e tyre në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Sipas certifikatës së pronësisë, numrat e titujve të ankuesve përkatësisht 462, 460 dhe 461, u korrespondojnë parcelave të tokës së regjistruar në regjistër përkatësisht me numrat 89/15, 89/16 dhe 89/17.

14. Për më tepër, më 7 prill 1999, Komisioni i Tokës, në bazë të një kërkesë të Ministrisë së Drejtësisë, deklaroi pavlefshmërinë e titujve të pronësisë së tre ankuesve të parë me arsyetimin që vendimi i datës 11 nëntor 1998 binte në kundërshtim me ligjin material.

2.Procedimet gjyqësore

15. Më 25 nëntor 1999 tre ankuesit e parë nisën procedimet në Gjykatën e Shkallës së Parë Durrës, duke pretenduar të drejtat e pronësisë mbi pronën përkatëse.

16. Më 4 shkurt 2000, Gjykata e Shkallës së Parë Durrës prishi vendimin e datës 7 prill 1999 të Komisionit të Tokës dhe vendosi rishqyrtimin (de novo) nga ky Komision, të pretendimeve të tre ankuesve të parë lidhur me njohjen e pronësisë së tokës me sipërfaqe prej 30 500 m². Më 6 mars të vitit 2000 vendimi mori formë të prerë.

3. Procedurat e ekzekutimit

17. Në një datë të paspecifikuar, Gjykata e Shkallës së parë Kavajë lëshoi urdhërekzekutimi për të ekzekutuar vendimin e datës 4 shkurt 2000.

18. Më 14 shkurt 2001, në bazë të dokumentit nr. 151/h, zyra e përmbarimit urdhëroi bashkinë e Kavajës të zbatonte vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë, 4 shkurt 2000.

19. Më 7 maj 2001, me vendimin nr. 366, bashkia e Kavajës vendosi mungesën e juridiksionit lidhur me zbatimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë, me arsyetimin se Komisioni i Tokës së Kavajës, nën jurdiksionin e të cilit ishte kjo çështje, ishte shpërbërë në përputhje me udhëzimin e kryetarit të Bashkisë të datës 8 nëntor 1999.

20. Më 8 janar 2003 në zbatim të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë, u krijua sërish Komisioni i Tokës së Kavajës, i cili konstatoi vlefshmërinë e titujve të pronësisë së tre ankuesve të parë, përkatësisht me numrat 462, 460 dhe 461.

21. Ankuesit pretendojnë se problemi i pronësisë mbetet ende i pazgjidhur, përderisa autoritetet vendore ua kanë transferuar parcelat e lartpërmendura personave të tretë, kështu që vendimi i Komisionit de facto ishte joefektiv. Në bazë të të dhënave të Regjistratit të Pasurive të Paluajtshme, parcelat e tokës të regjistruara përkatësisht me numrat 89/15 dhe 89/16 (korresponduese të titujve të ankuesve nr.462, 460) rezultojnë në pronësi të personave të tretë. Gjithashtu, përsa i përket parcelës së tretë të tokës, e cila i korrespondon titullit me nr.461, ankuesit pretendojnë se në këtë parcelë, persona të tretë kanë kryer ndërtime. Lidhur me këtë, Qeveria pretendoi se ankuesit nuk realizuan regjistrimin e pronës së tyre në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për të marrë pronësinë e tokës në fjalë. Gjithashtu nuk bënë komentuan përsa pretenduan ankuesit në lidhje me transferimin e pronës personave të tretë.

II-LEGJISLACIONI I BRENDSHËM PËRKATËS

A. Kushtetuta

22. Lidhur me çështjen në fjalë, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë parashikon si më poshtë:

Neni 41

1. E drejta e pronës private është e garantuar.
2. Prona fitohet me dhurim, me trashëgimi, me blerje dhe me çdo mënyrë tjetër klasike të parashikuar në Kodin Civil.
3. Ligji mund të parashikojë shpronësime ose kufizime në ushtrimin e së drejtës së pronës vetëm për interesa publikë.
4. Shpronësimet ose ato kufizime të së drejtës së pronës që barazohen me shpronësimin, lejohen vetëm përkundrejt një shpërblimi të drejtë.
5. Për mosmarrëveshjet lidhur me masën e shpërblimit mund të bëhet ankim në gjykatë.

Neni 42

2. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

Neni 142

3. Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore.

Neni 131

Gjykata Kushtetuese vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

1. Kuvendi, brenda dy deri tre vjetëve nga hyrja në fuqi e kësaj Kushtetute, nxjerr ligje për rregullimin e drejtë të çështjeve të ndryshme që lidhen me shpronësimet dhe konfiskimet e kryera para miratimit të kësaj Kushtetute, duke u udhëhequr nga kriteret e parashikuara në nenin 41 të Kushtetutës.

Nenit 41

2. Ligjet dhe aktet e tjera normative të miratuara para datës së hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute dhe që kanë të bëjnë me shpronësimet dhe konfiskimet, do të zbatohen kur nuk vijnë në kundërshtim me të.

B. Ligji për kthimin dhe kompensimin e pronave (Ligji nr.7698 i datës 15 prill 1993, amenduar me ligjet me nr.7736 dhe nr.7765 të vitit 1993, me Ligjet me nr. 7808 dhe nr.7879 të vitit 1994, me Ligjin nr.7916 të vitit 1995, me ligjin nr.8084 të vitit 1996 dhe shfuqizuar me ligjin nr.9235 të datës 29 korrik 2004 dhe së fundi amenduar me ligjin nr 9235 të vitit 2005 dhe ligjin nr. 9853 të vitit 2006)

23. Ligji për kthimin dhe kompensimin e pronës pësoi disa ndryshime gjatë katërmëdhjetë viteve të shkuara. Ndryshimet themelore të ligjit të parë të pronës të vitit 1993 ndodhën si rezultat i dy ligjeve, të cilët hynë në fuqi respektivisht në vitin 2004 dhe në vitin 2006, referuar më poshtë respektivisht si: “Ligji i pronësisë i vitit 1993“, “Ligji i pronësisë i vitit 2004” dhe “Ligji i pronësisë i vitit 2006”. Dispozitat përkatëse të secilit prej këtyre ligjeve përmbledhen si më poshtë vijon:

1. Ligji i pronësisë i vitit 1993

24. Sipas ligjit të vitit 1993 ish-pronarëve të shpronësuar nga regjimi përkatës dhe trashëgimtarëve të tyre ligjorë iu njoh e drejta të pretendonin të drejtën e pronës për pronat e origjinës. Pas njohjes të së drejtës së pronës, ata kishin ose të drejtën e kthimit të saj në natyrë, ose të drejtën e kompensimit në natyrë (jo më shumë 10 000 m²) apo në vlerë, nëse plotësonin kushtet e mëposhtme: prona e pretenduar 1) të ishte në formën e kullotës, livadhit, tokës pyjore, apo tokës bujqësore dhe jobujqësore; 2) të ishte e patrajtuar nga ligji nr.7501, datë 19 korrik 1991; 3) të ishte në pronësi të shtetit; 4) dhe në rast se mund të tjetërsohej në truall duke u përfshirë brenda sipërfaqes së vijave të reja kufizuese ndërtimore të qendrave të banuara. Për ato prona të cilat nuk mund të ktheheshin në natyrë, neni 16 parashikonte mënyrat e mëposhtme të kompensimit: a) me obligacione shtetërore sipas vlerës ekuivalente të pronës, obligacione të cilat do të përdorreshin në versionin e parë për të siguruar aksione në ndërmarrjet shtetërore që po privatizoheshin ose në sipërmarrje të tilla si kredidhënie b) me sipërfaqe trojesh ekuivalente pranë qendrave të banuara në përputhje me planet rregulluese të përgjithshme dhe c) me sipërfaqe ekuivalente në zonat turistike, në përputhje me planet rregulluese të përgjithshme. Këshilli i Ministrave përcaktonte rregullat më të hollësishme për mënyrat dhe afatet e kryerjes së këtyre kompensimeve. Gjithashtu, ligji i vitit 1993 parashikonte krijimin e Komisionit të Kthimit dhe të Kompensimit të Pronave si organi administrativ kompetent për të vendosur mbi pretendimet për kthimin dhe kompensimin e pronave.

25. Për më tepër, ligji i 1993 parashikonte që Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, të ishte struktura administrative kompetente për trajtimin e pretendimeve të ish-pronarëve, lidhur me kthimin dhe kompensimin. Por ky ligj, nuk parashikonte një afat brenda të cilit vendimet mund të apeloreshin, duke sjellë si pasojë, moszbatimin e tyre në praktikë.

2. Ligji i pronësisë i vitit 2004

26. Ligji i pronave i dekretuar në vitin 2004 shfuqizoi ligjin e mëparshëm dhe parashikoi dy forma të kthimit të pronës, kthimin në natyrë të pronës, nëse plotësoheshin disa kushte dhe kompensimin, në rast të pamundësisë nga ana e autoriteteve për të kthyer në natyrë pronën. Ligji nuk parashikonte kufizime për sipërfaqen e pronës që do të kthehej në natyrë. Ligji parashikonte pesë forma kompensimi: a) me një pronë të të njëjtit lloj, b) me një pronë të një lloji tjetër; c) me aksione në kompanitë shtetërore; d) me vlerën e një prone shtetërore në proces privatizimi; e) me një shumë parash, të cilat i korrespondojnë vlerës së pronës në kohën e dhënies së vendimit (neni 11). Ligji krijoi Komitetin Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave, të përbërë prej pesë

anëtarësh të zgjedhur nga Parlamenti. Roli i tij ishte të vendoste lidhur me ligjshmërinë e vendimeve të dhëna mbi pretendimet e kthimit dhe kompensimit të pronave të komisioneve lokale (neni 15 dhe 17). Këshilli i Ministrave duhej të përcaktonte rregulla dhe kritere më të hollësishme në zbatim të këtij ligji (neni 13).

27. Neni 19 parashikonte për vendimet të cilat caktonin kompensim, ekzekutimin e tyre brenda 6 muajve nga fillimi i çdo viti financiar. Me hyrjen në fuqi të ligjit, çdo person që pretendonte kthimin apo kompensimin e pronës së tij duhej t'i drejtohej me anë të një kërkesë komisionit lokal deri më datë 31 dhjetor 2007. Ligji i dha juridiksion komisionit për të vendosur në lidhje me formën e kompensimit, megjithëse çdo person në kërkesën e tij mund të përcaktonte preferencën e vet për mënyrën e kompensimit. Vendimet e komisionit lokal mund të apeloreshin para Komitetit Shtetëror (neni 20) dhe më pas para gjykatave të shkallës së parë brenda 30 ditëve nga dhënia e vendimit të Komitetit Shtetëror.

28. Më 28 prill 2005 Parlamenti miratoi një ligj i cili parashikonte mënyrat e vlerësimit të pronës së paluajtshme, që do të kompensohej. Zbatimi i tij iu la Komitetit Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave, i cili do të hartonte hartat për vlerësimin e pronave.

29. Për zbatimin e vendimeve të Komitetit kur caktohej kompensim në para, neni 23 i ligjit të vitit 2004 parashikonte krijimin e një Fondi për Kompensimin e Pronës për një periudhë 10-vjeçare, qëllimi i të cilit ishte sigurimi i mjeteve financiare për kompensime të tilla. Ligji i vitit 2004 u shqyrtua si nga Gjykata Kushtetuese, ashtu edhe nga Gjykata e Lartë. Më 24 mars 2005, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë konstatuan se ligji i pronësisë i vitit 2004 nuk kishte efekt prapaveprues dhe se në këtë mënyrë dispozitat e tij nuk mund të kishin ndikim mbi të drejtat e pronësisë, të njohura nga vendimet administrative ose gjyqësore, të dhëna para hyrjes së tij në fuqi.

3. Ligji i pronësisë i vitit 2006

30. Më 17 korrik 2006, ligji i pronësisë i vitit 2004 u ndryshua nëpërmjet ligjit të pronësisë së vitit 2006 i cili hyri në fuqi më 17 gusht 2006. Ky ligj parashikonte, ndër të tjera, krijimin e Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, një organ i ri kompetent për të vendosur në lidhje me pretendimet për kthimin dhe kompensimin e pronave (neni 15). Ligji i ri shfuqizoi nenet 11§2; 19 dhe 20 të ligjit të mëparshëm, i cili, ndër të tjera, përcaktonte procedurën për zbatimin e vendimeve që parashikonin kompensim.

E DREJTA

I. SHKELJET E PRETENDUARA TË NENIT 6.1 DHE NENIT 13 TË KONVENTËS

31. Kërkuesit ankohen lidhur me mosekzekutimin nga autoritetet shtetërore të tre vendimeve të formës së prerë të dhëna në favor të tyre. Për më tepër, ata pretenduan mungesën e mjeteve efektive për të mundësuar ekzekutimin e vendimeve të komisionit, që u jepnin atyre të drejtën e kompensimit.

Ata bazoheshin në nenin 6.1 të Konventës, i cili në lidhje me këtë çështje parashikon:

Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile.....çdokush ka të drejtën e një procesi të rregullt brenda një kohe të arsyeshme nga një gjykatë...."

Ata gjithashtu i referoheshin nenin 13 të Konventës, i cili parashikon si më poshtë:

"Çdo person të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e njohura në këtë Konventë, ka të drejtë të paraqesë një ankim efektiv përpara një instance kombëtare edhe kur kjo shkelje ka qenë kryer nga persona që veprojnë brenda ushtrimit të funksioneve të tyre zyrtare".

A. Ekzekutimi i vendimeve të Komisionit, për pagesën e kompensimit lidhur me dyqanet me sipërfaqje 150 m² dhe parcelës së tokës me sipërfaqje 5500 m².

1. Pranueshmëria

a) Parashtrimet e palëve

32. Ankuesit pretendojnë që nëpërmjet vendimit të 7 qershorit 1995 dhe 20 shtatorit 1996, kompensimi i njohur atyre nuk u pagua për një periudhë kohe të tejzgatur.

33. Qeveria e kundërshtoi këtë argument duke parashtruar se garancitë e parashikuara në nenin 6 nuk ishin të zbatueshme për ekzekutimin e vendimeve, të cilat sipas legjislacionit të brendshëm nuk ishin përfundimtare dhe të detyrueshme, siç ishte dhe rasti i vendimeve të Komisionit.

Si rrjedhojë, ankesa duhet konsideruar e papranueshme dhe në mospërputhje me *ratione materiae*.

Më tej Qeveria parashtroi se në rast se gjykata do ta gjente nenin 6 të zbatueshëm, lidhur me sa më sipër, ankesa duhej të konsiderohej si e papranueshme, duke qenë se ankuesit nuk kanë shterruar mjetet e brendshme të ankimit, të parashikuara nga Akti i Pronësisë I 2004, për të kërkuar rivendosjen e së drejtës, së cenuar nga mospagimi i kompensimit për pronën e tyre.

34. Ankuesit kundërshtuan pikëpamjet e Qeverisë, duke parashtruar se legjislacioni i brendshëm parashikonte se vendimet e komisionit, ashtu sikurse vendimet e gjykatës së rrethit, gjeneronin tituj pronësie të detyrueshëm. Më tej parashtruan ankuesit, për mëse 12 vjet këto vendime nuk janë kundërshtuar para gjykatave, pra ato ishin qartësisht përfundimtare. Gjithashtu, Gjykatat vendase kishin përcaktuar që Akti Pronësisë i 2004 nuk kishte fuqi prapavepruese.

Për më tepër, ata ishin të kënaqur nga themeli i vendimeve të Komisionit dhe mjetet e përmendura nga Qeveria ishin të papërshtatshme për t'u ofruar atyre rivendosjen e së drejtës, duke qenë se ato ofronin thjesht një mundësi ankimi kundër vendimeve të Komisionit dhe jo një mjet efektiv për të mundësuar zbatimin e tyre.

b) Vlerësimi i Gjykatës

i) Aplikimi i nenit 6&1

35. Gjykata rithekson se neni 6&1, në fushën civile të tij, aplikohet vetëm kur ekziston një mosmarrëveshje mbi një të "drejtë", që konsiderohet, të paktën, mbi baza të vërtetueshme, si e njohur në të drejtën e brendshme. Kjo e drejtë duhet të jetë e vërtetë dhe serioze. Ajo mund të mos jetë e lidhur vetëm me ekzistencën aktuale të një të drejte, por dhe me qëllimin dhe mënyrën e ushtrimit të saj.

Për më tepër, rezultati i procedimeve duhet të jetë drejtpërdrejt vendimtar për të drejtën civile në fjalë (shih ndër të tjera Frydlander k. Francës, nr. 30979/96, & 27, ECHR 2000-VII).

36. Gjykata vëren që në rastin konkret, nuk është kundërshtuar ekzistenca e një mosmarrëveshjeje mbi një të drejtë të njohur nga legjislacioni vendas, apo që mosmarrëveshja ishte e vërtetë dhe serioze ose që rezultati i procedimeve ishte drejtpërdrejt vendimtar për të drejtën në fjalë. Gjykata, më tej vëren se mosmarrëveshja lidhur me këtë të drejtë, e cila për nga natyra është një e drejtë civile, është një mosmarrëveshjeje ndërmjet shtetit dhe ankuesit, për të përcaktuar të drejtën e tij të pronësisë. Nëpërmjet, vendimeve të Komisionit kompetent për çështjen në fjalë, shteti u njohu të drejtën e kompensimit ankuesve. Pavarësisht se legjislacioni i brendshëm nuk përcaktonte kohën se kur këto vendime do të bëheshin përfundimtare (do të merrnin formë të prerë), Gjykata vëren se për më shumë se 12 vjet, themeli i këtyre vendimeve nuk u kundërshtua para ndonjë gjykate dhe ligjërish, asgjë nuk pengonte ekzekutimin e tyre të menjëhershëm. Si pasojë, Gjykata i konsideron të drejtat që burojnë prej këtyre vendime si të formës së prerë dhe të ekzekutueshme. Përveç kësaj, të drejtat që buronin prej këtyre vendimeve dhe procedurat vijuese të ekzekutimit ishin të lidhura ngushtësisht me njëri-tjetrin (efikasiteti i të parit varet në fund të fundit nga suksesi i të fundit).

37. Gjykata në këtë mënyrë vlerëson që procedimet përpara Komisionit të përshkruara më sipër bien në fushën e zbatimit të nenit 6&1 të Konventës dhe hedh poshtë kundërshtimet e Qeverisë.

ii) Shtërimi i mjeteve të brendshme të vëna në dispozicion nga Akti i Pronësisë 2004.

38. Gjykata përsërit se rregulli i shtërimit të mjeteve të brendshme, i parashikuar në nenin 35&1 të Konventës detyron ankuesit të përdorin mjetet e brendshme që janë zakonisht në dispozicion dhe të mjaftueshme në sistemin e brendshëm ligjor për të mundësuar rivendosjen e së drejtës që pretendohet se është shkelur. Ekzistenca e këtyre mjeteve duhet të jetë e sigurt, si në praktikë edhe teori. Nëse këto kritere nuk përmbushen, këto mjete e humbasin disponueshmërinë (aksesibilitetin) dhe efektivitetin e tyre. Përgjegjësia për të provuar përmbushjen e këtyre kritereve, bie mbi shtetin ndaj të cilit është ngritur pretendimi (shih Vernillo v. France, vendimi i 20 shkurtit 1991, Series A no. 198, pp. 11-12, § 27; Aksoy v. Turkey, no. 21987/93, §§ 51-52, Reports of Judgments and Decisions 1996-VI; and Akdivar dhe të Tjerë v. Turkey, nr. 21893/93, §§ 65-67, Reports 1996-IV).

39. Gjykata vëren se i njëjti argumentim i ngritur nga Qeveria në çështjen Beshiri dhe të tjerë u rrëzua, duke qenë se Qeveria nuk ishte në gjendje të provonte efektivitetin e mjeteve të parashikuara nga Akti i Pronësisë 2004 (shih Beshiri dhe të tjerë të përmendur më sipër, 54-55).

40. Megjithatë, Gjykata vëren se rasti konkret ndryshon nga Beshiri dhe të tjerë, duke qenë se ky i fundit kishte të bënte me ekzekutimin e një vendimi gjyqësor që njihte të drejtën e kompensimit, bazuar në Kodin e Procedurës Civile dhe jo në Aktin e Pronësisë.

41. Gjykata vlerëson që çështja e efektivitetit të procedurave të ekzekutimit është parësore përse i përket themelit të pretendimeve të ankuesit për këtë pjesë. Ajo konsideron se të dyja çështjet duhet të shqyrtohet së bashku me meritat (themelin) e çështjes.

iii) Pranueshmëria e ankesës për nenin 6&1 dhe nenin 13 të Konventës

42. Gjykata konstaton se ankesat në kuadër të këtyre neneve nuk janë haptazi të pabazuara në kuptimin e nenit 35&3 të Konventës. Ajo më tej konstaton se nuk ka bazë për mospranueshmërinë e tyre duke i konsideruar ato si të pranueshme.

2. Meritat (themeli)

a) Parashtrimet e palëve

43. Në opinionin e ankuesit, paaftësia e autoriteteve për të përcaktuar procedurat për të mundësuar ekzekutimin e vendimeve të komisionit ka cenuar të drejtën e tij për të pasur akses në gjykatë, siç parashikohet në nenin 6 dhe ka çuar gjithashtu në shkelje të nenit 13 të Konventës.

44. Qeveria kundërshtoi këtë qëndrim, duke parashtruar se mjetet e brendshme të parashikuara nga Akti i Pronësisë 2004 ishin efektive. Ato kishin qëllim për të gjetur zgjidhje përse i përket rikthimit të pronës dhe dhënies së kompensimit, në përputhje me normat ligjore në fuqi.

b) Vlerësimi i Gjykatës

45. Gjykata rithekson se neni 6.1 i siguron kujtdo të drejtën për t'iu drejtuar një gjykate për çdo lloj pretendimi lidhur me të drejtat dhe detyrimet e tij civile; në këtë mënyrë ky nen mishëron "të drejtën për gjykim", në të cilin aksesin në gjykatë përbën vetëm një aspekt (shih *Golder v. the UK*, vendimi 21 shkurt 1975, Series A nr. 18, pp. 13-18, §§ 28-36; dhe *Osman v. the United Kingdom*, vendim 28 tetor 1998, Reports 1998-VIII, p. 3166, § 136, and p. 3169, § 147).

46. Ndërsa, është e qartë që në rastin konkret ankuesit nuk u penguan për të filluar procedimet për njohjen e të drejtave të tyre të pronësisë sipas Aktit të Pronësisë, kjo nuk është e mjaftueshme, duke qenë se e drejta e aksesit në gjykatë përfshin jo vetëm të drejtën për të filluar një proces, por dhe të drejtën për të siguruar një zgjidhje të mosmarrëveshjes nga një gjykatë. (shih, *mutatis mutandis*, *Kutić v. Croatia*, no. 48778/99, § 25, ECHR 2002-II; *Lungoci v. Romania*, no. 62710/00, § 35, 26 January 2006; dhe *Yanakev v. Bulgaria*, no. 40476/98, § 68, 10 August 2006).

Për më tepër, përcaktimi i të drejtave civile, korrespondon me kohën kur e drejta e njohur bëhet realisht efektive (shih *Di Pede v. Italy* vendim i 26 September 1996, Reports 1996-IV, p. 1384, §§ 22-24, and *Zappia v. Italy*, vendimi i 26 September 1996, Reports 1996-IV, p. 1411, §§ 18-20), pavarësisht nga forma e autoritetit për ta ekzekutuar atë (see *Estima Jorge v. Portugal*, judgment of 21 April 1998, Reports 1998-II, pp. 772-73, §§ 37-38).

47. Megjithatë, thelbi i pretendimeve të ankuesve në kuadër të nenit 6 ka të bëjë me mosekzistencën e mjeteve për të adresuar mosekzekutimin e vendimeve të komisionit që u njohnin të drejtën e kompensimit, bazuar në Aktin e Pronësisë, aspekt për të cilin Gjykata është e mendimit se është më e përshtatshme të shqyrtohet në kuadër të nenit 13.

48. Përse i përket pajtueshmërisë së autoriteteve shtetërore me detyrimin e përgjithshëm të nenit 13 për të siguruar mjete efektive, lidhur me të drejtat e pavarura të garantuara nga Konventa, Gjykata sjell në vëmendje parimet e mëposhtme:

Neni 13 garanton disponueshmërinë në nivel kombëtar të mjeteve që mundësojnë zbatimin e thelbit (substance) të të drejtave dhe lirive të Konventës në çdo formë që ato mund të ndodhë të kërkojnë mbrojtje nga sistemi i brendshëm ligjor i një vendi. Efekti i këtij neni është pra të kërkojë parashikimin e një mjeti të brendshëm, i cili lejon autoritetin kombëtar kompetent, për të përcaktuar njëkohësisht si thelbin e ankimit për shkeljen respektive të Konventës, ashtu dhe sigurimin e një mjeti të përshtatshëm ankimes për të mundësuar rivendosjen e së drejtës, dhe pse palët kontraktuese i lejojnë vetes një lloj diskrecioni, përse i përket mënyrës me anë të së cilës ato sigurojnë

pajtueshmërinë me detyrimet në kuadër të këtij neni (shiko Chahal v Mbretërisë së Bashkuar, vendimi 15 Nëntorit 1996, Reports 1996-V, pp. 1869-70, § 145)

Qëllimi i detyrimit në kuadër të nenit 13 varion në varësi të natyrës së pretendimit të ankuesit (idem fq1870-71 §§ 150 -151). Sidoqoftë, mjeti i kërkuar në kuadër të nenit 13 duhet të jetë “efektiv” si në praktikë ashtu dhe në kuptimin ligjor, veçanërisht në kuptimin që ushtrimi i tij të mos pengohet në mënyrë të pajustificueshme nga veprimet ose mosveprimet e autoriteteve të shtetit respektiv (shih midis të tjerash Aksoy v. Turkey, vendimi 18 dhjetorit 1996, Reports 1996-VI, fq. 2286, § 95 dhe Cobzaru v. Rumanisë, nr. 48254/99, § 80, 26 korrik 2007)”.

49. Gjykata, vëren se, pavarësisht nëse vendimi përfundimtar për t’u ekzekutuar merr formën e një vendimi gjykate ose vendimi të një autoriteti administrativ, legjislacioni i brendshëm dhe Konventa parashikojnë që ai duhet të ekzekutohet. Asnjë masë nuk është ndërmarrë për të ekzekutuar vendimet e Komisionit në favor të ankuesve.

50. Gjykata vëren se asnjë nga Aktet e Pronësisë, apo ndonjë dispozitë tjetër në legjislacionin e brendshëm përkatës, nuk rregullon ekzekutimin e vendimeve të Komisionit. Veçanërisht, Akti i Pronësisë nuk parashikon as ndonjë afat ligjor për ankimimin e vendimeve të Komisionit para gjykatave të brendshme, as ndonjë mjet specifik për ekzekutimin e tyre. Gjykata më tej vëren se Akti i Pronësisë i njeh të drejtën e përcaktimit të formës dhe mënyrës së përshtatshme të kompensimit Këshillit të Ministrave, i cili përcakton rregullat e detajuara dhe metodat për këtë kompensim. Deri tani, asnjë masë e tillë nuk është miratuar (siç përshtatshëm në pjesën e mësipërme “Legjislacioni i brendshëm përkatës”) dhe Qeveria nuk ka dhënë asnjë shpjegim për këtë.

51. Fakti, që autoritetet janë të angazhuara, siç pohon Qeveria, për rikthimin e pronave dhe pagesën e kompensimit të përshtatshëm, kjo nuk ka çuar në ekzekutimin e vendimeve në favor të ankuesve, të paekzekutuar deri më tani përkatësisht prej 12 dhe 11 viteve. Për më tepër, Qeveria nuk ka paraqitur ndonjë provë për marrjen e ndonjë mase të menjëhershme.

52. Vlerësimet e mësipërme janë të mjaftueshme për t’i mundësuar Gjykatës të konkludojë që duke mos ndërmarrë masat e nevojshme për të siguruar mjetet për ekzekutimin e vendimeve të komisionit, ankuesit u privuan nga e drejta e tyre për një mjet të brendshëm efektiv, i cili do t’u mundësonte sigurimin e zbatimit të së drejtës së tyre civile për kompensim. Për këto arsye, Gjykata hedh poshtë kundërshtimet e Qeverisë.

B. Ekzekutimi i vendimit të gjykatës së rrethit për parcelën e tokës, me sipërfaqe 30 500 m².

1. Pranueshmëria.

a) Parashtrimet e palëve

54. Ankuesit pretendojnë për shkelje të nenit 6&1 duke qenë se autoritetet shtetërore nuk kanë qenë në gjendje për të siguruar ekzekutimin në praktikë të vendimit të gjykatës së rrethit të Kavajës, të 4 shkurtit 2000 që vendosi nxjerrjen e një vendimi mbi të drejtat e tyre të pronësisë. (shih paragrafin 16 më sipër).

55. Qeveria kundërshtoi argumentet e ankuesve, duke parashtruar se vendimi i Gjykatës së Rrethit Kavajës i 4 shkurtit 2000 është ekzekutuar në 8 janar 2003, kur komisioni i tokës nxori një vendim lidhur me titullin e tyre përkatës të pronësisë. Për më tepër, Qeveria parashtrroi se ankuesve u mungonte statusi i viktimës, duke qenë se ata nuk kanë ndërmarrë masat e nevojshme administrative për të regjistruar të dhënat e titujve të tyre në regjistrin e pasurive të paluajtshme dhe në këtë mënyrë nuk mund të pretendojnë zotërimin e pronës. Sipas, Qeverisë, ankuesit gjithashtu nuk kanë qenë në gjendje të provojnë që pronat e akorduara ndaj tyre u janë shitur personave të tretë dhe nëse është kështu ata nuk e kanë paraqitur këtë çështje para gjykatave të brendshme.

b) Vlerësimi i Gjykatës

56. Gjykata vëren se pretendimet e ankuesve në këtë drejtim kanë të bëjnë me mosekzekutimin e vendimit të gjykatës së rrethit të 4 shkurtit 2000. Duke qenë se vetëm tre ankuesit e parë kanë qenë palë në këtë proces, Gjykata vlerëson që tre ankuesit e fundit nuk kanë provuar që ata mund të pretendojnë të jenë “viktima” për mosekzekutimin e vendimit të sipërpërmendur.

57. Për më tepër, Gjykata konstaton se kundërshtimet e Qeverisë lidhur me statusin e “viktimës” së tre ankuesve të parë ka të bëjë me themelin e ankimit të tyre dhe këto çështje duhet të shqyrtohen së bashku me themelin.

58. Nga kjo rrjedh, që pretendimi i tre ankuesve të fundit është i papajtueshëm *ratione personae* me parashikimet e Konventës në kuptimin e nenit 35&3, dhe për këtë arsye e papranueshme sipas nenit 35&4 të Konventës. Pretendimi i tre ankuesve të parë nuk është haptazi i pabazuar në kuptimin e nenit 35&3 të Konventës. Më tej ajo konstaton se nuk ka arsye për të mos e konsideruar si të papajtueshme, kështu ajo duhet të deklarohet e pranueshme.

2. Meritat (themelin)

a) Parashtrimet e palëve

59. Tre ankuesit e parë parashtruan se për më tepër se 7 vjet, vendimi i Gjykatës së rrethit i 4 shkurtit 2000 nuk është ekzekutuar.

60. Qeveria argumentoi se autoritetet nuk mund të ishin përgjegjëse për mosekzekutimin e vendimit të sipërpërmendur duke qenë se ekzekutimi i tij varej nga marrja e masave të nevojshme nga ankuesit, konkretisht duke kërkuar regjistrimin e të dhënave të titujve të tyre të pronësisë në regjistrin e tokës.

b) Vlerësimi i Gjykatës

61. Parimet e përgjithshme lidhur me mosekzekutimin e vendimeve të formës së prerë janë përcaktuar në vendimin Beshiri dhe të tjerë (përmendur më sipër paragrafi 60).

62. Gjykata vëren se në 4 shkurt 2000 Gjykata e rrethit vendosi nxjerrjen e një vendimi të ri për pretendimet lidhur me të drejtën e pronësisë së tre ankuesve të parë. Në 8 janar 2003, pas 2 vitesh mosveprimi, Komisioni i tokës la në fuqi titujt e pronësisë për tre parcelat e tokës (shih paragrafin 14 më sipër), që nga ajo kohë toka u vu në zotërim të personave të tretë. Ky argument mbështetet dhe nga evidencat e regjistrit të tokës, të paraqitura nga ankuesit. Qeveria nuk ka dhënë komente lidhur me këto evidenca dhe nuk paraqiti asnjë informacion që të provonte të kundërtën.

63. Duke konstatuar se shteti nuk ka arritur të provojë efektivitetin e mjeteve juridike përkatëse (shih paragrafin 55 më sipër) dhe duke vërejtur që të drejtat e tre ankuesve të parë duket se janë shumë larg nga realizimi i tyre, gjykata konstaton se autoritetet shtetërore nuk kanë qenë në gjendje të ekzekutojnë vendimin e gjykatës së rrethit të 4 shkurtit 2000. Ajo kështu hedh poshtë kundërshtimet e Qeverisë (paragrafi 57 më sipër).

64. Për këto arsye, ka pasur shkelje të nenit 6 §1 të Konventës, përse i përket tre ankuesve të parë.

II. SHKELJET E PRETENDUARA TË NENIT 1 TË PROTOKOLLIT 1 TË KONVENTËS

65. Ankuesit pretendojnë për një shkelje të të drejtave të tyre të pronësisë për pronën përkatëse. Ata bazohen në nenin 1 të protokollit 1 të Konventës i cili parashikon:

“Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën që t’i respektohet pasuria e tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Megjithatë dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e shteteve për të nxjerrë ligje, që ato i gjykojnë të domosdoshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve të tjera ose të gjobave.”

66. Qeveria e kundërshtoi këtë argument.

A. Pranueshmëria.

67. Gjykata rithekson se “pasuritë” mund të jenë “pasuri ekzistuese” ose “asete”, përfshirë në disa raste të përcaktuara qartë, edhe pretendimet. Në mënyrë që një pretendim të konsiderohet “aset” në përputhje me nenin 1 të protokollit nr.1, duhet që pretenduesi të provojë se në legjislacionin vendas ekziston një bazë e mjaftueshme, si për shembull ekzistenca e një praktike të konsoliduar të gjykatave vendase në mbështetje të këtij pretendimi ose kur ekziston një vendim gjyqësor i formës së prerë në favor të pretendimeve të ankuesit. Kur kjo arrihet të provohet, hyn në veprim koncepti i “pritshmërisë së ligjshme” (shiko *Dragon v. France* [GC], nr. 1513/03, § 68, 6 tetor 2005, ECHR 2005-IX).

68. Gjykata vëren se ankesa është e lidhur me pretendimet e trajtuara në kuadrin e nenit 6 § 1, përsa i përket mosekzekutimit nga ana e autoriteteve shtetërore të vendimeve të dhëna në favor të ankuesve.

69. Duke qenë se gjykata i ka deklaruar të papranueshme pretendimet e tre ankuesve të fundit, përsa i përket mosekzekutimit të vendimit të 4 shkurtit 2000, këta ankues nuk kanë pasur një “pritshmëri të ligjshme”, të bazuar as në dispozitat e ligjit të tokës, as në vendimet e dhëna përsa i përket pretendimit të tyre për kthimin e parcelës së tokës me sipërfaqe 30.500 m². Rrjedhimisht, pretendimet e tre ankuesve të fundit lidhur me vendimin e 4 shkurtit janë të papajtueshme *ratione materiae* me parashikimet e Konventës, në kuptimin të nenit 35§3 dhe duhet të hidhen poshtë në përputhje me nenin 35§4.

70. Megjithatë, pretendimet e tre ankuesve të parë në kuadër të nenit 1 të protokollit nr.1, përsa i përket mosekzekutimit të vendimit të 4 shkurtit 2000 dhe të gjitha pretendimet e ankuesve përsa i përket mosekzekutimit të vendimeve të Komisionit të 1995 dhe 1996 nuk janë haptazi të pabazuara, në kuptimin e nenit 35§3 të Konventës.

71. Në këtë kuadër, Gjykata vëren se duke qenë se pronat përkatëse të ankuesve ishin shtetëzuar, bazuar në Aktin e Pronësisë, ligjin e tokës dhe vendimet e dhëna në favor të tyre, ata kanë një pretendim për kompensim në natyrë dhe vlerë monetare, i cili është i përcaktuar qartë në legjislacionin e brendshëm. Në kohën e vendimeve të 7 qershorit 1995 dhe 20 shtatorit 1996, ankuesve iu njoh e drejta e kompensimit financiar, në përputhje me Aktin e Pronësisë, dhe që në momentin e vendimit gjyqësor të 4 shkurtit 2000, tre ankuesve të parë iu njoh e drejta e kthimit të pronës së origjinës, në përputhje me ligjin e tokës. Në këto rrethana, gjykata vlerëson se pretendimet e ankuesve janë mjaftueshmërisht të bazuara për t’u cilësuar si “aset”, për qëllimet e nenit 1 të protokollit 1. Gjykata më tej vëren se pretendimet e tyre nuk janë të papranueshme mbi ndonjë bazë tjetër dhe për këtë arsye duhet të deklarohen të pranueshme.

B. Meritat (themeli)

1. Parashtrimet e palëve

72. Pala shqiptare kundërshtoi aplikimin e garancive të këtij neni, për vendimet e Komisionit dhe vendimin e gjykatës në çështjen konkrete, duke qenë se ankuesit duhet ta kishin ngritur këtë problem, përpara autoriteteve kompetente, në përputhje me Aktin e Pronësisë 2004. Qeveria pretendoi se mosekzekutimi i vendimeve të Komisionit, që u njihte kompensimin ankuesve, kishte ardhur si pasojë e rrethanave objektive, si mungesa e fondeve dhe interesi i përgjithshëm i komunitetit.

73. Lidhur me parcelën e tokës 30 500 m², pala shtetërore parashtroi se shteti nuk mund të konsiderohet përgjegjës për moskryerjen e veprimeve të nevojshme nga ana e ankuesit në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme e ankuesit për të marrë në zotërim pronën që u ishte caktuar atyre. Në parashtrimet e palës shqiptare, kjo do të kishte qenë e vetmja mënyrë për të përfituar nga mbrojtja e Konventës dhe do t’i mundësonte ankuesve të drejtën për të pretenduar cenimin e së drejtës së pronësisë në kuadrin e nenit 1 të protokollit 1.

74. Ankuesit kundërshtuan argumentet e Qeverisë, duke pretenduar se ato ishin të pabazuara. Ata parashtruan se të drejtat e tyre të pronësisë ishin ende të pabaralizuara pas një periudhe kohe shumë të gjatë.

2. Vlerësimi i Gjykatës

75. Gjykata rikujton se neni 1 i protokollit 1 përfshin tre rregulla të veçanta: rregulli i parë, i përcaktuar në fjalinë e parë të paragrafit të parë, është i një natyre të përgjithshme dhe shpreh parimin e gëzimit të qetë të pronës; rregulli i dytë i përcaktuar në fjalinë e dytë të paragrafit të parë, mbulon privimin e posedimit dhe e kufizon atë, vetëm në disa rrethana të caktuara; rregulli i tretë, i vendosur në paragrafin e dytë, parashikon që shtetet palë në Konventë, përveç të tjerash duhet të kontrollojnë përdorimin e pronës, në përputhje me interesin e përgjithshëm (shih ndër të tjera, *Pressos Compania Naviera S.A. and Others v. Belgium*, vendim i 20 nëntorit 1995, Series A no. 332, § 33, dhe *Draon*, përmendur më sipër, § 69).

76. Në rastin konkret, Gjykata vëren se ndërhyrja në të drejtën e ankuesve për gëzimin e posedimeve të tyre, rrjedh nga zvarritja e realizimit të pagesës së kompensimit financiar, i cili ishte

parashikuar nga vendimet e komisionit dhe për t'u rikthyer tre ankuesve të parë pronën për të cilën atyre u ishte njohur e drejta e pronësisë nga komisioni i tokës.

77. Gjykata vëren se në jurisprudencën e saj, ajo ka shqyrtuar mosekzekutimin e një vendimi që njeh një titull pronësie, në kuadrin e fjalisë së parë të nenit 1 protokollit 1 (shiko *Burdov v. Russia*, nr. 59498/00, § 40, ECHR 2002-III, *Jasiūnienė v. Lithuania*, nr. 41510/98, § 45, 6 Mars 2003; *Sabin Popescu v. Romania*, nr. 48102/99, § 80, 2 Mars 2004; dhe *Beshiri dhe të Tjerë*, i cituar më sipër § 99). Rrethanat e çështjes konkrete janë të ngjashme me ato të çështjeve të sipërpërmendura dhe për këtë arsye, ndërhyrja duhet trajtuar në kuadrin e fjalisë së parë të paragrafit të parë të nenit 1 protokollit 1, i cili përcakton parimin e gëzimit të qetë të pronës në terma të përgjithshme.

78. Gjykata, si rrjedhojë duhet të përcaktojë nëse është vendosur një raport i drejtë midis kërkesave të interesit të përgjithshëm të komunitetit dhe kritereve të mbrojtjes së të drejtave themelore të individit. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata duhet të përcaktojë nëse koha e nevojshme për autoritetet shtetërore për t'u paguar ankuesve kompensimin dhe për t'u kthyer tre ankuesve të parë pronat, për të cilat atyre u ishte njohur e drejta, e ka prishur këtë raport dhe nëse ajo (koha) ka vendosur një pengesë të "pajustificuar" mbi ta.

79. Gjykata rikujton se shteti ka një hapësirë të gjerë vlerësimi për të përcaktuar se cili është interesi i përgjithshëm, veçanërisht kur bëhet fjalë për kompensim për shkak të shtetëzimit ose shpronësimit, duke qenë se legjislacioni i brendshëm ka një diskrecion të gjerë në zbatimin e politikave ekonomiko-shoqërore.

Megjithatë, kjo hapësirë vlerësimi nuk është e pakufizuar dhe përdorimi i saj është objekt rishikimi nga mekanizmat e Konventës. (shih *Lithgoë dhe të tjerë v. the United Kingdom*, vendim i 8 korrikut 1986, Series A no. 102, pp. 50-51, §§ 121-22).

80. Në çështjen në fjalë, kanë kaluar 12 dhe 11 vjet respektivisht nga nxjerrja e vendimeve të Komisionit të 1995 dhe 1996, pa iu mundësuar ankuesve pagimin e kompensimit. Për më tepër, situata që rezulton si pasojë e shitjes së pronës përkatëse (sipërfaqje 30 500 m²) dhe vendimi i komisionit të tokës i 8 janarit 2003 pati efektin e privimit të ankuesve nga përfitimet e ekzekutimit të këtij vendimi (paragrafi 63 më sipër).

81. Gjykata vlerëson se mosekzekutimi i vendimeve të komisionit të 1995 dhe 1996 dhe të gjykatës së rrethit të 4 shkurtit 2000, kanë krijuar për ankuesin një gjendje pasigurie lidhur me realizimin e të drejtave të tij të pronësisë. Për më tepër, për një periudhë kohe të konsiderueshme, autoritetet i penguan ata nga gëzimi i përfuturit të mirave materiale dhe përdorimi i tokës.

82. Pala shtetërore parashtrroi se megjithë angazhimin i autoriteteve administrative për të zbatuar Aktin e Pronësisë dhe të Tokës, procedurat ishin shumë komplekse, pasi autoritetet duhet të shpreheshin lidhur me përcaktimin e mënyrës dhe fondeve për të përmbushur detyrimet e tyre, që rezultonin nga këto Akte. Duke pasur parasysh që nuk ekzistojnë rregulla të qarta ligjore në të drejtën e brendshme lidhur me llogaritjen e kompensimit ose ndonjë procedurë tjetër e ngjashme për të ekzekutuar vendimet e komisionit lidhur me kompensimet (shih paragrafin 24 më sipër), Gjykata nuk e vlerëson këtë argument, si shumë bindës, duke mbajtur në konsideratë faktin se ishte pikërisht mosveprimi i autoriteteve që shkaktoi "ndërhyrje" lidhur me çështjen në fjalë. Në çdo rast, ankuesit nuk duhet të pengoheshin të përfitonin nga zgjidhja me sukses e mosmarrëveshjes, në favor të tyre, mbi bazën e vështirësive të pretenduara, që po kalonte shteti (shiko *mutatis mutandis Jeličić v. Bosnia dhe Herzegovina*, nr. 41183/02, § 42, ECHR 2006-...).

83. Si përfundim, pala shqiptare nuk ka paraqitur ndonjë provë bindëse për të justifikuar mospërcaktimin për një kohë kaq të gjatë të shumës përfundimtare të kompensimit dhe moskthimin ndaj tre ankuesve të parë dhe parcelës së tokës, që tashmë është në zotërim të të tretëve. Kjo rezulton në një ndërhyrje në të drejtën e pronësisë të ankuesve, që në këndvështrimin e Gjykatës, është e tillë sa ka vendosur një pengesë të pajustificuar mbi ta.

84. Duke vlerësuar të gjitha rrethanat, Gjykata çmon se ka pasur shkelje të nenit 1 të protokollit 1, lidhur me çështjen e kompensimit për të gjithë ankuesit dhe, përsa i përket tre ankuesve të parë, edhe lidhur me çështjen e rikthimit të pronës.

III. SHKELJE TË TJERA TË PRETENDUARA TË KONVENTËS

85. Së fundmi, tre ankuesit e fundit pretenduan se gjykatat vendase i kanë diskriminuar mbi bazën e residencës së tyre, në shkellje të hapur të të drejtave të tyre të pronësisë. Ata u mbështetën në nenin 14 të Konventës, marrë së bashku me nenin 1 të protokollit Nr.1.

86. Pala shqiptare e kundërshtoi këtë argument.

87. Gjykata vëren se në vendimin e tij të 11 nëntorit 1998, komisioni i tokës i hodhi poshtë pretendimet e tre ankuesve të fundit me arsyetimin se ata nuk ishin rezidentë në zonën ku gjendej prona që ata pretendonin. Ankuesit nuk apeluan ndaj këtij vendimi.

88. Gjykata çmon se mosparaqitja e çështjes së diskriminimit të tyre para gjykatave vendase, ankuesit nuk kanë ezauruar mjetet e brendshme të ankimit për qëllimet e nenit 35 § 1. Si rrjedhojë, ky ankim duhet të hidhet poshtë në përputhje me nenin 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës.

IV. ZBATIMI I NENEVE 46 DHE 41 TË KONVENTËS

A. Neni 46 i Konventës

89. Neni 46 i Konventës parashikon:

1. Palët e larta kontraktuese angazhohen t'iu binden vendimeve përfundimtare të Gjykatës në mosmarrëveshjet në të cilat ato janë palë. 2. Vendimi përfundimtar i transmetohet Komitetit të Ministrave, i cili monitoron zbatimin e tij.

90. Gjykata vëren se në përfundimet e mësipërme të saj, del qartë se cënimi i të drejtave të ankuesve të garantuara nga neni 6 § 1 i Konventës dhe neni 1 i Protokollit nr.1 vjen nga një problem i përhapur që ndikon mbi një numër të madh njerëzish, konkretisht nga pengesa e pajustificueshme e së drejtës së tyre për një gëzim të qetë të pronës së tyre, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit të Komisionit, të cilat caktonin kompensim në përputhje me Aktin e Pronësisë. Në të vërtetë, ka tashmë dhjetëra ankime identike në Gjykatë. Përshkallëzimi i numrit të kërkesave është një faktor rëndues përse i përket përgjegjësisë së shtetit në bazë të Konventës, dhe është një kërcënim për efikasitetin në të ardhmen e sistemit të vendosur nga Konventa, kështu që sipas këndvështrimit të Gjykatës, vakumi ligjor i konstatuar në çështjen konkrete të ankimuesit, mund t'i japë jetë një numri të shumë kërkesash të tjera të bazuara.

91. Përpara shqyrtimit të pretendimeve individuale të ankuesit për zhdëmtim të drejtë sipas nenit 41 të Konventës dhe duke pasur parasysh rrethanat e çështjes konkrete, Gjykata dëshiron të marrë në konsideratë pasojat që rrjedhin nga neni 46 për shtetin e paditur. Gjykata rithekson se, sipas nenit 46, shtetet kontraktuese duhet t'u binden vendimeve përfundimtare të Gjykatës në mosmarrëveshjet në të cilat ata janë palë, mbikëqyrja e ekzekutimit të të cilave është në kompetencë të Komitetit të Ministrave. Një ndër efektet e këtij neni është që aty ku Gjykata konstaton shkellje, shteti i paditur ka detyrimin ligjor jo vetëm për t'u paguar personave përkatës shumat e përcaktuara, për një dëmshpërblim të drejtë, në bazë të nenit 41, por duhet të përzgjedhë dhe masat e përgjithshme dhe/ose kur është e përshtatshme masat e veçanta që duhet të adoptohen nga legjislacioni i brendshëm, për t'i dhënë fund shkelljes së konstatuar nga Gjykata dhe të mënjanojë sa të jetë e mundur efektet. Kjo përzgjedhje lidhur me masat që shteti duhet të ndërmarrë është objekt monitorimi nga Komiteti i Ministrave. Autoritetet kombëtare kanë detyrimin të ndërmarrin-me fuqi prapavepruese nëse është e mundur-(shiko midis të tjerave Scordino v. Italy (nr. 1) [GC], nr. 36813/97, § 233, ECHR 2006 dhe Bronioëski v. Poland [GC], no. 31443/96, § 192, ECHR 2004-V; Bottazzi v. Italy [GC], nr. 34884/97, § 22, ECHR 1999-V, Di Mauro v. Italy [GC], nr. 34256/96, § 23, ECHR 1999-V), masat e nevojshme për rivendosjen e së drejtës së shkelur, në përputhje me parimin e subsidiaritetit të Konventës, në mënyrë të tillë që Gjykata të mos rigjejë shkellje në një seri të gjatë rastesh të ngjashme. Këto masa, gjithashtu i nënshtrohen monitorimit nga Komiteti i Ministrave.

92. Në këtë kuadër, si pjesë e masave të përcaktuara për të garantuar efektivitetin e mekanizmit të krijuar nga Konventa, Gjykata tërheq vëmendjen lidhur me Rezolutën (Res(2004)3) dhe Rekomandimin Rec(2004)6 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës, të dyja të miratuara në 12 maj 2004.

93. Në teori nuk është Gjykata që duhet të përcaktojë se cilat mund të jenë masat e duhura për korrigjimin e situatës, në mënyrë që shteti i paditur të veprojë në përputhje me detyrimet e tij

sipas nenit 46 të Konventës. Megjithatë, shqetësimi i Gjykatës është të lehtësojë ndikimin e pasojave të keqfunksionimit të hasur në sistemin kombëtar të mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Në këtë kontekst duke iu referuar edhe gjendjes së konstatuar më sipër, (shiko paragrafin 90 më sipër), Gjykata çmon se masa të përgjithshme në shkallë kombëtare duhet të ndërmerren padyshim në ekzekutimin e vendimit aktual.

94. Me qëllim për të asistuar në zbatimin e detyrimeve sipas nenit 46 nga shteti i paditur, Gjykata u përpoq të tregonte llojin e masave që shteti shqiptar mund të ndërmarrë për t'i dhënë fund natyrës dhe shkaqeve të shkeljeve të gjetura në çështjen në fjalë. Ajo vlerëson se shteti i paditur duhet para së gjithash të parashikojë një mjet juridik që të sigurojë një korrigjim të vërtetë dhe efektiv për shkeljet e identifikuara të Konventës në gjykimin në fjalë, si dhe lidhur me gjithë ankimet e ngjashme në pritje, në përputhje me parimet për mbrojtjen e të drejtave të parashikuara në nenin 6 § 1 dhe 13 të Konventës dhe nenit 1 të protokollit nr.1. Duke parashikuar mjetin e duhur, shteti duhet, *inter alia* të caktojë organin kompetent, të përcaktojë rregullat procedurale, të sigurojë zbatimin e këtyre rregullave në praktikë dhe të evitojë të gjitha pengesat për dhënien e kompensimit sipas Aktit të Pronësisë. Këto objektiva mund të arrihen duke marrë masat e duhura ligjore, administrative dhe buxhetore. Këto masa duhet të përfshijnë hartimin e hartave për vlerësimin e pronës, për ankuesit të cilëve u është dhënë e drejta të marrin kompensim në natyrë, si dhe përcaktimin e një fondi të përshtatshëm, për ankuesit, të cilëve u është dhënë e drejta të marrin kompensim në vlerë, e gjithë kjo për t'u mundësuar të gjithë kërkuesve të kenë një vendim gjyqësor të suksesshëm në favor të tyre, i cili i kompenson ata sipas Aktit të Pronësisë, për të marrë sa më shpejt shumën ose tokën e caktuar. Këto masa duhet të trajtohen si çështje urgjente.

B. Neni 41 i Konventës

95. Neni 41 i Konventës parashikon:

Kur Gjykata deklaron shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj, dhe në qoftë se e drejta e brendshme e palës së lartë kontraktuese mundëson vetëm një mënjanim të pjesshëm të pasojave që kanë rrjedhur nga kjo shkelje, Gjykata, kur ka vend, i cakton palës së dëmtuar, një shpërblim të drejtë.

1. Dëmi

96. Përsa i përket dëmit material, ankuesit kërkuan 590 000 euro për parcelat e tokës me një sipërfaqe totale prej 36 000 m katror dhe 65 500 euro për dyqanet. Në përlllogaritjen e shumave të mësipërme, ankuesit patën parasysh vlerën aktuale të tregut të pronave, pra 2 000 euro për metër katror për tokën dhe 2 200 euro për metër katror për dyqanet. Gjithashtu ata e lanë në çmimin e Gjykatës të vendoste normën e interesit për periudhën gjatë së cilës autoritetet nuk mundën t'u paguanin atyre kompensimin. Së fundmi, aplikantët kërkuan 12 000 euro për dëmin jomaterial.

97. Pala shqiptare i kundërshtoi pretendimet e ankuesve, por nuk paraqiti ndonjë argument lidhur me shumat e pretenduara nga ankuesit. Megjithatë ata konfirmuan angazhimin e tyre për gjetjen e një zgjidhjeje për problemin e rikthimit të pronës dhe pagesën e kompensimit në përputhje me dispozitat përkatëse statutoare. Në këto rrethana, Pala shtetërore i kërkoi Gjykatës të vendoste nëse vetë konstatimi i shkeljes do të përbënte në vetvete një shpërblim të drejtë.

98. Gjykata përsërit se një gjykim në të cilin konstatohet një shkelje, ngarkon shtetin e paditur me një detyrim ligjor për t'i dhënë fund shkeljes dhe të mënjanojë pasojat e saj në atë mënyrë që ta kthejë situatën në gjendjen e mëparshme (shiko ish-mbreti i Greqisë dhe të tjerët v. Greqisë [GC] (just satisfaction), no. 25701/94, § 72. Nëse legjislacioni i brendshëm mundëson vetëm riparim të pjesshëm të dëmit, neni 41 i Konventës i jep Gjykatës kompetencë për të kompensuar palën e dëmtuar për veprimin apo mosveprimin që shkaktoi konstatimin e shkeljes. Gjykata gëzon një lloj diskrecioni në ushtrimin e kësaj kompetence, ashtu sikurse dëshmon edhe kushti “i drejtë” dhe fraza “nëse është e nevojshme”.

99. Midis çështjeve që Gjykata merr parasysh kur vlerësohet kompensimi, janë dëmi pasuror, domethënë, humbja aktualisht e shkaktuar si rezultat i drejtpërdrejtë i shkeljes së pretenduar dhe dëmi jopasuror, domethënë kompensimi për ankthin, vështirësitë dhe pasigurinë e shkaktuar nga shkelja dhe dëme të tjera jopasurore (shih, midis autoriteteve të tjera, Ernestina Zullo v. Italy, Nr 64897/01, § 25, 10 nëntor 2004). Për më tepër, nëse një ose më shumë kategori specifike të dëmit

nuk mund të llogariten saktësisht, ose nëse dallimi midis dëmit pasuror dhe jopasuror duket i vështirë, Gjykata mund të vendosë të bëjë një vlerësim total (shih *Comingersoll v. Portugal* [GC], No 35382/97, § 29, ECHR 2000-IV).

100. Gjykata më tej rikujton se forma më e përshtatshme e kompensimit lidhur me rivendosjen e së drejtës së shkelur në kuadër të nenit 6 është të sigurojë që ankuesi, për sa është e mundur të vihet në pozicionin, që ai ose ajo do të kishte qenë nëse kërkesat e nenit 6 do të ishin respektuar. (shih *Teteriny v. Russia*, nr. 11931/03, § 56, 30 qershor 2005). Duke pasur parasysh natyrën e shkeljes së konstatuar, Gjykata çmon se ankuesit kanë pësuar një dëm të konsiderueshëm pasuror dhe jopasuror, si pasojë e cenimit të të drejtave të tyre të njohura nga Konventa, arsye kjo pse vetëm konstatimi i shkeljes nuk mund të përbëjë një shpërblim të drejtë në kuptimin e nenit 41.

101. Duke pasur në konsideratë konstatimet e saj, në vendimet e marrë së fundmi, nga Gjykata, në të cilat ajo ka parashtruar që autoritetet shqiptare duhet të marrin masa të përshtatshme për të ekzekutuar vendimet e formë së prerë (shih *Qufaj Co. sh.p.k.*, të përmendur më sipër, § 54-59, dhe gjithashtu, *Beshiri dhe të Tjerë*, i sipërpërmendur, § 109), si dhe duke pasur parasysh se autoritetet shtetërore nuk kanë marrë masat e përshtatshme, të sugjeruara në gjykimet e fundit të sipërcituara, për të siguruar mjetet e nevojshme që do të mundësonin ekzekutimin e vendimeve të kompensimit, Gjykata çmon se nuk i mbetet mundësi tjetër, përveçse të caktojë një shpërblim i cili do të përbëjë një rregullim të plotë dhe përfundimtar të problemit të pronësisë (shih, midis autoriteteve të tjera *Plotnikov v. Russia*, nr. 43883/02, § 33, 24 shkurt 2005 dhe *OOO Rusatommet v. Russia*, nr.61651/00, § 33, 14 qershor 2005).

102. Gjykata çmon se, në rrethanat e çështjes në fjalë, kthimi i parcelës së tokës, me sipërfaqe 30 500 m², sipas vendimit të komisionit të tokës së 8 janarit 2003 dhe pagesa e kompensimit, e cila i korrespondon vlerës së parcelës së tokës, me sipërfaqe 5 500 m² dhe 150 m², në kohën e vendimit, duke përfshirë edhe shkallën e interesit që pasqyron ndërhyrjen, pasojë e së cilës ishte humbja e pronësisë dhe përdorimit të parcelës së tokës, do t'i vendosnin tre ankuesit e parë dhe të gjithë ankuesit e tjerë, aq sa është e mundur, në një situatë të njëjtë me atë në të cilën do të kishin qenë, ata po të mos kishim shkelje të Konventës.

103. Duke marrë në konsideratë, se nga materialet që disponon dhe nga fakti që autoritetet shtetërore nuk kanë parashtruar ndonjë kundërshtim mbi metodat e llogaritjes së kompensimit, të paraqitura nga ankuesit, si dhe duke bërë një vlerësim të drejtë, Gjykata u cakton bashkërisht të gjithë ankuesve një shumë totale prej 64 000 euro, për dëmin pasuror dhe jopasuror, lidhur me parcelën e tokës me sipërfaqe 5 500 m² dhe 150 m².

104. Më tej, ajo u cakton tre ankuesve të parë një shumë totale prej 25 000 euro së bashku me kthimin e parcelës së tokës me sipërfaqe 30 500 m². Në rast të moskthimit të parcelës së tokës nga shteti, brenda tre muajve nga data që ky vendim bëhet përfundimtar, Gjykata vendos që shteti duhet tu paguajë së bashku tre ankuesve të parë, një shumë prej 120 000 euro për dëmin pasuror dhe jopasuror, lidhur me këtë pronë.

Kostot dhe shpenzimet

105. Ankuesit që morën 824 euro për ndihmë ligjore nga Këshilli i Europës, lidhur me paraqitjen e çështjes së tyre kërkuar 2 800 euro dhe 2 500 euro përkatësisht për kostot dhe shpenzimet para gjykatave kombëtare dhe para Gjykatës. Ata nuk paraqitën ndonjë analizë të detajuar për vërtetimin e pretendimeve të tyre për kostot dhe shpenzimet para gjykatave kombëtare.

106. Pala shqiptare i kundërshtoi pretendimet e tyre.

107. Bazuar në jurisprudencën e Gjykatës, një ankues ka të drejtë të rimbursohet për kostot dhe shpenzimet vetëm nëse vërtetohet se ato janë paguar realisht, kanë qenë të nevojshme të paguheshin dhe kanë qenë të arsyeshme për sa i përket sasisë.

108. Në çështjen në fjalë, duke konsideruar informacionin e ofruar dhe kriteret e mësipërme, Gjykata vlerëson se është e arsyeshme të caktojë shumën 1 676 euro, përveç shumës së dhënë nga Këshilli i Europës për ndihmë ligjore, lidhur me kostot dhe shpenzimet për procedimet para Gjykatës, por rrëzon si të paprovuara pretendimet lidhur me kostot për procedimet para autoriteteve të brendshme.

3. Interesi i mospagimit

Gjykata çmon të nevojshme se interesi i mospagimit duhet të bazohet në normën marzhinale të huadhënies të Bankës Qendrore Europiane, së cilës duhet t'i shtohen tre pikë për qind.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA NJËZËRI:

1. Deklaron ankesat në lidhje me nenin 6 § 1 të Konventës, nenit 13 të Konventës dhe nenit 1 të protokollit shtesë nr.1 të Konventës, lidhur me vendimet e komisionit të 7 qershorit 1995 dhe 20 shtatorit 1996 të pranueshme;

2. Deklaron ankesat lidhur me nenin 6 § 1 dhe nenit 1 të protokollit nr.1 shtesë të Konventës, për sa i përket vendimit të gjykatë së rrethit të Kavajës 4 shkurt 2000, të pranueshme për tre ankuesit e parë dhe deklaron pjesën tjetër të ankimit si të papranueshëm;

3. Vendos, se ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës, për sa i përket neglizhencës për të ekzekutuar vendimet e Komisionit të 7 qershorit 1995 dhe 20 shtatorit 1996, si dhe vendimit të gjykatë së rrethit Kavajë të 4 shkurtit 2000;

4. Vendos, se ka pasur shkelje të nenit 13 të Konventës I marrë së bashku me nenin 6 § 1 të Konventës, për sa i përket mosefektivitetit të mjeteve në dispozicion të ankuesit për të siguruar ekzekutimin e vendimeve të Komisionit të 7 qershorit 1995 dhe 20 shtatorit 1996;

5. Vendos se ka pasur shkelje të nenit 1 të protokollit të parë shtesë të Konventës për të gjithë ankuesit, për sa i përket parcelës së tokës me sipërfaqe 5 500 m² dhe dyqaneve, dhe për 3 ankuesit e parë për sa i përket parcelës së tokës me sipërfaqe 30 500 m²;

6. Vendos se,

a) Shteti i paditur duhet t'i kthejë tre ankuesve të parë brenda 3 muajve nga data në të cilën vendimi merr formë të prerë në pajtim me nenin 44 § 2 të Konventës, parcelën e tokës me sipërfaqe 30 500 m² sq. dhe tu paguajë atyre së bashku shumën prej 25 000 euro (njëzet e pesë mijë euro) për dëmin pasuror dhe jopasuror, e cila do të konvertohet në monedhën vendase të shtetit të paditur, në normën e zbatueshme në datën e shlyerjes, duke përfshirë edhe ndonjë taksë që mund të jetë e tatueshme;

b) Nëse dështon në kthimin e tokës së mësipërme, shteti i paditur detyrohet t'u paguajë së bashku tre ankuesve, brenda gjashtë muajve nga data në të cilën vendimi merr formë të prerë, në pajtim me nenin 44 § 2 të Konventës, 120 000 euro (një qind e njëzet mijë) për dëmin pasuror dhe jopasuror. Kjo shumë duhet të konvertohet në monedhën vendase të shtetit të paditur, në normën e zbatueshme në datën e shlyerjes, duke përfshirë edhe ndonjë taksë që mund të jetë e tatueshme;

c) Shteti i paditur duhet t'u paguajë ankuesve, brenda tre muajve nga data në të cilën vendimi merr formë të prerë, në pajtim me nenin 44 § 2 të Konventës, shumat e mëposhtme, të cilat duhen konvertuar në monedhën vendase të shtetit të paditur, në normën e zbatueshme në datën e shlyerjes, duke përfshirë edhe ndonjë taksë që mund të jetë e tatueshme:

i) 64 000 euro (gjashtëdhjetë e katër mijë euro) për dëmin pasuror dhe jopasuror për sa u përket parcelave të tokës me sipërfaqe prej 5 500 m² dhe 150 m²;

ii) 1 676 euro (një mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e gjashtë euro) për kostot dhe shpenzimet;

d) Që nga skadimi i afatit të sipërpërmendur prej gjashtë muajsh (për sa i përket pikës (a) dhe (b), dhe prej tre muajsh (për sa i përket pikës (c)) interesi i thjeshtë i shlyerjes do të jetë i pagueshëm mbi shumat e mësipërme në një normë të barabartë me normën marzhinale të huadhënies së Bankës Qendrore Europiane gjatë periudhës së mospagimit, plus tre pikë për qind.

7. Hedh poshtë pjesën e mbetur të pretendimeve të ankuesit për shpërblim të drejtë.

Përgatitur në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 13 nëntor 2007, sipas rregullit 77 § 2 dhe 3 të rregullores së Gjykatës.

T.L EARLY
Kryesekretar

Josep CASADEVALL
Kryetar

VENDIM
(Ankimi nr.33771/02)
ÇËSHTJA “DRIZA KUNDËR SHQIPËRISË”

STRASBURG
13 NËNTOR 2007

Kjo çështje trajton prishjen e vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhe mosekzekutimin e tyre në favor të ankuesit. Gjykata Evropiane në këtë çështje konstatoi se ka patur shkelje të procesit të rregullt ligjor si pasojë e mungesës së sigurisë juridike. Ajo konkludoi se duke rishikuar një vendim gjyqësor përfundimtar dhe duke lejuar paraqitjen dhe zhvillimin e procedimeve paralele, Gjykata e Lartë e shndërroi një proces të tërë gjyqësor të padobishëm që si përfundim u përbyll me mosekzekutimin e vendimeve (shkelje e Nenit 6.1). Kjo çështje trajton gjithashtu mungesën e paanësisë së Gjykatës së Lartë. Gjykata e Lartë shfaq mungesë të paanësisë subjektive, duke pranuar rekursin në interes të ligjit, dhe gjithashtu mungesë të paanësisë objektive sepse një numër gjyqtarësh që ishin pjesë e kolegjit rishikues dhanë vendimet e datave 19/12/1998 dhe 07/12/2000 (shkelje e Nenit 6.1). Lidhur me zhvillimin e procedimeve paralele, Gjykata Evropiane tërheq vëmendjen se është përgjegjësi e Shtetit të organizojë sistemin ligjor (organizimi, menaxhimi dhe funksionimi i administrimit gjyqësor) në mënyrë të atillë që të identifikohen procedimet e lidhura dhe kur është e nevojshme ato të bashkohen ose të parandalojë zhvillimin e mëtejshëm të këtyre procedimeve që kanë lidhje me të njëjtën çështje.

Në çështjen Driza dhe të tjerë kundër Shqipërisë,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (seksioni i katërt), me dhomë gjykyesetë përbërë prej:

z. NICOLAS BRATZA Kryetar

z. J.CASADEVALL

z. G. BONELLO

z. K. TRAJA

z. L.GARLICKI

znj. L.MIJOVIC

z. J.SIKUTA

znj.P. HIRVELA gjykatës

dhe z.T.L.EARLY regjistruar i seksionit,

pas shqyrtimit me dyer të mbyllura në datën 16 tetor 2007, merr në këtë datë vendimin e mëposhtëm:

PROCEDURA

1. Çështja ka filluar në bazë të ankimit (nr.33771/02) kundër Republikës së Shqipërisë drejtuar në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (“Konventa”) nga shtetasi shqiptar, z. Ramazan Driza (“ankuesi”), më 4 shtator 2002.

2. Ankuesi u përfaqësua nga znj. A. Driza-Maurer, vajza e tij dhe avokate, që e ushtron aktivitetin e saj në Gjenevë. Qeveria shqiptare u përfaqësua nga agjentët e saj, z. S. Puto dhe znj S. Mëneri, nga Ministria e Punëve të Jashtme.

3. Ankuesi u ankua në veçanti për shkelje të nenit 6 § 1 në disa aspekte dhe për dështimin në zbatimin e vendimit të formës së prerë dhe në përputhje me nenin 13 të Konventës ai pretendoi se nuk kishte mjete juridike efektive në dispozicion në lidhje me ankimin e mësipërm.

4. Më 5 korrik 2005, Gjykata vendosi t’ia komunikonte ankimin qeverisë. Sipas dispozitave të nenit 29 § 3 të Konventës, ajo vendosi pranimin dhe shqyrtimin në themel të ankimit.

FAKTET

1. RRETHANAT E ÇËSHTJES

5. Ankuesi ka lindur në vitin 1941 dhe jeton në Tiranë (Shqipëri).

6. Procedurat e brendshme përkatëse kanë të bëjnë me një aplikim për kthimin e tokës.

A. Procedurat administrative për kthimin e tokës.

7. Në Shqipërinë e paraluftës i ati i ankuesit ka qenë pronar i një furre buke në Tiranë dhe një parcele toke përkatësisht me 6 000 metra katrorë. Në vitin 1960 shteti shqiptar e shkatërroi ndërtesën dhe shpronësoi tokën.

8. Më 27 shtator të vitit 1994 Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë ia ktheu ankuesit të drejtat e pronësisë mbi pronat e të atit të ndjerë, në përputhje me ligjin për kthimin dhe kompensimin e pronës të vitit 1993 (këtej e tutje referuar si Ligji i Pronës). Vendimi mori formë të prerë më 11 tetor 1994.

9. Në kushtet, kur kthimi në natyrë i ish-pronës ishte i pamundur, më 30 prill 1996 Këshilli Bashkiak i Tiranës vendosi që t'i njohë ankuesit të drejtën e kompensimit për ish-pronën me një pronë të të njëjtit lloj. Prona e alokuar ndodhej në një distancë prej 2 km nga qendra e Tiranës. Ajo kishte një sipërfaqe prej 5 000 metrash katrorë dhe ndahej në 2 parcela, respektivisht, 1 650 m² (këtej e tutje referuar si parcela e vogël), dhe 3 350 m² (këtej e tutje referuar si parcela e madhe).

10. Me vendimin nr.621, datë 20 qershor 1996 Komisioni i Kthimit dhe i Kompensimit të Pronave (këtej e tutje referuar si "Komisioni i Tiranës") la në fuqi vendimin e Këshillit Bashkiak të Tiranës.

11. Më 15 gusht të vitit 2007 titulli i pronësisë së ankuesit u regjistrua në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme në Tiranë.

12. Në vitin 1996 dhe 1997 u dhanë një sërë vendimesh mbi pronësinë e dy parcelave të tokës nga Këshilli Bashkiak i Tiranës dhe Gjykata e Shkallës së parë Tiranë; ankuesi nuk mundi të rimerrte pronat prej poseduesve të tyre.

13. Më 10 shtator të vitit 1997 ankuesi lidhi një kontratë paraprake shitjeje për parcelën e vogël.

B. Procedimet civile në lidhje me parcelën e vogël

1. Procedimet gjyqësore

14. Në bazë të ligjit nr.7501, datë 19 korrik 1991, një anëtar i të mëparshëm të kooperativës bujqësore F.Z., iu dha në përdorim parcela e vogël, e cila iu alokua ankuesit më vonë.

15. Në një datë të paspecifikuar F.Z., me anë të një padie civile paraqitur në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, pretendoi titull të plotë pronësie në bazë të ligjit nr.8053, datë 21 dhjetor 1995. Gjithashtu, ajo kërkoi nga gjykata, deklarin e pavlefshmërisë së vendimit të Komisionit të datës 20 qershor 1996 në lidhje me parcelën e vogël.

16. Më 10 tetor 1997, Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, shqyrtoi vendimin e Komisionit, lidhur me parcelën e vogël të tokës dhe vendosi që fillimisht Komisioni duhej të kompensonte përdoruesin e tokës dhe më pas ish-pronarin e saj.

17. Ankuesi me anë të një ankimi drejtuar Gjykatës së Apelit Tiranë, pretendoi titull të plotë pronësie mbi tokën. Ai shpjegoi se, kur Komisioni dha vendimin e tij, parcela ishte pronë shtetërore në dispozicion për t'iu alokuar ish-pronarëve *in lieu* me anë të kompensimit. Ai shtoi se F.Z. ishte thjesht një përdorues i tokës në atë kohë.

18. Më 2 qershor 1998 Gjykata e Apelit Tiranë pranoi ankimin e ankuesit, prishi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë për zbatim të keq të ligjit dhe la në fuqi vendimin e Komisionit në lidhje me titullin e pronësisë së ankuesit.

19. Më 17 dhjetor 1998 Gjykata e Lartë-Seksioni Administrativ, gjykoi çështjen në tërësi dhe i njohu ankuesit të drejtën e pronësisë mbi parcelën e vogël e alokuar në kompensim të ish-pronës së mëparshme. Në një datë të paspecifikuar vendimi mori formë të prerë.

2. Rekursi në interes të ligjit

20. Në një datë të paspecifikuar, gjatë vazhdimit të procedurave të ekzekutimit, F.Z.

depozitoi një rekurs në interes të ligjit në Gjykatën e Lartë duke kundërshtuar vendimin e 17 dhjetorit të vitit 1998 të Gjykatës së Lartë- Seksioni Administrativ dhe vendimin e 2 gushtit të vitit 1998 të Gjykatës së Apelit, për shkak se vinin në kundërshtim me ligjin material.

21. Rekursi në interes të ligjit u shqyrtua nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Më 5 korrik, përafërsisht dy vjet e gjysëm pas dhënies së vendimit të formës së prerë (1998), Gjykata e Lartë pranoi rekursin. Gjithashtu, në të njëjtën datë, gjykata, me shumicë votash prishi vendimet e 2 qershorit të vitit 1998 dhe të 17 dhjetorit 1998, të cilat ishin në favor të ankuesit, dhe la në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë të 10 dhjetorit 1997, vendim i cili kishte rrëzuar pretendimet e ankuesit në lidhje me parcelën e vogël. U konstatua se vendimi i Komisionit ishte bazuar në keqinterpretimin e ligjit të pronësisë (ligji i pronësisë 1993).

22. Ankuesi nuk u vu në dijeni të procesit për rekursin në interes të ligjit dhe nuk u ftua të merrte pjesë në seancat gjyqësore si subjekt procedural. Meqenëse ai nuk u njoh me vendimin e Gjykatës së Lartë brenda 6 muajve nga dita e dhënies së vendimit prej saj, nuk mundi ta apelonte këtë vendim.

23. Nga pesëmbëdhjetë gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, të cilët morën pjesë në dhënien e vendimit të 5 korrikut 2001, tre prej tyre (B.C, N.SH, dhe M.S) ishin anëtarë të kolegjit, i cili pas shqyrtimit të çështjes dha vendimin në datën 17 dhjetor të vitit 1998. Përveç kësaj tre prej gjyqtarëve (TH.K., P.Z., dhe V.K.) ishin anëtarë të kolegjit i cili gjykoi çështjen më 7 dhjetor 2000 (shiko në paragrafin më poshtë referuar procedurave në lidhje me të dyja parcelat). Tre gjyqtarët e parë morën pjesë në gjykimin e rekursit në interes të ligjit duke vendosur për keqinterpretimin e ligjit material në vendimin e mëparshëm (1998) të dhënë prej tyre, ndërsa tre gjyqtarët e dytë morën pjesë në shqyrtimin e po këtij rekursi duke vendosur për herë të dytë për të njëjtën çështje.

C. Procedurat gjyqësore në lidhje me pronën në tërësi (të dyja parcelat e tokës)

24. Në vitin 1997 Kontrolli i Lartë i Shtetit, duke vepruar në emër të tij dhe me kërkesë të S.SH., përdoruesit të parcelës së vogël të tokës alokuar ankuesit, paraqiti një padi përpara Gjykatës së Shkallës së Parë për konstatimin e pavlefshmërisë në tërësi të vendimit të Komisionit të datës 20 qershorit 1996 me arsyetimin se kishte tejkaluar juridiksionin e tij duke i alokuar tokë ankuesit.

25. Më 22 dhjetor 1997 Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë konstatoi pavlefshmërinë e plotë të vendimit të Komisionit, pasi vinte në kundërshtim me ligjin. Gjithashtu vendosi që shteti në bazë të Ligjit të Pronësisë, duhej të kompensonte ankuesin në lidhje me parcelën e tokës me një sipërfaqe prej 5 000 m².

26. Në një datë të paspecifikuar ankuesi iu drejtua Gjykatës së Apelit me ankim, duke kërkuar lënien në fuqi të vendimit të Komisionit, i cili i alokonte atij tokën.

27. Më 9 prill 1999 Gjykata e Apelit Tirane rrëzoi apelin e ankuesit dhe la në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë.

28. Në një datë të paspecifikuar ankuesi paraqiti rekurs para Gjykatës së Lartë- Seksioni Civil duke pretenduar që gjykatat e shkallëve më të ulëta nuk kishin konkluduar, se në çfarë titulli e shfrytëzonin tokën përdoruesit.

29. Më 7 dhjetor 2000 Gjykata e Lartë-Seksioni Civil, me anë të një vendimi, la në fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit me arsyetimin se Komisioni kishte tejkaluar juridiksionin e tij duke vendosur për formën e kompensimit që do të merrte ankuesi si pasojë e humbjes së ish-pronës së tij. Ajo konstatoi se në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave të 13 majit të vitit 1996, komisionet duhej të formoheshin nga këshillat bashkiake dhe duhej të vlerësonin kompensimin në zonat turistike. Komisionet nuk ishin formuar ende. Së fundi, gjykata i njohu të drejtën ankuesit për t'u kompensuar në vlerë në lidhje me një parcelë toke prej 5 000 m².

D. Procedurat në Gjykatën Kushtetuese.

30. Ankuesi paraqiti një kërkesë pranë Gjykatës Kushtetuese në bazë të nenit 131 (f) të Kushtetutës duke pretenduar se vendimet e Gjykatës së Lartë të datës 7 dhjetor 2000 dhe i 5 korrikut 2001 ishin antikushtetuese.

31. Më 8 prill 2002, Gjykata Kushtetuese, në përputhje me nenin 31 të ligjit të organizimit dhe funksionimit të Gjykatës Kushtetuese, vendosi të deklarojë të papranueshme kërkesën, pasi ishte “jashtë juridikisonit” të saj.

E. Zhvillimet e fundit

32. Ankuesi deklaroi se aktualisht mbi parcelën e madhe persona të tretë kishin ndërtuar dhe tashmë i kishin shitur apartamentet të cilat ishin zënë nga pronarët e rinj. Parcela e vogël ishte zënë nga ndërtesa të përkohshme. Ankuesi akoma nuk ishte kompensuar ende nga autoritetet kompetente shqiptare.

II. LIGJI PËRKATËS VENDAS

A. Kushtetuta

35. Kushtetuta shqiptare, lidhur me këtë, citon sa më poshtë :

Neni 41

1. E drejta e pronës private është e garantuar.
2. Prona fitohet me dhurim, me trashëgimi, me blerje dhe me çdo mënyrë tjetër klasike të parashikuar në Kodin Civil.
3. Ligji mund të parashikojë shpronësime ose kufizime në ushtrimin e së drejtës së pronës vetëm për interesa publikë.
4. Shpronësimit ose ato kufizime të së drejtës së pronës që barazohen me shpronësimin, lejohen vetëm përkundrejt një shpërblimi të drejtë.
5. Për mosmarrëveshjet lidhur me masën e shpërblimit mund të bëhet ankim në gjykatë.

Neni 42 *2

“Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.”

Neni 142*3

“Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore”.

Neni 131

Gjykata Kushtetuese vendos për: f) gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

Neni 181

1. Kuvendi, brenda dy deri tre vjetëve nga hyrja në fuqi e kësaj Kushtetute, nxjerr ligje për rregullimin e drejtë të çështjeve të ndryshme që lidhen me shpronësimet dhe konfiskimet e kryera para miratimit të kësaj Kushtetute, duke u udhëhequr nga kriteret e nenit 41.

2. Ligjet dhe aktet e tjera normative të miratuara para datës së hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute dhe që kanë të bëjnë me shpronësimet dhe konfiskimet, do të zbatohen kur nuk vijnë në kundërshtim me të.

C. Ligji për kthimin dhe kompensimin e pronave (Ligji nr.7698 i datës 15 prill 1993, ndryshuar me ligjet nr.7736 dhe nr.7765 të vitit 1993, me ligjet me nr. 7808 dhe nr.7879 të vitit 1994, me ligjin nr.7916 të vitit 1995, me ligjin nr.8084 të vitit 1996 dhe shfuqizuar me Ligjin nr.9235 të datës 29 korrik 2004 dhe së fundi ndryshuar me ligjin nr 9235 të vitit 2005 dhe ligjin nr. 9853 të vitit 2006).

36. Ligji për kthimin dhe kompensimin e pronës pësoi disa ndryshime gjatë katërmëdhjetë viteve të shkuara. Ndryshimet themelore të ligjit të parë të pronës të vitit 1993 ndodhën si rezultat i dy ligjeve, të cilët hynë në fuqi respektivisht në vitin 2004 dhe në vitin 2006, referuar më poshtë respektivisht si “Ligji i pronësisë i vitit 1993”, “Ligji i pronësisë i vitit 2004” dhe “Ligji i pronësisë i vitit 2006. Dispozitat përkatëse të secilit prej këtyre ligjeve janë të përmbledhura si vijon më poshtë:

1. Ligji i pronësisë i vitit 1993

37. Sipas ligjit të vitit 1993 ish-pronarëve të shpronësuar nga regjimi përkatës dhe trashëgimtarëve të tyre ligjorë iu njoh e drejta të pretendonin të drejtën e pronës për pronat e origjinës. Pas njohjes të së drejtës së pronësisë, ata kishin ose të drejtën e kthimit të saj në natyrë, ose të drejtën e kompensimit në natyrë (jo më shumë 10 000 m²) apo në vlerë, nëse plotësonin kushtet e mëposhtme: prona e pretenduar 1) të ishte në formën e kullotës, livadhit, tokës pyjore apo tokës bujqësore dhe jobujqësore; 2) të ishte e patrajtuar nga ligji nr.7501 të datës 19 korrik 1991; 3) të ishte në pronësi të shtetit; 4) dhe në rast se mund të tjetërsohej në truall duke u përfshirë brenda sipërfaqes së vijave të reja kufizuese ndërtimore të qendrave kompensimit: a) me obligacione shtetërore sipas vlerës ekuivalente të pronës, obligacione të cilat do të përdoreheshin në versionin e parë për të siguruar aksione në ndërmarrjet shtetërore që po privatizoheshin, ose në sipërmarrje të tilla si kredidhënie; b) me sipërfaqe trojesh ekuivalente pranë qendrave të banuara në përputhje me planet rregulluese të përgjithshme dhe c) me sipërfaqe ekuivalente në zonat turistike, në përputhje me planet rregulluese të përgjithshme. Këshilli i Ministrave përcaktonte rregulla më të hollësishme për mënyrat dhe afatet e kryerjes së këtyre kompensimeve. Gjithashtu, ligji i vitit 1993 parashikonte krijimin e Komisionit të Kthimit dhe të Kompensimit të Pronave si organi administrativ kompetent për të vendosur lidhur me pretendimet e personave për kthimin dhe kompensimin e pronave. Por ky ligj, nuk parashikonte një afat, brenda të cilit vendimet mund të apeloreshin duke sjellë si pasojë moszbatimin e tyre.

2. Ligji i pronësisë i vitit 2004

39. Ligji i pronave i dekretuar në vitin 2004 shfuqizoi ligjin e mëparshëm dhe parashikoi dy forma të kthimit të pronës, më konkretisht, kthimin në natyrë të pronës, nëse plotësoheshin disa kushte dhe kompensimin, në rast të pamundësisë nga ana e autoriteteve për të kthyer në natyrë pronën. Ligji nuk parashikonte kufizime për sipërfaqen e pronës që do të kthehej në natyrë. Ligji parashikonte pesë forma kompensimi: a) me një pronë të të njëjtit lloj, b) me një pronë të një lloji tjetër; c) me aksione në kompanitë shtetërore; d) me vlerën e një prone shtetërore në proces privatizimi; e) me një shumë parash, të cilat i korrespondojnë vlerës së pronës në kohën e dhënies së vendimit (neni 11). Ligji krijoi Komitetin Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave, të përbërë prej pesë anëtarësh të zgjedhur nga Parlamenti. Roli i tij ishte të vendoste lidhur me ligjshmërinë e vendimeve të dhëna mbi pretendimet e kthimit dhe kompensimit të pronave të komisioneve lokale (neni 15 dhe 17). Këshilli i Ministrave duhej të përcaktonte rregulla dhe kritere më të hollësishme në zbatim të këtij ligji (neni 13).

40. Neni 19 parashikonte për vendimet të cilat caktonin kompensim, ekzekutimin e tyre brenda 6 muajve nga fillimi i çdo viti financiar. Me hyrjen në fuqi të ligjit, çdo person që pretendonte kthimin apo kompensimin e pronës së tij duhej t'i drejtohej me anë të një kërkesë komisionit lokal deri më datën 31 dhjetor 2007. Ligji i dha juridiksion Komisionit për të vendosur në lidhje me formën e kompensimit, megjithëse çdo person në kërkesën e tij mund të përcaktonte preferencën e vet për mënyrën e kompensimit. Vendimet e komisionit lokal mund të apeloreshin para Komitetit Shtetëror (neni 20) dhe më pas para gjykatave të shkallës së parë brenda 30 ditëve nga dhënia e vendimit të Komitetit Shtetëror.

41. Më 28 prill 2005 Parlamenti miratoi një ligj i cili parashikonte mënyrat se si do të vlerësohej prona e paluajtshme, e cila do të kompensohej. Zbatimi i tij iu la Komitetit Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave, i cili do të hartonte hartat për vlerësimin e pronave.

42. Për zbatimin e vendimeve të Komitetit kur caktohej kompensim në para, neni 23 i ligjit të vitit 2004 parashikonte krijimin e një Fondi për Kompensimin e Pronës për një periudhë 10-vjeçare, qëllimi i të cilit ishte sigurimi i mjeteve financiare për kompensime të tilla. Ligji i vitit 2004

u shqyrtua si nga Gjykata Kushtetuese ashtu edhe nga Gjykata e Lartë. Më 24 mars 2005, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë konstatuan se Ligji i Pronësisë i vitit 2004 nuk kishte efekt prapaveprues dhe se në këtë mënyrë dispozitat e tij nuk mund të kishin ndikim mbi të drejtat e pronësisë, të njohura nga vendimet administrative ose gjyqësore, të dhëna para hyrjes së tij në fuqi.

3. Ligji i pronësisë i vitit 2006

43. Më 17 korrik 2006, Ligji i Pronësisë së vitit 2004 u ndryshua nëpërmjet Ligjit të Pronësisë së vitit 2006, i cili hyri në fuqi më 17 gusht 2006. Ky ligj parashikonte, ndër të tjera, krijimin e Agjencisë së Kthimit dhe të Kompensimit të Pronave, një organ i ri, kompetent për të vendosur në lidhje me pretendimet e personave për kthim dhe kompensim të pronës (neni 15). Ligji i ri shfuqizoi nenet 11§2, 19 dhe 20 të ligjit të mëparshëm, i cili, ndër të tjera, përcaktonte procedurën për zbatimin e vendimeve që parashikonin kompensim.

D. Ligji për tokën bujqësore

44. Ligji nr. 8053, i datës 21 dhjetor 1995, iu dha ish-anëtarëve të kooperativave bujqësore të drejtën për të kërkuar titullin e pronësisë së tokës që ata kishin punuar.

E DREJTA

1. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS

45. Ankuesi u ankua për shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës në disa aspekte duke argumentuar se prishja e një vendimi të formës së prerë ishte në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike; se Gjykata e Lartë kishte qenë e njëanshme gjatë dhënies së vendimit; dhe se autoritetet nuk kishin zbatuar vendimin e formës së prerë të datës 17 dhjetor 1998 dhe të datës 7 dhjetor 2000.

Neni 6 § 1, për sa kohë që është i zbatueshëm, vijon si më poshtë:

Në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile..., çdo person ka të drejtë të dëgjohet drejtësisht brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë.

A. Pranueshmëria

1. Pajtueshmëria me rregullin gjashtëmuor

46. Qeveria arsyetoi se ankimi ishte i papranueshëm, pasi ishte bërë jashtë afatit gjashtëmuor të parashikuar në nenin 35 § 1 të Konventës. Kështu, për shkak të karakterit diskrecionar të procedurave në Gjykatën Kushtetuese dhe vendimit të papranueshmërisë de plano të kësaj të fundit në çështjen aktuale, rregullimi përfundimtar efektiv brenda kuptimit të nenit 35 ishin në fakt vendimet e Gjykatës së Lartë të datës 5 korrik 2001 (faza e parë e procedimeve) dhe të datës 7 dhjetor 2000 (faza e dytë e procedimeve), ndërsa ankuesi paraqiti kërkesën e tij para Gjykatës më 4 shtator 2002.

47. Si përgjigje, duke iu referuar nenit 131 (f) të Kushtetutës dhe praktikës së Gjykatës Kushtetuese, ankuesi u shpreh se me qëllim shterrimin e të gjithave mjeteve juridike të brendshme, individët duhet të paraqisin një ankesë pranë Gjykatës Kushtetuese, nëse pretendonin një shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë (neni 6 i Konventës). Për më tepër, ankesa lidhej me konceptin e një gjykate të paanshme, shkeljen e parimit të sigurisë juridike dhe mosekzekutimin e vendimeve të formës së prerë, të cilat ishin në juridiksionin të Gjykatës Kushtetuese, përcaktuar kjo në jurisprudencën e saj. Gjykata Kushtetuese kishte juridiksionin dhe detyrimin për të shqyrtuar çështjen dhe për të vendosur mbi të me anë të një vendimi nëse do të ishte e nevojshme. Kështu që, ankuesi pretendoi se e kishte paraqitur kërkesën para Gjykatës në kohë, duke pasur parasysh se vendimi i Gjykatës Kushtetuese ishte i datës 8 prill 2002, edhe pse ishte një vendim papranueshmërie *de plano*.

48. Gjykata nënvizoi se e drejta për një proces të rregullt ligjor dhe e drejta për një vendim të formës së prerë të ekzekutueshëm, të cilat përbëjnë shqetësimin kryesor të ankuesit, janë të drejta kushtetuese të parashikuara në nenet 31 dhe 42 të Kushtetutës.

49. Gjithashtu Gjykata nënvizoi përfundimet e saj në këtë çështje në lidhje me Shqipërinë duke konkluduar, se ankesa pranë Gjykatës Kushtetuese mund të konsiderohej një mjet juridik efektiv që duhet të përdorej për qëllime të nenit 35 të Konventës, sa herë që ngriheshin çështje për një proces të rregullt ligjor (neni 6). Ajo çmoi, se nuk ka arsye për të devijuar nga ky konkluzion në rrethanat e kësaj çështjeje (shiko Qufaj k. Shqipërisë, nr. 54268/00, § 42, të dt. 18 nëntor 2004 dhe Balliu k. Shqipërisë vendimi nr. 74727/01 shtator 2004).

50. Ajo konstatoi se vendimi përfundimtar ishte ai i datës 8 prill 2002. Meqenëse ankuesi paraqiti kërkesën e tij më 4 shtator 2002, ai është në pajtim me afatin gjashtëmuor të parashikuar nga neni 35.

51. Për këto arsye, Gjykata hedh poshtë kundërshtimin e qeverisë.

2. *Rregullsia e procesit: shkëlja e parimit të sigurisë juridike dhe të paanshmërisë së gjykatës.*

52. Ankuesi pretendoi se Gjykata e Lartë (Kolegjet e Bashkuara) shkeli nenin 6 § 1 të Konventës, gjatë shqyrtimit të rekursit në interes të ligjit duke prishur vendimin e formës së prerë të datës 17 dhjetor 1998 dhe vendimin e Komisionit të datës 20 qershor 1996. Gjithashtu, ai u ankua për mungesën e paanshmërisë së panelit të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë në dy drejtime kryesore: tre prej gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë (TH.K., P.Z. dhe V.K.) ishin dy herë anëtarë të trupit gjykues, i cili vendosi në disfavor të ankuesit më 5 korrik 2001 dhe më 7 dhjetor 2000; gjithashtu ai përmendi rolin e dyfishtë të kryetarit të Gjykatës së Lartë gjatë procesit të rekursit në interes të ligjit.

53. Qeveria e kundërshtoi këtë pretendim.

54. Gjykata çmon se kjo pjesë e ankimit nuk është haptazi e pabazuar brenda kuptimit të nenit 35 § 3 të Konventës. Më tej vëren se nuk ka shkaqe për mospranueshmërinë e saj, kështu ajo deklarohet e pranueshme.

3. *Mosekzekutimi i vendimeve përfundimtare të datës 17 dhjetor 1998 dhe të datës 7 dhjetor 2000*

55. Qeveria shqiptare pretendoi se, ndërkohë që ankuesi nuk pranoi rezultatin përfundimtar të proceseve gjyqësore, ai nuk tregoi interes në ekzekutimin e vendimit të datës 7 dhjetor 2000; ai nuk kërkoi fillimin e procedurave të ekzekutimit pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe daljen e urdhrin të ekzekutimit të vendimit në fjalë. Gjithashtu, ai nuk përdori mjetet juridike të parashikuara në Ligjin e Pronësisë të vitit 2004 për sa i takon kompensimit. Qeveria shqiptare argumentoi se pretendimet e ankuesit duhet të deklaroheshin të papranueshme për shkak të mosshtrimit të mjeteve juridike të brendshme.

56. Ankuesi kundërshtoi efektivitetin e mjeteve juridike të referuara nga qeveria. Ai argumentoi se Ligji i Pronësisë i vitit 2004 nuk siguronte mjete juridike në kuptimin e Konventës. Ai vërejti se të drejtat e tij të pronësisë ishin përcaktuar në vendimet përfundimtare të datës 17 dhjetor 1998 dhe të datës 7 dhjetor 2000, kështu që një organ administrativ nuk mund të rishqyrtonte të njëjtën çështje. Së fundi, ai pohoi se nëse gjykata vendase do të kishte urdhëruar kompensim në një nga format e parashikuara nga ligji, përmbaruesit nuk do të kishin qenë në gjendje ta ekzekutonin atë vendim. Varet nga autoritetet shtetërore impelementimi i masave efektive, qoftë nëpërmjet kalsifikimit të pronave shtetërore që do të përdoren për kompensim në natyrë, qoftë duke siguruar fonde të mjaftueshme buxhetore për kompensim financiar, me qëllim që kjo mënyrë ndreqeje të realizohet. Në përfundim, ankuesi i qëndroi mendimit se qeveria deri tani nuk kishte marrë hapa efektivë për të gjetur zgjidhje në lidhje me çështjen e kompensimit të pronave ish-pronarëve.

57. Gjykata theksoi se rregulli i shtrimit të mjeteve juridike të brendshme, referuar nenit 35 § 1 të Konventës, detyron ankuesit të përdorin të gjitha mjetet juridike që në sistemin ligjor vendas janë normalisht në dispozicion dhe të mjaftueshme për t'i mundësuar ata të sigurojnë rivendosjen e së drejtës që pretendohet se është shkelur. Mjetet juridike ekzistuese duhet të jenë mjaftueshmërisht të besueshme, si në praktikë dhe në teori. Është përgjegjësi e shtetit ta sigurojë këtë garanci, pasi në të kundërt këto mjete nuk do të mund të përdoren sipas nevojave dhe do të mbeten fiktive (shih vendimin e Vernillo v. France të dt.20 shkurt 1991, Seria A, nr.198, fq 11-12, § 27; Aksoy v. Turkey, nr.21987/93, §§ 51-52, Reports 1996-VI; dhe Akdivar and others v. Turkey. nr.21893/93, §§ 65-67, Reports 1996-IV).

58. Gjykata çmon se problemi i efektivitetit të mjeteve juridike të parashikuara në Ligjin e Pronësisë përbën një ndër pretendimet kryesore të ankuesit sipas nenit 13 në kuptim të nenit 1 të protokollit nr.1. Ajo vëren, se të dyja këto probleme duhen shqyrtuar se bashku në themel.

B. Meritat (themeli)

1. Rregullsia e procesit

a) Siguria juridike: Prishja e vendimit të formës së prerë

i) Parashtrimet e palëve

59. Ankuesi pretendoi se qeveria kishte shkelur parimin e sigurisë juridike në dy raste të ndryshme. Në radhë të parë, duke përdorur një procedim të tipit Brumărescu, rezultat i së cilës ishte prishja e vendimit të Gjykatës së Lartë të datës 17 dhjetor 1998 i cili linte në fuqi pjesërisht vendimin e Komisionit të dt. 20 Gusht 1996; dhe në radhë të dytë, duke dhënë vendime kontradiktore në një set procesesh paralele, duke mos marrë parasysh vendimet e mëparshme të formës së prerë. Në të vertetë, vendimi i Gjykatës së Lartë i datës 7 dhjetor 2000 që kundërshtoi në tërësi vlefshmërinë e vendimit të Komisionit të datës 20 qershor 1996, nuk mori parasysh përfundimet e vendimit të Gjykatës së Lartë të datës 17 dhjetor 1998.

60. Me pak fjalë, duke dhënë vendime kontradiktore në një set procesesh paralele, të cilat pjesërisht apo plotësisht prishnin vendimet e mëparshme të formës së prerë, sistemi ligjor shqiptar tregoi pamajftueshmëri, pasojë e së cilës ishte shkelja e parimit të sigurisë juridike. Gjithashtu, pavarësisht faktit se instituti i rekursit në interes të ligjit ishte shfuqizuar, ankuesi ishte akoma viktimë e shkeljeve të pretenduara nga ky institut ligjor.

61. Qeveria e kundërshtoi këtë argument. Ajo pohoi se gjatë periudhës qershor-korrik 1997 gjykatat vendase ishin të legjitimuara për të filluar gjykimin e dy çështjeve civile të pavarura nga njëra-tjetra dhe të vendosnin mbi ligjshmërinë e vendimit të Komisionit të datës 20 qershor 1996 duke qenë se ishin vënë në lëvizje nga palë të ndryshme dhe kishin vendosur për çështje të ndryshme.

62. Për sa i përket rekursit në interes të ligjit, qeveria argumentoi se rishqyrtimi i një vendimi të formës së prerë brenda një afati kohor prej 3 vjetësh, pasi ky vendim kishte marrë formë të prerë, parashikohej nga legjislacioni i brendshëm i asaj kohe. Qëllimi i këtij mjeti ishte korrigjimi i atyre vendimeve të formës së prerë, të cilat ishin dhënë në kundërshtim me ligjin e brendshëm gjatë periudhës së tranzicionit dhe rrjedhimisht pati një efekt të përkohshëm deri në vitin 2001, kur u shfuqizua. Realisht, duke pasur parasysh se në lidhje me çështjen konkrete ishin dhënë dy vendime gjyqësore kontradiktore, rishqyrtimi nga një gjykatë më e lartë për të vendosur përfundimisht në lidhje me çështjen ishte i domosdoshëm. Kjo gjë u realizua me dhënien e vendimit të datës 5 korrik 2001 nga Gjykata e Lartë, vendim i cili përputhej me përfundimet e vendimit të datës 7 dhjetor 2000.

ii) Vlerësimet e Gjykatës

63. Parimi i sigurisë juridike përpara një gjykate garantuar nga neni 6 § 1 i Konventës duhet interpretuar nën dritën e preambulës së Konventës, e cila shpall që shteti i së drejtës do jetë trashëgimia e përbashkët e shteteve kontraktuese. Një ndër aspektet themelore të shtetit të së drejtës është edhe parimi i sigurisë juridike, i cili kërkon mbi të gjitha që, kur gjykatat, për një çështje të caktuar japin një vendim i cili merr formë të prerë, më pas, këto vendime nuk duhet të vihen në dyshim (shih *Brumărescu v. Romania* [GC], nr. 28342/95, § 61, EHCR 1999-VII; *Ryabykh v. Russia*, nr.52854/99, §§ 51-56. EHCR 2003-IX; *Roșca v. Moldova*, nr. 6267/02, § 24,22 Mars 2005).

64. Siguria juridike presupozon respektimin e parimit të gjësë së gjykuar (shih *Brumărescu v. Romania* të cituar më lart, § 62), i cili është parimi kryesor i një vendimi të formës së prerë. Ky parim konsiston në faktin që asnjë palë nuk ka të drejtë të kërkojë rigjykimin e një çështjeje që është zgjidhur me vendim të formës së prerë thjesht, sepse do të donin një rishqyrtim të çështjes së tyre. E drejta e gjykatave më të larta në shqyrtimin e ankimeve në lidhje me vendimet e gjykatave më të ulëta të cilat kanë marrë formë të prerë, duhet të përqendrohet në ndreqjen e gabimeve apo pasaktësive gjyqësore, dhe jo në rigjykimin në themel të çështjes. Ndreqja e gabimeve apo pasaktësive nuk duhet të trajtohet si një simulim në të vërtetë i ankimit, dhe mundësia e të paturit të dy vendimeve për të njëjtën çështje nuk përbën justifikim për një rishqyrtim të ri. Shmangia nga ky parim justifikohet vetëm kur vërtetohen rrethana thelbësore dhe të pakonstatueshme, se një gjë e tillë rezulton e domosdoshme (shih *Roșca v. Moldova* cituar më lart, §25).

65. Duke iu kthyer çështjes në fjalë, Gjykata vëren se më 17 dhjetor 1998, Gjykata e Lartë, Seksioni Administrativ la në fuqi njohjen e së drejtës së pronës së ankuesit mbi parcelën e vogël të tokës. Pavarësisht kësaj, më 7 Dhjetor 2000 Seksioni Civil i Gjykatës së Lartë, në një set procesesh gjyqësore paralele, konstatoi se titulli i pronësisë ishte dhënë në kundërshtim me ligjin. Gjithashtu, më 5 korrik 2001, në bazë të kërkesës së kryetarit të Gjykatës së Lartë që me anë të rekursit në interes të ligjit të rimerrej sërish në shqyrtim vendimi gjyqësor i vitit 1998, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, pa u referuar në përfundimet e vendimit të vitit 2000, prishën vendimin e formës së prerë të datës 17 Dhjetor 1998 në dëm të ankuesit. Me pak fjalë, pas 2 vjetësh e 7 muajsh vendimi i Gjykatës së Lartë i dt.17 Dhjetor 1998 u prish për herë të dytë nga Gjykata e Lartë, një herë nga një vendim i dhënë nga një set procesesh gjyqësore paralele dhe herën e dytë me anë të rekursit në interes të ligjit. Si rezultat problemi i pronësisë së ankuesit mbetet akoma i pazgjidhur.

66. Gjykata vëren se vendimi i vitit 1998 u prish për herë të parë gjatë procedurës të rekursit në interes të ligjit, i cili i mundësoi kryetarit të Gjykatës së Lartë të kundërshtonte çdo vendim të formës së prerë në lidhje me çështjen, në bazë të kërkesës së një prej palëve ndërgjyqëse. Ky procedim parashikohej në nenin 473 të Kodit të Procedurës Civile, i cili ishte në fuqi deri më 17 maj 2001.

67. Gjykata nuk pajtohet me argumentat e qeverisë në lidhje me efektin e kufizuar të institutit të rekursit në interes të ligjit. Shfuqizimi i këtij mjeti ligjor pasi rrodhën disa fakte në lidhje me çështjen, është pa kuptim: nuk ekzistojnë mjete juridike të brendshme të afta për të rivendosur të drejtat e cenuara si rezultat i shkeljes së parimit të sigurisë juridike, rrjedhojë kjo e përdorimit të procedurës të rekursit në interes të ligjit, efektet e të cilit nuk u korrigjuan kurrë në çështjen konkrete (shiko *Sardin v. Russia* vendimi nr. 69582/01, EHCR 2004-II; *Ryabykh v. Russia* vendimi nr. 52854/99, i datës 21 shkurt 2002).

68. I njëjti vendim u prish për herë të dytë nga një vendim i dhënë në një set procesesh paralele. Gjykata kundërshton argumentat e qeverisë se autoritetet ishin të legjitimuara për të filluar dy procese paralelisht në mënyrë të ndarë, në lidhje me të njëjtën çështje. Ajo rikujton nëpërmjet nenit 1 përgjegjësinë kryesore të shteteve për implementimin dhe zbatimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut (shiko *Kudla v. Poland* [GC], nr. 30210/96 § 152, ECHR 2000-XI).

69. Për këtë arsye, është përgjegjësia e shteteve kontraktuese për organizimin e legjislacionit të tyre në mënyrë të tillë që proceset e lidhura me njëra-tjetrën të identifikohen dhe aty ku është e nevojshme të bashkohen në të njëjtin proces ose për më tepër të ndalohej fillimi i proceseve të reja që kanë lidhje me të njëjtën çështje, për të shmangur rigjykimin e vendimeve të formës së prerë duke simuluar në fakt ankimin e tyre nën dritën e proceseve paralele.

70. Gjykata çmon se, duke i dhënë kryetarit të drejtën për të lejuar rigjykimin e një vendimi të formës së prerë dhe duke lejuar përdorimin e proceseve gjyqësore paralele, Gjykata e Lartë nuk mori fare parasysh të gjithë procesin gjyqësor, rezultat i të cilit ishte një vendim gjyqësor që në fakt përbënte *res judicata*. Kështu që duke pasur parasysh rrethanat e mësipërme, Gjykata nuk sheh ndonjë arsye për të ndarë përfundimet e veta në çështjen në fjalë (shiko paragrafet 63-64 më sipër).

71. Gjykata çmon se ka shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës për arsye se është prishur një vendim i formës së prerë i datës 17 dhjetor 1998 i dhënë në favor të ankuesit.

b) Paanshmëria

1. Parashtrimet e palëve

72. Ankuesi u ankua në bazë të nenit 6 § 1 për mungesën e paanshmërisë së panelit të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë. Kështu, tre prej gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë (TH.K., P.Z. dhe V.K.) ishin dy herë anëtarë të trupit gjykues, i cili vendosi në disfavor të ankuesit më 5 korrik 2001 dhe më 7 dhjetor 2000. Gjithashtu, kryetari i Gjykatës së Lartë, i cili paraqiti një kërkesë për rekurs në interes të ligjit në lidhje me vendimin e dhënë në favor të ankuesit, ishte gjithashtu dy herë pjesë e trupit gjykues që vendosi në disfavor të tij në procese të ndryshme.

73. Qeveria e kundërshtoi këtë argument. Ajo pohoi se duke iu referuar legjislacionit të brendshëm të asaj kohe, Gjykata e Lartë gjykonte ose në kolegje me trup gjykues të përbërë nga 5 gjyqtarë (kolegj civil/penal) ose me trup gjykues të përbërë nga të gjithë gjyqtarët (kolegje të bashkuara). Kolegjet e Bashkuara mund të shprehen, ndër të tjerash, në lidhje me kërkesat për

rekurs në interes të ligjit dhe për çështje të rëndësishme. Kështu që, në këndvështrimin e qeverisë, funksionimi i Kolegjeve të Bashkuara do të dëmtohej nëse gjyqtarët pjesëmarrës në kolegjin me trup gjykues prej 5 gjyqtarësh nuk do të ishin pjesë e Kolegjeve të Bashkuara. Ajo iu referua vendimit të Gjykatës Kushtetues të Dhjetor 7 prill 2000, i cili përcakton se funksionimi i Gjykatës së Lartë me të gjithë anëtarët e saj, si një trup vendimmarrës, është në përputhje me kërkesat për një trup gjykues të paanshëm. Së fundi, qeveria parashtroi se ankuesi nuk kishte arritur të provonte pretendimet në lidhje me mungesën e paanshmërisë së tre gjyqtarëve të sipërpërmendur.

i) Vlerësimet e Gjykatës

74. Gjykata pohoi se ka rëndësi themelore, që në një shoqëri demokratike gjykata të përcjellë besim tek qytetarët (shih *Padovani v. Italy*, vendimi i dt. 26 shkurt 1993, Seria A nr.257-B p.20). Neni 6 kërkon, që një gjykatë brenda juridiksionit të saj të jetë e paanshme. Paanshmëri do të thotë mungesë paragjykimi, apo anësie dhe ekzistenca e saj mund të provohet në mënyra të ndryshme. Kështu, Gjykata ka evidentuar dallimin midis kriterit subjektiv, i cili në thelb kërkon të provuarit e faktit, që bindja personale apo interesi i një gjyqtari kanë ndikuar në vendimin e gjykatës, dhe kriterit objektiv, i cili kërkon të provuarit nëse ai apo ajo ofruan garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm (shih *Piersack v. Belgium*, vendimi i datës 1 tetor 1982, Seria A nr.53, § 30 dhe *Kyprianou v. Cyprus* [GC], nr. 73797/01, § 118-119, ECHR 2005-...).

75. Gjykata ka deklaruar vazhdimisht se në kuptim të kriterit subjektiv, paanshmëria e gjyqtarëve duhet të prezumohet derisa të provohet e kundërta (shiko, për shëmbull, *Le Compte, Van Leuven dhe De Meyere v. Belgium*, vendim i datës 23 qershor 1981, Seria A nr 43, p.25, § 58).

76. Përsa i përket kriterit të dytë, nëse ky kriter zbatohet për anëtarët e trupit gjykues, ai nënkupton se, veç sjelljes personale të çdo anëtari të trupit gjykues, duhet të provohet, nëse ka fakte bindëse, të cilat vënë në dyshim paanshmërinë. Në këtë kuadër edhe dukja e jashtme mund të ketë një farë rëndësie (shiko *Castillo Algar v. Spain*, vendimi i datës 28 tetor 1998, Raporti 1998-VIII, p.31116, § 45 dhe *Morel v. France*, nr. 34130/96, § 42, ECHR 2000-VI). Në përcaktimin, nëse në një çështje konkrete ka arsye logjike për të dyshuar që një gjyqtar nuk është i paanshëm, këndvështrimi i atyre që ankohen për diçka të tillë është i rëndësishëm, por jo vendimtar. Në fakt, vendimtare është nëse objektiviteti i këtyre dyshimeve është mjaftueshëmrisht i bazuar (shiko *Ferrantelli dhe Santangelo v. Italy*, vendim i datës 7 gusht 1996, Reports 1996-III, pp. 951-52, § 58, dhe *Ëttestein v. Sëitserland*, nr. 33958/96, § 44, CEDH 2000-XII; *Kyprianou v. Cyprys* [GC], nr 73797/01, §§ 118 -119, ECHR 2005).

77. Në çështjen konkrete, ankuesi vuri në dyshim si paanshmërinë subjektive ashtu edhe atë objektive të tre gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, kështu që Gjykata do ta shqyrtojë secilin me radhë.

78. Në lidhje me paanshinë personale të gjyqtarëve P.Z. dhe V.K., Gjykata nuk konstaton ndonjë provë për të konfirmuar pretendimet e ankuesit. Ndërsa për Th.K., kryetarin e Gjykatës së Lartë, Gjykata vëren se, në përputhje me legjislacionin shqiptar të kohës kur është gjykuar çështja, procedurat e rekursit në interes të ligjit kishin filluar me kërkesë të kryetarit të Gjykatës së Lartë, i cili kishte vendosur tashmë në disfavor të ankuesit (seti i dytë i procedurave). Gjykata e Lartë, kryetari i së cilës ishte anëtar, së bashku me 14 gjyqtarë shqyrtuan kërkesën dhe vendosën prishjen e vendimit të formës së prerë, i cili ishte në favor të ankuesit. Gjykata është e mendimit, se kjo praktikë e Gjykatës së Lartë Shqiptare nuk ishte e pajtueshme me kriterin e “paansisë subjektive” të një gjyqtari që shqyrton një çështje, përderisa askush nuk mund të jetë në të njëjtën çështje paditës dhe gjyqtar (shiko *Svetlana Naumeko v. Ukraine* nr.41984/98, § 97. datës 9 nëntor 2004).

79. Për sa i përket paanshmërisë objektive, shqetësimet në lidhje me paanshmërinë e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, burojnë prej faktit, se trupi gjykues përbëhej prej pesëmbëdhjetë gjyqtarësh, gjashtë prej të cilëve kishin gjykuar çështjen në themel më përpara duke dhënë vendimet e datës 17 dhjetor 1998 dhe 7 dhjetor 2000.

80. Gjykata pranon, që situata mund të ketë ngjallur dyshime tek ankuesi në lidhje me paanshmërinë e Gjykatës së Lartë. Megjithatë, duhet shqyrtuar nëse objektiviteti i këtyre dyshimeve është mjaftueshëmrisht i provueshëm. Përfundimi lidhur me këtë varet prej rrethanave të çështjes.

81. Lidhur me këtë, Gjykata vëren se, në përputhje me legjislacionin e brendshëm lidhur me rekursin në interes të ligjit, Gjykata e Lartë duhet të shqyrtonte çështjen me të gjithë anëtarët e saj. Tre prej gjyqtarëve, të cilët kishin dalë me një vendim për çështjen, ishin pjesë e Kolegjeve të Bashkuara, që do të vendosnin nëse do ta pranonin kërkesën për rekurs në interes të ligjit dhe rrjedhimisht për themelin e çështjes. Si pasojë të tre gjyqtarët do të vendosnin nëse kishin gabuar në vendimin e tyre të mëparshëm apo jo. Për më tepër, tre gjyqtarë të tjerë të trupit gjykues duhet të vendosnin në lidhje me çështjen për të cilën ata e kishin dhënë njëherë sentencën e tyre.

82. Në këto kushte Gjykata konstaton, se paanshmëria objektive e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, lë shkas për dyshime. Kështu që dyshimi i ankuesit në lidhje me këtë problem mund të konsiderohet mjaftueshmërisht i bazuar.

83. Duke marrë parasysh gjithë sa u parashtruan më sipër, Gjykata konstaton se Gjykata e Lartë nuk ishte e paanshme për sa i përket dy konstatimeve të mësipërme në kuptim të nenit 6 § 1 të Konventës.

c) Konkluzione

84. Duke iu referuar konstatimeve të mësipërme, Gjykata çmon se është shkelur e drejta e ankuesit për një gjykim të drejtë nga një trup gjykues i paanshëm në bazë të nenit 6 § 1 të Konventës.

2. Mosekzekutimi i vendimeve të formës së prerë të datës 17 dhjetor 1998 dhe të datës 7 dhjetor 2000

d) Parashtrimet e palëve

85. Qeveria shqiptare i qëndroi mendimit se autoritetet shqiptare nuk mund të konsideroheshin përgjegjëse për mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore të sipërpërmendura, duke qenë se ekzekutimi varej nga ndërmarrja e hapave të nevojshëm nga ana e ankuesit, konkretisht: paraqitja e kërkesës për ekzekutim të vendimit para gjykatës kompetente. Qeveria iu referua argumenteve të saj të mëparshme mbi përdorimin e të gjitha mjeteve të brendshme juridike.

86. Ankuesi e kundërshtoi këtë argument.

e) Vlerësimet e Gjykatës

87. Parimet e përgjithshme në lidhje me moszbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të cilat caktonin kompensim, duke përfshirë edhe kompensim në natyrë në përputhje me skemën e kthimit të pronave, janë parashtruar në vendimin Beshiri (cituar më sipër § 60).

88. Gjykata çmon se vendimet e Gjykatës së Lartë të datës 17 dhjetor 1998 dhe të datës 7 dhjetor 2000, mund të interpretohen si detyrim i autoriteteve shqiptare për t'i siguruar ankuesit një formë kompensimi në natyrë ose në vlerë, e cila do ta zhdëmtonte atë *in lieu* për ish-pronën e tij.

89. Gjykata nuk e pranoi këndvështrimin e qeverisë për sa i përket mungesës së interesimit të ankuesit për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore; në fakt ankuesi kishte kundërshtuar rezultatin e procedimeve që çuan në vendimin e Gjykatës së Lartë të datës 7 dhjetor 2000.

90. Gjykata vëren se, ashtu si edhe në vendimin Beshiri, duke u marrë me dhënien e vendimit të vitit 2000, autoritetet nuk i ofruan ankuesit mundësi për të marrë kompensimin e duhur në përputhje me vendimin e mëparshëm gjyqësor të formës së prerë (shiko në kontrast, Uzkurëliene etj v. Lithuania, nr. 62988/00, § 36, 7 prill 2005). Kështu që ankuesi nuk pati asnjë mundësi për të shqyrtuar një ofertë kompensimi në raport të drejtë me kthimin në natyrë të pronës. Për më tepër, duke prishur dy herë radhazi vendimin e Gjykatës së Lartë të datës 17 dhjetor 1998, autoritetet nuk përmbushën detyrimet që buronin nga një vendim gjyqësor i formës së prerë.

91. Gjithashtu, Gjykata çmon që qeveria nuk ka dhënë asnjë shpjegim se, përse vendimi i datës 7 dhjetor 2000 nuk është ekzekutuar ende, edhe pse kanë kaluar 6 vjet nga shpallja e tij. Nuk ka të dhëna, që përmbaruesit gjyqësorë apo autoritetet administrative të kenë marrë ndonjë masë në zbatim të këtij vendimi.

92. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se ky problem vazhdon të ekzistojë pavarësisht përfundimeve të dhëna në vendimet Qufaj Co. sh.p.k dhe Beshiri (shiko Qufaj Co. sh.p.k., të cituar më lart, § 54-59, dhe Beshiri etj., cituar më lart, § 109).

92. Konsideratat e mësipërme janë të mjaftueshme për t'i dhënë mundësi Gjykatës të konstatojë, se mosmarrja e masave të nevojshme për të ekzekutuar vendimin e dt 7 Dhjetor 2000,

autoritetet shqiptare i zhveshën dispozitat e nenit 6 § 1 të Konventës nga të gjitha efektet e dobishme.

93. Pra ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës.

II. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 1 TË PROTOKOLLIT NR.1 TË KONVENTËS.

95. Ankuesi pretendoi se prishja e vendimit të Komisionit dhe e vendimit gjyqësor të formës së prerë të datës 17 dhjetor 1998, pa i dhënë ankuesit kompensim, përbën shkelje të nenit 1 të protokollit nr.1, i cili parashikon:

“Çdo person fizik ose juridik ka të drejtë të gëzojë paqësisht pronën që disponon. Askush nuk mund të privohet prej disponimit të pronës së tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Megjithatë, parashikimet e mësipërme nuk do të cenojnë të drejtën e shteteve për të zbatuar ligje, të cilat ata i gjykojnë të domosdoshme për të kontrolluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave a të kontributeve të tjera, ose të gjobave.”

A. Pranueshmëria

96. Gjykata çmon se ankimi sipas këtij kreu nuk është haptazi i pabazuar brenda kuptimit të nenit 35 § 3 të Konventës. Për më tepër ajo vëren, se nuk ka gjetur ndonjë arsye për ta deklaruar këtë pjesë të ankimit si të papranueshëm dhe kështu e deklaroi atë të pranueshëm.

B. Meritat (themeli)

1. Parashtrimet e palëve

97. Duke iu referuar vendimeve gjyqësore të brendshme në lidhje me çështjen, qeveria pretendoi se ankuesi nuk mund të kërkonte mbrojtje sipas këtij neni, duke qenë se vendimi i komisionit i akordoi atij dy pacela toke në vend të ish-pronës së tij, të cilën ankuesi nuk e posedoi kurrë. Pavarësisht faktit, që ankuesi e regjistroi titullin e tij të pronësisë në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme, në bazë të legjislacionit të brendshëm, një titull pronësie që jepej me anë të vendimeve të Komisionit mund të kundërshtohet para një gjykate pa iu nënshtruar ndonjë afati kohor. Në të vërtetë, vendimi i mësipërm u kundërshtua në gjykatën e brendshme, e cila konstatoi pavlefshmërinë absolute të titullit dhe urdhëroi, që ankuesi të kompensohet për ish-pronën e tij. Për më tepër, në këndvështrimin e qeverisë, vendimi i formës së prerë i Gjykatës së Lartë, i cili la në fuqi vendimin e Komisionit në lidhje me parcelën e vogël nuk mund të konsiderohet njohje absolute e së drejtës së pronësisë, pasi ndërkohë, që një set tjetër procesesh gjyqësore po shqyrtonin vlefshmërinë e këtij titulli (shiko më sipër 24-29).

98. Gjithashtu, qeveria pohoi se meqenëse ankuesi nuk e pranoi rezultatit e proceseve gjyqësore në lidhje me ligjshmërinë e titullit të tij mbi dy parcelat e tokës, autoritetet shqiptare nuk mund të deklaroheshin përgjegjëse, përderisa ankuesi nuk paraqiti para autoriteteve kompetente kërkesën për kompensim në përputhje me Ligjin e Pronësisë.

99. Qeveria shtoi gjithashtu, se pamundësia për të ekzekutuar vendimet gjyqësore të formës së prerë, që jepnin kompensim në kuadër të kthimit dhe kompensimit të pronave ishte për shkak të rrethanave objektive, si mungesa e fondeve dhe ndikimi i tyre mbi interesin e përgjithshëm të komunitetit.

100. Ankuesi pretendoi se deklaratat e qeverisë ishin të pabazuara. Ai parashtrroi, se vendimi i Gjykatës së Lartë i vitit 2000 përbënte një kufizim të së drejtës së pronësisë së tij jo sipas një interesi publik. Për më tepër, ai pretendoi, se pas më shumë se 12 viteve procedurash administrative dhe gjyqësore civile, të drejtat e tij në bazë nenit 1 të protokollit nr. 1 nuk u respektuan. Ankuesi parashtrroi se shteti ishte përgjegjës për borxhet e papaguara ndaj tij, të tilla si kompensimi dhe duke mos arritur të paguante ato borxhe për një kohë të gjatë, shteti e kishte privuar atë nga e drejta për të poseduar realisht pronën, në shkelje të nenit 1 të protokollit nr.1.

2. Vlerësimet e Gjykatës

101. Gjykata rikujton parimet e mëposhtme të përcaktuara në jurisprudencën e saj sa i takon nenit 1 të protokollit nr.1 (mes të tjerash shiko Kopecký v. Slovakia [GC], nr. 44912/98, § 35; von Maltzan etj v. Germany (dec) [GC], nr. 71916/01, nr.71917/01 dhe nr 10260/02, § 74, ECHR 2005-V dhe Beshiri e cituar më lart).

102. Gjykata rithekson se “pasuritë” mund të jenë “pasuri ekzistuese” ose “asete”, përfshirë në disa raste të përcaktuara qartë, edhe pretendimet. Që një pretendim të konsiderohet “aset” në përputhje me nenin 1 të protokollit nr.1, duhet që pretenduesi të provojë se në legjislacionin vendas ekziston një bazë e mjaftueshme, për shembull kur ekziston një praktikë e konsoliduar e gjykatave vendase në mbështetje të këtij pretendimi, ose kur ekziston një vendim gjyqësor i formës së prerë në favor të pretendimeve të ankuesit. Kur kjo arrihet të provohet hyn në veprim koncepti i “pritshmërisë së ligjshme” (shiko *Dragon v. France* [GC], nr. 1513/03, § 68, 6 tetor 2005, ECHR 2005-IX, dhe *Burdov v. Russia*, nr 59498/00, § 40, ECHR 2000-III).

103. Gjykata vëren se ankuesi ka paraqitur një padi rivendikimi në lidhje me ish-pronën e tij në përputhje me Ligjin e Pronësisë. Autoritetet deklaruan, se shtetëzimi i pronës së babait të tij ishte i kundërligjshëm, dhe i alokuan atij me anë të kompensimit dy parcela toke me sipërfaqe prej 5 000 m² në vend të ish-pronës së tij me sipërfaqe prej 6 000 m². Megjithë ndërhyrjen e autoriteteve shtetërore, ankuesi nuk e mori kurrë posedimin e tokës, përderisa ajo u zu nga persona të tretë. Asnjëra prej palëve nuk komentoi ngjarjet, që ndodhën gjatë periudhës që pasoi dhënien e vendimit të Gjykatës së Lartë të vitit 1998, i cili la në fuqi të drejtën e pronësisë së ankuesit mbi parcelën e tokës me sipërfaqe prej 1 650 m². Në vitin 2001 dhe 2000 u dhanë dy vendime gjyqësore njëra si rezultat i procedurës të rekursit në interes të ligjit, dhe tjetri rezultat i proceseve paralele, të cilat deklaruan pavlefshmërinë e titullit të pronësisë së ankuesit mbi të dyja parcelat e tokës dhe urdhëruan kompensimin e tij në një nga mënyrat e parashikuara në ligj. Që nga ajo datë ankuesi nuk është kompensuar ende.

104. Pavarësisht, se të dyja parcelat e tokës u regjistruan në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme dhe e drejta e tij e pronësisë mbi parcelën e vogël të tokës u la në fuqi me një vendim gjyqësor të formës së prerë, i cili u përmbys më vonë me procedurën e rekursit në interes të ligjit, Gjykata nuk mund të hamendësojë, nëse ankuesi ka patur ndonjëherë nën zotërim ndonjëherë nga parcelat apo jo, ose për gjendjen aktuale. Kështu që, me qëllim shqyrtimin e ankimit do të konsiderohet, që ankuesi ka pasur një “pretendim” në përputhje me nenin 1 të protokollit nr.1.

105. Gjykata vëren se kjo pjesë e ankimit ka lidhje me atë të shqyrtuar në bazë të nenit 6 §1 të Konventës, në lidhje me mos-zbatimin e vendimeve të formës së prerë (shiko më lart paragrafët 85-94).

106. Gjykata konstaton se në çështjen konkrete autoritetet kanë detyrimin, që në bazë të vendimeve të datës 17 dhjetor 1998 dhe të datës 7 dhjetor 2000, të kompensojnë ankuesin respektivisht në natyrë dhe në vlerë në raport të drejtë me ish-pronën e tij. Kështu që ankuesi ka të drejtë të pretendojë zbatimin e detyrimeve, që rrjedhin nga vendimet gjyqësore në fjalë.

107. Gjykata çmon se moszbatimi i vendimeve të formës së prerë të datës 17 dhjetor 1998 dhe të datës 7 dhjetor 2000, përbën një ndërhyrje në të drejtën e ankuesit për një gëzim të qetë të pronës së tij në kuptimin e nenit 1 të protokollit nr.1 të Konventës.

108. Përsa i përket justifikimit të parashtruar nga qeveria për këtë ndërhyrje, Gjykata rikujton se mungesa e fondeve nuk mund të justifikojë mosekzekutimin e një vendimi detyrues të formës së prerë për shlyerje borxhi (shih *Pasteli and Others v. Moldova* nr.9898/02, 9863/02, 6255/02 dhe 10425/02, § 30, 15 qershor 2004, *Voytenko v.Ukraine*, nr 18966/02, § 55. 29 Qershor 2004; *Shmalko v. Ukraine*, nr 60750/00, § 57, 20 korrik 2004).

109. Për pasojë ka pasur shkelje të nenit 1 të protokollit nr.1 të Konventës lidhur me kompensimin.

III. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 13 I MARRË BASHKËRISHT ME NENIN 1 TË PROTOKOLLIT NR.1.

110. Ankuesi u ankua për mungesën e mjeteve efektive juridike për të siguruar një përcaktim përfundimtar të së drejtës së tij të pronësisë. Ai iu referua nenit 13 të Konventës, i cili vijon si më poshtë:

“Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e njohura në këtë Konventë, ka të drejtë të bëjë ankim efektiv tek një organ i vendit të tij, edhe kur shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare”.

111. Kështu, që gjykata do të shqyrtojë këtë pjesë të ankimit sipas nenit 13 i marrë së bashku me nenin 1 të protokollit nr.1 të Konventës. Për këtë problem, gjykata ka ndërthurrur pjesën e ankimit në lidhje me shterrimin e mjeteve juridike të brendshme me atë të moszbatimit të vendimeve sipas nenit 6 (shiko paragrafin 58 më lart).

A. Pranueshmëria

112. Gjkata çmon se ankimi, sipas këtij kreu, nuk është haptazi i pabazuar sipas kuptimit të nenit 35 § 3 të Konventës. Për më tepër ajo vëren, se nuk ka gjetur ndonjë arsye për ta deklaruar këtë pjesë të ankimit si të papranueshme dhe kështu e deklaroi atë të pranueshme.

B. Meritat (themeli)

1. Parashtrimet e palëve

113. Ankuesi parashittoi se mjeti i vetëm i siguruar nga legjislacioni shqiptar për kthimin dhe kompensimin e pronave, më konkretisht paraqitja e një kërkesë para organit kompetent sipas Ligjit të Pronësisë nuk mund të konsiderohet “efektiv” në kuptim të qëllimit të nenit 13. Edhe nëse një kërkesë e tillë përmbushej me sukses, kthimi dhe/ose kompensimi i pronës së origjinës në të vërtetë ishte në diskrecionin e autoriteteve kompetente dhe varej nga vullneti i tyre për të zbatuar parashikimet e nevojshme lidhur me këtë çështje.

114. Qeveria e kundërshtoi këtë argument të ankuesit, në veçanti duke përsëritur argumentin në lidhje me neglizhencën e ankuesit në shterrimin e mjeteve të brendshme juridike. Ajo vuri në dukje se legjislacioni shqiptar parashikonte një mjet juridik të veçantë, me anë të të cilit ankuesi mund të pretendonte kthimin dhe kompensimin e pronës së tij, nëse ajo ishte shtetëzuar dhe i ishte konfiskuar në mënyrë të kundërligjshme nga shteti. Skema ligjore në lidhje me çështjen e kthimit dhe të kompensimit i është nënshtruar ndryshimeve të shumta ligjore për shkak të pasojave të konsiderueshme financiare dhe sociale të këtij procesi. Megjithatë, pavarësisht ndryshimeve ligjore, që çuan në përmirësimin e këtij procesi, tre mjetet juridike të parashikuara nga Ligjet e Pronësisë ishin në përputhje me kërkesat e nenit 13 të Konventës. Megjithatë, qeveria sugjeroi, pa dhënë shpjegime të mëtijshme, që ankuesi duhet t’i ishte drejtuar autoritetit kompetent të parashikuar nga Ligji i Pronësisë së vitit 2004 me anë të një kërkesë për të siguruar zhdëmtim.

2. Vlerësimi i Gjykatës

115. Gjkata vëren se ankimi i ankuesit në bazë të nenit 1 të protokollit nr.1 të Konventës përbën në mënyrë të padiskutueshme “objekt shqyrtimi”. Për rrjedhojë ankuesi gëzonte të drejtën e një mjeti juridik të brendshëm efektiv sipas kuptimit të nenit 13 të Konventës.

116. Për më tepër, Gjkata rikujton se “autoriteti” i përmendur në nenin 13 nuk mund të jetë domosdoshmërisht në të gjitha instancat një autoritet gjyqësor në kuptimin e ngushtë të këtij termi. Sidoqoftë, kompetencat dhe garancitë procedurale, që disponon një autoritet janë të rëndësishme për të përcaktuar, nëse mjeti juridik, që ka në dispozicion ankuesi është efektiv ose jo (shiko *Klass and others v. Germany*, vendimi i dt.6 shtator 1978, Seria A nr. 28, p. 30, § 67). Mjeti juridik, sipas kuptimit të nenit 13 duhet të jetë “efektiv” si në praktikë ashtu edhe në teori, në veçanti, në kuptimin, që përdorimi i tij të mos pengohet në mënyrë të paligjshme nga veprimet apo mosveprimet e autoriteteve të shtetit në fjalë (shih *Aksoy v. Turkey*, vendimi i datës 18 dhjetor 1996, Reports of Judgments and Decisions 1996-VI, p. 2286, § 95 në fund).

117. Gjkata vëren, se në vijim, të tre Ligjet e Pronësisë, parashikuan një mjet juridik, në formën e një veprimi për kthim dhe kompensim të pronës adresuar një organi administrativ të posaçëm, i cili kishte në kompetencë të vendoste në lidhje me titullin e pronësisë së ish-pronarëve dhe aty ku ishte e mundur t’iu alokonte atyre pronën e tyre të origjinës ose t’i kompensonte ata *in lieu*. Procedura e mësipërme është mënyra e vetme për të fituar të drejtën e pronësisë në lidhje me pronën, e shtetëzuar në kundërshtim me ligjin. Ankuesi e përdori këtë mjet, dhe në dy raste autoritetet i njohën të drejtën për t’u kompensuar në lidhje me ish-pronën e babait të tij (shih paragrafët 9-10 më sipër).

118. Gjkata vëren se Ligji i Pronësisë i vitit 1993 (shfuqizuar me Ligjin e Pronësisë së vitit 2004 dhe ndërkohë i ndryshuar nga Ligji i Pronësisë i vitit 2006) parashikonte forma të ndryshme kompensimi, kur prona e origjinës nuk mund t’i kthehej në natyrë pronarit (shih paragrafët 36-43 më sipër). Gjkata konstaton se Ligji i Pronësisë i vitit 1993, e linte në kompetencë të Këshillit të

Ministrave, përcaktimin e formës së duhur të kompensimit, i cili duhet të hartonte rregullat dhe mënyrat e mëtejshme për kompensimin, në zbatim të ligjit. Duke iu referuar përfundimeve në vendimin e Gjykatës së Lartë të datës 7 dhjetor 2000, organi kompetent, i cili do vendoste në lidhje me çështjen e kompensimit nuk ishte formuar akoma në atë kohë (shiko paragrafin 29 më sipër). Pavarësisht, se Ligji i Pronësisë së vitit 2004 hyri në fuqi, situata nuk ndryshoi. Vetëm më 28 prill 2005, Parlamenti nxori një ligj, i cili përcaktonte skemën në lidhje me vlerësimin e pronës për qëllime kompensimi. Neni 5 i këtij ligji la zbatimin e kësaj skeme në kompetencë të Komitetit Shtetëror të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, i cili do të hartonte hartat për vlerësimin e pronave. Megjithatë deri më sot këto harta akoma nuk janë hartuar.

119. Rrjedhimisht, Gjykata çmon se, duke mos u krijuar organet kompetente, të cilat do të vendosnin në lidhje me problemin e kompensimit dhe duke mos u hartuar hartat për vlerësimin e pronave, Qeveria nuk mundi të krijonte një procedurë të përshtatshme në lidhje me kërkesat për kompensim. Për më tepër, është e pamundur që nëpërmjet këtyre sistemeve kaq të shpejta apo brenda një harku kohor relativisht të shkurtër, shteti të mundësojë zgjidhjen e çështjes duke dhënë një përcaktim përfundimtar në lidhje me të drejtat e ankuesit.

120. Rrjedhimisht, duke rikujtuar përfundimet në vendimin Beshiri, Gjykata konstaton se ankuesit i është mohuar e drejta për një mjet juridik efektiv në lidhje me pretendimet e tij, e cila përbën shkelje të nenit 1 të protokollit nr.1 (shih Beshiri etj. të cituar më sipër, §§ 54, 55).

121. Pra, është shkelur neni 13 i Konventës i marrë bashkërisht me nenin 1 të protokollit nr.1 të Konventës. Për rrjedhojë, Gjykata hedh poshtë kundërshtimet e qeverisë.

IV. ZBATIMI I NENEVE 46 DHE 41 TË KONVENTËS

A. Neni 46 i Konventës

121. Neni 46 i Konventës parashikon:

“1. Palët e larta kontraktuese zotohen t’u binden vendimeve përfundimtare të Gjykatës në çdo rast, kur ata janë palë.

2. Vendimi përfundimtar i Gjykatës i transmetohet Komitetit të Ministrave i cili mbikëqyr zbatimin e tij.”

122. Gjykata vëren se përfundimet e saj të lartpërmendura (shih paragrafët 117-118), tregojnë se zvarritja e pajustificuar e kompensimit, sipas Ligjit të Pronësisë, nuk mund t’i atriubohet ndonjë sjelljeje të veçantë të ankuesit. Kjo zvarritje erdhi si pasojë e ekzistencës së vakuumit në legjislacionin shqiptar, si rrjedhim i së cilit një kategori e tërë individësh u privuan nga e drejta për gëzimin paqësor të pronës, si pasojë e mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore, të cilat caktonin kompensim në përputhje me Ligjin e Pronësisë. Në të vërtetë, tashmë janë paraqitur dyzina me kërkesa identike para Gjykatës përsa i përket këtij problemi. Përshkallëzimi i numrit të kërkesave është një faktor rëndues përsa i përket përgjegjësisë së shtetit në bazë të Konventës, dhe përbën kërcënim për efikasitetin në të ardhmen të sistemit të vendosur nga Konventa, kështu që sipas këndvështrimit të Gjykatës, vakumi ligjor i zbuluar në çështjen konkrete të ankuesit, mund t’i japë jetë një numri të shumë kërkesash të tjera të bazuara.

123. Përpara shqyrtimit të pretendimeve individuale të ankuesit për shpërblim të drejtë, sipas nenit 41 të Konventës dhe duke pasur parasysh rrethanat e çështjes konkrete, Gjykata dëshiron të marrë në konsideratë efektet e nenit 46 për shtetin e paditur. Gjykata rithekson se, sipas nenit 46, shtetet kontraktuese duhet t’u binden vendimeve përfundimtare të Gjykatës në mosmarrëveshjet ku ata janë palë, mbikëqyrja e ekzekutimit të të cilave është në kompetencë të Komitetit të Ministrave. Një ndër efektet e këtij neni është: aty ku Gjykata konstaton shkelje, shteti i paditur ka detyrimin ligjor, jo vetëm të shlyejë detyrimet monetare në kuadër të shpërblimit të drejtë konform nenit 41, por duhet të për zgjedhë, subjektin që do të mbikëqyrret nga Komiteti i Ministrave, masat e përgjithshme dhe/ose kur është e përshtatshme masat e veçanta që duhet të ndërmerren në sistemin e brendshëm të së drejtës, për t’i dhënë fund shkeljeve të konstatuara nga Gjykata dhe të korrigjojë sa më shpejt të jetë e mundur efektet e tyre. Për më tej, që prej momentit kur Gjykata konstaton mangësi në sistemin ligjor, autoritetet kombëtare, subjekt i mbikëqyrjes prej Komitetit të Ministrave, kanë detyrimin të ndërmarrin brenda një afati kohor të caktuar-me fuqi prapavepruese nëse është e mundur- (shih ndër autoriteteve të tjera Xenides-Arestis v. Turkey, nr, 46347/99, §§ 39, 40, 22

Dhjetor 2005: Scordino v. Italy (nr.1) [GC], nr. 36813/97, § 233. ECHR 2006 dhe Bronioëski v. Poland [GC], nr.31443/96, § 192, ECHR 2004-V; Bottazzi v. Italy [GC], nr 34884/97, § 22, ECHR 1999-V, Di Mauro v. Italy [GC], nr 34256/96, §23, ECHR 1999-V), masat e nevojshme për t'i korrigjuar këto mangësi në përputhje me parimin e subsidiaritetit, sipas Konventës, me qëllim që Gjykata të mos ripërsërisë përfundimet e veta për shkeljen në fjalë në një seri të gjatë çështjesh të ngjashme.

124. Në këtë kontekst, si pjesë e masave të parashikuara për të garantuar efektivitetin e makinerisë së vendosur nga Konventa, Gjykata dëshiron të verë në dukje Rezolutën (Res(2004)3) dhe Rekomandimin (Rec(2004)6) të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës të miratuara më 12 maj 2004.

125. Në teori nuk është Gjykata ajo që duhet të përcaktojë se kush mund të jenë masat e duhura për korrigjim, në mënyrë që shteti i paditur të veprojë në përputhje me detyrimet e tij sipas nenit 46 të Konventës. Megjithatë, një ndër shqetësimet e Gjykatës është lehtësimi i rrethanave që do të mundësojnë një shtypje të shpejtë dhe efektive të keqfunksionimit të konstatuar në sistemin vendas, që garanton mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Në këtë kontekst duke iu referuar edhe gjendjes së konstatuar më sipër, Gjykata çmon se duhet të ndërmerren masa të përgjithshme në nivel kombëtar, të cilat janë padyshim të nevojshme për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore aktuale

126. Për të asistuar në zbatimin e detyrimeve sipas nenit 46 nga shteti i paditur, Gjykata është përpjekur të parashtojë llojin e masave, që shteti shqiptar duhet të ndërmarrë për t'i dhënë fund natyrës dhe shkaqeve të shkeljeve të gjetura në çështjen në fjalë. Gjykata çmon se shteti i paditur, mbi të gjitha, duhet të heqë të gjitha pengesat që bëhen shkak për kompensimin sipas Ligjit të Pronësisë, duke mundësuar marrjen e të gjitha masave ligjore, administrative dhe buxhetore të domosdoshme. Këto masa duhet të përfshijnë hartimin e hartave për vlerësimin e pronës për ankuesit të cilët kanë të drejtë të marrin kompensim në natyrë, si dhe përcaktimin e një fondi të përshtatshëm për ankuesit që përfitojnë kompensim në vlerë, me qëllim që të gjithë ata pretendues, të cilët kanë në duar vendime gjyqësore në favorin e tyre, vendime të cilat u njohin atyre të drejtën e kompensimit sipas Ligjit të Pronësisë të përfitojnë pa vonesë shumën e kompensimit ose truallin. Këto masa duhet të vihen në dispozicion sa më parë.

B. Neni 41 i Konventës

127. Neni 41 i Konventës parashikon:

“Kur Gjykata konstaton shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj, dhe e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese mundëson vetëm ndreqjen e pjesshme të pasojave të shkaktuara nga shkelja, Gjykata kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar.”

1. Dëmi

128. Ankuesi fillimisht pretendoi kthimin e plotë të të dy parcelave të tokës (me sipërfaqe 5 000 m²) dhe gjithashtu shumën prej 186 000 euro për fitimin e munguar. Meqenëse kthimi i ish-tokës së tij ishte i pamundur, ai pretendoi në lidhje me të 5 779 000 euro përsa i përket dëmit pasuror dhe fitimit të munguar. Ai u mbështet në një raport vlerësimi ekspertësh, për qëllime të përcaktimit të vlerës së përgjithshme të pasurive të tij dhe fitimit të munguar. Sipas këtij raporti ish-prona ndodhet në një zonë urbane shumë të zhvilluar të Tiranës. Prona kishte akses të mirë me rrugët kryesore dhe kishte një potencial ekonomik të mirë, i cili u shfrytëzua për qëllime ndërtimi. Raporti ndër të tjera konstatonte, se vlera e tregut në lidhje me tokën varionte nga 400 euro për m² në 2000 euro për m² në varësi të faktit se për çfarë ishte destinuar. Së fundi, ankuesi pretendoi 70 000 euro për dëmin jopasuror.

129. Qeveria kundërshtoi pretendimet e ankuesit, por nuk parashtroi asnjë argument në lidhje me shumën e pretenduar nga ankuesi. Ajo pohoi angazhimin e saj për të gjetur një zgjidhje në lidhje me kthimin dhe kompensimin e pronës. Në këtë mënyrë qeveria i rikujtoi Gjykatës rregullin se konstatimi i një shkelje përbënte në vetvete një zhdëmtim të drejtë.

130. Gjykata rithekson se një vendim nëpërmjet të cilit ajo konkludon se ka pasur shkelje, vendos shtetin e paditur para detyrimit ligjor sipas Konventës për t'i dhënë fund shkeljes dhe për të riparuar pasojat e saj në mënyrë të tillë që të rivendoset sa më shpejt të jetë e mundur situata

ekzistuese siç ishte para shkeljes (shih *Former King of Greece and the Others v. Greece* [GC] (zhdëmtim i drejtë), nr 25701/94, § 72). Nëse legjislacioni i brendshëm mundëson vetëm riparim të pjesshëm të dëmit, neni 41 i Konventës i jep Gjykatës kompetencë për të kompensuar palën e dëmtuar për veprimin apo mosveprimin që u bë shkak i shkeljes së konstatuar. Gjykata gëzon një lloj diskrecioni në ushtrimin e kësaj kompetence, siç provohet dhe nga përdorimi i fjalës “i drejtë” dhe frazës “nëse është e nevojshme”.

131. Midis çështjeve që Gjykata merr parasysh kur vlerësohet kompensimi, janë dëmi pasuror (humbja aktualisht e shkaktuar si rezultat i drejtëpërdrejtë i shkeljes së pretenduar) dhe dëmi jopasuror (kompensim për ankthin, vështirësitë dhe pasigurinë e shkaktuar nga shkelja) dhe dëme të tjera jopasurore (shih, midis autoriteteve të tjera *Ernestina Zullo v. Italy* nr.64897/01, § 25, 10 nëntor 2004). Për më tepër, nëse një ose më shumë kategori specifike të dëmit nuk mund të llogariten saktësisht ose nëse dallimi midis dëmit pasuror dhe jopasuror duket i vështirë, Gjykata mund të vendosë të bëjë një vlerësim total (shih *Comingerstoll v. Portugal* [GC], nr. 35382/97, § 29. ECHR 2000-IV).

132. Duke iu kthyer çështjes në fjalë, Gjykata çmon se vendimi gjyqësor i formës së prerë i datës 7 dhjetor 2007, i njohu ankuesit pronësinë mbi parcelën e tokës me sipërfaqe prej 5 000 m². Kështu që pretendimi i ankuesit në lidhje me prona të ndryshme nga ato që iu alokuan atij, konsiderohet *ultra petita*, dhe si pasojë nuk pranohet.

133. Për më tepër, Gjykata çmon se në çështjen në fjalë u konstatua shkelje të nenit 6 § 1 të nenit 1 të protokollit të parë shtesë nr.1 dhe të nenit 13 të Konventës, duke zbuluar se ankuesi u pengua në gëzimin e qetë të pronës së tij ose me anë të kompensimit *in lieu*. Gjykata çmon se ankuesit i është shkaktuar një dëm i konsiderueshëm pasuror dhe jopasuror si rezultat i shkeljes së të drejtave të tij të afirmuara në Konventë, e cila është dhe arsyeja se pse konstatimi qoftë edhe i një shkeljeje të vetme nuk mund të përbëjë mjaftueshmërisht një zhdëmtim të drejtë sipas kuptimit të nenit 41 të Konventës.

134. Gjithashtu, duke iu referuar konkluzioneve të saj në vendimet më të fundit që janë dhënë nga Gjykata, ku parashtrohet se autoritetet shqiptare duhet të merrnin masa të përshtatshme me qëllim pajtimin me vendimet e formës së prerë (shih *Qufaj Co. Sh.p.k* cituar më sipër, § 54-59, dhe gjithashtu, *Beshiri etj.*, cituar më sipër § 109), dhe në mungesë të adoptimit të mjeteve të brendshme në lidhje me ekzekutimin e vendimeve të kompensimit që nga dhënia e këtyre vendimeve, Gjykata çmon se nuk i mbetet mundësi tjetër përveçse të caktojë një shpërblim, i cili do të përbëjë një rregullim të plotë dhe përfundimtar të problemit të pronësisë (shih, midis autoriteteve të tjera *Plotnikov v. Russia*, nr. 43883/02, § 33, 24 shkurt 2005 dhe *OOO Rusatommet v. Russia*, nr.61651/00, § 33, 14 Qershor 2005).

135. Gjykata çmon se, në rrethanat e çështjes në fjalë, kthimi i parcelës së vogël të tokës, ashtu siç u caktua me vendimin gjyqësor të formës së prerë të Gjykatës së Lartë të datës 17 dhjetor 1998, së bashku me pagimin e fitimit të munguar, si dhe të kompensimit në vlerë në lidhje me parcelën e madhe të tokës në bazë të vendimit të datës 7 dhjetor 2000, duke përfshirë edhe shkallën e interesit që pasqyron ndërhyrjen, pasojë e së cilës ishte humbja e pronësisë së parcelës së madhe të tokës, do ta vendosnin ankuesin sa më shpejt të jetë e mundur në një situatë të njëjtë me atë në të cilën do të kish qenë ai po të mos kishim shkelje të Konventës.

136. Përsa i përket shumës së kompensimit, Gjykata vëren se qeveria as nuk parashtroi një metodë vlerësimi sipas këndvështrimit të saj dhe as nuk paraqiti ndonjë kundërshtim për sa i përket metodës së vlerësimit të kompensimit të parashtuar nga ankuesi.

137. Duke iu referuar informacionit të disponueshëm sipas vlerësimit të ankuesit në lidhje me çmimet e tregut të tokës në Tiranë në kohën kur janë dhënë vendimet gjyqësore përkatëse dhe duke bërë një vlerësim të paanshëm, Gjykata i jep ankuesit një shumë prej 500 000 euro për sa i përket dëmit pasuror dhe jopasuror në lidhje me parcelën e madhe të tokës.

138. Gjithashtu, Gjykata i jep ankuesit një shumë totale prej 50 000 euro së bashku me kthimin e parcelës së vogël të tokës. Në rast se shteti i paditur dështon në kthimin e kësaj parcele ankuesit brenda tre muajve nga data në të cilin ky vendim merr formë të prerë, atëherë Gjykata

vendos që shteti detyrohet t'i paguajë ankuesit, një shumë prej 280 000 euro për sa i përket dëmit pasuror dhe jopasuror në lidhje me këtë parcelë.

2. Kostot dhe shpenzimet

139. Ankuesi gjithashtu pretendoi 5 000 euro për kostot dhe shpenzimet para gjykatave kombëtare dhe 1 000 euro para Gjykatës. Ai nuk dha analizë të detajuar për vërtetimin e pretendimeve të tij në lidhje me kostot dhe shpenzimet.

140. Qeveria e kundërshtoi pretendimin duke e konsideruar si të ekzagjeruar.

141. Gjykata përsëriti se kostot dhe shpenzimet nuk do të rimbursohen në bazë të nenit 41, në rast se nuk provohet se ato janë paguar aktualisht, ishin të nevojshme të paguheshin dhe kanë qenë të arsyeshme për sa i përket sasisë (shih *The Sunday Times v. the United Kingdom* (neni 50), vendimi i datës 6 nëntor 1980, Seria A nr. 38, p. 13, § 23.) Gjithashtu kostot ligjore janë të rimbursueshme për sa kohë ato kanë lidhje me shkeljen e konstatuar (shiko *Beyler v. Italy*, (zhdëmtim) [GC], nr 33202/96, § 27, 28 maj 2002).

142. Gjykata konstaton se këto shpenzime të pretenduara nuk janë provuar me anë të dokumenteve përkatëse se janë paguar. Në këtë mënyrë ajo nuk do t'i rimbursojë ato.

3. Interesi i mospagimit

Gjykata çmon të nevojshme se interesi i mospagimit duhet të bazohet në normën marzhinale të huadhënies të Bankës Qendrore Europiane, së cilës duhet t'i shtohen tre pikë për qind.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA NJËZËRI:

1. I deklaron ankesat në lidhje me nenin 6 § 1 të Konventës (për sa i përket shkeljes së parimit të sigurisë juridike, paanshmëris së trupit gjykues dhe moszbatimit të një vendimi të formës së prerë) dhe nenin 1 të protokollit shtesë nr.1 të Konventës vetëm dhe së bashku me nenin 13 të Konventës, të pranueshme;

2. Konstaton, se ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës, për sa i përket parimit të sigurisë juridike, si rrjedhim i prishjes së vendimit të datës 17 dhjetor 1998, nga Gjykata e Lartë me anë të procedurës të rekursit në interes të ligjit dhe të proceseve paralele;

3. Konstaton, se për sa i përket vendimit të Gjykatës së Lartë të datës 5 korrik 2001 mbi themelin e çështjes, ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje me mungesën e paanësisë subjektive të kryetarit të Gjykatës së Lartë dhe mungesën e paanësisë objektive të Gjykatës së Lartë;

4. Konstaton, se ka pasur shkelje të nenit 1 të protokollit të parë shtesë të Konventës për sa i përket moszbatimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë të datës 17 dhjetor 1998 dhe të datës 7 dhjetor 2000;

5. Konstaton, se ka pasur shkelje të nenit 13 të Konventës i marrë së bashku me nenin nr.1 të protokollit nr.1 për sa i përket joefektivitetit të mjeteve juridike të parashikuara nga Ligji i Pronësisë;

6. Vlerëson se:

a) Shteti i paditur duhet t'i kthejë ankuesit brenda 3 muajve nga data në të cilën vendimi merr formë të prerë në pajtim me nenin 44 § 2 të Konventës, parcelën e tokës me sipërfaqe 1 650 m², si dhe t'i paguajë shumën prej 50 000 euro (pesëdhjetë mijë euro) në lidhje me dëmin pasuror dhe jopasuror për sa i përket kësaj parcele, e cila do të konvertohet në monedhën vendase të shtetit të paditur, në normën e zbatueshme në datën e shlyerjes, duke përfshirë edhe ndonjë taksë që mund të jetë e tatueshme;

b) Nëse nuk realizon kthimin e tokës së mësipërme, shteti i paditur detyrohet t'i paguajë ankuesit 280 000 euro (dyqind e tetëdhjetë mijë) në lidhje me dëmin pasuror dhe jopasuror, brenda gjashtë muajve nga data në të cilën vendimi merr formë të prerë, në pajtim me nenin 44 § 2 të Konventës. Kjo shumë duhet të konvertohet në monedhën vendase të shtetit të paditur, në normën e zbatueshme në datën e shlyerjes, duke përfshirë edhe ndonjë taksë që mund të jetë e tatueshme;

c) Shteti i paditur duhet t'i paguajë ankuesit, brenda tre muajve nga data në të cilën vendimi merr formë të prerë, në pajtim me nenin 44 § 2 të Konventës, shumën prej 500 000 euro (pesëqind mijë) në lidhje me dëmin pasuror dhe jopasuror për sa i përket parcelës së tokës me sipërfaqe prej 3 350 m², e cila duhet konvertuar në monedhën vendase të shtetit të paditur, në

normën e zbatueshme në datën e shlyerjes, duke përfshirë edhe ndonjë taksë që mund të jetë e tatueshme;

d) Që nga skadimi i afatit të sipërpërmendur prej gjashtë muajsh (përsa i përket pikës (a) dhe (b), dhe prej tre muajsh (përsa i përket pikës (c)) interesi i thjeshtë i shlyerjes do të jetë i pagueshëm mbi shumat e mësipërme në një normë të barabartë me normën marzhinale të huadhënies së Bankës Qendrore Europiane gjatë periudhës së mospagimit, plus tre pikë për qind.

8. Hedh poshtë pjesën e mbetur të pretendimeve të ankuesit për zhdëmtim të drejtë.

Përgatitur në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 13 nëntor 2007, sipas rregullit 77 § 2 dhe 3 të rregullores së Gjykatës.

T.L EARLY
Kryesekretar

Josep CASADEVALL
Kryetar

VENDIM
(Ankimi nr. 3738/02)
ÇËSHTJA “MARINI KUNDËR SHQIPËRISË”

STRASBOURG
18 dhjetor 2007

Ky vendim do të marrë formë të prerë në rrethanat e përcaktuara në nenin 44 § 2 të Konventës. Ai mund t'i nënshtrohet rishikimit redaktues.

Kjo çështje ka të bëjë me shkeljen e të drejtës së ankuesit për akses në gjykatë, Gjykata Kushtetuese duke mos u shprehur me vendim mbi kërkesën e ankuesit, efektivisht ka refuzuar të japë një vendim (shkelje e Nenit 6.1 të Konventës). Gjykata Evropiane ka konstatuar se zbatimi i Nenit 74 të Ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese” nuk është në interes të parimit të sigurisë juridike dhe privon ankuesit nga e drejta e tyre ligjore efektive për të patur një vendim përfundimtar mbi ankimin kushtetues.

Në çështjen “Marini kundër Shqipërisë”,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (seksioni i katërt), me trup gjykues të përbërë nga:

Sir Nicolas Bratza Kryetar

Z. J. Casadevall

Z. G. Bonello

Z. K. Traja

Z. S. Pavlovschi

Z. J. Šikuta

Znj. P. Hirvelä gjyqtarë,

dhe Z. T.L. Early Kryesekretar,

pas shqyrtimit me dyer të mbyllura më datë 2 tetor 2007 dhe 27 nëntor 2007,

merr vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua në datën e fundit të përmendur.

PROCEDURA

1. Çështja filloi në bazë të ankimit nr.3738/02 kundër Republikës së Shqipërisë, të depozituar në Gjykatë në përputhje me nenin 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa) nga një shtetas shqiptar, z. Vlash Marini (ankuesi), më 24 janar 2002.

2. Ankuesi u përfaqësua nga z. S. Puto, avokat që e ushtron aktivitetin e tij në Tiranë. Pala shqiptare u përfaqësua nga Përfaqësuesja e saj Ligjore, znj. S. Mëneri, Ministria e Punëve të Jashtme.

3. Ankuesi pretendoi se autoritetet nuk kishin përmbushur detyrimet që lindnin nga themelimi i një shoqërie me kapital themeltar të ortakëve në masën 50% secili, ku secila palë zotëronte 50% të aksioneve. Ai u ankua veçanërisht për shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës për: mosekzekutim të vendimeve të formës së prerë, tejzgjatje në kohë të procedimeve, mosarsyetim të vendimeve të gjykatës dhe mohim i së drejtës për t'u dëgjuar nga gjykata. Duke u bazuar në nenin 13 të Konventës, ai u ankua për mungesë mjeti efektiv ligjor ankimi në kuptimin e nenit 6 të Konventës. Së fundi, ai u ankua për shkelje të nenit 1 të Protokollit nr.1 të Konventës dhe nenit 14 të Konventës.

4. Më 10 prill 2006, seksioni i katërt i Gjykatës vendosi t'ia komunikonte ankimin palës shqiptare. Bazuar në dispozitat e nenit 29 § 3 të Konventës, ajo vendosi të shqyrtojë meritat (themelin) e ankimit si dhe pranueshmërinë e tij.

FAKTET

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

5. Ankuesi u lind në vitin 1936 dhe banon në Tiranë.

A. Procedurat në Arbitrazhin Shtetëror

6. Ankuesi, një shtetas amerikan dhe shqiptar, dhe Qeveria Shqiptare themeluan në vitin 1991 një ndërmarrje të përbashkët për një periudhë prej dhjetë vjetësh. Ndërmarrja u quajt “Marini-Albplastik” dhe u specializua në prodhimin e materialeve plastike. Statuti i shoqërisë i datës 11 mars 1991 u njoh me vendim të Këshillit të Ministrave të datës 23 prill 1991. Shoqëria e re u regjistrua në regjistrin tregtar në bazë të procedurave përkatëse.

7. Asetet e shoqërisë përbëheshin nga një fabrikë dhe pajisjet e saj, me vlerë totale 1,500,000 lekë (afërsisht 12,497 euro), të cilat më parë i përkisnin një shoqërie me kapital shtetëror, të quajtur “Mandimpeks”. Kontributi i ankuesit në kapitalin themeltar të shoqërisë ishte me vlerë totale 1,100,000 USD (afërsisht 834,098 euro), për t’u përdorur për rinovimin e fabrikës dhe blerjen e teknologjisë së re. Secila palë zotëronte 50% të aksioneve.

8. Më 30 maj 1991, për të përmbushur detyrimet e përcaktuara në statut, ankuesi nënshkroi me Edil-Plastic, kompani italiane, një kontratë në emër të shoqërisë “Marini-Albplastik” për blerjen e teknologjisë së re për prodhimin e materialeve plastike. Ai pagoi një shumë totale prej 228,000 dollarësh (afërsisht 173,000 euro). Një shumë e dytë parash do të investohej pas fazës së parë të rinovimit të fabrikës.

9. Pasi ishte kryer 60% e rinovimit të fabrikës, shteti ndërpreu veprimtarinë e shoqërisë dhe i kërkoi ankuesit të propozonte kushte të reja bashkëpunimi. Ankuesi nuk ra dakord. Për rrjedhojë, në një vendim të datës 3 prill 1993, Këshilli i Ministrave anuloi vendimin e tij të datës 23 prill 1991 dhe në mënyrë të njëanshme shfuqizoi marrëveshjen për themelimin e shoqërisë “Marini-Albplastik”.

10. Në një datë të papërcaktuar, për të përfituar dëmshpërblim, ankuesi u ankua në Arbitrazhin Shtetëror, i cili në atë kohë ishte organi kompetent për mosmarrëveshjet ku përfshiheshin ndërmarrjet me kapital shtetëror.

11. Më 7 maj 1993, Arbitrazhi Shtetëror njohu vlefshmërinë e statutit të shoqërisë “Marini-Albplastik”. Për më tepër, ai urdhëroi shtetin t’i paguante ankuesit 41 milionë lekë (afërsisht 341,608 Euro) për fitimin e munguar si rezultat i ndërprerjes së veprimtarisë së shoqërisë gjatë vitit 1992 dhe 68,400 lekë (afërsisht 569 euro) për të mbuluar interesin bankar për investimin e shumës 228,000 dollarë. Më tej, ai urdhëroi shoqërinë me kapital shtetëror të përfundonte punimet e rikonstruksionit të fabrikës brenda datës 30 tetor 1993. Së fundi, Arbitrazhi Shtetëror rrëzoi kërkesën e ankuesit për t’u kompensuar për pjesën e tij të aksioneve, me arsyetimin se ato përbënin pjesë të aktivitetit të shoqërisë.

12. Shteti e apeloj vendimin e mësipërm në Mbledhjen e Përgjithshme të Arbitrave të Arbitrazhit Shtetëror. Më 7 korrik 1993, ky i fundit pranoi pjesë të vendimit të Arbitrazhit Shtetëror që e urdhëronte shoqërinë të përmbushte detyrimet e saj për të vazhduar veprimtarinë e ndërmarrjes së përbashkët. Gjithashtu, ajo prishi pjesën e vendimit që i caktonte ankuesit dëmshpërblim për interesin bankar dhe fitimin e munguar dhe e dërgoi çështjen në Arbitrazhin Shtetëror për një përllogaritje të re të fitimit të munguar. Pjesa e parë e vendimit të datës 7 maj 1993 mori formë të prerë në po atë datë.

13. Më 5 nëntor 1993, në përputhje me udhëzimet e Mbledhjes së Përgjithshme të Arbitrave të Arbitrazhit Shtetëror në vendimin e saj të datës 7 korrik 1993, Arbitrazhi Shtetëror urdhëroi shtetin t’i paguante ankuesit shumën totale prej 26 milionë lekësh (afërsisht 217,286 euro) për fitimin e munguar në vitin 1992. Vendimi mori formë të prerë në të njëjtën datë.

14. Në një datë të papërcaktuar në vitin 1993, në përputhje me vendimin e sipërpërmendur të formës së prerë, përmbauesit ngrinë asetet e shoqërisë me kapital shtetëror dhe i paguan ankuesit shumën që i takonte prej 26 milionë lekësh.

15. Pas refuzimit të Këshillit të Ministrave për të zbatuar vendimin e Mbledhjes së Përgjithshme të Arbitrave të Arbitrazhit Shtetëror të datës 7 korrik 1993, ai i bëri kërkesë Gjykatës Kushtetuese për dëmshpërblim. Më 8 nëntor 1995, Gjykata Kushtetuese gjeti shkelje të të drejtave

kushtetuese të ankuesit dhe urdhëroi që ndaj tij të zbatohet vendimi i marrë nga Mbledhja e Përgjithshme e Arbitrave të Arbitrazhit Shtetëror.

16. Këshilli i Ministrave e zbatoi vendimin e Mbledhjes së Përgjithshme të Arbitrave të Arbitrazhit Shtetëror dy vjet pas daljes së tij.

B. Procesi gjyqësor në lidhje me vlefshmërinë e vendimit të Arbitrazhit Shtetëror

17. Në një datë të papërcaktuar, shoqëria me kapital shtetëror, ortake me ankuesin në ndërmarrjen e përbashkët, iu drejtua Gjykatës së Rrethit Tiranë për shpalljen absolutisht të pavlefshëm të vendimit të Arbitrazhit të datës 5 nëntor 1993, me arsyetimin se ai ishte marrë pasi Arbitrazhi kishte pushuar që qeni një trup vendimmarrës më 4 nëntor 1993. Për më tepër, ajo i kërkoi gjykatës të anulonte urdhrin e përmbarimit për ngrirjen e aseteve të saj, me synim zbatimin e vendimit të arbitrazhit.

18. Më 27 nëntor 1996 dhe 11 qershor 1997, respektivisht Gjykata e Rrethit Tiranë dhe Gjykata e Apelit Tiranë hodhën poshtë ankimin e shoqërisë dhe lanë në fuqi vendimin e Arbitrazhit Shtetëror në favor të ankuesit. Vendimi mori formë të prerë jo më vonë se 26 qershori 1997.

C. Privatizimi i fabrikës që i përkiste ndërmarrjes së përbashkët

19. Më 13 shtator 1996 dhe 24 janar 1997, respektivisht, Agjensia Kombëtare e Privatizimit i shiti F-së godinën e fabrikës dhe tokën ngjitur saj, pavarësisht se ato ishin aktivë të shoqërisë “Marini-Albplastik”.

20. Ankuesi filloi procesin kundër vendimit të privatizimit.

21. Më 10 qershor 1998, 18 dhjetor 1998, 1 dhjetor 1999, 19 dhjetor 2000 dhe 2 maj 2001, respektivisht Gjykata e Rrethit Tiranë, Gjykata e Apelit Tiranë, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe Gjykata Kushtetuese i konstatuan aktet e privatizimit absolutisht të pavlefshme dhe urdhëruan ndër të tjera që fabrika të trajtohet si pjesë e aseteve të shoqërisë “0Marini-Albplastik”. Së fundi, gjykatat vendase urdhëruan F-në. t’u kthejë pronësinë e fabrikës dhe tokës ngjitur saj ortakëve të shoqërisë “Marini-Albplastik”.

22. Pas një kërkesë të bërë nga ankuesi, Gjykata e Rrethit Tiranë nxori më 17 janar 2000 një urdhër për ekzekutimin e vendimit të datës 10 qershor 1998.

23. Pavarësisht urdhrin të sipërpërmendur, Ministria e Ekonomisë dhe Financave lidhi, pa aprovimin e ankuesit, më 4 korrik 2001, një kontratë qiraje njëzetvjeçare me një tjetër shoqëri, D, e cila do ta përdorte fabrikën në fjalë për prodhim këpucësh (shiko proceset në seksionin F më poshtë). Shoqëria D, e zotëronte tashmë fabrikën dhe operonte në bazë të një kontrate qiraje katërvjeçare të lidhur me F. në vitin 1998 (shiko proceset në seksionin D më poshtë).

D. Procesi gjyqësor në lidhje me vlefshmërinë e kontratës së parë të qirasë

24. Në vitin 1998, ndërsa nuk ishte përfunduar procesi mbi ligjshmërinë e vendimeve të privatizimit të fabrikës, F-ja lidhi një kontratë qiraje katërvjeçare me shoqërinë D, në bazë të së cilës kjo e fundit do të përdorte fabrikën për prodhimin e këpucëve.

25. Me qëllim pezullimin e ekzekutimit të urdhrin të gjykatës të datës 17 janar 2000, shoqëria D bëri kërkesë në Gjykatën e Rrethit Tiranë për pezullim të ekzekutimit të vendimit. Gjykata e pranoi kërkesën më 17 shkurt 2000.

26. Në një vendim të datës 11 maj 2000, Gjykata e Rrethit Tiranë shprehej se ankuesi duhej të zbatonte kushtet e kontratës së qirasë të lidhur mes F-së dhe shoqërisë D. Më 2 shkurt 2001 gjykata e apelit la në fuqi vendimin e mësipërm.

27. Ankuesi bëri rekurs kundër vendimit në Gjykatën e Lartë.

28. Më 23 dhjetor 2002 Gjykata e Lartë konstatoi që, përderisa vendimet e privatizimit u shpallën absolutisht të pavlefshme, F. nuk kishte mundësi të lidhte një kontratë të tillë; ndaj kontrata e qirasë ishte absolutisht e pavlefshme. Gjykata prishi vendimet e gjykatës së rrethit gjyqësor dhe të gjykatës së apelit dhe pushoi gjykimin e çështjes.

29. Sidoqoftë, në atë kohë kishte mbaruar kontrata katërvjeçare e qirasë (më 2 tetor 2002) dhe shoqëria D., me të cilën kishte lidhje procesi, e përdorte tashmë fabrikën në bazë të një kontrate të re qiraje, kësaj radhe të lidhur me Qeverinë (shiko procesin në seksionin F më poshtë).

E. Statuti/ Kontrata e re e shoqërisë “Marini-Albplastik”

30. Më 1 shkurt 2001, ndërsa vazhdonte procesi kundër shoqërisë D, në lidhje me vlefshmërinë e kontratës së parë të qirasë, Ministria e Punës dhe ankuesi ranë dakord të formojnë një shoqëri të re “Marini-Albplastik”. Shoqëria e re u krijua në bazë të statutit të shoqërisë së parë “Marini-Albplastik” të datës 11 mars 1991, vendimit të Arbitrazhit Shtetëror të datës 7 maj 1993 dhe vendimit përfundimtar në favor të ankuesit, të gjykatës së shkallës së parë të datës 10 qershor 1998.

31. Në bazë të nenit 9 të statutit që themeloi shoqërinë e re, “palët njohën përgjegjësitë e tyre për moszbatim të detyrimeve të përcaktuara në kontratën e parë dhe ranë dakord të paguanjë dëmet përkatëse (vendim i Arbitrazhit Shtetëror, datë 7 maj 1993 dhe vendim i Gjykatës së Rrethit Tiranë datë 10 qershor 1998)”.

32. Palët ranë dakord për të qenë ortakë të përbashkët të shoqërisë me 50% të kapitalit themeltar secili për një periudhë 10-vjeçare dhe ankuesi do të kishte rolin e administratorit të shoqërisë.

33. Me një vendim të datës 18 maj 2001, Gjykata e Rrethit Tiranë regjistroi shoqërinë e re me emrin “Marini-Albplastik” sh.p.k., një shoqëri prodhimi materialesh plastike, ndërmarrje në zotërim të përbashkët të ankuesit dhe një shoqërie me kapital shtetëror, që në atë kohë ishte nën përgjegjësinë e Ministrisë së Punës.

34. Më 6 shtator 2001, ortakët organizuan mbledhjen e parë të përgjithshme të asamblesë për të përcaktuar vlerën e tyre të aksioneve. Përfaqësuesi i ndërmarrjes shtetërore parashitroi se shteti do t'i regjistronte aksionet e tij në emër të shoqërisë “Marini-Albplastik” kur ankuesi të investonte pjesën e tij të aksioneve. Ankuesi nuk ra dakord, me arsyetimin se ligji parashikonte që ortakët duhej t'i investonin pjesët e tyre të kapitalit në të njëjtën kohë.

F. Procesi gjyqësor në lidhje me vlefshmërinë e kontratës së dytë të qirasë

1. Kontrata e dytë e qirasë

35. Më 4 korrik 2001, pavarësisht regjistrimit të shoqërisë së re më 18 maj 2001 dhe në shkelje të detyrimeve të marra përsipër nga Ministria e Punës më 1 shkurt 2001, Ministria e Ekonomisë dhe Financave, pa miratimin e ankuesit, lidhi një kontratë qiraje njëzetvjeçare me shoqërinë D. Në bazë të kontratës së re, shoqëria D, do ta përdorte fabrikën që i përkiste shoqërisë “Marini-Albplastik” për prodhim këpucësh.

2. Fshirja nga regjistri të aktivëve të shoqërisë “Marini-Albplastik”

36. Në lidhje me sa më sipër, Ministria e Ekonomisë dhe Financave urdhëroi më 23 korrik 2001 fshirjen e aktivëve të “Marini-Albplastik” nga Regjistri i Pasurive të Paluajtshme. Për rrjedhojë, fabrika dhe toka pranë saj u regjistruan si prona shtetërore.

37. Ankuesi bëri ankim kundër urdhrit pranë Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Gjykatës së Rrethit Tiranë dhe institucioneve të tjera shtetërore. Më 6 gusht 2001, Gjykata e Rrethit Tiranë urdhëroi pezullimin e ekzekutimit të urdhrit.

38. Në një letër të 27 korrikut 2001, Zëvendës kryeministri këshilloi Ministrin e Punës, Ministrin e Ekonomisë dhe Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të zbatonin vendimin e formës së prerë të gjykatës në favor të ankuesit.

39. Pavarësisht sa më sipër, aktivët e shoqërisë së ankuesit u fshinë nga Regjistri i Pasurive të Paluajtshme.

40. Në një datë të papërcaktuar, ankuesi ngriti padi në Gjykatën e Shkallës së Parë për mungesë ligjshmërie të një mase të tillë.

41. Më 24 qershor 2002, gjykata e shkallës së parë vendosi reregjistrimin e aktivëve të shoqërisë në regjistër.

42. Më 14 janar 2003, gjykata e apelit prishi vendimin e gjykatës së shkallës së parë për shkelje procedurale dhe ia dërgoi çështjen për rigjykim kësaj Gjykate.

43. Më 19 mars 2004, Gjykata e Lartë nuk pranoi rekursin e ankuesit, me arsyetimin se shkaku për të cilin ai bënte rekurs nuk përfshihej në rastet e parashikuara nga neni 472 të Kodit të Procedurës Civile.

44. Në një datë të papërcaktuar, Gjykata e Rrethit Tiranë, gjatë rigjykimit të çështjes, i kërkoi likuiduesit të shoqërisë së ankuesit të ndërhynte në proces si palë e tretë (shiko procesin e paraqitur në seksionin H më poshtë).

45. Më 27 janar 2005, gjykata e rrethit gjyqësor, gjatë rigjykimit të çështjes, hodhi poshtë padinë e ankuesit me arsyetimin se ai përfaqësonte një shoqëri në likuidim dhe për rrjedhojë nuk mund të ishte palë ndërgjyqëse. Ky vendim u la në fuqi nga gjykata e apelit më 12 maj 2005.

46. Më 27 janar 2007, Gjykata e Lartë nuk pranoi rekursin e ankuesit, me arsyetimin se shkaku për të cilin ai bënte rekurs nuk përfshihej në rastet e parashikuara nga neni 472 i Kodit të Procedurës Civile.

G. Procesi gjyqësor për zbatimin e urdhrin të ekzekutimit të datës 17 janar 2000

47. Për sa më sipër, shoqëria D, bëri kërkesë në Gjykatën e Rrethit Tiranë për pezullim ekzekutimi të vendimit të nxjerrë nga e njëjta gjykatë më 17 janar 2000 (shiko paragrafin më sipër 24). Gjykata e pranoi kërkesën më 14 tetor 2002.

48. Ankuesi bëri ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë.

49. Më 5 janar 2003, gjykata e apelit konstatoi që shoqëria D, nuk ishte palë në procesin që çoi në nxjerrjen e urdhrin të ekzekutimit të datës 17 janar 2000, ndaj nuk plotësonte kushtet për të bërë një kërkesë të tillë.

50. Më 10 prill dhe 9 maj 2002 dhe 23 nëntor 2002 respektivisht, Avokati i Popullit dhe Ambasadori i Shteteve të Bashkuara në Shqipëri u bënë thirrje autoriteteve të respektonin vendimet e marra për çështjen e ankuesit.

51. Në një letër të datës 27 janar 2003, Ministri i Ekonomisë i kërkonte Zyrës së Përmbartimit Gjyqësor të mos zbatonte urdhrin e gjykatës të datës 17 janar 2000, meqenëse fabrika ishte regjistruar në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme si pronë shtetërore dhe për këtë arsye nuk ishte më një aset i shoqërisë “Marini-Albplastik”, por pjesë e objektit të kontratës së qirasë të lidhur me një tjetër shoqëri.

52. Më 5 shkurt 2003, zyra e përmbartimit vendosi të mos zbatonte urdhrin e ekzekutimit.

53. Pas kërkesës së ankuesit në emër të shoqërisë, gjykata e shkallës së parë më datë 28 mars 2003 dhe gjykata e apelit më datë 5 qershor 2003 pranuan kërkesën e ankuesit dhe urdhëruan zyrën e përmbartimit të ekzekutonte urdhrin.

54. Zyra e përmbartimit bëri rekurs në Gjykatën e Lartë kundër këtyre vendimeve.

55. Më 23 mars 2004, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë hodhën poshtë vendimet e gjykatës së shkallës së parë dhe gjykatës së apelit dhe e dërguan çështjen për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë, me arsyetimin se gjykatat nuk kishin njoftuar për procesin gjyqësor zyrën e Avokatit të Popullit.

56. Në një datë të papërcaktuar, gjatë rigjykimit, duke marrë parasysh vendimin e dhënë prej vetë saj për likuidimin e shoqërisë, gjykata e shkallës së parë u kërkoi likuiduesve të shoqërisë “Marini-Albplastik” të bashkonin paditë në një gjykim të vetëm (shiko proceset e përmbledhura në seksionin H më poshtë). Ankuesi kundërshtoi me arsyetimin se mosmarrëveshja kishte të bënte me interesat e tij dhe jo ato të shoqërisë në likuidim.

57. Më 1 tetor 2004, me kërkesë të likuiduesit, gjykata e shkallës së parë pushoi procesin. Vendimi u la në fuqi nga gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë në datat 10 shkurt 2005 dhe 13 prill 2006 respektivisht.

H. Procedurat për likuidimin e “Marini-Albplastik”

58. Në vitin 2003, shoqëria shtetërore i ka kërkuar disa herë ankuesit, por pa rezultat, që në pozicionin e tij si administrator i shoqërisë “Marini-Albplastik”, të thërriste mbledhjen e asamblesë.

59. Më 21 shkurt 2003, gjatë një mbledhjeje të përgjithshme të asamblesë së shoqërisë, përfaqësuesi i shoqërisë shtetërore njoftoi ankuesin për vendimin e tij për të revokuar kontratën me shoqërinë “Marini-Albplastik”. Ankuesi e kundërshtoi këtë gjë. Për rrjedhojë, Ministria e Ekonomisë i kërkoi gjykatës të urdhëronte likuidimin e shoqërisë “Marini-Albplastik” dhe të aktiveve të saj, për mungesë interesimi nga ana e ankuesit për veprimtaritë e shoqërisë.

60. Më 8 maj 2003, gjykata caktoi një likuidues dhe vendosi likuidimin e “Marini-Albplastik”. Vendimi i gjykatës së shkallës së parë u la në fuqi nga gjykata e apelit me vendim të datës 20 nëntor 2003. Në datë 20 korrik 2004, Gjkata e Lartë nuk pranoi rekursin që pasoi këtë vendim, me arsyetimin se shkak për rekursin nuk përfshihej në rastet e parashikuara nga neni 472 i Kodit të Procedurës Civile.

61. Në një datë të papërcaktuar, ankuesi paraqiti kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, duke pretenduar, ndër të tjera, që proceset gjyqësore ishin të parregullta, me arsyetimin se Ministria e Ekonomisë, duke mos qenë aksionare e shoqërisë “Marini-Albplastik”, nuk kishte të drejtën të kërkonte likuidimin e shoqërisë dhe që proceset kishin filluar kundër ankuesit dhe jo kundër shoqërisë, përderisa Ministria e Punës, aksionarja tjetër, nuk ishte njoftuar për procesin.

62. Më 14 tetor 2004, likuiduesi i shoqërisë “Marini-Albplastik” i kërkoi ankuesit të dorëzonte llogaritë dhe vulën e shoqërisë, duke qenë se ai ishte administratori i shoqërisë. Duke pas parasysh kundërshtimin e ankuesit për të marrë pjesë në mbledhjet e asamblesë të thirrura nga likuiduesi, ky i fundit i kërkoi Gjykatës së Rrethit Tiranë të vërtetonte llogaritë përfundimtare të shoqërisë dhe të urdhëronte fshirjen e saj nga regjistri tregtar. Ankuesi kërkoi pezullim të gjykimit deri në daljen e vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

63. Më 6 janar 2005, Gjkata e Rrethit Tiranë hodhi poshtë kërkesën e ankuesit, vërtetoi llogaritë përfundimtare të shoqërisë dhe urdhëroi përfundimin e procesit të likuidimit. Ajo urdhëroi gjithashtu që përfundimi i procesit të likuidimit të shënohej në regjistrin tregtar. Ky vendim u la në fuqi nga Gjkata e Apelit Tiranë më 7 qershor 2005.

64. Më 27 prill 2005, Gjkata Kushtetuese, në seancë plenare me praninë e shtatë nga nëntë gjyqtarë sikurse përcaktohet nga ligji përkatës për funksionimin dhe organizimin e saj, refuzoi kërkesën e ankuesit meqenëse çështja nuk ishte votuar nga shumica e kërkuar/votat ishin ndarë në mënyrë të barabartë. Gjkata u kufizua në arsyetimin e saj në faktin që nuk u arrit shumica e kërkuar e votave për asnjë nga çështjet e ngritura në rastin e paraqitur. Në bazë të nenit 74 të ligjit për Gjykatën Kushtetuese, ankuesi u ftua të riparaqesë kërkesën (shiko paragrafin 72 më poshtë).

65. Ankuesi nuk e riparaqiti kërkesën në Gjykatën Kushtetuese sipas nenit 74 të ligjit për Gjykatën Kushtetuese.

II. LEGJISLACIONI I BRENDSHËM PËRKATËS

A. Kushtetuta

66. Dispozitat përkatëse të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë vijnë si më poshtë:

Neni 42 § 2

“Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.”

Neni 131

“Gjkata Kushtetuese vendos për:....

f) gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave.”

Neni 133

“(…)

2. Gjkata Kushtetuese vendos me shumicën e të gjithë anëtarëve të saj.”

Neni 142 § 3

“Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore.”

B. Ligji nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”

67. Ligji përcakton se Gjkata Kushtetuese është autoriteti më i lartë që garanton respektimin e Kushtetutës dhe bën interpretimin e saj.

68. Gjkata përbëhet nga nëntë anëtarë, të cilët zgjidhen nga Presidenti i Republikës me pëlqimin e Kuvendit (neni 7).

69. Shqyrtimi paraprak i kërkesës bëhet nga një kolegji i përbërë nga 3 gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, ku bën pjesë dhe relatori (neni 31).

70. Gjykata i gjykon çështjet në seancë plenare, ku marrin pjesë të gjithë gjyqtarët. Kuorumi i seancës plenare është 2/3 e gjyqtarëve të zgjedhur në detyrë (neni 32). Gjykata vendos me shumicën e të gjithë anëtarëve të saj (neni 133 i Kushtetutës).

71. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese merren me shumicën e votave të të gjithë gjyqtarëve të saj dhe abstenimi nuk lejohet (neni 72).

72. Në bazë të nenit 74 të ligjit, në rast se votat ndahen në mënyrë të barabartë ose në atë mënyrë që asnjë përfundim i çështjes nuk votohet nga shumica e kërkuar, Gjykata Kushtetuese vendos refuzimin e kërkesës. Vendimi për refuzimin e kërkesës nuk përbën pengesë që kërkuuesi ta riparaqesë kërkesën pranë të njëjtës Gjykate, e cila merr vendim në rast se krijohen kushtet për formimin e shumicës së kërkuar.

C. Ligji nr. 7424, datë 14.11.1990 “Për Arbitrazhin Shtetëror”

73. Ligji për Arbitrazhin Shtetëror parashikonte organizimin dhe funksionimin e Arbitrazhit Shtetëror, i cili ishte organi me juridiksion zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ku shqyrtoheshin interesat pasurorë të shtetit. Në përputhje me nenin 28 të ligjit, kur vendimet e tij merrnin formë të prerë, ishin të detyrueshme për Bankën e Shtetit, organet financiare të shtetit dhe zyrën e përmbarimit.

74. Procesi për ekzekutimin e vendimeve të formës së prerë fillonte me depozitimin e kërkesës në zyrën e përmbarimit gjyqësor. Sipas nenit 30 të ligjit, kundër vendimeve të Arbitrazhit Shtetëror mund të bëhej ankim në Mbledhjen e Përgjithshme të Arbitrarëve të Arbitrazhit Shtetëror.

75. Ky ligj u shfuqizua me ligjin nr.7801, datë 2.3.1994, i cili shpërndau Arbitrazhin e Shtetit.

II. LEGJISLACIONI KRAHASUES PËRKATËS

76. Materialet në dispozicion të Gjykatës paraqesin raste të ngjashme kur gjatë votimit votat ndahen në mënyrë të barabartë apo nuk arrihet shumica e kërkuar në vendimmarrjet e gjykatave të larta në një sërë shtetesh kontraktuese, që përfaqësojnë tradita të ndryshme ligjore. Nuk ekziston një praktikë e unifikuar në shtetet kontraktuese në lidhje me dukurinë e ndarjes së votave në mënyrë të barabartë apo mosarritjes së shumicës së kërkuar në vendimet që merren nga gjykatat e larta dhe kushtetuese. Shumë shtete parashikojnë masa për të shmangur një dukuri të tillë dhe për të siguruar shumicën e votave, që do të thotë, duke krijuar kolegje të përbëra nga një numër tek gjyqtarësh (për shembull në Shqipëri, Bosnjë-Hercegovinë, Poloni, Maltë dhe Mbretërinë e Bashkuar) dhe/ose duke mos i lejuar gjyqtarët të abstenojnë (për shembull në Shqipëri, Bosnjë-Hercegovinë dhe Moldavi) dhe ose duke përcaktuar një numër tek gjyqtarësh për të siguruar kuorumin për të marrë vendim (për shembull në Itali, Andora dhe Austri). Sidoqoftë, edhe në këto rrethana mundet të ndodhë që të ndahen votat në mënyrë të barabartë ose të mos arrihet shumica e kërkuar. Për të siguruar marrjen e një vendimi përfundimtar, pavarësisht se ndodh kjo dukuri, sisteme të ndryshme ligjore japin zgjidhje të ndryshme, që do të thotë se vendos vota e kryetarit të gjykatës/kolegjit (për shembull në Austri, Itali dhe Spanjë) ose vendos vota e relatorit të gjyqit (për shembull në Andora) ose duke bërë një interpretim të ndarjes së votave në mënyrë të barabartë (për shembull në Gjermani, Poloni, Sllovaki dhe Moldavi). Në rast se votat ndahen në mënyrë të barabartë ose nuk arrihet shumica e kërkuar, sistemi ligjor shqiptar bën shtyrjen e çështjes deri në një kohë të papërcaktuar, derisa rrethanat që sollën ndarjen e votave në mënyrë të barabartë apo mosarritjen e shumicës së kërkuar nuk ekzistojnë më (shiko paragrafin 72 më sipër).

E DREJTA

77. Duke iu referuar nenit 6 § 1 të Konventës, ankuesi u ankua për moszekzekutimin nga organet të vendimit të formës së prerë, tejzgjatjen në kohë të procesit, mungesën e arsytimit të vendimeve të gjykatës dhe mohimin e së drejtës për t’u dëgjuar nga një gjykatë. Duke u mbështetur në nenin 13 të Konventës, ai u ankua për mungesë të një zgjidhjeje efektive të ankimeve të tij sipas nenit 6. Së fundi, ankuesi u ankua për shkelje të nenit 1 të protokollit nr.1 dhe nenit 14 të Konventës.

78. Neni 6 § 1 i Konventës, për sa ka lidhje me çështjen, parashikon:

“1. Në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile ..., çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj ...”

79. Neni 13 i Konventës parashikon si vijon:

“Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e njohura në këtë Konventë, ka të drejtë të bëjë ankim efektiv tek një organ i vendit të tij, edhe kur shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.”.

80. Neni 1 i protokollit nr.1 të Konventës parashikon:

“Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën që t’i respektohet pasuria e tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e shteteve për të nxjerrë ligje, që ato i gjykojnë të domosdoshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve të tjera, ose të gjobave.”.

81. Neni 14 i Konventës parashikon:

“Gëzimi i të drejtave dhe lirive të njohura në këtë Konventë duhet të sigurohet pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si: seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër.”.

I. KUNDËRSHTIMI PARAPRAK I PALËS SHQIPTARE

A. Shpërdorimi i të drejtës së ankimit nga individi

82. Pala shqiptare kërkoi që ankimi të deklarohet i papranueshëm, meqenëse ishte shpërdoruar e drejta për ankim nga individi. Ajo deklaroi se ankuesi kishte shtrembëruar faktet e çështjes dhe kishte keqinterpretuar qëllimisht vendimet e gjykatave vendase. Në lidhje me regjistrimin e ndërmarrjes së përbashkët në vitin 1993, pala shqiptare parashittoi se ajo ishte regjistruar në regjistrin tregtar në përputhje me dispozitat e reja të ligjit nr.7667 të vitit 1993, i cili kishte hyrë në fuqi pasi ishte krijuar ndërmarrja e përbashkët në fjalë, por kishte fuqi prapavepruese. Kështu, ankuesi nuk mund të pretendonte të drejta civile nga një shoqëri e jashtëligjshme, pavarësisht faktit se Arbitrazhi Shtetëror nuk e kishte marrë parasysh këtë fakt në vendimin e tij dhe kishte konstatuar se shteti kishte përgjegjësi në menaxhimin e ndërmarrjes së përbashkët.

83. Ankuesi kundërshtoi argumentet e palës shqiptare.

84. Neni 35 § 3 II Konventës, për sa i përket çështjes, parashikon si më poshtë:

“Gjykata deklaron të papranueshme çdo kërkesë individuale të paraqitur në zbatim të nenit 34, kur çmon se kërkesa ... është haptazi e pabazuar ose abuzive.”

85. Gjykata përsëriti argumentin që, përveçse në raste të jashtëzakonshme, kërkesa mund të hidhet poshtë si abuzive vetëm nëse ajo bazohet me dashje në fakte të pavërteta (shiko Akdivar e të Tjerë k. Turqisë, vendim i 16 shtatorit 1996, Raporte të Gjykimeve dhe Vendimeve 1996-IV, §§ 53-54; I.S. k. Bullgarisë, vendim nr. 32438/96, 6 prill 2000; dhe Varbanov k. Bullgarisë, nr. 31365/96, § 36, GJEDNJ 2000-X).

86. Ajo gjykon se kundërshtimi i palës shqiptare buron nga një ndryshim në mendimin ligjor mbi interpretimin e vendimeve të gjykatave vendase dhe Gjykata nuk mendon se kjo shkon deri në abuzim të së drejtës për të bërë ankim në këtë Gjykatë. Për rrjedhojë, ajo nuk e pranoi kundërshtimin e palës shqiptare.

B. Shkelja e pretenduar e nenit 17 të Konventës

87. Sipas palës shqiptare, në çdo rast, neni 17 i Konventës nuk e lejonte ankuesin t’u referohej parashikimeve të nenit 6 të Konventës, për sa u përket kërkesës së tij drejtuar Gjykatës për të deklaruar vendimet e gjykatave vendase si jokushtetuese, kërkesë që nuk hynte në juridiksionin e kësaj Gjykate.

88. Ankuesi nuk bëri komente për këtë çështje.

89. Neni 17 parashikon:

“Asnjë nga dispozitat e kësaj Konvente nuk mund të interpretohet se i jep një shteti, grupimi apo individ të drejtë që të ndërmarrë ose të kryejnë ndonjë akt që synon cenimin e të drejtave ose lirive të njohura në këtë Konventë, ose kufizime më të gjera të këtyre të drejtave ose lirive të parashikuara gjithashtu në këtë Konventë.”.

90. Gjykata rithekson se qëllimi i nenit 17, për sa i takon grupimeve apo individëve, është të bëjë të pamundur që ata të përfitojnë nga Konventa të drejtën për t'u përfshirë në ndonjë aktivitet apo të kryejnë ndonjë akt që synon cënimin e të drejtave dhe lirive të njohura në Konventë. Kështu që askush të mos mund të përfitojë nga dispozitat e Konventës për të kryer akte me synim cënimin e këtyre të drejtave dhe lirive. Kjo dispozitë, e cila është ndaluese në objektin e saj, nuk mund të interpretohet me supozim të ndërsjellë, se privon një person fizik nga liritë themelore të individit të garantuara nga nenet 5 dhe 6 të Konventës (shiko Lawless k. Irlandës (nr.3), vendim i 1 korrikut 1961, Seria A, nr. 3, fq. 45-46, § 7).

91. Në çështjen në fjalë, ankuesi nuk është mbështetur në Konventë për të justifikuar apo kryer akte në kundërshtim me të drejtat dhe liritë të njohura aty, por është ankuar, ndër të tjera, se i janë privuar garancitë e parashikuara nga neni 6 i Konventës. Ndaj, Gjykata nuk ka mundësi tjetër veçse të hedhë poshtë kundërshtimin e palës shqiptare.

C. Ankimi i depozituar jashtë afatit

92. Pala shqiptare argumentoi se ankimi ishte bërë jashtë afatit prej gjashtë muajsh të parashikuar nga Konventa. Ajo parashtroi se, meqenëse argumenti kryesor e ankuesit ishte mosekzekutimi i vendimit të Arbitrazhit Shtetëror të vitit 1993, i cili përbënte bazën për ankimet e mëtejshme të ankuesit, ky vendim ishte vendimi i fundit për qëllimet e nenit 35. Pra, ankimi duhet konsideruar se i është drejtuar Gjykatës jashtë afatit kohor të përcaktuar nga neni 35 i Konventës.

93. Ankuesi kundërshtoi argumentin e palës shqiptare, duke parashtuar se mosekzekutimi i vendimit të Arbitrazhit Shtetëror ishte objekti i vetëm një prej ankimeve të bëra për këtë çështje dhe që ankimet e tjera ishin më vete. Gjithashtu, edhe nëse supozohet se argumenti i palës shqiptare ishte i bazuar, ai parashtroi se afati gjashtëmuor nuk mund të zbatohet ndaj shkeljeve të vazhdueshme të pretenduara, si për shembull mosekzekutimi i një vendimi të formës së prerë. Ai u mbështet në çështjen Hornsby k. Greqisë (vendim i datës 19 mars 1997, Reportet 1997-II, fq. 508, § 35) dhe Qufaj Co. Sh.p.k. k. Shqipërisë (vendim nr. 54268/00, GJEDNJR 2003-XI).

94. Gjykata vëren që ankimi në fjalë i ishte drejtuar Gjykatës më 24 janar 2002. Vendimet e formës së prerë, me qëllim përlllogaritjen e afatit gjashtëmuor, në lidhje me shkallët e ndryshme të gjykimin, u morën më 2005 dhe 2006.

95. Në lidhje me ankimin për mosekzekutimin e vendimeve të formës së prerë, Gjykata konstaton, sikurse dhe ankuesi, se dështimi i organeve për të ekzekutuar vendimet e formës së prerë çoi në një situatë të pandërprerë, ndaj nuk gjen zbatim rregullin për afatin gjashtëmuor (shiko, ndër burimet e tjera zyrtare, Iatridis k. Greqisë [GC], nr. 31107/96, § 50, GJEDNJ 1999-II).

96. Për këtë arsye, duhet hedhur poshtë kundërshtimi për sa i përket të gjitha ankimeve të ankuesit depozituar më 24 janar 2002.

D. Mosezaurimi i mjeteve të brendshme ligjore për ankimin për kohëzgjatjen e proceseve

97. Pala shqiptare i kërkoi Gjykatës të hidhte poshtë ankimin mbi tejzgjatjen e procesit me arsyetimin se ankuesi nuk kishte ezauruar mjetet e brendshme ligjore të ankimit. Në lidhje me këtë, ajo pretendoi se ankuesi nuk kishte bërë kërkesë pranë Gjykatës Kushtetuese në përputhje me nenin 131 të Kushtetutës. Pa iu referuar ndonjë praktike të gjykatave vendase, ajo theksoi efektshmërinë e kërkesës bërë Gjykatës Kushtetuese, e cila kishte juridiksion të merrej me çështjet e procesit të drejtë ligjor, dhe kështu mund të siguronte vënien në vend të së drejtës, nëse ankuesi do i ishte drejtuar me një kërkesë mbi zgjatjen në kohë të procesit.

98. Ankuesi nuk ishte dakord me palën shqiptare. Ai parashtroi faktin se deri në atë kohë Gjykata Kushtetuese nuk kishte shqyrtuar kurrë më parë një kërkesë mbi tejzgjatjen në kohë të çështjes dhe kështu të provonte efektshmërinë e një mjeti të tillë ligjor. Ai iu referua faktit se pala shqiptare nuk kishte mundur të përmendte ndonjë praktikë të kësaj Gjykate apo t'i referohej ndonjë

dispozite të legjislacionit të brendshëm për të mbështetur argumentet e saj mbi çështjen.

99. Gjykata gjykon se efektshmëria e apelimit kushtetues është vendimtare për të përcaktuar nëse ankuesi i kishte mjetet e duhura ligjore në kuptimin e nenit 35 § 1 dhe nenit 13 të Konventës. Për këtë arsye, Gjykata shprehet se themeli i të dyja çështjeve duhet shqyrtuar së bashku.

II. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS

100. Ankuesi u ankua për shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës për mosekzekutim të vendimeve të formës së prerë të dhëna në favor të tij, tejzgjatje në kohë të proceseve, mungesë arsytimi të vendimeve të Gjykatës së Lartë dhe kufizim të së drejtës së tij për t'u dëgjuar nga gjykata, për dy shkaqe: refuzimi i kërkesës së tij drejtuar Gjykatës Kushtetuese për shkak se çështja nuk u votua nga shumica e kërkuar dhe nxjerrja e urdhrat për likuidimin e shoqërisë, që e kishin penguar atë të vinte në lëvizje gjykatën në mbrojtje të interesave të tij.

101. Në komentet e tij të datës 11 dhjetor 2006, ankuesi vuri në dyshim paanshmërinë e Gjykatës së Lartë, me argumentimin se vendimi i datës 27 janar 2006 ishte dhënë nga i njëjti kolegji që e kishte gjykuar tashmë çështjen e tij më 19 mars 2004.

A. Pranueshmëria

1. Paanshmëria e Gjykatës së Lartë

102. Gjykata vëren se ankimi i ankuesit në lidhje me paanshmërinë e kolegjit të Gjykatës së Lartë që mori vendim për çështjen e tij më datë 27 janar 2006, u bë vetëm më 11 dhjetor 2006, çka do të thotë pasi kishte kaluar afati gjashtëmujor i parashikuar nga Konventa. Në këto rrethana, ai duhet hedhur poshtë si i bërë jashtë afatit gjashtëmujor të parashikuar nga nenet 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës.

2. Mungesa e arsytimit

103. Ankuesi u ankua se në vendimet e saj të datave 19 mars 2004, 20 korrik 2004 and 27 janar 2006, Gjykata e Lartë nuk kishte pranuar rekursin e tij, duke përdorur formulime standarde (me arsytimin se shkaku për të cilin ai bënte rekurs nuk përfshihej në rastet e parashikuara nga neni 472 i Kodit të Procedurës Civile). Sipas tij, duke marrë parasysh faktin se rekursat e tij kishin të bënin me një sërë çështjesh, formulimi i mësipërm nuk sqaronte arsyet e vendimit të marrë nga gjykata vendase. Duke pasur parasysh faktin se, sipas tij, arsyet e rekursit përfshiheshin të paktën në rastin e parashikuar nga neni 472, germa “a” të Kodit të Procedurës Civile, kjo formulë mospranimi *de plano* nuk merrte parasysh detyrimin e legjislacionit të brendshëm dhe të Konventës për vendime të arsyetuara.

104. Pala shqiptare kundërshtoi pretendimin e ankuesit. Ajo parashtroi se meqenëse Gjykata e Lartë kishte lënë në fuqi vendimet e Gjykatës së Apelit ndaj të cilave ankuesi kishte bërë rekurs, duhej konsideruar që ajo vërtetonte arsytimin e këtyre gjykatave; ndaj, nuk ishte nevoja të përsëriteshin arsyet e dhëna nga ajo gjykatë.

105. Gjykata përsërit se e drejta që i garantohet një ndërgjyqësi prej nenit 6 të Konventës, përfshin të drejtën për arsytimin e vendimeve të marra nga një gjykatë vendase për çështjen e tij. Sidoqoftë, detyrimi që ka një gjykatë vendase për të arsyetuar vendimet e saj, nuk mund të interpretohet sikur kërkohet arsytim i detajuar për çdo pretendim të palës ndërgjyqëse. Detyrimi për të arsyetuar vendimin varet nga natyra e vendimit në fjalë (shiko, për shembull Helle k. Finlandës, vendim i datës 19 dhjetor 1997, Raportet 1997-VIII, fq. 2929, § 56).

106. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se ankuesi bëri rekurs në Gjykatën e Lartë me pretendimin se në vendimet e gjykatave më të ulëta është zbatuar keq ligji. Gjykata çmon se, sidoqoftë, arsytimi i kufizuar që Gjykata e Lartë bëri në formulën *de plano* të vendimit të saj, tregonte pa dyshim që ankuesi nuk kishte parashtruar si bazë ligjore një nga pikat e parashikuara nga dispozita e brendshme përkatëse, që është një kërkesë për pranimin e rekursit. Gjykata vëren se kur Gjykata e Lartë nuk pranon një rekurs për shkak se nuk është parashtruar baza ligjore e çështjes, kërkesat e nenit 6 të Konventës mund të plotësohen me një arsytim shumë të kufizuar (shiko, *mutatis mutandis*, Nerva k. Mbreërisë së Bashkuar, vendim nr. 42295/98, 11 korrik 2000).

107. Për arsyet e sipërpërmendura, Gjykata çmon se kërkesa e ankuesit bazuar në këtë pikë të nenit 6 të Konventës, është haptazi e pabazuar në kuptimin e nenit 35 § 3, ndaj e papranueshme në zbatim të nenit 35 § 4 të Konventës.

3. Pjesa tjetër e ankimit

108. Për sa i përket pjesës tjetër të ankimit të ankuesit të bazuar në këtë dispozitë, konkretisht mohimi i së drejtës për t'u dëgjuar nga gjykata, mosekzekutimi i vendimeve të formës së prerë dhe tejzgjatja në kohë e procesit, Gjykata çmon se ato nuk janë haptazi të pabazuara në zbatim të nenit 35 § 3 të Konventës. Ajo konstaton në vazhdim se këto kërkesa nuk janë të papranueshme për ndonjë arsye tjetër. Për këtë arsye ato duhen deklaruar të pranueshme.

Gjithashtu, Gjykata çmon se edhe pse ankimi për zgjatjen e procesit ka të bëjë me të njëjtën situatë faktike si ajo e ankimit për mosekzekutim të vendimeve, dispozitat përkatëse të Konventës janë shumë të ndryshme. Ndaj, ajo do ta shqyrtojë themelin e të dy ankimeve veçmas.

B. Meritat (themeli)

1. Mohimi i së drejtës për t'u dëgjuar nga gjykata

(a) Parashtrimet e palëve

109. Ankuesi u ankua që gjatë proceseve në gjykatën vendase, ishte cenuar e drejta e tij për t'u dëgjuar nga gjykata në dy aspekte. Së pari, ai u ankua për urdhrin për likuidimin e shoqërisë, që e kishte penguar atë të fillonte procesin gjyqësor në mbrojtje të interesave të tij. Më tej, ai parashtroi se gjatë proceseve vendase, ai ishte përfaqësuar nga likuiduesi, i cili kishte vepruar kundër interesave të tij.

110. Së dyti, ankuesi parashtroi që mosarritja e shumicës së votave në vendimin e Gjykatës Kushtetuese të datës 27 prill 2005, kishte cenuar të drejtën e tij për t'u dëgjuar nga Gjykata Kushtetuese. Fakti që ai më pas mund të ribënte kërkesë pranë Gjykatës nuk siguronte zgjidhje, sepse mund të ndodhte përsëri që të mos arrihej shumica e kërkuar.

111. Pala shqiptare nuk bëri komente mbi ankimin për aspektin e parë. Për sa i përket ankimit në lidhje me aspektin e dytë, ajo e kundërshtoi argumentin e tij, duke u shprehur se rrëzimi i kërkesës në rast mosarritjeje të shumicës së kërkuar parashikohej nga ligjvënësi për të garantuar parimin e sigurisë juridike. Kjo nuk sillte pasoja të përhershme, meqenëse gjykata mund ta shqyrtonte përsëri të njëjtën kërkesë sapo të ndryshonin rrethanat që kishin çuar në mosarritjen e shumicës së kërkuar të votave dhe të bëhej një kërkesë e re në Gjykatën Kushtetuese.

(b) Vlerësimi i Gjykatës

112. Gjykata përsërit se neni 6 § 1 i Konventës i garanton çdo personi të drejtën për t'u dëgjuar nga gjykata për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile. Në këtë mënyrë, ai parashikon "të drejtën për proces të rregullt", ku e drejta për t'u dëgjuar, që është e drejta për të filluar një proces gjyqësor për çështjet civile, përbën një aspekt të saj (shiko Golder k. Mbretërisë së Bashkuar, vendim i datës 21 shkurt 1975, Seria A, nr. 18, fq. 17-18, §§ 35-36). Kjo e drejtë shtrihet vetëm për mosmarrëveshjet (konfliktet) për "të drejta dhe detyrime të natyrës civile", të cilat mund të thuhet, të paktën kur mund të vërtetohet, se njihen nga legjislacioni i brendshëm (shiko, përveç burimeve të tjera zyrtare, James e të Tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar, vendim i datës 21 shkurt 1986, Seria A, nr. 98, fq. 46-47, § 81, dhe Powell e Rayner k. Mbretërisë së Bashkuar, vendim i datës 21 shkurt 1990, Seria A nr. 172, fq. 16-17, § 36).

113. Më tej, "e drejta për gjykimin e çështjes" nuk është absolute. Ajo u nënshtrohet kufizimeve të nënkuptuara, veçanërisht kur bëhet fjalë për kushtet e pranueshmërisë së një kërkesë, meqenëse për vetë natyrën e tyre, nevojitet rregullimi i shtetit, i cili gëzon një rezervë të caktuar për të bërë vlerësimin në lidhje me këtë (shiko Ashingdane k. Mbretërisë së Bashkuar, vendim i datës 28 mars 1985, Seria A, nr. 93, fq. 24-25, § 57). Sidoqoftë, këto kufizime nuk duhet të kufizojnë apo zvogëlojnë të drejtën e personit për t'u dëgjuar në atë mënyrë apo masë sa të cënohet thelbi i së drejtës; së fundi, kufizime të tilla nuk janë në përputhje me nenin 6 § 1 nëse ato nuk kanë një synim të përligjur ose nëse nuk ka një lidhje të arsyeshme proporcionaliteti mes mjetit të përdorur dhe qëllimit që synohet të arrihet (shiko Levages Prestations Services k. Francës, vendim i datës 23 tetor 1996, Reportet 1996-V, fq. 1543, § 40).

114. Tani Gjykata do të shqyrtojë kërkesën e ankuesit duke pasur parasysh parimet e përgjithshme të sipërcituara.

(i) Mohimi i së drejtës për t'u dëgjuar nga gjykata si pasojë e procedurave të likuidimit

115. Gjkata mendon se kufizimi që iu bë ankuesit në mundësinë për të filluar proces gjyqësor synonte që t'i caktohej likuiduesit roli i përfaqësimit të shoqërisë së likuiduar në gjykatë për çështjet e ngritura mbi të drejtat e saj pasurore. Me daljen e urdhrat për likuidimin, likuiduesi është përgjegjës për administrimin e aseteve të shoqërisë. Sipas Gjykatës, në fakt, është e vetëkuptueshme që mosmarrëveshje për çështje të tilla mund të kenë pasoja të rëndësishme në aktivët dhe pasivet e pasurisë së shoqërisë. Për rrjedhojë, Gjkata konstaton se kufizimi ka synuar të mbrojë të drejtat dhe interesat e të tjerëve, konkretisht ato të kreditorëve të shoqërisë. Gjkata do të vazhdojë të shqyrtojë nëse pasojat që pati ankuesi ishin në përpjestim me synimin e ligjshëm të kërkuar (shiko, *mutatis mutandis*, Luordo k. Italisë, nr.32190/96, § 86, GJEDNJ 2003-IX).

116. Sikurse Gjkata e ka konfirmuar në praktikën e saj, rreziku në një sistem të tillë qëndron në faktin se ai mund të kufizojë në mënyrë të paarsyeshme të drejtën për t'u dëgjuar nga gjykata, veçanërisht nëse proceset tejzgjaten (në të njëjtin dokument., § 87). Gjkata vëren se për çështjen në fjalë procedurat e likuidimit zgjatën katër vjet. Ankuesi mundi të kundërshtonte procedurat e likuidimit në katër shkallë gjykimi. Ndaj, nuk mund të konsiderohet se të drejtat e tij në shqyrtim u kufizuan në mënyrë të paarsyeshme. Përveç kësaj, edhe nëse supozohet se ankimi i ankuesit kishte të bënte me sjelljen e likuiduesit, ai nuk ia doli mbanë ta provonte këtë sjellje para gjykatave vendase.

117. Duke pasur parasysh sa më sipër, Gjkata del në përfundimin se procedurat e likuidimit nuk çuan në shkelje të së drejtës për t'u dëgjuar nga gjykata, sikurse garantohet nga neni 6 § 1 i Konventës.

(ii) Mohimi i së drejtës për t'u dëgjuar nga gjykata si rezultat i mosarritjes së shumicës së kërkuar të votave

118. Gjkata vëren se neni 74 i ligjit për organizimin e Gjykatës Kushtetuese (në vijim LOGJK) parashikon që Gjkata Kushtetuese duhet të rrëzojë kërkesat e personave në rast se votat ndahen në mënyrë të barabartë dhe/ose në rast se asnjë përfundim i çështjes nuk votohet nga shumica e kërkuar. Nëse ankuesi i drejtohet me një kërkesë të re Gjykatës Kushtetuese, kërkesa me të njëjtin objekt dhe që ngre të njëjtën çështje mund të rishqyrtohet më vonë prej saj.

119. Edhe pse palët kanë deklaruar se kërkesa e ankuesit është rrëzuar nga Gjkata Kushtetuese për shkak të mosarritjes së shumicës së kërkuar të votave, Gjkata vëren se Gjkata Kushtetuese ishte mbledhur në kolegji të përbërë nga shtatë gjyqtarë dhe në përputhje me nenin 72 të LOGJK, është e pamundur që gjyqtarët që marrin pjesë në gjykim të abstenojnë. Për këtë arsye, dhe në kundërshtim me pozicionin e palëve, Gjkata mundet vetëm të dalë në përfundimin se Gjkata Kushtetuese nuk mori një vendim në lidhje me kërkesën e ankuesit jo për shkak të ndarjes së votave, por për shkak të pamundësisë të saj për të siguruar shumicën në ndonjë nga çështjet e paraqitura për gjykim. Është konstatuar se nuk janë dhënë arsyet për këtë situatë të krijuar.

120. Gjkata kujton se neni 6 i Konventës nuk i detyron Shtetet Kontraktuese të krijojnë gjykata apeli apo kasacioni. Megjithatë, shteteve që krijojnë gjykata të tilla u kërkohet të sigurojnë që personat që nisin procese gjyqësore do të gëzojnë ndaj këtyre gjykatave garancitë themelore që parashikon neni 6 (shiko, ndër dokumentat e tjera zyrtare, Delcourt k. Belgjikës, vendim i datës 17 janar 1970, Seria A, nr. 11, fq. 14, § 25). Në këto garanci përfshihet e drejta për një vendim përfundimtar për çështjet e paraqitura në gjykatë, në rastin e ankuesit përfshirë një vendim mbi pranueshmërinë dhe/ose themelin e kërkesës së tij drejtuar Gjykatës Kushtetuese.

121. Në rastin në fjalë, Gjkata Kushtetuese praktikisht nuk pranoi të merrte një vendim. Pala shqiptare mbështetet në faktin që rrëzimi i kërkesës së ankuesit nuk pati pasoja të përhershme e të pandryshueshme për të, meqenëse ai mund ta përsëriste kërkesën e tij nëse do të kishte ndryshim të atyre "rrethanave" që çuan në mosmarrjen e një vendimi nga Gjkata Kushtetuese. Megjithatë, Gjkata nuk mund të pranojë faktin që, thjesht se rrethanat mund të ndryshonin dhe ankuesi mund të kishte një vendim përfundimtar për kërkesën e tij në një kohë të papërcaktuar në të ardhmen, përmbush kërkesën për siguri juridike.

122. Pamundësia e Gjykatës Kushtetuese për të siguruar shumicën e kërkuar të votave për çështjet në shqyrtim, e la ankuesin pa një vendim përfundimtar dhe për rrjedhojë kufizoi thelbin e së

drejtës së tij për t'u dëgjuar nga gjykata. Për këtë arsye, ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës.

123. Edhe pse nuk ka lidhje me rrethanat e çështjes në fjalë, për sa i përket faktit që palët mbështeten në dispozitat e LOGJK mbi ndarjen e votave, Gjykata vëren se qëndrimi i mbajtur në Shqipëri në rast ndarjeje të barabartë të votave duket se ndryshon mjaft nga ai i adoptuar nga sistemet ligjore të shteteve të tjera kontraktuese (shiko paragrafin 76 më sipër). Në ndryshim nga sistemet e tjera ligjore, të cilët ose e pengojnë mundësinë e ndarjes së votave ose sigurojnë alternativa të ndryshme për të bërë të mundur marrjen e një vendimi përfundimtar në rast se ndodh kjo ndarje, në sistemin ligjor shqiptar ndarja e votave në mënyrë të barabartë në Gjykatën Kushtetuese çon në marrjen e një vendimi, i cili formalisht nuk i jep zgjidhje çështjes në shqyrtim. Për më tepër, nuk jepen arsyet për rrëzimin e kërkesës në raste të tilla, përveçse që votat janë ndarë në mënyrë të barabartë. Duke marrë parasysh parashtrimet e saj të mësipërme, Gjykata mundet veçse të dalë në përfundimin se parashikimi për ndarjen e votave në mënyrë të barabartë në nenin 74 të LOGJK-së nuk i shërben sigurisë juridike dhe mund të privojë ankuesin nga e drejta efektive për një vendim përfundimtar për kërkesën e tij drejtuar Gjykatës Kushtetuese.

2. Mosekzekutimi i vendimeve të formës së prerë

(a) Parashtrimet e palëve

124. Ankuesi u ankua për mosekzekutimin nga ana e autoriteteve të vendimit të Arbitrazhit Shtetëror të datës 7 korrik 1993, për sa ai urdhëronte Shtetin, si ortak të shoqërisë “Marini-Albplastik”, të përmbushte detyrimet e vendosura kur u themelua shoqëria në vitin 1991. Përveç kësaj, ai u ankua për shkelje të së drejtës së tij në kuptim të këtij neni, sepse autoritetet nuk kishin ekzekutuar vendimin përfundimtar dhe të detyrueshëm të datës 10 qershor 1998, që urdhëronte që fabrika të trajtohej si pjesë e aseteve të “Marini-Albplastik” dhe të regjistrohej si pronë e saj.

125. Për sa i përket drejtimit të parë të kërkesës, pala shqiptare parashtrroi që në vitin 1993 autoritetet i kishin paguar ankuesit dëmshpërblim në shumën 26 milionë lekë të caktuar nga Arbitrazhi Shtetëror. Ajo parashtrroi më tej se ankuesi nuk kishte shfaqur ndonjë interes në zbatimin e pjesës së vendimit që urdhëronte përfundimin e punimeve restauruese. Për rrjedhojë, kjo pjesë e ankimit ishte e pambështetur në prova dhe një abuzim i së drejtës për ankim. Së fundi, pala shqiptare parashtrroi se pjesa e dytë e ankimit të ankuesit ishte e pambështetur në prova.

(b) Vlerësimi i Gjykatës

126. Gjykata përsërit se neni 6 § 1 i garanton çdo personi të drejtën që t'i dëgjohet nga një gjykatë çdo pretendim në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile; në këtë mënyrë ky nen parashikon “të drejtën për gjykimin e çështjes”, ku e drejta për t'u dëgjuar nga gjykata, që do të thotë e drejta për të filluar proces gjyqësor civil, përbën njërin aspekt të saj. Sidoqoftë, kjo e drejtë do të ishte iluzionare nëse sistemi i brendshëm ligjor i shteteve kontraktuese do të lejonte që një vendim gjyqësor i formës së prerë dhe i detyrueshëm të mbetej i paekzekutuar në dëm të njëres palë. Do të ishte e pakonceptueshme që neni 6 § 1 t'i parashikonte në detaje garancitë procedurale që i sigurohen ndërgjyqësit – proces gjyqësor të drejtë, publik dhe të shpejtë – pa realizuar mbrojtjen e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore. Të interpretosh nenin 6 sikur të ketë të bëjë vetëm me të drejtën për t'u dëgjuar nga një gjykatë dhe zhvillimin e procesit, ka shumë të ngjarë të çojë në situata që nuk përputhen me parimin e shtetit të së drejtës, të cilin Shtetet Kontraktuese u zotuan të respektojnë kur ratifikuan Konventën. Ndaj, ekzekutimi i vendimeve të dhëna nga cilado gjykatë duhet konsideruar pjesë përbërëse e “procesit gjyqësor” në kuptimin e nenit 6. Vonesa në ekzekutimin e vendimit mund të justifikohet në rrethana të caktuara. Por kjo vonesë nuk duhet të jetë e tillë sa të cenojë thelbin e së drejtës të garantuar nga neni 6 § 1 (shiko, përveç burimeve të tjera zyrtare, Hornsby, cituar më sipër, fq. 510, § 40; Jasiūnienė k. Lituanisë, nr. 41510/98, § 27, 6 mars 2003; Qufaj Co. Sh.p.k. k. Shqipërisë, nr. 54268/00, § 38, 18 nëntor 2004; dhe Beshiri e të Tjerë k. Shqipërisë, nr. 7352/03, § 60, 22 gusht 2006).

127. Fillimisht Gjykata mendon se drejtimi i dytë i ankimit të ankuesit është pasojë e mospërmbushjes nga autoritetet të detyrimeve që lindën me themelimin e shoqërisë, ndaj duhet shqyrtuar bashkë me drejtimin e parë të ankimit.

128. Gjykata vëren se vendimet e arbitrazhit të vitit 1993 e urdhëronin shtetin t'i paguante ankuesit shumën prej 26 milionë lekësh (afërsisht 217,286 euro) dhe të ndiqte veprimtarinë e shoqërisë. Vendimet e arbitrazhit u lanë në fuqi nga gjykata e rrethit gjyqësor në vendimin e saj të datës 27 nëntor 1996, dhe morën formë të prerë më 26 qershor 1997.

129. Për sa i përket ekzekutimit të pjesës së parë të vendimit të arbitrazhit në fjalë, Gjykata vëren se nuk ishte kundërshtuar nga palët që autoritetet t'i paguan ankuesit shumën që i takonte prej 26 milionë lekësh.

130. Gjykata vëren më tej se nuk mund të thuhet e njëjta gjë për pjesën e dytë të vendimit, që ka të bëjë me detyrimin e Shtetit për të vazhduar veprimtarinë e shoqërisë. Ajo vëren se dështimi i autoriteteve për të respektuar atë pjesë të vendimit të formës së prerë të përmendur më sipër, ishte përcaktuar ndër të tjera edhe në vendimin e Gjykatës së Rrethit Tiranë të datës 10 qershor 1998. Përveç kësaj, formulimi i nenit 9 të statutit të shoqërisë së re Marini-Albplastik tregon se deri në vitin 2001 autoritetet ende nuk e kishin ekzekutuar vendimin e formës së prerë në favor të ankuesit.

131. Pra Gjykata çmon se që nga viti 1993 deri në 2001, pavarësisht kërkesave të ankuesit për ekzekutimin e vendimeve përfundimtare dhe të detyrueshme të Arbitrazhit Shtetëror, të lëna në fuqi me vendime të formës së prerë të gjykatave vendase, autoritetet dështuan në ekzekutimin e tyre. Në fakt, sikurse rezulton nga parashtimet e palëve, shteti lidhi kontratë me palë të treta, duke mos marrë parasysh statusin e ankuesit si ortak i shoqërisë që zotëronte 50% të aksioneve të saj.

132. Sidoqoftë, më 1 shkurt 2001, Ministria e Punës dhe ankuesi lidhën një kontratë për të krijuar ndërmarrjen e përbashkët "Marini-Albplastik". Në bazë të kontratës, palët ranë dakord që shoqëria e re të vendosej në të njëjtën ndërtesë që kishte pasur shoqëria e parë.

133. Gjykata vëren më tej se ndërmarrja e re nuk operoi fare deri në vitin 2003, duke ditur se shteti lidhi kontrata me palë të treta, pavarësisht detyrimeve që kishte në bazë të kontratës së re.

134. Përveç kësaj, Gjykata mendon se pala shqiptare nuk dha ndonjë shpjegim se përse vendimi i arbitrazhit dhe vendimet gjyqësore të formës së prerë në favour të ankuesit nuk u ekzekutuan për mbi dhjetë vjet, që nga data kur u morën e deri në vitin 2003, kur shoqëria u likuidua dhe pushoi së ekzistuari. Nuk duket se zyra e përmbarimit apo autoritetet administrative morën ndonjë masë efektive për ekzekutimin e këtyre vendimeve.

135. Për këtë arsye ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës në këtë aspekt.

3. Kohëzgjatja e proceseve

(a) Parashtimet e palëve

136. Ankuesi pretendoi se shkallët e gjykimit civil nëpër të cilat kishte kaluar nuk kishin respektuar kërkesën për "afat të arsyeshëm". Ai parashtroi se gjykatat vendase, duke mos dalë me një vendim në shkallën e parë të gjykimit, e kishin shkelur këtë kërkesë. Për më tepër, vonesa e tejzgjatur në ekzekutimin nga ana e autoriteteve të vendimeve të dhëna në favor të tij, e kishin rënduar cenimin e nenit 6.

137. Pala shqiptare kundërshtoi argumentin e ankuesit. Ajo parashtroi se proceset të cilave u referohej ankuesi nuk kishin lidhje me njëri tjetrin dhe periudhat kohore që duheshin marrë parasysh për këtë qëllim duheshin vlerësuar për secilin proces më vete. Sipas palës shqiptare, duke pasur parasysh mungesën e interesit të ligjshëm të ankuesit ndaj aktiviteteve të shoqërisë së përbashkët dhe përfshirjes së interesave të palëve të treta në biznes, proceset për çështjen në fjalë nuk mund të trajtohen si të zhvilluara në shkelje të kërkesave të nenit 6 § 1 të Konventës.

(b) Vlerësimi i Gjykatës

(i) Periudha kohore që merret parasysh

138. Gjykata vëren se ankuesi u ankua për zgjatjen e tepruar në kohë të pesë proceseve gjyqësore.

139. Procesi i parë filloi në një datë të papërcaktuar në vitin 1993, kur ankuesi bëri kërkesë në Arbitrazhin Shtetëror. Ai vazhdoi me procedurat për ekzekutimin e vendimit në favor të ankuesit dhe përfundoi më 20 nëntor 2003, me likuidimin e shoqërisë "Marini-Albplastik", duke i bërë procedurat e mëtejshme të diskutueshme. Procesi i dytë filloi në një datë të papërcaktuar në janar të vitit 1997, kur ankuesi ngriti padi në gjykatë mbi vlefshmërinë e vendimit për privatizimin e fabrikës. Ai vazhdoi me procedurat për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë në favor të

ankuesit dhe përfundoi më 13 prill 2006. Procesi i tretë filloi në vitin 2000 dhe përfundoi me vendimin e Gjykatës së Lartë të datës 23 dhjetor 2002 (proces që kishte të bënte me vlefshmërinë e kontratës së parë të qirasë). Procesi i katërt filloi në vitin 2001, kur ankuesi ngriti padi në gjykatë për vlefshmërinë e kontratës së dytë të qirasë dhe përfundoi më 27 janar 2006. Procesi i pestë filloi në vitin 2003 dhe përfundoi më 27 prill 2005 kur kërkesa e ankuesit u rrëzua nga Gjykata Kushtetuese për shkak të mosarritjes së shumicës së kërkuar të votave.

140. Periudha që duhet marrë në shqyrtim për ankimet në tërësi fillon më 2 tetor 1996, kur hyri në fuqi njohja që Shqipëria i bëri të drejtës për paraqitje të kërkesave nga individët. Pavarësisht faktit që Gjykata i mori në shqyrtim së bashku aspektet e mosekzekutimit të vendimeve të formës së prerë në procesin e parë dhe të dytë (paragrafi 127), ajo konstatoi se këto procese nuk kishin lidhje me njëra-tjetrën dhe për rrjedhojë ajo do ta shqyrtojë më vete zgjatjen në kohë të secilit proces të sipërpërmendur. Kështu, pesë proceset zgjatën shtatë vjet, nëntë vjet, dy vjet, pesë vjet dhe dy vjet, respektivisht.

(ii) Afati i arsyeshëm i zgjatjes së procesit

141. Sipas nenit 6 të Konventës, çdo person ka të drejtë që për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij civile të jepet vendim i formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm. Për këtë arsye shtetet kontraktuese kanë detyrimin të organizojnë sistemet e tyre ligjore në mënyrë të tillë që t'i mundësojnë gjykatat të përmbushin këtë kërkesë (shiko Unión Alimentaria Sanders S.A. k. Spanjës, vendim i datës 7 korrik 1989, Seria A, nr. 157, fq.14-15, § 38).

142. Gjykata përsërit që kohëzgjatja “e arsyeshme” e procesit duhet vlerësuar në bazë të rrethanave të çështjes dhe në lidhje me kriteret e mëposhtme: kompleksiteti i çështjes, qëndrimi i ankuesit dhe i autoriteteve përkatëse dhe interesat e ankuesit në mosmarrëveshje (shiko, përveç burimeve të tjera zyrtare, Comingersoll S.A. k. Portugalisë [GC], nr. 35382/97, § 19, GJEDNJ 2000-IV).

143. Duke pasur parasysh numrin e shkallëve të gjykimit të përfshira, Gjykata nuk e konsideron zgjatjen në kohë të procesit të tretë, të katërt dhe të pestë të jenë në një afat aq të paarsyeshëm sa të përbëjë cenim të së drejtës së ankuesit, sikurse garantohet në Konventë. Sidoqoftë, nuk mund të thuhet e njëjta gjë për procesin e parë dhe të dytë.

144. Gjykata çmon veçanërisht se këto procese nuk mund të konsiderohen komplekse, meqenëse ato kishin të bënin me respektimin e detyrimeve që lindnin nga krijimi i një ndërmarrjeje të përbashkët me kapital themeltar në shumën 50%-50% mes ankuesit dhe shtetit. Gjithashtu duket se shteti nuk bëri përpjekje për të respektuar kushtet e kontratës. Më tej Gjykata çmon se ankuesi nuk ka ndikuar në ndonjë mënyrë në këtë vonesë.

145. Përsa i përket procesit të dytë, Gjykata vëren se çështja është dërguar në mënyrë të përsëritur për rigjykim. Ajo vëren se në raste të ngjashme, kur procesi ishte zgjatur shumë në kohë për shkak të rigjykimit të çështjeve, është vendosur që përderisa dërgimi i çështjes për rigjykim kishte ardhur për shkak të gabimeve të kryera nga gjykatat më të ulta, përsëritja e këtyre vendimeve brenda të njëjtit proces zbulon një të metë serioze në sistemin gjyqësor (shiko, përveç burimeve të tjera zyrtare, Wierciszewska k. Polonisë, nr. 41431/98, § 46, 25 nëntor 2003, dhe Huseinović k. Sllovenisë, nr. 75817/01, § 25, 6 prill 2006). Kështu, Gjykata vëren se duke dhënë një sërë vendimesh kontradiktore në shkallë të ndryshme të gjykimit, autoritetet shqiptare kanë shfaqur një mangësi të sistemit gjyqësor për të cilin janë përgjegjës.

146. Konstatimet e mësipërme mjaftojnë për ta bërë Gjykatën të dalë në përfundimin se ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës për sa i përket tejzgjatjes në kohë të procesit të parë dhe të dytë për çështjen konkrete.

III. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 13 TË KONVENTËS

147. Duke u bazuar në nenin 13 të Konventës, ankuesi u ankua se mjetet ligjore të ankimit në dispozicion të tij nuk mund të ishin të efektshme dhe të përshtatshme për sa i përket ankimit të tij sipas nenit 6.

148. Pala shqiptare e kundërshtoi këtë argument. Gjithashtu, veçanërisht në lidhje me ankimin e ankuesit për zgjatjen në kohë të proceseve, ajo parashtroi se apelimi kushtetues ishte efektiv, duke u mbështetur në të njëjtat argumente të parashtruara në vëzhgimet e saj paraprake.

149. Ankuesi e kundërshtoi argumentin e palës shqiptare në lidhje me zgjatjen në kohë të proceseve. Ai parashittoi se sistemi ligjor vendas në përgjithësi nuk siguronte një mjet të veçantë ligjor me anë të të cilit të mund të bëhej ankim për zgjatjen në kohë të proceseve.

150. Gjykata përsërit se neni 13 zbatohet vetëm kur një person ka një “pretendim të argumentueshëm” se i është shkelur një e drejtë e parashikuar në Konventë (shiko Boyle dhe Rice k. Mbretërisë së Bashkuar, vendim i datës 27 prill 1988, Seria A, nr. 131, fq. 23, § 52). Për këtë arsye, ankuesi nuk ka një pretendim të argumentueshëm në kuptimin e këtyre aspekteve të nenit 6 që tashmë janë gjetur të papranueshme nga Gjykata dhe për rrjedhojë neni 13 është i pazbatueshëm. Ajo vazhdon se kjo pjesë e ankimit është dukshëm e pabazuar dhe duhet rrëzuar në përputhje me nenet 35 §§ 3 dhe 4 të Konventës dhe që pjesa tjetër është e pranueshme.

151. Gjykata ka marrë në shqyrtim ankimin e ankuesit për mosekzekutimin nga autoritetet të vendimeve të formës së prerë në favor të tij. Ajo vëren që ankimi i ankuesit sipas nenit 13 është në thelb i bazuar në të njëjtën mungesë të mbrojtjes procedurale, që tashmë është konstatuar se ka çuar në një shkelje të nenit 6 (shiko, *mutatis mutandis*, British-American Tobacco Company Ltd. k. Holandës, vendim i datës 20 nëntor 1995, Seria A, nr. 331, fq. 29, § 91, dhe Beshiri e të Tjerë, përmendur më sipër, § 68). Në këto rrethana, Gjykata konstaton se nuk është e nevojshme ta shqyrtojë ankesën më vete sipas nenit 13.

152. Përsa i përket ankimit të ankuesit për mungesën e një mjeti ligjor ankimi për zgjatjen në kohë të proceseve, Gjykata përsërit se neni 13 garanton një mjet ligjor efektiv ankimi tek një organ vendas për një shkelje të pretenduar të nenit 6 § 1 që garanton të drejtën për t’u dëgjuar nga gjykata brenda një afati të arsyeshëm (shiko Kudła k. Polonisë [GC], nr. 30210/96, § 156, GJEDNJ 2000-XI).

153. Gjithashtu, sikurse është përcaktuar në praktikën e saj, Gjykata përsërit se mjetet ligjore të ankimit që i sigurohen palës ndërgjyqëse në nivel vendor për të bërë ankim për kohëzgjatjen e proceseve janë “efektive”, në kuptim të nenit 13 të Konventës, nëse ato “[parandalojnë] shkeljen e pretenduar apo vazhdimin e saj, ose [sigurojnë] dëmshpërblimin e duhur për çdo shkelje që tashmë [ka] ndodhur” (i njëjti dokument, § 158). Ndaj, neni 13 ofron alternativën që, një mjet ankimi është “efektiv” nëse ai mund të përdoret si për të përshpejtuar dhënien e vendimit nga gjykata që shqyrton çështjen, ashtu edhe për t’i siguruar ndërgjyqësit dëmshpërblimin e duhur për vonesat që kanë ndodhur (dokumenti i përmendur më sipër § 159).

154. Gjykata vëren se, përveç apelimit kushtetues, sistemi ligjor shqiptar nuk siguron mjete të veçanta ankimi, si ato të përmendura nga Gjykata në çështjen Kudła (të përmendur më sipër), të cilat ankuesi t’i kishte në dispozicionin e tij për t’u dëmshpërblyer për zgjatjen e tepruar të proceseve.

155. Pala shqiptare iu referua kërkesës drejtuar Gjykatës Kushtetuese në përputhje me nenin 131 të Kushtetutës. Sipas kësaj dispozite, individët mund të bëjnë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese nëse dhe kur pretendojnë se ka shkelje të nenit 6 të Konventës. Një kërkesë e tillë merret në shqyrtim nga kjo e fundit vetëm pasi të jenë ezauruar të gjitha mjetet juridike të ankimit në gjykatat e ulta, pavarësisht vonesave të mëtejshme që kjo mund të shkaktojë.

156. Gjykata vëren më tej se, edhe duke supozuar se Gjykata Kushtetuese do të mundej në teori të ofronte dëmshpërblimin e duhur për pretendimet për kohëzgjatje të tepruar, pala shqiptare nuk mund të jepte ndonjë rast ku Gjykata Kushtetuese ka marrë vendim për një kërkesë për kohëzgjatje të tepruar. Edhe pse nuk i takon Gjykatës të marrë vendim për një çështje ende të pazgjidhur të ligjit të brendshëm, (shiko, *mutatis mutandis*, De Jong, Baljet dhe Van den Brink k. Hollandës, vendim i datës 22 maj 1984, Seria A, nr. 77, fq. 19, § 39, dhe Horvat k. Kroacisë, nr. 51585/99, § 44, GJEDNJ 2001-VIII), mungesa e praktikës tregon pasigurinë e një mjeti të tillë ligjor në praktikë.

157. Duke pasur parasysh sa më sipër, Gjykata konstaton se nuk ka prova se një ankim sipas nenit 131 të Kushtetutës mund të konsiderohet, në një shkallë të mjaftueshme sigurie, se përbën një mjet efektiv ligjor ankimi në dispozicion të ankuesit për zgjatjen e tepruar të proceseve gjyqësore.

158. Për rrjedhojë, Gjykata konstaton se në çështjen konkrete ka pasur shkelje të nenit 13 të Konventës, sepse ankuesi nuk ka pasur mjete të brendshme ligjore ankimi që do ta lejonin të ushtronte të drejtën e tij “për t’u dëgjuar brenda një afati të arsyeshëm”, sikurse garantohet nga neni 6 § 1 i Konventës. Për këtë arsye ajo rrëzon kundërshtimin paraprak të palës shqiptare (shiko paragrafin 99 më sipër).

IV. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 1 TË PROTOKOLLIT NR.1 TË KONVENTËS

159. Ankuesi u ankua për shkelje të së drejtës së tij të pronës. Ai u mbështet në nenin 1 të protokollit nr.1 të Konventës.

A. Pranueshmëria

160. Gjykata konstaton se ankimi i parashtruar në këtë pjesë nuk është dukshëm i pabazuar në kuptimin e nenit 35 § 3 të Konventës. Ajo gjithashtu konstaton se nuk ka arsye të tjera për ta deklaruar këtë pjesë të ankimit të papranueshme, ndaj e deklaron atë të pranueshme.

B. Meritat (themeli)

1. Parashtrimet e palëve

161. Ankuesi pretendoi se pas dështimit të stërzgatur të ortakut të tij, “Shtetit, për të përmbushur detyrimet e tij të lindura me krijimin e ndërmarrjes së përbashkët “Marini-Albplastik”, dhe ndryshimet në aktivitetin prodhues të fabrikës si rezultat i kontratave të lidhura mes shtetit dhe palëve të tjera, pjesa e tij e aksioneve në këtë shoqëri është reduktuar në vlerë dhe për pasojë ai kishte humbur kontrollin mbi veprimtarinë dhe asetet e shoqërisë.

162. Pala shqiptare e kundërshtoi këtë argument duke u mbështetur në mungesën e interesit nga ana e ankuesit për administrimin e duhur të shoqërisë.

2. Vlerësimi i Gjykatës

(a) Zbatueshmëria e nenit 1 të protokollit nr.1

163. Gjykata përsërit se, sipas praktikës së saj, neni 1 i protokollit nr.1 përfshin tre rregulla të veçanta: “Rregulli i parë, i shprehur në fjalinë e parë të paragrafit të parë, është i një natyre të përgjithshme dhe përcakton qartë parimin e gëzimit të qetë të pronës; rregulli i dytë, që shprehet në fjalinë e dytë të paragrafit të parë, trajton privimin nga prona dhe ia nënshtron atë kushteve të veçanta; rregulli i tretë, i shprehur në paragrafin e dytë, u njeh shteteve kontraktuese, ndër të tjera, të drejtën për të kontrolluar përdorimin e pronës në përputhje me interesin e përgjithshëm. Sidoqoftë, të tre rregullat nuk janë “të veçanta” në kuptimin e të qenit të palidhura. Rregulli i dytë dhe i tretë kanë të bëjnë me raste të veçanta të ndërhyrjes në të drejtën e gëzimit të qetë të pronës, ndaj duhen interpretuar duke pasur parasysh parimin e përgjithshëm të shprehur qartë në rregullin e parë” (shiko Beyeler k. Italisë [GC], nr. 33202/96, § 98, GJEDNJ 2000-I).

164. Gjykata konstaton që aksionet që zotëronte ankuesi kishin pa dyshim një vlerë financiare dhe përbënin “pronë” në kuptimin e nenit 1 të protokollit nr.1. Për këtë arsye ajo e çmon nenin 1 të aplikueshëm.

165. Gjithashtu Gjykata duhet të vendosë se cila dispozitë e nenit 1 është e zbatueshme në rastin konkret. Ajo vëren në lidhje me këtë, se një “aksion i shoqërisë” është diçka komplekse. Ai vërteton se mbajtësi zotëron një aksion në shoqëri së bashku me të drejtat përkatëse. Kjo nuk përbën vetëm një pretendim indirekt ndaj aktivëve të shoqërisë, por të drejta të tjera mund të lindin nga aksioni, veçanërisht e drejta e votimit dhe e drejta për të ushtruar ndikim në shoqëri (shiko Company S. dhe T. k. Suedisë, nr. 11189/84, vendim i Komisionit i datës 11 dhjetor 1986, Vendime dhe Raporte 50, fq. 138).

166. Gjykata vëren se në rastin konkret ankuesi zotëron 50% të aksioneve të shoqërisë “Marini-Albplastik”. Pas veprimeve të përsëritura të shtetit, të cilat binin në kundërshtim me kushtet e kontratës, ankuesi nuk kishte kompetenca vendimmarrëse në shoqëri. Për rrjedhojë, ndryshuan kompetencat që ankuesi ushtronte si aksionar, që do të thotë aftësia e tij për të drejtuar shoqërinë, kontrolluar asetet e aj dhe marrë fitimet.

167. Duke pasur parasysh rrethanat e çështjes dhe duke marrë në konsideratë natyrën e veçantë të pronës së ankuesit, Gjykata nuk konstaton se ndërhyrjet mund të klasifikohen në ndonjë kategori të veçantë të nenit 1 të protokollit nr. 1. Për këtë arsye, ajo e çmon të nevojshme ta

shqyrtojë çështjen duke pasur parasysh rregullin e përgjithshëm të përcaktuar në atë nen (shiko, *mutatis mutandis*, Sovtransavto Holding k. Ukraina, nr. 48553/99, § 93, GJEDNJ 2002-VII).

(b) Pajtueshmëria me nenin 1 të Protokollit Nr.1

168. Gjykata u referohet tre rregullave që përmban neni 1 i protokollit nr.1 (shiko paragrafin 163 më sipër). Ajo vëren se në rastin konkret nuk ka pasur privim të drejtpërdrejtë të së drejtës së pronës nga autoritetet vendase dhe ndërhyrje të krahasueshme me një privim të tillë.

169. Gjykata vëren se ankimi i ankuesit konsiston në faktin që shteti nuk përmbushi detyrimet e tij ndaj ndërmarrjes së përbashkët, duke bërë që ai të mos mundte të ushtronte kontroll efektiv, në përputhje me ligjin, mbi aktivitetet e “Marini-Albplastik”, çka solli marrjen e vendimeve të paligjshme dhe më vonë likuidimin e shoqërisë.

170. Ajo përsërit se, në bazë të nenit 1 të Konventës, çdo palë kontraktuese “do t’i njohë çdo personi që përfshihet në juridiksionin e tyre të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Konventë”. Detyrimi për të garantuar ushtrimin efektiv të të drejtave të parashikuara në këtë instrument, mund të çojë në detyrime positive për Shtetin (shiko, ndër të tjera, X dhe Y k. Holandës, vendim i datës 26 mars 1985, Seria A, nr. 91, fq. 11, §§ 22-23). Në këto rrethana, Shteti nuk mundet thjesht të qëndrojë pasiv dhe “nuk ka vend për të dalluar mes veprimit dhe mosveprimit” (shiko, *mutatis mutandis*, Airey k. Irlandës, vendim i datës 9 tetor 1979, Seria A, nr. 32, fq. 14, § 25).

171. Përsa i përket së drejtës së garantuar nga neni 1 i protokollit nr.1, këto detyrime pozitive mund të imponojnë marrjen e disa masave të nevojshme për mbrojtjen e së drejtës së pronës (shiko, ndër të tjera dhe *mutatis mutandis*, López Ostra k. Spanjës, vendim i datës 9 dhjetor 1994, Seria A, nr. 303-C, fq. 55, § 55), edhe në rastet kur kemi të bëjmë me çështjet gjyqësore mes individëve dhe shoqërive. Kjo nënkupton veçanërisht faktin që shtetet kanë detyrimin të mundësojnë procedura ligjore që ofrojnë garancitë e duhura procedurale dhe për pasojë bëjnë të mundur që gjykatat vendase të gjykojnë me efektshmëri dhe drejtësi çdo mosmarrëveshje mes personave juridikë privatë (shiko Sovtransavto Holding, të përmendur më sipër, § 96).

172. Në rastin konkret, Gjykata ka konstatuar se shteti i paditur mban përgjegjësi për shkeljen e nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje me mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhe tejzgjatjen në kohë të proceseve. Në lidhje me këtë, Gjykata thjesht do t’u referohej mangësive procedurale që ajo vuri në dukje më sipër, ndërsa shqyrtoi ankimin në përputhje me nenin 6 § 1 të Konventës (shiko paragrafët 126-146 më sipër).

173. Gjykata konstaton se mungesa e vullnetit të organeve vendase dhe zyrës së përmbartimit për të përmbushur detyrimet që lindën me themelimin e shoqërisë, ndikuan në mënyrë të drejtpërdrejtë të drejtën e ankuesit për gëzimin e qetë të pronës së tij. Kësaj i shtohet edhe zgjatja e tepruar në kohë e proceseve në fjalë, çka krijoi pasiguri të vazhdueshme rreth ligjshmërisë së vendimit të marrë nga shteti, ortaku i ankuesit, në lidhje me veprimtarinë e shoqërisë. Për rrjedhojë ankuesi u bë një aksionar pasiv, duke bërë kështu të pamundur marrjen e fitimeve të pritshme.

174. Duke marrë parasysh sa më sipër, Gjykata konstaton se mosekzekutimi nga ana e organeve të vendimeve në favor të ankuesit, mënyra si u zhvilluan proceset dhe pasiguria që iu krijua ankuesit, prishën “ekuilibrin e drejtë” që duhej ruajtur mes kërkesave të interesit publik dhe nevojës për të mbrojtur të drejtën e ankuesit për gëzim të qetë të pronës së tij. Për pasojë, shteti nuk ia doli të përmbushte detyrimin e tij për t’i garantuar ankuesit gëzimin efektiv të së drejtës së tij të pronës, sikurse garantohet nga neni 1 i protokollit nr.1.

175. Për këtë arsye ka pasur shkelje të kësaj dispozite.

V. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 14 TË KONVENTËS

176. Duke iu referuar nenit 14 të Konventës, ankuesi u ankua që autoritetet e kishin diskriminuar atë për shkak të dyshetësisë së tij shqiptaro-amerikane.

177. Pala shqiptare e kundërshtoi këtë fakt.

178. Gjykata konstaton se ankuesi nuk ka mundur të provojë pretendimin e tij se i ishte nënshtruar trajtimit të diferencuar diskriminues për shkak të shtetësisë së tij. Ajo vazhdon që ky ankim është haptazi i pabazuar dhe duhet hedhur poshtë në përputhje me nenin 35 §§ 3 dhe 4 të Konventës.

VI. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

179. Neni 41 i Konventës parashikon:

“Kur Gjykata konstaton shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj, dhe në qoftë se e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese mundëson vetëm një mënjanim të pjesshëm të pasojave që kanë rrjedhur nga kjo shkelje, Gjykata, kur ka vend, i cakton palës së dëmtuar një shpërblim të drejtë.”.

A. Dëmet

180. Si parashtrim kryesor, ankuesi kërkoi ekzekutimin e vendimeve të formës së prerë të dhëna në favor të tij, që do të thotë përmbushjen nga ana e shtetit të detyrimeve të lindura me themelimin e shoqërisë. Më tej ai pretendoi shumën 6,697,000 euro për dëmin financiar të shkaktuar prej investimit të tij të kapitalit themeltar që arrin afërsisht shumën 173,000 euro, si dhe të shumës prej 2,748,000 euro për fitimin e munguar për një periudhë 13 vjeçare. Ai u mbështet në një akt ekspertimi vlerësues dhe në gjetjet e vendimit të arbitrazhit të datës 5 nëntor 1993 me qëllim vlerësimin e fitimit të munguar. Për më tepër, ai pretendoi shumën 100,000 euro për dëmin jofinanciar.

181. Pala shqiptare argumentoi se shumat e pretenduara nga ankuesi ishin të ekzagjeruara, pa propozuar shuma alternative.

182. Gjykata përsërit se, në përputhje me Konventën, vendimi në bazë të të cilit ajo konstaton shkelje i vë shtetit të paditur detyrimin ligjor për t'i dhënë fund shkeljes dhe për të ndrequr pasojat e saj. Nëse legjislacioni i brendshëm lejon vetëm ndreqje të pjesshme, neni 41 i Konventës i jep Gjykatës kompetencën t'i caktojë kompensim palës së dëmtuar për veprimin apo mosveprimin që ka çuar në konstatimin e shkeljes së Konventës. Gjykata gëzon një shkallë diskrecioni në ushtrimin e kësaj kompetence, sikurse e provon mbiemri “i drejtë” dhe togfjalëshi “kur e gjen me vend”.

183. Gjykata u referohet konstatimeve të saj në çështjen Qufaj Co. sh.p.k., ku ajo vendosi që autoritetet shqiptare duhet të merrnin masat e duhura për të ekzekutuar një vendim të formës së prerë (shiko Qufaj Co. sh.p.k., e përmendur më sipër, § 54-59, si dhe, *mutatis mutandis*, Beshiri e të Tjerë, përmendur më sipër, § 109).

184. Ndër faktet që Gjykata merr në konsideratë kur vlerëson kompesimin janë dëmi financiar (humbja që në fakt është pësuar si rezultat i drejtpërdrejtë i shkeljes së pretenduar) dhe dëmin jofinanciar (dëmshpërblim për shqetësimin, parehatinë dhe pasigurinë e shkaktuar nga shkelja) dhe dëme të tjera jofinanciare (shiko, ndër të tjera Ernestina Zullo k. Italisë, nr. 64897/01, § 25, 10 nëntor 2004).

185. Përveç kësaj, nëse një apo më shumë dëmshpërblime nuk mund të përlllogariten me saktësi ose nëse dallimi mes dëmit financiar dhe atij jofinanciar rezulton i vështirë, Gjykata mund të vendosë të bëjë një vlerësim të përgjithshëm (shiko Comingersoll S.A., të përmendur më sipër, § 29).

186. Gjykata kujton se në rastin konkret ajo konstatoi shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës dhe nenit 1 të protokollit nr.1, për shkak se proceset gjyqësore tejkaluan kërkesën për një afat të arsyeshëm dhe që vendimi në favor të ankuesit kishte mbetur i paekzekutuar për një periudhë kohe, duke mos e lejuar atë të gëzonte pronën e tij. Për këtë arsye ekziston lidhje shkakësore mes këtyre shkeljeve të konstatuara dhe pretendimit të ankuesit për dëm financiar (shiko paragrafët 174-175 më sipër).

187. Gjykata vëren se për vetë natyrën e vendimeve të formës së prerë në favor të ankuesit dhe faktit që shoqëria “Marini-Albplastik” pushoi së ekzistuari në vitin 2003, *restitutio in integrum* është i pamundur. Sidoqoftë, dëmshpërblimi duhet bërë *in lieu*.

188. Gjykata e vlerëson të arsyeshme ta dëmshpërblejë ankuesin për dëmin financiar për humbjen e investimit të tij dhe fitimet e munguara.

189. Për sa i përket humbjes së investimit, Gjykata vëren se më datë 12 qershor 1991, sipas një kontrate mes shoqërisë “Marini-Albplastik” dhe shoqërisë “Edil-Palstic”, ankuesi i pagoi kësaj të fundit shumën 173,000 euro, për të mbuluar shpenzimet për përgatitjen e një projekti të ri për

rikonstruktimin e fabrikës (afërsisht 62,400 euro), si dhe një pagesë për blerjen e makinerive të reja. Gjykata konstaton më tej se makineria zotërohet ende nga ankuesi.

190. Për sa u përket fitimeve, Gjykata nuk mund t'i pranojë shumat e paraqitura nga ankuesi, dhe ajo konsideron veçanërisht spekulative përpjekjen për të llogaritur cilat mund të kishin qenë fitimet e shoqërisë. Për rrjedhojë, për të përcaktuar shumën që do të caktohet në këtë pjesë, ajo do të mbështetet edhe në vlerësimin e Arbitrazhit Shtetëror të datës 5 nëntor 1993.

191. Duke marrë parasysh materialin në dispozicion dhe faktin se pala shqiptare nuk depozitoi ndonjë kundërshtim mbi metodën e llogaritjes së dëmshpërblimit të parashtruar nga ankuesi, si dhe duke bërë vlerësimin mbi baza barazie, Gjykata i cakton ankuesit shumën totale prej 330,000 euro për dëmin financiar dhe jofinanciar.

B. Kostot dhe shpenzimet

192. Ankuesi pretendoi edhe 15,900 euro për kostot dhe shpenzimet gjyqësore para gjykatave vendase dhe 5,700 euro për ato para Gjykatës. Ai paraqiti një tabelë të detajuar për të provuar pretendimin e tij për shpenzimet për procesin në Gjykatë.

193. Pala shqiptare e kundërshtoi pretendimin pa dhënë arsye specifike.

194. Në rastin konkret, duke marrë parasysh informacionin që disponon dhe kriteret e mësipërme, Gjykata çmon të arsyeshme të caktojë shumën 5 700 euro për kostot dhe shpenzimet e proceseve para Gjykatës, por hodhi poshtë pretendimin për kostot në proceset vendase për mungesë provash.

C. Interesi i papaguar

195. Gjykata çmon të nevojshme që interesi i papaguar duhet të bazohet në normën marxhinale të huadhënies së Bankës Qendrore Evropiane, së cilës duhet t'i shtohen tre për qind të pikëve.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA: NJËZËRI

1. Vendors të bashkojë meritat (themelin) e kundërshtimeve paraprake të palës shqiptare në lidhje me mosezaurimin nga ana e ankuesit të mjeteve të brendshme ligjore të ankimit në lidhje me ankimin e tij për kohëzgjatjen e proceseve.

2. I deklaron të pranueshme ankimet në lidhje me nenin 6 § 1 (përsa i përket së drejtës për t'u dëgjuar nga një gjykatë, afatit të procesit dhe mosekzekutimit të një vendimi të formës së prerë), nenin 13, të marrë së bashku me aspektin e pranueshmërisë së nenit 6 § 1, dhe nenin 1 të protokollit nr.1 dhe pjesën tjetër të ankimit të papranueshme.

3. Gjykon se nuk ka patur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës përsa i përket kufizimit të pretenduar të së drejtës së ankuesit për t'u dëgjuar nga gjykata në lidhje me urdhrin e likuidimit.

4. Gjykon se ka patur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës përsa i përket mohimit të së drejtës së ankuesit për t'u dëgjuar nga një gjykatë si rezultat i mosmarrjes së një vendimi nga Gjykata Kushtetuese mbi kërkesën e tij drejtuar asaj.

5. Gjykon se ka patur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës përsa i përket mosekzekutimit të vendimit të formës së prerë të datës 7 korrik 1993.

6. Gjykon se ka patur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës përsa i përket zgjatjes së tepruar në kohë të procesit të parë dhe të dytë gjyqësor.

7. Gjykon se nuk ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës përsa i përket zgjatjes së tepruar në kohë të procesit të tretë, të katërt dhe të pestë.

8. Gjykon se ka pasur shkelje të nenit 13 të Konventës përsa i përket mungesës së një mjeti efektiv ankimi nga ankuesi kundër zgjatjes së proceseve dhe rrëzoi kundërshtimin paraprak të palës shqiptare.

9. Gjykon se nuk është e nevojshme të shqyrtohet më vete pjesa e mbetur e ankimit të ankuesit sipas nenit 6 të Konventës.

10. Gjykon se ka patur shkelje të nenit 1 të protokollit nr.1 të Konventës.

11. Gjykon:

a) që pala shqiptare duhet t'i paguajë ankuesit brenda tre muajve nga data në të cilën vendimi merr formë të prerë, në pajtim me nenin 44 § 2 të Konventës, shumat e mëposhtme, që duhen konvertuar në monedhën vendase të shtetit të paditur, me kursin e zbatueshëm në datën e shlyerjes, plus taksat që mund të jenë të tatueshme/të ngarkohen:

(i) 330 000 euro (treqind e tridhjetë mijë euro) për dëmin financiar dhe jofinanciar;

(ii) 5700 euro (pesë mijë e shtatë qind euro) për kostot dhe shpenzimet;

(b) që nga skadimi i afatit të mësipërm tremujor deri në shlyerje, interesi i thjeshtë do të jetë i pagueshëm mbi shumat e mësipërme me një normë të barabartë me normën marxhinale të Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mospagimit, plus tre për qind të pikëve.

12. Rrëzon pjesën e mbetur të pretendimeve të ankuesit për shpërblim të drejtë.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 18 dhjetor 2007, sipas neneve 77 §§ 2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

T.L. Early
Kryesekretar

Nicolas Bratza
Kryetar

VENDIM
(Ankimi Nr.45264/04)
ÇESHTJA “HAMZARAJ KUNDËR SHQIPËRISË” (NR.1)

STRASBURG
3 Shkurt 2009

Ky vendim do të konsiderohet përfundimtar në rrethanat e përcaktuara nga neni 44§2 i Konventës. Vendimi mund t'i nënshtrohet rishikimit editorial.

Kjo çështje trajton mosekzekutimin e vendimit të KKK Pronave që ka vendosur kompensimin e ankuesit. Gjykata Evropiane vëren se, pavarësisht faktit nëse jemi para një vendimi gjyqësor apo administrativ që është përfundimtar (i formës së prerë), ligji i brendshëm dhe Konventa parashikon që vendimi të zbatohet (shkelje e Nenit 6.1 të Konventës). Gjykata ka konsideruar pretendimin e ankuesit të bazuar në ligjin e brendshëm për t'u kualifikuar si një “vlerë” e zbatueshme në bazë të nenit 1 të Protokollit 1. Gjykata konstaton se ndërhyrja duhet të shqyrtohet në bazë të parimit për zotërimin në paqe të pasurisë në terma të përgjithshëm (ref. çështjen Beshiri).

Në çështjen “Hamzaraj kundër Shqipërisë” (nr.1),

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (seksioni i katërt), të mbledhur në seancë të përbërë nga:

Nicolas Bratza Kryetar

Giovani Bonello

David Thor Byorgvinsson

Jan Sikuta

Paivi Hirvela

Ledi Bianku,

Nebojsa Vucinic gjykatës

dhe Lawrence Early, sekretar i seksionit,

duke shqyrtuar privatisht më 13 janar 2009,

paraqesin vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua në të njëjtën datë.

PROCEDURA

1. Çështja lindi në bazë të kërkesës (nr.45264/04) kundër Republikës së Shqipërisë, depozituar pranë Gjykatës sipas nenit 34 të Konventës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore (Konventa) nga ana e një shtetasi shqiptar, znj Afërdita Hamzaraj (kërkuesi) më 27 nëntor 2004.

2. Kërkuesi, të cilit i është siguruar ndihmë ligjore, u përfaqësua nga z. S. Puto, një avokat që ushtron aktivitetin në Tiranë. Qeveria Shqiptare (Qeveria) u përfaqësua me anë të agjentit të tyre, znj. S. Meneri.

3. Kërkuesi pretendoi në bazë të nenit 6 § 1 të Konventës dhe nenit 1 të protokollit nr.1 të Konventës një shkelje të të drejtave të saj të pronësisë, duke pasur parasysh neglizhimin e zgjatur të autoriteteve për të zbatuar një vendim administrativ, ku urdhërohet kompensim në natyrë ose nëpërmjet bonove shtetërore/thesarit. Kërkuesi gjithashtu u ankua për kohëzgjatjen e seancës në bazë të nenit 6 § 1 të Konventës.

4. Më 25 qershor 2006, Kryetari i seksionit të katërt të Gjykatës vendosi ta njoftojë Qeverinë mbi kërkesën. Në bazë të parashikimeve të nenit 29 § 3 të Konventës, u vendos të shqyrtoheshin të vërtetat e ankimit dhe në të njëjtën kohë të pranimit të tij.

5. Kërkuesi dhe Qeveria respektivisht depozituan vërejtje të mëtejshme me shkrim (direktiva 59 § 1).

FAKTET

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

6. Kërkuesi lindi më 1926 dhe banon në qytetin e Vlorës.

7. Më 30 janar 1995, Gjykata e Rrethit të Lushnjës njohu ekzistencën e së drejtës së pasurisë të babait të ankuesit mbi një ngastër toke me madhësi 576 metra katrorë të lokalizuar në qytetin e Lushnjës (vendim për vërtetim fakti). Vendimi hyri në fuqi dhe mori formën përfundimtare më 13 shkurt 1995.

8. Ankuesi, në vijim të aktit/ligjit të kthimit dhe kompensimit të pasurisë (tani e tutje “Ligji i pasurisë”), depozitoi një kërkesë pranë komisionit të kthimit dhe kompensimit të pasurive të Lushnjës (tani e tutje Komisioni) duke kërkuar kthimin e pasurisë së dikurshme.

9. Me anë të një vendimi të 21 marsit 1996, Komisioni pranoi të drejtën e pronësisë së ankuesit dhe të pesë trashëgimtarëve të tjerë të babait të saj mbi ngastren e tokës me madhësi 576 metra katrorë të lokalizuar në qytetin e Lushnjës. Mbi bazën e dokumentacionit në zotërim të tij, Komisioni gjykoi se kthimi i pasurisë së dikurshme ishte i pamundur për shkak se ajo ishte e zënë. Prandaj, Komisioni vendosi që ankuesi të kompensohej në natyrë ose në formën e bonove shtetërore/thesarit në bazë të seksionit 16 të ligjit të pasurisë. Komisioni urdhëroi autoritetet e rrethit të merrnin masat e nevojshme me qëllim zbatimin e këtij vendimi.

10. Më 2004, mbas dështimit të autoriteteve për të zbatuar vendimin e Komisionit, ankuesi kërkoi që autoritetet e rrethit të përcaktonin shumën e kompensimit që do t'i akordohej në lidhje me pasurinë e saj.

11. Autoritetet ende nuk janë pajtuar me detyrimin e tyre.

II. LIGJI PËRKATËS KOMBËTAR

12. Ligji përkatës kombëtar është përshkruar i detajuar në “Driza kundër Shqipërisë” (nr.33771/02, §§ 33-44, ECHR 2007-... (fragmente) dhe “Ramadhi dhe të tjerët kundër Shqipërisë” (nr.38222/02, §§ 22-30, 13 nëntor 2007).

E DREJTA

I. SHKELJE TË PRETENDUARA TË NENIT 6§1 TË KONVENTËS

13. Ankuesi u ankua mbi dështimin e autoriteteve për të zbatuar në mënyrë efikase vendimin e Komisionit për ta kompensuar në natyrë ose në formën e bonove shtetërore/thesarit. Ajo gjithashtu ngriti edhe një ankesë tjetër mbi kohëzgjatjen e plotë të seancës së moszbatimit. Ajo u mbështet në nenin 6 § 1 të Konventës, i cili për sa i përket çështjes, parashikon:

“Në përcaktimin e detyrimeve dhe të drejtave të tij civile ... kushdo gëzon të drejtën për një seancë ... të drejtë shqyrtimi brenda një periudhe të arsyeshme ... nga ana e një ... gjykate ...”

A. Moszbatimi i vendimit të Komisionit të 21 marsit 1996

1. Pranueshmëria

a) Paraqitjet e palëve

14. Qeveria kundërshtoi kompetencën *rationale temporis* të Gjykatës për të shqyrtuar pretendimin e ankuesit për sa kohë që vendimi i Komisionit u realizua para se Konventa të hynte në fuqi në Shqipëri. Qeveria gjithashtu kundërshtoi zbatueshmërinë e nenit 6 § 1 të Konventës për masa administrative të vendosura me anë të vendimit të Komisionit më 21 mars 1996.

15. Qeveria pretendoi se ankuesi nuk kishte shteruar të gjitha mundësitë e brendshme për sa i përket moszbatimit të vendimit të Komisionit. Qeveria ishte e mendimit se ankuesi nuk kishte bërë kërkesë pranë autoriteteve të brendshme/kombëtare, nuk kishte depozituar ndonjë ankesë pranë Komisionit Shtetëror të Kthimit dhe Kompensimit të Pasurisë (zëvendësuar nga Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pasurisë, duke u mbështetur në ligjin e pasurisë të vitit 2006) dhe as që kishte filluar ndonjë proces gjyqësor lidhur me moszbatimin e vendimit të Komisionit.

16. Ankuesi pohoi se vendimi i Komisionit, i cili pranoi të drejtën e saj mbi pasurinë, ishte i ngjashëm me një vendim gjykate për sa u përket rrethanave që krijoi. Ajo parashittoi se nuk ekzistonte asnjë mundësi e brendshme/kombëtare lidhur me zbatimin e vendimeve të Komisionit, të cilat përcaktonin kompensimin *in lieu* /në vend të pasurisë origjinale. Ajo konstatoi se në 2004 u ishte drejtuar pa sukses autoriteteve të rrethit mbi shumën e kompensimit që do t'i paguhej në bazë të vendimit të Komisionit.

b) Vlerësimi i gjykatës

17. Gjykata përsërit se është kompetente për të shqyrtuar çështje duke filluar nga 2 tetori 1996, datë në të cilën hyri në fuqi në Shqipëri Konventa. Megjithatë, Gjykata mundet të marrë në konsideratë fakte/raste para datës së ratifikimit për sa kohë që raste të tilla mund të konsiderohen se kanë krijuar një situatë e cila shtrihet përtej kësaj datë ose mund të ketë lidhje për të kuptuar fakte/raste që kanë ndodhur mbas asaj date (Broniowski kundër Polonisë (dhjetor) {GC}, nr.31443/96, § 74, ECHR 2002-X).

18. Në rastin aktual, më 2 tetor 1996, vendimi i Komisionit i 21 marsit 1996 nuk pajtohej me Konventën. Deri më sot dhe gjatë 12 viteve që nga data e miratimit të saj, vendimi i Komisionit nuk është zbatuar ende. Për sa kohë që ankesat e ankuesit iu drejtohen akteve dhe pjesëve të lëna jashtë të shtetit shqiptar lidhur me implementimin e dhënies së të drejtës për një masë kompensuese të siguruar në bazë të ligjit shqiptar, një e drejtë e cila vazhdoi të ekzistonte mbas datës 2 tetor 1996 dhe ekziston akoma edhe sot, Gjykata zotëron autoritet kalimtar për të shqyrtuar ankimin (shiko Broniowski, cituar më sipër, § 76). Prandaj Gjykata hedh poshtë kundërshtimin e Qeverisë mbi papajtueshmërinë e saj *ratione temporis*.

19. Për sa i përket kundërshtimit të Qeverisë lidhur me zbatueshmërinë e nenit 6§1 të Konventës, Gjykata vëren se një kundërshtim i tillë u hodh poshtë në vendimin e gjykatës në çështjen “Ramadhi dhe të tjerë kundër Shqipërisë” (cituar më sipër, §§ 35-37). Gjykata nuk shikon arsye tjetër për të arritur në një konkluzion ndryshe në çështjen në fjalë. Prandaj ajo hedh poshtë kundërshtimin e Qeverisë.

20. Për sa i përket kundërshtimit të Qeverisë lidhur me mosshkrimin e mundësive të brendshme/kombëtare nga ana e ankuesit, Gjykata kujton përfundimin/konkluzionin e arritur prej saj në gjykimin e çështjes “Ramadhi dhe të tjerë...” (cituar më sipër, §§ 50-51), ku u pa se nuk ekzistonte një zgjidhje/mundësi efektive që do të mundësonte zbatimin e vendimeve të Komisionit. Prandaj Gjykata nuk pranon kundërshtimin e Qeverisë.

21. Gjykata gjykon se kjo ankesë nuk duket se është keqdashëse, dhe as e papranueshme bazuar në arsye të tjera brenda kuptimit të nenit 35 të Konventës. Prandaj Gjykata e deklaron ankesën të pranueshme.

2. Rrethanat e çështjes

a) Paraqitjet e palëve

22. Qeveria pretendon se procesi i kthimit dhe kompensimit të pasurisë ishte i mbushur me vështirësi veçanërisht kur pasuria e shpronësuar/konfiskuar është përdorur për qëllime publike. Konkluzioni i një procesi të tillë kompleks është kushtëzuar dhe ndërthurur me përfundimin e proceseve të tjera që parashikonin/rregullonin të drejtën e pasurisë. Qeveria argumenton se ankuesi mbeti pasiv në përpjekjet e saj për ta bërë të mundur zbatimin e vendimit të Komisionit dhe se ajo nuk shteroi të gjitha mundësitë/zgjidhjet e brendshme siç parashikohet në ligjin e pasurisë.

23. Ankuesi pohon se moszbatimi i vendimit të Komisionit shkaktoi një shkelje të së drejtës së saj për t’iu drejtuar gjykatës. Ajo pretendon se nuk i është ofruar asnjëherë mundësia e kompensimit në natyrë ose në formën e bonove shtetërore/thesarit pavarësisht kushteve të qarta të vendimit të Komisionit të datës 21 mars 1996. Ankuesi shtoi se në vitin 2004 ajo nuk pati sukses për të kontaktuar autoritetet e rrethit mbi çështjen e kompensimit. Megjithatë, ajo theksoi faktin se një personi i cili ka përfituar një vendim të zbatueshëm kundër shtetit si pasojë e një çështjeje gjyqësore të suksesshme, nuk duhet t’i kërkohet të mjaftohet/drejtohet masave zbatuese me qëllim ekzekutimin e vendimit (shiko “Metaxas kundër Greqisë”, nr.8415/02, § 19, 27 maj 2004).

b) Vlerësimi i Gjykatës

24. Parimet e përgjithshme sipas nenit 6§1 të Konventës lidhur me moszbatimin e vendimeve të Komisionit janë përcaktuar në gjykimin e çështjes “Ramadhi dhe të tjerë...” (cituar më sipër, §§ 45 et seq).

25. Gjykata vëren se vendimi i Komisionit i 21 marsit 1996 urdhëroi kompensimin në natyrë ose nëpërmjet bonove shtetërore/thesarit për t’u paguar *in lieu*/në vend të ngastrës origjinale të tokës. Ai vendim nuk është kundërshtuar para një gjykate dhe mbetet ende në fuqi.

26. Gjykata vëren se, pavarësisht nëse vendimi përfundimtar për t'u ekzekutuar merr formën e një vendimi gjyqësor ose të një vendimi nga ana e një autoriteti administrativ, ligji i brendshëm/kombëtar, si dhe Konventa parashikon që vendimi të zbatohet. Asnjë hap nuk është ndërmarrë për të zbatuar vendimin e Komisionit në favor të ankuesit (shiko “Ramadhi dhe të tjerë...”, cituar më sipër, § 49).

27. Prandaj, Gjykata arrin në përfundimin se është shkelur e drejta e ankuesit për t'u drejtuar gjykatës në bazë të nenit 6 § 1 të Konventës.

B. Kohëzgjatja e seancës gjyqësore

1. Pranueshmëria

28. Në 13 dhjetor 2006 ankuesi paraqiti një ankesë të re në bazë të nenit 6§1 mbi kohëzgjatjen e seancave gjyqësore veçanërisht lidhur me moszbatimin e vendimit të Komisionit të vitit 1996.

29. Qeveria parashtroi se ankuesi nuk kishte nisur asnjëherë ndonjë seancë gjyqësore pranë gjykatave vendore lidhur me ankesën në fjalë.

30. Gjykata kujton përfundimin e arritur në gjykimin e saj të çështjes “Gjonboçari dhe të tjerë kundër Shqipërisë” (nr.10508/02, §§ 80-82, 23 tetor 2007), kur konstatoi se nuk ekzistonin zgjidhje/mundësi reale në sistemin ligjor vendor për sa i përket ankesës mbi kohëzgjatjen e seancave gjyqësore. Prandaj, ankuesi çlirohet nga detyrimi për të shteruar zgjidhjet/mundësitë e brendshme/vendore.

31. Gjykata gjykon se ankesa në fjalë nuk shfaqet e pabazuar brenda kuptimit të nenit 35 § 3 të Konventës. Për më tepër ajo nuk gjen arsye të tjera për të vendosur se kjo pjesë e ankimit është e papranueshme dhe prandaj e deklaron ankesën të pranueshme.

2. Cilësitë

32. Ankuesi u ankua rreth kohëzgjatjes së paarsyeshme të masave zbatuese, të cilat kanë zgjatur më shumë se 12 vjet. Ajo ia atribuoi këtë vonesë autoriteteve vendore, të cilat kanë dështuar në sigurimin e kompensimit *in lieu*/në vend të pasurisë së dikurshme.

33. Gjykata gjykon se ankesa tashmë është adresuar në kontekstin e arsyetimit dhe vendimit që nuk është zbatuar dhe mendon se nuk është e nevojshme të shqyrtohen këto fakte përsëri nëpërmjet prizmit të kërkesës së “kohëzgjatjes së arsyeshme” të nenit 6 § 1 të Konventës.

II. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 1 TË PROTOKOLLIT NR.1 TË KONVENTËS

34. Ankuesi u ankua se mosrealizimi i kompensimit shkaktoi një shkelje të nenit 1 të protokollit 1 të Konventës e cila parashikon:

“Çdo person juridik apo fizik gëzon të drejtën e zotërimit në paqe të pasurive të tij. Askush nuk privohet nga pasuritë e tij përveçse për interesa publike dhe kushtëzuar nga dispozita ligjore dhe parimet e përgjithshme të ligjit ndërkombëtar.

Dispozitat e lartpërmendura, megjithatë, nuk cenojnë në asnjë mënyrë të drejtën e shtetit për të zbatuar ligje të tilla, ashtu siç i gjykon të nevojshme për të kontrolluar përdorimin e pasurisë në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagesën e taksave dhe kontributeve ose ndëshkimeve të tjera.”.

A. Pranueshmëria

35. Gjykata gjykon se ankesa në fjalë nuk shfaqet e pabazuar brenda kuptimit të nenit 35 § 3 të Konventës. Më tej gjykata gjykon se nuk janë konstatuar arsye të tjera për ta deklaruar këtë pjesë të ankimit të papranueshëm dhe si pasojë e deklaron ankesën të pranueshme.

B. Cilësitë

1. Paraqitjet e palëve

36. Qeveria pohon se nuk ka pasur shkelje të së drejtës së ankuesit kundrejt pasurisë pasi shteti nuk ka ndërhyrë në mënyrë të tepruar. Qeveria mbajti qëndrimin e saj që ankuesi duhet të kishte shteruar të gjitha burimet/mundësitë vendore lidhur me të drejtën e saj për kompensim.

37. Ankuesi pretendoi se moszbatimi i vendimit të komisionit i cili i kishte njohur asaj të drejtën e kompensimit *in lieu*/në vend të pasurisë origjinale përbënte një shkelje të së drejtës së saj kundrejt pasurisë. Ankuesi vazhdoi se vendimi i Komisionit, i cili nuk ishte kundërshtuar dhe ishte finalizuar, duhet të gjykohet si si vlerë/aset dhe si pasojë një e drejtë pronësie.

2. Vlerësimi i Gjykatës

38. Parimet e përgjithshme sipas nenit 1 të protokollit nr.1 të Konventës janë përcaktuar në rastin e gjykimit të çështjes “Ramadhi dhe të tjerë...” (cituar më sipër, §§ 67-71 dhe §§ 75-79).

39. Gjykata vëren se ankuesit iu njoh e drejta për kompensim për arsye të vendimit të Komisionit të vitit 1996 i cili ishte përfundimtar. Kështu që, për qëllime të shqyrtimit të ankesës, gjykata e konsideron pretendimin e ankuesit të bazuar sa duhet në ligjin vendor për t’u kualifikuar si një “vlerë” e zbatueshme në bazë të nenit 1 të protokollit nr.1.

40. Gjykata vëren se kjo ankesë lidhet me ankesën e shqyrtuar sipas nenit 6 § 1 lidhur me dështimin për të zbatuar vendimin e Komisionit (shiko paragrafët 24-27 më sipër). Mbi bazën e çështjes gjyqësore të krijuar, Gjykata konstaton se ndërhyrja i takon të shqyrtohet në bazë të fjalisë së parë të paragrafit të parë të nenit 1 të protokollit nr.1, e cila përcakton parimin e zotërimit në paqe të pasurisë në terma të përgjithshëm (shiko, p.sh. “Burdov kundër Ruisë”, nr.59498/00, § 40, ECHR 2002-III, “Jasiuniene kundër Lituanisë”, nr.41510/98, § 45, 6 mars 2003; “Sabin Popescu kundër Romanisë”, nr.48102/99, § 80, 2 mars 2004; dhe “Beshiri dhe të tjerë kundër Shqipërisë”, nr.7352/03, § 99, 22 gusht 2006; “Ramadhi dhe të tjerë kundër Shqipërisë”, cituar më sipër, § 77).

41. Gjykata duhet si pasojë të përcaktojë nëse u vendos një ekuilibër i drejtë ndërmjet kërkesave të interesave të përgjithshëm të komunitetit dhe kërkesave për mbrojtjen e të drejtave themelore të individit. Në rrethanat e rastit urgjent, Gjykata thirret për të vendosur nëse kohëzgjatja gjatë së cilës autoritetet vendore nuk arritën t’i paguanin ankuesit kompensimin duke çrregulluar ekuilibrin dhe nëse kohëzgjatja vendosi një detyrim të tepërt mbi ankuesin.

42. Gjykata vëren se ajo tashmë e ka shqyrtuar këtë çështje në gjykimin e saj në rastin e “Ramadhi dhe të tjerë”, cituar më sipër, §§ 79-84. Duke vërejtur se Qeveria nuk ka paraqitur fakte bindëse për të justifikuar dështimin e autoriteteve vendore gjatë kaq shumë viteve për të përcaktuar shumën përfundimtare të kompensimit për t’iu paguar ankuesit, Gjykata nuk shikon ndonjë arsye për të arritur një konkluzion tjetër në rrethanat e rastit urgjent.

43. Prandaj, në këtë rast, është shkëlur neni 1 i protokollit nr.1 të Konventës.

III. ZBATIMI I NENEVE 46 DHE 41 TË KONVENTËS

A. Neni 46 i Konventës

44. Neni 46 i Konventës parashikon:

“1. Palët Kontraktuese të ngritura ndërmarrin të pajtohen me vendimin përfundimtar të gjykatës në secilin rast kur janë palë.

2. Vendimi përfundimtar i Gjykatës i transmetohet Komitetit të Ministrave, i cili mbikëqyr zbatimin e tij”.

45. Gjykata përsërit konkluzionin e arritur në rastin “Ramadhi dhe të tjerë...” (cituar më sipër, §§ 90-94) për sa i përket nenit 46 të Konventës. Gjykata nxit shtetin e paditur të miratojë masa të përgjithshme siç përcaktohet në paragrafët 93 dhe 94 të gjykimit në fjalë.

B. Neni 41 i Konventës

46. Neni 41 i Konventës parashikon:

“Nëse gjykata konstaton se ka pasur shkelje të Konventës ose protokolleve të saj dhe në rast se ligji i brendshëm i palës kontraktuese të ngritur të interesuar lejon vetëm realizimin e një përmirësimi të pjesshëm, Gjykata, nëse është e nevojshme, akordon plotësim të drejtë ndaj palës së dëmtuar”.

1. Dëmshpërblimi

47. Ankuesi pretendoi 137 100 euro (eur) për sa i përket dëmshpërblimit në të holla dhe 40320 për sa i përket dëmshpërblimit jo në të holla. Për sa i përket pretendimit për dëmshpërblimin në të holla, ankuesi paraqiti një vlerësim të kualifikuar/ekspert të pasurisë, i cili vlerësoi vlerën aktuale me 68550 euro dhe humbjen e përfitimeve që nga viti 1996 me 68550 euro.

48. Qeveria nuk paraqiti argumente lidhur me shumën e pretenduar.

49. Gjykata kujton se parimet e përgjithshme të përcaktuara në gjykimin e çështjes “Ramadhi dhe të tjerë...” (cituar më sipër, §§ 98-101) për sa i përket pretendimeve të nenit 41.

50. Gjykata konsideron, në rrethanat e çështjes, se pagesa e kompensimit që i korrespondon vlerës së ngastrës së tokës me madhësi 576 metra katrorë, me masë interesi për të reflektuar humbjen përkatëse nga përdorimi i ngastrës së tokës në fjalë, do ta vendoste ankuesin sa më shumë

që të jetë e mundur në një situatë të ngjashme me situatën në të cilën ajo do të ishte në rast se nuk do të kishte pasur shkelje të Konventës.

51. Duke vërejtur se në seancat para Gjykatës ankuesi nuk veproi në emër të pesë trashëgimtarëve të tjerë dhe në mungesë të të dhënave që tregojnë se ajo është trashëgimtarja e vetme e pasurisë dhe duke marrë në konsideratë madhësinë në zotërimin e saj dhe duke e vlerësuar mbi baza të barabarta, Gjykata i akordon ankuesit shumën prej 12500 eurosh përsa i përket dëmshpërblimit në të holla.

52. Përsa i përket dëmshpërblimit jo në të holla, Gjykata, duke vendosur mbi baza të barabarta, i akordon ankuesit shumën prej 5000 eurosh.

2. Kostot dhe shpenzimet

53. Ankuesi, i cili përfitoi 850 euro si ndihmë ligjore nga Këshilli i Europës lidhur me prezantimin e çështjes së saj, kërkoi 4000 euro për shpenzimet ligjore të shkaktuara në seancat gjyqësore vendore dhe seancat gjyqësore të Strasburgut. Ajo nuk paraqiti një ndarje të detajuar për të provuar pretendimin e saj për kostot dhe shpenzimet.

54. Sipas ligjit të Gjykatës për këtë çështje, ankuesit gëzojnë të drejtën të rimbursohen për kostot dhe shpenzimet vetëm në masën që tregohet se kostot dhe shpenzimet në fjalë janë shkaktuar aktualisht dhe në mënyrë të nevojshme dhe janë të arsyeshme përsa u përket shumave. Për këtë qëllim, direktiva 60 §§ 2 dhe 3 e rregullave të Gjykatës parashikon që ankuesit duhet të bashkëmbyllin me pretendimet e tyre për një plotësim të drejtë “çdo dokumentacion përkatës mbështetës”, dështimi i së cilës bën që Gjykata “të mund të hedhë poshtë pretendimet plotësisht ose pjesërisht”. Në rastin aktual, duke vërejtur se ankuesi nuk arriti të paraqesë dokumentacionin përkatës- si p.sh. fatura të specifikuar ose *invois*-në mbështetje të pretendimit të saj, Gjykata nuk cakton ndonjë shpërblim për shpenzimet në fjalë.

3. Interesi i mospagimit

55. Gjykata e mendon të përshtatshme që interesi i mospagimit të bazohet mbi cakun e normës së huadhënies së Bankës Qendrore Europiane së cilës duhet t’i shtohet 3%.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, NJËZËRI:

1. E deklaron të pranueshme kërkesën.

2. Gjykon se ka pasur një shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës përsa i përket moszbatimit të vendimit të Komisionit të 21 marsit 1996.

3. Gjykon se nuk e konsideron të nevojshme ta shqyrtojë veças ankesën mbi kohëzgjatjen e seancave gjyqësore në bazë të nenit 6 § 1 të Konventës.

4. Gjykon se është shkelur neni 1 i protokollit nr.1 të Konventës mbi bazën e moszbatimit të vendimit të Komisionit të 21 marsit 1996.

5. Gjykon:

a) se shteti i paditur duhet t’i paguajë ankuesit, brenda tre muajve nga data në të cilën vendimi mori formën përfundimtare në përputhje me nenin 44 § 2 të Konventës, shumat e mëposhtme duke i konvertuar në monedhën e shtetit të paditur me normën e aplikueshme në datën e shlyerjes:

i) 12500 euro (dy mijë e pesëqind euro), plus çdo taksë që mund të aplikohet përsa i përket dëmshpërblimit në të holla;

ii) 5000 euro (pesë mijë euro) plus çdo taksë që mund të aplikohet përsa i përket dëmshpërblimit jo në të holla.

b) se nga skadimi i periudhës së lartpërmendur prej 3 muajsh deri në shlyerje, interesat e thjeshtë janë të pagueshëm mbi shumat e mësipërme në një normë të barabartë me cakun e normës së huamarrjes së Bankës Qendrore Europiane gjatë periudhës së mospagimit plus 3%.

6. Hedh poshtë pretendimin shtesë të ankuesit për shlyerje të plotë.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 3 shkurt 2009 në vijim të direktivës 77 §§ 2 dhe 3 të rregulloreve të gjykatës.

Lawrence Early
Sekretari

Nicolas Bratza
Kryetari

VENDIM
(Ankimi Nr. 12306/04)
ÇËSHTJA “NURI KUNDËR SHQIPËRISË”

STRASBURG
3 shkurt 2009

Ky gjykim do të marrë formë të prerë në përputhje me rrethanat e parashtruara në nenet 44 dhe 2 të Konventës. Mund edhe të redaktohet.

Kjo çështje trajton mos ekzekutimin e vendimit të KKK pronave që ka vendosur kompensimin e ankueses për truallin, vendim megjithëse ka qenë përfundimtar nuk është ekzekutuar asnjëherë (shkelje e Nenit 6.1 të Konventës). Gjykata ka konsideruar pretendimin e ankuesit të bazuar në ligjin e brendshëm për t’u kualifikuar si një “vlerë” e zbatueshme në bazë të nenit 1 të Protokollit 1. Gjykata konstaton se ndërhyrja duhet të shqyrtohet në bazë të parimit për zotërimin paqësor të pasurisë në terma të përgjithshëm (ref. çështjen Beshiri).

Në çështjen “Nuri kundër Shqipërisë”,

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (seksioni i katërt), e përbërë nga:

Nicolas Bratza Kryetar

Giovanni Bonello

David Thor Bjorgvinsson

Jan Sikuta

Paivi Hirvela

Ledi Bianku

Nebojsa Vucinic gjyqtarë

dhe Lawrence Early sekretar seksioni,

pasi shqyrtoi çështjen me dyer të mbyllura më 13 janar 2009,

mori vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua në të njëjtën datë.

PROCEDURA

1. Çështja filloi me depozitimin e një ankimi kundër Republikës së Shqipërisë (nr.12306/040) pranë Gjykatës, bazuar në nenin 34 të Konventës ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut (Konventa), nga shtetasja shqiptare, zj. Tefta Nuri (ankuesi), më 18 shkurt 2004.

2. Ankuesi, të cilit i ishte ofruar ndihmë ligjore, u përfaqësua nga zoti S. Puto, avokat i cili ushtron profesionin në Tiranë . Qeveria e Shqipërisë (Qeveria) u përfaqësua nga zj. S. Meneri.

3. Aplikanti pretendon se është shkelur neni 6§1 i Konventës dhe neni 1 i protokollit nr.1 të Konventës, sepse i është dhunuar e drejta mbi pronësinë, pasi autoritetet nuk kanë zbatuar një vendim administrativ, i cili i akordonte asaj një kompensim në vend të rikthimit të pronës.

4. Më 5 qershor 2006, Kryetari i seksionit të katërt të Gjykatës, vendosi ta njoftojë Qeverinë për ankimin. Bazuar në dispozitat e nenit 29 § 3 të Konventës u vendos të shqyrtohej meritat (themelin) i ankimit në të njëjtën kohë me vendimin për pranimin e kërkesës.

5. Aplikuesja dhe Qeveria dorëzuan aplikime shtesë me shkrim (rregulli 59 § 3).

FAKTET

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

6. Aplikuesja ka lindur në vitin 1948 dhe jeton në Tiranë.

7. Aplikuesja ka dorëzuar një aplikim në një datë të paspecifikuar te Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave në Lushnjë (Komisioni), dhe ka kërkuar kthimin e pronës të të afërmit të saj të vdekur, e cila ishte konfiskuar në 1949.

8. Më 22 prill 1994 Komisioni ka mbështetur ankimin dhe ka njohur të drejtën e pronësisë të aplikueses për dy vila dhe një ndërtesë trikatëshe me sipërfaqje 1 380 metra katrorë dhe një truall me sipërfaqje 540 merta katrorë.

9. Për sa i përket ndërtesës trikatëshe dhe njëres prej vilave, Komisioni vendosi t'i kthejë pronën aplikueses. Për sa i përket vilës tjetër, Komisioni njohu të drejtën e bashkëpronësisë së aplikueses me banorin ekzistues. Megjithatë, meqë nuk ishte e mundur që trualli prej 540 metrash katrorë t'i kthehej aplikueses, Komisioni vendosi t'i jepej kompensim me bono shtetërore me vlerë të barabartë me atë të truallit. Në fund, Komisioni urdhëroi autoritetet ta zbatojnë vendimin.

10. Në një datë të paspecifikuar aplikuesja nisi një padi civile në Gjykatën e Rrethit të Lushnjës kundër pjesës të vendimit të Komisionit që e njihte njërën nga vilat si pronë të përbashkët dhe kërkoi pronësi të plotë mbi të. Banori i vilës dhe Komisioni u njoftuan për gjyqin.

11. Më 23 janar 1996 gjykata mori vendim në favor të padisë civile të aplikueses dhe njohu pronësinë e plotë mbi vilën. Gjykata nuk mori vendim për pjesën e vendimit të Komisionit që kishte të bënte me kompensimin.

12. Më 10 maj 1996, pas një apelimi nga pala e paditur, Gjykata e Apelit në Tiranë nuk e rrëzoi vendimin e Gjykatës së Rrethit. Duke qenë se vendimi nuk u apelua në Gjykatën e Lartë, ai mori formë të prerë.

13. Në një datë të paspecifikuar, pas zbatimit të vendimit të gjykatës, aplikuesja mori pronat që i ishin dhënë, që do të thotë dy vilat dhe ndërtesën trikatëshe.

14. Në vitin 2004, duke qenë se nuk i ishin dhënë bonot shtetërore, aplikuesja i dërgoi një letër Komisionit, me anë të së cilës i kërkonte një zgjidhje për çështjen e kompensimit për truallin prej 540 metrash katrorë. Letra nuk mori përgjigje.

15. Deri më sot, autoritetet nuk i kanë dhënë kompensim për truallin prej 540 metrash katrorë, pavarësisht nga vendimi i Komisionit.

II. LIGJI I VENDIT

Ligji vendas që lidhet me këtë çështje është përshkruar në detaj në çështjen Driza kundër Shqipërisë (nr.33771/02 § 33-44 dhe KEDNJ 2007 - ... (ekstrakte)), si dhe në "Ramadi etj. kundër Shqipërisë" (nr.38222/02, 22-30, 13 nëntor 2007)

LIGJI

I. PRETENDIMI PËR SHKELJE TË NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS

17. Aplikuesja u ankua se autoritetet nuk kishin zbatuar me efikasitet vendimin e Komisionit, i cili i jepte asaj kompensim. Ajo u bazua te neni 6 § 1 i Konventës, i cili në lidhje me këtë çështje, thotë:

"Në caktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ... çdokush mund të ketë një gjykim të drejtë nga një gjykatë."

A. PRANUESHMËRIA

1. Pretencat e palëve

18. Qeveria e kundërshtoi aplikueshmërinë e nenit 6 § 1 të Konventës për praktikën administrative për çështjen në fjalë.

19. Qeveria pretendoi se aplikuesja nuk i kishte përdorur të gjitha mundësitë në vend për sa i përket moszbatimit të vendimit të Komisionit. Ata pretenduan se aplikuesja duhet të kishte bërë ankimim pranë Komitetit Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave (zëvendësuar nga Agjencia Shtetërore për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave me anë të ligjit për pronat të vitit 2006) dhe të kërkonte zbatimin e vendimit të Komisionit. Meqë një pjesë e vendimit të Komisionit ishte rikonfirmuar nga gjykatat e vendit, Qeveria pretendoi se aplikuesja duhet t'i kishte përdorur procedurat e zbatimit në përputhje me Kodin e Procedurës Civile.

20. Për sa i përket kundërshtimeve të Qeverisë për mosshkrimin e mundësive në vend, aplikuesja pretendoi se ligji i pronave nuk jepte zgjidhje për rastet e moszbatimit të vendimeve të komisionit që kanë të bëjnë me dhënien e kompensimit në vend të kthimit fizik të pronës.

2. Vlerësimi i gjykatës

21. Për sa i përket kundërshtimit të Qeverisë në lidhje me aplikueshmërinë e nenit 6 § 1 të Konventës, Gjykata vëren se një kundërshtim i ngjashëm është hedhur poshtë në vendimin e gjykatës

në çështjen “Ramadhi etj. kundër Shqipërisë” (cituar më lart, §35-37). Gjykata nuk sheh arsye të marrë vendim të ndryshëm në rastin e tanishëm. Si rrjedhim, gjykata nuk e pranon kundërshtimin e Qeverisë.

22. Për sa i përket kundërshtimit të Qeverisë për mosshkrimin e zgjidhjeve në vend nga ana e aplikueses, Gjykata mbështetet në vendimin e saj në çështjen “Ramadhi etj. kundër Shqipërisë” (cituar më lart, §50-51), që konstaton se nuk ka zgjidhje efikase për të zbaruar vendimin e Komisionit. Si rrjedhim, Gjykata hedh poshtë kundërshtimet e Qeverisë.

23. Gjykata konstaton se padia nuk është e pabazuar ose e papranueshme për ndonjë arsye tjetër sipas kuptimit të nenit 35 të Konventës. Prandaj çështja konsiderohet e pranueshme.

B. MERITAT (THEMELI)

1. Pretencat e palëve

24. Qeveria pretendoi se procesi i kompensimit ishte kompleks dhe se vështirësitë e procesit vinin për shkak të lëvizjeve masive demografike, ndryshimeve drastike në titujt e pronësisë gjatë regjimit të mëparshëm komunist, mungesës së përvojës dhe procesit të tranzicionit. Ata pretenduan se po bëheshin përpjekje për hartimin e hartave për vlerësimin e pronave. Qeveria nuk paraqiti ndonjë shifër për numrin e qytetarëve që kishin përfituar nga procesi i kompensimit.

25. Aplikuesja pretendoi se moszbatimi i vendimit të Komisionit kishte shkelur të drejtën e saj për ta zgjidhur çështjen në gjyq. Ajo pretendoi se autoritetet nuk kishin dhënë kurrë bono shtetërore si kompensim për pronarët, pavarësisht nga fakti se shteti lëshon bono thesari. Aplikuesja deklaroi se kishte bërë përpjekje për zbatimin e vendimit të Komisionit (shih paragrafin 14, më lart). Duke u zbatuar te precedenti i gjykatës, ajo pretendoi se nuk duhej të kryente procedura zbatimi për një vendim kundër autoriteteve (shih “Metaxas kundër Greqisë” nr.8415/02, § 19, 27 maj 2004).

2. Vlerësimi i gjykatës

26. Parimet e përgjithshme në nenin 6 § 1 të Konventës që kanë të bëjnë me moszbatimin e vendimeve të Komisionit shpjegohen në vendimin “Ramadhi etj. kundër Shqipërisë” (cituar më lart, § 45 e pas).

27. Gjykata konstaton se vendimi i Komisionit i datës 22 prill 1994 urdhëroi pagimin e kompensimit për truallin me përmasa 540 metra katrorë. Ai vendim nuk ishte kundërshtuar kurrë dhe është ende në fuqi.

28. Gjykata vëren se, pavarësisht nga fakti nëse vendimi përfundimtar që do të ekzekutohet merr formën e një vendimi gjyqësor ose të një autoriteti administrativ, ligji vendas, si dhe Konventa kërkon zbatimin e tij. Nuk janë marrë hapa për zbatimin e vendimit që Komisioni mori në favor të aplikueses Ramadhi etj. (cituar më lart, § 49).

29. Rrjedhimisht gjykata konkludon se ka pasur dhunim të së drejtës së aplikueses për t’iu drejtuar gjykatës në bazë të nenit 6 § 1 të Konventës.

II. PRETENDIMI PER SHKELJE TË NENIT 1 TË PROTOKOLLIT NR.1 TË KONVENTËS

30. Aplikuesja u ankua se mospagimi i kompensimit përbënte shkelje të nenit 1 të protokollit nr.1 të Konventës, i cili shprehet:

“Çdo person fizik ose ligjor ka të drejtë t’i shijojë pronat e tij në paqe. Askujt nuk mund t’i merret prona, përveç kur bëhet për të mirën e publikut dhe sipas kushteve të caktuara me ligj dhe parimet e përgjithshme të ligjit ndërkombëtar.

Dispozitat pararendëse nuk duhet t’i heqin të drejtën një shteti për të kontrolluar përdorimin e pronës në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose kontributeve, ose penaliteteve të tjera.”

A. Pranueshmëria

31. Gjykata nuk e konsideron të pabazuar kuptimin e nenit 35 § 3 të Konventës. Gjykata vëren se nuk ka arsye të tjera për ta deklaruar të papranueshme këtë pjesë të ankimit prandaj e konsideron të pranueshme.

B. MERITAT (THEMELI)

1. Pretencat e palëve

32. Qeveria pretendoi se aplikuesja nuk ka pasur kurrë posedim efektiv të pronës. Rrjedhimisht, nuk ka pasur kurrë shkelje të së drejtës së saj mbi pronën. Qeveria pranoi se procesi i kthimit dhe kompensimit nuk mund të ndodhte brenda ditës dhe në mënyrë spontane dhe se vonesat që lidhen me të kanë të bëjnë me procesin e tranzicionit që po kalon vendi.

33. Qeveria pretendoi se aplikuesja nuk ishte ankuar kurrë se vonesat në zbatim i kishin sjellë vështirësi financiare ose sociale. Meqë pjesa tjetër e vendimit të Komisionit ishte zbatuar, moszbatimi i shpërblimit nuk kishte rënduar gjendjen e aplikueses dhe nuk i kishte krijuar asaj probleme joproporcionale.

34. Aplikuesja theksoi faktin se moszbatimi i vendimit të Komisionit për kompensimin e truallit prej 540 metrash katrorë, i cili nuk ishte kundërshtuar, i shkelte asaj të drejtën e pronës.

2. Vlerësimi i Gjykatës

35. Parimet e përgjithshme të nenit nr.1 të protokollit nr.1 të Konventës janë shpjeguar në vendimin “Ramadhi etj.” (cituar më lart, § 67-71 dhe § 75-79).

36. Gjykata vëren se aplikueses i njihet e drejta e kompensimit me anë të vendimit të Komisionit në vitin 1994, i cili ishte i formës së prerë. Si rrjedhojë, për ta shqyrtuar ankesën ajo e konsideron padinë e aplikueses të bazuar në ligjin e vendit dhe një aset të zbatueshëm sipas nenit 1 të protokollit nr.1 (shih, për shembull, “Ramadhi etj.”, cituar më lart, § 71).

37. Gjykata vëren se kjo padi lidhet me atë të shqyrtuar në kuadër të nenit 6 § 1 në lidhje me moszbatimin e vendimit të Komisionit (shih paragrafët 26-29 më lart). Bazuar në precedent, Gjykata konstaton se ndërhyrja mund të shqyrtohet nën fjalinë e parë të paragrafit të parë të nenit 1 të protokollit nr.1, i cili përcakton parimin e gëzimit paqësor të pronës në terma të përgjithshëm (shih, për shembull, “Burdov kundër Rusisë”, nr.59498/00, § 40, KEDNJ 2002-III, “Jasiuniene kundër Lituanisë”, nr.41510/98, § 45, 6 mars 2003, “Sabin Popescu kundër Rumanisë” 48102/99 § 80, 2 mars 2004, dhe “Beshiri etj. kundër Shqipërisë” nr.7352/03, § 99 22 gusht 2006, “Ramadhi etj. kundër Shqipërisë”, cituar më lart, § 77).

38. Gjykata duhet të konstatojë nëse ka pasur një bilanc të drejtë midis kërkesave të interesit të përgjithshëm të komunitetit dhe kërkesave për mbrojtjen e të drejtave themelore të individit. në rrethanat e kësaj çështjeje, gjykatës iu kërkua të vendosë nëse kohëzgjatja e mospagimit të kompensimit nga autoritetet ndikojnë në këtë balancë dhe nëse kjo ishte barrë e rëndë për aplikuesen.

39. Gjykata vëren se këto çështje i ka shqyrtuar më parë në vendimin e marrë për “Ramadhi etj.”, të cituar më sipër, § 79-84. Duke qenë se Qeveria nuk prezantoi fakte bindëse për të justifikuar mospërcaktimin e shumës së kompensimit nga autoritetet e vendit për një periudhë disavjeçare, Gjykata nuk e sheh të arsyeshme të marrë vendim të ndryshëm për rrethanat e çështjes në fjalë.

40. Bazuar në sa më sipër, në këtë çështje konstatohet shkelje e nenit 1 të protokollit nr.1 të Konventës.

III. ZBATUESHMËRIA E NENEVE 46 DHE 41 TË KONVENTËS

41. Neni 46 i Konventës thotë:

“1. Palët e larta kontraktuese zotohen ta zbatojnë gjykimin përfundimtar të Gjykatës për çështje në të cilën janë palë.

2. Gjykimi përfundimtar i Gjykatës i transmetohet Komitetit të Ministrave, i cili mbikëqyr zbatimin e tij.”

42. Gjykata rithekson konkluzionet e çështjes “Ramadhi etj.”. (cituar më sipër, § 90-94) në lidhje me nenin 46 të Konventës. Ajo i kërkon shtetit të paditur të marrë masat e përgjithshme sipas paragrafëve 93 dhe 94 të vendimit në fjalë.

B. Neni 41 i Konventës

43. Aplikuesja kërkoi 141 910 euro për dëmet ekonomike dhe 42 320 euro për dëmet joekonomike. Për sa i përket kërkesës për dëmet ekonomike, aplikuesja paraqiti vlerësimin e një

eksperti për pronën, i cili e vlerësoi pronën me 64 500 euro dhe fitimin e munguar që prej vitit 1994 me 77 410 euro.

44. Qeveria nuk paraqiti argumente për shumat e kërkuara.

45. Gjykata rikujton parimet e përgjithshme të përcaktuara në çështjen “Ramadhi etj.”, (të cituar më lart, § 90-94) për sa i përket nenit 46 të Konventës.

46. Gjykata konstaton se në rrethanat e çështjes në fjalë, pagimi i kompensimit që i korrespondon vlerës së truallit prej 540 metrash katorë, me interes, për të reflektuar humbjet nga mospërdorimi i këtij trualli, do ta vendoste aplikuesen në një pozitë më të afërt të mundshme me atë në të cilën do të gjendej në qoftë se nuk do të kishte shkelje të Konventës.

47. Duke pasur parasysh materialin që zotëron dhe duke bërë një vlerësim të balancuar, Gjykata vendos që aplikueses t’i jepet shuma prej 71 500 eurosh për sa u përket dëmeve ekonomike.

48. Për sa u përket dëmeve joekonomike, Gjykata, duke marrë një vendim të balancuar, vendos që aplikueses t’i jepet shuma 5 000 euro.

1. Kostot dhe shpenzimet

49. Aplikuesja, e cila ka marrë 850 euro ndihmë ligjore nga Këshilli i Europës për prezantimin e çështjes së saj, kërkoi 4 000 euro për shpenzimet ligjore në proceset në vendin e saj dhe në Strasburg. Ajo nuk paraqiti një listë të detajuar për të mbështetur kërkesën e saj për kostot dhe shpenzimet.

50. Bazuar në precedentët e gjykatës, ankuesit mund të rimbursohen për shpenzimet vetëm nëse ato vërtetohen se janë kryer dhe kanë qenë të nevojshme dhe janë të arsyeshme. Për këtë qëllim, rregulli 60 § 2 dhe 3 i rregullores së gjykatës, kërkon që aplikantët të dorëzojnë, së bashku me kërkesat e tyre për shpërblim të drejtë, “çdo dokument mbështetës dhe relevant” ose në rast të kundërt Gjykata “mund të refuzojë kërkesat në tërësi ose pjesërisht”. Në rastin në fjalë, gjykata vëren se aplikuesja nuk paraqiti dokumente – si lista të detajuara ose fatura për të mbështetur kërkesën, dhe vendos të mos jepet shpërblim për këtë zë.

2. Interesi normal

51. Gjykata e konsideron të arsyeshme që interesi normal të bazohet te norma marginale e interesit të Bankës Qendrore Europiane, të cilit i duhet shtuar 3%.

PER KËTO ARSYE, GJYKATA, ME VENDIM UNANIM:

1. Deklaron se ankimi pranohet.

2. Vendos se ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës për sa i përket moszbatimit të vendimit të Komisionit të datës 22 prill 1994.

3. Vendos se moszbatimi i vendimit të Komisionit të datë 22 prill 1994 përbën shkelje të nenit 1 të protokollit nr.1 të Konventës.

4. Vendos:

a) Shteti i paditur duhet t’i paguajë aplikueses, brenda tre muajve nga data në të cilën vendimi - merr formë të prerë sipas nenit 44 § 2 të Konventës, shumat e mëposhtme të konvertuara në - monedhën e shtetit të paditur me kursin e datës së pagimit:

i) 71 500 euro (shtatëdhjetë e një mijë e pesëqind euro) dëme ekonomike;

ii) 5 000 euro (pesëmijë euro), plus taksat e aplikueshme, dëme joekonomike;

b) nga data e skadimit të tri muajve të lartpërmendur deri në pagimin e shumës, do të llogaritet interes i thjeshtë për shumat e mësipërme me normë të barabartë me normën marginale të interesit të Bankës Qendrore Europiane, plus 3%.

5. Rrëzon kërkesat e tjera të aplikantes për kompensim të drejtë.

Shkruar në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 3 shkurt 2009, sipas rregullit 77 § 2 dhe 3 të rregullores së Gjykatës.

Lawrence Early
Kryesekretar

Nicolas Bratza
Kryetar

VENDIM
(Ankimi nr.19206/05)
ÇËSHTJA “DAUTI KUNDËR SHQIPËRISË”

STRASBURG
3 shkurt 2009

Ky vendim merr formë të prerë në rrethanat e parashikuara në nenin 44 § 2 të Konventës. Mund t’i bëhen ndryshime editoriale.

Kjo çështje trajton shkeljen e të drejtës për akses në gjykatë kundër vendimeve administrative që kanë të bëjnë me përfitimet për statusin e invaliditetit të ankuesit (shkelje e Nenit 6.1 të Konventës). Gjykata Evropiane ka konstatuar se Komisioni i Apelit mbi ekzaminimet mjekësore, në aspektin e punës që kryen nuk përbën “një gjykatë të pavarur dhe të paanshme” dhe se vendimet e tij, sipas legjislacionit të fuqi në atë kohë, nuk mund të kundërshtohen para një gjykate.

Në çështjen Dauti kundër Shqipërisë,

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Katërt), në Dhomën e përbërë prej:

Nicolas Bratza Kryetar

Lech Garlicki

Giovanni Bonello

Ljiljana Mijovic

Paivi Hirvela

Ledi Bianku

Nebojsa Vucinic gjyqtarë

Dhe Lawrence Early, kancelar i seksionit,
pas konsultimeve me dyer të mbyllura më 13 janar 2009,
nxjerr vendimin e mëposhtëm që u mor në këtë datë.

PROCEDURA

1. Çështja bazohet në një ankim (nr.19206/05) kundër Republikës së Shqipërisë të paraqitur në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore (Konventa) nga një shtetas shqiptar, z. Ramiz Dauti ankimuesi, më 12 maj 2005.

2. Ankimuesi, të cilit i është dhënë ndihmë ligjore, u përfaqësua nga z. G. Terpo dhe z. R. Islami, avokatë që ushtrojnë aktivitetin në Tiranë dhe Dibër, Shqipëri. Qeveria Shqiptare (Qeveria) u përfaqësua nga agjenti i saj, znj S.Meneri.

3. Ankimuesi u ankua sipas neneve 6 § 1 dhe 13 të Konventës për shkeljen e së drejtës së tij për t’iu drejtuar gjykatës me qëllim që të kundërshtojë vendimet e dhëna nga organet administrative.

4. Me 23 qershor 2005, Kryetari i seksionit të katërt të Gjykatës vendosi ta njoftojë Qeverinë për ankimin. Sipas dispozitave të nenit 29 § 3 të Konventës, u vendos të shqyrtohet meritat (themeli) i ankimit, si dhe pranueshmëria.

5. Ankimuesi dhe Qeveria kanë bërë parashtrime të tjera me shkrim (rregulli 59 § 1).

MERITAT (THEMELI)

1. Rrethanat e çështjes

6. Ankimuesi ka lindur në vitin 1947 dhe banon në Tiranë.

7. Më 14 prill 1992, ankimuesi ka pësuar një aksident të rëndë në punë dhe nuk ishte në gjendje të vazhdonte punën. Nuk ka informacion të dokumentuar në lidhje me gjendjen shëndetësore të ankimuesit nga 1992 deri më 2001.

A. Procedura para Komisionit Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë

8. Ankimuesi u shtrua në spital në një datë të papërcaktuar. Më 13 mars 2001 ai doli nga spitali me një raport mjekësor, që i rekomandonte atij të bënte kërkesë për njohjen e paaftësisë për punë (fletë drejtimi për KEMP) dhe për kompensimet përkatëse.

9. Më 14 mars 2001 ankimuesi bëri kërkesë në Komisionin Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP Dibër) – komisioni i qarkut) duke kërkuar t'i caktohej shkalla e paaftësisë dhe për t'iu dhënë kompensimi. Me vendim të datës 28 shtator 2001 Komisioni njohu paaftësinë e ankimuesit për punë me efekt nga 14 prilli 1992. Megjithatë, ai vendosi që ai do të ishte i përshtatshëm për kompensimet përkatëse vetëm për periudhën 16 mars 2001 deri më 30 mars 2002 dhe i tha atij kategorinë 4 të statusit të paaftësisë me shkakun se ai konsiderohej të kishte pësuar aksident jashtë pune.

10. Më 1 tetor 2001, ankimuesi bëri ankim në Komisionin Mjekësor të Ankimeve për Caktimin e Paaftësisë për Punë (KMCAP Epror – Komisioni i Ankimeve) duke kundërshtuar pjesërisht vendimin e komisionit të qarkut. Ai argumentoi që, duke pasur parasysh që ai ka pësuar një aksident jashtë pune, komisioni i qarkut i kishte vlerësuar gabimisht rrethanat e çështjes. Ai pretendoi që atij duhej t'i jepej kategoria 2 e statusit të paaftësisë në vend të kategorisë 4.

11. Më 30 janar 2003, Komisioni i Ankimeve e anuloi plotësisht vendimin e komisionit të qarkut. Ai e deklaroi ankimuesin të përshtatshëm për punë dhe të papërshtatshëm për kompensimet e paaftësisë.

B. Gjykimi

1. Gjykimi në lidhje me njohjen zyrtare të aksidentit

12. Në një datë të pacaktuar, ankimuesi i kërkoi Gjykatës së Rrethit Dibër të verifikonte dhe të njihte që aksidenti i datës 14 prill 1992 kishte ndodhur në vendin e tij të punës.

13. Më 30 maj 2003, mbi bazën e deklarimeve me dëshmitarë dhe raporteve mjekësore, Gjykata e Rrethit Dibër konstatoi që ankimuesi kishte pësuar aksidentin më 14 prill 1992 gjatë orëve të punës. Vendimi mori formë të prerë dhe u bë i detyrueshëm më 16 korrik 2003.

2. Gjykimi në lidhje me ligjshmërinë e vendimit të Komisionit të Ankimeve

14. Në një datë të papërcaktuar, ankimuesi filloi çështjen gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Tiranë për të kundërshtuar ligjshmërinë e vendimit të Komisionit të Ankimeve.

15. Më 9 qershor 2003, gjykata e rrethit nuk e pranoi padinë e ankimuesit me shkakun se, në pajtim me seksionin 35 të ligjit të sigurimeve shoqërore, vendimet e Komisionit të Ankimeve janë përfundimtare dhe të formës së prerë dhe nuk i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor (shih paragrafi 24 më poshtë).

16. Ankimuesi bëri ankim më gjykatën e apelit. Ai pretendoi shkeljen e së drejtës së tij për t'iu drejtuar gjykatës me qëllim që të kundërshtonte drejtësinë e procedimit në Komisionin e Ankimit. Përveç kësaj, ankimuesi argumentoi që duke refuzuar të investohej për çështjen, gjykata e rrethit e kishte diskriminuar atë kundërshtuesve të tjerë që, duke kundërshtuar drejtësinë e procedimit para Komisionit të Ankimeve, kishin gjetur ndihmën e gjykatës (shih paragrafët 34 dhe 35 më poshtë).

17. Më 9 tetor 2003, gjykata e apelit mbajti në fuqi vendimin e gjykatës së rrethit, duke konfirmuar që rezultati i procedurës para Komisionit të Ankimit ishte përfundimtar dhe nuk i nënshtrohej shqyrtimit gjyqësor. Në lidhje me ankimin e ankimuesit që ai ishte diskriminuar, kjo konstatoi që gjykata e rrethit e kishte bazuar vendimin e saj në ligj dhe jo në precedentë gjyqësorë. Së fundi, gjykata nuk pranoi argumentin e ankimuesit në lidhje me paaftësinë e pretenduar të anëtarëve të komisionit të ankimeve dhe konstatoi që aftësitë e tyre profesionale janë të pranueshme.

18. Më 5 mars 2004, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë refuzoi një ankim të ankimuesit.

19. Në një datë të papërcaktuar, ankimuesi bëri ankim në Gjykatën Kushtetuese, duke kundërshtuar vendimet e gjykatave më të ulëta. Ai pretendoi shkeljen e së drejtës së tij për t'iu drejtuar gjykatës me qëllim që të kundërshtojë vendimin e Komisionit të Ankimeve para gjykatave vendase dhe për të marrë ndihmë për padrejtësinë e pretenduar gjatë procedimit në komisionin e ankimeve.

Për më tepër, ai kundërshtoi kompetencën e anëtarëve të Komisionit të Ankimeve.

20. Më 23 dhjetor 2004, Gjykata Kushtetuese la në fuqi vendimet e gjykatave më të ulëta. Gjykata Kushtetuese nuk shqyrtoi ankimin e ankimuesit në lidhje me mungesën e kontrollit gjyqësor të vendimit të komisionit të ankimeve. Ajo vuri në dukje që gjykata e apelit kishte marrë vendim për çështjen e paanësisë së anëtarëve të komisionit. Ajo doli me përfundimin që ata janë emëruar nga Ministria e Shëndetësisë mbi bazën e aftësive, kualifikimeve dhe eksperiencës së tyre profesionale. Kështu ankimi i ankimuesit ishte i pabazuar.

C. Zhvillime të fundit

21. Më 10 qershor 2005, ankimuesit iu dha një raport mjekësor që i rekomandonte të bënte kërkesë për kategorinë 2 të statusit të paaftësisë (fletëdrejtimi për KEMP). Më 22 korrik 2005, Komisioni i Qarkut Dibër e konstatoi ankimuesin tërësisht të paaftë për punë me efekt nga 16 marsi 2001 dhe i dha atij kompensimet e paaftësisë për periudhën 30 qershor 2005 dhe 30 qershor 2006. Komisioni i Ankimeve, pas ankimit të ankimuesit, e ndryshoi periudhën, kështu që ajo përfshinte 20 nëntor 2005 deri 30 maj 2006.

22. Më 29 qershor 2006, Komisioni i Ankimeve e shtyu statusin e paaftësisë së ankimuesit nga 1 qershor 2006 deri në 1 janar 2007.

23. Me një certifikatë të komisionit të qarkut të datës 21 qershor 2007, paaftësia e ankimuesit u shtri në periudhën nga 1 janar 2007 deri në 1 janar 2008.

II. Ligji dhe praktika e brendshme përkatëse

A. Akti i sigurimeve shoqërore (ligji nr.7703, datë 11 maj 1993, i ndryshuar me ligjin nr.7932 të vitit 1995, ligjet nr.8286 dhe 8392 të vitit 1998, ligjin nr.8575 të vitit 2000, ligjet nr.8776 dhe 8852 të vitit 2001, ligji nr.8889 të vitit 2002, ligjet nr.9058 dhe 9114 të vitit 2003 dhe ligjin nr.9498 të vitit 2006).

24. Akti i sigurimeve shoqërore themeloi Komisionin Mjekësor për Caktimin e Aftësisë për Punë (KMCAP), i cili përcakton paaftësinë e ankimuesit për punë. Seksioni 35 i aktit parashikon që vendimi (i Komisionit) tregon shkaqet e paaftësisë për punë, datën e fillimit dhe shkallën e paaftësisë. Një ankimues mund të bëjë ankim te Komisioni i Ankimeve kundër vendimit të komisionit të qarkut. Vendimi i Komisionit të Ankimeve në lidhje me vlerësimin e paaftësisë për punë është përfundimtar.

25. Seksioni 71 parashikon ngritjen e Institutit të Sigurimeve Shoqërore (ISSH) që rregullon dhe administron sigurimet sociale në vend. ISSH-ja përbëhet nga dy organe kryesore: këshilli administrativ dhe drejtori i përgjithshëm. Këshilli administrativ është organi më i lartë ekzekutiv dhe përbëhet nga dymbëdhjetë anëtarë (gjashtë përfaqësues nga Këshilli i Ministrave – nga Ministria e Financave, Ministria e Punës, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Drejtësisë, ISSH-ja dhe Banka e Kursimeve -, tre përfaqësues nga organizatat e punëdhënësve dhe tre përfaqësues nga bashkimet profesionale). Drejtori i përgjithshëm zgjidhet nga këshilli administrativ.

26. Seksioni 77 parashikon që këshilli administrativ duhet t'i paraqesë Këshillit të Ministrave, nëpërmjet Ministrisë së Financave, një raport financiar vjetor (të ardhura dhe shpenzime) dhe zërat e buxhetit për ISSH-në.

27. Seksioni 86 parashikon që ankimet kundër vendimeve mbi përfitimet mund të bëhen në drejtoritë rajonale. Ankimet kundër vendimeve të zyrove rajonale mund të bëhen në selinë e ISSH-së dhe pastaj te gjykatat e brendshme.

1. Rregullorja e përbashkët e datës 13 korrik 1995 të ISSH-së dhe Ministrisë së Shëndetësisë mbi organizimin, të drejtat dhe detyrat dhe funksionimin e Komisionit Mjekësor për Caktimin e Aftësisë për Punë (KMCAP – Komisioni).

28. Shtesa të rregullores së përbashkët, ndërmjet dispozitave të tjera seksioni 35 të aktit të sigurimeve shoqërore. Komisioni drejtohet dhe i raporton ISSH-së. Ai operon në nivel rajonal (komisionet e qarkut) dhe në nivel kombëtar (Komisioni i Ankimeve).

29. Komisionet e rajonit (KMCAP) përbëhen nga tre ose pesë mjekë të specializuar nga fushat e kardiologjisë, neurologjisë, psikiatrisë, patologjisë etj., që kanë të paktën pesë vjet eksperiencë, përveç mjekut të ISSH-së. Ata emërohen për një periudhë të pacaktuar kohe nga drejtoritë rajonale të ISSH-së. Emërimi miratohet nga shefi i njësisë së shëndetit, nën mbikëqyrjen e

të cilit punojnë mjekët e emëruar. Çdo ndryshim në anëtarësinë e komisioneve rajonale duhet të aprovohet nga ISSH-ja. Puna e anëtarëve shpërblehet në raport me praninë e tyre. Komisioni rajonal shqyrton kërkesën e ankimuesit, dokumentet mjekësore dhe financiare, paaftësinë e personit për punë dhe nivelin e paaftësisë. Ai vendos për shkakun e paaftësisë, kohën e fillimit dhe kohëzgjatjen dhe mundësinë e rishqyrtimit/rishikimit dhe trajnimit fizik dhe në punë. Komisioni konsideron që personat që janë të paaftë për punë të kenë të drejtën e përfitimeve të paaftësisë së plotë, nëse niveli i paaftësisë është i barabartë ose e kalon 67%.

30. Komisioni i Ankimeve (KMCAP epror) trajton ankimet kundër vendimeve të komisioneve rajonale. Komisioni i ankimeve përbëhet nga mjekë të specializuar në fushën e kardiologjisë, neurologjisë, psikiatrisë dhe patologjisë. Anëtarësia përcaktohet nga ISSH-ja dhe aprovohet nga Ministria e Shëndetësisë. Anëtarët emërohen për një periudhë të pacaktuar kohe. Si rregull komisioni i ankimeve kryesohet nga shefi i njësisë së shëndetit. Puna e anëtarëve shpërblehet në raport me praninë e tyre. Vendimet janë përfundimtare dhe të formës së prerë.

31. Rregullorja e përbashkët nuk përmban ndonjë dispozitë në lidhje me largimet nga detyra apo dorëheqjet e anëtarëve të komisioneve rajonale ose Komisionit të Ankimeve.

B. Kodi i Procedurës Civile

32. Nenet e Kodit të Procedurës Civile rregullojnë gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative. Neni 324 parashikon që një palë mund të ngrejë padi në gjykatë me qëllim anulimin ose ndryshimin e një vendimi administrativ. Pala duhet të argumentojë që vendimi është i paligjshëm dhe që interesat dhe të drejtat e tij ose të saj cenohen drejtpërdrejt ose tërthorazi, individualisht ose kolektivisht. Ankim mund të bëhet edhe kundër një vendimi gjyqësor të një gjykatë më të lartë.

C. Kodi i Procedurave Administrative

33. Nenet 18 dhe 137 të Kodit të Procedurave Administrative sanksionojnë parimin e kontrollit gjyqësor të vendimeve administrative, me kusht që të jenë përdorur të gjitha mjetet e brendshme të ankimit administrativ.

D. Praktika e brendshme

34. Gjykata e Rrethit Tiranë, me vendimin nr.1522, datë 30 prill 2001 pranoi padinë civile të ankimuesit, që kërkonte anulimin e vendimeve të komisionit rajonal dhe komisionit të ankimeve, që kishin revokuar paaftësinë e ankimuesit pas nëntë vitesh njohjeje (nga vitit 1991 deri në 2000). Gjykata caktoi një grup ekspertësh për të shqyrtuar nga pikëpamja mjekësore ankimuesin dhe përfundimisht prishi vendimin e Komisionit të Ankimeve.

35. Pas një ankimi nga ISSH-ja, në mbështetje të seksionit 35 të aktit të sigurimeve shoqërore, gjykata e ankimit mbajti në fuqi vendimin e gjykatës së rrethit më 6 nëntor 2001. Gjykata e apelit e anashkaloi tekstin e seksionit 35 të aktit të sigurimeve shoqërore duke u mbështetur në seksionin 86 të aktit.

Ligji

I. Shkelja e pretenduar e nenit 6 § 1 të Konventës

36. Ankimuesi bëri ankim në bazë të nenit 6 § 1 të Konventës që atij i ishte mohuar e drejta për t'iu drejtuar gjykatës në faktin që gjykatat e brendshme nuk kishin shqyrtuar ankimin e tij që vendimi i Komisionit të Ankimeve duhet të deklarohet i pavlefshëm.

Pjesët përkatëse të nenit 6 § 1 të Konventës parashikojnë:

“Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të veta civile ..., kushdo ka të drejtën e një procesi të rregullit ... nga (një) ... gjykatë...”

A. Pranueshmëria

Zbatimi i nenit 6 § 1 të Konventës

37. As Qeveria, dhe as ankimuesi nuk e kundërshtoi zbatueshmërinë e nenit 6 § 1 të Konventës në këtë rast. Nuk janë paraqitur argumente dhe nuk ka asgjë që të tregojë që ky rast në lidhje me pretendimin e ankimuesit për përfitimet nga paaftësia nuk ka të bëjë me një mosmarrëveshje për një “të drejtë” që mund të thuhet që, për shkaqe të diskutueshme, të njëjtit sipas ligjit të brendshëm. Veçanërisht, nuk mund të thuhet që pretendimi i ankimuesit ishte i pabazuar ose i tepërt apo të ketë mungesa të tjera në bazën e tij.

38. Nuk diskutohet që gjykata është e bindur që e drejta në fjalë ishte “civile” në karakterin e vet në kuptimin autonom të nenit 6 § 1 të Konventës. Gjykata përsërit që më parë ka vendosur që përfitimet e mirëqenies dhe të drejtat e sigurimeve shoqërore janë “të drejta civile” brenda kuptimit të nenit 6 § 1 të Konventës, i cili zbatohet në gjykimin në lidhje me to (shih, për shembull, “Salesi v. Italy”, 26 shkurt 1993, § 19, seria A nr.257-E). Kjo çështje ka të bëjë me të drejtën e ankimuesit për përfitime mirëqenieje, që është pagesa e paaftësisë që rrjedh nga paaftësia e tij për punë.

39. Gjykata nxjerr përfundimin se neni 6 § 1 i Konventës zbatohet në këtë rast.

40. Gjykata është e mendimit që ankimi nuk duket i pabazuar. Ajo konstaton më tej që nuk ka shkaqe të tjera për deklarimin të papranueshme dhe këtu që ajo e deklaroi të pranueshme.

B. Meritat (themeli)

1. Parashtresat e palëve

41. Ankimuesi parashtroi që vendimet administrative i nënshtroheshin rishikimit gjyqësor në pajtim me seksionin 86 të aktit të sigurimeve shoqërore dhe nenit 324 të Kodit të Procedurës Civile. Sipas mendimit të tij, gjykatat e brendshme janë gjithashtu ligjërish të detyruara të pranojnë ankimet e tij mbi bazën e vendimeve të mëparshme të brendshme gjyqësore (shih paragrafët 34 dhe 35 më sipër).

42. Në lidhje me argumentin e ankimuesit që gjykatat e vendit kishin rishikuar vendimet e Komisionit të Ankimeve, Qeveria parashtroi që çështja e ankimuesit ishte shqyrtuar rregullisht dhe në mënyrë të arsyeshme nga Komisioni i Ankimeve. Sipas mendimit të Qeverisë, pozicioni i ankimuesit ndryshonte nga ai i ankimuesit në një vendim të mëparshëm gjyqësor të brendshëm, në faktin që paaftësia për punë e ankimuesit tjetër dhe përfitimet përkatëse ishin revokuar pas dhjetë vjet njohjeje.

43. Qeveria pretendon që pretendimet e ankimuesit janë shqyrtuar nga gjykatat e vendit. Kështu, gjykata e apelit kishte konstatuar që përbërja e Komisionit të Ankimit ishte në pajtim me ligjin dhe anëtarët e tij ishin caktuar nga Ministria e Shëndetësisë. Për më tepër, Gjykata Kushtetuese kishte konstatuar që vendimi që përcakton kategorinë e paaftësisë së ankimuesit u takon gjykatave më të ulëta.

44. Deri në masën që pretendimi i ankimuesit duhej të interpretohej në lidhje me vlerësimin e provave, Qeveria ishte e mendimit që neni 6 § 1 i Konventës nuk vendoste ndonjë rregull në lidhje me pranueshmërinë e provave. Këto çështje, duke përfshirë vlerësimin e tyre, u takonin kryesisht gjykatave të brendshme.

2. Vlerësimi i gjykatës

45. Meqenëse neni 6 § 1 i Konventës konsiderohet të jetë i zbatueshëm, për pasojë ankimuesi kishte të drejtë që çështja e tij të shqyrtohej nga një “gjykatë” që përmbush kushtet e parashikuara në këtë nen.

46. Ndërsa neni 6 § 1 parashikon “të drejtën për në gjykatë”, ai nuk i detyron shtetet kontraktuese t’ia nënshtrojnë mosmarrëveshjet në lidhje me të “drejtat dhe detyrimet civile” ,një procedure të zhvilluar në të gjitha fazat e saj para “gjykatave” që përmbushin kërkesat e ndryshme të nenit. Nevoja për fleksibilitet dhe efikasitet, që janë plotësisht në pajtim me mbrojtjen e të drejtave të njeriut, mund ta justifikojnë ndërhyrjen fillestare të organeve administrative ose profesionale dhe, aq më tepër, të organeve gjyqësore që nuk përmbushin këto kërkesa në çdo aspekt. “E drejta për në gjykatë” mbulon çështjet e faktit po aq sa edhe çështjet e ligjit (shih Le Compte, Ven Leuven dhe De Meyere v. Belgium, 23 qershor 1981, § 51, seria A nr 43).

47. Gjykata vëren që në bazë të nenit 6 § 1 të Konventës, është e nevojshme që vendimet e organeve administrative që nuk përmbushin vetë kërkesat e këtij neni duhet t’i nënshtrohen kontrollit pasues të një “organi gjyqësor që ka juridiksion të plotë” (shih për shembull, Ortenberg v. Austria, 25 nëntor 1994, § 31, seria A nr 295-B, dhe Crisan v. Rumania, nr 42930/98, § 24, 27 maj 2003).

48. Gjykata vëren që të paktën në një shkallë, gjykatat e brendshme, vendimet përfundimtare të të cilave nuk u kundërshtuan nga Qeveria, rishikoi vendimin e Komisionit të Ankimeve (shih paragrafët 34 dhe 35 më sipër). Në këtë rast, mbi bazën e praktikës së brendshme, ankimuesi bëri ankim te gjykatat e brendshme, as refuzuan pretendimet e tij me shkakun që vendimi i Komisionit të Ankimeve ishte përfundimtar dhe nuk i nënshtrohej kontrollit gjyqësor.

Për më tepër, Gjykata Kushtetuese nuk shqyrtoi ankimin e ankimuesit në lidhje me mungesën e kontrollit gjyqësor të vendimit të Komisionit të Ankimeve (shih paragrafin 20 më sipër).

49. Gjykata nuk është e bindur që argumenti i Qeverisë që çështja e ankimuesit ka qenë nga pikëpamja lëndore ndryshe nga ajo e ankimuesit tjetër (shih paragrafin 42 më sipër). Thelbi i ankimeve të ankimuesit lidhej me pavlefshmërinë e vendimit të Komisionit të Ankimeve, njësoj si ai i ankimuesit tjetër. Gjykata nxjerr përfundimin që gjykatat e brendshme mund të kishin vepruar në të njëjtën mënyrë edhe me këtë çështje dhe të shqyrtonin “çështjet e faktit, ashtu edhe ato të ligjit”.

50. Kështu është e nevojshme të përcaktohet nëse komisioni i ankimeve përbënte një “gjykatë të pavarur dhe të paanshme” brenda kuptimit të nenit 6 § 1 të Konventës.

51. Me qëllim që të përcaktohet nëse një gjykatë konsiderohet e pavarur, duhet t’i kushtohet vëmendje, ndër të tjera, mënyrës së emërimit të anëtarëve të saj dhe mandatit në detyrë, ushtrimit të garancive ndaj presioneve të jashtme dhe çështjes nëse organi ka shprehjen e pavarësisë (shih, ndër të tjerash *Morris v. Mbretërisë së Bashkuar* nr 38784/97, § 58, KEDNJ 2002-I).

52. Gjykata vëren që Komisioni i Ankimeve përbëhet tërësisht nga mjekë në detyrë, të emëruar nga ISSH-ja dhe të aprovuar së fundi nga Ministria e Shëndetësisë, nën autoritetin dhe mbikëqyrjen e së cilës mjekët punojnë. Në Komisionin e Ankimeve nuk ka anëtarë të kualifikuar ligjorë apo gjyqësorë (shih, për kontrast, *Le Compte, Van Leuven dhe De Meyere* të përmendur më sipër, § 58).

53. Ligji dhe rregulloret e brendshme nuk përmbajnë rregulla që të rregullojnë mandatin e anëtarëve në detyrë, largimin e tyre, dorëheqjen apo ndonjë garanci për patundshmërinë e tyre. Rregullat statusore nuk parashikojnë mundësinë e betimit të bërë nga anëtarët e tij. Duket sikur ata mund të largohen në çdo moment nga detyra, sipas dëshirës së ISSH-së ose Ministrisë së Shëndetësisë, që ushtrojnë diskrecion të pakufizuar. Pozicioni i anëtarëve të komisionit të ankimeve është i hapur ndaj presioneve të jashtme. Një situatë e tillë e minon pamjen e pavarësisë.

54. Nga sa më sipër, gjykata konsideron që Komisioni i Ankimeve nuk mund të konsiderohet si një “gjykatë e pavarur dhe e paanshme”, siç kërkohet në nenin 6 § 1 të Konventës.

55. Duke pasur parasysh faktin që komisioni i ankimeve nuk përbën një “gjykatë të pavarur dhe të paanshme” dhe që vendimet e tij, sipas ligjit në fuqi në këtë kohë, nuk mund të kundërshtohen para një gjykate vendase, gjykata konkludon që ka pasur shkelje të së drejtës së ankimuesit për t’iu drejtuar gjykatës sipas nenit 6 § 1 të Konventës.

II. Shkeljet e pretenduara të nenit 13 të Konventës

56. Ankimuesi u ankua që nuk ka mjet të efektshëm mbrojtjeje me anë të të cilit të kundërshtohet vendimi i komisionit të ankimeve para gjykatave të brendshme. Ai u mbështet në nenin 13 të Konventës, që parashikon:

“Kushdo të cilit i shkelen të drejtat dhe liritë që parashikohen në Konventë ka mjete të efektshme para një autoriteti të brendshëm, pavarësisht nëse shkelja është bërë nga persona që veprojnë në një cilësi zyrtare.”

A. Pranueshmëria

57. Gjykata konsideron që kjo ankesë nuk duhet e pabazuar. Ajo konstaton më tej që nuk ka shkak për ta deklaruar të papranueshme dhe kështu e deklaroi atë të pranueshme.

B. Meritat (themeli)

58. Gjykata ripërsërit që në masën që e drejta e Konventës e ngritur nga ankuesi është një “e drejtë civile”, neni 6 § 1 konsiderohet të përbëjë një *lex specialis* në lidhje me nenin 13. Garancitë e tij janë më rigorozë dhe përfshijnë ato të nenit 13 (shih *Menesheva v. Rusisë*, nr 59261/00, § 105, KEDNJ 2006-..)

59. Gjykata konsideron që nuk është e nevojshme që të shqyrtohet ankesa e ankimuesit nën kërkesa më pak rigorozë.

III. Zbatimi i nenit 41 të Konventës

60. Neni 41 i Konventës parashikon:

“Nëse gjykata konstaton që ka një shkelje të Konventës ose protokolleve të saj dhe nëse ligji i brendshëm i një Pale Kontraktuese përkatëse lejon të bëhet vetëm zhdëmtim i pjesshëm, gjykata, sipas rastit, i jep palës së dëmtuar kompensim të drejtë.”

A. Dëmi

61. Ankimuesi pretendoi 30 000 euro si dëm monetar dhe 500 000 euro si dëm jomonetar.

62. Qeveria i kundërshtoi pretendimet e ankimuesit. Ata parashtruan që nëse gjykata do të vendosë për t'i dhënë ankimuesit zhdëmtim monetar, ajo duhet ta bëjë këtë vetëm për periudhën 16 mars 2001 dhe 30 mars 2002. Ajo thekson që vendimet e viteve 2003, 2004 dhe 2005 që njohin paaftësinë e ankimuesit nuk janë kundërshtuar. Qeveria pretendon që pretendimi i ankimuesit për zhdëmtim jomonetar është i tepërt.

63. Gjykata ka konstatuar një shkelje të së drejtës së ankimuesit për t'iu drejtuar gjykatës sipas nenit 6 § 1 të Konventës me qëllim kundërshtimin e vendimit të komisionit të ankimit që shqyrtoi "të drejtat civile" të ankimuesit. Nuk i takon Gjykatës të spekulojë se cili do të kishte qenë rezultati i gjykimit nëse do të ishin në pajtim me kërkesat e nenit 6 § 1 të Konventës. Kështu që nuk jep asnjë zhdëmtim monetar.

64. Gjykata pranon që ankimuesit duhet t'i jetë shkaktuar një masë e konsiderueshme stresi dhe shqetësimi si rezultat i mohimit të së drejtës së tij për t'iu drejtuar gjykatës. Duke bërë një vlerësim mbi një bazë të drejtë, ajo i jep ankimuesit një shumë prej 6000 euro për zhdëmtimin jomonetar.

B. Kostoja dhe shpenzimet

65. Ankimuesi pretendoi 20 000 euro për koston dhe shpenzimet e shkaktuara para gjykatave vendase dhe ato të shkaktuara para gjykatës.

66. Qeveria e kundërshtoi pretendimin e ankimuesit.

67. Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës, ankimuesi ka të drejtën e rimbursimit të koston dhe shpenzimeve vetëm në masën që janë shkaktuar faktikisht dhe që kanë qenë të nevojshme dhe të arsyeshme në masë (shih, për shembull, Nilsen dhe Johnsen kundër Norvegjisë (GC), nr 23118/93, ç 62, KEDNJ 1999-VIII).

68. Në këtë çështje, duke pasur parasysh mungesën e dokumenteve provuese, Gjykata e refuzon pretendimin e koston dhe shpenzimeve në gjykimet vendase dhe gjykimin para gjykatës.

C. Interesi i munguar

69. Gjykata e konsideron të përshtatshme që interesi i munguar të bazohet në normën marginale të huadhënies së Bankës Europiane Qendrore, së cilës duhet t'i shtohen tri pikë përqindje.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, NJËZËRI:

1. Deklaron ankimin të pranueshëm.

2. Konsideron që ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës.

3. Konsideron që nuk është e nevojshme për ta shqyrtuar ankesën e ankimuesit sipas nenit 13 të Konventës.

4. Konsideron:

a) që shteti i paditur duhet t'i paguajë ankimuesit, brenda tri muajve nga data në të cilën ky vendim merr formë të prerë në pajtim me nenin 44 § 2 të Konventës 6000 euro (gjashtë mijë euro) në lidhje me dëmin jomonetar, që duhet të konvertohet në monedhën vendase të shtetit të paditur me kursin e këmbimit të datës së këmbimit, plus tatimin që mund të ngarkohet;

b) që nga skadimi i afatit tremujor të përmendur më sipër deri në momentin e pagesës paguhet interes i thjeshtë mbi shumën e përmendur më sipër me një normë të barabartë me normën marginale të huadhënies së Bankës Qendrore Europiane gjatë periudhës së qenies në vonesë duke i shtuar tri pikë përqindje.

5. Refuzon pjesën tjetër të pretendimit të ankimuesit për kompensim të drejtë.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 3 shkurt 2009, në pajtim me rregullin 77 §§ 2 dhe 3 të rregullave të Gjykatës.

Lawrence Early
Kryesekretar

Nicolas Bratza
Presiden

VENDIM
(Ankimi nr.2141/03)
ÇËSHTJA “VRIONI DHE TË TJERËT kundër SHQIPËRISË”

STRASBURG
24 mars 2009

Ky vendim do të marrë formë të prerë në rrethanat e përcaktuara në nenin 44 § 2 të Konventës. Ai mund t'i nënshtrohet rishikimit redaktues.

Në këtë çështje, ankuesit ankohen për shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës në drejtim të anulimit të vendimit të formës së prerë të datës 5 shkurt 1998 në favor të tyre, në atë që autoritetet kombëtare kanë shkelur parimin e sigurisë ligjore dhe të drejtën e ankuesve “për t’iu drejtuar gjykatës” në bazë të nenit 6 § 1 të Konventës. Gjykata Evropiane tërheq vëmendjen se siguria ligjore presupozon respektin ndaj parimit të res judicata, domethënë, parimin e gjësë së gjykuar. Ky parim insiston që asnjë palë nuk ka të drejtë të kërkojë rishikimin e një vendimi detyrues të formës së prerë vetëm për të përfituar një ridëgjim në seancë gjyqësore dhe një rishqyrtim dhe rigjykim të çështjes. Kompetencat për rishikim të gjykatave më të larta duhen ushtruar për korrigjimin e gabimeve gjyqësore dhe dështimeve në dhënien e drejtësisë, por jo për të kryer një gjykim të ri të çështjes. Gjykata përsërit që “posedimi” mund të jetë “posedim ekzistues” apo aset duke përfshirë, në disa situata të përcaktuara qartë edhe pretendimet. Një vendim gjyqësor i formës së prerë, i cili i njeh dikujt titullin e pronësisë mund të konsiderohet si një “pronë” për qëllimet e Nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës.

Në çështjen “Vrioni dhe të tjerët kundër Shqipërisë”,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (seksioni i katërt), e mbledhur si trup gjykues i përbërë nga:

Nikolas Bratza kryetar
Lech Garlicki
Giovanni Bonello
Ljiljana Mijovic
David Thor Bjorgvinsson
Ledi Bianku
Mihai Poalelungi gjyqtarë
dhe Fatos Araci zëvendëssekretar i seksionit,
pasi shqyrtuan çështjen në fjalë me dyer të mbyllura më 3 mars 2009,
jep vendimin e mëposhtëm, të miratuar po në atë datë.

PROCEDURA

1. Çështja nisi me kërkesëpadinë (nr.2141/03) kundër Republikës së Shqipërisë të depozituar në Gjykatë në bazë të nenit 34 të Konventës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore (Konventa) nga pesë shtetas shqiptarë, zonja Valeria Vrioni (Benusi), zoti Julian Benusi, zonja Cecili Benusi, zonja Hartina Benusi dhe zonja Klara Benusi (paditësit), në datën 21 dhjetor 2002.

2. Paditësit u përfaqësuan nga zonja L.Sula, avokate në Tiranë. Qeveria Shqiptare (Qeveria) u përfaqësua nga ish-përfaqësuesit e saj në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, zoti S. Puto dhe zonja S.Meneri.

3. Paditësit pretenduan që ishte bërë një shkelje e nenit 6 § 1 të Konventës për shkak të anulimit të një vendimi të formës së prerë në procedurat e rekursit në interes të ligjit dhe

kohëzgjatjes së procedurave civile palë e së cilave ata kishin qenë. Ata gjithashtu iu referuan nenit 1 të protokollit nr. 1, duke u ankuar në lidhje me shkeljen e së drejtës të gëzimit paqësor të pronës së tyre.

4. Në datën 5 korrik 2005, kryetari i seksionit të katërt të Gjykatës vendosi ta njoftonte Qeverinë në lidhje me kërkesëpadinë. Në bazë të dispozitave të nenit 29 § 3 të Konventës, u vendos shqyrtimi në themel i kërkesëpadisë dhe në të njëjtën kohë edhe i pranueshmërisë së saj.

5. Paditësit dhe Qeveria depozituan veçmas vërejtjet me shkrim (rregulli 59 § 1 i rregullores së Gjykatës). Palët iu përgjigjën me shkrim vërejtjeve përkatëse të njëra-tjetrës. Gjithashtu, komentet e palës së tretë u morën nga trashëgimtari i KG-së, që ishte autorizuar nga kryetari për të ndërhyrë në procedurën me shkrim (neni 36 § 2 i Konventës dhe rregulli 44 § 2).

FAKTET

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

6. Paditësit kanë lindur përkatësisht në vitet 1936, 1934, 1930, 1971 dhe 1973 dhe jetojnë në Romë (Itali) dhe Tiranë (Shqipëri).

7. Në Shqipërinë e paraluftës, i ati i paditësve zotëronte një vilë dhe tokën rreth saj me sipërfaqe 1.377 metra katrorë që ndodhej në Tiranë.

8. Në vitin 1941 Banka e Napolit (Banka) mori një hipotekë të vendosur mbi pronën, duke përfshirë copën e tokës dhe vilën, si garanci për një hua që paditësi kishte marrë nga banka. Në vitin 1945 pronësia e bankës i kaloi shtetit, duke përfshirë edhe detyrimet e bankës, ndërmjet të cilave edhe huaja e paditësit.

9. Më 21 prill 1948, Gjykata e Lartë Ushtarake e deklaroi të atin e paditësve fajtor për vepra politike, duke e dënuar atë me shtatë vjet heqje lirie, si edhe urdhëroi konfiskimin e gjysmës së pasurisë së tij që ishte depozituar në formën e hipotekës. Konfiskimi u ekzekutua në bazë të një vendimi të Komitetit Ekzekutiv të K P Qytetit Tiranë më 20 korrik 1948.

10. Nga dokumentet rezulton që pronësia e pronës në fjalë i kaloi shtetit më 16 korrik 1957. Në datën 4 shtator 1957, sipas ligjit nr.419, datë 16 prill 1947, Ministria e Financave urdhëroi zyrën e hipotekës të shlyente borxhin hipotekor të pronës së të atit të paditësve. Në datën 5 tetor 1957, i ati i paditësve ia shiti pjesën e tij të pasurisë shtetasit P.D.

11. Në vitin 1959 shteti ia shiti pjesën e tij të pasurisë shtetasit K.G. Rrjedhimisht, në vitin 1959 vila dhe toka rreth saj ishin në bashkëpronësi të shtetasve P.D dhe K.G.

A. Grupi i parë i procedurave që kanë të bëjnë me kthimin e pronave

12. Në datën 8 tetor 1992, në bazë të aktit për rehabilitimin e viktimave të represionit politik (ligji nr.7514, datë 30 shtator 1991), njësia financiare pranë Bashkisë së Tiranës i dha paditësve pjesën e vilës që në atë kohë zotërohej nga shtetasi K.G, si edhe gjysmën e tokës që e rrethonte. Bashkia ishte e mendimit që pasuria ishte konfiskuar në mënyrë të paligjshme dhe për pasojë paditësve duhej t'u kthehej e drejta e pronësisë në lidhje me atë pjesë të saj. Gjithashtu, bashkia urdhëroi regjistrimin e titullit të pronësisë së paditësit në regjistrin kadastral të Tiranës.

1. Procedurat e zakonshme në lidhje me dhënien e titullit të pronësisë

13. Në një datë të paspecifikuar, shtetasi K.G depozitoi një padi civile në Gjykatën e Rrethit Tiranë, ku kërkonte anulimin e urdhrit për dhënien e titullit të pronësisë, duke arsyetuar që ai kishte qenë një blerës në mirëbesim (*bona fide*). Ai mendonte që akti për rehabilitimin e viktimave të represionit politik nuk ishte i zbatueshëm për pronat private. Gjithashtu, shtetasi K.G parashtroi që vila i kishte kaluar shtetit për shkak të pamundësisë së të atit të paditësve për të shlyer hipotekën.

14. Në datën 16 shkurt 1995 Gjykata Rrethit Tiranë e rrëzoi kërkesën e shtetasit K.G. si të pabazuar.

15. Në datën 26 prill 1995 në vijim të padisë së shtetasit K.G., Gjykata e Apelit Tiranë e anuloi vendimin e Gjykatës së Rrethit Tiranë dhe duke vendosur në themel e deklaroi të pavlefshëm urdhrin e dhënies së titullit të pronësisë, meqë ai ishte lëshuar nga një autoritet që nuk kishte kompetencën e duhur për të vendosur në lidhje me këtë çështje. Gjithashtu, gjykata caktoi komisionin e kthimit dhe kompensimit të pronave (komisioni) si autoritetin kompetent për të vendosur në lidhje me çështjet e kthimit të pronave.

16. Në një datë të paspecifikuar paditësit apeluan në Gjykatën e Lartë. Më 7 korrik 1995 Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë e anuloi vendimin e Gjykatës së Apelit, duke konstatuar që urdhri për dhënien e titullit të pronësisë ishte lëshuar në vitin 1992, domethënë, një vit para ngritjes së komisionit. Rrjedhimisht gjykata çmoi që urdhri duhej të konsiderohej se jepte një titull pronësie të ligjshëm.

2. Rekursi ne interes te ligjit

17. Në një datë të paspecifikuar Kryetari i Gjykatës së Lartë depozitoi një kërkesëpadi për rekursit ne interes te ligjit. Ai pretendonte që vendimi i Gjykatës së Lartë i datës 7 korrik 1995 nuk ishte i mbështetur në ligj dhe që duhej të zbatohej akti për kthimin dhe kompensimin e pronave. Më 22 maj 1996 Gjykata e Lartë (Kolegji i Bashkuar) e anuloi vendimin e Gjykatës së Lartë të datës 7 korrik 1995 dhe ia dërgoi çështjen për rishqyrtim Gjykatës së Rrethit Tiranë.

18. Më 7 tetor 1996 Gjykata e Rrethit Tiranë e rrëzoi kërkesën e shtetasit K.G. duke mbështetur të drejtat e paditësve mbi pronësinë e vilës në bazë të faktit që të drejtat e tyre mbi pronësinë e vilës kishin fuqinë e *res judicata*: për çështjen ishte vendosur së pari në vendimin e Gjykatës së Lartë të datës 7 korrik 1995, për sa kohë që ai mbështeste vlefshmërinë e urdhrit për dhënien e titullit të pronësisë, dhe së dyti, në vendimin e komisionit të datës 29 gusht 1996 (shihni paragrafët 20-21 më poshtë).

19. Më 2 dhjetor 1996 dhe 5 shkurt 1998 përkatësisht, Gjykata e Apelit Tiranë dhe Gjykata e Lartë e rrëzuan kërkesën e shtetasit K.G., duke lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Tiranë.

B. Grupi i dytë i procedurave në lidhje me kthimin e pronës

20. Në një datë të paspecifikuar, ndërkohë që procedurat për vlefshmërinë e urdhrit për dhënien e titullit të pronësisë ishin në shqyrtim e sipër nga Gjykata e Apelit Tiranë, paditësit depozituan një kërkesëpadi pranë Komisionit ku kërkonin të drejtat e pronësisë mbi pjesën e konfiskuar të vilës.

21. Më 29 gusht 1996 Komisioni ia dha paditësve pjesën e konfiskuar të vilës.

1. Grupi i dytë i procedurave gjyqësore në lidhje me vendimin e Komisionit

22. Në një datë të paspecifikuar, shtetasi K.G. depozitoi një padi civile në Gjykatën e Rrethit Tiranë ku kërkonte deklarimin e pavlefshmërisë së vendimit të Komisionit të datës 29 gusht 1996. Sipas parashtrimeve të shtetasit K.G., pjesa e tij e vilës ishte konfiskuar nga shteti për shkak se i ati i paditësve nuk kishte shlyer hipotekën në vitin 1947.

23. Më 19 maj 1997 Gjykata e Rrethit Tiranë e deklaroi të pavlefshëm vendimin e Komisionit të datës 29 gusht 1996 në bazë të faktit që shtetasi K.G. e kishte blerë pronën në mirëbesim. Gjykata çmoi që konfiskimi i pronës së të atit të paditësve kishte ardhur si pasojë e mosshlyerjes së hipotekës nga ana e këtij të fundit dhe që nuk ishte ekzekutuar në bazë të vendimit të dhënë nga Gjykata Penale Ushtarake.

24. Në datat 1 gusht 1997 dhe 16 janar 1998, përkatësisht Gjykata e Apelit Tiranë dhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë e rrëzuan apelin e paditësve si të pabazuar.

2. Procedurat e Gjykatës Kushtetuese

25. Paditësit apeluan në Gjykatën Kushtetuese në bazë të nenit 131 § f të Kushtetutës, duke argumentuar që vendimet e gjykatave të mësipërme ishin jokushtetuese në bazë të privimit nga të drejtat për *rem judicatum*.

26. Në këtë kontekst, paditësit pretendonin që çështja e titullit të pronësisë mbi vilën ishte vendosur në favor të tyre me anë të vendimit të Bashkisë së Tiranës të datës 8 tetor 1992, i cili kishte marrë formë të prerë dhe kishte hyrë në fuqi së pari për shkak të vendimit të Gjykatës së Lartë të datës 7 korrik 1995 gjatë procedurave të saj të zakonshme, dhe pastaj, si rezultat i vendimit të po asaj Gjykate të datës 5 shkurt 1998 gjatë procedurave të rishikimit mbikëqyrës.

27. Më 29 tetor 1998, Gjykata Kushtetuese anuloi vendimet e gjykatave në lidhje me vlefshmërinë e vendimit të Komisionit të datës 29 gusht 1996 si jokushtetuese. Gjykata u shpreh si më poshtë:

“Procedurat ishin të padrejta në dy drejtime:

Së pari, Komisioni ka shkelur rregullat e juridiksionit të përcaktuara në nenin 36 të Kodit të Procedurës Civile. Sipas kësaj dispozite, Komisioni, si një institucion jogjyqësor, nuk kishte kompetenca për të marrë në shqyrtim këtë mosmarrëveshje civile dhe për të dhënë një vendim, për sa kohë që çështja ishte në gjykim e sipër nga gjykatat.

Së dyti, ... Komisioni nuk ishte i autorizuar për të shqyrtuar këtë çështje, ashtu siç ka qenë vendosur disa vite më parë nga Njësia financiare e Bashkisë së Tiranës. Në vitin 1992, Njësia financiare, me anë të një vendimi, i ka dhënë këtë pjesë të shtëpisë të trashëgimtarëve të ... [pra, ankuesve].

...

Në këto rrethana, gjykata e konsideron vendimin e Komisionit të 1996 si të pavlefshëm. Si i tillë, ai nuk mund të prodhojë efekte juridike, qoftë edhe pse njësia financiare e Bashkisë së Tiranës kishte trajtuar si më parë çështje dhe kishte arriti njëtin përfundim.

Duke vendosur në favor të K.G., Gjykata e Rrethi dhe Gjykata e Apelit i kanë mohuar ankuesve të drejtat e tyre pronësore dhe kanë drejtuar një gjykim të padrejtë.

Shkelja e kësaj të drejte kushtetuese, e cila ka ndodhur në tre instanca, përbën një shkelje të parimit procedural thelbësor, sipas të cilit vendimet përfundimtare gjyqësore janë të detyrueshme për gjykatën dhe palët në gjykim që nuk mund të rishikohen, përderisa të mos jenë prishur nga një gjykatë më e lartë, ose mbi bazën e kërkesave të tjera për rishikim ose të jenë kundërshtuar gjyqësisht nga palët e treta.

... gjykatat që shqyrtuan këtë padi të palës së interesuar nuk ishin të ndërgjegjshme për faktin që pretendimet në fjalë kanë qenë edhe objekt i një tjetër padie kundër ankuesit. Gjykata e Rrethit ka rrëzuar padinë tjetër si të pathemeltë dhe vendimi i saj u confirmua nga Gjykata e Apelit në dhjetor të 1996, duke u bërë kështu përfundimtar.

Pavarësisht faktit që gjykata nuk merr parasysh se vendimi në fjalë ka marrë fuqinë *res judicata* (gjësë së gjykuar), bazuar nën dritën e dallimeve të elementet përbërëse të padive, objekt i tyre për nga kuptimi material ishte megjithatë i njëjtë, pra që kundërshtimi sfidues i të drejtave pronësore të ankuesve nga paditësi ...

... gjykata nuk kishte tagrat për të shqyrtuar meritat (themelin) e çështjes dhe të arrinte në një tjetër përfundim nga ai i gjykatës të parë, pasi në rastin konkret ajo nuk po shqyrtonte ndonjë kërkesë të veçantë për rishikim gjyqësor."

3. *Seria e dytë e procedurave gjyqësore lidhur me vendimin e Komisionit*

28. Në një datë të papërcaktuar K.G. ngriti një padi civile në Gjykatën e Rrethit të Tiranës, ku kërkonte që të prishte vendimin e Komisionit të 29 gushtit 1996 në përputhje me Vendimin e Gjykatës Kushtetuese të datës 29 tetor 1998.

29. Më 4 qershor 1999, Gjykata e Rrethit të Tiranës deklaroi vendimin e Komisionit të 29 gushtit 1996 të pavlefshëm.

30. Më 10 shkurt 2000 dhe 24 korrik 2000, respektivisht Gjykata e Apelit Tiranë dhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë hodhi poshtë ankesat e ankuesve si të pabazuara.

4. *Shqyrtimi i dytë në interes të ligjit*

31. Në një datë të papërcaktuar K.G. ka paraqitur një ankim në Gjykatën e Lartë për rishikim në interes të ligjit kundër vendimit të Gjykatës së Rrethit të Tiranës të datës 7 tetor 1996, të vendimit të Gjykatës së Apelit të Tiranës të datës 2 dhjetor 1996, dhe vendimit të Gjykatës së Lartë të 5 shkurtit 1998, pasi ishin në shkelje të ligjit material.

32. Më 12 maj 2000 Gjykata e Lartë (me Kolegje të Bashkuara), vendosi në zbatim të procedurës për rishikim në interes të ligjit të prishë vendimet e sipërpërmendura dhe, duke vendosur mbi meritat (në themel), ka deklaruar si të pavlefshëm urdhrin e datës 8 tetor 1992 që i jepte titullin e pronësisë.

33. Ankuesit kanë paraqitur një kërkesë para Gjykatës Kushtetuese në bazë të Nenit 131 § f të Kushtetutës.

34. Më 3 korrik të vitit 2002 Gjykata Kushtetuese *de plano* vendosi për të deklaruar kërkesën e ankuesve si të papranueshëm pasi ishte "jashtë juridiksionit të saj".

II. LEGJISLACIONI PËRKATËS DHE PRAKTIKA VENDASE

A. Ligji relevant vendas

35. Kushtetuta e Shqipërisë parashikon:

Neni 42 § 2

" Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj..

Neni 131

" Gjykata Kushtetuese vendos për:

...

(f) f) gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave. "

36. Sipas Kodit të Procedurës Civile të vitit 1996, i cili ishte në fuqi në atë kohë, vendimet bëheshin përfundimtare në rrethanat e mëposhtme:

Neni 451

Vendimi i gjykatës merr formë të prerë kur nuk mund të bëhet ankim kundër tij, nuk është bërë ankim kundër tij brenda afateve të caktuara nga ligji ose kur ankesa është tërhequr; ankesa e paraqitur nuk është pranuar; vendimi i gjykatës është lënë në fuqi, ndryshuar ose është pushuar gjykimi në shkallë të dytë, vendimi bëhet ligjërisht detyrues kur gjykata më e lartë jep vendimin e saj ... "

37. Sipas dispozitave në fuqi në atë kohë, rekursi në interes të ligjit ishte një mjet ligjor ankimimi i jashtëzakonshëm që i mundësonte gjykatat të rihapnin procedimet pas një vendimi përfundimtar (Rekurs në interes të ligjit). Midis vitit 1996 dhe shfuqizimit të tij në vitin 2001 me Ligjin nr. 8812 të datës 17 maj 2001, rekursi në interes të ligjit ka qenë subjekt i disa ndryshime legjislative.

Neni 473 - Rekursi në interes të ligjit

Kundër vendimeve të formës së prerë, vendimeve të mospranimit të rekursit si dhe vendimeve të kolegjeve të Gjykatës së Lartë, palët kanë të drejtë që për shkaqet e parashikuara në shkronjat "a", "b" dhe "c" të nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile, të bëjnë recurs në kolegjet e bashkuara, brenda 3 viteve nga marrja formë të prerë e vendimit.

Rekursi shqyrtohet në dhomën e këshillimit nga një kolegji seleksionues i përbërë nga pesë gjyqtarë të caktuar me short. Në kolegjin seleksionues nuk mund të jenë gjyqtarët që kanë gjykuar çështjen. Kolegji cakton me short nga gjiri i tij relatorin.

Vendimi për kalimin e rekursit në gjykim merret me shumicë votash. Relatori i çështjes në kolegjet e bashkuara caktohet me short nga gjyqtarët që nuk kanë marrë pjesë në gjykimin e çështjes, ashtu dhe në kolegjin seleksionues. Gjykimi në kolegje të bashkuara për të njëjtën çështje mund të bëhet vetëm një herë.

38. Nenet përkatëse të Ligjit për Pronë (Kthimin dhe Kompensimit) janë përshkruar në çështjet *Beshiri dhe të tjerë k. Shqipërisë* (nr. 7352/03, § § 21-29, 22 gusht 2006), *Driza kundër Shqipërisë* (nr. 33771/02 , § § 36-43, ECHR 2007 ... (ekstrakte) dhe *Ramadhi dhe të tjerë k. Shqipërisë* (nr. 38222/02, § § 23-30, 13 nëntor 2007).

39. Neni 5 (d) i Ligjit “Për... Rehabilitimin e ish të Dënuarve dhe të Përndjekurve Politike” (Ligji nr. 7514 të datës 30 shtator 1991) u njihte të drejtën viktimave të shtypjes së diktaturës që t’i kërkonin kthimin e pronave të tyre që kishin qenë të konfiskuara apo të shtetëzuara.

E DREJTA

I. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS

40. Ankuesit u ankuan sipas nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje me shkeljen e parimit të sigurisë ligjore, për atë që vendimi përfundimtar në favor të tyre ishte prishur sipas procedurës për rekursin në interes të ligjit. Ata gjithashtu u ankuan në lidhje me kohëzgjatjen e procedurës, e cila kishte zgjatur rreth tetë vjet, dhe çështja kishte qenë shqyrtuar në gjashtëmbëdhjetë instanca nga gjykatat.

Pjesët përkatëse të nenit 6 § 1 të Konventës sigurojnë:

“Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ..., çdokush ka të drejtë ... të një gjykimi brenda një afati të arsyeshëm ... nga [një] ... Gjykatë ...

A. PRANUESHMËRIA

41. Qeveria argumentoi që vendimi i Gjykatës Kushtetuese i datës 3 korrik 2002, ku apeli i paditësve deklarohet si i papranueshëm duke qenë se ishte “jashtë juridiksionit të saj” nuk mund të konsiderohet si një mjet ligjor i efektshëm dhe shterues. Prandaj, mjeti ligjor përfundimtar i efektshëm brenda kuptimit të nenit 35 të Konventës ishte vendimi i Gjykatës së Lartë i datës 24 korrik 2000. Qeveria parashtrroi që kërkesëpadia duhet të deklarohet e papranueshme dhe jashtë afateve kohore, duke qenë se ishte depozituar në datën 21 dhjetor 2002.

42. Paditësit parashtruan në përgjigjen e tyre që ata kishin bërë dy herë rekurs në Gjykatën Kushtetuese, në vitin 1998 dhe 2002. Kërkesëpadia e tyre ishte deklaruar e pranueshme dhe një vendim ishte dhënë në favor të tyre nga Gjykata Kushtetuese në vitin 1998 në drejtim të tri grupeve të para të procedurave. Sidoqoftë, kërkesëpadia e tyre kushtetuese e vitit 2002 ishte konsideruar si e papranueshme nga Gjykata Kushtetuese po atë vit, ndonëse ankesat e tyre përmbanin argumente në lidhje me pikat e ligjit dhe procedurat në fjalë që kishin vënë në pikëpyetje fuqinë e vendimit të Gjykatës Kushtetuese të vitit 1998. Paditësit pretendonin që vendimi i papranueshmërisë i Gjykatës Kushtetuese i vitit 2002 duhet të konsiderohet si vendimi i formës së prerë i gjykatave vendase.

43. Gjykata i përsërit konstatimet e saj në çështjen “Balliu kundër Shqipërisë”, nr.74727/01, datë 30 shtator 2004, më pas të konfirmuara në vendimin e çështjes “Beshiri dhe të tjerët kundër Shqipërisë” (nr.7352/03, § 32, datë 22 gusht 1996), ku ajo mendon se ankesat e paraqitura në Gjykatën Kushtetuese të Shqipërisë duhet të konsiderohen një mjet ligjor i efektshëm, i cili duhet të përdoret për qëllimet e nenit 35 të Konventës ku trajtohen çështjet e gjykimit të drejtë. Ajo mendon që nuk ka asnjë arsye që të mos e marrë parasysh konstatimin e mësipërm edhe në rrethanat e çështjes në fjalë.

44. Në fakt paditësit e shfrytëzuan këtë mjet ligjor. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese mban datën 3 korrik 2002 dhe paditësit e depozituan kërkesëpadinë e tyre në këtë Gjykatë më 21 dhjetor 2002. Për pasojë, ata e respektuan afatin gjashtëmujor të parashikuar në nenin 35 në drejtim të çështjeve të gjykimit të drejtë.

45. Gjykata vëren që kërkesëpadia nuk është haptazi e pabazuar brenda kuptimit të nenit 35 § 3 të Konventës. Ajo shton më tej që kërkesëpadia nuk është e papranueshme në bazë të ligjeve të tjera. Prandaj, ajo duhet të deklarohet e pranueshme.

B. SHQYRTIMI NË THEMEL

1. Siguria ligjore: anulimi i një vendimi të formës së prerë:

a) Parashtrimet e palëve

46. Paditësit kundërshtuan faktin që një vendim gjykatë i formës së prerë është anuluar në procedurat e rishikimit mbikëqyrës në vitin 2000. Ata e konsiderojnë këtë fakt shkelje të parimit të sigurisë ligjore.

47. Qeveria argumentoi që procedura e rishikimit mbikëqyrës ishte garantuar nga ligji në kohë fizike dhe konsiderohet si një masë e nevojshme në procesin e dhënies së drejtësisë gjatë periudhës së tranzicionit në të cilën po kalonte vendi. Me qëllim garantimin e një gjykimi të drejtë, kërkesa për rishikim mbikëqyrës u mor në shqyrtim nga një trup gjykues përzgjedhës, i cili nuk

përfshiu asnjërin nga gjyqtarët që kishin shqyrtuar çështjen në një prej trupave gjykues të Gjykatës së Lartë.

48. Sipas mendimit të Qeverisë, të dy grupet e procedurave ishin kryer në kundërshtim me dy vendimet administrative që njihnin të drejtën e pronësisë të paditësve. Seria e parë e procedurave kishte të bënte me pavlefshmërinë e vendimit të vitit 1992 nga njësia financiare e Bashkisë së Tiranës, e cila i kishte njohur paditësve të drejtën e pronësisë. Seria e dytë e procedurave kishte të bënte me pavlefshmërinë e vendimit të vitit 1996 të Komisionit, i cili gjithashtu ia kishte njohur paditësve të drejtën e pronësisë.

49. Ekzistenca e dy vendimeve kontradiktore-vendimi i Gjykatës së Lartë i datës 5 shkurt 1998 dhe vendimi i Gjykatës së Lartë i datës 16 janar 1998 bëri të nevojshme kryerjen e një rishikimi nga një organ më i lartë vendimmarrës me qëllim zgjidhjen e çështjes. Kjo çoi në miratimin e vendimit nga Gjykata e Lartë (Kolegji i Bashkuar) më 12 maj 2000 nëpërmjet rekursit në interes të ligjit.

50. Së fundmi, Qeveria mendon që e drejta për rishikim mbikëqyrës ishte zbatuar për pesë vjet, ndërmjet periudhës 1996-2001, kur ajo ishte shfuqizuar me ligj.

b) Parashtrimet e palës së tretë

51. Pala e tretë që ndërhyri, trashëgimtari i K.G.-së (shihni paragrafin 5 më sipër), argumentoi që nuk ka pasur asnjë shkelje të parimit të sigurisë ligjore. Si pasojë, nuk ka pasur asnjë shkelje të së drejtës për një gjykim të drejtë në bazë të nenit 6 § 1 të Konventës.

c) Vlerësimi i gjykatës

52. E drejta për një gjykim të drejtë nga një gjykatë siç garantohet nga neni 6 § 1 të Konventës duhet interpretuar në bazë të hyrjes së Konventës, në pjesën përkatëse të së cilës deklarohet që shteti ligjor është pjesë e trashëgimisë së përbashkët të shteteve kontraktuese. Një nga aspektet themelore të shtetit ligjor është edhe parimi i sigurisë ligjore, i cili, ndërmjet të tjerave kërkon që atje ku gjykatat janë shprehur përfundimisht në lidhje me një çështje të caktuar, vendimi i tyre nuk duhet të diskutohet apo të vihet në pikëpyetje (shihni “Brumarescu kundër Rumanisë” [GC], nr. 28342/95, § 61, ECHR 1999-VII; “Ryabyhk kundër Rusisë”, nr. 52854/99, §§ 51-56, ECHR 2003-IX; dhe “Rosca kundër Moldavisë”, nr. 6267/02, § 24, 22 mars 2005).

53. Siguria ligjore presupozon respektin ndaj parimit të *res judicata* (shihni Brumarescu, të cituar më sipër, § 62), domethënë, parimin e marrjes së formës së prerë të vendimeve gjyqësore. Ky parim insiston që asnjë palë nuk ka të drejtë të kërkojë rishikimin e një vendimi detyrues të formës së prerë vetëm për të përfituar një ridëgjim në seancë gjyqësore dhe një rishqyrtim dhe rigjykim të çështjes. Kompetencat për rishikim të gjykatave më të larta duhen ushtruar për korrigjimin e gabimeve gjyqësore dhe dështimeve në dhënien e drejtësisë, por jo për të kryer një gjykim të ri të çështjes. Rishikimi nuk duhet trajtuar si një apel i fshehur dhe thjesht mundësia e ekzistencës së dy pikëpamjeve të ndryshme në lidhje me objektin e gjykimit nuk përbën një bazë për rishqyrtim. Anashkalimi i këtij parimi justifikohet vetëm kur kjo bëhet e nevojshme nga rrethanat me natyrë të rëndësishme dhe detyruese (shihni Rosca, i cituar më sipër, § 25).

54. Gjykata ka kompetencën të shqyrtojë ngjarjet nga 2 tetori i vitit 1996 dhe në vazhdim, kur hyri në fuqi njohja nga Shqipëria e së drejtës për të bërë kërkesë individuale. Sidoqoftë, ajo mundet të marrë parasysh faktet e ndodhura para ratifikimit, me kusht që ato të mund të konsiderohen se kanë krijuar një situatë që shtrihet përtej asaj date ose që mund të ketë lidhje me të kuptuarit e fakteve që kanë ndodhur pas asaj date (shihni “Broniowski kundër Polonisë” [GC], nr. 31443/96, § 74, ECHR 2002-X). Duke u kthyer te çështja në fjalë, më 7 korrik 1995, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë njohu të drejtën e pronësisë të paditësve. Procedurat e rishikimit mbikëqyrës u iniciuan me kërkesën e Kryetarit të Gjykatës së Lartë më 22 maj 1996. Çështja u dërgua për rigjykim dhe procedurat u përmbyllën me një vendim të formës së prerë të Gjykatës së Lartë më 5 shkurt 1998 që njihte të drejtën e pronësisë të paditësve. Gjykata çmon që vendimi i datës 5 shkurt 1998 është vendimi i formës së prerë për qëllimet e pajtueshmërisë së tij *ratione temporis*, pas hyrjes në fuqi të Konventës për Shqipërinë më 2 tetor 1996.

55. Pavarësisht nga grupi i mësipërm i procedurave, në një seri paralele procedurash, të cilat kundërshtojnë vendimin e vitit 1996 të Komisionit që njihte të drejtën e pronësisë të paditësve,

Gjykata Kushtetuese më 29 tetor 1998 e njohu vendimin e Gjykatës së Lartë të datës 5 shkurt 1998 si *res judicata* dhe e shpalli jokushtetues vendimin e Gjykatës së Lartë të datës 16 janar 1998.

56. Gjykata nuk pajtohet me argumentin e Qeverisë që mjeti ligjor i rekursit ne interes te ligjit ishte i nevojshëm gjatë periudhës së tranzicionit dhe që mospërputhja ndërmjet dy vendimeve të gjykatës të formës së prerë mund të korrigjohet me anë të një vendimi tjetër të rishikimit mbikëqyrës.

57. Së pari, ajo kujton që vendimi i Gjykatës së Lartë i datës 16 janar 1998 është deklaruar jokushtetues nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese i datës 29 tetor 1998. Si i tillë, vendimi i Gjykatës së Lartë nuk kishte asnjë fuqi ligjore dhe nuk mund të kundërshtonte ndonjë vendim tjetër. Gjykata nuk e kupton se si procedurat e rekursit ne interes te ligjit të vitit 2000 mund të kishin korrigjuar ekzistencën e dy vendimeve kontradiktore në një kohë kur asnjë mospërputhje nuk ekzistonte sipas pikëpamjes së vendimit të vitit 2008 të Gjykatës Kushtetuese. Fakti që një palë e tretë kishte një pikëpamje tjetër në lidhje me vendimet e gjykatës nuk mund të shërbente si arsye për rishqyrtimin e çështjes.

58. Së dyti, Gjykata thekson që sipas nenit 1, përgjegjësinë kryesore për zbatimin dhe kontrollin e zbatueshmërisë së të drejtave dhe lirive të garantuara e kanë autoritetet kombëtare (shihni “Kudla kundër Polonisë” [GC], nr. 30210/96, § 152, ECHR 2000-XI). Në këtë kontekst, është përgjegjësi e shtetit të bëjë organizimin e sistemit ligjor në mënyrë të tillë që të shmanget miratimi i vendimeve gjyqësore të papajtueshme në procedura paralele dhe të mbështesë parimin e sigurisë ligjore të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, çka u dëmtua nga përdorimi i procedurës së rishikimit mbikëqyrës në rastin konkret (shihni, në lidhje me anulimin e një vendimi të formës së prerë, “Driza kundër Shqipërisë”, nr.33771/02, § 69, ECHR 2007-...(fragmente të shkëputura).

59. Gjykata çmon që, duke përdorur procedurën e rekursit ne interes te ligjit për të anuluar vendimin e formës së prerë të miratuar më 5 shkurt 1998, Gjykata e Lartë e bëri të pavlefshëm një proces të tërë gjyqësor që ishte përmbyllur me një vendim gjyqësor të detyrueshëm të formës së prerë, i cili kishte në këtë mënyrë fuqinë e *res judicata*. Prandaj, në bazë të rrethanave të mësipërme, Gjykata nuk gjen ndonjë arsye për të anashkaluar konstatimet e saj në praktikën gjyqësore të parashikuar në lidhje me këtë çështje (shihni paragrafët 52-53 më sipër).

60. Prandaj ka pasur një shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës në drejtim të anulimit të vendimit të formës së prerë të datës 5 shkurt 1998 në favor të paditësve, në atë që autoritetet vendase kanë shkelur parimin e sigurisë ligjore dhe të drejtën e paditësve “për t’iu drejtuar gjykatës” në bazë të nenit 6 § 1 të Konventës.

2. Kohëzgjatja e procedurave:

a) Parashtrimet e palëve

61. Paditësit argumentuan që të tri grupet e procedurave ishin kryer gjatë tetë viteve në lidhje me të njëjtën pronë, pothuajse mbi baza ligjore identike dhe me përfshirjen e së njëjtave palë.

62. Qeveria argumentoi që ishin kryer dy grupe procedurash të veçanta, me një shtrirje kohore prej pesë vitesh. Autoritetet gjyqësore nuk kanë vërejtur asnjë vonesë të pajustificuar në asnjërin prej shkallëve të juridiksionit. Sipas mendimit të Qeverisë, fakti që të dy grupet e procedurave janë zhvilluar në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri, nuk përbënte arsye për ndonjë ankesë në lidhje me kohëzgjatjen e procedurave, meqë ato janë përmbyllur që të dyja në të njëjtën kohë. Qeveria argumentoi që pavarësisht nga rezultati i vendimeve gjyqësore vendase, paditësit asnjëherë nuk e kanë poseduar në të vërtetë pronën e tyre. Për këtë arsye, kohëzgjatja e procedurave nuk mund të konsiderohet si një faktor thelbësor dhe vendimtar për paditësit.

b) Vlerësimi i Gjykatës

63. Gjykata vëren që titulli i pronësisë së paditësve u njoh nga vendimi i Gjykatës së Lartë i datës 5 shkurt 1998, i cili ka fituar fuqinë e *res judicata*. Gëzimi i asaj të drejte u pengua nga zhvillimi i procedurave paralele dhe procedurave të rekursit ne interes te ligjit.

64. Për shkak të procedurave të rekursit ne interes te ligjit, gjykata çmon që asaj nuk i duhet të marrë një vendim veçmas në lidhje me shqyrtimin në themel të ankesës për kohëzgjatjen e procedurave. Në këto rrethana, është më me vend që çështja të trajtohet në kontekstin e nenit 41.

II. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 1 TË PROTOKOLLIT NR 1 TË KONVENTËS

65. Padiësit pretenduan që ata kanë qenë viktime të shkeljes së nenit 1 të protokollit nr.1 të Konventës për shkak të anulimit të vendimit të formës së prerë që ishte dhënë në favor të tyre.

Në nenin 1 të protokollit nr 1 parashikohet që:

“Çdo person fizik apo juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pronës së tij. Asnjë person nuk do të privohet nga prona e tij me përjashtimin e interesave të publikut dhe kur u nënshtrohet kushteve të parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Dispozitat pararendëse, sidoqoftë, nuk do të cenon në asnjë mënyrë të drejtën e një shteti për të zbatuar këto ligje në mënyrën që e gjykon të nevojshme për të kontrolluar përdorimin e pronës në përputhje me interesin e përgjithshëm apo për të siguruar pagimin e taksave ose të ndonjë kontributi apo detyrimi tjetër”.

A. Pranueshmëria

66. Gjykata vëren që ankesa e referuar në këtë pjesë nuk duket qartësisht e pabazuar brenda kuptimit të nenit 35 § 3 të Konventës. Ajo vëren më tej që ankesa në fjalë nuk është e papranueshme për asnjë lloj arsyeje tjetër. Prandaj, ajo duhet të deklarohet e pranueshme.

B. Shqyrtimi në themel

1. Parashtrimet e palëve

67. Padiësit argumentuan që vendimi i vitit 2000 të Gjykatës së Lartë i dhënë nëpërmjet rekursit në interes të ligjit, i ka privuar ata nga e drejta e pronësisë.

68. Qeveria argumentoi që vendimi i vitit 2000 i rekursit në interes të ligjit të Gjykatës së Lartë nuk e ka shkelur të drejtën e pronësisë të padiësve në bazë të nenit 1 të protokollit nr.1 të Konventës. Vendimi në fjalë ka korrigjuar paligjshmërinë e vendimeve të mëparshme, që kanë rezultuar nga zbatimi i gabuar i ligjit.

69. Sipas mendimit të Qeverisë, parimi i gëzimit paqësor të pronës së gjithsecilit zbatohet për rastet kur pronari e posedonte pronën e tij pa pengesa *de jure* apo *de facto*. Në këtë rast, padiësit kishin marrë një vendim gjykatë në favor të tyre, por një vendim tjetër gjykatë kishte ekzistuar në të njëjtën kohë që e shpallnin vendimin e vitit 1996 të Komisionit të pavlefshëm. Në këto rrethana, duke pasur parasysh faktin që tekstet e dy vendimeve në fjalë ishin kontradiktore, neni 1 i protokollit nr.1 të Konventës nuk u zbatua.

2. Parashtrimet e palës së tretë

70. Pala e tretë që ndërhyri, trashëgimtari i shtetasit K.G. (shihni paragrafin 5 më sipër), kundërshtoi të drejtën e pronësisë të padiësve, duke pretenduar që shtetasi K.G. e kishte pasur pronën në zotërim që në vitin 1959.

3. Vlerësimi i Gjykatës

71. Gjykata përsërit që “posedimi” mund të jetë “posedim ekzistues” apo aset duke përfshirë, në disa situata të përcaktuara qartë edhe pretendimet. Një vendim gjyqësor i formës së prerë, i cili i njeh dikujt titullin e pronësisë mund të konsiderohet si një “pronë” për qëllimet e nenit 1 të protokollit nr.1 të Konventës (shihni Brumarescu, të cituar më lart, § 70).

72. Gjykata vëren që padiësve iu është njohur titulli i pronësisë nga një vendim i formës së prerë i Gjykatës së Lartë më 5 shkurt 1998. Duket se padiësit nuk e morën pronën në posedim meqë ajo ishte e zënë nga pala e tretë. Në vitin 2000, një vendim i dhënë gjatë procedurave të rekursit në interes të ligjit e anuloi titullin e pronësisë të padiësve.

73. Duke pasur parasysh faktin që pasuria ishte regjistruar në Regjistrin Kadastral në emër të padiësve dhe që e drejta e pronësisë të padiësve ishte mbështetur nga vendimi i formës së prerë i Gjykatës së Lartë i datës 5 shkurt 1998 dhe më vonë ishte përmbysur në procedurat e rishikimit mbikëqyrës, Gjykata konstaton që padiësit posedonin një “pronë” sipas kuptimit të nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës.

74. Gjykata vëren që kjo ankesë ka lidhje me atë që shqyrtohet në bazë të nenit 6 § 1 në drejtim të anulimit të një vendimi gjyqësor të formës së prerë (shihni paragrafët 52-60 më lart). Pasi ka konstatuar që autoritetet kanë vepruar në shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës, Gjykata vëren që padiësit kishin pretendime detyruese që rridhnin nga vendimi në fjalë. Si rezultat i procedurave të rekursit në interes të ligjit, anulimi i një vendimi të detyrueshëm, ka cenuar besimin e padiësve të

një vendim gjyqësor detyrues dhe i ka privuar ata nga mundësia për të vënë në zbatim titullin e tyre të pronësisë.

75. Në këto rrethana, Gjykata mendon që anulimi i vendimit të datës 5 shkurt 1998 ishte i papajtueshëm me nenin 1 të Protokollit Nr.1 të Konventës. Prandaj, ka pasur një shkelje të atij neni.

III. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

76. Neni 41 i Konventës parashikon që:

“Nëse Gjykata konstaton që ka pasur një shkelje të Konventës apo protokolleve të saj dhe në rast se ligji i brendshëm i Palës Kontraktuese të Lartë të interesuar lejon vetëm bërjen e korrigjimeve të pjesshme, Gjykata, në qoftë se është e nevojshme, do t’ia japë këtë mundësi palës së dëmtuar”.

A. Dëmi

77. Paditësit kërkuar 1 047 678 euro për dëmin financiar dhe 450 000 euro për dëmin jofinanciar. Për sa i përket kërkesës për dëmin financiar, paditësit paraqitën vlerësimin e pronës së tyre të bërë nga një ekspert, e cila përbëhet nga shtëpia me sipërfaqe 244,12 m² dhe pjesa rrethuese e tokës me sipërfaqe 400 m², vlera e përbashkët e së cilave është 800 000 euro, ndërsa humbja e fitimit për periudhën 1992-2005 është vlerësuar në shumën prej 247 678 eurosh.

78. Qeveria parashtroi që konstatimi i një shkeljeje në drejtim të ankesave të paditësve do të përbënte një kompensim të mjaftueshëm të tyre.

79. Gjykata përsërit që një vendim gjyqësor në të cilin gjendet një shkelje vendos mbi shtetin e paditur detyrimin ligjor në bazë të Konventës për ta ndërprerë shkeljen dhe të bëjë korrigjimet e duhura për pasojat e saj. Nëse ligji kombëtar lejon vetëm bërjen e korrigjimeve të pjesshme, neni 41 i Konventës i jep Gjykatës kompetencën për t’i dhënë dëmshpërblimin palës së dëmtuar nga veprimi apo mosveprimi që ka çuar në konstatimin e shkeljes së asaj Konvente. Gjykata gëzon autoritet të caktuar në ushtrimin e atyre kompetencave, siç dëshmohet nga mbiemri “i drejtë” dhe fraza “në rast se është e nevojshme” (shihni Driza, i cituar më lart, § 130).

80. Ndërmjet çështjeve që gjykata merr në shqyrtim gjatë përlllogaritjes së dëmshpërblimit janë dëmi financiar (humbja e shkaktuar si rezultat i drejtpërdrejtë i shkeljeve të pretenduara) dhe dëmi jofinanciar (kompensimi për ankthin, bezdinë, shqetësimin dhe pasigurinë e shkaktuar nga kjo shkelje), si edhe humbje të tjera jofinanciare (shihni, ndërmjet autoriteteve të tjera “Ernestina Zullo kundër Italisë”, nr. 64897/01 § 25, 10 nëntor 2004).

81. Gjithashtu, në rast se një apo më shumë nga zërat e elementeve të dëmit nuk mund të përlllogariten me saktësi apo përcaktimi i ndryshimit ndërmjet dëmit financiar dhe atij jofinanciar është i vështirë, Gjykata mund të vendosë kryerjen e një vlerësimi tërësor (shihni “Comingersoll S.A. kundër Portugalisë” [GC], nr. 35382/97, § 29, ECHR 2000-IV).

82. Gjykata kujton që në rastin konkret ajo ka konstatuar një shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës dhe të nenit 1 të protokollit nr.1 për shkak të anulimit të një vendimi gjyqësor të formës së prerë, i cili i njihte paditësve të drejtën e pronësisë. Prandaj ekziston një lidhje shkakore ndërmjet shkeljeve të konstatuara dhe kërkesës së paditësve për zhdëmtim financiar.

83. Gjykata mendon që vetë natyra e vendimeve gjyqësore të formës së prerë në favor të paditësve dhe fakti që prona ende është e zënë nga një palë e tretë që e ka blerë atë në mirëbesim do të thotë që *restitutio in integrum* është i pamundur. Rrjedhimisht, zhdëmtimi duhet të jepet *in lieu*.

84. Gjykata e sheh të arsyeshme të kompensojë paditësit për dëmin financiar në lidhje me gjysmën e pronës së tyre dhe për humbjen e fitimeve duke i dhënë një shumë totale. Gjykata nuk mund të pranojë shumat e paraqitura nga paditësit, dhe në veçanti, e konsideron si spekulative orvajtjen për të përlllogaritur se sa mund të ketë qenë humbja e fitimeve të paditësve.

85. Duke pasur parasysh dokumentacionin që ka në dispozicion dhe duke bërë vlerësimin mbi një bazë të drejtë dhe të paanshme, gjykata u jep paditësve një shumë totale prej 450 000 eurosh në lidhje me dëmin financiar dhe atë jofinanciar të shkaktuar ndaj pronës së tyre.

B. Kostot dhe shpenzimet

86. Paditësit kërkuar një shumë totale prej 20 000 eurosh për shpenzimet gjyqësore të procedurave të zhvilluara në Shqipëri dhe atyre të zhvilluara në Strasburg. Ata nuk paraqitën një pasqyrë të detajuar të shpenzimeve të ndara sipas zërave për të mbështetur pretendimin e tyre për kostot dhe shpenzimet.

87. Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës, paditësit kanë të drejtë për të marrë rimbursim të kostove dhe shpenzimeve të tyre vetëm në rast se është treguar që ato në të vërtetë dhe domosdoshmërisht janë paguar prej tyre dhe janë të arsyeshme për sa i përket vlerës së tyre. Për këtë qëllim, rregulli 60 §§ 2 dhe 3 i rregullores së Gjykatës përcakton që paditësit duhet t'u bashkëngjisin pretendimeve të tyre për përmbushje të drejtë "çdo dokument mbështetës përkatës" dhe në rast se kjo nuk ndodh, Gjykata "mund ta rrëzojë kërkesën tërësisht apo pjesërisht". Në rastin konkret, duke vërejtur që paditësit nuk kanë paraqitur asnjë dokument, të tilla si fatura të specifikuar për të mbështetur pretendimin e tyre, Gjykata nuk mund të japë asnjë shumë për këtë kërkesë.

C. Interesi i mospërmbushjes së detyrimit

88. Gjykata e çmon të përshtatshme që interesi i mospërmbushjes së detyrimit të mbështetet në normën marxhinale të huadhënies të Bankës Qendrore Europiane, së cilës do t'i shtohen tri pikë për qind.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, NJËZËRI:

1. E deklaron kërkesëpadinë të pranueshme.
 2. Gjykon që ka pasur një shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës për sa i përket anulimit të vendimit të Gjykatës së Lartë të datës 5 shkurt 1998.
 3. Gjykon që në bazë të nenit 6 § 1 të Konventës nuk del asnjë çështje e veçantë në lidhje me kohëzgjatjen e procedurave.
 4. Gjykon që ka pasur një shkelje të nenit 1 të protokollit nr.1 të Konventës.
 5. Gjykon:
 - a) që shteti i paditur t'i paguajë paditësve, brenda tri muajve nga data në të cilën vendimi merr formë të prerë në përputhje me nenin 44 § 2 të Konventës, shumën e mëposhtme, që do të konvertohet në valutën kombëtare të shtetit të paditur në normën e zbatueshme në datën e shlyerjes së detyrimit;
450 000 euro (katërqind e pesëdhjetë mijë euro) plus taksat e nevojshme, në lidhje me dëmin financiar dhe atë jofinanciar;
 - b) që nga skadimi i periudhës tremujore të përmendur më sipër deri në datën e shlyerjes së detyrimit, do të paguhet interes i thjeshtë mbi shumën e lartpërmendur me një normë të barabartë me normën marxhinale të huadhënies së Bankës Qendrore Europiane gjatë periudhës së mospërmbushjes së detyrimit plus tri pikë për qind.
 6. E rrëzon pjesën e mbetur të kërkesave të paditësve për kompensim të drejtë.
- Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 24 mars 2009, sipas rregullit 77 §§ 2 dhe 3 të rregullores së Gjykatës.

Fatos Araci
Zëvendës-sekretar

Nicolas Bratza
Kryetar

VENDIM
(THEMELI)
(Ankimi nr. 35720/04 dhe 42832/06)
ÇËSHTJA “VRIONI E TË TJERË KUNDËR SHQIPËRISË DHE ITALISË”

STRASBURG
29 shtator 2009

Ky vendim bëhet i formës së prerë në rrethanat e parashikuara në Nenin 44 § 2 të Konventës. Ai mund të jetë objekt rishikimi redaktorial.

Në këtë çështje ankuesit pretendojnë se ka patur shumë shkelje të Nenit 6 § 1 të Konventës, kryesisht përsa i përket tejzgjatjes së proceseve të brendshme dhe moszbatimit të vendimit të Gjykatës së Lartë të datës 15 qershor 2004 që urdhëronte pagimin e kompensimit për ta në lidhje me tokën e njohur nga komisioni Kthimit dhe kompensimit te pronave. Gjykata Evropiane ka vlerësuar se e drejta për akses në gjykatë, e garantuar nga Neni 6 § 1 i Konventës, do të ishte iluzionare, nëse sistemi i brendshëm ligjor i Shtetit Kontraktues lejon që një vendim gjyqësor detyruar i formës së prerë të mbetet i pazbatuar në dëm të njërës prej palëve. Si rezultat ekzekutimi i një vendimi të dhënë nga çdo gjykatë, duhet të konsiderohet si një pjesë përbërëse e “procesit”, për qëllimet e Nenit 6 të Konventës. Gjykata është e mendimit se paaftësia e autoriteteve për të zbatuar vendimin e gjykatës të datës 15 qershor 2004 për një kohë të tillë të gjatë çon në ndërhyrjen në të drejtën e ankuesve për gëzim të qetë të pronave të tyre, brenda kuptimit të Nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës.

Në çështjen Vrioni dhe të Tjerë k. Shqipërisë dhe Italisë,
Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Katërt), me trup gjykues të përbërë prej:

Nicolas Bratza *President*,
Lech Garlicki
Giovanni Bonello
Ljiljana Mijović
David Thór Björgvinsson
Ledi Bianku
Mihai Poalelungi *gjyqtarë*
dhe Laërence Early, *Sekretar i Seksionit*,
Pas shqyrtimit me dyer të mbyllur më 8 shtator 2009,
Merr në këtë datë vendimin e mëposhtëm:

PROCEDURA

196. Çështja e ka origjinën në dy aplikime kundër Republikës së Shqipërisë dhe të Italisë, të depozituara në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore (Konventa), si më poshtë vijon: aplikimi nr.35720/04, Vrioni, i datës 8 prill 1999; aplikimi nr.42832/06, Vrioni dhe të tjerë, i datës 15 gusht 2006.

197. Ankuesit u përfaqësuan nga znj. Ms L. Sula dhe nga znj. E. Qirjako, avokatë që ushtrojnë profesionin në Tiranë. Qeveria shqiptare (Qeveria) u përfaqësua nga agjentja e saj në atë kohë, znj. S. Meneri.

198. Ankuesit pretendonin cenim të nenit 6 § 1 të Konventës, nenit 1 të protokollit nr.1 të konventës dhe nenit 13 i marrë në lidhje me nenin 1 të protokollit nr.1.

199. Më 9 shkurt 2006 dhe më 8 janar 2007, presidenti i seksionit të katërt të Gjykatës vendosi të njoftonte Qeverinë e Shqipërisë për aplikimin nr.35720/04 dhe aplikimin nr.42832/06. Sipas dispozitës së nenit 29 § 3 të Konventës, u vendos që themeli i çështjeve të shqyrtohej në të

një tën kohë me pranueshmërinë e tyre.

200. Ankuesit dhe Qeveria dërguan secili vëzhgimet e tyre të mëtejshme me shkrim (rregulli 59 § 1).

FAKTET

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

201. Z. Shahin Vrioni, ankuesi, në aplikimin nr.35720/04, është nënshtetas shqiptar, i lindur në vitin 1925 dhe jeton në Shqipëri. Z.Gherardo La Francesca, z. Dario La Francesca dhe z. Oliver Vrioni, ankuesit, në aplikimin nr.42832/06, janë nënshtetas shqiptarë dhe italianë, të lindur përkatësisht në vitin 1946, 1950 dhe 1974, të cilët jetojnë në Itali. Z. Shahin Vrioni përfaqësoi veten dhe ankuesit e tjetër në proceset e gjykatave të brendshme.

A. Sfondi i çështjes

202. Në vitin 1950 autoritetet shqiptare konfiskuan pa kompensim një sipërfaqe toke prej 1 637 metrash katrorë që i përkiste paraardhësit të ankuesve.

203. Më 1 korrik 1991 ambasada italiane në Shqipëri bleu dy ndërtesa në Tiranë, në kufi të pronës që i ishte konfiskuar gjyshit të ankuesit. Transaksioni u krye nëpërmjet një marrëveshjeje ndërshtetërore, që u bë e vlefshme nëpërmjet shkëmbimeve të notave verbale ndërmjet të dyja qeverive. Nota verbale nuk përmbante asnjë informacion në lidhje me transferimin e titullit për sipërfaqet rrethuese ose fqinje të tokës. Titujt përkatës të pronësisë nuk ishin hedhur në regjistrin e pronave të Tiranës.

204. Si rrjedhojë, qeveria shqiptare përdori të ardhurat nga transaksioni për të blerë mjediset e ambasadës shqiptare në Romë.

205. Sipas aktit për kthimin dhe kompensimin e pronës (akti i pronës), ankuesit depozituan dy ankesa përkatësisht në vitin 1996 dhe 1999 në Komisionin e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (Komisioni), nëpërmjet të cilave kërkonin titullin e pronësisë të gjyshit të tyre të sëmure.

206. Më 18 mars 1996 dhe 14 dhjetor 1999 Komisioni njohu titullin e ankuesit për dy parcela toke me sipërfaqe 1 100 m² dhe 537 m² secila. Komisioni vendosi se ishte e pamundur që ankuesve t'u kompensohej e gjithë sipërfaqja fillestare. Ai vendoi t'u kthejë ankuesve një truall të lirë me sipërfaqe 1 456 m², i ndodhur brenda mjediseve të zëna nga ambasada italiane dhe urdhëroi autoritetet të paguanin kompensimin në lidhje me sipërfaqen prej 181 m². Për më tepër, Komisioni urdhëroi regjistrimin e titullit të ankimesit në regjistrin e pronave të Tiranës.

207. Ankuesve iu dhanë dhe dy certifikata pronësie nga zyra e regjistrimit: regjistrimi nr. 4373, i datës 1 qershor 1996, dhe regjistrimi nr.420, i datës 28 dhjetor 1999.

208. Në një datë të paspecifikuar në vitin 1996 duke pasur parasysh faktin se, sipas notës verbale të vitit 1991, ambasada italiane kishte titullin vetëm për njërën nga ndërtesat, por jo për sipërfaqen e tokës, ankuesit i kërkuar ambasadës t'u kthente pronën e tyre, të cilën ajo (ambasada) e kishte zaptuar pa titull.

209. Më 27 nëntor 1996 Ministria e Punëve të Jashtme të Shqipërisë, duke pasur parasysh pretendimet e pronësisë nga ankuesit për sipërfaqen ngjitur me ndërtesat e ambasadës, ofroi ndërmjetësim për ambasadën italiane, me synimin e arritjes së marrëveshjeve civile me ankuesit.

210. Më 16 gusht 1997 ambasada italiane në Tiranë, në përgjigje të kërkesës së ankuesve për marrjen e pronës së tyre, i informoi ata se pretendimet e tyre të pronësisë për sipërfaqen e tokës që gjendej brenda mjediseve të tyre duhej të zgjidheshin me autoritetet shqiptare.

211. Më 1 tetor 1997, pas një kërkesë nga ankuesit, Ministria Italiane e Punëve të Jashtme i informoi ata se, nëpërmjet një shkëmbimi të një note verbale të vitit 1991, ambasada italiane në Shqipëri kishte pronësi të plotë mbi ndërtesat dhe mbi tokën përreth. Për më tepër, ajo i referoi aplikantët tek autoritetet shqiptare si kompetente për të vendosur për pretendimet për kompensim që mund të ngrinin ankuesit.

B. Proceset gjyqësore për marrjen dhe kompensimin e pronës

212. Më 2 maj 1997, pas një padie civile të ngjitur nga ankuesit kundër Ministrisë së Punëve të Jashtme, Gjykata e Rrethit të Tiranës (Gjykata e Tiranës) konstatoi se ambasada italiane po zaptonte pronën e ankuesit pa pasur titull dhe, duke mos qenë në gjendje të ndërmerre veprime kundër një misioni diplomatik, ajo urdhëroi Ministrinë e Punëve të Jashtme të lehtësonte marrjen e

pronës nga ankuesit dhe, gjithashtu, t'u paguante atyre dëmshpërblimin prej 21 607,50 dollarësh amerikanë.

213. Më 27 janar 1998 Gjykata e Apelit e Tiranës (Gjykata e Apelit) e rrëzoi vendimin e Gjykatës së Rrethit dhe ia ktheu çështjen për rishqyrtim Gjykatës së Rrethit nga një trup gjykues i ndryshëm nga trupi i parë. Sipas Gjykatës së Apelit, Ministria e Punëve të Jashtme, e cila kishte përfaqësuar shtetin shqiptar në marrëveshjen për transferimin e pronësisë tek ambasada italiane, nuk mund të ishte palë e akuzuar në proces për aq kohë sa Ministria e Financës ishte organi kompetent për përfaqësimin e interesave shtetërore në proceset e brendshme. Ankuesit apeluan kundër vendimit të Gjykatës së Apelit në Gjykatën e Kasacionit të asaj kohe.

214. Më 17 qershor 1998 Gjykata e Kasacionit rrëzoi vendimin e Gjykatës së Apelit dhe ia ridërgoi çështjen për rishqyrtim kësaj gjykate.

215. Më 29 janar 1999 Gjykata e Apelit, gjatë rishqyrtimit të çështjes, konstatoi se Ministria e Punëve të Jashtme nuk mund të ishte përgjegjëse për këtë gjë dhe caktoi ambasadën italiane, e cila kishte zënë pronën e ankuesit pa titull, si subjektin përgjegjës në lidhje me pronësinë. Ajo rrëzoi vendimin e Gjykatës së Rrethit të datës 2 maj 1997 dhe ia rinisi çështjen për rigjykim së njëjtës gjykatë.

216. Më 20 qershor 2000 Gjykata e Rrethit rrëzoi bazën e apelit të ankuesit, duke i shpallur të paligjshme vendimet e Komisionit të datës 18 mars 1996 dhe 14 dhjetor 1999, pasi ato ishin në kundërshtim me seksionin 4 të aktit të pronësisë.

217. Gjykata e Rrethit u shpreh se sipërfaqja e tokës që pretendohet nga ankuesit, megjithëse nuk kishte ndërtesa mbi të, ishte një pjesë përbërëse e mjediseve të ambasadës italiane. Në këtë mënyrë, Gjykata e Rrethit i deklaroi të pavlefshme vendimet e Komisionit dhe vendosi se ankuesit kishin të drejtën e marrjes së kompensimit për pronat fillestare në njërën prej formave të parashikuara në seksionin 16 të aktit të pronësisë.

218. Më 31 tetor 2001 Gjykata e Apelit rrëzoi vendimin e Gjykatës së Rrethit dhe ia dërgoi çështjen për rishikim një paneli të ndryshëm të Gjykatës së Apelit, në përputhje me nenin 467/a të Kodit të Procedurës Civile, pasi kishte vënë re parregullsi në procedimet e gjykatave më të ulëta.

219. Më 29 tetor 2002 Gjykata e Apelit, pasi kishte njoftuar siç duhet për seancën palët kundërshtare, përkatësisht, Ministrinë e Punëve të Jashtme, Komisionin e Tiranës, Ministrinë e Financës dhe ambasadën italiane në Tiranë, deklaroi të pavlefshme vendimet e Komisionit të datës 18 mars 1996 dhe të datës 14 dhjetor 1999. Ajo vendosi se të gjithë ankuesit kishin të drejtën e marrjes së kompensimit *in lieu* të pronës fillestare në njërën ndër format e parashikura nga ligji përse i përket sipërfaqës së tokës prej 1 456 m². Si rrjedhojë, të gjithë ankuesit do të merrnin kompensim në përputhje me aktin e pronësisë për sipërfaqen e përgjithshme prej 1 637 m². Për më tepër, Gjykata e Apelit u shpreh se, përderisa prona ishte pjesë integrale e ambienteve të ambasadës italiane, ajo nuk mund të konsiderohej si tokë bosh sipas kuptimit të seksionit 4 të aktit të pronësisë (shih paragrafin 226 më poshtë).

220. Më 15 qershor 2004 Gjykata e Lartë, e cila kishte zëvendësuar Gjykatën e Kasacionit, pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Shqipërisë më 28 nëntor 1998, pas një ankimi të ankuesve, pranoi arsyetimin e vendimit të Gjykatës së Apelit të datës 29 tetor 2002.

221. Në një datë të paspecifikuar në vitin 2004, ankuesit depozituan një ankesë në Gjykatën Kushtetuese, sipas nenit 131 (f) të Kushtetutës, ku pretendonin se vendimi i Gjykatës së Apelit të Tiranës, i datës 29 tetor 2002 dhe vendimi i Gjykatës së Lartë, i datës 15 qershor 2004, ishin jokushtetuese.

222. Apeli u shpall i papranueshëm nga Gjykata Kushtetuese më 13 janar 2005 nga një panel prej tre gjyqtarësh. Gjykata u shpreh se ankesa kushtetuese e ankuesve lidhej me vlerësimin e provave, gjë e cila ishte në juridiksionin e gjykatave më të ulëta, por ishte jashtë juridiksionit të saj.

II. LEGJISLACIONI PÛRKATËS NDËRKOMBËTAR DHE I BRENDSHËM

A. E drejta përkatëse ndërkombëtare

223. Dispozitat ndërkombëtare përkatëse janë parashtruar në çështjen Treska kundër Shqipërisë dhe Italisë (dec.), nr.26937/04, ECHR 2006-... (fragmente) dhe Manolescu dhe Dobrescu kundër Rumanisë dhe Rusisë (dec.), nr. 60861/00, §§ 38-39, ECHR 2005-VI.

B. E drejta përkatëse e brendshme

1. Kushtetuta

224. Dispozitat përkatëse të Kushtetutës së Shqipërisë parashikojnë si më poshtë:

“Neni 41

1. E drejta e pronës private është e garantuar.
2. Prona fitohet me dhurim, me trashëgimi, me blerje dhe me çdo mënyrë tjetër klasike të parashikuar në Kodin Civil.
3. Ligji mund të parashikojë shpronësime ose kufizime në ushtrimin e së drejtës së pronës vetëm për interesa publike.
4. Shpronësimit ose ato kufizime të së drejtës së pronës që janë të barazvlefshme me shpronësimin, lejohen vetëm përkundrejt një shpërblimi të drejtë.
5. Për mosmarrëveshjet lidhur me masën ose shkallën e shpërblimit mund të bëhet ankim në gjykatë.”

Neni 42 § 2

“Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.”

Neni 142 § 3

“Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore.”

Neni 131

“Gjykata Kushtetuese vendos për: ...

(f) gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shterruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave.”

Neni 181

“1. Kuvendi, brenda dy deri tre vjetëve nga hyrja në fuqi e kësaj Kushtetute nxjerr ligje për rregullimin e drejtë të çështjeve të ndryshme që lidhen me shpronësimet dhe konfiskimet e kryera para miratimit të kësaj Kushtetute, duke u udhëhequr nga kriteret e nenit 41.

2. Ligjet dhe aktet e tjera normative të miratuara para datës së hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute dhe që kanë të bëjnë me shpronësimet dhe konfiskimet, do të zbatohen kur nuk vijnë në kundërshtim me të.”

2. Akti për kthimin dhe kompensimin e pronës (ligji nr.7698 i datës 15 prill 1993, i ndryshuar me ligjet nr.7736 dhe nr.7765 të vitit 1993, ligjet nr.7808 dhe nr.7879 të vitit 1994, ligji nr.7916 i vitit 1995, ligji nr.8084 i vitit 1996 dhe i shfuqizuar nga ligji nr.9235, datë 29 korrik 2004 dhe i ndryshuar së fundmi nga ligji nr.9388 i vitit 2005 dhe ligji nr.9583 i vitit 2006)

225. Seksionet përkatëse të aktit të pronave (për kthimin dhe kompensimin e pronave) janë përshkruar në çështjen Beshiri dhe të tjerë kundër Shqipërisë (nr.7352/03, §§ 21-29, 22 gusht 2006), Driza kundër Shqipërisë (nr.33771/02, §§ 36-43, ECHR 2007-...) dhe Ramadhi dhe të tjerë kundër Shqipërisë (nr.38222/02, §§ 23-30, 13 nëntor 2007).

226. Seksioni 4 i aktit të pronës, i vitit 1993, i ndryshuar dhe siç ka qenë në fuqi në kohën fizike, parashikonte se trojet e tokës që ishin bosh do t'u jepeshin dhe ktheheshin ish-pronarëve ose trashëgimtarëve të tyre, me përjashtim të rasteve kur parashikohej ndryshe.

3. Kodi i Procedurës Civile

227. Dispozita përkatëse e Kodit të Procedurës Civile parashikon si më poshtë:

Anëtarë të përfaqësive konsullore dhe diplomatike me seli në Republikën e Shqipërisë nuk janë subjekt i juridiksionit të gjykatave shqiptare, përveç rasteve:

a) kur ata e pranojnë këtë vullnetarisht;

b) në rastet dhe kushtet e parashikuara nga Konventa e Vjenës për marrëdhëniet diplomatike.

LEGJISLACIONI

I. BASHKIMI I APLIKIMEVE

228. Duke qenë se të dyja aplikimet kanë të bëjnë me të njëjtat fakte, ankesa dhe procese të gjykatave të brendshme, Gjykata vendos t'i bashkojë ato, sipas nenit 42 § 1 të rregullores së Gjykatës.

II. PRANUESHMËRIA

A. Përputhshmëria *ratione personae*

229. Ankuesit u ankuan kundër Italisë për shkelje të nenit 1 të protokollit nr.1 të Konventës, duke qenë se zotërimi *sine titulo* nga ambasada italiane në Tiranë i pronës që u ishte dhënë atyre nga akti i pronësisë, përbënte ndërhyrje për gëzimin e pronave të tyre në paqe.

230. Gjykata duhet të përcaktojë nëse faktet e ngritura nga ankuesi janë të tilla saqë përfshijnë përgjegjësinë e Italisë sipas Konventës. Siç është theksuar në mënyrë të vazhdueshme prej saj, përgjegjësia e një shteti përfshihet nëse cenohet një ndër të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Konventë, që vjen si rezultat i shkeljes së nenit 1, nëpërmjet të cilit “Palët e Larta Kontraktuese i sigurojnë çdonjërit në juridiksionin e tyre të drejtat dhe liritë e përcaktuara në seksionin I të Konventës” (shih Costello-Roberts kundër Mbretërisë së Bashkuar, vendim i datës 25 mars 1993, seritë A nr. 247-C, fq. 57, §§ 25-26).

231. Si rezultat, Gjykata përcakton nëse ankuesit ishin “brenda juridiksionit” të Italisë në kuptimin e kësaj dispozite. Me fjalë të tjera, duhet të përcaktohet nëse, pavarësisht nga fakti që proceset në fjalë nuk janë zhvilluar në territorin e atij shteti, Italia prapë mund të jetë përgjegjëse për rezultatet mbi ta dhe për pamundësinë e pretenduar për zbatimin e vendimeve të autoriteteve shqiptare në favor të ankuesve.

232. Gjykata i referohet jurisprudencës së saj përsa i përket ushtrimit të juridiksionit territorial dhe jashtëterritorial nga një shtet kontraktues (shih, për shembull, Drozd dhe Janousek kundër Francës dhe Spanjës, vendimi i datës 26 qershor 1992, seritë A nr. 240; Banković dhe të tjerët kundër Belgjikës dhe 16 shteteve të tjera kontraktuese (dec.) [GC], nr.52207/99, ECHR 2001-XII; Ilaşcu dhe të tjerët kundër Moldavisë dhe Rusisë [GC], nr.48787/99, ECHR 2004-VII; McElhinney kundër Irlandës dhe Mbretërisë së Bashkuar (dec.) [GC], nr.31253/96, 9 shkurt 2000).

233. Proceset në fjalë janë zhvilluar ekskluzivisht në territorin e Shqipërisë. Gjykatat shqiptare kanë autoritet sovran në çështjen e ankuesve dhe autoritetet italiane nuk kanë ndikim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mbi vendimet apo gjykimet e dhëna në Shqipëri. Detyrimi për zbatimin e vendimit të Gjykatës së Lartë të datës 15 qershor 2004, e cila vendosi përfundimisht për dëmshpërblim në lidhje me ankuesit, u përket autoriteteve shqiptare.

234. Është e qartë nga rrethanat e çështjes në fjalë se ankuesit nuk ishin në juridiksionin e Italisë. Ky shtet nuk ka ushtruar juridiksion mbi ankuesit. Nuk ka faktor që justifikon sjelljen e aplikimeve nën juridiksionin e Italisë për qëllimet e nenit 1 të Konventës (shih Treska, cituar më lart; Manoilescu dhe Dobrescu, cituar më lart, §§ 104–105).

235. Pra, rezulton se kjo ankesë nuk është në përputhje *ratione personae* me dispozitat e Konventës në kuptim të nenit 35 § 3 dhe duhet të hidhet poshtë në përputhje me nenin 35 § 4.

B. Përputhshmëria me rregullin e gjashtëmujorit

236. Më 6 qershor 2006 ankuesi i aplikimit nr.35720/04 depozitoi një ankesë të re në Gjykatë për mungesë arsyetimi në vendimin e Gjykatës Kushtetuese të datës 13 janar 2005.

237. Gjykata thekson se, në lidhje me ankesat që nuk janë përfshirë në aplikimin fillestar, shtrirja e afatit kohor gjashtëmujor nuk ndërpritet deri në datën kur ankesa i është dërguar për herë të parë një organi të Konventës (shih Allan kundër Mbretërisë së Bashkuar (dec.), nr. 48539/99, vendim i datës 28 gusht 2001).

238. Rezulton se ankesa, për mungesë arsyesh, u paraqit më shumë se gjashtë muaj nga data e vendimit të Gjykatës Kushtetuese të 13 janarit 2005 dhe si e tillë nuk duhet të pranohet, në përputhje me nenin 35 § 1 dhe 4.

C. Çështje të tjera

239. Ankuesit u ankuan për mohim aksesit në gjykatë përse i përket papaftësisë së tyre për të hapur një çështje kundër një misioni diplomatik, përkatësisht ambasadës së Republikës së Italisë në Shqipëri.

240. Neni 6 § 1 i siguron gjithsecilit të drejtën për të çuar përpara gjykatës çdo çështje lidhur me të drejtat dhe detyrimet e tij civile (shih Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar, vendim i datës 21 shkurt 1975, seritë A nr. 18, § 36). Gjithësesi, e drejta për akses në një gjykatë nuk është absolute, por mund të jetë subjekt i kufizimeve; këto kufizime lejohen nëpërmjet nënkuptimit, pasi e drejta për akses, nga natyra, kërkon rregullim nga shteti (shih Ashingdane kundër Britanisë së Bashkuar, vendim i datës 28 maj 1985, Seritë A nr. 93, § 57).

241. Gjykata thekson se rregullat e njohura gjerësisht të së drejtës ndërkombëtare për imunitetin shtetëror nuk mund të konsiderohen si vendosëse të kufizimeve jopërpjestimore mbi të drejtën e aksesit në një gjykatë, siç parashikohet në nenin 6 § 1 të Konventës. Për shkak se e drejta e aksesit në një gjykatë është pjesë përbërëse e garancisë për një proces të rregullt ligjor në atë nen, po kështu, disa kufizime mbi aksesin duhet të konsiderohen si të qenësishme, si për shembull ato kufizime që përgjithësisht pranohen nga komuniteti i shteteve si pjesë e doktrinës së imunitetit shtetëror (shih McElhinney kundër Irlandës [GC], nr. 31253/96, § 37, ECHR 2001-XI; Manoilescu dhe Dobrescu, (dec.), cituar më lart, § 80, ECHR 2005-VI; dhe, Treska, cituar më lart).

242. Në çështjen në fjalë nuk ka asgjë që të tregojë shmangie nga këto përfundime. Në këto rrethana, faktet e ankimura nuk përbëjnë një kufizim të pajustificuar të së drejtës së ankuesve për të pasur akses në gjykatë. Si rezultat, ankesa nuk është e pranueshme, pasi është haptazi e pabazuar dhe duhet të rrëzohet sipas nenit 35 § 3 dhe 4 të Konventës.

III. PRETENDIM PËR SHKELJE TË NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS

243. Ankuesit pretendojnë se ka pasur shumë shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës, kryesisht përse i përket tejzgjatjes së proceseve të brendshme dhe moszbatimit të vendimit të Gjykatës së Lartë të datës 15 qershor 2004.

Neni 6 i Konventës, në pjesën që lidhet me këtë ankesë, parashikon si më poshtë:

“Në përcaktim të të drejtave të tij civile dhe detyrimeve ..., çdokush ka të drejtë të ketë një proces ... të drejtë ... nga [një] ... gjykatë ...”

A. Moszbatimi i vendimit të Gjykatës së Lartë i datës 15 qershor 2004

1. Pranueshmëria

244. Ankuesit u ankuan për moszbatimin në praktikë nga autoritetet të vendimit të Gjykatës së Lartë që urdhëronte pagimin e kompensimit për ta në lidhje me tokën e paraardhësit të tyre.

245. Qeveria u shpreh se ankuesit nuk kishin shterruar mjetet e reja juridike në vend, të prezantuara nga akti i pronësisë i vitit 2004, në lidhje me këtë ankesë.

246. Gjykata thekson parimin e deklaruar në çështjen Driza (cituar më lart, § 57) dhe është e mendimit se çështja e efektivitetit të mjeteve juridike të ofruara nga aktet e pronësisë është thelbësore për themelin e ankimit të ankuesve, sipas nenit 13 në lidhje me nenin 1 të protokollit nr. 1. Ajo vendos se të dyja çështjet duhet të shqyrtohen në themel së bashku. Për më tepër, kjo ankesë nuk është haptazi e pabazuar në kuptimin e nenit 35 § 3 të Konventës. Ajo deklaroi se nuk ekzistojnë baza të tjera për deklarimin e kësaj ankese të papranueshme dhe, si rezultat, e deklaroi atë të pranueshme.

2. Themeli

(a) Parashtrimet palëve

247. Qeveria përsëriti se autoritetet nuk mund të jenë përgjegjëse për moszbatimin e vendimit të Gjykatës së Lartë të datës 15 qershor 2004, pasi ekzekutimi varej nga marrja e hapave të nevojshëm nga ankuesit, që do të thotë nga hapja e një çështjeje për të kërkuar zbatimin e saj. Qeveria iu referua argumenteve të saj të mëparshme për shterrimin e mjeteve juridike të brendshme.

248. Ankuesit e kundërshtuan argumentin e qeverisë.

(b) Vlerësimi i Gjykatës

249. E drejta për akses në gjykatë, e garantuar nga neni 6 § 1 i Konventës, do të ishte iluzionare nëse sistemi i brendshëm ligjor i shtetit kontraktues lejon që një vendim gjyqësor detyrues i formës së prerë të mbetet i pazbatuar në dëm të njëres prej palëve. Ekzekutimi i një gjykimi të dhënë nga çdo gjykatë, si rezultat, duhet të konsiderohet si një pjesë përbërëse e “procesit”, për qëllimet e nenit 6 (shih, *inter alia*, Beshiri dhe të tjerë, cituar më lart, § 60).

250. Konventa nuk mund të interpretohet se vendos detyrime të përgjithshme të shteteve kontraktuese për të marrë prona që u janë transferuar atyre para ratifikimit të Konventës (shih Kopecký k. Sllovakisë [GC], nr. 44912/98, § 35, dhe von Maltzan dhe të tjerë kundër Gjermanisë (dec.) [GC], nr. 71916/01, 71917/01 dhe 10260/02, § 74, ECHR 2005-V). Në Konventë nuk ka ndonjë detyrim për përcaktimin e procedurave ligjore, sipas të cilave mund të kërkohej kthimi i pronësisë. Gjithsesi, kur një shtet kontraktues vendos të përcaktojë procedura të tilla ligjore, ai nuk mund të përjashtohet nga detyrimi për të respektuar të gjitha garancitë përkatëse të parashikuara nga Konventa, në veçanti nga neni 6 § 1.

251. Gjykata rikujton gjetjen e saj në paragrafin 38 më lart. Vendimi i Gjykatës së Lartë i datës 15 qershor 2004 mund të interpretohet si urdhërues për autoritetet për t’i ofruar ankuesit një formë kompensimi, që do t’i zhdëmtonte ata në vend të kthimit të pronës së tyre fillestare.

252. Gjykata vë re se, pas dhënies së vendimit në vitin 2004, autoritetet nuk iu ofruan ankuesve opsionin e marrjes së kompensimit të duhur (krahasoni Uzkurëlienë dhe të tjerët kundër. Lituanisë, nr. 62988/00, § 36, 7 prill 2005). Në këtë mënyrë, ankuesit nuk kishin as mundësinë e shqyrtimit të një oferte kompensimi *in lieu* të kthimit të pronësisë që më parë u ishte dhënë atyre (shih Driza, cituar më lart, § 90.).

253. Për më tepër, Qeveria nuk ka ofruar asnjë shpjegim në lidhje me arsyen pse vendimi i datës 15 qershor 2004 nuk është zbatuar pas më shumë se pesë vitesh nga dhënia e tij. Nuk duket se autoritetet administrative kanë marrë ndonjë masë për zbatimin e vendimit.

254. Si rezultat, Gjykata është e mendimit se problemi vijon dhe mbetet i pazgjidhur, parësisht nga treguesit që ka dhënë në çështjen Beshiri dhe të tjerët se “në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore që urdhërojnë shtetin për kryerjen e një pagese, personit, i cili ka marrë vendimin kundër shtetit për të përfutur pagesën nga ai, nuk duhet t’i kërkohej ndërmarrja e procedimeve për ekzekutim, në mënyrë që të përfitojë shumën e duhur” (shih § 108).

255. Konsideratat e lartpërmendura janë të mjaftueshme për ta bërë Gjykatën në gjendje të arrijë në përfundimin se, duke dështuar në marrjen e masave të nevojshme për zbatimin e vendimit të datës 15 qershor 2004, autoritetet shqiptare privuan dispozitat e nenit 6 § 1 të Konventës nga të gjitha efektet e dobishme.

256. Kjo, si rezultat, çon në shkeljen e nenit 6 § 1 të Konventës në këtë aspekt.

B. Zgjatja e procesit

1. Pranueshmëria

257. Gjykata është e mendimit se ankesa në këtë seksion nuk është haptazi e pabazuar sipas kuptimit të nenit 35 § 3 të Konventës. Ajo konstaton më tej se nuk ka arsye të tjera për ta deklaruar këtë pjesë të ankesës si të papranueshme dhe, si rezultat, e deklaron atë të pranueshme.

2. Themeli

(a) Parashtrimet e palëve

258. Ankuesit u ankuan për zgjatjen e paarsyeshme të proceseve të brendshme, të cilat kishin zgjatur për rreth tetë vjet për nëntë nivele juridiksioni. Ata ua atribuan këtë vonesë autoriteteve të brendshme, të cilat kishin nxjerrë përfundime të ndryshme në nivele të ndryshme juridiksioni, si dhe pozicionit të mbajtur nga Ministria e Punëve të Jashtme të Shqipërisë në lidhje me të drejtën e tyre të pronësisë.

259. Qeveria parashtroi se proceset kishin qenë komplekse, si rezultat i ndryshimeve dhe vlerësimit të të drejtave të pronësisë në periudha të ndryshme dhe për shkak të faktit se ishte, i përfshirë një mision diplomatik i akredituar në Shqipëri. Ata shtuan se kompleksiteti i fakteve i kombinuar me mungesën e jurisprudencës kishte çuar në rikthime të shumta të çështjes për rishqyrtim. Ata pretenduan se kohëzgjatja e proceseve nuk kishte ndikim të drejtpërdrejtë mbi të

drejtën e ankuesve, pasi ata nuk e kishin zotëruar asnjëherë efektivisht pronën e tyre.

(b) Vlerësimi i Gjykatës

260. Gjykata vë re se të gjitha proceset në fjalë lidhen me çështjen e të drejtave të pronësisë së ankuesve. Koha që duhet të merret parasysh, duhet të mbulojë të gjithë kohëzgjatjen e proceseve, të cilat filluan në një datë të paspecifikuar në vitin 1997 dhe përfunduan me vendimin e Gjykatës të datës 13 janar 2005. Për më tepër, vendimi i Gjykatës së Lartë i datës 15 qershor 2004 nuk është zbatuar ende. Deri më sot, proceset gjyqësore kanë zgjatur për më shumë se njëmbëdhjetë vjet.

261. Gjithsesi, Gjykata është e mendimit se në dritën e gjetjeve të saj për cenim të nenit 6 § 1 të Konventës për moszbatimin e vendimit të Gjykatës së Lartë të datës 15 qershor 2004, asaj nuk i duhet të marrë vendim të veçantë për themelin e ankesës së kohëzgjatjes së gjykimit (shih Lizanets kundër Ukrainës, nr. 6725/03, § 48, 31 maj 2007).

IV. PRETENDIM PËR SHKELJE TË NENIT 1 TË PROTOKOLLIT NR.1 TË KONVENTËS

262. Ankuesit u ankuan se paaftësia për t'u dhënë atyre kompensim, sipas vendimit përfundimtar të datës 15 qershor 2004, përbën shkelje të nenit 1 të protokollit nr.1 të Konventës, i cili parashikon si më poshtë:

“Çdo person fizik ose juridik ka të drejtë për të gëzujë në paqe pasuritë e tij. Askush nuk do të privohet nga prona e tij, veçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e shteteve të fusin në fuqi ligje që ato i quajnë të domosdoshme për të rregulluar përdorimin e pronës në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagesën e taksave, ose të kontributeve të tjera, ose të gjobave.”

A. Pranueshmëria

263. Gjykata është e mendimit se kjo ankesë nuk është haptazi e pabazuar brenda kuptimit të nenit 35 § 3 të Konventës. Për më tepër, ajo nuk gjen arsye të tjera për deklarimin e saj të papranueshme dhe, për rrjedhojë, e deklaroi atë të pranueshme.

B. Themeli

1. Parashtrimet e palëve

264. Qeveria parashtroi se e drejta e ankuesve për pronë nuk është cenuar pasi vendimi i Gjykatës së Lartë i datës 15 qershor 2004 kishte pranuar të drejtën e tyre për kompensim në njërën ndër format e këtij ligji. Ajo kontestoi se ankuesit ende nuk kishin përmbushur rregullat e parashikuara në aktin e pronësisë, në mënyrë që të përcaktonin formën e atij kompensimi. Ajo shtoi se procesi i kompensimit ishte penguar nga kohëzgjatja e tepruar, e cila ka qenë gjithashtu rezultat i rrethanave objektive, të tilla si mungesa e fondeve dhe interesat e përgjithshme të komunitetit.

265. Ankuesit ishin të mendimit se u ishte cenuar e drejta e tyre për pronësi.

2. Vlerësimi i Gjykatës

266. Gjykata thekson parimet e përcaktuara nga jurisprudenca e saj sipas nenit 1 të protokollit nr.1 (shih, ndërmjet të tjerash, Kopecký kundër Sllovakisë [GC], nr.44912/98, § 35; von Maltzan dhe të tjerë kundër Gjermanisë (ven.) [GC], nr. 71916/01, 71917/01 dhe 10260/02, § 74, ECHR 2005-V; dhe Beshiri dhe të tjerë, të cituar më lart).

267. “Pronat” mund të jenë “prona ekzistuese” ose asete, duke përfshirë, në disa situata të mirëpërcaktuara, dhe pretendimet. Në mënyrë që një pretendim të jetë i aftë të konsiderohet “aset” që bie nën objektin e nenit 1 të protokollit nr.1, ankuesi duhet të sigurohet se ai ka bazë të mjaftueshme në të drejtën e brendshme, ku ka, për shembull, një jurisprudencë të përcaktuar të gjykatave kombëtare që e konfirmojnë atë, ose kur ka një vendim përfundimtar të gjykatës në favor të ankuesit. Kur bëhet kjo, mund të futet në lojë koncepti i “pritjeve legjitime” (shih Draon kundër Francës [GC], nr. 1513/03, § 68, 6 tetor 2005, ECHR 2005-IX, dhe Burdov kundër Rusisë, nr.59498/00, § 40, ECHR 2002-III).

268. Gjykata vë re se ankuesve u është njohur e drejta e kompensimit nëpërmjet vendimit përfundimtar të Gjykatës së Lartë të datës 15 qershor 2004 (shih paragrafin 25 më lart). Pra, ankuesit kishin pretendime të zbatueshme që rridhnin nga vendimi në fjalë.

269. Ajo vë re se kjo ankesë është e lidhur me ankesën e shqyrtuar sipas nenit 6 § 1 në lidhje me paaftësinë për të zbatuar një vendim përfundimtar (shihni paragrafët 249–256 më lart).

270. Gjykata është e mendimit se paaftësia e autoriteteve për të zbatuar vendimin e gjykatës të datës 15 qershor 2004 për një kohë të tillë të gjatë çon në ndërhyrjen e të drejtës së aksuesve për gëzim të paqhtë të pronave të tyre, brenda kuptimit të nenit 1 të protokollit nr.1 të Konventës.

271. Përsa i përket justifikimit të parashtruar nga qeveria në lidhje me këtë ndërhyrje, Gjykata thekson se mungesa e fondeve nuk mund të justifikojë paaftësinë e shtetit për të zbatuar pagimin e një borxhi të përcaktuar në një vendim përfundimtar dhe detyrues (shih Driza, cituar më lart, § 108; Pasteli dhe të tjerë kundër Moldavisë, nr. 9898/02, 9863/02, 6255/02 dhe 10425/02, § 30, 15 qershor 2004; Voytenko k. Ukrainës, nr.18966/02, § 55, 29 qershor 2004; dhe Shmalko kundër Ukrainës, nr.60750/00, § 57, 20 korrik 2004).

272. Si rezultat, ka pasur shkelje të nenit 1 të protokollit nr.1 të Konventës në këtë aspekt.

V. PRETENDIMI PËR SHKELJE TË NENIT 13 NË LIDHJE ME NENIN 1 TË PROTOKOLLIT NR.1 TË KONVENTËS

273. Ankuesit u ankuan për mungesë të mjeteve ligjore efektive për të përfituar përcaktimin përfundimtar të të drejtave të tyre të pronësisë. Ata u bazuan në nenin 13 të Konventës, në të cilin parashikohet si më poshtë:

“Çdo personi, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e njohura nga kjo Konventë, ka të drejtë të paraqesë një ankim efektiv përpara një instance kombëtare dhe kur kjo shkelje është kryer nga persona që veprojnë brenda funksioneve të tyre zyrtare.”

A. Pranueshmëria

274. Gjykata është e mendimit se kjo ankesë nuk është haptazi e pabazuar brenda kuptimit të nenit 35 § 3 të Konventës. Ajo vijon më tej se nuk janë përcaktuar baza të tjera për ta deklaruar atë të papranueshme dhe si rezultat, e deklaroi atë të pranueshme.

B. Themeli

1. Parashtrimet e palëve

275. Ankuesit parashtruan se nuk kishte mjete ligjore efektive me anë të të cilave të pretendohen kompensimin *in lieu* të kthimit të pronës. Ata argumentuan se si rezultat i vëzhgimeve të Qeverisë për mungesë fondesh dhe mungesë disponueshmërie të parcelave bosh të tokës, ata nuk mund të merrnin kompensimin e përvijuar në vendimin e Gjykatës së Lartë të datës 15 qershor 2004.

276. Qeveria ngriti të njëjtat kundërshtime në lidhje me paaftësinë e pretenduar për përdorimin e mjeteve efektive ligjore (shih paragrafin 247 më lart). Ajo iu referua mjeteve efektive të prezantuara në aktin e pronësisë të vitit 2004, të cilat duhet të konsideroheshin efektive për qëllime të nenit 13.

2. Vlerësimi i gjykatës

277. Gjykata vë re se ankesa e ankuesve në përputhje me nenin 1 të protokollit nr. 1 të Konventës është pa diskutim “e diskutueshme” Ankuesi, si rezultat, kishte të drejtë të përdorimit të mjeteve ligjore efektive brenda kuptimit të nenit 13 të Konventës.

278. Për më tepër, “autoriteti” të cilit i referohet neni 13 jo domosdoshmërisht në të gjitha rastet është autoritet gjyqësor në kuptim strikt. Gjithsesi, kompetencat dhe garancitë procedurale që zotëron një autoritet janë të mjaftueshme për të përcaktuar nëse mjetet para tij kanë qenë efektive (shih Klass dhe të tjerë kundër Gjermanisë, vendimi i datës 6 shtator 1978, seritë A nr.28, f. 30, § 67). Mjeti i kërkuar sipas nenit 13 duhet të jetë “efektiv” në praktikë dhe në ligj, në veçanti në kuptimin që ushtrimi i tij nuk duhet të pengohet në mënyrë të pajustificueshme nga veprimet ose mosveprimet e autoriteteve të shtetit përkatës (shih Aksoy kundër Turqisë, vendim i datës 18 dhjetor 1996, Reportet 1996-VI, f. 2286, § 95 në gjoba).

279. Gjykata i referohet gjetjeve të saj në çështjen Driza, të cituar më lart, §§ 117-120. Qeveria nuk dha asnjë informacion në lidhje nëse kishte pasur masa të veçanta të miratuara ose veprime të marra që prej dhënies së vendimit për çështjen Driza. Në rastin në fjalë, nuk ka asnjë tregues të largimit nga gjetje të tilla. Pra, rezulton se ka pasur shkelje të nenit 13 të Konventës në lidhje me nenin 1 të protokollit nr.1.

280. Mbi këtë bazë, kundërshtimi paraprak i qeverisë bazuar në mospërdorimin e mjeteve të brendshme juridike duhet të rrëzohet.

VI. ZBATIMI I NENIT 46 DHE 41 TË KONVENTËS

A. Neni 46 i Konventës

281. Neni 46 i Konventës parashikon:

“1. Palët e Lartë Kontraktuese zotohen t’u binden vendimeve përfundimtare të Gjykatës për çështjet në të cilat ata janë palë.

2. Vendimi përfundimtar i Gjykatës i transmetohet Këshillit të Ministrave, i cili mbikëqyr zbatimin e tij.”

282. Gjykata thekson gjetjet e saj në çështjen Driza (të cituar më lart, §§ 122 – 126) në lidhje me nenin 46 të Konventës. Ajo i bën thirrje shtetit të paditur të marrë masa të përgjithshme siç tregohet në paragrafin 126 të vendimit të lartpërmendur.

B. Neni 41 i Konventës

283. Neni 41 i Konventës parashikon:

“Kur Gjykata konstaton shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj, dhe nëse e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese mundëson vetëm ndreqje të pjesshme të pasojave që kanë rrjedhur nga kjo shkelje, Gjykata, nëse është e nevojshme, i jep palës së dëmtuar një shpërblim të drejtë.”

284. Ankuesit pretenduan një total prej 2,719,500 eurosh në lidhje me dëmin material dhe 200,000 euro në lidhje me dëmin jomaterial. Në lidhje me pretendimin për dëm material, ankuesit parashtuan një vlerësim të pronës nga një ekspert, i cili e vlerësoi vlerën e pronës në 2,184,000 euro dhe humbjen e fitimeve në periudhën nga 1996 deri në 2006 në 535,500 euro.

285. Qeveria nuk parashtroi asnjë koment.

286. Gjykata është e mendimit se çështja e aplikimit të nenit 41 nuk është gati për vendim. Si rezultat, çështja duhet të rezervohet dhe duhet të fiksohet një procedurë e mëtejshme, duke i kushtuar rëndësi mundësisë së arritjes së një marrëveshjeje ndërmjet Qeverisë së Shqipërisë dhe ankuesve të tjerë.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA: UNANIMISHT

1. *Vendos* të bashkojë ankimet.

2. *I deklaron* ankesat e ankuesve të lidhura me nenin 6 § 1 të Konventës, për sa i përket mohimit të aksesit në gjykatë dhe mungesës së arsytimit në vendimin e Gjykatës Kushtetuese të datës 13 janar 2005, të papranueshme;

3. *Deklaron* ankimin e ankuesve sipas nenin 1 të protokollit nr.1 të Konventës të papërputhshëm *ratione personae* për sa kohë ai ishte në mënyrë të drejtëpërdrejtë kundër Italisë.

4. *Bashkohet* me themelin e kundërshtimit paraprak të qeverisë në lidhje me mosshkrimin e mjeteve të brendshme juridike nga ankuesit dhe deklaron pjesën tjetër të aplikimit të pranueshme.

5. *Vendos* se ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje me moszbatimin e vendimit të Gjykatës së Lartë të datës 15 qershor 2004.

6. *Vendos* se nuk e konsideron të nevojshme shqyrtimin e ankesës për kohëzgjatjen e proceseve sipas nenit 6 § 1 të Konventës.

7. *Vendos* se ka pasur shkelje të nenit 1 të protokollit nr.1 të Konventës.

8. *Vendos* se ka pasur shkelje të nenit 13 në lidhje me nenin 1 të protokollit nr.1 të Konventës, dhe si rezultat *rrëzon* kundërshtimet paraprake të qeverisë.

9. *Vendos* se çështja e zbatimit të nenit 41 nuk është e gatshme për vendim; rrjedhimisht:

a) *e rezervon* tërësisht çështjen e sipërpërmendur;

b) *fton* Qeverinë dhe ankuesit të parashtojnë, brenda tre muajve të ardhshëm nga data në të cilën vendimi bëhet përfundimtar sipas parashikimit të nenit 44 § 2 të Konventës, vëzhgimet e tyre me shkrim për çështjen dhe në veçanti, të njoftojnë Gjykatën për marrëveshje që mund të arrihen prej tyre;

c) *rezervon* procedurën mëtejshme dhe i delegon presidentit të trupit gjykues kompetencën e fiksimit të kësaj çështjeje, nëse del e nevojshme.

Përgatitur në anglisht, dhe njoftuar me shkrim më 29 shtator 2009, në përputhje me nenin 77 §§ 2 dhe 3 të rregullores së Gjykatës.

Lawrence Early
Sekretar

Nicolas Bratza
President

VENDIM
(THEMELI)
(Ankimi nr. 32907/07)
ÇËSHTJA “GJYLI KUNDËR SHQIPËRISË”

STRASBURG
29 shtator 2009

Ky vendim bëhet i formës së prerë në rrethanat e parashikuara në nenin 44 § 2 të Konventës. Ai mund të jetë objekt rishikimi redaktorial.

Në këtë çështje ankuesi ankohet për shkelje të Nenit 6 § 1 të Konventës për moszbatim të vendimeve gjyqësore që urdhëronin kthimin e tij në detyrë dhe pagimin e pagave të prapambetura për të. Procesi i apelimit është akoma i varur para Gjykatës së Lartë. Gjykata Evropiane tërheq vëmendjen se edhe nëse një ankesë në Gjykatën e Lartë nuk ka efekt pezullues automatik dhe, pavarësisht nga kompetencat e Gjykatës së Lartë sipas Nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, Gjykata përsërit se Neni 6 mbron zbatimin e vendimeve përfundimtare dhe të formës së prerë, dhe jo vendime të cilat mund të jenë objekt i një kontrolli të mëpasshëm në një gjykatë të një niveli më të lartë, dhe që eventualisht, mund të rrëzohen.

Gjykata thekson se Neni 6 § 1 në kreun “civil” të tij është i zbatueshëm për të gjitha mosmarrëveshjet që përfshijnë nëpunësit civilë, në përjashtim të rasteve kur legjislacioni i brendshëm përjashton shprehimisht aksesin në një gjykatë për postin ose kategorinë e stafit/personit në fjalë, dhe kur ky përjashtim është i justifikuar për arsye objektive në interes të Shtetit. Gjykata thekson se një vonesë e tejzgjatur e paarsyeshme në zbatimin e një vendimi përfundimtar dhe i formës së prerë mund të shkelë Konventën. Arsyeshmëria e një vonesa të tillë duhet përcaktuar duke pasur parasysh në veçanti kompleksitetin e zbatimit të proceseve, sjelljen e vetë ankuesit dhe të organeve kompetente si dhe masën dhe natyrën e dëmshpërblimit të përcaktuar nga gjykata.

Në çështjen Gjyli k. Albania,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (seksioni i katërt), me trup gjykues të përbërë prej:

Nicolas Bratza President
Lech Garlicki
Giovanni Bonello
Ljiljana Mijović
Päivi Hirvelä
Ledi Bianku
Nebojša Vučinić gjyqtarë
dhe Lawrence Early sekretar i seksionit,
pas shqyrtimit me dyer të mbyllura më 8 shtator 2009,
Merr në këtë datë vendimin e mëposhtëm:

PROCEDURA

1. Çështja e ka zanafillën në një ankim (nr.32907/07) kundër Republikës së Shqipërisë dërguar në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive kryesore të njeriut (Konventa) nga një nënshtetas shqiptar, Z. Ali Gjyli (ankuesi), më 13 korrik 2007.

2. Ankuesi, i cili kishte përfituruar ndihmë ligjore, u përfaqësua nga z. S. Puto, avokat, që ushtron profesionin e tij në Tiranë. Qeveria shqiptare (“Qeveria”) u përfaqësua nga Agjentja e asaj kohe, Znj. S. Meneri.

3. Ankuesi u ankua për moszbatimin e dy vendimeve të gjykatës.
4. Më 7 nëntor 2007 ankimit iu dha përparësi sipas nenit 41 të rregullores së Gjykatës.
5. Më 12 dhjetor 2007 kryetari i trupit gjykues të cilit i ishte caktuar çështja vendosi ta njoftojë Qeverinë për ankimin. Sipas dispozitave të nenit 29 § 3 të Konventës, u vendos të shqyrtohej themeli i ankimit në të njëjtën kohë me pranueshmërinë e çështjes.
6. Secila nga palët, ankuesi dhe Qeveria parashtruan vëzhgimet e tyre me shkrim (neni 59 § 1).

FAKTET

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

7. Ankuesi ka lindur në vitin 1945 dhe banon në Durrës, Shqipëri.

A. Proceset në lidhje me heqjen nga puna të ankuesit

8. Ankuesi ishte i punësuar në Shërbimin Kombëtar të Punësimit (SHKP) si Drejtor i Qendrës së Trajnimit Profesional në Durrës (“SHKP-ja e Durrësit). SHKP-ja është në varësi të Ministrisë së Punës. Më 9 korrik 2005, ankuesi u hoq nga puna. Duke e konsideruar heqjen e tij nga puna arbitrare, ai iu drejtua Gjykatës së Rrethit të Durrësit. Ankuesi nuk kërkoi dëmshpërblim për dëm material.

9. Në vendimin e saj të datës 27 shtator 2005, Gjykata e Rrethit të Durrësit e deklaroi të pavlefshme heqjen nga puna si rezultat i një procedure të parregullt dhe urdhëroi kthimin e tij në punë. Më 1 nëntor 2005, SHKP-ja e apeloj vendimin në Gjykatën e Apelit të Durrësit (Gjykata e Apelit).

10. Me anë të vendimit të datës 12 dhjetor 2005, Gjykata e Apelit të Durrësit e deklaroi ankimin të papranueshëm pasi ai ishte depozituar pas mbarimit të afatit ligjor. Ky gjykim mori formë të prerë pasi për të nuk u depozitua asnjë ankim në Gjykatën e Lartë.

11. Për qëllim të ekzekutimit të vendimit të Gjykatës së Rrethit të Durrësit të datës 27 shtator 2005, gjykata lëshon një urdhër ekzekutimi më 22 dhjetor 2005, në përputhje me nenet 510 (a) dhe 511 (a) të Kodit të Procedurës Civile (shih “legjislacionin dhe praktikën e brendshme përkatëse” më poshtë).

12. Më 23 janar 2006 zyra e përmbarimit lëshoi një gjobë për Ministrin e Punës në lidhje me moszbatimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit të Durrësit. As sot e kësaj dite vendimi i Gjykatës së Rrethit të Durrësit nuk është ekzekutuar.

B. Proceset në lidhje me pagimin e pagave të humbura

13. Në një datë të paspecifikuar, ankuesi depozitoi një ankim në Gjykatën e Rrethit të Durrësit, ku kërkonte pagimin e pagave të humbura që prej 9 korrikut 2005.

14. Më 24 tetor 2006 Gjykata e Rrethit të Durrësit vendosi në favor të ankuesit dhe urdhëroi SHKP-në t’i paguante ankuesit pagën e tij që prej datës 9 korrik 2005 deri në datën e rikthimit të tij në punë.

15. Më 14 qershor 2007, Gjykata e Apelit të Durrës-it e rrëzoi ankimin e bërë nga SHKP-ja. SHKP-ja ankimoi vendimin në Gjykatën e Lartë. Sipas informacionit që i është dhënë Gjykatës, duket se procesi është ende pezull në Gjykatën e Lartë.

16. Më 6 dhjetor 2006, me kërkesë të ankuesit, Gjykata e Rrethit të Durrësit lëshoi një urdhër ekzekutimi për vendimin e saj të datës 24 tetor 2006.

17. Në një datë të paspecifikuar, SHKP-ja kërkoi pezullimin e menjëhershëm të ekzekutimit. Gjykata e Rrethit të Durrësit vendosi që çështja dilte jashtë juridiksionit të saj territorial dhe ia transferoi atë Gjykatës së Rrethit të Tiranës.

18. Më 31 janar 2008 Gjykata e Rrethit të Tiranës rrëzoi padinë e SHKP-së. Në një datë të paspecifikuar, SHKP-ja e ankimoi këtë vendim. Duket sikur çështja është pezull në Gjykatën e Apelit të Tiranës.

II. LEGJISLACIONI DHE PRAKTIKA E BRENDSHME PËRKATËSE

A. Kushtetuta e Shqipërisë

19. Pjesët përkatëse të Kushtetutës së Shqipërisë parashikojnë si më poshtë:

“Neni 42 § 2

Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.”

Neni 131

Gjykata Kushtetuese vendos për: ... (f) gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave.”

“Neni 142 § 3

Organet e shtetit janë të detyruara të zbatojnë vendimet gjyqësore.”

B. Akti i Gjykatës Kushtetuese (organizimi dhe funksionimi) (ligji nr.8577) i datës 10 shkurt 2000

20. Akti i Gjykatës Kushtetuese, në pjesën që lidhet me këtë çështje, parashikon si më poshtë:

“Neni 81 – Ekzekutimi i vendimeve

1. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë detyruese.
2. Ekzekutimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese sigurohet nga Këshilli i Ministrave nëpërmjet organeve përkatëse të administratës shtetërore.
3. Gjykata Kushtetuese mund të caktojë një tjetër organ përgjegjës për ekzekutimin e vendimeve të tij, dhe, sipas nevojës, dhe metodën e ekzekutimit të tij.
4. Personat që nuk zbatojnë ose parandalojnë zbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, kur veprimi i tyre nuk përbën një veprë penale, janë objekt i një gjobe (...) të vënë nga Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, vendimi i të cilit është përfundimtar dhe përbën një titull ekzekutiv.”

C. Jurisprudenca përkatëse e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë

1. Vendimi nr.6/06 i datës 31 mars 2006

21. Çështja kishte të bënte me një mosmarrëveshje pune, të ardhur si rezultat i heqjes së ankuesit nga puna. Gjykatat e brendshme vendosën për kthimin në punë të ankuesit dhe urdhëruan pagimin e pagave të tij të munguara. Përderisa përmbaruesit nuk ishin efektivë në zbatimin e vendimit përfundimtar kundër bashkisë, ankuesi iu drejtua në Gjykatën Kushtetuese.

22. Me anë të vendimit nr.6 të datës 31 mars 2006, Gjykata Kushtetuese, duke pasur parasysh vendimin e kësaj Gjykate në çështjen Qufaj Co. sh.p.k. kundër Shqipërisë (nr.54268/00, 18 nëntor 2004), vendosi se kishte shkelje të së drejtës së ankuesit për një proces të rregullt ligjor për shkak të moszbatimit të vendimit përfundimtar të Gjykatës. Gjithsesi, ankuesit nuk iu dha asnjë dëmshpërblim.

2. Vendimi nr. 43/07 i datës 13 nëntor 2007

23. Çështja kishte të bënte me moszbatimin e një vendimi të një gjykate të brendshme për pagimin e pagave të papaguara të ankuesit nga një njësi administrative e qeverisë vendore (këshilli i rrethit).

24. Gjykata Kushtetuese u shpreh se argument i palës së paditur për mungesë fondesh ishte i pamjaftueshëm dhe nuk mund të justifikonte mosplotësimin e detyrimit për ankuesin. Në vendim, në pjesët që lidhen me këtë çështje, thuhet:

“(…) Gjykata Kushtetuese nuk gjen ndonjë shkak të arsyeshëm që justifikon cenimin e së drejtës së ankuesit për një proces të drejtë ligjor, të shkaktuar nga moszbatimi nga autoritetet përkatëse të vendimit përfundimtar të gjykatës. Ajo është e mendimit se në procesin në fjalë pala debitoare ka pasur të gjitha mjetet e disponueshme gjatë të gjithë kohës, që prej datës së marrjes së vendimit e në vijim, për të paguar ankuesin në shumën e përcaktuar në vendimin e gjykatës. Për më tepër, gjatë shqyrtimit të çështjes, Gjykata Kushtetuese nuk mundi të dallonte masa konkrete të palës debitoare apo të shihte demonstrim prej saj të vullnetit për të zbatuar vendimin që rridhte nga vendimi i gjykatës.

Për më tepër, në lidhje me organin përgjegjës sipas ligjit për zbatimin e vendimeve të formës së prerë të gjykatave, pra përmbaruesit, Gjykata Kushtetuese shprehet se ata duhet të zbatojnë me korrektësi të gjithë legjislacionin përkatës procedural, pavarësisht nga fakti që pala debitoare është institucion shtetëror. Të gjitha palët, qoftë subjekte private ose publike, mbajnë të njëjtën përgjegjësi kur përballen me detyrimin për të zbatuar një vendim të formës së prerë të gjykatës.

Për të përfunduar, duke pasur parasysh arsyetimin e mësipërm, në proceset në fjalë, Gjykata Kushtetuese konstaton se moszbatimi i vendimit përfundimtar (...) të gjykatës përbën shkelje të së drejtës së ankuesit për proces të rregullt ligjor, siç parashikohet në nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 § 1 të Konventës.”

25. Gjithsesi, ankuesit nuk iu dha asnjë dëmshpërblim.

3. Vendimi nr.1/09 dhe 6/09 i datës 19 janar dhe 6 mars 2009

26. Vendimi nr.1/09 ka të bëjë me moszbatimin e një vendimi përfundimtar administrativ në lidhje me kthimin në punë të ankuesit dhe pagimin e pagave të humbura prej tij. Vendimi nr. 6/09 kishte të bënte me moszbatimin e një vendimi përfundimtar të gjykatës në lidhje me lirimin e një parcele toke.

27. Në të dyja vendimet, Gjykata Kushtetuese deklaroi se kishte pasur shkelje të së drejtës së ankuesit për akses në gjykatë për shkak të moszbatimit të një vendimi përfundimtar administrativ dhe për moszbatim të një vendimi të gjykatës. Gjykata Kushtetuese nuk urdhëroi rikthimin në punë të ankuesit në lidhje me vendimin nr.1/09. Asnjërit nga ankuesve nuk iu dha asnjë dëmshpërblim për dëme material ose jomateriale.

D. Kodi i Procedurës Civile

28. Pjesët përkatëse të Kodit të Procedurës Civile parashikojnë si më poshtë:

“Neni 451 – Vendimi i formës së prerë

Vendimi i gjykatës merr formë të prerë kur:

- a) nuk mund të bëhet ankim kundër tij;
- b) nuk është bërë ankim kundër tij brenda afateve të caktuara nga ligji ose kur ankesa është tërhequr;
- c) ankesa e paraqitur nuk është pranuar;
- d) vendimi i gjykatës është lënë në fuqi, ndryshuar ose është pushuar gjykimi në shkallë të dytë.

Neni 479 – Pezullimi i ekzekutimit të vendimit

Gjykata e Lartë pezullon ekzekutimin e vendimit kur:

- a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme;
- b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin e vendimit.”

Neni 510 – Titujt ekzekutivë

Ekzekutimi i detyrueshëm mund të bëhet vetëm në bazë të një titulli ekzekutiv.

Janë tituj ekzekutivë:

- a) vendimet civile të gjykatës që kanë marrë formë të prerë. ...

Neni 511 – Urdhri i ekzekutimit

“Titulli ekzekutiv vihet në ekzekutim me kërkesën e kreditorit. Për këtë qëllim lëshohet urdhri i ekzekutimit, i cili jepet:

- a) nga gjykata që ka dhënë vendimin në rastet e parashikuara në [nenin 510 (a)]; (...).”

LEGJISLACIONI

I. PRETENDIM PËR SHKELJE TË NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS

29. Ankuesi u ankua sipas nenit 6 § 1 të Konventës për moszbatim të vendimit të Gjykatës së Durrësit të datës 27 shtator 2005, që urdhëronte kthimin e tij në detyrë dhe të vendimit të Gjykatës së Rrethit të Durrësit të datës 24 tetor 2006, që urdhëronte pagimin e pagave të munguara për të.

Neni 6 § 1 i Konventës, në pjesët që lidhen me këtë çështje, parashikon si më poshtë:

“Në ushtrimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile, ... çdo person ka të drejtën e një procesi të drejtë ligjor ... nga [një] ... gjykatë ...”

A. Pranueshmëria

1. Moszbatimi i vendimit të Gjykatës së Rrethit të Durrësit të datës 24 tetor 2006 në lidhje me pagimin e pagesave të munguara

30. Qeveria u shpreh se ankuesi nuk kishte shteruar mjetet e brendshme juridike në lidhje me këtë ankim. Deri më sot, procesi është pezull në Gjykatën e Lartë (shih paragrafët 13–15 më lart).

31. Ankuesi pranoi se proceset ishin pezull para Gjykatës së Lartë, por pretendon se vendimi i Gjykatës së Apelit Durrës ishte i zbatueshëm. Gjykata e Lartë nuk kishte pezulluar zbatimin sipas nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile.

32. Në çështjen në fjalë, Gjykata vë re se vendimi i Gjykatës së Rrethit Durrës të datës 24 tetor 2006, i pranuar nga vendimi i Gjykatës së Apelit të Durrësit të datës 14 qershor 2007, njihte të drejtën e ankuesit për pagimin e pagesave të tij të munguara nga 9 korriku 2005 deri në datën e kthimit të tij në punë. Në përputhje me nenet 510(a) dhe 511(a) të Kodit të Procedurës Civile u lëshua një urdhër ekzekutimi. Ndërkohë, pala e paditur apeloj në Gjykatën e Lartë të dyja vendimet e gjykatave më të ulëta (shih paragrafin 15 më lart).

33. Në këto rrethana, Gjykata është e mendimit se vendimi i Gjykatës së Rrethit të Durrësit të datës 24 tetor 2006 nuk mund të konsiderohet përfundimtar dhe detyrues, pasi ai ishte i hapur për ankim. Në fakt, procesi i apelit është pezull para Gjykatës së Lartë. Edhe nëse një ankesë në Gjykatën e Lartë nuk ka efekt pezullues automatik dhe, pavarësisht nga kompetencat e Gjykatës së Lartë sipas nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, Gjykata kujton se neni 6 mbron zbatimin e vendimeve përfundimtare dhe detyruese, dhe jo vendimeve të cilat mund të jenë objekt i kontrollit të mëposhtëm të një gjykate të një niveli më të lartë, dhe, eventualisht, mund të rrëzohen (shih, për shembull, Ouzounis dhe të tjerë kundër Greqisë, nr. 49144/99, § 21, 18 prill 2002; Ioannis Karahalios kundër Greqisë (ven.), nr.62499/00, 26 shtator 2002; Xheraj kundër Shqipërisë, nr.37959/02, § 70, 29 korrik 2008).

34. Duke pasur parasysh proceset pezull në Gjykatën e Lartë, çfarë do të thotë që vendimi i Gjykatës së Rrethit Durrës nuk ka efekt *res judicata*, Gjykata është e mendimit se kjo ankesë nuk është e pranueshme, pasi është e parakohshme dhe duhet të rrëzohet sipas nenit 35 §§ 3 dhe 4 të Konventës.

2. Moszbatimi i vendimit të Gjykatës së Rrethit të Durrësit të datës 27 shtator 2005 në lidhje me kthimin në punë të ankuesit

35. Qeveria kontestoi zbatueshmërinë e nenit 6 § 1, duke u mbështetur në vendimin për çështjen Pellegrin kundër Francës ([GC] nr.28541/95, §§ 66-67, ECHR 1999-VIII). Prej saj u sqarua se mosmarrëveshjet që rrjedhin nga punësimi ndërmjet shtetit dhe nëpunësve të tij civilë, si rregull, nuk konsiderohen si “civile” në kuptimin e nenit 6 § 1 të Konventës.

36. Qeveria parashtroi gjithashtu se Gjykata Kushtetuese ishte një mjet juridik për t’u shteruar në lidhje me moszbatimin e një vendimi përfundimtar të gjykatës. Ata iu referuan vendimit të kësaj Gjykate në çështjen Qufaj Co. sh.p.k. kundër Shqipërisë, (nr.54268/00, § 42, 18 nëntor 2004), siç aplikohet nga Gjykata Kushtetuese (vendimet nr.6/06 dhe 43/07, shih paragrafët 21-27 më lart).

37. Gjykata thekson se neni 6 § 1 nën kokën “civile” të tij është i zbatueshëm për të gjitha mosmarrëveshjet që përfshijnë nëpunësit civilë, në përjashtim të rasteve kur legjislacioni i brendshëm përjashton shprehimisht aksesin në një gjykatë për postin ose kategorinë e stafit/personit

në fjalë, dhe kur ky përjashtim është i justifikuar me arsye objektive në interes të shtetit. Në parim nuk mund të ketë justifikim për përjashtim nga garancitë e nenit 6 të mosmarrëveshjeve të zakonshme të punës, të tilla si mosmarrëveshje që lidhen me pagat, dietat apo çështje të tilla të ngjashme, mbi bazën e natyrës së posaçme të marrëdhënies ndërmjet nëpunësit civil të veçantë dhe shtetit në fjalë (shih Eskelinen dhe të tjerët kundër Finlandës, nr.43803/98, § 62, 8 gusht 2006).

38. Duke iu kthyer çështjes në fjalë, Gjykata vë re se pretendimi civil i ankuesit u shqyrtua dhe u zgjidh nga gjykatat e brendshme sipas rregullave të zakonshme të procedurës civile. Ankuesi nuk u përjashtua nga legjislacioni i brendshëm nga “aksesi në gjykatë” brenda kuptimit të nenit 6 të Konventës. Bazuar në testin e zhvilluar në çështjen Eskelinen dhe të tjerë, cituar më lart, Gjykata arrin në përfundimin se neni 6 është i zbatueshëm në proceset e brendshme në fjalë.

39. Gjykata është e mendimit se çështja e shterimit të mjeteve të brendshme ligjore është e lidhur ngushtë dhe thelbësore për çështjen e efektivitetit të ankesës kushtetuese në lidhje me moszbatimin e një vendimi përfundimtar gjykatë, i cili është shqyrtuar sipas nenit 13 më poshtë (shih paragrafët 48-61 më poshtë).

40. Ajo konstaton se ky ankim nuk është haptazi i pabazuar në kuptimin e nenit 35 § 3 të Konventës. Ajo konstaton më tej se kërkesa nuk është e papranueshme për arsye të tjera. Si rezultat, ajo duhet deklaruar e pranueshme.

B. Themeli

1. Parashtrimet e palëve

41. Qeveria parashtroi se emërimi i ankuesit si Drejtor i Qendrës së Trajnimit Profesional në Durrës kishte qenë i paligjshëm. Si rezultat, ai ishte hequr nga puna.

42. Ankuesi deklaroi se vendimi i Gjykatës së Rrethit të Durrësit të datës 27 shtator 2005, i cili ishte bërë vendim i formës së prerë më datë 14 janar 2006, nuk ishte zbatuar, duke përbërë kështu shkelje të nenit 6 të Konventës. Përprjekjet e ndërmarra nga përmbartuesi kishin qenë të pamjaftueshme dhe jo efektive.

2. Vlerësimi i Gjykatës

43. Gjykata thekson se një vonesë e tejzgatur e paarsyeshme në zbatimin e një vendimi përfundimtar dhe detyrues mund të shkelë Konventën (shih Burdov kundër Rusisë, nr.59498/00, ECHR 2002-III). Arsyeshmëria e një vonesa të tillë duhet përcaktuar duke pasur parasysh në veçanti kompleksitetin e zbatimit të proceseve, sjelljen e vetë ankuesit dhe të organeve kompetente dhe masën dhe natyrën e dëmshpërblimit të përcaktuar nga gjykata (shih Raylyan kundër Rusisë, nr. 22000/03, § 31, 15 shkurt 2007).

44. Një person që ka marrë një vendim kundër shtetit mund të mos pritët të kërkojë një proces të posaçëm për zbatimin (shih Metaxas kundër Greqisë, nr. 8415/02, § 19, 27 maj 2004). Në raste të tilla, autoriteti i shtetit të paditur duhet njoftuar në kohë për vendimin dhe në këtë mënyrë të jetë i mirëpozicionuar për ta përmbushur vendimin ose për t’ia transferuar atë një tjetër autoriteti shtetëror që është përgjegjës për ekzekutimin.

45. Gjykata vë re se Qeveria nuk parashtroi ndonjë arsye bindëse për moszbatimin nga autoritetet përgjegjëse të vendimit të Gjykatës së Rrethit të Durrësit të datës 27 shtator 2005. Në lidhje me sugjerimin e Qeverisë se emërimi i ankuesit ishte i padrejtë, gjykatat e brendshme vendosën në favor të tij. Rreziku i çdo gabimi duhet t’i ngarkohet shtetit dhe ato (gabimet) nuk duhet të ndreqen në kurriz të individit përkatës (shih Xheraj, cituar më lart, § 58).

46. Autoritetet kombëtare duket se nuk kanë bërë përpjekje për t’i ofruar ankuesit një zgjidhje alternative, për shembull për t’i dhënë atij një tjetër pozicion të të njëjtit nivel. Nuk ka informacion për të dëshmuar se zbatimi përfshinte ndonjë kompleksitet specifik. Ankuesi nuk e pengoi zbatimin. Gjykata nuk gjen justifikim për këtë periudhë moszbatimi, e cila vijon dhe sot e kësaj dite dhe ka cenuar thelbin e të drejtës së ankuesit për një proces të rregullt në gjykatë.

47. Për arsyet e lartpërmenduar, Gjykata është e mendimit se ka shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës.

II. SHKELJE E NENIT 13 NË LIDHJE ME NENIN 6 § 1 TË KONVENTËS

48. Ankuesi nuk u ankua për mungesë të mjeteve ligjore të brendshme efektive në lidhje me moszbatimin e vendimeve në favor të tij.

49. Gjithsesi, Gjykata vë re se mungesa e efektivitetit të masave të brendshme ligjore përritet gjithnjë e më tepër përpara kësaj Gjykate në çështjet që lidhen me moszbatimin ose zbatimin e vonuar të vendimeve të brendshme të formës së prerë. Si rezultat, Gjykata ka vendosur me mocion të saj të shqyrtojë këtë çështje sipas nenit 13 të Konventës (shih, për shembull, Burdov kundër Rusisë (nr.2), nr.33509/04, §§ 89-117, 15 janar 2009; Beshiri dhe të tjerë kundër Shqipërisë, nr. 7352/03, 22 gusht 2006; dhe Qufaj Co. sh.p.k. kundër Shqipërisë, nr.54268/00, 18 nëntor 2004).

Neni 13 i Konventës thotë:

“Çdo personi, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e njohura nga kjo Konventë, ka të drejtë të paraqesë një ankim efektiv përpara një instance kombëtare dhe kur kjo shkelje është kryer nga persona që veprojnë brenda funksioneve të tyre zyrtare.”

A. Pranueshmëria

50. Gjykata është e mendimit se kjo ankesë nuk është haptazi e pabazuar brenda kuptimit të nenit 35 § 3 të Konventës. Ajo konstaton se kërkesa nuk është e papranueshme për shkak të ndonjë baze tjetër. Si rezultat, Gjykata e deklaron atë të pranueshme.

B. Themeli

1. Parashtrimet e palëve

51. Qeveria u shpreh se një ankim kushtetues është mjet efektiv ligjor në kuadrin e vendimit të Gjykatës në çështjen Qufaj Co. sh.p.k., të cituar më lart dhe në jurisprudencën e Gjykatës (shih paragrafët 21-27 më lart).

52. Ankuesi u shpreh se një ankim kushtetues rreth moszbatimit të një vendimi përfundimtar të gjykatës nuk është masë efektive, siç kërkohet në nenin 13 të Konventës. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese (shih paragrafët 21-27 më lart) u kufizuan në gjetjen e një shkeljeje të një natyre deklarative. Ata nuk parashikonin një mjet efektiv ligjor apo nuk e eliminuan vijimësinë e shkeljes përse i përket moszbatimit të një vendimi përfundimtar të gjykatës.

2. Vlerësimi i Gjykatës

A. Parimet e përgjithshme

53. Neni 13 i Konventës garanton disponueshmërinë në nivelin kombëtar të një mjeti ligjor për të zbatuar thelbin e të drejtave dhe lirive të Konventës në çdo lloj forme që mund të jetë parashikuar në rendin e tyre të brendshëm ligjor. Efekti i nenit 13 në këtë mënyrë kërkon ofrimin e mjeteve të brendshme juridike për të trajtuar përmbajtjen e një “ankese të diskutueshme” sipas Konventës dhe për të dhënë kompensimin e duhur (shih Kudla kundër Polonisë [GC], nr. 30210/96, § 157, ECHR 2000-XI).

54. Objekti i detyrimeve të shteteve kontraktuese sipas nenit 13 ndryshon në varësit të natyrës së ankimit të ankuesit; gjithsesi, mjeti juridik i nenit 13 ndryshon në varësi të natyrës së ankimit të ankuesit; gjithsesi, mjeti juridik i kërkuar nga neni 13 duhet të jetë “efektiv” si në praktikë, dhe në ligj (shih, për shembull, İlhan kundër Turqisë [GC], nr. 22277/93, § 97, ECHR 2000-VII) në kuptimin ose të parandalimit të shkeljes së pretenduar ose të vijimësisë së saj, ose të ofrimit të kompensimit të përshtatshëm për çdo shkelje të ndodhur (shih Kudla, cituar më lart, § 158).

B. Ankimi në çështjen në fjalë

55. Gjykata vë re se në sistemin ligjor shqiptar çdokush që mendon se i janë shkelur të drejtat e tij për një proces të rregullt ligjor, mund, nëse ka shteruar të gjitha mjetet e brendshme juridike, të depozitojë një ankim kushtetues në Gjykatën Kushtetuese sipas nenit 131 (f) të Kushtetutës.

56. Në vendimin e saj për çështjen Qufaj Co. sh.p.k. (cituar më lart, § 42), Gjykata konstatoi se:

“Gjykata Kushtetuese ishte kompetente për të trajtuar ankimin e shoqërisë tregtare të ankuesit në lidhje me moszbatimin e një vendimi përfundimtar si pjesë e juridiksionit të saj për të siguruar të drejtën e një gjykimi të drejtë”.

Ky element i së drejtës për një proces të drejtë ligjor u reflektua për herë të parë në vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.6/06 dhe më pas u pranua dhe në vendimet e saj nr.43/07, 1/09 dhe 6/09.

57. Në çështjen në fjalë, gjithsesi, Gjykata vë re se ankuesi nuk depozitoi një ankim kushtetues në Gjykatën Kushtetuese në lidhje me moszbatimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit të Durrësit të datës 27 dhjetor 2005. Gjykata duhet të përcaktojë nëse mjetet ligjore të sipërpërmendura kanë qenë “efektive” në kuptimin ose të parandalimit të shkeljes së pretenduar ose të vijimësisë së saj, ose të ofrimit të dëmshpërblimit të përshtatshëm për çdo shkelje të ndodhur.

58. Gjykata vë re se vendimet e Gjykatës Kushtetuese (shih paragrafët 21-27 më lart) njohën se ka një shkelje të së drejtës së ankuesit për akses në gjykatë lidhur me moszbatimin e vendimeve të gjykatave së brendshme. Gjithsesi, gjetjet e tyre ishin deklaruese në kuptimin që Gjykata Kushtetuese nuk ofroi ndonjë dëmshpërblim efektiv. Më specifikisht, ajo nuk dha ndonjë dëmshpërblim për dëme materiale e jo-materiale, dhe as që mundi të ofrojë një perspektivë të qartë për të parandaluar një shkelje të pretenduar ose vijimësinë e saj.

59. Për më tepër, Gjykata vë re se veprimet e përmbaruesit nuk ishin efektive në rastin në fjalë. Plus, Qeveria nuk konsideroi praninë e ndonjë mase alternative parandaluese, e cila, në rrethanat e kësaj çështjeje, do t'i ishte ofruar ankuesit.

60. Gjykata arrin në përfundimin se, si rrjedhim, ka shkelje të nenit 13 në lidhje me nenit 6 § 1 të Konventës.

61. Mbi këtë bazë, kundërshtimi paraprak i Qeverisë, bazuar në mosshkrimin e mjeteve të brendshme juridike, duhet të rrëzohet.

III. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

62. Neni 41 i Konventës parashikon:

“Kur Gjykata konstaton shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj, dhe nëse e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese mundëson vetëm ndreqje të pjesshme të pasojave që kanë rrjedhur nga kjo shkelje, Gjykata, nëse është e nevojshme, i jep palës së dëmtuar një shpërblim të drejtë”

A. Dëmi material

63. Ankuesi pretendoi 2,724,965 lekë (rreth 22,272 euro) në lidhje të dëmit material. Ai parashtroi shumën për pagën e munguar nga 9 korriku i 2005-ës deri më 31maji i 2008-ës, duke pasur parasysh vendimin e Gjykatës së Rrethit të Durrësit të datës 24 tetor 2006.

64. Qeveria parashtroi se procesi në lidhje me pagimin e pagave të munguara të ankuesit është pezull në Gjykatën e Lartë. Ajo i kërkoi Gjykatës të pezullojë shqyrtimin e nenit 41 deri në daljen e vendimit të Gjykatës së Lartë. Ndërkohë që qeveria u zotua se do të dërgonte një tabelë me vlerësimin e pagave të prapambetura të ankuesit, deri tani nuk është dhënë asnjë informacion për këtë gjë.

65. Gjykata rithekson se një vendim në të cilin ajo gjen shkelje ngarkon mbi shtetin e paditur një detyrim ligjor për të përfunduar shkeljen dhe për të bërë riparimin e pasojave të saj sipas Konventës (shih, për shembull, Beshiri dhe të tjerë kundër Shqipërisë, nr.7352/03, § 110, 22 gusht 2006).

66. Ndërmjet çështjeve që Gjykata merr parasysh kur vlerësohet kompensimi janë dëmi material (humbja që pësohet si rezultat i drejtpërdrejtë i shkeljeve të pretenduara) dhe dëmi jomaterial (dëmshpërblim për ankthin, problemet apo pasiguritë e vuajtura si rezultat i shkeljes) dhe dëme të tjera jomateriale (shih, ndërmjet të tjerash, Ernestina Zullo kundër Italisë, nr.64897/01, § 25, 10 nëntor 2004). Për më tepër, nëse një ose më shumë zëra dëmi nuk mund të përlllogariten saktë ose nëse dallimi ndërmjet dëmit material ose jomaterial është i vështirë të bëhet, Gjykata mund të vendosë të bëjë një vlerësim të përgjithshëm (shih Comingersoll kundër Portugalisë [GC], nr. 35382/97, § 29, ECHR 2000-IV).

67. Gjykata është e mendimit se çështja e dëmshpërblimit për moskthimin në detyrë të ankuesit mund të jetë e lidhur me procesin pezull para Gjykatës së Lartë në lidhje me pagat e humbura. Si rrjedhojë, Gjykata është e mendimit se çështja e zbatimit të nenit 41 në lidhje me dëmin material nuk është gati për vendim. Si rezultat, çështja duhet rezervuar dhe duhet të fiksohet procedura e mëtejshme në varësi të zhvillimeve të brendshme për procesin e pagave të munguara.

B. Dëmi jomaterial

68. Ankuesi kërkoi 1,500,000 lekë (rreth 12,260 euro) në lidhje me dëmin jomaterial. Qeveria nuk ra dakord me shumën e kërkuar nga ankuesi.

69. Gjykata pranon se ankuesi ka vuajtur nga stresi i cili mund të ishte shmangur nëse autoritetet do të kishin respektuar vendimin përfundimtar. Në këtë pikë, duke e bërë vlerësimin e saj mbi një bazë të barabartë, Gjykata i dha ankuesit 2,100 euro për dëmin jomaterial.

C. Kostot dhe shpenzimet

70. Ankuesi kishte marrë 850 euro si ndihmë ligjore nga Këshilli i Evropës në lidhje me prezantimin e kësaj çështje dhe kërkoi 162,194 lekë (rreth 1,277 euro) për shpenzimet ligjore të dala nga proceset e brendshme ligjore. Ai ofroi dokumente mbështetëse në lidhje me postimin, tarifat ligjore dhe taksën e paguar për përmbaruesin për zbatimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit të Durrësit të datës 24 tetor 2006. Ankuesi kërkoi 3,665 euro për shpenzimet për shqyrtimin e çështjes në Strasburg. Për këtë qëllim, ai dorëzoi një faturë.

71. Qeveria kontestoi pretendimet e ankuesit për kostot dhe shpenzimet, duke u shprehur se tarifat ligjore të brendshme dhe të Strasburgut nuk bazoheshin në fatura të tatueshme të njohura zyrtarisht.

72. Sipas jurisprudencës së Gjykatës, një ankues ka të drejtën e rimbursimit të kostove dhe shpenzimeve të tij vetëm për atë kohë sa është dëshmuar se këto kosto e shpenzime janë kryer realisht e kanë qenë të nevojshme dhe kur janë të arsyeshme në sasi (shih, për shembull, Xheraj, cituar më lart, § 85).

73. Në lidhje me kostot dhe shpenzimet për proceset e brendshme, Gjykata vë re se ajo është e kënaqur me tarifat e postimit siç janë pretenduar nga ankuesi. Ajo mendon se tarifat ligjore të dala në grupin e parë të proceseve ligjore janë të arsyeshme duke pasur parasysh informacionin që zotëron. Gjithsesi, ajo nuk pranon rimbursimin e tarifave ligjore dhe taksës së përmbaruesit për sa i përket grupit të dytë të proceseve, pasi e ka shpallur të papranueshme këtë ankim.

74. Në lidhje me kostot dhe shpenzimet për procesin në Gjykatën e Strasburgut, Gjykata vë re se kjo çështje nuk ishte komplekse. Për to, duke pasur parasysh jurisprudencën e saj, Gjykatës nuk ju desh kërkim i zgjeruar, dhe as nuk duhej ndonjë mbështetje e madhe në prova.

75. Në këto rrethana dhe duke pasur parasysh detajet e pretendimeve të parashtruara nga ankuesi, Gjykata i jep atij në lidhje me procesin e brendshëm dhe atë të Strasburgut 3,000 euro minus 850 euro të marra si ndihmë ligjore nga Këshilli i Evropës.

C. Interesi i munguar

76. Gjykata e mendon të arsyeshme se interesi i munguar duhet të bazohet në nivelin marxhinal të huasë së Bankës Qendrore Evropiane, mbi të cilën duhet të shtohen tre përqind.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, NË MËNYRË UNANIME:

1. *Deklaron* ankimin sipas nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje me moszbatimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit të Durrës, të datës 24 tetor 2006 të papranueshëm.

2. *Bashkohet* me themelin e kundërshtimit paraprak të Qeverisë në lidhje me mosshkrimin e mjeteve të brendshme juridike nga ankuesi për sa i përket vendimit të Gjykatës së Rrethit të Durrësit të datës 27 shtator 2005 dhe *e deklaron* pjesën tjetër të ankimit të pranueshëm.

3. *Vendos* se ka shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje me moszbatimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit të Durrësit të datës 27 shtator 2005.

4. *Vendos* se ka shkelje të nenit 13 në lidhje me nenin 6 § 1 të Konventës për sa i përket mungesës së mjeteve ligjore efektive për moszbatimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit të Durrësit të datës 27 shtator 2005 dhe rrjedhimisht *rrëzon* kundërshtimin paraprak të Qeverisë.

5. *Vendos*:

a) se shteti i paditur do t'i paguajë ankuesit, brenda tre muajsh nga data në të cilën vendimi bëhet përfundimtar sipas nenit 44 § 2 të Konventës, shumat e mëposhtme, të konvertuara në monedhën e shtetit të paditur, të aplikueshme në datën e pagimit:

i) 2,100 (dy mijë e njëqind) euro, plus çdo tatim që mund të vendoset në lidhje me dëmin jomaterial;

ii) 2,150 (dy mijë e njëqind e pesëdhjetë) euro, plus çdo tatim që mund të vendoset në lidhje me kostot dhe shpenzimet;

b) që prej skadimit të tremujorit të përmendur më lart deri në kryerjen e pagesës për ankuesin, do të paguhet interesa të thjeshtë mbi shumën e sipërpërmendur sipas një niveli interesi të barabartë me nivelin marxhinal të huasë së Bankës Qendrore Europiane gjatë periudhës së mospagimit, plus tre përqind.

6. *Vendosi* që çështja e zbatimit të nenit 41 të Konventës në lidhje me dëmin material nuk është gati për vendim.

Si rezultat:

a) *e rezervon* këtë çështje;

b) *fton* Qeverinë e paditur dhe ankuesit të parashtrojnë, brenda tre muajve në vijim nga data kur vendimi bëhet përfundimtar, në përputhje me nenin 44 § 2 të Konventës, vëzhgimet e tyre të shkruara për çështjen, dhe, në veçanti, të njoftojnë Gjykatën për zhvillimet e brendshme;

c) *rezervon* procedurën e mëtejshme dhe *i delegon* kryetarit të trupit gjykues kompetencën e fiksimit të kësaj çështjeje nëse është e nevojshme.

E bërë në anglisht dhe e njoftuar me shkrim në datën 29 shtator 2009, në përputhje me nenin 77 § 2 dhe 3 të rregullores së Gjykatës.

Lawrence Early
Sekretar

Nicolas Bratza
Kryetar

VENDIM
(Ankimi nr. 45265/04)
ÇËSHTJA AFERDITA HAMZARAJ KUNDËR SHQIPËRISË (NR. 2)

Kjo çështje është nxjerrë jashtë listës së gjykimit nga Gjykata Evropiane për arsye se ankuesja ka tërhequr ankimin pasi nuk ka mundur të provojë pretendimet e saj të argumentuara mbi të drejtën e brendshme lidhur me të drejtat pronësore.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i katërt), më 22 shtator 2009, e përbërë nga trupi gjykues:

Nicolas Bratza Kryetar

Giovanni Bonello

David Thór Björgvinsson

Ján Šikuta

Päivi Hirvelä

Ledi Bianku

Nebojša Vučinić gjyqtarë,

dhe Lawrence Early, regjistruar i seksionit,

duke pasur parasysh kërkesën e mësipërme të paraqitur më 27 nëntor 2004,

duke pasur parasysh vërejtjet e paraqitura nga qeveria e paditur dhe vëzhgimet në përgjigje të tyre të paraqitura nga ankuesja,

mbasi diskutimit të çështjes, vendosi si vijon:

FAKTET

Ankuesja, znj. Afrdita Hamzaraj është shtetase shqiptare e cila ka lindur në vitin 1926 dhe jeton në Vlorë. Ajo përfaqësohet para Gjykatës nga znj. M. Xibinaku. Qeveria Shqiptare ("Qeveria") është përfaqësuar nga agjenti i tyre, znj. E. Hajro.

A. Rrethanat e çështjes

Faktet e çështjes, të paraqitura nga palët, mund të përmbledhen si më poshtë.

Më 16 shkurt 1995 Gjykata e Rrethit Lushnjë ka njohur ekzistencën e të drejtave të pronësisë të nënës së ankuses mbi një ngastër toke prej 13.000 m² (vendim për vërtetim fakti). Ankuesja pretendon se, sipas ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronave ("Ligji i pronës"), dikur në vitin 1995 ajo paraqiti një kërkesë pranë Komisionit për Kthimin dhe Kompensimin e Pronës Lushnjë (zëvendësuar nga Agjencia për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave për arsye të Ligjit të Pronës të vitit 2006) duke kërkuar kthimin e pronës së hershme të nënës së saj. Nuk rezulton asnjë informacion i dokumentuar lidhur me zhvillimet nga viti 1995 deri në vitin 2007.

Më 28 shtator 2007, ankuesja paraqiti një kërkesë tjetër në Agjencinë Rajonale për Kthimin dhe Kompensimin e Pronës ("Agjencia"), duke kërkuar përsëri kthimin e pronës së hershme të nënës së saj.

Me një letër të datës 24 tetor 2007, ankuesja njoftoi Gjykatën se agjencia nuk i kishte dhënë ndonjë konfirmim për marrjen e kërkesës të saj. Ata as nuk i kishin dhënë ndonjë afat kohor për shqyrtimin e kërkesës.

Deri më sot, agjencia nuk ka marrë ndonjë vendim.

B. Legjislacioni i brendshëm përkatës dhe praktika

1. Ligji i pronës

Neni 22 i ligjit të pronës i vitit 1993, është shfuqizuar nga ligji i pronës i vitit 2004, i cili parashikonte kushtin se ekzistenca e të drejtave pronësore mund të njihet me vendim gjykatë në mungesë të dokumenteve zyrtare që do të paraqiten nga të interesuarit.

Neni 15 i ligjit të pronës i vitit 2006 parashikonte që "Agjencia për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave nuk do të marrë asnjë vendim në lidhje me kërkesat (aplikimet), pretendimet e të cilëve janë bazuara vetëm në një vendim gjyqësor për njohjen e faktit juridik, (Vendim gjyqësor të vërtetimit të faktit juridik të pronës) mbi një pronë të paluajtshme, brenda

kuptimit të nenit 388 të Kodit të Procedurës Civile. Të gjitha kërkesat (aplikimet) të bazuara në vendime të tilla do t'u kthehen palëve [pa kryer ndonjë veprim të mëtejshëm] brenda tridhjetë ditëve nga dorëzimi i kërkesës". Agjencia rajonale shqyrton një kërkesë brenda tre muajve nga dita e regjistrimit të saj. Ajo njofton kërkuuesin, me anë të një vendimi të arsyetuar, për çdo zgjatje të afatit kohor, i cili nuk duhet të tejkalojë tridhjetë ditë shtesë.

Neni 16 parashikon procedurën e ankimit që duhet të ndiqet kundër një vendimi të agjencisë rajonale që i njeh të drejtat e pronës kërkuuesit, kthimin apo kompensimin e saj. Ligji i pronës nuk përmban asnjë procedurë ankimi në lidhje me nenin 15 të saj, për rastet kur agjencia rajonale nuk ka marrë ndonjë vendim.

Dispozitat e tjera përkatëse të ligjit të pronës janë përshkruar në vendimet Gjonbocari kundër Shqipërisë (nr.10508/02, 23 tetor 2007); Driza kundër Shqipërisë (nr.33771/02, 13 nëntor 2007), dhe Ramadhi kundër Shqipërisë (nr. 38222/02, 13 nëntor 2007).

a) Vendimi i Këshillit të Ministrave mbi organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave (Vendimi nr. 566, datë 23 gusht 2006)

Vendimi përcakton skemën organizative të Agjencisë, e cila përbëhet nga 12 zyra rajonale. Ai parashikon procedurën e emërimit të stafit të saj menaxhues dhe detyrat e përgjegjësitë e tyre përkatëse.

b) Vendimi i Këshillit të Ministrave në mbledhjen, përpunimin dhe administrimin e kërkesave nga partitë e shpronësuara gjatë procesit të njohjes, kthimin dhe kompensimin e pronave (Vendimi nr. 747 të 9 dhjetorit 2006).

Vendimi parashikon listën e dokumenteve që kërkojnë të jenë pjesë e kërkesës së subjektit të shpronësuar për njohjen, kthimin dhe kompensimin e pronës. Kërkesa duhet dorëzuar në zyrën rajonale.

Në qoftë se kërkesa është e plotë, zyra rajonale i cakton një numër regjistrimi (protokolli). Në të kundërt, zyra rajonale ia kthen kërkesën personit të shpronësuar për paraqitjen e dokumenteve që mungojnë.

Vendimi nuk parashikon ndonjë afat kohor, brenda të cilit zyra rajonale duhet të shqyrtojë një kërkesë.

2. Kodi i Procedurës Civile

Neni 388 i Kodit të Procedurës Civile parashikon se çdo person i interesuar ka të drejtë të kërkojë me anë të një vendimi gjyqësor, njohjen (vërtetimin) e një fakti, kur akti që e vërteton atë është zhdukur, ka humbur dhe nuk mund të bëhet përsëri ose nuk mund të merret me ndonjë rrugë tjetër, me kusht që ky fakt është përcaktues për lindjen, ndryshimin ose shuarjen e të drejtave personale apo pasurore.

3. Praktika e brendshme

Praktika e brendshme e Komisionit për Kthimin dhe Kompensimin e Pronës (zëvendësuar nga Agjencia) ka qenë unike në atë që ajo duhej të vendoste njohjen e të drejtave të pronësisë së ankuesit mbi një ngastër toke, pasi kërkuesi zotëronte një vendim gjyqësor që i njihte fakti juridik të ekzistencës së të drejtave pronësore.

Gjykata e Lartë është shprehur mbi praktikën e Komisionit në disa nga vendimet e saj të fundit (për shembull, vendimin nr 746/2007 të datës 31 maj 2007, nr.15/2008 të datës 18 janar 2008, dhe vendimi nr.304/1998 i datës 29 maj 2008). Megjithatë, në vendimet e saj nr. 746/2007 të datës 31 maj 2007 dhe 98/2008 të datës 14 shkurt 2008 në lidhje me një mosmarrëveshje për pronën, Gjykata e Lartë ka shtuar se "një vendim gjyqësor i dhënë sipas nenit 388 të Kodit të Procedurës Civile nuk duhet të interpretohet si i detyrueshëm për autoritetet administrative, por si një dokument udhëzues për t'u mundësuar atyre që të marrin një vendim në përputhje me ligjin dhe dokumentet që ata zotërojnë". "Në vendimin nr. 749/2007 të datës 31 maj 2007, Gjykata e Lartë ka shtuar se "një vendim i tillë gjyqësor duhet të shqyrtohet nga agjencia në lidhje me dokumente të tjera shtesë që e mbështesin, dhe do të jetë agjencia që në fund do të vendosë të pranojë apo rrëzojë kërkesën e kërkuarit [në lidhje me njohjen e të drejtave të tij të pronësisë] .

ANKESA

Ankuesja, pa iu referuar ndonjë dispozitë të veçantë të Konventës, duket se e mbështet kërkesën e saj në nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës për aq sa autoritetet nuk i kanë njohur të drejtat pronësore të nënës së saj në bazë të vendimit të Gjykatës së Rrethit Lushnjë 16 shkurt 1995.

E DREJTA

Vërejtjet e qeverisë iu dërguan përfaqësuesit të ankueses me letrën e datës 15 qershor 2009, duke i kërkuar të dorëzojnë ndonjë vërejtje, së bashku me çdo kërkesë për dëmshpërblim deri me datë 25 korrik 2009.

Më 29 korrik 2009 përfaqësuesi i ankueses njoftoi Gjykatën me letrën e datës 14 korrik 2009 se ankuesja dëshironte të tërhiqte ankimin, pasi ajo nuk ishte në gjendje të provonte pretendimin e saj në lidhje me të drejtat e pronësisë.

Gjykata gjykon se, në këto rrethana, ankuesja mund të konsiderohet se nuk dëshiron të ndjekë ankimin e saj, brenda kuptimit të nenit 37 § 1 (a) të Konventës. Për më tepër, në përputhje me nenin 37 § 1 në fund, Gjykata nuk gjen asnjë rrethanë të veçantë në lidhje me respektimin e të drejtave të njeriut sikurse përcaktohen në Konventë dhe Protokollet e saj, të cilat kërkojnë shqyrtimin pa ndërprerje të çështjes. Për sa më lart, është e përshtatshme nxjerrja jashtë listës së gjykimit e këtij ankimi.

Për këto arsye, Gjykata njëzëri.

Vendos për nxjerrjen jashtë listës së gjykimit të këtij ankimi.

Lawrence Early
Regjistruar

Nicolas Bratza
Kryetar

VENDIM MBI PRANUESHMËRINË
(ANKIMI NR.12310/04)
ÇËSHTJA “ZYFLLI KUNDËR SHQIPËRISË”

STRASBURG
27 shtator 2005

Kjo çështje trajton aplikimin e ankuesit për shkelje të nenit 5.1(a) dhe Nenit 5 të Konventës. Ankuesi pretendon se ndalimi i tij për periudhën 2001-2005 ka qenë i paligjshëm dhe se nuk ka gëzuar asnjë të drejtë që zbatohet për kompensimin. Në këtë vendim Gjykata Evropiane ka ritheksuar se rregulli i shterimit të mjeteve të brendshme juridike, referuar nenit 35.1 të Konventës, i detyron ankuesit të përdorin mjetet juridike që janë normalisht të disponueshme dhe të mjaftueshme në sistemin e brendshëm ligjor. Ekzistenca e mjeteve juridike duhet të jetë e garantuar si në teori ashtu edhe në praktikë. E drejta për kompensim, në kuptimin e paragrafit 5, lind nëse autoritetet vendase apo gjykatat cënojnë të paktën njërin nga paragrafët paraprirës të nenit 5 të Konventës.

Në çështjen Zyfli kundër Shqipërisë,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i katërt), e mbledhur më 27 shtator 2005, me trup gjykues të përbërë prej:

sir Nicolas BRATZA *Kryetar*

z. J.CASADEVALL

z. M.PELLONPAA

z. R. MARUSTE

z. K.TRAJA

znj. L. MIJOVIC

z. J. SIKUTA *gjykatës*

dhe znj. F. ELENIS-PASSOS zëvendësregjistruar i seksionit,

duke pasur parasysh ankimin e mësipërm, depozituar më 27 janar 2004;

duke pasur parasysh informacionin mbi faktet e paraqitura nga pala shqiptare, me kërkesë të Gjyqtarit Relator, në bazë të nenit 49 § 2 (a) të rregullores së Gjykatës dhe komenteve në përgjigje të këtij informacioni, të paraqitura nga ankuesi,

pas shqyrtimit të ankimit, vendos si më poshtë:

FAKTET

Ankuesi, z.Bujamin Zyfli, është shtetas shqiptar i lindur në 1945. Në kohën e depozitimit të ankimit në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ai vuante dënimin në burgun e Krujës. Aktualisht jeton në qytetin e Devollit.

A. Rrethanat e çështjes

Siç janë parashtruar nga ana e ankuesit dhe nga pala shqiptare, rrethanat e çështjes, në bazë të nenit 49 § 2 (a) të rregullores së Gjykatës, mund të përmbledhen si më poshtë:

1. Parashtrimet e ankuesit

Më 3 prill 1989, ankuesi u arrestua dhe u akuzua për vrasje dhe armëmbajtje pa leje.

Më 25 maj 1989, Gjykata e Rrethit të Korçës e shpalli atë fajtor, duke e dënuar me njëzet vjet burg.

Nga periudha qershor 1989 deri në gusht 1992, ankuesi vuajti dënimin në burgun e Batërit dhe gjatë kësaj kohe iu kërkuar të kryente punë të detyrueshme në një minierë.

Nga viti 1992 deri në 1997 ai u transferua në tre burge të ndryshme.

Në bazë të ligjit “Për amnistinë” të 13 nëntorit 1989, ankuesit iu falën katër vjet, dhjetë muaj dhe dy ditë burg nga dënimi.

Në bazë të dekretit të faljes të nxjerrë në 28 dhjetor 1995, atij iu dha e drejta e uljes së dënimit me dy vjet.

Në 1996, ankuesi argumentoi se i ishin ulur dy vjet, tre muaj e gjashtë ditë nga dënimi, në bazë të dy dekreteve të faljes.

Më 13 mars 1997 ai u largua nga burgu, në kohën kur shteti nuk mbante dot burgjet nën kontroll dhe Shqipëria u përfshi nga trazirat.

Sipas ankuesit, ligji “Për amnistinë” i vitit 1997 i dha atij të drejtën e uljes së dënimit me dy vjet.

Më 11 shtator 2000 ai u dorëzua pranë autoriteteve, me qëllim vuajtjen e pjesës së mbetur të dënimit, i cili sipas ankuesit konsistonte në disa muaj.

Më 5 shkurt 2003 dhe 25 mars 2004, në vijim të kërkesave të ankuesit, Gjykata e Rrethit të Krujës, i dha gjithsej 6 muaj ulje dënimi për sjellje të mirë.

Në 2003, ankuesi depozitoi dy kërkesa pranë gjykatësit përgjegjës për ekzekutimin e dënimeve, për uljen e dënimit si më poshtë: a) nëntë muaj dhe gjashtëmbëdhjetë ditë që i korrespondojnë tre viteve punë të detyrueshme të vuajtura në burgun e Batërit; b) dy vjet, tre muaj dhe gjashtë ditë, në bazë të dy dekreteve të faljes të dhëna në 1996; c) një muaj që konsiston në periudhën e ndalimit të paraburgimit; dhe d) dy vjet në bazë të ligjit “Për amnistinë” i vitit 1997. Sipas ankuesit, ndalimi i tij pas vitit 2001 ka qenë i paligjshëm.

Në 22 tetor dhe 13 nëntor 2003, Gjykata e Rrethit të Krujës, vendosi të pushojë procedimet në lidhje me kërkesat e ankuesit për çështjet që duheshin hequr nga lista. Ankuesi nuk i apeloj vendimet e mësipërme.

2. Parashtrimet e palës shqiptare

Pas një kërkesë për informacion mbi faktet, në bazë të nenit 49 § 2 (a) të rregullores së Gjykatës, pala shqiptare deklaroi më 1 korrik 2004 se ankuesit i kishin mbetur për të vuajtur tetë muaj dhe katërmëdhjetë ditë nga dënimi.

Ata parashtruan se ankuesit i ishte dhënë e drejta e uljes së dënimit për periudhat e mëposhtme: a) dy vjet sipas dekretit të faljes së 28 dhjetorit 1995; b) katër vjet, dhjetë muaj e dy ditë në bazë të amnistisë së 13 nëntorit 1989; c) një muaj për ndalimin e paraburgimit; d) gjashtë muaj të dhëna nga gjykata vendase për sjellje të mirë; e) një muaj e njëzet ditë që i korrespondojnë trembëdhjetë ditëve punë të detyrueshme.

Për sa i përket pretendimit të ankuesit për ulje të dënimit mbi bazën e punës së detyrueshme, pala shqiptare parashtrroi se dosja e burgut të ankuesit specifikonte se gjatë tre viteve në burgun e Batërit ai kishte kryer gjithsej trembëdhjetë ditë punë të detyrueshme gjatë periudhës qershor - korrik 1989, duke fituar një ulje dënimi prej një muaj e njëzet ditësh.

Në lidhje me periudhën tjetër të vuajtjes së dënimit në burgun e Batërit, nuk ekziston në dosjen e burgut ndonjë dokument që të vërtetojë se ankuesi është konsideruar i aftë për të punuar në minierë. Megjithatë, pala shqiptare vëren se ankuesi nuk ka depozituar asnjë kërkesë për vërtetimin e fakteve pranë gjykatave vendase, me qëllim rishikimin e dosjes së burgut.

Sipas palës shqiptare, ankuesit nuk i është dhënë asnjë ulje dënimi në 1996, as nuk është kualifikuar për falje në bazë të ligjit “Për amnistinë” të vitit 1997.

3. Lirimi i ankuesit

Më 14 mars 2005, ankuesi u lirua nga burgu pas vuajtjes së dënimit.

B. Legjislacioni i brendshëm përkatës

1. Kodi i Procedurës Civile

Dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Civile vijnë si më poshtë:

Neni 388

“Kur nga një fakt varet lindja, ndryshimi ose shuarja e të drejtave personale apo pasurore të një personi dhe akti që vërteton atë është zhdukur, ka humbur dhe nuk mund të bëhet përsëri ose nuk mund të merret me ndonjë rrugë tjetër, personi i interesuar ka të drejtë të kërkojë që fakti të vërtetohet me vendim të gjykatës së shkallës së parë.”

2. Dekretet për falje dënimi

a) Në bazë të dekretit të faljes, të nxjerrë më 28 dhjetor 1995, Presidenti i Republikës, duke ushtruar të drejtën e faljes për personat e dënuar, vendosi që ankuesit t'i jepet e drejta e uljes së dënimit me dy vjet.

b) Në 1996, Presidenti i Shqipërisë, në bazë të kompetencave të tij të posaçme, nxori gjashtë dekrete për falje dënimi, por sipas palës shqiptare, ankuesi nuk ishte përfshirë në asnjërin prej tyre.

3. Ligji "Për amnistinë"

Neni 7 i ligjit "Për amnistinë" i 13 nëntorit 1989, parashikonte se të gjithë personat e dënuar në kohën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, gëzonin të drejtën e faljes së një të katërtës së dënimit të tyre.

ANKIMIMI

Duke u bazuar në nenin 5 § 1 (a) dhe 5 të Konventës, ankuesi pretendonte se ndalimi i tij nga viti 2001 deri në 2005 nuk kishte bazë ligjore. Ai gjithashtu pretendonte se nuk kishte gëzuar një të drejtë të zbatueshme për kompensim.

E DREJTA

Bazuar në nenin 5 § 1 (a) dhe 5 të Konventës, ankuesi u ankua se ndalimi i tij ishte i "paligjshëm" dhe se ai nuk gëzonte të drejtë të zbatueshme për kompensim.

Neni 5 i Konventës, për çështjen në fjalë, vijon si më poshtë:

"1. Çdokush ka të drejtën e lirisë e të sigurisë personale. Askujt nuk mund t'i hiqet liria, me përjashtim të rasteve që vijnë dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj:

a) kur burgoset ligjërisht, pas një dënimi të dhënë nga një gjykatë kompetente;

...

5. Çdo person, që arrestohet ose burgoset në kundërshtim me dispozitat e këtij neni, ka të drejtën e dëmshpërblimit."

a) Ankuesi

Ankuesi kundërshtoi arsyetimin e vendimeve të gjykatave vendase, të cilat sipas tij ishin absurde. Ai refuzoi të paraqiste ndonjë kërkesë pranë gjykatave për një pushim të procedimit dhe theksoi se i kishte nisur disa letra Presidentit të Republikës, Avokatit shqiptar të Popullit dhe politikanëve, duke pretenduar se ndalimi i tij ishte i paligjshëm, pasi periudha e dënimit të vendosur nga gjykatat kishte përfunduar.

Ankuesi pohoi se autoritetet nuk kishin mundur të përditësonin dosjen e tij të burgut gjatë transferimeve të shumta në burgje të ndryshme dhe se dosja ishte dëmtuar pjesërisht, kur shteti humbi kontrollin e burgjeve gjatë periudhës së trazirave në Shqipëri. Për pasojë, ndalimi i tij ishte zgjatur për shkak të neglizhencës së autoriteteve të burgut. Sipas ankuesit, ndalimi i tij nga viti 2001 deri në 2005, përmbledhej në ndalimin "sine titulo".

b) Vlerësimi i Gjykatës

Gjykata vëren fillimisht se ankuesi u ndalua në vitin 1989 pas "dënimit nga një gjykatë kompetente". Për pasojë, ndalimi i tij u realizua në lidhje me përcaktimet e nenit 5 § 1 (a). Nuk ka dyshim se dënimi me burgim ishte i ligjshëm në bazë të legjislacionit shqiptar. Gjithashtu, nuk mund të thuhet se ndalimi i ankuesit nuk ishte sipas qëllimit për të cilin privimi i lirisë lejohet, në bazë të nenit 5 § 1 (a). Përfundimisht, nuk ekziston asnjë e dhënë që të vërtetojë se dënimi i tij nuk ishte i bazuar në fakte apo se ishte arbitrar.

Pavarësisht nga fakti se ndalimi i ankuesit u krye në vitin 1989, d.m.th. përpara hyrjes në fuqi të Konventës në Shqipëri (2 tetor 1996), situata me të cilën ankuesi u përball, vazhdoi edhe pas datës së lartpërmendur. Pra, Gjykata ka juridiksion "ratione temporis" për të shqyrtuar nëse ndalimi, në bazë të pretendimit të ankuesit se periudha e burgimit të tij është keqlllogaritur, ishte i paligjshëm.

Gjykata rithekson se rregulli i shterimit të mjeteve të brendshme juridike, i referuar në nenin 35§1 të Konventës, i detyron ankuesit të përdorin mjetet juridike që janë normalisht të disponueshme dhe të mjaftueshme në sistemin e brendshëm ligjor, për t'iu dhënë mundësi atyre të adresojnë shkeljet e pretenduara. Ekzistenca e mjeteve juridike duhet të jetë e garantuar si në teori ashtu edhe në praktikë. Mungesa e kësaj garancie çon në mungesën e aksesit dhe efikasitetit të kërkuar. Neni 35 § 1 gjithashtu parashikon që para se të paraqiten në Gjykatën Europiane, ankimet duhet të

paraqiten në organet e brendshme përkatëse, duke respektuar kriteret e legjislacionit vendas sa i takon formës dhe përmbajtjes së ankimit, por nuk duhet të ndiqet një adresim i tillë për mjetet juridike që nuk janë të përshtatshme dhe efektive (shih *Aksoy v. Turkey*, nr.21987/93, §§ 51-52, ECHR 1996-VI, dhe *Akdivar and Others v. Turkey*, nr.21893/93, §§ 65-67, ECHR 1996-VI). Për më tepër, u takon autoriteteve vendase, veçanërisht gjykatave, që të interpretojnë legjislacionin vendas (shih *Garcia Ruiz v. Spain [GC]*, nr.30544/96, § 28, ECHR 1999-I).

Përsa i përket rastit në fjalë, Gjykata vëren se informacioni i paraqitur nga pala shqiptare në lidhje me dosjen e burgut të ankuesit, tregon se ka të dhëna për vetëm dy muaj nga tre vitet e dënimit që ai vuajti në burgun e Batërit.

Gjykata vëren se përgjegjësia për mbajtjen e të dhënave të duhura i takon administratës së burgut. Të dënuarit nuk duhet të cenohen nga pamundësia e tyre në mbajtjen e të dhënave të tilla, dhe për pasojë periudha e ndalimit të tyre nuk duhet të zgjatet.

Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se kur përballlet me një konflikt që ka të bëjë me rrethanat e sakta të çështjes, një shtet anëtar nuk mund të pretendojë të përmbushë detyrimet e tij sipas Konventës, nëse nuk paraqet të dhëna të plota të dosjeve të burgut. Në mungesë të dokumentacionit ose fakteve kundërshtuese, Gjykata mund të marrë për bazë deklaratimet e ankuesit (shih mutandis *Messina v. Italy*, vendimi i 26 shkurtit 1993, Seria A, nr. 257-H, § 31).

Duke pasur këtë fakt parasysh, Gjykata çmon se në rastin në fjalë, ajo nuk përballlet vetëm me një konflikt faktik që ka të bëjë me rrethanat e sakta të çështjes, por gjithashtu me një çështje të së drejtës, dhe për pasojë duhet të marrë një vendim mbi bazën e vendimeve të disponueshme të gjykatave vendase, ku përcaktohet nëse ankuesi ka kryer punë të detyrueshme gjatë vuajtjes së dënimit në burgun e Batërit apo është justifikuar për arsye shëndetësore.

Megjithatë, Gjykata vëren se në burgun e Batërit, të burgosurve u kërkohej të kryenin punë të detyrueshme në minierë, vetëm nëse ata plotësonin kushte specifike mjekësore (shëndetësore).

Gjykata çmon se është detyrë e gjykatave vendase të vendosin nëse ankuesi mund të kishte përfituar nga ligji “Për amnistinë” i vitit 1997 ose nëse ai ishte përfshirë në listën e të ndaluarve të cilët përfituan ulje dënimi në 1996.

Ankuesi nuk kundërshtoi as para Gjykatës së Apelit, as me një rekurs në Gjykatën e Lartë, përlllogaritjen e periudhës së dënimit që i duhet të vuante ose ligjshmërinë e vendimeve të Gjykatës së Rrethit. Edhe Gjykata, nuk mundi të gjejë ndonjë arsye pse të paktën një nga këto mjete juridike nuk ishte përdorur.

Gjykata konstaton se ankuesi për pasojë nuk ka ezauruar të gjitha mjetet e brendshme juridike brenda kuptimit të nenit 35 § 1 të Konventës, dhe për këtë arsye ankimi i tij sipas nenit 5 § 1 duhet të konsiderohet i papranueshëm sipas kuptimit të nenit 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës.

2. Gjykata rithekson se neni 5 § 5 zbatohet në ato raste, ku plotësohen kushtet për të kërkuar kompensim sa i takon privimit të lirisë të realizuar në kushte, që bien në kundërshtim me paragrafët 1, 2, 3 ose 4 (shih *Wassink v. the Netherlands*, vendimi i 27 shtatorit 1990, Seria A, nr.185-A, fq. 14, § 38; *Vachev v. Bulgaria*, nr.42987/98, § 78, ECHR 2004-VIII). Për pasojë, e drejta për kompensim, në kuptimin e paragrafit 5, lind nëse autoritetet vendase apo gjykatat cenojnë të paktën njërin nga paragrafët paraprirës të nenit 5.

Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se në çështjen në fjalë, ankimi sipas nenit 5 § 1, duhet të konsiderohet i papranueshëm. Më tej vëren se ankimi përkatës, sipas nenit 5 § 5, nuk mund të shqyrtohet nga Gjykata.

Për këto arsye, Gjykata njëzëri,

E deklaron ankimin si të papranueshëm.

F. ELENZ-PASSOS
Zëvendësregjistrues

Nicolas BRATZA
Kryetar

VENDIM
MBI PRANUESHMËRINË
(Ankimi NR.74727/01)
ÇËSHTJA “BALLIU KUNDËR SHQIPËRISË” (PRANUESHMËRIA)

Në këtë çështje ankuesi pretendon se bazuar në nenin 6 . 1 dhe 3 (c) dhe (d) të Konventës, i është mohuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, duke qenë se nuk është mbrojtur si duhet me ndihmë ligjore dhe nuk ka qenë në gjendje të pyesë disa dëshmitarë ose të kërkojë paraqitjen e dëshmitarëve në mbrojtje të tij. Gjykata konstaton se një ankesë në Gjykatën Kushtetuese të Shqipërisë mund të konsiderohet si mjet efektiv që duhet të përdoret për qëllimet e nenit 35 të Konventës kur trajtohen çështje që lidhen me një proces të rregullt ligjor. Duke pasur parasysh qëllimin e Konventës, për mbrojtjen e të drejtave që janë praktike dhe efektive, Gjykata ka konstatuar në mënyrë të vazhdueshme se shtetet nuk mund të jenë përgjegjëse për çdo të metë të avokatëve të caktuar për ndihmë ligjore, por në rrethana të veçanta të çështjes autoritetet kompetente duhet të marrin masa për të siguruar që ankuesit të gëzojnë efektivisht të drejtën për ndihmë ligjore falas që u njihet.

Në çështjen Taulant Balliu kundër Shqipërisë

Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut (Seksioni i tretë), e mbledhur më 27 maj dhe 30 shtator 2004, me trup gjykues të përbërë nga:

z.G.RESS *Kryetar*

z. I.CABRAL BARRETO

z.L.CAFLISCH

z.J.HEDIGAN

znj.M. TSATSA-NIKOLOVSKA

z.K.TRAJA

znj. A.GYULUMYAN *gjykatës,*

dhe z.Mark VILLIGER *zëvendësregjistrues i seksionit,*

duke marrë parasysh ankimin e mësipërm të depozituar më 3 gusht 2001;

duke marrë parasysh vëzhgimet e paraqitura nga pala shqiptare dhe vëzhgimet në përgjigje të tyre të paraqitura nga ankuesi;

duke marrë parasysh parashtrimet e palëve në seancën dëgjimore më 27 maj 2004;

pas shqyrtimit të ankimit vendos si më poshtë:

FAKTET

Ankuesi, z. Taulant Balliu, është shtetas shqiptar, lindur më 1971. Ai është aktualisht duke vuajtur një dënim me burgim në burgun e Bënçës-Tepelenë (Shqipëri). Ai është përfaqësuar para gjykatës nga z. P. Pavarini, një avokat që ushtron profesionin në Torino (Itali). Në sencën dëgjimore të mbajtur më 27 maj 2004, ankuesi është përfaqësuar nga z. Q.Gjonaj, z. B.Rusi, dhe z. L.Giabardo, këshilltarë. Pala shqiptare është përfaqësuar nga z. S.Puto, agjent, z. L. Bianku këshilltar dhe znj. H.Meçaj, asistente ligjore.

A. Rrethanat e çështjes

Faktet e çështjes, siç janë paraqitur nga palët mund të përmbledhen si më poshtë:

Gjatë procedimeve penale kundër bandave të armatosura që vepronin gjatë trazirave politike në Shqipëri nga marsi deri në shtator 1997, prokuroria e rrethit gjyqësor Elbasan akuzoi ankuesin si organizator të bandës së armatosur, të njohur si “Banda Kateshi”. Banda e stërvitur si komando ushtarake, synonte të merrte hakun për vrasjen e anëtarëve të bandës në konflikte me bandat e tjera dhe financohej duke u zhvatur para biznesmenëve të ndryshëm në atë zonë.

Në procedimet e mëtejshme penale, ankuesi është përfaqësuar para të gjitha gjykatave nga avokati D.Leli, që ushtron veprimtarinë e tij në Tiranë.

1. Procedimet penale

Në 1999 ankuesi u akuzua para Gjykatës së Rrethit Durrës për pesë vepra penale: për vrasje, dy për tentativë vrasje, një për mbajtje armësh ushtarake dhe një për krijim dhe pjesëmarrje në bandat e armatosura.

Avokati i ankuesit, z. Leli, ishte i pranishëm në seancat publike para gjykatës më 25 qershor 1999, 13 shtator 1999 dhe 10 dhjetor 1999. Megjithatë, gjatë periudhës nga data 10 dhjetor 1999 deri më 15 shkurt 2000, avokati nuk i siguroi ndihmë ligjore dhe ankuesit nuk iu caktua kryesisht një avokat. Ankuesi parashitroi se në seancat e asaj periudhe, prokuroria kishte thirrur dëshmitarë kundër tij, kishte marrë në pyetje dëshmitarët që ishin të pranishëm dhe kishte paraqitur prova të tjera kundër tij. Avokati i ankuesit kishte thirrur dy dëshmitarë në favor të ankuesit, por ata nuk u paraqitën në gjyq.

Sipas pretendimeve të ankuesit, asnjë avokat mbrojtës nuk i ka ofruar atij ndihmë ligjore gjatë kësaj faze, në të cilën palët kanë bërë parashtrimet e tyre përfundimtare. Në këtë kontekst, siç është pasqyruar edhe në procesverbalin e seancave gjyqësore, avokati i ankuesit ka munguar në seancë pa arsye dhe ankuesi ka refuzuar të paraqesë vetë parashtrimet e tij përfundimtare të mbrojtjes. Në një rast të tillë, ankuesi është ankuar dhe i ka kërkuar gjykatës t'i caktojë atij kryesisht një avokat mbrojtës, por nuk ka marrë përgjigje.

Sipas parashtrimeve të shtetit shqiptar, seancat e gjykatës së shkallës së parë zgjatën shtatë muaj dhe u organizuan 21 seanca gjyqësore. Seancat gjyqësore ishin shtyrë në shumë raste si rezultat i mungesës së pajustifikuar të avokatëve, veçanërisht të avokatit mbrojtës të ankuesit. Ky i fundit mungonte gjatë shtatë seancave gjyqësore të njëpasnjëshme, pa dhënë asnjë arsye.

Në tërësi, në të vërtetë ishin zhvilluar vetëm njëmbëdhjetë seanca, kurse dhjetë të tjera ishin shtyrë për shkak të mungesës së avokatit mbrojtës. Kështu, gjykata vendosi caktimin e një mbrojtësi kryesisht, i cili ishte i pranishëm në seancën që u zhvillua më 28 janar 2000. Megjithatë, ankuesi refuzoi të mbrohej nga një avokat që nuk ishte i zgjedhur prej tij. Për këtë arsye, gjykata e shkarkoi avokatin mbrojtës të caktuar kryesisht prej saj dhe vazhdoi procedimin në prani të ankuesit, por pa avokat mbrojtës.

Më 15 shkurt 2000, Gjykata e Rrethit Durrës e shpalli fajtor ankuesin dhe e dënoi atë me burgim të përjetshëm.

Më 21 shkurt 2000, ankuesi depozitoi ankimin pranë Gjykatës së Apelit Durrës, kundër vendimit të dhënë më 15 shkurt 2000. Ai pretendonte se gjatë gjykimit në Gjykatën e Rrethit, atij i ishte mohuar e drejta për një gjykim të drejtë, sepse nuk kishte pasur ndihmë ligjore nga një avokat mbrojtës gjatë dy muajve të parë të gjykimit. Një avokat i tillë do të kishte bërë të mundur përgatitjen e mbrojtjes së tij dhe do kishte thirrur dëshmitarë në mbrojtje të tij. Ai pretendonte se nuk kishte pasur avokat mbrojtës, as në paraqitjen e kërkesave të tij përfundimtare. Ai gjithashtu pretendonte se kishte qenë jashtë shtetit gjatë kohës kur ishin kryer disa nga krimet për të cilat ai ishte akuzuar, duke paraqitur dhe vula doganore të vendosura në pasaportën e tij për të provuar se ai ishte larguar jashtë vendit. Në apelimin e tij, ankuesi nuk kërkojë marrjen në pyetje të dëshmitarëve të tjerë.

Më 19 prill 2000, Gjykata e Apelit la në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit të datës 15 shkurt 2000, duke bërë disa ndryshime lidhur me dënimet e dhëna për disa nga veprat penale. Këto ndryshime nuk ndryshuan vendimin e dënimit me burgim të përjetshëm.

Më 19 maj 2000, ankuesi depozitoi ankimin në Gjykatën e Lartë, duke pretenduar shkelje të të drejtave të tij kushtetuese, duke qenë se i ishte mohuar e drejta për t'u përfaqësuar me avokat gjatë procedimit. Ai ankohej veçanërisht se megjithëse nuk kishte pasur përfaqësim të duhur, Gjykata e Rrethit kishte proceduar me marrjen në pyetje të dëshmitarëve kundër tij dhe kishte marrë në konsideratë dhe prova të tjera.

Më 7 dhjetor 2000, Gjykata e Lartë la në fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit mbi bazën e arsyetimit të mëposhtëm:

“Shkeljet e paraqitura nga ankimuesi ishin njohur dhe ndrequr nga Gjykata e Apelit, pa pasur ndonjë ndikim thelbësor në përmbytjen e vendimit të shkallës së parë. Gjatë periudhës së

paraburgimit, ashtu dhe gjatë procesit gjyqësor, të paditurit i ishte ofruar ndihmë ligjore. Gjykata arsyetonte se mungesa e pajustificuar e avokatit mbrojtës, në marrëveshje me të paditurin, për të shtyrë gjyqin, nuk mund të sillte si pasojë pavlefshmërinë absolute të një vendimi të Gjykatës së Rrethit.”

2. Procedimet në Gjykatën Kushtetuese

Më pas, ankuesi, mbështetur në nenin 131 (f) të Kushtetutës, depozitoi një ankim pranë Gjykatës Kushtetuese. Më 19 prill 2001, Gjykata Kushtetuese, në përputhje me nenin 31 të ligjit nr.8577 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, datë 10 shkurt 2000, vendosi *de plano* të deklarojë ankimin të papranueshëm si “jashtë juridiksionit të saj”.

B. Legjislacioni i brendshëm përkatës

1. Kushtetuta

9. Dispozitat përkatëse të Kushtetutës së Shqipërisë parashikojnë:

Neni 31

“Gjatë procesit penal kushdo ka të drejtë:

...

ç) të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij; të komunikojë lirisht dhe privatisht me të, si dhe t’i sigurohet mbrojtja falas, kur nuk ka mjete të mjaftueshme;

d) t’u bëjë pyetje dëshmitarëve të pranishëm dhe të kërkojë paraqitjen e dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.

Neni 42

“1. Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor.

2. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. ”

Neni 131

Gjykata Kushtetuese vendos për:

(...)

f) gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

2. *Gjykata Kushtetuese (organizimi dhe funksionimi)*, ligji nr. 8577 i datës 10 shkurt 2000

Shqyrtimi paraprak i kërkesës

1. Kërkesa shqyrtohet paraprakisht nga kolegji i përbërë nga 3 gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, ku bën pjesë dhe relatori.

2. Kur kërkesa, megjithëse është në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese dhe është paraqitur nga subjekti që legjitimohet, nuk është e plotë, kolegji ia kthen kërkesit për plotësim, duke treguar shkaqet e kthimit dhe afatin e plotësimit të saj. Pas kësaj, kur kërkesa paraqitet e plotësuar, kalon përsëri për shqyrtim paraprak në kolegji. Kërkesa e paplotësuar nuk merret në shqyrtim.

3. Kur kërkesa është paraqitur nga subjekti që legjitimohet dhe çështja është në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese, kolegji vendos kalimin e çështjes në seancë plenare, ndërsa kur ajo nuk është paraqitur nga subjekti që legjitimohet ose çështja nuk është në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese, kolegji vendos moskalimin e çështjes në seancë plenare. Në të gjitha rastet, kur ndonjë nga gjyqtarët e kolegjit nuk është i një mendimi me të tjerët, kërkesa i kalon për shqyrtim paraprak

Mbledhjes së Gjyqtarëve, e cila vendos me shumicë votash për kalimin ose jo të çështjes në seancë plenare.

4. Në të gjitha rastet e mësipërme, kolegji ose Mbledhja e Gjyqtarëve nuk shqyrton zgjidhjen në themel të çështjes.

3. Kodi i Procedurës Penale

Neni 49

Mbrojtësi i caktuar

5. Kur kërkohet prania e mbrojtësit dhe mbrojtësi i zgjedhur ose i caktuar nuk është siguruar, nuk është paraqitur ose e ka lënë mbrojtjen, gjykata ose prokurori cakton si zëvendësues një mbrojtës tjetër, i cili ushtron të drejtat dhe merr përsipër detyrimet e mbrojtësit.

6. Mbrojtësi i caktuar mund të zëvendësohet vetëm për shkaqe të përligjura.

Ai i pushon funksionet kur i pandehuri zgjedh mbrojtësin e tij.

7. Kur i pandehuri nuk ka mjete të mjaftueshme, shpenzimet e bëra për mbrojtjen paguhen nga shteti.

4. Praktika e Gjykatës Kushtetuese lidhur me të drejtën për proces të rregullt ligjor

Gjykata Kushtetuese është e ngarkuar të vendosë, lidhur me ankesat kushtetuese të bëra nga individët që pretendojnë shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë. Gjykata Kushtetuese e ka zgjeruar kuptimin e së drejtës për gjykim të drejtë, e cila tani përfshin edhe disa të drejta shtesë.

Që nga krijimi i Gjykatës Kushtetuese më 1992, kjo gjykatë ka vendosur mbi një sërë çështjesh që kanë të bëjnë me procesin e rregullt ligjor, veçanërisht pas vitit 1998, kur Kushtetuta e re ka hyrë në fuqi. Gjykata e ka konsideruar mbrojtjen e të akuzuarit nëpërmjet ndihmës ligjore, si një element të gjykimit të drejtë.

Një përshkrim statistikor i paraqitur nga qeveria tregon se më 2002, Gjykata Kushtetuese ka vendosur për 243 kërkesa, 197 prej të cilave janë konsideruar të papranueshme *de plano*. Në 2003 gjykata ka vendosur mbi 279 kërkesa, 240 prej të cilave janë deklaruar të papranueshme *de plano*. Në 2002 dhe në 2003, 37 nga çështjet që janë deklaruar të pranueshme, kanë pasur të bëjnë me të drejtën për një proces të rregullt ligjor.

P.sh. në çështjen e Ilir Sulës, Gjykata Kushtetuese ka gjetur shkelje të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, pasi mbrojtësi i të pandehurit është lejuar të marrë pjesë në gjykimin e zhvilluar pranë Gjykatës së Lartë, pa qenë i pajisur sipas rregullit me akt përfaqësimi të lëshuar në format e parashikuara nga ligji (Vendimi nr. 20, datë 18 prill 2000).

Në rastin e Elezi Zydi, Gjykata Kushtetuese e ka shfuqizuar vendimin e Gjykatës së Lartë, pasi ankuesi nuk ka qenë i mbrojtur ashtu siç duhet për shkak të mungesës së mbrojtjes në procedimet para Gjykatës së Lartë (Vendimi nr.44, datë 18 korrik 2000).

Në rastin e Hyqmet Pishës, Gjykata Kushtetuese ka arsyetuar që bazuar në nenin 42 të Kushtetutës Shqiptare, është e një rëndësie thelbësore për një proces të rregullt, mbrojtja e duhur e të akuzuarit gjatë gjykimit (vendimi nr. 5, datë 17 shkurt 2003).

Në rastin e Halil Dautit, Gjykata Kushtetuese, duke iu referuar dhe praktikës së mëparshme, ka arsyetuar se mbrojtja e të akuzuarit nga një avokat mbrojtës që ka konflikt interesash, përbën shkelje të së drejtës për një proces të rregullt ligjor (Vendimi nr. 9, datë 28 prill 2004).

PRETENDIMET

Ankuesi pretendon, bazuar në nenin 6 § § 1 dhe 3 (c) dhe (d) të Konventës, se i është mohuar e drejta për një proces të rregullt ligjor. Ai argumenton që në mënyrë të veçantë, mungesa e avokatit mbrojtës në faza të caktuara të procesit gjyqësor, ka shkelur të drejtën e tij për t'u mbrojtur me ndihmë ligjore. Për më tepër, për shkak të mungesës së avokatit, ai nuk ka pasur mundësi të pyesë dëshmitarë, të cilët ishin të pranishëm ose të kërkojë paraqitjen e dëshmitarëve, ekspertëve dhe personave të tjerë në emër të tij.

E DREJTA

Ankuesi është ankuar sipas nenit 6/1 dhe 3c dhe 3d të Konventës, që atij i është mohuar e drejta për një proces të rregullt gjyqësor, pasi ai nuk kishte qenë i mbrojtur siç duhet me avokat dhe që nuk ka qenë në gjendje të pyesë dëshmitarë të caktuar.

Në pjesët përkatëse, neni 6 i Konventës parashikon:

Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësishtnga një gjykatë e pavarur,e cila do të vendosë për bazueshmërinë e çdo akuze të natyrës penale që i është drejtuar.

3. Çdo i akuzuar ka, së paku, të drejtat e mëposhtme:

...

c. të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij dhe, në qoftë se ai nuk ka mjete për të shpërblyer mbrojtësin, t'i mundësohet ndihma ligjore falas nga një avokat i caktuar, kryesisht kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë;

d. të pyesë ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës;

A. Kundërshtimi i qeverisë

Qeveria argumentoi se ankimi është i papranueshëm, pasi është depozituar pas kalimit të afatit 6-mujor, sipas nenit 35/1 të Konventës. Në këtë mënyrë, duke u bazuar në karakterin diskrecionar të procedimeve në Gjykatën Kushtetuese dhe në papranueshmërinë *de plano* të kësaj të fundit mbi vendimin lidhur me këtë rast, mjeti i fundit efektiv i ankimit, sipas kuptimit të kësaj dispozite, ishte në fakt vendimi i Gjykatës së Lartë më 7 dhjetor 2000, ndërsa ankuesi e ka paraqitur kërkesën e tij më 3 gusht 2001.

Qeveria argumentoi se një ankim mund të sillet në mënyrë të vlefshme para Gjykatës Kushtetuese vetëm atëherë kur një sistem gjyqësor ka dështuar të identifikojë dhe të adresojë shkeljen e së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Për rrjedhojë, mekanizmi i ankimit sipas nenit 131/f të Kushtetutës për individët para Gjykatës Kushtetuese, ka karakter subsidiar. Mekanizmi i ankimit përpara Gjykatës vihet në lëvizje vetëm në rast se mjetet e mëparshme të ankimit, të marra si një e tërë, kanë neglizhuar të sigurojnë respektimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, siç parashikohet në nenin 135 të Kushtetutës. Ankuesi ka paraqitur për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese, tërësinë e procedurave nga Gjykata e Rrethit deri në Gjykatën e Lartë. Siç rezulton dhe nga praktika, Gjykata Kushtetuese ka ndërhyrë për rrëzimin e vendimeve të Gjykatës së Lartë, vetëm kur kjo e fundit ka dështuar të respektojë mbrojtjen kushtetuese të të drejtave të individit për një proces të rregullt gjyqësor. Në rastin konkret, Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se procedurat në tërësinë e tyre kanë qenë të drejta dhe për rrjedhojë ka marrë vendim për papranueshmërinë *de plano* të kërkesës.

Më tej, duke iu referuar nenit 35 të Konventës, autoritetet shtetërore argumentuan se në vlerësimin e situatës duhet të merret për bazë dhe konteksti ligjor dhe politik i një vendi. Në kontekstin ligjor shqiptar, një apelim në Gjykatën Kushtetuese nuk është një mjet efektiv që ofron ndryshime të qarta e të sigurta për ndreqjen e situatës dhe për pasojë të mos ezaurohet sipas qëllimit të nenit 35/1 të Konventës. Qeveria i referohet në mënyrë të veçantë vëzhgimit të praktikës së Gjykatës Kushtetuese, nga e cila rezulton që nga viti 2002 deri në 2003, kjo Gjykatë ka deklaruar të pranueshme vetëm 37 ankime që kanë të bëjnë me të drejtën për një proces të rregullt ligjor.

Ankuesi është përgjigjur duke iu referuar nenit 131/f të Kushtetutës dhe praktikës së Gjykatës Kushtetuese, që në mënyrë që të ezaurohen të gjitha mjetet e brendshme të ankimit në sistemin vendas, individët duhet të ankohen në Gjykatën Kushtetuese, atëherë kur ata pretendojnë shkelje të së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Për më tepër, e drejta për avokat mbrojtës përfshihet në kuptimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, gjë e cila konstatohet dhe nga praktika e Gjykatës Kushtetuese. Kjo e fundit ka kompetencën dhe detyrimin për të shqyrtuar rastin dhe për të marrë një vendim, në rast se do të ishte e nevojshme. Si rrjedhojë, ankuesi pretendon që ai e ka depozituar kërkesën në Gjykatën Europiane në kohë, pasi vendimi i Gjykatës Kushtetuese i përkiste datës 19 prill 2001, edhe pse ishte një vendim papranueshmërie *de plano*.

Gjykata thekson se rregulli i ezaurimit të mjeteve të brendshme efektive, i parashikuar në nenin 35/1 të Konventës, i detyron ata që kërkojnë të sjellin rastin e tyre kundër shtetit para një organi arbitrazhi ose organi gjyqësor ndërkombëtar, të përdorin fillimisht mjetet e ankimit të parashikuara në sistemin ligjor vendas. Për rrjedhim, shtetet s'janë të detyruara të përgjigjen për veprimet e tyre para një gjykate ndërkombëtare më parë se ata të kenë pasur mundësinë për ta trajtuar çështjen në sistemin gjyqësor vendas. Rregulli është bazuar në supozimin e reflektuar në nenin 13 të Konventës - me të cilën ka ngjashmëri - që duhet të ketë patjetër një mjet ankimi efektiv lidhur me pretendimin e shkeljeve të të drejtave në sistemin e brendshëm, pavarësisht nëse dispozitat e Konventës janë ose jo pjesë përbërëse e sistemit të brendshëm ligjor. Për rrjedhim, ky rregull është një aspekt i rëndësishëm i parimit që mekanizmi mbrojtës i krijuar nga Konventa është subsidiar në lidhje me sistemin e brendshëm të mbrojtjes së të drejtave të njeriut (Akdivar and others.v. Turkey, vendim dt. 16 shtator 1996, raporte të vendimeve dhe gjykimeve 1996-IV, p.1210/ 65). Nga parimi i subsidiaritetit, të përmendur më sipër, rrjedh që gjykatat kombëtare duhet të interpretojnë dhe të zbatojnë kur është e mundur të drejtën vendase në përputhje me Konventën.

Duke iu referuar rrethanave konkrete të çështjes, Gjykata vëren se vendimi i 19 prillit 2001 i Gjykatës Kushtetuese, që deklaroi kërkesën e ankuesit si të papranueshme, nuk ofroi arsytim tjetër, përveçse atij që kërkesa ishte “jashtë juridiksionit të saj”. Në këtë këndvështrim, çështja shtrohet nëse kërkesa kushtetuese e ankuesit përbën një mjet juridik efektiv në sistemin e brendshëm.

Gjykata vëren si fillim, se e drejta për mbrojtje ligjore në procesin penal – që përbën dhe thelbin e ankimit të kërkesit para Gjykatës, është parashikuar si një e drejtë kushtetuese në nenet 31 dhe 42 të Kushtetutës dhe kjo pasqyrohet relativisht dhe në praktikën e gjykatave shqiptare. Për më tepër, sipas nenit 131 të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve që pretendojnë ndër të tjera, shkelje të së drejtës së tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor. Ky mjet efektiv është përjashtimor, duke qenë se Gjykata Kushtetuese nuk e shqyrton çështjen në tërësi; juridiksioni i saj është i kufizuar në shqyrtimin e shkeljes së pretenduar për një të drejtë të veçantë kushtetuese, si ajo e procesit të rregullt ligjor. Në anën tjetër, ashtu sikurse autoritetet shqiptare kanë theksuar në përmbushje të këtij qëllimi, Gjykata Kushtetuese shqyrton në tërësi procesin, nga procedurat në gjykatën e shkallës së parë deri në procedurat para Gjykatës së Lartë. Nuk ka asnjë diskutim ndërmjet palëve, që vendimi që merret nga Gjykata Kushtetuese, e cila ka kompetencë të rrëzojë vendimet e gjykatave më të ulta, është ligjërish i detyrueshëm për t'u zbatuar. Në këtë kontekst, gjithashtu, Gjykata vlerëson se nga statistikat e siguruara nga pala shqiptare, rezulton që Gjykata Kushtetuese ka shqyrtuar dhe mbështetur një numër të konsiderueshëm ankimesh, të cilat janë regjistruar në vitet 2002 dhe 2003 dhe që kanë pasur të bëjnë me të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Duket qartë që në këtë rast nuk bëhet fjalë thjesht për një mjet efektiv diskrecionar, në vlerësimin e Gjykatës Kushtetuese. Së fundi, duke qenë se kërkesa e ankuesit është konsideruar jo e plotë, Gjykata Kushtetuese, në vend që ta konsideronte atë të papranueshme, mund t'ia kthente sërish ankuesit për ta plotësuar sipas kërkesave të paragrafit 31 të ligjit nr.8577 për Gjykatën Kushtetuese (organizimi dhe funksionimi).

Kështu, në vlerësimin e Gjykatës Europiane, në këtë rast Gjykata Kushtetuese është vënë në lëvizje për të shqyrtuar kërkesën kushtetuese të ankuesit, të cilin ajo e hodhi poshtë pasi shqyrtoi faktet e çështjes në kuadrin e së drejtës kushtetuese të ankuesit për një proces të rregullt ligjor.

Si rrjedhim, ankimi kushtetues në Gjykatën Kushtetuese shqiptare mund të konsiderohet një mjet efektiv ankimi, ezaurimi i të cilit kërkohet, në kuptimin e nenit 35 të Konventës. Faktikisht, ankuesi e ka ezauruar këtë mjet. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese daton më 19 prill 2001 dhe ankuesi ka paraqitur ankimin e tij më 3 gusht 2001. Ai në këtë mënyrë, është brenda afatit kohor prej 6 muajsh, sipas nenit 35. Për këto arsye, Gjykata e hedh poshtë kundërshtimin e autoriteteve shtetërore.

B. Themeli

Ankuesi ka pretenduar fillimisht që në procesin penal kundër tij, ai nuk ka qenë i përfaqësuar si duhet nga një mbrojtës, siç kërkohet nga neni 6/1 dhe 3c të Konventës.

Qeveria ka argumentuar se që nga periudha e hetimeve e më tej, dhe veçanërisht gjatë gjykimin, ankuesi ka pasur çdo mundësi për të ushtruar të drejtën e tij për një gjykim të drejtë dhe në

mënyrë të veçantë të përfaqësohej nga një avokat. Në këtë mënyrë pavarësisht nga mungesa e vazhdueshme dhe e pajustificuar e mbrojtësit të tij, Gjykata e Rrethit ka shtyrë seancat gjyqësore në disa raste, duke i dhënë mundësinë avokatit për t'u paraqitur. Në dosjen e gjykatës nuk ka asnjë deklaratë, sipas së cilës mbrojtësi i ankuesit ka pushuar së përfaqësuari ankuesin. Gjykata e Rrethit i ka caktuar ankuesit një avokate të caktuar kryesisht, sipas skemës së ndihmës ligjore. Kur kjo e fundit është paraqitur më 28 janar 2000, ankuesi ka deklaruar se ai dëshironte të kishte avokatin e tij dhe nuk ka pranuar të mbrohej nga një avokat i caktuar kryesisht nga Gjykata.

Sipas vlerësimit të palës shqiptare, vendimi i marrë nga Gjykata e Rrethit për të vazhduar seancat gjyqësore, pavarësisht nga mungesa ose prania e mbrojtjes ligjore të ankuesit nuk i shkel të drejtat e tij kushtetuese. Në fakt, e drejta e ankuesit për t'u mbrojtur me anë të ndihmës ligjore, i është siguruar madje dhe gjatë seancave gjyqësore në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën e Lartë, ku ai ishte përfaqësuar nga i njëjti avokat.

Ankuesi ka kundërshtuar argumentet e autoriteteve shtetërore, duke pretenduar që avokati i tij nuk e ka përfaqësuar atë gjatë pjesës më të rëndësishme të procedimeve gjyqësore në shkallë të parë. Pavarësisht nga arsyet e mungesës së avokatit të tij, autoritetet e kanë lejuar një mungesë të tillë dhe asnjë masë disiplinore nuk është marrë nga autoritetet kompetente për sjelljen jo korrekte të avokatit. Si rrjedhojë dhe duke pasur parasysh kompleksitetin e çështjes dhe dënimin e rëndë, ankuesi konkludon se ai nuk ka mundur të ushtronte siç duhet të drejtat e tij për t'u mbrojtur, sipas nenit 6/3c të Konventës.

b) Së dyti, përsa i përket pretendimit të ankuesit, mbi pamundësinë për të pyetur dëshmitarë të caktuar, siç kërkohet nga neni 6/1 dhe 3d të Konventës, autoritetet shtetërore kanë argumentuar se mosparaqitja e dëshmitarëve në kohën kur mbrojtja ka dashur t'i sjellë ata para Gjykatës së Rrethit, nuk ishte përgjegjësi e Gjykatës. Në veçanti, ankuesi kishte zgjedhur të mbetej pasiv dhe të mos ushtronte të drejtat e tij sipas Konventës. Në të vërtetë, kjo ishte pjesë e strategjisë së tij mbrojtëse, të cilën ai kishte zgjedhur. Gjykimi në tërësi ka qenë i drejtë, në bazë të ligjit dhe të Konventës, dhe ankuesi e ka pasur efektivisht mundësinë për të ushtruar të drejtat e tij gjatë procesit. Ankuesi kundërshtoi, duke deklaruar që Gjykata e Rrethit kishte dështuar në zbatimin e dispozitave të Kodit Penal, të cilat i njihnin atij të drejtën për të thirrur dëshmitarë në favor të tij. Për më tepër, ai nuk mund të pranonte deklaratimet e autoriteteve shtetërore, lidhur me mundësinë për të thirrur dëshmitarë gjatë procedimeve para Gjykatës së Apelit.

c) Duke pasur parasysh pretendimet e ankuesit dhe vëzhgimet e palës shqiptare, Gjykata vlerëson se çështje serioze shtrohen, lidhur me faktet dhe bazën ligjore, përcaktimi i të cilave duhet t'i nënshtrohet shqyrtimit mbi themelin e çështjes. Kjo pjesë e ankimimit nuk mund të konsiderohet si haptazi e pabazuar në kuptimin e nenit 35/3 të Konventës. Nuk ka arsye të tjera për ta deklaruar çështjen të papranueshme.

Për këto arsye, Gjykata vendos me unanimitet të deklarojë ankimin të pranueshëm, pa cenuar themelin e çështjes.

Mark Villiger
Zëvendësregjistruesi

George Res
Kryetar

VENDIM
(Ankimi Nr.74727/01)
ÇËSHTJA “BALLIU KUNDËR SHQIPËRISË”

STRASBURG
16 QERSHOR 2005

PËRFUNDIMTAR
30/11/2005

Ky vendim merr formë të prerë në rrethanat e përcaktuara në nenin 44 § 2 të Konventës. Ai mund t'i nënshtrohet rishikimit redaktues.

Në çështjen Balliu kundër Shqipërisë,
Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni III²), me dhomë gjykyesetë përbërë nga:

z. G. RESS Kryetar
z. I. CABRAL BARRETO
z. L. CAFLISCH
z. B.M. ZUPANCIC
z. J. HEDIGAN
z. K. TRAJA

znj. A. GYULUMYAN, gjykatës dhe
z. M. VILLIGER, zëvendësregjistruer i seksionit,
pas shqyrtimit me dyer të mbyllura të çështjes, më 27 maj 2004 dhe më 24 maj 2005, shpall vendimin e mëposhtëm, i cili u mor në datën e fundit të sipërcituar:

PROCEDURA

1. Çështja ka filluar me ankimin (nr.74727/01) kundër Republikës së Shqipërisë, depozituar në Gjykatë në bazë të nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (“Konventa”) nga një shtetas shqiptar, z.Taulant Balliu (“Ankuesi”), më 3 gusht 2001.

2. Ankuesi, të cilit i ishte garantuar ndihmë ligjore, u përfaqësua nga z. P. Pavarini, avokat që ushtronte profesionin në Torino (Itali). Pala shqiptare (“Qeveria”) u përfaqësua nga agjenti qeveritar z. S. Puto.

3. Ankuesi pretendonte se mungesa e avokatit mbrojtës në gjyq ka cenuar të drejtën e tij për t’u mbrojtur nëpërmjet ndihmës ligjore. Përveç kësaj, për shkak të mungesës së avokatit mbrojtës, ai e kishte të pamundur të pyeste sipas rregullit dëshmitarët që ishin të pranishëm ose të siguronte paraqitjen e dëshmitarëve në emër të tij.

4. Ankimi iu caktua seksionit të tretë të Gjykatës (neni 52 § 1 i rregullores së Gjykatës). Trupi gjykues që do të shqyrtonte çështjen në këtë seksion (neni 27 § 1 i Konventës) përbëhej siç parashikohej në nenin 26 § 1 të rregullores.

5. Me vendim të datës 30 shtator 2004, pas një seance mbi pranueshmërinë dhe themelin (Neni 54 § 3 i rregullores), Gjykata deklaroi pranimin e ankesës.

6. Si Ankuesi dhe Qeveria paraqitën vërejtje mbi themelin (Neni 59 § 1). Pasi trupi gjykues, në konsultim me palët mori vendim se nuk ishte i nevojshëm caktimi i një seance dëgjimore për themelin (Neni 59 § 3 i rregullores in fine), palët iu përgjigjën me shkrim vëzhgimeve të njëra-tjetrës.

7. Më 1 nëntor 2004 Gjykata ndryshoi përbërjen e seksioneve (Neni 25 § 1 i rregullores), por çështja iu la trupit gjykues, me përbërje si në seksionin III të lartpërmendur.

² Në përbërjen e tij para datës 1 nëntor 2004.

FAKTET

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

8. Ankuesi ka lindur në 1971 dhe është aktualisht duke vuajtur dënimin me burgim në burgun e Peqinit në Shqipëri.

10. Gjatë procedimeve penale kundër bandave të armatosura që vepronin gjatë trazirave politike në Shqipëri nga marsi deri në shtator 1997, prokuroria e rrethit gjyqësor Elbasan akuzoi ankuesin si organizator të bandës së armatosur, të njohur si “Banda Kateshi”. Banda e stërvitur si komando ushtarake, synonte të merrte hakun për vrasjen e anëtarëve të bandës në konflikte me bandat e tjera dhe financohej duke i zhvatur para biznesmenëve të ndryshëm në atë zonë.

A. Procedimet penale

11. Në 1999 ankuesi u akuzua para Gjykatës së Rrethit Durrës për pesë vepra penale për vrasje, dy për tentativë vrasje, një për mbajtje armësh ushtarake dhe një për krijim dhe pjesëmarrje në bandat e armatosura.

12. Avokati i ankuesit, z. Leli, ishte i pranishëm në seancat publike para gjykatës më 25 qershor 1999, 13 shtator 1999 dhe 10 dhjetor 1999. Megjithatë, gjatë periudhës nga data 10 dhjetor 1999 deri më 15 shkurt 2000, avokati nuk i siguroi ndihmë ligjore, dhe ankuesit nuk iu caktua kryesisht një avokat. Ankuesi parashtroi se në seancat e asaj periudhe, prokuroria kishte thirrur dëshmitarë kundër tij, kishte marrë në pyetje dëshmitarët që ishin të pranishëm dhe kishte paraqitur prova të tjera kundër tij. Avokati i ankuesit kishte thirrur dy dëshmitarë në favor të ankuesit, por ata nuk u paraqitën në gjyq.

13. Sipas pretendimeve të ankuesit, asnjë avokat mbrojtës nuk i ka ofruar atij ndihmë ligjore gjatë kësaj faze, në të cilën palët kanë bërë parashtrimet e tyre përfundimtare. Në këtë kontekst, siç është pasqyruar edhe në procesverbalin e seancave gjyqësore, avokati i ankuesit ka munguar në seancë pa arsye dhe ankuesi ka refuzuar të paraqesë vetë parashtrimet e tij përfundimtare të mbrojtjes. Në një rast të tillë, kërkuesi është ankuar dhe i ka kërkuar gjykatës t’i caktojë atij kryesisht një avokat mbrojtës, por nuk ka marrë përgjigje.

14. Sipas parashtrimeve të shtetit shqiptar, seancat e gjykatës së shkallës së parë zgjatën shtatë muaj dhe u organizuan 21 seanca gjyqësore. Seancat gjyqësore ishin shtyrë në shumë raste si rezultat i mungesës së pajustificuar të avokatëve, veçanërisht të avokatit mbrojtës të ankuesit. Ky i fundit mungonte gjatë shtatë seancave gjyqësore të njëpasnjëshme, pa dhënë asnjë arsye.

15. Në tërësi, në të vërtetë ishin zhvilluar vetëm njëmbëdhjetë seanca, kurse dhjetë të tjera ishin shtyrë për shkak të mungesës së avokatit mbrojtës. Kështu, gjykata vendosi caktimin e znj. Meta si avokate mbrojtëse, e cila ishte e pranishme në seancën që u zhvillua më 28 janar 2000. Megjithatë, ankuesi refuzoi të mbrohej nga një avokat që nuk ishte zgjedhur prej tij. Për këtë arsye, gjykata e shkarkoi avokatin mbrojtës të caktuar kryesisht prej saj dhe vazhdoi procedimin në prani të ankuesit, por pa avokat mbrojtës.

16. Me anë të letrës të datës 13 dhjetor 1999, Gjykata e Rrethit Durrës informoi Ministrin e Drejtësisë, midis të tjerash, për një moskorrektesë nga ana e avokatit mbrojtës të ankuesit dhe i kërkonte atij të ndërhynte në çështje. Megjithatë, nuk u mor asnjë masë disiplinore ndaj z. Leli nga Dhoma e Avokatisë, Tiranë.

17. Më 15 shkurt 2000, gjykata e rrethit Durrës e shpalli fajtor ankuesin dhe e dënoi atë me burgim të përjetshëm.

18. Më 21 shkurt 2000, ankuesi depozitoi ankimin pranë Gjykatës së Apelit Durrës kundër vendimit të dhënë më 15 shkurt 2000. Ai pretendonte se gjatë gjykimit në Gjykatën e Rrethit, atij i ishte mohuar e drejta për një gjykim të drejtë, sepse nuk kishte pasur ndihmë ligjore nga një avokat mbrojtës gjatë dy muajve të parë të gjykimit. Një avokat i tillë do të kishte bërë të mundur përgatitjen e mbrojtjes së tij dhe do të kishte thirrur dëshmitarë në mbrojtje të tij. Ai pretendonte se nuk kishte pasur avokat mbrojtës as në paraqitjen e kërkesave të tij përfundimtare. Ai gjithashtu pretendonte se kishte qenë jashtë shtetit gjatë kohës kur ishin kryer disa nga krimet për të cilat ai ishte akuzuar, duke paraqitur dhe vula doganore të vendosura në pasaportën e tij për të provuar se ai ishte larguar jashtë vendit. Në apelimin e tij, ankuesi nuk kërkoi marrjen në pyetje të dëshmitarëve të tjerë.

19. Më 19 prill 2000, Gjykata e Apelit la në fuqi, vendimin e Gjykatës së Rrethit të datës 15 shkurt 2000, duke bërë disa ndryshime lidhur me dënimet e dhëna për disa nga veprat penale. Këto ndryshime nuk ndryshuan vendimin e dënimit me burgim të përjetshëm.

20. Më 19 maj 2000, ankuesi depozitoi ankimin në Gjykatën e Lartë, duke pretenduar shkelje të të drejtave të tij kushtetuese, duke qenë se i ishte mohuar e drejta për të pasur një përfaqësues ligjor gjatë procedimit. Ai ankohej veçanërisht se megjithëse nuk kishte pasur përfaqësim të duhur, gjykata e rrethit kishte proceduar me marrjen në pyetje të dëshmitarëve kundër tij dhe kishte marrë në konsideratë dhe prova të tjera.

21. Më 7 dhjetor 2000, Gjykata e Lartë la në fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit mbi bazën e arsyeve të mëposhtme:

“Shkeljet e paraqitura nga ankuesi ishin njohur dhe ndrequr nga Gjykata e Apelit, pa pasur ndonjë ndikim thelbësor në përmbajtjen e vendimit të shkallës së parë. Gjatë periudhës së paraburgimit, ashtu dhe gjatë procesit gjyqësor, të paditurit i ishte ofruar ndihmë ligjore. Gjykata arsyetonte se mungesa e pajustificuar e avokatit mbrojtës, në marrëveshje me të paditurin, për të shtyrë gjyqin nuk mund të sillte si pasojë pavlefshmërinë absolute të një vendimi të gjykatës së rrethit.”

B. Procedimet në Gjykatën Kushtetuese

22. Më pas, ankuesi, mbështetur në nenin 131 (f) të Kushtetutës, depozitoi një ankim pranë Gjykatës Kushtetuese. Më 19 prill 2001, Gjykata Kushtetuese, në përputhje me nenin 31 të ligjit nr.8577 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, datë 10 shkurt 2000, vendosi *de plano* të deklarojë ankimin të papranueshëm si “jashtë juridiksionit të saj”.

II. LEGJISLACIONI I BRENDSHËM PËRKATËS

A. Kushtetuta

23. Dispozitat përkatëse të Kushtetutës së Shqipërisë parashikojnë:

Neni 31

“Gjatë procesit penal kushdo ka të drejtë:

...

ç) të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij; të komunikojë lirisht dhe privatisht me të, si dhe t’i sigurohet mbrojtja falas, kur nuk ka mjete të mjaftueshme;

d) t’u bëjë pyetje dëshmitarëve të pranishëm dhe të kërkojë paraqitjen e dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.

Neni 42

“1. Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor.

2. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. ”

B. Kodi i Procedurës Penale

23. Sa më sipër, Kodi Shqiptar i Procedurës Penale parashikon:

Neni 49

Mbrojtësi i caktuar

“...

5. “Kur kërkohet prania e mbrojtësit dhe mbrojtësi i zgjedhur ose i caktuar nuk është siguruar, nuk është paraqitur ose e ka lënë mbrojtjen, gjykata ose prokurori cakton si zëvendësues një mbrojtës tjetër, i cili ushtron të drejtat dhe merr përsipër detyrimet e mbrojtësit.”

E DREJTA

SHKELJET E PRETENDUARA TË NENIT 6§§1 DHE § 3 (c) DHE (d) TË KONVENTËS

24. Ankuesi pretendon se bazuar në nenin 6 § § 1 dhe 3 (c) dhe (d) të Konventës, i është mohuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, duke qenë se nuk është mbrojtur si duhet me ndihmë ligjore dhe nuk ka qenë në gjendje të pyesë disa dëshmitarë ose të kërkojë paraqitjen e dëshmitarëve në mbrojtje të tij.

Pjesët përkatëse nga neni 6 i Konventës vijojnë si më poshtë:

“1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht ...nga një gjykatë e pavarur ...,e cila do të vendosë ... për bazueshmërinë e çdo akuze të natyrës penale që i është drejtuar.

3. Çdo i akuzuar ka, së paku, të drejtat e mëposhtme:

c. të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij dhe, në qoftë se ai nuk ka mjete për të shpërblyer mbrojtësin, t'i mundësohet ndihma ligjore falas nga një avokat i caktuar, kryesisht kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë;

d. të pyesë ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës.

25. Gjykata fillimisht rithekson se kërkesat e paragrafit 3 (c) dhe (d) të nenit 6 duhet të shihen si aspekte të veçanta të së drejtës për një gjykim të drejtë proces të rregullt ligjor, të garantuara nga paragrafi 1. Për këtë arsye, Gjykata e konsideron të arsyeshëm shqyrtimin e pretendimeve të ankuesit lidhur me paragrafin 3, së bashku me parimet themelore të paragrafit 1 (shih, midis të tjerash, *Artico v Italy*, vendimi i 13 majit 1980, Seria A, nr.37, fq. 15, § 32, dhe *Van Geyseghem v Belgium [GC]*, nr.26103/95, § 27, ECHR 1999-I). Në tërësi, Gjykata do të shqyrtojë nëse procedimet në tërësinë e tyre kanë qenë të drejta.

A. Shkelja e pretenduar e nenit 6 §§ 1 dhe 3 (c)

1. Parashtrimet e palëve

26. Së pari ankuesi pretendoi se në procedimin penal kundër tij, ai nuk është përfaqësuar në mënyrën e duhur nga një avokat, siç kërkohet nga neni 6 §§ 1 dhe 3 (c) i Konventës. Kjo do të kishte qenë mjaft e rëndësishme në lidhje me kompleksitetin e çështjes dhe shkallën e ashpërsisë së dënimit.

27. Ankuesi vërejti se ishte e qartë, si nga parashtrimet e autoriteteve shtetërore, ashtu edhe nga dokumentet e dosjes, se avokati i tij nuk e ka përfaqësuar atë si duhet gjatë pjesëve më të rëndësishme të procedimit para Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit të Durrësit. Pavarësisht nga shkaqet për mungesën e mbrojtësit të tij, asnjë masë disiplinore nuk është marrë nga autoriteti kompetent në lidhje me sjelljen e tij të papërgjegjshme.

28. Më 26 nëntor 2004, ankuesi depozitoi në Gjykatë dy deklarata të bëra para një noteri në Durrës, më 4 korrik 2003, në të cilat z. Leli, mbrojtësi i tij dhe znj. Meta, avokatja e caktuar kryesisht, deklaruan se Gjykata e Rrethit të Durrësit nuk kishte arritur t'i siguronte ankuesit ndihmën e nevojshme ligjore. Përveç kësaj, z. Leli pohoi se Gjykata e Rrethit e kishte shkarkuar atë nga mbrojtja e ankuesit gjatë procedimit në shkallën e parë dhe se ai ishte kërcënuar nga persona të panjohur.

29. Autoritetet shtetërore nuk pranuan pretendimet e ankuesit. Ata pretendonin se që nga koha e fillimit të hetimit, dhe veçanërisht në gjykim, ankuesi kishte pasur çdo mundësi për të ushtruar të drejtën e tij për një gjykim të drejtë, dhe veçanërisht për të qenë i përfaqësuar nga një avokat. Kështu, pavarësisht nga mungesa e vazhdueshme dhe e pajustificuar e avokatit të tij, gjykata e rrethit e shtyu seancën disa herë, duke i dhënë avokatit mundësinë për të qenë i pranishëm. Përveç kësaj, gjykata e rrethit i caktoi ankuesit një avokat sipas skemës së ndihmës ligjore. Kur ky i fundit u paraqit më 28 janar 2000, ankuesi deklaroi se dëshironte të kishte avokatin e tij dhe nuk pranoi një avokat tjetër të caktuar nga gjykata.

30. Në parashtrimet e autoriteteve shtetërore, vendimi i gjykatës së rrethit për të vazhduar seancat, pavarësisht nga mungesa ose prania e përfaqësuesit ligjor të ankuesit, nuk cenon të drejtat kushtetuese të ankuesit. Në fakt, e drejta e ankuesit për t'u mbrojtur nëpërmjet ndihmës ligjore, ishte

siguruar madje edhe gjatë seancave para Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës së Lartë, në të cilat ai ishte përfaqësuar nga i njëjti avokat.

31. Në lidhje me deklaratat e ankuesit, të paraqitura më 26 nëntor 2004, Qeveria pohoi se në dosjen e gjykatës së rrethit nuk kishte të dhëna që gjykata e rrethit kishte shkarkuar avokatin mbrojtës të ankuesit.

2. Vlerësimi i Gjykatës

32. Gjykata rithekson se si parim i përgjithshëm, bazuar në nocionin e një gjykimi të drejtë, një personi të akuzuar për një vepër penale, i cili nuk dëshiron të mbrohet vetë, duhet t'i jepet mundësia për të pasur ndihmë ligjore nëpërmjet një mbrojtësi të zgjedhur prej tij. Nëse ai nuk ka burime të mjaftueshme për të përballuar këtë ndihmë, Konventa i njuh të drejtën që ta ketë këtë ndihmë falas kur e kërkojnë interesat e drejtësisë (shih *Campbell and Fell v. the United Kingdom*, vendim i 28 qershorit 1984, Seritë A, nr.80, fq 45, § 99 dhe *Pakelli v. Germany*, vendimi 25 prillit 1983, Seritë A, nr.64, fq. 15, § 31).

33. Duke pasur parasysh qëllimin e Konventës, për mbrojtjen e të drejtave që janë praktike dhe efektive, Gjykata ka konstatuar në mënyrë të vazhdueshme që, ndërsa shtetet nuk mund të jenë përgjegjëse për çdo të metë të avokatëve të caktuar për ndihmë ligjore, në rrethana të veçanta të çështjes autoritetet kompetente duhet të marrin masa për të siguruar që ankuesit të gëzojnë efektivisht të drejtën që u njihet. (shih *Artico v. Italy*, vendim i 13 majit 1980, Seritë A, nr.37, fq. 18, § 36).

34. Në rastin në fjalë, Gjykata duhet të përcaktojë nëse shteti mban përgjegjësi për neglizhimin e avokatit të zgjedhur nga ankuesi, për të përmbushur detyrën e tij, në shkelje të të drejtave të akuzuarit sipas Konventës.

35. Gjykata vëren gjithashtu se në këtë rast, kur ankuesi nuk dëshironte të mbrohej vetë dhe kur avokati i zgjedhur prej tij nuk e përmbushi detyrën, autoritetet shqiptare kishin në dispozicion disa mundësi. Ato mund të siguronin që z. Leli, avokati i zgjedhur i ankuesit të përmbushte detyrën e tij, ose mund ta zëvendësonin atë me një avokat të caktuar kryesisht. Megjithatë, ishte e pamundur, duke marrë parasysh pavarësinë e Dhomës së Avokatisë, për ta detyruar mbrojtësin e ankuesit për të vepruar. Për më tepër, Ankuesi nuk pranoi të mbrohej nga një avokat i caktuar kryesisht. Kështu, gjykata e rrethit zgjodhi një mundësi të tretë, atë të shtyrjes së seancave dhe procedimit në mungesë të avokatit, por në prani të ankuesit.

36. Gjykata vëren më tej se ankuesi nuk e informoi asnjëherë Gjykatën e Rrethit të Durrësit për mungesën e përfaqësuesit të tij dhe as të avokatit të caktuar kryesisht. Ai gjithashtu nuk kërkoi ndonjë avokat tjetër.

37. Në këto rrethana, Gjykata vëren se autoritetet e përmbushën në nivel të mjaftueshëm detyrimin e tyre për të siguruar ndihmë ligjore, si duke shtyrë seancat, për t'i dhënë avokatit të ankuesit mundësi për të përmbushur detyrën e tij, ashtu dhe duke caktuar një avokat sipas skemës së ndihmës ligjore.

38. Duke pasur parasysh gjithashtu detyrimin e autoriteteve sipas nenit 6 § 1 të Konventës për të përfunduar procesin “brenda një afati të arsyeshëm”, rrethanat e përfaqësimit të ankuesit gjatë gjykimit të tij nuk cenojnë të drejtën për sigurimin e ndihmës ligjore, siç kërkohet nga neni 6 § 3 (c) i Konventës, ose mohim të gjykimit të drejtë, sipas paragrafit 1 të këtij neni.

B. Shkelja e pretenduar e nenit 6 §§ 1 dhe 3 (d)

1. Parashtrimet e palëve

39. Ankuesi u ankua gjithashtu se nuk iu dha mundësia të pyeteshin disa dëshmitarë, siç kërkohet nga neni 6 §§ 1 dhe 3 (d) i Konventës.

40. Në veçanti, Gjykata e Rrethit nuk ka dështuar në respektimin e dispozitave të ligjit të brendshëm, i cili, sipas pikëpamjes së ankuesit kërkonte thirrjen e dëshmitarëve në emër të tij. Përveç kësaj, ai nuk pranoi deklaratimet e autoriteteve shtetërore rreth mundësisë për të thirrur dëshmitarë gjatë procedimeve para Gjykatës së Apelit. Ai argumentoi se qëndrimi i papërshtatshëm i avokatit të tij gjatë procesit në shkallën e parë ka vazhduar edhe gjatë procesit para Gjykatës së Apelit.

41. Autoritetet shtetërore argumentuan se mosparaqitja e dëshmitarëve të mbrojtjes në një kohë kur mbrojtja kishte dashur që ata të jepnin prova para Gjykatës së Rrethit, nuk ishte përgjegjësi e gjykatës. Në mënyrë të veçantë, ankuesi kishte zgjedhur me paramendim si pjesë të strategjisë së tij të mbrojtjes, të rrinte pasiv dhe të mos ushtronte të drejtat e tij sipas Konventës. Në të vërtetë, gjykimi, në tërësi, ka qenë i drejtë, siç kërkohet nga ligji dhe Konventa dhe ankuesi ka pasur në të vërtetë mundësinë për të ushtruar të drejtat e tij gjatë procedimeve.

2. Vlerësimi i Gjykatës

42. Gjykata rithekson se pranimi i provave rregullohet kryesisht nga rregullat e legjislacionit të brendshëm dhe se, si rregull, janë gjykatat kombëtare që duhet të vlerësojnë provat para tyre. Detyra e institucioneve të Konventës është të sigurojë që procesi në tërësinë e tij, përfshirë dhe mënyrën sesi janë marrë provat, të ketë qenë i rregullt. Si rregull, këto të drejta kërkojnë që të akuzuarit t'i jepet mundësia e nevojshme dhe e përshtatshme për të kundërshtuar dhe pyetur një dëshmitar kundër tij, qoftë në momentin kur ai bën deklaratat, ose dhe në një fazë të mëvonshme të procedimeve (shih Saïdi v France, vendim i 20 shtatorit 1993, seritë A nr.261 –C, fq. 56 § 43, dhe A.M. v. Italy, nr. 37019/97, § 25, ECHR 1999 –IX).

43. Rrjedhimisht, në rastin konkret duhet të përcaktohej nëse ankuesit i ishte ofruar mundësia e duhur për të ushtruar të drejtat e tij për t'u mbrojtur, brenda kuptimit të nenit 6 të Konventës, në lidhje me provat e dhëna nga dëshmitarët.

44. Në seancat gjyqësore në gjykatën e rrethit të Durrësit, si ankuesi, edhe mbrojtësi i tij, u përballën me dëshmitarët e akuzës, patën mundësinë që t'u bënin atyre pyetje, edhe pse preferuan të mos e bënin këtë: avokati i ankuesit duke munguar, ndërsa ankuesi duke heshtur.

45. Në këtë mënyrë, nuk mund të thuhet se autoritetet nuk vepruan në përputhje me detyrën e tyre sipas nenit 6 §§ 1 dhe 3 (d), për t'i siguruar ankuesit mundësinë e duhur për të pyetur dëshmitarët në gjykim.

C. Përfundimi

46. Në përfundim, Gjykata çmon se në tërësi procesi penal kundër ankuesit nuk mund të konsiderohet si i parregullt. Kështu, nuk ka shkelje të nenit 6 §§ 1 dhe 3 (c) në lidhje me ndihmën ligjore të marrë nga ankuesi, veçanërisht gjatë gjykimit të shkallës së parë para gjykatës së rrethit, Durrës. Gjithashtu, nuk ka pasur shkelje të të drejtave të ankuesit sipas nenit 6 § 3 (d) të Konventës, përse i përket mundësisë për të pyetur dëshmitarët në proces.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA NJEZËRI

Çmon se nuk ka pasur shkelje të nenit 6 §§ 1 dhe 3 (c) dhe (d) të Konventës.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 16 qershor 2005, sipas nenit 77 §§ 2 dhe 3 të rregullores së Gjykatës.

Mark Villiger
Zëvendësregjistruar

Georg Ress
Kryetar

VENDIM
(Ankimi Nr. 41153/06)
ÇËSHTJA “DYBEKU KUNDËR SHQIPËRISË”

STRASBURG
18 DHJETOR 2007

Kjo çështje ka të bëjë me keqtrajtimin e vuajtur nga ankuesi si rezultat i kushteve të papërshtatshme të mbajtjes në burg (shkelje e Nenit 3 të Konventës). Ankuesi vuan nga skizofrenia paranojake kronike. Në vitin 2003 ankuesi është dënuar për vrasje me burgim të përjetshëm. Ai është transferuar tre herë në burgje të ndryshme për të vuajtur dënimin e tij. Gjykata Evropiane ka konstatuar se duke konsideruar efektet akumuluese të mbajtjes në kushte të papërshtatshme të ankuesit, ky ka qenë subjekt i trajtimit mjekësor të papërshtatshëm që për nga natyra, kohëzgjatja dhe ashpërsia e atij keqtrajtimi ishte e mjaftueshme për tu kualifikuar si çnjerëzor dhe degradues sipas kuptimit të nenit 3 të Konventës.

Në çështjen Ilir Dybeku kundër Shqipërisë,

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (seksioni i katërt), me dhomë gjykyesetë përbërë prej:

J. CASADEVALL *Kryetar*

G. BONELLO

K. TRAJA

S.PAVLOVSCHI

J. ŠIKUTA

P. HIRVELA *gjyqtarë*

T.L.EARLY regjistruar i seksionit,

pas shqyrtimit me dyer të mbyllura në datën 27 nëntor 2007, merr në këtë datë vendimin e mëposhtëm:

I. PROCEDURA

1. Çështja ka filluar në bazë të ankimit (nr.41153/06) kundër Republikës së Shqipërisë, drejtuar në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore (Konventa) nga një shtetas shqiptar, z. Ilir Dybeku (ankuesi), më 25 shtator 2006.

2. Ankuesi u përfaqësua nga z. S.Shyri, avokat, që e ushtron aktivitetin e tij në Berat. Pala shqiptare (Pala) u përfaqësua nga përfaqësuesi i saj ligjor, znj S. Mëneri nga Ministria e Punëve të Jashtme.

3. Ankuesi u ankua, në mënyrë të veçantë, që në burg kushtet e tij të vuajtjes së dënimit dhe trajtimi mjekësor që ka marrë ishin të papërshtatshme, referuar gjendjes së tij shëndetësore. Për më tepër, ai u ankua për shkelje të nenit 6 të Konventës, për arsye të parregullsisë së proceseve në lidhje me papërshtatshmërinë e kushteve të vuajtjes së dënimit, referuar gjendjes së tij shëndetësore.

4. Më 14 dhjetor 2006, Kryetari i seksionit të katërt të Gjykatës vendosi t’ia komunikonte ankimin palës shqiptare. Sipas dispozitave të nenit 29 § 3 të Konventës, ajo vendosi të shqyrtonte themelin e ankimit, si dhe njëkohësisht pranueshmërinë e tij.

5. Në të njëjtën datë ankuesit iu dha përparësi sipas rregullit 41 të rregullores të Gjykatës.

FAKTET

1. RRETHANAT E ÇËSHTJES

6. Ankuesi ka lindur në vitin 1971 dhe është aktualisht duke vuajtur dënimin në burgun e sigurisë së lartë në Peqin.

A. Rrethanat që çuan në arrestimin e ankuesit

7. Prej vitit 1996 e më tej, ankuesi ka vuajtur nga sëmundja e skizofrenisë paranojake kronike. Për shumë vite ai ka marrë trajtim mjekësor si pacient në shumë spitale psikiatrike.

8. Më 23 gusht të vitit 2002 vdiqën tre persona, duke përfshirë edhe 2 fëmijë të moshës 10 dhe 13 vjeç, dhe të tjerë u plagosën si rezultat vendosjes së eksplozivëve në apartamentin e familjes së motrës së ankuesit.

9. Më 27 gusht të vitit 2002 filloi procesi penal kundër ankuesit, i cili në të njëjtën datë u arrestua dhe u akuzua së pari për veprën penale të vrasjes me dashje, *inter alia* të fëmijëve dhe së dyti për mbajtje të paligjshme të eksplozivëve. Ankuesi u vendos në ambientet e dhomave të paraburgimit në komisariatit e policisë, Durrës, ku ndante qelinë me një numër të paspecifikuar të burgosurish.

B. Gjykimi i ankuesit

10. Më 27 maj të vitit 2003, duke u bazuar në ekspertimin mjekësor, i cili konkludonte se në kohën e kryerjes së veprës çrregullimi mendor i ankuesit ishte në periudhë qetësie, Gjykata e Shkallës së Parë Durrës vendosi që ankuesi ishte i aftë t'i nënshtrohej procesit gjyqësor. Rrjedhimisht, gjykata e deklaroi ankuesin fajtor dhe e dënoi me burgim të përjetshëm.

11. Më 4 Qershor të vitit 2003 avokati i ankuesit depozitoi ankimin para Gjykatës së Apelit Durrës, duke pretenduar që procesi kishte qenë i parregullt, duke qenë se raporti i ekspertëve kishte qenë i njëanshëm dhe i pabazuar. Ai i kërkoi gjykatës që të urdhëronte kryerjen e një raporti të ri mjekësor për të përcaktuar gjendjen shëndetësore të ankuesit.

12. Më 4 shtator të vitit 2003 dhe më 2 mars të vitit 2004, respektivisht, Gjykata e Apelit Durrës dhe Gjykata e Lartë lanë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë. Për më tepër, gjykatat e brendshme nuk e pranuan kërkesën e ankuesit për një ekzaminim të ri mjekësor. Ato konkluduan se ekspertimi i parë mjekësor ishte kryer nga ekspert të paanshëm dhe në përputhje me garancitë procedurale.

C. Gjendja shëndetësore e ankuesit gjatë vuajtjes së dënimit

13. Që prej dhjetorit të vitit 2003 ankuesi u transferua në tre burgje të ndryshme për të ekzekutuar dënimin e tij dhe më konkretisht në burgun e Tiranës nr.302, burgun e Tepelenës dhe në burgun e Peqinit, ku mbahet aktualisht. Ai i ka ndarë qelitë me të burgosur të tjerë që kanë qenë në gjendje të mirë shëndetësore dhe është trajtuar njësoj si ata, pavarësisht gjendjes së tij shëndetësore.

14. Duke qenë se ankuesi ka pasur çrregullime mendore, të cilat sa vinin e rriteshin, më 7 janar të vitit 2005 avokati i tij nisi një proces gjyqësor para Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, duke kërkuar lirimin ose transferimin e tij (ankuesit) në një institucion mjekësor, për shkak se kushtet e vuajtjes së dënimit ishin të papërshtatshme lidhur me gjendjen e tij shëndetësore dhe përbënin rrezik për jetën e tij. Avokati i ankuesit i kërkoi gjykatës të urdhëronte ekzaminimin e ankuesit nga ekspertë psikiatrikë. Kërkesa bazohej në raportet mjekësore të lëshuara nga profesionistë të cilët e kishin mjekuar ankuesin në periudhën nga maji deri në prill të vitit 2003.

15. Më 11 prill të vitit 2005 Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë e rrëzoi kërkesën si të pabazuar, duke qenë se raporti mjekësor i paraqitur prej avokatit të ankuesit nuk mund të provonte që kushtet e vuajtjes së dënimit përbënin ndonjë kërcënim për jetën apo për gjendjen e tij shëndetësore.

16. Më 27 shtator të vitit 2005 dhe më 17 shkurt të vitit 2006, respektivisht Gjykata e Apelit Tiranë dhe Gjykata e Lartë lanë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë. Sipas ankuesit, vendimi i Gjykatës së Lartë nuk iu komunikua atij deri më 3 prill të vitit 2006.

17. Më 25 qershor të vitit 2007 Gjykata Kushtetuese rrëzoi kërkesën e ankuesit, me arsyetimin se pretendimet e tij në lidhje me vlerësimin e provave nuk ishin në juridiksionin e saj.

II. LEGJISLACIONI I BRENDSHËM PËRKATËS DHE BURIMET NDËRKOMBËTARE

A. Legjislacioni i brendshëm përkatës

1. Kodi Penal, amenduar me ligjin nr.8204 i datë 10 prill të vitit 1997, ligjin nr.8279 i datë 15 janar të vitit 1998 dhe me ligjin nr.8733 i datë 27 janar 2001

Neni 79

Vrasja me paramendim për shkak të cilësive të veçanta të personit

“Personi që kryen vrasje ndaj: a) një të mituri nën 16 vjeç; ... dënohet me burgim të përjetshëm ose me burgim për një periudhë jo më pak se njëzet vjet.”

2. Kodi i Procedurës Penale

Neni 478
Lirimi i të burgosurit

“Gjykata e vendit të ekzekutimit mund të vendosë lirin e të burgosurit kur vazhdimi i burgimit mund të ketë pasoja për jetën e tij.”

B. Materiali përkatës ndërkombëtar

1. Rregullorja Europiane e Burgjeve

18. Materiali përkatës nga rekomandimi i Komitetit të Ministrave Nr. R (87) 3 mbi Rregulloren Europiane të Burgjeve (miratuar nga Komiteti i Ministrave më 12 shkurt 1987 në takimin 404-të të zëvendësministrave), rishikuar dhe përditësuar me anë të rekomandimit Rec(2006)2 (miratuar nga Komiteti i Ministrave më 11 janar 2006 në takimin e 952-të të zëvendësministrave), vijon si më poshtë:

“ Kujdesi shëndetësor

39. Autoritetet e burgut duhet të garantojnë shëndetin e të gjithë të burgosurve nën kujdesin e tyre.

Organizimi i kujdesit shëndetësor të burgut

40.1 Shërbimet mjekësore në burg duhet të organizohen në përputhje me administrimin e përgjithshëm të shëndetit të komunitetit ose të vendit.

40.2 Politika e shëndetit në burgje duhet të harmonizohet dhe të jetë në pajtim me politikën kombëtare të shëndetit.

40.3 Të burgosurit duhet të kenë akses në shërbimet shëndetësore të vlefshme në një shtet pa diskriminim për shkak të gjendjes së tyre ligjore.

40.4 Shërbimet mjekësore në burg duhet të mundësojnë zbulimin dhe mjekimin e sëmundjeve fizike dhe mendore ose të anormalive nga të cilat vuajnë të burgosurit.

40.5 Të burgosurve duhet t’u sigurohen të gjitha shërbimet e nevojshme mjekësore, kirurgjikale dhe psikiatrike, duke përfshirë edhe ato shërbime që janë të vlefshme në komunitet.

Sigurimi i kujdesit shëndetësor

46.1 Të burgosurit e sëmurë që kërkojnë trajtim të specializuar, duhet të transferohen në institucione të specializuara ose në spitale civile, kur një trajtim i tillë nuk është i mundur në institucionin e burgut.

46.2 Nëse shërbimi i burgut ka mjediset e tij spitalore, ato duhet të pajisen me personelin dhe mjetet e mjaftueshme për t’i siguruar të burgosurve kujdesin dhe mjekimin e duhur.

Shëndeti mendor

47.1 Burgjet e specializuara apo seksionet nën kontrollin mjekësor duhet të mundësojnë mbikëqyrjen dhe trajtimin e të burgosurve që vuajnë nga çrregullime dhe anormali mendore, të cilët jo domosdoshmërisht përfitojnë nga nenet e rregullit 12.

47.2 Shërbimi mjekësor i burgut duhet të parashikojë trajtimin psikiatrik të të gjithë të burgosurve të cilët kanë nevojë për një shërbim të tillë dhe t’i kushtojë një vëmendje të veçantë parandalimit të vetëvrasjes...”

B. Raporti i Komitetit European për parandalimin e torturës dhe trajtimit çnjerëzor dhe degradues (CPT)

19. Një delegacion i CPT-së vizitoi Shqipërinë nga data 28 deri më 31 mars të vitit 2006. Pjesët përkatëse të raportit të datës 6 shtator të vitit 2007 vijnë si më poshtë (theksuar nga CPT):

11. Në raportin e vizitës së vitit 2005, CPT-ja thekson që, në shumë qendra të paraburgimit ku ka shkuar (në veçanti në Durrës), personat e ndaluar mbaheshin në kushtet e ndalimit që mund të quheshin lehtësisht çnjerëzore dhe degraduese. Në të vërtetë, akumulimi i kushteve materiale të neveritshme, ndalimi me ligj i aktiviteteve brenda qelive dhe pothuajse mungesa e plotë e aktiviteteve jashtë qelive, si dhe kohëzgjatja e tepërt e qëndrimit në këto vende është përshkruar nga Komiteti në bazë të përvojës së tij si të qenurit unike në kuptimin evropian.

Përbën problem serioz fakti që nga vëzhgimet e bëra në Durrës, gjatë vizitës në muajin mars të vitit 2006, situata ka ngelur në të vërtetë haptazi e pandryshuar. Gjithashtu duhet të shtohet se situata e konstatuar në Drejtorinë e Policisë në Fier, ishte pothuajse më e favorshme.

Gjatë konsultimeve në nivele të larta me autoritetet shqiptare, pikëpamjet e delegacionit u ndanë me ato të Kryeministrit, i cili pohoi se kushtet e ndalimit në dhomat e paraburgimit ishin një “turp” për Shqipërinë.

Tashmë në këtë fazë, CPT-ja gjithashtu shpreh shqetësimin serioz rreth mungesës së përkujdesjes për një sëmundje të rëndë të një personi të ndaluar, i cili u gjet në qelinë e tij në dhomat e paraburgimit në Drejtorinë e Policisë së Fierit. Ai ishte lënë në një gjendje katastrofike mbi dyshtemenë e qelisë së tij për shumë ditë, pa marrë ndonjë ndihmë mjekësore.

Këto çështje do të trajtohen në detaje në seksionet pasardhëse të këtij raporti, por rëndësia justifikon përmendjen e tyre në këtë seksion mbi keqtrajtimin.

23. Vizita e 2006-tës demonstroi se asnjë nga rekomandimet specifike të përsëritura, bërë në këtë drejtim nga CPT në raportet e vizitave të mëparshme, nuk ishte zbatuar në praktikë, pavarësisht garancive të shprehura për të kundërtën nga autoritetet shqiptare në përgjigjen e tyre për raportin e 2003-it. Veçanërisht, në asnjë nga vendet e vizituara personat e ndaluar rishtazi nuk i ishin nënshtruar ekzaminimit mjekësor në pranim (përjashto rastet e emergjencës ose kërkesat e bëra). Për më tepër, konsultimi/ekzaminimi mjekësor, atëherë kur ishte kryer, akoma kryhej sistematikisht në prani të oficerëve të policisë. Duhet shtuar se në ato pak raste kur dosja mjekësore ishte hapur, atyre u mungonin të dhënat bazë mjekësore dhe zakonisht përdoreshin nga stafi jo mjekësor. Kjo gjendje është totalisht e papranueshme.

24. Për më tepër, asnjë përmirësim nuk ishte bërë lidhur me furnizimin e përgjithshëm për kujdesin mjekësor në çdo institucion të vizituar, pavarësisht nga rekomandimet e bëra nga CPT në raportet e vitit 2003 dhe vitit 2005. Më specifikisht, nuk ishte marrë asnjë hap për të garantuar praninë periodike të stafit të kualifikuar të infermierisë (në një kohë të plotë në Durrës). Është veçanërisht shqetësuese që autoritetet shqiptare në përgjigjen e tyre më 27 qershor 2006, për raportin e vizitës 2005, nuk adresuan rekomandimet e bëra nga Komiteti për këtë çështje.

25. Kujdesi shëndetësor i ofruar në dhomat e paraburgimit në Fier rezulton të jetë veçanërisht problematik dhe, në një numër rastesh, ai nuk ofrohet fare. Për më tepër, kushtet në ambientet e kujdesit për shëndetin ishin të tmerrshme. Delegacioni dëgjoi shumë ankime nga të ndaluarit lidhur me vonesat për të pasur akses te mjeku dhe cilësinë e shërbimit shëndetësor të ofruar; delegacioni vëzhgoi vetë në vend rastin e një të ndaluarit në nevojë urgjente për trajtim mjekësor, i cili ishte lënë në një gjendje braktisjeje të plotë.

Sikurse është përmendur në paragrafin e 11, një i ndaluar i sëmurë mendor u gjet i shtrirë në një gjendje të tmerrshme mbi dyshtemenë e një qelie të mbipopulluar, poshtë një tubi rrjedhës të ujërave të zeza, pa marrë asnjë kujdes mjekësor. Me sa dukej, ai ndodhej në këtë gjendje për disa ditë. Një ekzaminim fizik nga një prej anëtarëve të delegacionit konstatoi se këmba e tij e djathtë kishte ngjyrë të theksuar të kuqe dhe ishte e enjtur, që shkakonte dhimbje kur e prekje. Sipas personave që ndodheshin në të njëjtën dhomë me të, ai kishte pësuar këtë dëmtim pak ditë më parë, kur kishte rënë në dyshteme në ambientet sanitare (në të cilat ai dërgohet nga të ndaluarit e tjerë).

Pas konsultimeve me stafin dhe shokët e tij të qelisë, rezultoi se i ndaluarit kishte qenë i shtruar në spital për shkak të çrregullimeve të rënda nervore dhe ishte kthyer në qendrën e ndalimit dy javë përpara vizitës. Kushtet e tij shëndetësore rezultonin të ishin të qëndrueshme për dy ditët e para të kthimit të tij, por që ishin përkeqësuar në mënyrë drastike më vonë, mesa duket në sajë të faktit se ai nuk kishte marrë mjekimin e përshkruar nga spitali.

Kur u ballafaqua me këtë rast, mjeku pretendoi se ai e kishte vizituar këtë të burgosur, por nuk ishte në gjendje të jepte ndonjë informacion lidhur me kushtet e tij shëndetësore ose trajtimin e dhënë.

Kur u pyet për vendndodhjen e dosjes mjekësore të të ndaluarit të sipërpërmendur, si edhe të të ndaluarve të tjerë, mjeku konfirmoi se dosje të tilla kishte për çdo të burgosur, por pretendoi se nuk kishte çelësin e raftit, ku u tregua se mbaheshin këto dosje. Pas një vonese të konsiderueshme, çelësi u gjet nga një oficer policie, dhe u konstatua se aty nuk kishte asnjë dosje mjekësore personale të vetme.

I vetmi dokumentacion mjekësor i disponueshëm ishte regjistri i vizitave të mjekut dhe shënimi i fundit ishte në nëntor 2005. Shpjegimi mjekut për këtë gjendje ishte se “ai nuk kishte shënuar ndonjë gjë, pasi nuk kishte marrë asnjë ilaç për të rekomanduar që nga ajo kohë”.

20. Vizita e mëparshme e delegacionit të CPT-së në Shqipëri u realizua nga data 23 maj deri në datën 3 qershor të vitit 2005. Delegacioni kontrollloi, *inter alia*, spitalin e burgut të Tiranës. Pjesët përkatëse të raportit të CPT-së të datës 2 korrik 2006 vijnë si më poshtë (theksuar nga CPT-ja):

“61. Kushtet materiale të ndalimit ishin të tmerrshme në qendrat e paraburgimit të vizituara. Shumë prej të ndaluarve mbaheshin në kushte të mbipopulluara (për shembull, në Vlorë rezultoni mbi shtatë persona në një qeli prej 5 m², ndërsa në Durrës mbi 10 persona në një qeli prej 8 m²). Qelitë ishin të furnizuara vetëm me dyshekë prej sfungjeri dhe/ose batanije. Për më tepër, aksesit në ndriçimin natyral ishte shumë i kufizuar dhe ajrimi ishte jashtëzakonisht i varfër.

Kushtet më të rënda u konstatuan në Durrës, ku personave të ndaluar nuk u ishin siguruar as dyshekë dhe as skelete krevatesh. Për më tepër, disa prej të ndaluarve ishin vendosur në dy dhoma depo, të cilat ishin mbushur me ushqime të paketuara, të destinuara për të gjithë personat e ndaluar. Disa prej personave të ndaluar u gjetën në gjendje “mpirjeje”, dhe delegacioni u informua se të ndaluarve u kishte rënë herë pas here të fikët si rezultat i temperaturave jashtëzakonisht të larta dhe nivelit të lartë të lagështirës. Nuk është për t’u çuditur që shumë prej personave të ndaluar vuanin nga sëmundjet e lëkurës dhe/ose nga problemet e frymëmarrjes. Gjithashtu është shqetësues fakti që shumë prej personave të ndaluar ishin mbajtur në këto institucione për shumë vite....

108. Gjatë vizitës vijuese në spitalin e burgut në Tiranë delegacioni u fokusua kryesisht në gjendjen psikiatrike të pacientëve. Ai gjithashtu rishikoi masat e marra nga autoritetet shqiptare nën dritën e rekomandimeve të bëra pas vizitës së vitit 2000 përsa i përket spitalit të burgut në përgjithësi. ...

110. Kushtet materiale në spitalin e burgut ishin përmirësuar dukshëm qysh prej vizitës së vitit 2000. Të gjitha qelitë ishin me përmasa të arsyeshme, kishin një akses të mirë përsa i përket ndriçimit natyral dhe artificial, dhe ishin të mirëpajisura (me krevate, komodinë, tavolinë, karrige, radio). Megjithatë, u konstatua që shërbimi sanitar ishte në një gjendje shumë të varfër fizike dhe higjienë. CPT-ja rekomandon që duhet të merren hapa për të korrigjuar pamjaftueshmëritë.

111. CPT-ja mbetet e shqetësuar rreth mungesës së plotë të aktiviteteve jashtë qelisë për pacientët e spitalit të burgut.

Përsa i takon pacientëve të cilët janë deklaruar të papërgjegjshëm penalisht, asnjë aktivitet jashtë qelisë nuk ishte organizuar për ta, ndërsa ushtrimet në ambientet e jashtme të burgut ishin siguruar në mënyrë jo sistematike, jo të përvashme dhe çdo herë, për më pak se një orë.

Për më tepër, nuk i jepej mundësia të kryenin ushtrime në ambientet e jashtme apo çdo aktivitet tjetër jashtë qelisë çdo pacienti tjetër. Kështu që, përveç aksesit në shërbimet sanitare, pacientët ishin zakonisht të izoluar në dhomat e tyre 24 orë në ditë, dhe e vetmja mënyrë për të shpenzuar kohën ishte të lexojë ose të dëgjojë radion. Gjithashtu, spitali nuk kishte as librari.

Në një shtet probleme të tilla janë tërësisht të papranueshme dhe përbëjnë një mospëmbushje flagrante nga ana e autoriteteve shqiptare të rekomandimeve të cilat tashmë janë bërë që mbas vizitës së vitit 2007 dhe janë përsëritur gjatë vizitave periodike në spitalin e burgut.

CPT-ja u bën thirrje autoriteteve shqiptare të marrin masat e menjëhershme për t’u garantuar të gjithë pacientëve, që në kartelat e tyre mjekësore të mundësohet të paktën një orë në ditë ushtrime në ambientin e jashtëm.

Për më tepër, rritetson rekomandimin e tij që pacientëve afatgjatë në spitalin e burgut t’u mundësohet një gamë e gjerë aktiviteteve, si dhe t’u kushtohet një vëmendje e veçantë të miturve që vuajnë dënime të gjata.

112. CPT-ja mirëpret fuqizimin aktual të spitalit të burgut me personel mjekësor (dy doktorë shtesë dhe një psikolog). Delegacioni u informua që sipas programeve në zbatim e sipër, do të rritej numri i personelit të infermierisë. CPT-ja do të dëshironte që të mbahej e informuar sa i takon çështjes në fjalë.

113. Përsa i përket trajtimit të parashikuar për pacientët, situata në tërësi nuk ka ndryshuar. Ashtu si në vitin 2000, mjekimi psikiatrik është bazuar në përgjithësi në farmakoterapinë. Nuk kishte programe për trajtim individual apo psikoterapi individuale, terapi profesionale apo terapi në grup. Në këtë pikëpamje, CPT-ja dëshiron të nënvizojë sërish se mjekimi psikiatrik duhet të bazohet në trajtimin individual, i cili nënkupton hartimin e një plani konkret trajtimi për çdo pacient, duke përcaktuar qëllimin e mjekimit, kuptimin e terapisë së përdorur dhe anëtarët e personelit përgjegjës. Planin e trajtimit duhet të përmbajë gjithashtu rezultatin e rishikimit të herëpashershëm të kushteve të shëndetit mendor të pacientit dhe një rishikim të mjekimit të pacientit. Trajtimi duhet të përmbajë një gamë të gjerë aktiviteteve rehabilituese dhe terapeutike në mjekimin e pacientit, duke përfshirë aksesin në terapinë e specializuar, terapinë në grup, psikoterapinë individuale dhe sportet. Veç kësaj, pacientët duhet të kenë akses të rregullt në dhoma çlodhëse të përshtatshme; gjithashtu këshillohet mundësia e arsimimit dhe punës së përshtatshme (shih paragrafin 111).

CPT-ja rritet rekondicionimin e saj, që trajtimi psikiatrik i ofruar pacientëve në spitalin e burgut të rishikohet në dritën e vërejtjeve të lartpërmendura.

114. Përsa i përket kontaktit me botën e jashtme, është për t'u lavdëruar fakti që tani pacientët kanë akses të rregullt në shërbimin telefonik (një herë në javë). Përsa i përket vizitave, të drejtat e pacientëve ishin të njëjta me ato të personave që vuanin dënimin në burg. Në këtë pikë, do t'i referohemi vërejtjeve dhe rekomandimeve të bëra në paragrafin 136.

115. CPT-ja vëren se, qysh prej fillimit të vitit 2005, pacientët e acaruar³ nuk mbaheshin për shumë kohë në krevatet e tyre të izoluar me pranga në duar dhe në kyçet e këmbës. Për më tepër, u vu re se mjetet shtrënguese dhe izoluese nuk ishin të tepruara (shirita lëkure, mjekim qetësues). Megjithatë, nuk mbaheshin regjistra të veçantë për kufizimin/shtrëngimin. Duhet të merren masa për të ndrequr këtë mangësi.

116. Konfidencialiteti i ekzaminimeve/konsultimeve dhe i të dhënave mjekësore nuk respektohet në të gjitha spitalet e burgut. Në këtë pikë do t'u referohemi vërejtjeve dhe rekomandimeve të bëra në paragrafin 127.

117. Personat që janë deklaruar të papërgjegjshëm penalisht i nënshtrohen masave të detyruara të vendosjes në një institucion për një kohë të pacaktuar. Në këto raste, neni 46 i Kodit Penal parashikon që domosdoshmëria e kësaj vendosjeje duhet të rishikohet nga gjykata *ex officio* pas një viti. Megjithatë, delegacioni u informua se ky rishikim gjyqësor nuk është ndërmarrë në asnjë rast *ex officio*, por vetëm me iniciativë të personave të interesuar ose të avokatit.

CPT-ja i bën thirrje autoriteteve shqiptare të marrin masat e menjëhershme për të garantuar që procedura e rishikimit sipas nenit të 46 të Kodit Penal të ndërmerret përsa i përket të gjithë personave që janë deklaruar të papërgjegjshëm penalisht.

C. Raporti i Amnesty International i vitit 2007 përsa i përket gjendjes të së drejtave të njeriut

21. Përsa i përket gjendjes së të drejtave të njeriut në burgjet e Shqipërisë, raporti i Amnesty International i vitit 2007 konstatoi:

“Kushtet e ndalimit

Përveç programit të mbështetur nga BE-ja për reformën e burgjeve dhe disa përmirësimeve në kushtet e ndalimit, këto ishin në përgjithësi shumë të varfra dhe karakterizoheshin nga mbipopullimi, higjenë e varfër dhe kushte sanitare, dietë dhe kujdes mjekësor i papërshtatshëm. Në kundërshtim me legjislacionin shqiptar dhe standardet ndërkombëtare, të miturit mbaheshin shpeshherë së bashku me të ndaluarit e rritur dhe ata të arrestuar së bashku me personat e dënuar në të njëjtën qeli. Të burgosurit e sëmurë mendërisht mbaheshin shpeshherë në burg, në vend që të dërgoheshin për trajtim mjekësor në institucionet e specializuara në përputhje me vendimin e gjykatës. Të ndaluarit që mbaheshin në dhomat e paraburgimit në rajonet e policisë, vuanin në veçanti nga kushtet shumë të rënda, kryesisht sa i takon mbipopullimit në rajonet e policisë në Durrës, Elbasan dhe Korçë”.

³ Persona me aktivitet psikomotor tepër të zhvilluar, shoqëruar me tension të lartë dhe nervozizëm.

E DREJTA

1. SHKELJA E PRETENDUAR E nenit 3 TË KONVENTËS

22. Pa u bazuar në asnjë prej neneve të Konventës, ankuesi u ankua për papërshtatshmërinë e trajtimit të tij mjekësor, si dhe duke iu referuar raportit të CPT-së mbi burgjet shqiptare në përgjithësi, për kushtet e vuajtjes së dënimit në raport me gjendjen e tij shëndetësore.

23. Në vëzhgimet e datës 22 maj të vitit 2007 ankuesi kundërshtoi papërshtatshmërinë e kushteve të ndalimit në qelitë e qendrës së paraburgimit në rajonin e policisë në Durrës nga gushti i vitit 2002 deri në dhjetor të vitit 2003.

24. Gjykata vlerëson se, pavarësisht faktit që ankuesi nuk u bazua shprehimisht në nenin 3 të Konventës, pretendimet e tij do të shqyrtohen në përputhje me këtë nen. Pala shqiptare (Qeveria) në vëzhgimet e saj kërkoi që të shqyrtohej sipas këtij neni. Neni 3 vijon si më poshtë:

“Askush nuk mund t’i nënshtrohet torturës, as dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore, ose poshtëruese.”.

A. Pranueshmëria

25. Qeveria i kundërshtoi argumentet e ankuesit. Ata pretenduan se ankuesi nuk kishte parashtruar ankesat e tij para gjykatave të brendshme dhe se kjo pjesë e ankimit duhet të deklarohet e papranueshme për mosshkrim të mjeteve juridike të brendshme.

26. Ankuesi pretendoi se ankesat e tij të përsëritura përpara gjykatave të brendshme kompetente ishin hedhur poshtë dhe se aktualisht ai ishte duke vuajtur dënimin në të njëjtin vend si të burgosurit e tjerë që ishin në gjendje të mirë shëndetësore. Ai pohoi se ankesat e tij ishin bazuar në një problem strukturor të sistemit ndëshkimor të Shqipërisë, pasojë e të cili është mungesa e institucioneve kompetente për të garantuar kushtet e përshtatshme të ndalimit dhe trajtimit mjekësor të domosdoshëm për njerëzit me gjendje shëndetësore të ngjashme. Si pasojë, ankimet e tij do të kishin qenë joefektive në praktikë, edhe nëse do të ishin të suksesshme në nivel të brendshëm.

27. Gjykata vëren se në fillim, ankuesi i ishte drejtuar gjykatës me ankimin e tij rreth kushteve të ndalimit në dhomat e paraburgimit (nga gushti i vitit 2002 deri në dhjetor të vitit 2003), në 22 maj të vitit 2007, pra pas afatit gjashtëmuor të parashikuar nga Konventa. Në këto rrethana ky ankim u refuzua pasi ishte depozituar jashtë afatit prekluziv gjashtëmuor në përputhje me nenet 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës.

28. Përsa i takon pjesës tjetër të ankimit në bazë të këtij neni, që i referohet papërshtatshmërisë së kushteve të vuajtjes së dënimit dhe trajtimit mjekësor që ankuesi ka marrë, gjykata vëren se kjo rezulton nga dosja e tij, ku pasi u dënua, ai u vendos në një qeli me të burgosur të tjerë. Kur gjendja e tij u përkeqësua, ai u transferua në spitalin e burgun në Tiranë, ku mori trajtimin si pacient. Avokati i ankuesit, duke marrë shkas nga kushtet e rënda të vuajtjes së dënimit në burgun e sigurisë së lartë, u kërkoi gjykatave të brendshme, por pa rezultat, të lirojnë ankuesin nga burgun dhe/ose të urdhërojnë shtrimin e tij në një institucion të specializuar mjekësor. Në këtë mënyrë, ankuesi nuk mund të qortohet për mosshkrim të mjeteve të brendshme juridike.

29. Për më tepër, gjykata dëshiron të konstatojë se pala shqiptare nuk ka treguar përshtatshmërinë e mjeteve juridike të referuara për realizimin e pretendimeve të ankuesit. Në veçanti, pala shqiptare nuk ka përmendur vendime të gjykatave të brendshme, ku të tregohet se individëve të ndodhur në të njëjtën situatë si të ankuesit, iu është siguruar transferimi nga një burg në një institucion të specializuar për trajtimin e sëmundjeve mendore. Rrjedhimisht, kundërshtimi i tyre nuk pranohet.

31. Duke marrë parasysh vlerësimet e mësipërme, Gjykata vëren se ankimi në lidhje me kushtet e vuajtjes së dënimit dhe trajtimin mjekësor që ka marrë ankuesi gjatë kohës që ka qenë në burg, nuk janë haptazi të pabazuara brenda kuptimit të nenit 35 § 3 të Konventës. Për më tepër, Gjykata vëren se ato nuk janë të papranueshme për ndonjë arsye tjetër. Kështu që kjo pjesë e ankimit duhet të deklarohet e pranueshme.

B. Meritat (themeli)

1. Parashtrimet e palëve

31. Ankuesi argumentoi se ai ishte duke vuajtur dënimin në një burg, ku kushtet e vuajtjes së dënimit nuk ishin ato që parashikohen për një person me gjendjen e tij shëndetësore. Për më

tepër, ai tregoi se neglizhenca e autoriteteve, përsa i përket mostrajtimin me ilaçet e rekomanduara nga doktorët specialistë, përbën shkelje të të drejtave të tij në përputhje me Konventën.

32. Pala shqiptare, duke veçuar ndjenjat subjektive të ankuesit, kundërshtoi që pretendimi mbi trajtimin e përfituar në nivelin minimal të vuajtjes së dënimit të papërshtatshëm me atë të kërkuar, të jetë brenda kuptimit të nenit 3. Së pari, ata pohuan se, nën dritën e dëshmive mjekësore të paraqitura përpara gjykatës, nuk kishte dyshim që autoritetet përkatëse kishin monitoruar me vëmendje dhe në mënyrë të vazhdueshme gjendjen shëndetësore të ankuesit dhe i kishin siguruar ndihmën e duhur mjekësore në përputhje me gjendjen e tij shëndetësore.

33. Pala shqiptare parashtroi që kushtet e vuajtjes së dënimit në burgjet shqiptare duhen trajtuar në të njëjtin këndvështrim si ato të vendeve të tjera anëtare, të cilat janë duke reformuar sistemin e tyre ligjor. Në të vërtetë, qysh prej vizitës së CPT-së në Shqipëri në vitin 1990, është arritur një zhvillim pozitiv dhe kushtet e vuajtjes së dënimit janë përmirësuar. Për më tepër, ata parashtroan se kushtet në të cilat të burgosurit si ankuesi vuanin dënimin, duhen vlerësuar në raport me situatën ekonomike të shtetit dhe standardet e jetesës në vend.

34. Së fundi ata pohuan në veçanti se, duke qenë se gjykatat e brendshme e kishin deklaruar ankuesin të përgjegjshëm penalisht për veprat penale të kryera, kushtet e vuajtjes së dënimit të tij ishin të përshtatshme me gjendjen e tij shëndetësore dhe të njëjta me standardet e aplikuar ndaj të burgosurve të tjerë. Pala shqiptare parashtroi raportet mjekësore mbi gjendjen shëndetësore të ankuesit, të cilat i referoheshin trajtimit të tij mjekësor gjatë periudhës së qëndrimit të tij në burg dhe në spitalin e burgut. Këto raporte pasqyrojnë faktin se ankuesi ishte trajtuar me ilaçe të njëjta me ato të rekomanduara nga mjeku i përgjithshëm dhe se pranimi i tij në një institucion të specializuar, brenda sistemit të burgut, varej nga struktura e këtyre institucioneve në të ardhmen.

2. Vlerësimet e Gjykatës

a) Parime të përgjithshme

35. Në fillim, Gjykata përsëriti se neni 3 i Konventës përmban një nga vlerat më themelore të shoqërisë demokratike. Ai i ndalon absolutisht termat e torturës dhe trajtimin e dënimit çnjerëzor dhe johuman, pavarësisht nga rrethanat dhe sjellja e viktimës (shih *Van der Ven v. Netherlands*, no.50901/99 § 46, ECHR 2003-II, dhe *Poltoratskiy v. Ukraine*, no. 38812/97, § 130, ECHR 2003-V).

36. Gjykata rithekson se, sipas jurisprudencës së saj, trajtimi i sëmundjes duhet të prekë nivelin minimal të kushteve të vuajtjes së dënimit, në mënyrë që të jetë brenda kuptimit të nenit 3 të Konventës. Vlerësimi i këtij niveli minimal të vuajtjes së dënimit është relativ: ai varet nga të gjitha rrethanat e çështjes, siç është kohëzgjatja e trajtimit, efektet e tij fizike dhe mendore dhe në disa raste varet nga seksi, mosha dhe gjendja shëndetësore e viktimës (shih *Kudla v. Poland* [GC], no. 30210/96, § 91, ECHR 2000-XI; *Mouisel v. France*, no 67263/01, § 37, ECHR 2002-IX; dhe *Papon v. France* (no.1) (dec.), no. 64666/01, ECHR 2001-VI).

37. Gjykata e konsideron trajtimin si “çnjerëzor”, sepse, *inter alia*, ishte i paramenduar, ishte përdorur me orë të zgjatura duke shkaktuar ose dëmtime të dukshme trupore ose vuajtje të mëdha fizike dhe mendore. Gjithashtu mendohet se trajtimi është degradues, sepse ishte i tillë sa i shkaktoi viktimës ndjenja frike, ankth dhe inferioritet si pasojë e poshtërimit dhe përluljes (shih *Kudla*, të cituar më sipër). Problemi, nëse qëllimi i këtij trajtimi ishte për ta përlulur dhe poshtëruar viktimën, është një faktor i mëtejshëm që do të merret parasysh, por mungesa e këtij qëllimi nuk mund të përjashtojë përfundimisht shkeljen e nenit 3 (shih *Peers v. Greece*, no. 28524/95, § 74, ECHR 2001-III; *Kalashnikov v. Russia*, nr.47095/99, § 101, ECHR 2002-VI dhe *Ramirez Sanchez v. France* [GC], no. 59450/00, § 119, ECHR 2006-...)

38. Vuajtja dhe poshtërimi i shkaktuar duhet të shkojnë përtej elementit të paevitueshëm të vuajtjes dhe poshtërimit, që rrjedh nga një trajtim ose dënim i ligjshëm. Masat kufizuese të lirisë së një personi shpeshherë përfshijnë elemente të tilla. Akoma nuk mund të thuhet nëse ndalimi/dënimi në vetvete ngre një çështje sipas nenit 3. Megjithatë sipas këtij neni, shteti duhet të garantojë që një person të dënohet në kushtet të cilat janë në pajtim me dinjitetin njerëzor, që mënyra apo metoda e ekzekutimit të këtyre masave të mos e nënshtrojnë atë ndaj ankthit apo mundimit të një intensiteti të tillë që e kapërcen nivelin e pashmangshëm të vuajtjes e cila është prezent në burg, dhe sipas

kërkesave praktike të burgimit të sigurohen në mënyrë të përshtatshme shëndeti dhe mirëqenia e tij. Kur vlerësohen kushtet e vuajtjes së dënimit, duhet të merren parasysh efektet që kanë pasur në tërësi kushtet dhe kohëzgjatja e dënimit (*shih Dougoz v. Greece*, no. 40907/98, § 46, ECHR 2001-II, dhe *Kalashnikov* i cituar më sipër, § 102). Në veçanti, Gjykata duhet të ketë parasysh gjendjen shëndetësore të personit të dënuar (*shih Assenov and Others v. Bulgaria*, vendim i datës 28 tetor 1998, *Raportet të vendimeve dhe gjykimeve* 1998-VIII, fq. 3296, § 135; Kudla, cituar më sipër, § 94 dhe *Ramirez Sanchez*, cituar më sipër, § 119).

39. Një faktor i rëndësishëm, përsa i përket kushteve materiale, është regjimi i vuajtjes së dënimit. Në vlerësimin nëse një regjim kufizues mund të përbëjë një trajtim në kundërshtim me nenin 3, në rastin konkret duhet të kihen parasysh kushtet e veçanta, rreptësia e regjimit, kohëzgjatja e tij, qëllimi i ndjekur dhe efektet e tij në lidhje me personin (*shih Messina v. Italy* (dec), no. 25498/94, ECHR 1999-V; *Van der Ven*, cituar më lart, § 51; *Iorgov v. Bulgaria*, no. 40653/98, §§ 82-84 dhe 86, 11 mars 2004; dhe *G.B v. Bulgaria*, no.42346/98, §§ 83-85 dhe 87, 11 mars 2004).

40. Kështu që Gjykata shqyrtoi, *inter alia*, nëse është në pajtim me nenin 3 që personat në vijim të dënohen në kushte të cilat nuk janë të përshtatshme duke u nisur nga gjendja e tyre mendore dhe fizike: personat që vuajnë nga një çrregullim mendor (*shih Kudla*, të cituar më sipër dhe *Keenan v. the United Kingdom*, no. 27229/95, ECHR 2001-III) ose nga një sëmundje serioze (*shih Mouisel*, cituar më sipër, dhe *Matencio v. France*, no. 58749/00, 15 janar 2004; dhe *Sakkopoulos v. Greece*, no. 61829/00, 15 janar 2004), të paaftët (*shih Price v. the United Kingdom*, no. 33394/96, ECHR 2001-VII) të moshuarit (*shih Papon* (dec), cituar më sipër) ose narkomanët të cilët vuajnë nga simptoma veçimi (*shih McGlinchey and Others v. the United Kingdom*, no. 50390/99, ECHR 2003-V).

41. Megjithatë neni 3 i Konventës nuk mund të interpretohet në mënyrë të tillë që të parashikojë një detyrim të përgjithshëm për lirimin e të dënuarve nisur nga shkaqet shëndetësore, por ky nen u vë detyrimin shteteve për të mbrojtur mirëqenien fizike të personave me liri të kufizuar, për shembull duke u dhënë atyre ndihmën e duhur mjekësore (*shih Hurtado v. Zvicrës*, vendim i datë 28 janar 1994, Seria A no.280-A, Opinioni i Komisionit, pp. 15-16, § 79. Mungesa e kujdesit të duhur mjekësor mund të çojë në një trajtim në kundërshtim me nenin 3 (*shih Ilhan v. Turkey* [GC], no. 22277/93, § 87, ECHR 2000-VII; *Naumeko v. Ukraine*, no. 42023/98, § 112, 10 shkurt 2004; dhe *Farbtuhs v. Latvia*, no. 4672/02, § 51, 2 dhjetor 2004). Në veçanti, në vlerësimin nëse kushte të caktuara të vuajtjes së dënimit janë të papajtueshme me standardet e nenit 3, duhet të merret në konsideratë, në rastin e personave të sëmurë mendërisht, paaftësia dhe cenueshmëria e tyre, si dhe në disa raste, ankimi në mënyrë koherente apo në përgjithësi rreth faktit se sa janë ndikuar ata nga trajtime të caktuara (për shembull, *shih*, *Herczegfalvy v. Austria*, vendim i datës 24 Shtator 1992, Seria A no.244, pp. 25-26, § 82, dhe *Aerts v. Belgium*, vendim i datës 30 korrik 1998, *Raportet* 1998-V, p. 1966, § 66).

42. Tri janë elementet e veçanta të cilat duhet të merren parasysh në lidhje me pajtueshmërinë e gjendjes së ankuesit për sa i takon me qëndrimin të tij në burg: a) kushtet mjekësore të të burgosurit; b) përshtatshmëria e ndihmës dhe e përkujdesit mjekësor të parashikuar në burg dhe c) garantimi i masave të burgimit në përputhje me gjendjen shëndetësore të ankuesit (*shih Mouisel*, cituar më sipër, §§ 40-42, dhe *Melnik v. Ukraine*, no. 72286/01, §94, 28 mars 2006).

b) Zbatimi i këtyre parimeve në çështjen konkrete

43. Gjykata konsideron se shqetësimi i ankuesit, në bazë të këtij neni, që do të thotë pamjaftueshmëria e kushteve të vuajtjes së dënimit dhe trajtimi mjekësor i papërshtatshëm që ka marrë gjatë kohës së qëndrimit në burg, kanë lidhje me të njëjtat aspekte të Konventës. Kështu që Gjykata duhet të shqyrtojë themelin e të dyja pretendimeve së bashku.

44. Gjykata vëren se palët kanë rënë dakord që ankuesi ka vuajtur nga një çrregullim mendor kronik, i cili përfshinte episode psikotike dhe ndjenja paranoje. Historia e ndalimit të tij në ambientet e dhomave të paraburgimit në rajonin e policisë në Durrës dhe më pas në burgun e sigurisë së lartë në Peqin nga viti 2002 e më tej, tregojnë se kushtet e tij ishin përkeqësuar nga koha që kishte marrë trajtim si pacient në spitalin e burgut në Tiranë. Në veçanti, përgjatë pesë viteve të

burgimit, ankuesi kishte marrë trajtim mjekësor si pacient në spitalin e burgut në Tiranë nga 26 maji i vitit 2004 deri në 2 gusht të vitit 2004 dhe nga 1 dhjetori i vitit 2004 deri në 26 janar të vitit 2005.

45. Sipas autoriteteve, nisur nga pamundësia e sigurimit të trajtimit të duhur mjekësor për ankuesin, për shkak të mungesës së institucioneve përkatëse dhe medikamenteve (shih paragrafin 34 më sipër), ai ishte trajtuar me ilaçe të ngjashme me ato të rekomanduara nga mjeku i tij dhe deri në ngritjen e një institucioni psikiatriko-penal të specializuar, ai ishte vendosur në një qeli me ajrim dhe me ndriçim të mirë, në një burg të sigurisë së lartë, të cilën ai e ndante më të burgosur të tjerë, të cilët ishin në gjendje të mirë shëndetësore. Ai kishte marrë trajtim si pacient i spitalit të burgut të Tiranës vetëm kur gjendja e tij ishte përkeqësuar.

46. Babai dhe avokati i ankuesit paraqitën një sërë ankesash para autoriteteve kompetente kundër administratës së spitalit të burgut dhe repartit mjekësor, duke pretenduar që ata kishin neglizhuar duke mos arritur të rekomandojnë trajtimin e përshtatshëm mjekësor dhe se gjendja e tij ishte përkeqësuar për shkak të mungesës së trajtimit dhe ekzaminimit mjekësor. Megjithatë, të gjitha ankesat e tyre nuk u morën parasysh. Në të vërtetë, Gjykata vëren se vlerësimi i fundit mbi gjendjen shëndetësore të ankuesit daton përpara vitit 2002. Të dhënat mjekësore mbi ankuesin tregojnë se atij vazhdueshmërisht i është rekomanduar i njëjti trajtim dhe se nuk është bërë asnjë përshtetësi i detajuar mbi zhvillimin e sëmundjes së tij.

47. Gjykata konsideron se fakti që ankuesi ishte deklaruar i përgjegjshëm penalisht për konsumimin e elementeve të veprës penale të vrasjes dhe ishte dënuar me burgim të përjetshëm nuk është vendimtar për sa i përket çështjes, nëse autoritetet i kishin përmbushur detyrimet e tyre sipas nenit 3 për ta mbrojtur atë nga një trajtim apo dënim në kundërshtim me këtë nen. Në të vërtetë, ndjenja e inferioritetit dhe pafuqishmëria, e cila është tipike për personat të cilët vuajnë nga çrregullime mendore, kërkon një vëmendje të madhe për të parë nëse Konventa është respektuar. Ndërkohë që është detyrë e autoriteteve të vendosin mbi bazën e rregullave të njohura të shkencës së mjekësisë, në lidhje me metodat terapeutike që duhet të përdoren për të trajtuar gjendjen fizike dhe mendore të personave të paafte për të vendosur për veten e tyre dhe për të cilët këto autoritete janë të përgjegjshme, sërish këta persona mbeten nën mbrojtjen e nenit 3, kërkesat e të cilëve nuk e lejojnë përjashtimin nga ky nen.

48. Gjykata pranon që natyra e kushteve psikologjike të ankuesit e bëri atë më shumë të prekshëm sesa mesatarja e të dënuarve të tjerë dhe se burgimi i tij mund të ketë acaruar në një nivel të caktuar ndjenjat e tij të ankthit, vuajtjes dhe frikës. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se fakti që pala shqiptare e pranoi që ankuesi ishte trajtuar si të burgosurit e tjerë, pavarësisht gjendjes së tij shëndetësore të veçantë, tregon mungesën e angazhimit të tyre për përmirësimin e kushteve të vuajtjes së dënimit në pajtim me rekomandimet e Këshillit të Europës (shih paragrafin 18 më sipër). Në vendimet e fundit, Gjykata ka tërhequr vëmendjen lidhur me rëndësinë e këtyre rekomandimeve, pavarësisht natyrës së tyre jo të detyrueshme për shtetet anëtare (shih *Rivière v. France*, nr 33834/03, § 72, 11 korrik 2006, dhe *Naumenko v. Ukraine*, cituar më sipër, § 94).

49. Për më tepër, Gjykata vëren se pala shqiptare nuk ka dhënë informacion të detajuar rreth kushteve materiale të vuajtjes së dënimit të ankuesit, edhe të tregojë se, pavarësisht qëndrimit të tij në një burg të sigurisë së lartë, këto kushte ishin përshtatshme për një person me një të kaluar të tillë përse i takon çrregullimit mendor. Gjithashtu, Gjykata konsideron se vizitat e rregullta të ankuesit në spitalin e burgut nuk mund të shihen si një zgjidhje, për sa kohë që ankuesi është duke e vuajtur një dënim me burgim të përjetshëm.

50. Gjykata nuk e nënvlerëson rëndësinë e vështirësive financiare të referuara nga pala shqiptare (shih paragrafin 33 më sipër). Megjithatë, ajo vëren se shumë prej mangësive të identifikuara më sipër mund të ishin ndrequr edhe në mungesën e mjeteve financiare të konsiderueshme. Në çdo rast, mungesa e burimeve financiare nuk mundet të justifikojë kushte të tilla vuajtje dënimi, të cilat janë kaq të varfra sa prekin nivelin minimal të vuajtjes së dënimit të parashikuar nga neni 3, duke bërë që ai të zbatohet në këtë rast, (shih *Poltoratsky*, § cituar më sipër, dhe *Iovchev v. Bulgaria*, no.41211/98, § 136, 2 shkurt 2006).

51. Duke pasur parasysh efektet në tërësi të të gjitha kushteve të papërshtatshme të vuajtjes së dënimit, të cilave iu ishte nënshtruar ankuesi, të cilat kishin pasur efekt të dëmshëm në shëndetin

dhe mirëqenien e tij (shih Kalashnikov, cituar më sipër, § 98), konstatimet e CPT-së në raportet më të fundit në lidhje me kushtet e vuajtjes së dënimit në burgjet shqiptare, në veçanti për sa i përket të burgosurve të sëmurë mendërisht (shih paragrafet 19-20 më sipër), dhe precedentin e saj në këtë fushë (shih paragrafin 41 më sipër), Gjykata konsideron se natyra, kohëzgjatja dhe vuajtja e dënimit sa i takon keqtrajtimit të të cilit ankuesi i ishte nënshtruar, si dhe efektet që kanë pasur në tërësi mbi gjendjen e tij shëndetësore, janë të mjaftueshme për t'u kualifikuar si çnjerëzore dhe degraduese (shih *Egmez v. Cyprus*, no. 30873/96, § 77, ECHR 2000-XII; *Labzov v. Russia*, no. 62208/00, § 45, 16 qershor 2005; dhe *Mayzit v. Russia*, no. 63378/00, § 42, 20 janar 2005).

52. Pra është shkelur neni 3 i Konventës.

II. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS

A. Parashtrimet e palëve

53. Duke u mbështetur në nenin 6 §1 të Konventës, ankuesi ankohet për parregullsinë e proceseve në lidhje me kërkesën e tij për lirimin nga burgu ose mbylljen në një institucion të specializuar të përshtatshëm për gjendjen e tij shëndetësore. Në veçanti, ai u ankua që gjykatat e brendshme nuk i kishin dhënë atij një mundësi për t'u kontrolluar nga një psikolog i pavarur dhe i paanshëm, i cili do të përcaktonte natyrën e këtij çrregullimi mendor, duke e vendosur atë në një situatë të disfavorshme përballë prokurorit dhe duke mos respektuar parimin e barazisë së mjeteve.

54. Pala shqiptare e kundërshtoi këtë argument. Ata parashtruan se ankuesi kishte pasur mundësinë për të provuar se kushtet e vuajtjes së dënimit të tij kishin kërcënuar jetën e tij. Në parashtrimet e tyre, pretendimet e ankuesit lidhur me rezultatin e proceseve në fjalë duhet të mos pranohen nga Gjykata, pasi nga vetë natyra e tyre i përkasin një instance të shkallës së katërt.

B. Vlerësimi i Gjykatës

55. Gjykata rikujton precedentin e qëndrueshëm të mekanizmave të Konventës, për sa i përket përfundimit që proceset në lidhje me ekzekutimin e një dënimi, të dhëna nga një gjykatë kompetente, duke përfshirë edhe proceset e dhënies së një lirimi me kusht, nuk hyjnë në qëllimin e nenit 6 § 1 të Konventës. Sipas këtij neni nuk mund të jepet një përcaktim, as për një “akuzë penale” dhe as lidhur me “të drejtat dhe detyrimet civile” (shih, përsëmbull, *Aldrian v. Austria*, no. 16266/90, vendim i Komisionit i datës 7 maj 1990, Vendime dhe raporte (DR) 65, p.337; *A.B v. Switzerland*, no. 20872/98, vendim i Komisionit i datës 22 shkurt 1995, DR 80, pp.66 dhe 72; *Grava v. Italy* (dec), no. 43522/98, 5 dhjetor 2002; *Husain v. Italy* (dec.), no. 18913/03, 24 shkurt 2005; dhe *Sannino v. Italy* (dec.), no. 30961/03, 24 shkurt 2005).

56. Gjykata vëren se shpallja fajtor dhe masa e dënimit për ankuesin u lanë në fuqi nga gjykatat e brendshme në të tria shkallët e gjyqësorit. Ankuesi është duke vuajtur dënimin me burg prej shumë kohësh. Gjykata nuk është e bindur nëse vendimi i marrë nga gjykatat e brendshme në lidhje me kërkesën e ankuesit për të vuajtur dënimin e tij në një institucion të specializuar në përputhje me gjendjen e tij shëndetësore apo për t'u liruar, përfshihen në përcaktimin e “një akuze penale” ose “të drejtave dhe detyrimeve civile” brenda kuptimit të nenit 6 § 1. Kërkesa e ankuesit lidhet në praktikë me mënyrën e ekzekutimit të dënimit të tij.

57. Gjykata për më tepër vëren se Konventa nuk garanton, si të tillë, të drejtën për lirim të kushtëzuar ose vuajtjen e një dënimi në përputhje me regjimin e veçantë të dënimeve (shih *Aldrian*, vendim i Komisionit i cituar më sipër dhe *Savic v. Slovakia*, no. 28409/95, vendim i Komisionit i datës 3 dhjetor 1997).

58. Ajo vijon se kjo pjesë e ankimit nuk duhet pranuar në përputhje me nenin 35 § 3 dhe 4 të Konventës.

III. ZBATIMI I NENEVE 46 DHE 41 TË KONVENTËS

A. Neni 46 i Konventës

59. Neni 46 i Konventës parashikon:

“1. Palët e Larta Kontraktuese zotohen t’iu binden vendimeve përfundimtare të Gjykatës në mosmarrëveshjet në të cilat ata janë palë.

2. Vendimi përfundimtar i Gjykatës i transmetohet Komitetit të Ministrave, i cili mbikëqyr zbatimin e tij.”.

60. Neni 41 i Konventës vijon sa më poshtë:

“Kur Gjykata konstaton shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj, dhe e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese mundëson vetëm ndreqjen e pjesshme të pasojave të shkaktuara nga shkelja, Gjykata kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar.”

Ankuesi tregoi se ai ishte ndaluar/dënuar në kushte të varfëra, nga viti 2002 e më tej, kohë gjatë së cilës ai nuk kishte marrë trajtimin e duhur mjekësor. Ai kërkoi të vendosej në një institucion mjekësor të specializuar në përputhje me gjendjen e tij shëndetësore, dhe gjithashtu kërkoi 500,000 euro në lidhje me dëmin pasuror dhe jopasuror të shkaktuar. Meqenëse autoritetet nuk kishin zbatuar kërkesën e mësipërme, ai pretendoi 1,000,000 euro, përsa i përket kësaj kërkesë lidhur me dëmin pasuror dhe jopasuror.

62. Gjykata u kufizua për sa i përket këtij pretendimi, pasi nuk kishte asnjë provë që t'i mbështeste pretendimet e ankuesit.

63. Gjykata ritheksoi se, në përputhje me nenin 46 të Konventës, një konstatim i shkeljes i imponon shtetit të paditur një detyrim ligjor jo vetëm të kompensojë shumat e kërkuara duke e dëmshtëpërblyer sipas nenit 41, por gjithashtu të përcaktojë mbikëqyrjen e personin që do të mbikëqyret nga Komiteti i Ministrave, masat e përgjithshme dhe/ose kur është e nevojshme ato individuale që do adoptohen në legjislacionin e tyre të brendshëm, për t'i dhënë fund shkeljes së konstatuar nga Gjykata dhe t'i korrigjojë sa më shpejt të jetë e mundur efektet/pasojat, proces i cili mbikëqyret nga Komiteti i Ministrave (shih *Bronioski v. Poland* [GC], no. 31443/96, § ECHR 2004-V).

64. Gjykata ka bërë shënimet e duhura për angazhimin e shtetit shqiptar lidhur me përmirësimin e kushteve në burg. Në këtë drejtim shteti shqiptar duhet të gjejë rrugën e duhur për çështjen në fjalë, duke respektuar sistemin e përshkruar me një frymë mbrojtëse, i cili është i krijuar nga Konventa. Megjithatë Gjykata konstaton se, në këndvështrimin e konstatimeve të saj në çështjen në fjalë, duhet të merren urgjentisht masat e domosdoshme për t'i siguruar kushtet e duhura të vuajtjes së dënimit dhe trajtimin mjekësor të përshtatshëm, në veçanti për sa i përket të burgosurve si ankuesi të cilët kanë nevojë për një kujdes të veçantë në përputhje me gjendjen e tyre shëndetësore.

A Dëmi

65. Përsa i përket dëmit pasuror të pretenduar së është shkaktuar, Gjykata ritheksoi se duhet të ketë një lidhje shkakësore të dukshme ndërmjet dëmit të pretenduar nga ankuesi dhe shkeljes së Konventës (shih *Barberà, Messeguè and Jabardo v. Spain*, vendim i datë 13 qershor 1994 (neni 50 i mëparshëm), seria A no. 285-C, §§ 16-20; shih gjithashtu *Berktaş v. Turkey*, no. 22493/93, § 215, 1 mars 2001; dhe *Khudobin v. Russia*, no. 59696/00, § 142, ECHR 2006-... (extracts)).

66. Gjykata, duke pasur parasysh konstatimet e saj në lidhje me ankimin e ankuesit në bazë të nenit 3 të Konventës, çmon se nuk ka lidhje shkakësore ndërmjet dëmit të pretenduar dhe shkeljes së konstatuar (shih *Kalashnikov*, cituar më sipër, § 139). Në këtë mënyrë ajo nuk e pranon pretendimin e ankuesit lidhur me dëmin pasuror.

67. Për sa i përket dëmit jopasuror, Gjykata vëren se të drejtat e ankuesit në bazë të nenit 3 të Konventës janë shkelur. Ajo çmon se ankuesi ka vuajtur një dëm të natyrës jopasurore, si rezultat i dënimit të tij në kushte çnjerëzore dhe degraduese, të papërshtatshme me gjendjen e tij shëndetësore (shih paragrafët 51-52 më sipër), e cila nuk është korrigjuar mjaftueshmërisht vetë nga një konstatim i shkeljes së të drejtave të tij në bazë të Konventës.

68. Për arsyet e sipërpërmendura, duke pasur parasysh rrethanat specifike të çështjes konkrete dhe jurisprudencën e Gjykatës në rastet e ngjashme (shih, *mutatis mutandis*, *Peers*, cituar më sipër, § 88; *Khokhlich v. Ukraine*, no. 41707/98, § 228, 29 prill 2003; dhe *Melnik*, cituar më sipër, § 121) dhe duke vendosur mbi baza të paanshme, Gjykata i cakton ankuesit 5.000 euro në lidhje me këtë shkelje, plus ndonjë takse që mund të jetë e tatueshme mbi këtë shumë.

B. Kosto dhe shpenzime

69. Ankuesi nuk pretendoi kosto dhe shpenzime as për proceset lidhur me Konventën dhe as për proceset para gjykatave të brendshme, përveç atyre të dhëna për ndihmën ligjore.

C. Interesi i mospagimit

70. Gjykata çmon të nevojshme se interesi i mospagimit duhet të bazohet në normën marzhinale të huadhënies së Bankës Qendrore Europiane, të cilës duhet t'i shtohen tre për qind pikë.

Për këto arsye gjykata, njëzëri:

1. I deklaron ankesat lidhur me papërshtatshmërinë e kushteve të vuajtjes së dënimit të ankuesit në burg dhe trajtimin mjekësor që ai ka marrë në këndvështrimin e gjendjes së tij shëndetësore, të pranueshme dhe pjesën tjetër të ankimit të papranueshme.

2. Vlerëson se ka patur shkelje të nenit 3 të Konventës.

3. Vlerëson se:

a) Shteti i paditur duhet t'i paguajë ankuesit, brenda 3 muajve nga data në të cilën vendimi merr formë të prerë në pajtim me nenin 44 § 2 të Konventës, shumën prej 5,000 euro (pesë mijë euro) në lidhje me dëmin jopasuror, i cili do të konvertohet në monedhën vendase të shtetit të paditur, në normën e zbatueshme në datën e shlyerjes, duke përfshirë edhe ndonjë taksë që mund të jetë e tatueshme;

b) që nga skadimi i afatit të sipërpërmendur prej tre muajsh, interesi i thjeshtë i shlyerjes do të jetë i pagueshëm mbi shumat e mësipërme në një normë të barabartë me normën marzhinale të huadhënies së Bankës Qendrore Europiane gjatë periudhës së mospagimit, plus tre pikë për qind.

4. Hedh poshtë pjesën e mbetur të pretendimeve të ankuesit për zhdëmtim të drejtë.

Përgatitur në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 18 dhjetor 2007, sipas rregullit 77 § 2 dhe 3 të rregullores së Gjykatës.

T.L EARLY
Kryesekretar

Nicolas BRATZA
Kryetar

VENDIM
(Ankimi nr.37959/02)
ÇËSHTJA “XHERAJ KUNDËR SHQIPËRISË”

STRASBURG
29 korrik 2008

PËRFUNDIMTAR
01.12.2008

Ky vendim do të marrë formë të prerë në rrethanat e parashikuara në nenin 44 § 2 të Konventës. Ai mund t’u nënshtrohet rishikimeve editoriale.

Kjo çështje trajton shkeljen e të drejtës së ankuesit për proces të rregullt ligjor si pasojë e prishjes së vendimit të formës së prerë që e deklaronte atë të pafajshëm (shkelje e Nenit 6.1 të Konventës). Gjykata Evropiane ka konstatuar se apeli i prokurorit dhe prishja e vendimit të pafajësisë ndaj ankuesit nuk heq një vijë të drejtë ndërmjet interesave të ankuesit dhe efektivitetit të sistemit të drejtësisë penale. Vendimi i Gjykatës së Lartë që prishi vendimin e pafajësisë ishte në shkelje të parimit të sigurisë juridike. Gjykata Evropiane ka tërhequr vëmendjen se nuk mund të lejohet rivendosja në afat për të bërë ankim kundër vendimit gjyqësor të formës së prerë kur nuk ka arsye serioze ligjore që e lejojnë atë, sikurse është konstatuar kjo praktikë e pranuar nga gjykatat e brendshme.

Në çështjen “Xheraj kundër Shqipërisë”,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (seksioni i katërt), i përbërë nga trupi gjyqësor:

Lech Garlicki kryetar

Ljiljana Mijović

David Thór Björgvinsson

Ján Šikuta

Päivi Hirvelä

Ledi Bianku

Mihai Poalelungi gjyqtarë

dhe Lawrence Early sekretar.

Pas shqyrtimit të çështjes në seancë të mbyllur më 8 korrik 2008,

jep vendimin e mëposhtëm, i cili është miratuar në të njëjtën datë.

PROCEDURA

287. Çështja filloi me depozitimin e aplikimit (nr.37959/02) kundër Republikës së Shqipërisë në Gjykatë, sipas nenit 34 të Konventës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore (Konventa) nga një nënshtetas shqiptar z. Arben Xheraj (ankuesi), më 20 shtator 2002.

288. Ankuesi u përfaqësua nga z. D. Bengasi, avokat që ushtron profesionin në Tiranë. Qeveria Shqiptare (Qeveria) u përfaqësua nga agjentët e saj, z. S. Puto dhe znj. S. Meneri.

289. Ankuesi, në bazë të neneve 6 §§ 1 dhe 3 të Konventës, pretendon se procesi për rishikimin e vendimit për pafajësinë e tij, i cili mori formë përfundimtare, kishte qenë i padrejtë, pasi as ai dhe as avokati i tij nuk ishin informuar për seancat gjyqësore dhe si rezultat, ata nuk kishin qenë në gjendje të mbrojnë çështjen. Pa dhënë shkaqe, ankuesi pretendon shkelje të nenit 10 të Konventës. Së fundmi ai u ankua për shkelje të parimit të *ne bis in idem*, parashikuar në nenin 4 të protokollit nr.7, pasi në vendimin e saj të datës 20 qershor 2001 Gjykata e Lartë parashikonte një sanksion të dytë për të njëjtën vepër penale, atë të vrasjes.

290. Më 8 shtator 2005, kryetari i seksionit të katërt të Gjykatës vendosi që ta njoftonte Qeverinë për aplikimin. Sipas dispozitave të nenit 29 § 3 të Konventës u vendos që të shqyrtohej themeli i aplikimit në të njëjtën kohë me pranueshmërinë e tij.

291. Si ankuesi, ashtu edhe Qeveria depozituan vëzhgime me shkrim (rregulli 59 § 1).

FAKTET

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

292. Ankuesi ka lindur në vitin 1970 dhe aktualisht po vuan dënimin në burgun e Viçencës në Itali.

A. Proceset që çuan në dënimin e ankuesit

293. Në vitin 1995 zyra e prokurorisë së qytetit të Durrësit e akuzoi ankuesin për vrasje, mbi bazën e provave të babait të viktimës, i cili deklaroi se para se të vdiste viktimë i kishte thënë se ankuesi ishte një ndër vrasësit. Hetimi në lidhje me tre të dyshuar të tjerë u ndërpre.

294. Babai i ankuesit, kur u mor në pyetje nga policia, deklaroi se ankuesi kishte udhëtuar për në Itali me dy persona të tjerë ditët kur ishte kryer vrasja.

295. Më 27 nëntor 1996, ankuesi, *in absentia*, u deklarua fajtor për veprën penale të vrasjes, të parashikuar në nenin 76 të Kodit Penal dhe u dënua me 20 vjet heqje lirie nga Gjykata e Apelit të Durrësit. Ankimimi i tij në Gjykatën e Kasacionit të asaj kohe u deklarua i papranueshëm më 10 mars 1997.

B. Proceset që çuan në deklarimin e ankuesit të pafajshëm

296. Pas nënshkrimit të një autorizimi nga babai i ankuesit më 10 dhjetor 1997, sipas nenit 450 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), avokati i ankuesit kërkoi rishikimin gjyqësor të vendimit të gjykatës së apelit me anë të një kërkesë që mbante të njëjtën datë. Aplikimi për rishikim gjyqësor arriti në gjykatën e rrethit më 11 dhjetor 1997.

297. Në kërkesën për rishikim gjyqësor deklarohet se kishin dalë prova të reja në favor të ankuesit. Së pari, nga raporti i autopsisë, dilte se viktimë ishte qëlluar me thikë në zemër dhe kishte vdekur menjëherë, si rrjedhim, nga pikëpamja shkencore, viktimë nuk kishte qenë në gjendje të komunikonte. Së dyti, dy dëshmitarë deklaruan se ata kishin udhëtuar që herët në mëngjes me traget për në Itali në kohën kur kishte ndodhur vrasja.

298. Më 13 dhjetor 1997 ankuesi autorizoi të njëjtin avokat, i cili ishte caktuar nga i ati më 10 dhjetor 1997, për ta përfaqësuar atë në proceset e brendshme gjyqësore.

299. Me anë të një letre të datës 26 gusht 1998 dërguar prokurorit të rrethit, Drejtoria e Hetimit dhe Inspektimit në zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm dërgoi dosjen e çështjes së ankuesit dhe shtoi se:

“kërkesa për rishikimin e vendimit plotëson kriteret ligjore”.

Ajo i kërkoi prokurorit të rrethit të shqyrtonte objektivisht provat e reja që do t'i çoheshin gjykatës së rrethit.

300. Prokurori i rrethit, i cili rezultoi të ishte i njëjti person që kishte marrë pjesë në gjykimin e parë, mori pjesë në proces dhe kërkoi rrëzimin e çështjes në përputhje me nenin 328 (dh) të Kodit të Procedurës Penale, i cili thotë që çështja mund të rrëzohet “nëse rezulton se i pandehuri nuk e ka kryer veprën penale ose nëse nuk provohet se ai e ka kryer veprën penale.”

301. Më 27 nëntor 1998, Gjykata e Rrethit të Durrësit e deklaroi aplikimin e ankuesit për rishikimin e vendimit të papranueshëm. Gjykata vendosi për themelin e çështjes dhe pas shqyrtimit të provave të reja dhe pas marrjes parasysh të kërkesës së zyrës së prokurorit, rrëzoi vendimin e gjykatës së apelit të datës 27 nëntor 1996 (shih paragrafin 9 më lart) dhe e deklaroi të pafajshëm ankuesin më 14 dhjetor 1998 (vendimi i pafajësisë).

302. Kundër vendimit nuk u bë asnjë ankimim brenda afatit të parashikuar prej 10 ditëve dhe si rezultat, vendimi u bë përfundimtar më datë 24 dhjetor 1998.

C. Kërkesa e prokurorit për leje për rivendosje në afat

303. Më 8 tetor 1999, prokurori në Gjykatën e Apelit të Durrësit (prokurori i apelit) depozitoi një kërkesë për leje për rivendosje në afat kundër vendimit të pafajësisë në Gjykatën e Rrethit të Durrësit. Prokurori i apelit deklaroi si bazë të kërkesës së tij mangësitë e vëna re në lidhje me prokurorin e rrethit. Duke iu referuar nenit 26 § 1 të Kodit të Procedurës Penale rreth dorëheqjes së një prokurori në rastet e mungesës së paanshmërisë, përmbajtja e të cilit i referohet dorëheqjes së një gjyqtari sipas nenit 17 të Kodit të Procedurës Penale, prokurori i apelit pretendonte se prokurori i rrethit që kishte marrë pjesë në proceset e gjykimin të parë nuk duhet të

kishte marrë pjesë dhe në procesin e rishikimit të vendimit. Neni 17 § 1 (c) i Kodit të Procedurës Penale parashikon se një gjyqtar duhet të japë dorëheqjen “kur ai ka dhënë këshilla ose ka shprehur mendim rreth subjektit të procesit.”

304. Prokurori i apelit argumentonte se familja e viktimës, e cila kishte qenë palë e dëmtuar në proces, nuk ishte informuar për procesin e pafajësisë në përputhje me nenin 137 të Kodit të Procedurës Penale. Prokurori i apelit u vu në dijeni për vendimin e pafajësisë në një datë të paspecifikuar para fundit të shtatorit të vitit 1999, kur ankimi i familjes së viktimës për pafajësinë u ishte dërguar autoriteteve të tjera.

305. Më 21 tetor 1999, Gjykata e Rrethit të Durrësit, në mungesë të ankuesit dhe në prani të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht, pavarësisht nga ekzistenca e një avokati mbrojtës të përzgjedhur nga ankuesi (shih paragrafin 12 më lart), i dha leje prokurorit që të apelonte jashtë afatit normal kohor.

306. Në një datë të paspecifikuar, avokati i caktuar kryesisht për procesin në Gjykatën e Rrethit të Durrësit, e apeloj çështjen në Gjykatën e Apelit të Durrësit duke sfiduar vendimin e lartpërmendur, pasi ankuesi nuk ishte njoftuar dhe vendimi nuk i ishte shërbyer atij në përputhje me nenin 414 të Kodit të Procedurës Penale. Ndërkohë, në përputhje me vendimin e gjykatës së rrethit të datës 21 tetor 1999, prokurori i apelit depozitoi një ankesë kundër vendimit të pafajësisë.

307. Më 15 dhjetor 1999, Gjykata e Apelit të Durrësit rrëzoi kërkesën e avokatit të caktuar kryesisht me arsyetimin se vendimi që e lejon prokurorin të apelojë jashtë afatit kohor, nuk është subjekt ankimi sipas nenit 147 § 5 të PKK-së, pasi ai nuk shënon fundin e procesit penal. Ajo rrëzoi gjithashtu dhe kërkesën e prokurorit, pasi ai nuk i është njoftuar shprehimisht/qartësisht ankuesit në përputhje me nenin 414 të KPP-së. Në një datë të paspecifikuar prokurori e çoi çështjen në Gjykatën e Lartë.

308. Më 19 prill 2000, seksioni penal i Gjykatës së Lartë rrëzoi vendimin e Gjykatës së Apelit të Durrësit të datës 15 dhjetor 1999. Ajo identifikoi që kërkesat në lidhje me njoftimin e vendimeve gjyqësore për avokatin e caktuar kryesisht të ankuesit ishin plotësuar, përderisa ankuesi konsiderohej i larguar. Si rezultat, gjykata pranoi kërkesën e prokurorit për rivendosje në afat kundër vendimit të pafajësisë dhe ia ktheu çështjen Gjykatës së Apelit të Durrësit për rishqyrtim.

D. Apeli i vonuar i prokurorit

309. Në përputhje me parashtrimet e prokurorit të apelit në Gjykatën e Apelit të Durrësit, pafajësia duhej të deklarohet e pavlefshme për sa kohë që provat e reja të paraqitura nga ankuesi, dhe në rast se ato e pajisnin ankuesin me një alibi, ishin depozituar shumë vonë. Për më tepër, prokurori që kishte marrë pjesë në procesin e rishikimit të vendimit gjyqësor kishte marrë pjesë dhe në gjykimin fillestar. Së fundmi, pretendohet se avokati i ankuesit nuk kishte të drejtë të fillonte procesin për rishikim vendimi, pasi ankuesi kishte nënshkruar një autorizim dy ditë pas depozitimit të aplikimit për rishikim vendimi.

310. Më 18 dhjetor 2000, Gjykata e Apelit të Durrësit konfirmoi arsyetimin e parashtruar në vendimin e pafajësisë të datës 14 dhjetor 1998 dhe rrëzoi kërkesën e prokurorit. Avokati i caktuar kryesisht u njoftua për vendimin. Në një datë të paspecifikuar, duke cituar të njëjtat arsye apeli që kishte depozituar në Gjykatën e Apelit të Durrësit, prokurori e ankimoi çështjen në Gjykatën e Lartë, duke pretenduar se vendimi i pafajësisë ishte i pavlefshëm.

311. Më 20 qershor 2001, seksioni penal i Gjykatës së Lartë la në fuqi shkaqet e apelit të prokurorit, dhe, duke vendosur për themelin e çështjes, anuloi vendimin e pafajësisë. Ajo arsyetoi se ishin shkelur dispozitat e KPP-së në lidhje me kapacitetin juridik të avokatit të ankuesit për të depozituar një aplikim për rishikim vendimi më 11 dhjetor 1997. Ajo vuri re se avokati ishte caktuar të vepronte nga ankuesi më 13 dhjetor 1997, d.m.th. 2 ditë pas depozitimit të kërkesës në gjykatën e rrethit. Gjykimi iu njoftua avokatit të caktuar kryesisht.

312. Në vitin 2002, ankuesi, i cili që prej vitit 1999 e në vijim ka vuajtur dënimin e lëshuar nga gjykatat italiane me 16 vjet heqje lirie në burgun e Viçencës (Itali) për trafikim ndërkombëtar droge, u njoftua për vendimin e Gjykatës së Lartë, që kishte çuar në rishikimin e pafajësisë së tij, pas një kërke të autoriteteve shqiptare për ekstradimin e tij.

E. Procesi në Gjykatën Kushtetuese

313. Më 13 shkurt 2002 avokati i caktuar nga ankuesi, i cili kishte vepruar në emër të tij në procesin e rishikimit të vendimit (shih paragrafin 1 më lart) depozitoi një ankesë në Gjykatën Kushtetuese, duke pretenduar cenim të së drejtës kushtetuese të ankuesit për gjykim të drejtë dhe shkelje të nenit 6 §§ 1 dhe 3 (a) dhe (c) të Konventës.

314. Në parashtrimet para gjykatës, ankuesi pretendonte se proceset e gjykatave të brendshme nuk kishin qenë të rregullta, me arsyetimin se as ai dhe as avokati mbrojtës i zgjedhur prej tij nuk ishin informuar për kryerjen e proceseve dhe se ai kishte pretenduar të ishte larguar pavarësisht nga fakti se ai kishte caktuar një avokat, aftësia juridike e të cilit formon bazën e ankesës së prokurorit kundër pafajësisë.

315. Për më tepër, ankuesi parashtroi se në lidhje me faktin se autoritetet shqiptare kishin trajtuar dy kërkesa për autoritetet italiane për ekstradimin e tij në Shqipëri, kishte arsye të besojë se autoritetet shqiptare kishin pasur mundësinë e njoftimit për kryerjen e proceseve dhe të ofrimit të vendimeve të gjykatës për të.

316. Në lidhje me themelin e çështjes që çoi në anulimin e pafajësisë së tij, ankuesi pretendon se kapaciteti juridik i avokatit të tij nuk e lejonte këtë gjë, pasi më datën 10 dhjetor 1997 babai i tij e kishte autorizuar avokatin ta përfaqësonte ankuesin para gjykatave kombëtare në proceset për rishikim vendimi dhe se ai e kishte konfirmuar autorizimin më datë 13 dhjetor 1997.

317. Më 26 prill 2002, Gjykata Kushtetuese vendosi të deklaronte *de plano* ankimin e ankuesit si të papranueshëm, pasi ai nuk ishte në juridiksionin e saj.

II. LEGJISLACIONI DHE PRAKTIKA E BRENDSHME

A. Kushtetuta e Shqipërisë

318. Kushtetuta e Shqipërisë, në pjesët e saj përkatëse, parashikon se:

Neni 31

Gjatë procesit penal kushdo ka të drejtë:

- a) të vihet në dijeni menjëherë dhe hollësisht për akuzën që i bëhet, për të drejtat e tij, si dhe t'i krijohet mundësia për të njoftuar familjen ose të afërmit e tij;
- b) të ketë kohën dhe lehtësitë e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e vet;
- c) të ketë ndihmën pa pagesë të një përkthyesi, kur nuk flet ose nuk kupton gjuhën shqipe;
- d) të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij, të komunikojë lirisht dhe privatisht me të, si dhe t'i sigurohet mbrojtja falas, kur nuk ka mjete të mjaftueshme;
- e) t'u bëje pyetje dëshmitarëve të pranishëm dhe të kërkojë paraqitjen e dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.

Neni 32

1. Askush nuk mund të detyrohet të dëshmojë kundër vetvetes ose familjes së vet dhe as të pohojë fajësinë e tij.

2. Askush nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme.

Neni 33

1. Kushdo ka të drejtë të dëgjohet para se të gjykohet.

2. Nga kjo e drejtë nuk mund të përfitojë personi që i fshihet drejtësisë.

Neni 34

Askush nuk mund të dënohet më shumë se një herë për të njëjtën vepër penale dhe as të gjykohet sërish, me përjashtim të rasteve kur është vendosur rigjykimi i çështjes nga një gjykatë më e lartë, sipas mënyrës së parashikuar me ligj.

Neni 42 § 2

“Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.”

Neni 43

Kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveçse kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe.

Neni 142 § 3

“Strukturat shtetërore respektojnë vendimet gjyqësore.”

Neni 131

“Gjykata Kushtetuese vendos: ...

f) gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave;”

B. Kodi i Procedurës Penale

319. Pjesët përkatëse të Kodit të Procedurës Penale (KPP) që ishin në fuqi në atë kohë, parashikonin si më poshtë:

320. Neni 26 § 1 i KPP-së i kërkon një prokurori të japë dorëheqjen kur ka arsye për të dyshuar për anshmëri në rastet e parashikuara në nenin 17 të KPP-së. Neni 17 i referohet dorëheqjes së një gjyqtari nga gjykimi i një çështjeje ekzistuese. Neni 17 § 1 (c) i kërkon një gjyqtari të japë dorëheqjen në rast se ai ka dhënë këshilla ose ka shprehur një mendim për subjektin e procesit.

321. Neni 48 i Kodit të Procedurës Penale (KPP) parashikon se pala e paditur zgjedh avokatin e saj me anë të parashtrimeve me gojë në një seancë gjyqësore ose me anë të një autorizimi që dërgohet me postë të regjistruar. Edhe të afërmit e të paditurit mund të zgjedhin një avokat për të përfaqësuar të paditurin që është ndaluar, arrestuar ose gjykuar dhe dënuar me burgim, me anë të metodave të lartpërmendura, në përjashtim të rasteve kur i padituri e ka zgjedhur avokatin e tij.

322. Neni 58 i Kodit të Procedurës Penale (KPP) i jep të drejtë palës së dëmtuar nga një veprë penale ose trashëgimtarëve të tij të kërkojë ndjekjen e autorit të veprës dhe dëmshpërblim. Neni 409 e lejon palën e dëmtuar të depozitojë një ankesë vetë ose nëpërmjet përfaqësuesit të tij ligjor në lidhje me aspektet penale dhe civile.

323. Sipas nenit 147 § 1 të KPP-së, një palë në proces, që nuk ka mundur të ankimojë kundër një vendimi brenda kohës së parashikuar si rezultat i aktiviteteve të paparashikuara ose shkaqe të forcës madhore, mund të kërkojë rivendosje në afat. Sipas nenit 147 § 2, një të padituri të gjykuar në mungesë mund t'i jepet e drejta për rivendosje në afat kundër një vendimi gjykate, nëse ai vërteton se nuk kishte pasur dijeni për vendimin. Sipas nenit 147 § 3 kërkesa për rivendosje në afat duhet të bëhet dhjetë ditë brenda datës kur palët marrin njoftim për vendimin. Sipas nenit 147 § 5, vendimi për rivendosje në afat mund të apelohej në lidhje me vendimin për themelin e çështjes.

324. Sipas nenit 414 mund të depozitohet një ankesë në gjykatën e apelit brenda 10 ditëve duke filluar nga dita e deklarimit ose njoftimit të vendimit.

325. Nenet 449 dhe 451 të KPP-së parashikojnë se rishikimi i vendimit gjyqësor mbi bazën e rrethanave të reja të zbuluara duhet të depozitohet nga njëra palë në proces në të njëjtën gjykatë që ka dhënë vendimin fillestar. Një aplikim i tillë bëhet brenda pesë vjetëve nga dhënia e vendimit të pafajësisë.

LEGJISLACIONI

I. PRETENDIMI PËR SHKELJE TË NENIT 6 §§ 1, 3 (a) dhe (c) TË KONVENTËS

326. Ankuesi u ankua se vendimi i Gjykatës së Lartë i datës 20 qershor 2001, i dhënë pas pafajësisë së tij përfundimtare, përbënte shkelje të së drejtës së tij për proces të rregullt ligjor dhe se vendimi i pafajësisë, i cili ishte vendim përfundimtar u anulua nga kjo gjykatë. Ai u ankua gjithashtu për faktin se as ai dhe as avokati mbrojtës i zgjedhur prej tij nuk u njoftuan menjëherë për kërkesën e prokurorit për rivendosje në afat kundër vendimit të pafajësisë. Ai u bazua në nenet 6 § 1 dhe 6 § 3 (a) dhe (c) të Konventës, pjesët përkatëse të së cilës parashikojnë:

“1. në përcaktimin e ... çdo akuze penale kundrejt tij, kushdo gëzon të drejtën e të dëgjuarit ... të drejtën ... nga [një] ... gjykatë ...”

...

3. Kushdo i akuzuar për një vepër penale ka këto të drejta minimale:

a) Të informohet menjëherë, në një gjuhë që e kupton dhe në detaje për natyrën dhe shkakun e akuzës së ngritur kundër tij.

...

c) Të mbrohet personalisht ose nëpërmjet ndihmës ligjore të përzgjedhur prej tij, nëse nuk ka mjete të mjaftueshme për të paguar për ndihmë ligjore, t'i ofrohet kjo ndihmë pa pagesë kur kërkohet nga interesat e drejtësisë;”

...

A. PRANUESHMËRIA

327. Qeveria parashtroi se aplikimi ishte i papranueshëm, pasi ai është depozituar jashtë afatit. Për shkak se Gjykata Kushtetuese e kishte deklaruar kërkesën e ankuesit të papranueshme më 26 prill 2002, vendimi i fundit gjyqësor për qëllime të nenit 35 të Konventës në fakt është vendimi i Gjykatës së Lartë i datës 20 qershor 2001, ndërsa ankuesi e ka paraqitur kërkesën e tij më datë 20 shtator 2002.

328. Në përgjigjen e tij ankuesi parashtroi se apelimi në Gjykatën Kushtetuese është mjet i brendshëm juridik që duhet ezauruar brenda rendit të brendshëm ligjor. Si rezultat, vendimi i Gjykatës Kushtetuese për papranueshmërinë duhet të konsiderohet si vendimi i fundit gjyqësor i brendshëm.

329. Gjykata thekson konstatimet e saj në vendimin për pranueshmërinë për çështjen “Balliu kundër Shqipërisë” (nr. 74727/01), i respektuar dhe në çështjen “Beshiri dhe të tjerët kundër Shqipërisë”, (nr.7352/03, § 32, 22 gusht 2006), ku ajo vendosi se një ankesë në Gjykatën Kushtetuese të Shqipërisë mund të konsiderohet si mjet efektiv që duhet të përdoret për qëllimet e nenit 35 të Konventës kur u ngritën çështjet që lidhen me një proces të rregullt ligjor. Gjykata mendon se nuk ka arsye për të rrëzuar këtë konstatim në rrethanat e çështjes në fjalë.

330. Në fakt ankuesi e përdori këtë mjet. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese mban datën 26 prill 2002 dhe ankuesi e depozitoi ankimin e tij në gjykatë më datën 20 shtator 2002. Pra ai ka respektuar afatin prej gjashtë muajsh të parashikuar në nenin 35 të Konventës.

331. Gjykata konstaton se aplikimi nuk është i pabazuar brenda kuptimit të nenit 35 § 3 të Konventës. Ajo konstaton më tej se aplikimi për asnjë arsye tjetër nuk është i papranueshëm. Si rezultat aplikimi duhet të deklarohet i pranueshëm.

B. Themeli i çështjes

1. Siguria ligjore: rrëzimi i një vendimi përfundimtar

a) Parashtrimet e palëve

332. Ankuesi deklaroi se fillimisht i ati caktoi një avokat të vepronte në emër të tij me anë të një autorizimi të nënshkruar më 10 dhjetor 1997. Ky autorizim u bë pjesë e dosjes së çështjes dhe nuk duhet të injorohet nga gjykatat e brendshme në lidhje me procedurat e njoftimit për ankuesin. Ai shtoi se prokurori nuk kishte arsye ligjore (aktivitete të paparashikuara ose *force majeure*) sipas nenit 147 § 1 të KPP-së për të kërkuar leje për apelim jashtë afatit kohor të përcaktuar kundër vendimit të pafajësisë, i cili ishte vendim përfundimtar, pasi autoritetet gjithnjë ishin bërë të ndërgjegjshme për kërkesën për rishikim gjykim me anë të letrës së datës 26 gusht 1998 (shih paragrafin 13 më lart).

333. Për sa i përket mospërputhshmërisë së prokurorit të rrethit, i cili më parë kishte marrë pjesë në procesin që kishte çuar në dënimin e ankuesit në vitin 1996, ankuesi argumentoi se mospërputhshmëria e gjyqtarëve nuk zbatohej për prokurorët, nëse ata merrnin pjesë në procese në të njëjtin nivel gjykim.

334. Qeveria parashtroi se kërkesa e prokurorit për leje për apelim jashtë afatit erdhi si rezultat i shkeljeve procedurale nga ana e gjykatës së rrethit, e cila nuk e kishte njoftuar familjen e viktimës për pafajësinë e ankuesit në mënyrë që ata të mund të kishin të drejtë ankimi kundër vendimit të pafajësisë. Familja e viktimës u vu rastësisht në dijeni të atij vendimi disa muaj më vonë.

335. Sipas mendimit të Qeverisë, një arsye tjetër që çoi në apelin e vonuar të prokurorit ishte fakti që prokurori që mori pjesë në seancat gjyqësore të pafajësisë në gjykatën e rrethit nuk i informoi eprorët e tij për proceset në fjalë.

336. Qeveria është e mendimit se përderisa legjislacioni i brendshëm parashikon rishikimin e një vendimi gjyqësor, si dhe procedurën për të kërkuar rivendosje në afat, këto hapa nuk mund të konsiderohen si shkelje e parimit të sigurisë ligjore sipas nenit 6 § 1 të Konventës.

b) Vlerësimi i gjykatës

i. Parime të përgjithshme

337. Gjykata thekson se në kuadrin e preambulës së Konventës, shteti i së drejtës është pjesë e trashëgimisë së përbashkët të shteteve kontraktuese, një ndër aspektet themelore të të cilit është parimi i sigurisë ligjore, i cili kërkon, ndërmjet të tjerash, se kur gjykatat kanë vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i tyre nuk duhet të vihet në pikëpyetje (shih Brumărescu k. Rumanisë [GC], nr 28342/95, § 61, GJEDNJ 1999-VII).

338. Për më tepër, Gjykata vlerëson se kërkesat e sigurisë ligjore nuk janë absolute. Largimi nga parimi justifikohet vetëm nëse një gjë e tillë bëhet e nevojshme nga rrethanat e një karakteri substancial ose detyrues (Ryabykh k. Rosisë, nr. 52854/99, § 52, GJEDNJ 2003-IX) ose kur arsye serioze legjitime janë më me peshë se siguria juridike (shih Bratyakin k. Rosisë (dek.), nr. 72776/01, 9 mars 2006).

339. Thjesht mundësia e rihapjes së një çështjeje penale është *prima facie* në përputhje me Konventën, duke përfshirë dhe garancitë e nenit 6. Duhet të vlerësohet në kuadrin e nenit 4§2 të protokollit nr.7, për shembull, që e lejon shprehimisht një shtet të rihapë një çështje si rezultat i daljes së fakteve të reja ose kur zbulohet një defekt thelbësor në proceset e mëparshme, që mund të kenë ndikim mbi rezultatin e çështjes (shih Nikitin k. Rosisë, nr. 50178/99, § 54-57, GJEDNJ 2004-VIII, dhe Savinskiy k. Ukrainës, nr. 6965/02, § 23, 28 shkurt 2006). Rrethana të posaçme të çështjes mund të dëshmojnë se mënyra aktuale në të cilën përdoret një rishikim dëmton thelbin e një procesi të drejtë gjyqësor. Në veçanti, gjykatës i duhet të vlerësojë nëse, në një rast të caktuar, kompetenca për të nisur dhe për të kryer një [...] rishikim ushtrohet nga autoritetet për të arritur, sa më maksimalisht të jetë e mundur, një balancë të drejtë ndërmjet interesave të individit dhe nevojës për të siguruar efektivitetin e sistemit të drejtësisë penale (shih Bujnița k. Moldovisë, nr. 36492/02, § 21, 16 janar 2007).

340. Konsideratat përkatëse që duhet të merren parasysh në këtë pikë, përfshijnë, në veçanti, efektin e rihapjes dhe proceseve të tjera pasuese mbi situatën individuale të ankuesit dhe nëse rihapja vjen si rezultat i kërkesës së vetë ankuesit, arsyet në bazë të të cilave autoritetet e brendshme revokojnë vendimin përfundimtar në çështjen e ankuesit; përputhshmërinë e procedurës në fjalë me kërkesat e legjislacionit të brendshëm, praninë dhe funksionimin e sigurive procedurale në sistemin e brendshëm ligjor të afta për të parandaluar abuzime të kësaj procedure nga autoritetet e brendshme dhe rrethana të tjera përkatëse të çështjes (Radchikov k. Rosisë, nr. 65582/01, § 44, 24 maj 2007).

ii. Zbatimi i parimeve të sipërpërmendura në çështjen në fjalë

341. Gjykata vë re se në këtë çështje vendimi përfundimtar që e nxjerr të pafajshëm ankuesin për të gjitha akuzat u rishqyrtua dhe u anulua duke i dhënë leje prokurorit për të bërë ankim jashtë afatit kundrejt vendimit të pafajësisë (shih, në ndryshim çështjen, Fadin k. Rosisë, nr. 58079/00, § 34, 27 korrik 2006) dhe kjo pranohet nga të dyja palët. Çështja që ngrihet është

nëse mbi bazën e fakteve të çështjes dhe shqyrtimit të proceseve të rishikimit të vendimit autoritetet realizojnë, në nivelin më maksimal të mundshëm, një baraspeshë ndërmjet interesave të ankuesit dhe nevojës për të siguruar efektivitetin e sistemit të drejtësisë penale, duke respektuar në këtë mënyrë nenin 6.

342. Thelbi i kërkesës së prokurorit për leje për apelim jashtë afatit më datë 8 tetor 1999 lidhet me shkeljen e sigurive procedurale në faktin që pala e dëmtuar, d.m.th. familja e viktimës, nuk ishte njoftuar për vendimin e pafajësisë. Gjykata vë re se sipas nenit 58 § 1 të KPP-së, pala e dëmtuar mund ta kërkojë ndjekjen e autorit të veprës dhe dëmshpërblimin e dëmtimit. Sipas nenit 409 të KPP-së, pala e dëmtuar mund të bëjë ankesë, ose vetë ose nëpërmjet përfaqësuesit të tij ligjor, në lidhje me aspektet penale dhe civile.

343. Gjykata shpreh keqardhjen e saj për faktin se gjykata e brendshme nuk përmbushi kërkesat e njoftimit të parashikuara në nenin 137 § 1 të KPP-së. Gjithsesi, ajo vë re se në bazë të dokumenteve të depozituara në dosjen e çështjes, nuk ka tregues që familjes së viktimës t'i jetë dhënë status i "palës së dëmtuar". Edhe po të supozohet se familjes së viktimës i është dhënë statusi i "palës së dëmtuar" dhe nëse do të kishte interesa në lidhje me ndonjë aspekt penal ose civil të pretenduar, ata vetë nuk bënë ndonjë ankesë në gjykatën e rrethit as personalisht dhe as nëpërmjet përfaqësuesit të tyre ligjor. Ata nuk bënë as dhe një kërkesë për lejen për rivendosje në afat ose nuk ndërmorën në mënyrë të drejtpërdrejtë asnjë veprim të nevojshëm nëpërmjet ndihmës së zyrës së prokurorit. Familja e viktimës zgjodhi një tjetër rrugë. Ata depozituan një kërkesë në autoritete të tjera të brendshme, si për shembull në Zyrën e Presidentit të Republikës, autoritete të cilat nuk kishin kompetenca të merrnin asnjë lloj vendimi, përveçse t'ia kalonin ankesën zyrës së prokurorisë.

344. Gjykata nuk e pranon argumentin e Qeverisë se prokurori që mori pjesë në procedurat e pafajësisë, edhe pse kishte marrë pjesë dhe më parë në proceset që kishin përfunduar në dënimin e ankuesit, nuk kishte njoftuar eprorët e tij, duke çuar kështu në mosdepozitimin e një ankese brenda afateve kohore të parashikuara me ligj. Ajo gjykon se gabimet e autoriteteve shtetërore duhet t'i shërbejnë të pandehurit. Me fjalë të tjera, rreziku i ndonjë gabimi të kryer nga autoriteti i prokurorisë, ose edhe nga gjykata, duhet të mbulohet nga shteti; gabimet nuk duhet të paguhen nga individ i përfshirë në çështje (shih më lart Radchikov k. Ruisë, § 50). Për më tepër, nivelet më të larta në zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm ishin të ndërgjegjshme për proceset e rishikimit të vendimit gjyqësor siç dëshmohet në letrën e datës 26 gusht 1998 (shih paragrafin 13 më lart).

345. Situata në të cilën vendimi përfundimtar në favor të ankuesit u vu në dyshim dhe u rishikua, mund të ishte shmangur nëse zyra e prokurorisë do të kishte bërë një ankesë të zakonshme brenda afatit kohor 10-ditor të parashikuar me ligj. Në çështjen në fjalë zyra e prokurorit dështoi në ushtrimin e të drejtës së saj për depozitimin e kërkesës së zakonshme dhe lejoi kalimin e afatit ligjor prej 10 ditësh pa e kundërshtuar vendimin e pafajësisë. Kjo zyrë kërkoj leje për rivendosje afati pas më shumë se nëntë muajsh, pasi vendimi në favor të ankuesit ishte bërë përfundimtar dhe i zbatueshëm dhe pas deklarimit të tij të pafajshëm. Kërkesa e prokurorit nuk përmbante informacion në lidhje me datën kur kishte filluar llogaritja e afatit 10-ditor sipas kuptimit të nenit 147 § 3 të KPP-së, dhe as Qeveria nuk ka vënë në pah ndonjë rrethanë përjashtimore që do ta kishte parandaluar zyrën e prokurorit nga bërja e një kërkesë të rregullt në një kohë të arsyeshme.

346. Gjykata vlerëson se argumentet e palëve të përdorura nga prokurori për të justifikuar kërkesën për rivendosje në afat ishin të pamjaftueshme për të justifikuar vënien në pikëpyetje të një vendimi përfundimtar dhe për të përdorur këtë mjet të jashtëzakonshëm. Gjykata është e mendimit se lejimi i kërkesës së prokurorit nuk vendos një baraspeshë ndërmjet interesit të ankuesit dhe nevojës për të siguruar efektivitetin e sistemit të drejtësisë penale.

347. Duke marrë parasysh këto konsiderata, Gjykata është e mendimit se duke i dhënë leje prokurorit për rivendosje në afat, Gjykata e Lartë cenoj parimin e sigurisë ligjore të parashikuar në nenin 6§1 të Konventës. Si rezultat, ka pasur shkelje të këtij neni.

2. "Informohet menjëherë" dhe mbrojtja nga "një ndihmë ligjore e zgjedhur prej tij".

a) Parashtrimet e palëve

348. Ankuesi ankohet se edhe pse nëpërmjet një avokati të përzgjedhur prej tij, të konfirmuar me atë të autorizimit të datës 13 dhjetor 1997, autoritetet nuk informuan as avokatin e

tij, dhe as anëtarët e familjes së tij për proceset e reja, në të cilat prokurorit i ishte dhënë e drejta e rivendosjes në afat, e cila çoi në anulimin e vendimit përfundimtar të pafajësisë, duke e bërë në këtë mënyrë të drejtën e mbrojtjes së vetes me anë të një avokati të zgjedhur prej tij të pamundur.

349. Qeveria në parashtrimin e saj thotë se përderisa ankuesi ishte deklaruar i larguar në drejtim të paditur dhe atij i është caktuar një avokat kryesisht nga gjykata, këtij avokati iu komunikuan vendimet e gjykatave të brendshme për dhënien e së drejtës për rivendosje në afat.

b) Vlerësimi i gjykatës

350. Gjykata thekson që në fillim se kërkesat e paragrafit 3 të nenit 6 duhet të konsiderohen si aspekte të veçanta të së drejtës për proces të rregullt ligjor të garantuar në paragrafin 1 (shih, ndërmjet autoriteteve të tjera, Balliu k. Shqipërisë, nr. 74727/01, § 25, 16 qershor 2005). Në tërësi Gjykatës i kërkohet të shqyrtojë nëse proceset që çuan në rigjykimin e ankuesit, ishin të drejta (shih, ndërmjet autoriteteve të tjera, Vanyan k. Rusisë, nr.53203/99, § 63-68, 15 dhjetor 2005, Imbrioscia k. Zvicrës, vendimi i datës 24 nëntor 1993, seritë A nr.275, § 38 dhe S.N. k. Zvicrës, nr. 34209/96, § 43, GJEDNJ 2002-V).

351. Duke pasur parasysh gjetjen për shkeljen në lidhje me anulimin e një vendimi përfundimtar sipas nenit 6 § 1 (shih paragrafin 61 më lart), gjykata vëren se nuk është e nevojshme që të shqyrtohet nëse në këtë çështje ka pasur cenim të nenit 6 § 1 në lidhje me nenin 6 § 3 (a) dhe (c).

II. PRETENDIM PËR SHKELJE TË NENIT 10 TË KONVENTËS

352. Ankuesi më tej u ankua për shkelje të nenit 10 pa ofruar asnjë shkak. Neni 10 i Konventës parashikon:

“1. Kushdo ka të drejtën e lirisë së shprehjes, kjo e drejtë përfshin lirinë e shprehjes së opinionëve, të marrjes dhe të ndarjes së informacionit dhe të ideve pa ndërhyrjen e autoritetit publik dhe pavarësisht nga kufijtë. Ky nen nuk i parandalon shtetet nga kërkimi i licencimit për kompanitë e transmetimit, televizive ose kinematografike.

2. Ushtrimi i këtyre lirive, përderisa shoqërohet me detyra dhe përgjegjësi, mund të jetë subjekt i formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose gjobave të tilla të parashikuara në ligj dhe të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurimit kombëtar, integritetit territorial ose sigurisë publike për parandalimin e mungesës së rendit apo krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose moralit, për mbrojtjen e reputacionit ose të drejtave të të tjerëve, për parandalimin e shpërndarjes së informacionit të marrë në mirëbesim ose për ruajtjen e autoritetit dhe paanshmërinë e gjyqësorit.”

353. Gjykata vë re se ankimi i ankuesit mbetet i paprovuar. Përmbajtja e dosjes së çështjes nuk tregon për cenim të të drejtave të ankuesit të parashikuara në këtë dispozitë.

354. Ajo vijon se ankimi është i pabazuar dhe duhet të rrëzohet në përputhje me nenin 35 §§ 3 dhe 4 të Konventës.

III. PRETENDIME PËR SHKELJE TË NENIT 4 TË PROTOKOLLIT NR.7 TË KONVENTËS

355. Ankuesi pretendon më tej se vendimi i Gjykatës së Lartë i datës 20 qershor 2001 ka shkelur parimin *ne bis in idem* të parashikuar në nenin 4 të protokollit nr.7 të Konventës dhe duhet të konsiderohet si një gjykim i dyfishtë për të njëjtën vepër penale. Neni 4 i protokollit nr.7 të Konventës parashikon si më poshtë:

“1. Asnjë nuk ka të drejtë të gjykohet ose të dënohet dy herë në procese penale sipas juridiksionit të të njëjtit shtet për një vepër penale për të cilën ai është deklaruar përfundimisht i pafajshëm ose është dënuar në përputhje me ligjin dhe procedurën penale të atij shteti.

2. Dispozitat e paragrafit më lart nuk parandalojnë rihapjen e çështjes në përputhje me ligjin dhe procedurën penale të shtetit në fjalë nëse ka prova të fakteve të reja ose të zbuluara rishtazi, ose nëse ka pasur një defekt thelbësor në proceset e mëparshme, i cili mund të ketë pasur ndikim mbi çështjen.

3. Nga ky nen nuk ka përjashtim sipas nenit 15 të Konventës.”

356. Gjykata vë re se qëllimi i nenit 4 të protokollit nr.7 është që të parandalojë përsëritjen e proceseve penale që kanë përfunduar me vendim përfundimtar. Gjykata thekson se qëllimi i raportit shpjgues të protokollit nr.7 është të ndalohet përsëritja e procesit penal për të cilin ka përfunduar një vendim përfundimtar. Sipas raportit shpjgues të protokollit nr.7, i cili në vetvete i

referohet Konventës europiane për vlefshmërinë ndërkombëtare të vendimeve penale, “një vendim është përfundimtar ‘nëse, sipas shprehjes tradicionale, ai ka marrë fuqi *res judicata*. Ky është rasti kur vendimi është i pakthyeshëm, pra kur nuk ka mjete të tjera të disponueshme ose kur palët i kanë shfrytëzuar këto mjete ose kanë lejuar skadimin e afatit kohor pa i përdorur ato’ ” (shih Nikitin, cituar më lart, § 37).

357. Gjykata konstaton se vendimi i pafajësisë i datës 14 dhjetor 1998 u bë përfundimtar më 24 dhjetor 1998, pasi kundër tij nuk u bë asnjë apel brenda afatit prej dhjetë ditësh të parashikuar në ligj (shih paragrafët 16 dhe 38 më lart). Në këtë mënyrë, mbetet të përcaktohet nëse proceset që u zhvilluan pas dhënies së lejes për rivendosje në afat konsiderohen si gjykim i dytë ose si rihapje e proceseve të pafajësisë.

358. Sipas mendimit të gjykatës, neni 4 i protokollit nr.7 e bën të qartë dallimin ndërmjet një ndjekjeje ose gjykimi të dytë, i cili ndalohet nga paragrafi i parë i të njëjtit nen, dhe rihapjes së gjykimit në raste përjashtimore, gjë që parashikohet në paragrafin e dytë. Neni 4 § 2 i protokollit nr.7 parashikon shprehimisht mundësinë që një individ duhet ta pranojë ndjekjen për të njëjtat akuza, në përputhje me legjislacionin e brendshëm, kur një çështje rihapet pas daljes së një prove të re ose pas zbulimit të një defekti thelbësor në proceset e mëparshme (shih Nikitin, cituar më lart, § 45).

359. Legjislacioni shqiptar i lejonte në atë kohë dhe i lejon ende dhe sot secilës prej palëve në proces penal të kërkojë rivendosje në afat, kur plotësohen kushtet e parashikuara në nenin 147§1 të KPP-së. Subjekti i procesit pas marrjes së lejes për rivendosje në afat mbetet e njëjta akuzë penale për të cilën është dënuar ankuesi. Efekti përfundimtar i lejes për rivendosje në afat është që të rihapet procesi, të rrëzohet vendimi i pafajësisë dhe të përcaktohet akuza penale në vendimin e ri. Pra në një farë mënyre ky proces përbën një formë vijimësie të procesit të mëparshëm (shih Nikitin, cituar më lart, § 45).

360. Si rezultat, Gjykata përfundon se për qëllime të parimit të *ne bis in idem*, qëllimi i lejes për rivendosje në afat përbënte një përpjekje për të rihapur proceset e mëparshme, dhe jo një “gjykim të dytë”. Ajo vijon më tej duke thënë se nuk ka pasur shkelje të nenit 4 § 1 të protokollit nr. 7 të Konventës.

IV. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

361. Neni 41 i Konventës parashikon se:

“Nëse gjykata konstaton se ka pasur shkelje të Konventës dhe të protokolleve të saj dhe nëse legjislacioni i brendshëm i palëve të larta kontraktuese lejon vetëm riparim të pjesshëm, gjykata, nëse është e nevojshme, akordon dëmshpërblim të drejtë për palën e dëmtuar.”

A. Dëmi

362. Në bazë të nenit 57, pretendon 31 euro për çdo ditë burgu, në bazë të vendimit të Gjykatës së Lartë të datës 20 qershor 2001 në lidhje me dëmet materiale.

363. Qeveria e kontestoi pretendimin e tij.

364. Gjykata nuk sheh ndonjë lidhje shkakore ndërmjet shkeljes dhe dëmit material të pretenduar. Ankuesi po vuante dënimin me 16 vjet heqje lirie në Itali, vendim ky i lëshuar nga gjykatat italiane për trafikim ndërkombëtar droge (shih paragrafin 26) në kohën kur vendimi i pafajësisë së tij u anulua nga Gjykata e Lartë më 20 qershor 2001. Burgimi i tij në Itali nuk kishte ardhur si rezultat i vendimit të Gjykatës së Lartë të Shqipërisë në vitin 2001.

365. Ankuesi pretendon nga 30 000 deri në 100 000 dollarë amerikanë (USD) në lidhje me dëmet jomateriale. Ai pretendon se anulimi i vendimit të pafajësisë dhe dënimi i tij kishin çuar në shumë presion dhe tension për të. Ai ia lë në dorë gjykatës të përcaktojë shumën e saktë.

366. Qeveria e kontestoi pretendimin e tij.

367. Gjykata rithekson se shkelja e Konventës e identifikuar në çështjen në fjalë ka ardhur si rezultat i anulimit të pafajësisë së ankuesit. Pavarësisht nga natyra përfundimtare e gjykimit që e shpalli atë të pafajshëm, ai ishte dënuar në kundërshtim me parimin e sigurisë ligjore. Gjykata është e mendimit se ankuesit duhet t’i jetë shkaktuar stres dhe tension si rezultat i anulimit të vendimit të Gjykatës së Rrethit të datës 14 dhjetor 1998 (shih Bujniça k. Moldovisë, cituar më lart, § 28). Gjithsesi, shuma e kërkuar është ekstreme. Duke bërë vlerësimin e saj mbi një bazë të barabartë, ajo

i akordon ankuesit 2000 euro për dëme jomateriale.

368. Gjithsesi, Gjykata vë re gjithashtu se ankuesi vazhdon të jetë subjekt i pasojave të anulimit të vendimit të 14 dhjetorit 1998. Ajo është e mendimit se forma më e përshtatshme e kompensimit për situatën e vazhdueshme do të ishte konfirmimi i vendimit përfundimtar të pafajësisë nga autoritetet dhe heqja e dënimit që është në shkelje të Konventës duke filluar që prej asaj dite (shih Bujnița, cituar më lart, § 29).

B. Kostot dhe shpenzimet

369. Ankuesi pretendoi dhe 10 000 euro për kostot dhe shpenzimet për gjykatat e brendshme dhe për Gjykatën e Strasburgut.

370. Qeveria e kontestoi këtë pretendim.

371. Në bazë të praktikës së Gjykatës, një ankues ka të drejtë të marrë rimbursim për kostot dhe shpenzimet e tij vetëm për atë kohë sa dëshmohet se ato janë kryer dhe kanë qenë të nevojshme dhe janë të arsyeshme në masë (shih, për shembull, Nilsen dhe Johnsen k. Norëay [GC], nr. 23118/93, § 62, GJEDNJ 1999-VIII).

372. Në çështjen në fjalë, duke pasur parasysh mungesën e dokumenteve mbështetëse, Gjykata e kundërshton pretendimin për kosto dhe shpenzime në proceset penale dhe për proceset para Gjykatës së Strasburgut.

C. Interesat e mospagesës

373. Gjykata është e mendimit se interesi i mospagesës duhet të bazohet në nivelin marxhinal të huadhënies së Bankës Qendrore Europiane, mbi të cilin duhen shtuar tre për qind.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, UNANIMISHT:

1. Deklaron aplikimin të pranueshëm në lidhje me pretendimet që kanë të bëjnë me nenin 6§1 veçmas dhe në lidhje me nenin 6 § 3 (a) dhe (c) të Konventës sipas nenit 4 të protokollit nr.7 të Konventës, dhe deklaron pjesën tjetër të aplikimit të papranueshme.

2. Vendosi se ka shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës.

3. Vendosi se nuk ka nevojë të shqyrtohet ankesa sipas nenit 6 § 3 (a) dhe (c) të Konventës.

4. Vendosi se nuk ka shkelje të nenit 4 të protokollit nr.7 të Konventës.

5. Vendosi:

a) se shteti i paguan ankuesit, brenda tre muajve nga data kur ky vendim bëhet përfundimtar sipas nenit 44 § 2 të Konventës, 2 000 euro (dy mijë euro) për dëme jomateriale, plus çdo tatim të aplikueshëm, konvertuar në monedhën e shtetit palë në proces me kursin e këmbimit në datën e pagimit;

b) se nga data e përfundimit të afatit tremujor të përmendur më lart deri në pagesën e shumës, paguhen interesa të thjeshta mbi këtë shumë në një nivel të barabartë me nivelin marxhinal të huadhënies të Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mospagimit plus tre për qind.

6. Rrëzon pjesën e mbetur të pretendimeve të ankuesit.

I hartuar në anglisht dhe i njoftuar me shkrim më 29 korrik 2008, në përputhje me rregullin 77§§2 dhe 3 të rregullores së Gjykatës.

Lawrence Early
Sekretar

Lech Garlicki
Kryetar

VENDIM
(Ankimi nr. 25336/04)
ÇËSHTJA “GRORI KUNDËR SHQIPËRISË”

STRASBURG
7 Korrik 2009

Ky vendim merr formë përfundimtare në rrethanat e parashikuara në nenin 44 § 2 të Konventës. Vendimi mund të jetë objekt rishikimesh redaktimi.

Kjo çështje ka të bëjë me mungesën e një trajtimi të duhur mjekësor të ankuesit që ndodhet në burg nga ana e autoriteteve të brendshme, e cila përbën një trajtim çnjerëzor në kundërshtim me nenin 3 të Konventës. Gjykata Evropiane tërheq vëmendjen se ankuesi është lënë për një periudhë nga prilli i vitit 2005 deri në janar të vitit 2008, kur ka ndërhyrë një urdhër i Gjykatës, pa trajtimin mjekësor të përshtatshëm. Raporti i fundit mjekësor mbi gjendjen e ankuesit konfirmoi shtimin e sëmundjes gjatë viteve të shkaktuara si pasojë e moskujdesit mjekësor. Sipas Gjykatës është alarmues fakti se çështja e ekzaminimeve mjekësore lihet në diskrecion të prokurorit. Gjykata konstaton se mungesa e një ndihme mjekësore adekuate e shoqëruar me një refuzim nga ana e autoriteteve për t'i ofruar ankuesit një trajtim të përshtatshëm të rekomanduar nga mjekët, i ka krijuar atij një ndjenjë kaq të fortë pasigurie, që bashkë me vuajtjet fizike të tij përbën një trajtim degradues sipas nenit 3 të Konventës.

Kjo çështje ka të bëjë me shkeljen e së drejtës së ankuesit për liri dhe siguri (neni 5 § 1) nga ana e gjykatave të brendshme të cilat kanë vendosur lidhur me mbajtjen në paraburgim gjatë shqyrtimit të procedurave që kanë të bëjnë me njohjet e vendimeve penale të dhëna nga shtetet e huaja duke shkelur në mënyrë flagrante kërkesat ligjore që rridhnin nga legjislacioni në fuqi në atë kohë. Gjykata e konsideron kohën e paraburgimit nga 15 maji 2002 deri në 29 dhjetor 2003 që ka të bëjë me ndalimin e personave gjatë kohës së zhvillimit të procedurave për njohjen e vendimeve penale të huaja në përputhje me objektin e nenit 5 § 1 të Konventës.

Gjykata përsërit se heqja e lirisë duhet të jetë në përputhje me parimin e sigurisë juridike. Ndonëse është detyrë e autoriteteve të brendshme të interpretojnë dhe zbatojnë ligjin vendas, dështimi për të respektuar ligjin e brendshëm shkakton një shkelje të nenit 5 § 1, për rrjedhojë Gjykata duhet të ushtrojë një farë të drejte kontrolli mbi të tilla ankesa. Baza ligjore e gjetur nga ana Gjykatës së Lartë për të përligjur parimin e ligjshmërisë plotëson fare pak kriteret cilësore të kërkesës së “ligjshmërisë” në lidhje me ndalimin e ankuesit dhe konvertimit të dënimit të dhënë nga gjykatat italiane. Ndaj nuk mund të thuhet se ankuesi ka qenë në gjendje të parashikojë në një shkallë të arsyeshme me rrethanat se mbajtja në burg e tij gjatë kohës së njohjes së vendimit penal të dhënë nga një gjykatë e huaj, ishte në përputhje me procedurën ligjore të parashikuar nga e drejta e brendshme.

Kjo çështje ka të bëjë me të drejtën e ankuesit për t'i zbatuar një normë penale të mëpasshme më favorizuese nga norma penale e mëparshme (Neni 7 § 1). Gjykata përsërit se gjykatat shqiptare zbatuan dënimin me burgim të përjetshëm për ankuesin, siç parashikohet nga ligji në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, pavarësisht nga fakti se, dënimi i zbatueshëm për të njëjtën vepër penale në kohën e dënimit nga gjykatat shqiptare ishte më i favorshëm për të.

Kjo çështje ka të bëjë me shkeljen e nenit 34 të Konventës, sipas së cilit “Palët e Larta Kontraktuese zotohen të mos pengojnë në ndonjë mënyrë ushtrimin efektiv të kësaj të drejte.”

Gjykata konstaton në rastin konkret se masa e përkohshme nuk u respektua për një periudhë kohore prej shtatëmbëdhjetë ditësh nga Qeveria. Gjykata përsërit se masat e përkohshme duhet të konsiderohen si çështje urgjente, për rrjedhojë autoritetet e brendshme duhet të angazhohen për të ndihmuar Gjykatën në parandalimin e ndodhjes së dëmeve të pariparueshme.

Kjo çështje ka të bëjë me pretendimin për shkelje të nenit 2 të Protokollit 2, lidhur me mospranimin e kërkesës për rishikim nga ana e Gjykatës së Lartë. Gjykata vëren se ankuesi, në thelb ankohet për paaftësinë e gjykatave të brendshme për të arsyetuar vendimet e tyre. Gjykata përsërit se e drejta që i garantohet një ankuesi sipas Nenit 6 të Konventës përfshin të drejtën për të marrë vendimet të arsyetuara nga një gjykatë e brendshme në çështjen e tij. Por detyrimi i një gjykate të brendshme për të arsyetuar vendimet e saj nuk kërkon një përgjigje të detajuar për çdo argument të sjellë nga një ankues. Gjykata vëren se, kur Gjykata e Lartë refuzon të pranojë një çështje me arsyetimin se arsyet ligjore për një çështje të tillë nuk ekzistojnë, një arsyetim i kufizuar mund të plotësojë kërkesat e Nenit 6 të Konventës.

Kjo çështje ka të bëjë me pretendimin për shkelje të nenit 2 të Protokollit 2, lidhur me mospranimin e kërkesës për rishikim nga ana e Gjykatës së Lartë. Gjykata vëren se ankuesi, në thelb ankohet për paaftësinë e gjykatave të brendshme për të arsyetuar vendimet e tyre. Gjykata përsërit se e drejta që i garantohet një ankuesi sipas Nenit 6 të Konventës përfshin të drejtën për të marrë vendimet të arsyetuara nga një gjykatë e brendshme në çështjen e tij. Por detyrimi i një gjykate të brendshme për të arsyetuar vendimet e saj nuk kërkon një përgjigje të detajuar për çdo argument të sjellë nga një ankues. Gjykata vëren se, kur Gjykata e Lartë refuzon të pranojë një çështje me arsyetimin se arsyet ligjore për një çështje të tillë nuk ekzistojnë, një arsyetim i kufizuar mund të plotësojë kërkesat e Nenit 6 të Konventës.

Në çështjen Grori k. Shqipërisë,

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i katërt), i përbërë nga trupi gjykues:

Nicolas Bratza, kryetar

Josep Casadevall

Giovanni Bonello

Kristaq Traja

Ljiljana Mijović

Ján Šikuta

Päivi Hirvelä, gjyqtarë,

dhe Lawrence Early, sekretar i Seksionit,

pas shqyrtimit të çështjes në seancë të mbyllur më 27 nëntor 2007, 20 janar 2008 dhe 18 qershor 2009,

jep vendimin e mëposhtëm, i cili është miratuar në datën e fundit.

PROCEDURA

374. Çështja e ka zanafillën në aplikimin (nr. 25336/04) kundër Republikës së Shqipërisë, të depozituar në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive Kryesore të Njeriut (Konventa) nga një nënshtetas shqiptar, z. Arben Grori (“ankuesi”), në datën 9 korrik 2004.

375. Ankuesi u përfaqësua nga z.A.Kasapi, avokat që ushtron profesionin në Tiranë. Qeveria shqiptare (Qeveria) u përfaqësua nga agjentët e saj, z. S. Puto dhe znj. S. Mëneri.

376. Ankuesi pretendon se, në veçanti, gjykatat shqiptare kishin vendosur për burgimin e tij, duke konvertuar një vendim të dhënë nga gjykatat italiane, në shkelje flagrante të kërkesave ligjore që rridhnin nga ligjet në fuqi në atë kohë. Ai bazohet në nenin 3, nenin 5 § 1 (a), nenin 6 § 1 dhe nenin 7 të Konventës dhe nenin 2 të protokollit nr. 7 të Konventës.

377. Më 6 shtator 2005, Gjykata vendosi ta njoftonte qeverinë për aplikimin. Sipas dispozitave të nenit 29 § 3 të Konventës, ajo vendosi ta shqyrtojë themelin e çështjes në të njëjtën kohë me pranueshmërinë e saj.

378. Më 7 dhjetor 2004, aplikimit iu dha përparësi, sipas nenit 41 të rregullores së gjykatës.

FAKTET

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

379. Ankuesi ka lindur në vitin 1971 dhe aktualisht po vuan dënimin me burgim të përjetshëm dhe me 15 vjet heqje lirie në burgun e sigurisë së lartë të Peqinit (Shqipëri).

A. Baza e çështjes

380. Më 6 tetor 1997 autoritetet italiane lëshuan një urdhërarresti për ankuesin, duke e akuzuar për vrasje me paramendim të një nënshtetasi shqiptar në Milano, Itali.

381. Më 2 shkurt 2001, ankuesi u dënua në mungesë (*in absentia*) me burgim të përjetshëm nga Gjykata e Apelit të Milanos (Milan Assize Court of Appeal) për vrasje dhe me pesë vjet heqje lirie për armëmbajtje pa leje.

382. Më 16 shkurt 2001, autoritetet italiane lëshuan një fletarresti të dytë për ankuesin, lidhur me një akuzë të re kundër tij, për pjesëmarrje në një organizatë kriminale dhe trafikim ndërkombëtar të lëndëve narkotike. Nga dokumentet në dosje del se gjatë periudhës së proceseve në gjykatat italiane, ankuesi kryente një biznes të ligjshëm dhe banonte në Shqipëri.

383. Më 29 prill 2001 Interpoli i Shqipërisë i transmetoi policisë së Tiranës dy fletëarrestet e përmendura më lart. Në të njëjtën datë, shefi i policisë kriminale të Tiranës urdhëroi “zbatimin e menjëhershëm të fletarrestit”.

384. Më 30 prill 2001, Interpoli i Romës u dërgoi një faks autoriteteve shqiptare duke u kërkuar fillimin e proceseve penale kundër ankuesit për krimet e kryera në territorin italian.

B. Proceset penale për akuzat për trafikim ndërkombëtar të lëndëve narkotike

1. Arrestimi fillestar i ankuesit

385. Më 30 prill 2001, ankuesi u ndalua në Shqipëri mbi bazën e fletë arrestit të lëshuar më 16 shkurt 2001 nga gjyqtari hetues i Gjykatës së Apelit të Milanos. Akuza lidhej me përfshirjen e ankuesit në një organizatë kriminale dhe me trafikimin ndërkombëtar të lëndëve narkotike.

386. Më 1 maj 2001, ankuesi u mbajt i ndaluar në paraburgim për 15 ditë në pritje të vendimit të gjykatës.

387. Më 12 maj 2001, gjykata e rrethit të Tiranës, (“Gjykata e Rrethit”), rrëzoi ankimimin e ankuesit kundër arsyeve të ndalimit të tij. Të njëjtën ditë, prokurori e informoi ankuesin rreth akuzave të ngritura kundër tij, që ishin pjesëmarrje në një organizatë kriminale dhe trafikimi ndërkombëtar i lëndëve narkotike.

388. Më 15 maj 2001, gjykata e rrethit pranoi parashtrimin e prokurorit dhe urdhëroi burgimin e ankuesit për një periudhë të pacaktuar. Më 4 qershor 2001, Gjykata e Lartë e pranoi vendimin.

389. Në qershor dhe dhjetor 2001, zyra e Prokurorit të Përgjithshëm i kërkoi në mënyrë të përsëritur autoriteteve italiane të dërgonin prova që mbështesnin akuzat kundër ankuesit. Në janar 2002, kërkesa u përsërit dhe nga Ministria e Drejtësisë së Shqipërisë.

2. Fillimi i proceseve penale

390. Në 30 korrik 2002, zyra e Prokurorit të Përgjithshëm filloi proceset penale në gjykatën e rrethit të Tiranës, duke e akuzuar ankuesin me trafikim të lëndëve narkotike (më poshtë proceset penale).

391. Më 29 dhjetor 2003, gjykata e rrethit e nxori fajtor ankuesin për krijimin e një organizate kriminale dhe për trafikimin ndërkombëtar të lëndëve narkotike dhe e dënoi atë me 19 vjet heqje lirie. Sipas ankuesit, dënimi lidhej me një akuzë të re, për të cilën ai nuk ishte njoftuar

kurrë më parë. Më 25 qershor, Gjykata e Apelit të Tiranës (Gjykata e Apelit) la në fuqi vendimin e gjykatës së rrethit. Por ndryshoi dënimin e ankuesit në 17 vjet heqje lirie. Ankuesi apeloj vendimin në Gjykatën e Lartë. Më 23 qershor 2006, Gjykata e Lartë ndryshoi cilësimin e njërës prej veprave penale për të cilën ishte dënuar ankuesi. Ajo la në fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit dhe ndryshoi dënimin e ankuesit me 15 vjet heqje lirie. Ankuesi i dërgoi një ankesë kushtetuese Gjykatës Kushtetuese kundër vendimeve të lartpërmendura, ankesë e cila është ende pezull në Gjykatën Kushtetuese.

C. Proceset për vlefshmërinë dhe zbatimin në Shqipëri të vendimit të dhënë nga gjykata Italiane

1. Kërkesa për vlefshmërinë e vendimit të gjykatave italiane dhe arrestimi i dytë i ankuesit

392. Më 21 shkurt 2002, ndërsa ankuesi ishte i ndaluar për akuzat për pjesëmarrje në një organizatë kriminale dhe për trafikimin ndërkombëtar të lëndëve narkotike (shih paragrafin 12 më lart), zyra e prokurorisë publike të Milanos i kërkoi Ministrisë Italiane të Drejtësisë t'u kërkonte autoriteteve shqiptare të bënin të vlefshëm (të njihnin) në Shqipëri vendimin e dhënë për ankuesin nga Gjykata e Apelit të Milanos (Milan Assize Court of Appeal) më 2 shkurt 2001, që kishte marrë formë përfundimtare më 30 janar 2002.

393. Më 28 mars 2002, Ministria Italiane e Drejtësisë, ndërmjet të tjerave, e informoi zyrën e prokurorit publik të Milanos se autoritetet italiane nuk mund të kërkojnë njohjen dhe zbatimin në Shqipëri të një vendimi penal të dhënë nga gjykata italiane, duke qenë se asnjëri nga shtetet nuk ishte palë në ndonjë marrëveshje ndërkombëtare që lidhej me këtë çështje. Të njëjtën ditë, Ministria Italiane e Drejtësisë, i dërgoi Ambasadës Shqiptare në Romë vendimin e sipërpërmendur për arsye informative.

394. Më 8 prill 2002, Ambasada Shqiptare në Romë, në një letër me kokë çorientuese "Transferimi i një nënshtetasi shqiptar që aktualisht vuan dënimin në Itali", e informoi qeverinë shqiptare për "kërkesën për ekstradim" të Ministrisë Italiane të Drejtësisë për ankuesin, i cili, sipas letrës së ambasadës, "po vuante dënimin në Itali".

395. Më 23 prill 2002, Qeveria e Italisë dhe qeveria e Shqipërisë nënshkruan një marrëveshje për transferimin e personave të dënuar, e cila u ratifikua nga parlamentet përkatëse në vitin 2003 dhe 2004.

396. Më 3 maj 2002, Ministria e Drejtësisë së Shqipërisë, sipas nenit 512 të Kodit të Procedurës Penale të Shqipërisë (KPP), i kërkoi zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm të fillonte procedurën për njohjen dhe zbatimin në Shqipëri të vendimit të dhënë nga gjykata italiane për ankuesin.

397. Më 15 maj 2002, gjykata e rrethit, në një proces me një gjyqtar të vetëm, urdhëroi ndalimin e ankuesit në pritje të proceseve për njohjen dhe zbatimin e vendimit të Gjykatës së Apelit të Milanos (Milan Assize Court of Appeal) të datës 2 shkurt 2001 në Shqipëri. Ankuesit iu bë i ditur vendimi, ndërkohë që ishte i ndaluar për proceset penale të përmendura më lart (shih paragrafët 390-391 më lart).

2. Proceset e zakonshme gjyqësore

398. Më 10 maj 2002, sipas nenit 512 dhe 514 të KPP-së, zyra e Prokurorisë së Përgjithshme filloi proceset para gjykatës së rrethit për njohjen dhe zbatimin në Shqipëri të gjykimit të dhënë nga Gjykata e Apelit të Milanos (më poshtë "proceset e njohjes dhe zbatimit").

399. Sipas parashtrimeve të ankuesit në gjykatën e rrethit në maj të vitit 2002, neni 514 i KPP-së kërkon, *inter alia*, pëlqimin e tij për njohjen dhe zbatimin në Shqipëri të vendimit të Gjykatës së Apelit të Milanos, pëlqim të cilin ai vendosi të mos e jepte (shih paragrafin 85 më poshtë).

400. Më 13 qershor 2002 Parlamenti miratoi ndryshimet për dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, të cilat, *inter alia*, shfuqizuan kërkesën për pëlqimin e të ndaluarit, të parashikuar në pikën (e) të nenit 514 të KPP-së (shih paragrafin 459 më poshtë).

401. Më 17 qershor 2002, Prokurori i Përgjithshëm depozitoi vëzhgime të tjera në gjykatën e rrethit, duke theksuar, ndërmjet të tjerash, se:

"... pavarësisht nga fakti se pëlqimi i personit të dënuar kërkohet nga neni 514 (e) i KPP-së

për njohjen në Shqipëri të një vendimi të dhënë nga një organ i huaj, kjo duhet të interpretohet vetëm në rrethanat që lidhen me transferimin e personave të dënuar dhe jo në një mënyrë të tillë që të pengojë dhënien e drejtësisë. Për më tepër, Parlamenti, nëpërmjet ligjit nr. 8813 të 13 qershorit 2002, e shfuqizoi pikën (e) të nenit 514 të KPP-së ...”

402. Më 20 qershor 2002, gjykata e rrethit e rrëzoi kërkesën e Prokurorit të Përgjithshëm, duke e konsideruar atë si jo në përputhje me kërkesat e nenit 514, pika (e) e KPP-së. Gjykata vendosi:

“...kërkesat e parashikuara në nenin 514, pika (e), të KPP-së është e nevojshme për njohjen dhe zbatimin në Shqipëri të një vendimi të dhënë nga një organ i huaj, në përputhje me Konventën mbi Transferimin e Personave të Dënuar dhe dispozitat e legjislacionit të brendshëm. Në përputhje me formulimin e nenit të sipërpërmendur, kërkohet pëlqimi i personave të dënuar pa dallim ndërmjet rrethanave të transferimit të të ndaluarit ose njohjes së vendimit të dhënë nga një gjykatë e huaj. Për më tepër, ligji nr.8813 i 13 qershorit 2002, që shfuqizon pikën (e) të nenit 514, nuk është i zbatueshëm në rastin në fjalë, pasi ai nuk ka hyrë në fuqi ende ...”

403. Më 24 korrik 2002, Gjykata e Apelit rrëzoi ankesën e bërë nga Prokurori i Përgjithshëm. Gjykata pranoi arsyetimin e dhënë në vendimin e gjykatës së rrethit dhe vendosi që ligji nr. 8813 i 13 qershorit 2002 nuk ka efekt prapaveprues me arsyetimin se ai do të çonte në dispozita më të ashpra në dëm të ankuesit.

404. Në një datë të paspecifikuar në vitin 2002, Prokurori i Përgjithshëm bëri apel në Gjykatën e Lartë (Seksioni penal) kundër vendimit të Gjykatës së Apelit.

405. Më 29 tetor 2002, për unifikimin dhe ndryshimin e praktikës gjyqësore, Kryetari i Gjykatës së Lartë ia kaloi juridiksionin për çështjen Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

406. Më 30 janar 2003, Gjykata e Lartë, Kolegjet e Bashkuara, rrëzuan vendimet e Gjykatës së Apelit dhe të gjykatës së rrethit dhe vendosën t’ia dërgonin çështjen sërish për shqyrtim gjykatës së rrethit. Në vendimin e saj, Gjykata e Lartë i interpretoi dispozitat e KPP-së të lidhura me ekstradimin, transferimin e personave të dënuar dhe njohjen dhe zbatimin në Shqipëri të vendimeve të dhëna nga gjykata të huaja, duke e dhënë përkufizimin e saj nga pikëpamja e parimeve të së drejtës ndërkombëtare dhe të bashkëpunimit ndërshtetëror. Gjykata vendosi që në rrethanat ku nuk mund të jepej asnjë vendim për një çështje specifike, pasi dispozitat përkatëse ishin të papërshtatshme, baza ligjore mund të ofrohej nga zakonet ndërkombëtare, përkatësisht nga parimet të vullnetit të mirë dhe reciprocitetit dhe traktatet. Në rastin në fjalë, duke thënë se kërkesat e parashikuara në nenin 514, pika (e) të KPP-së ishin të papërshtatshme, ajo ishte e mendimit se Konventa Europiane mbi Njohjen Ndërkombëtare të Vendimeve Penale dhe Konventa Europiane mbi Transferimin e Personave të Dënuar parashikonte një bazë të mjaftueshme për njohjen dhe zbatimin në Shqipëri të vendimit të Gjykatës së Apelit të Milanos.

407. Gjykata deklaroi, në lidhje me atë çfarë u trajtua më lart, si më poshtë:

“Transferimi i personave të dënuar është rregulluar nga Konventa Europiane mbi Transferimin e Personave të Dënuar, e ratifikuar nga Parlamenti i Republikës së Shqipërisë dhe botuar në Fletoren Zyrtare nr. 22 të 1999-ës (...). Konventa Europiane për Njohjen e Vendimeve Penale është e nënshkruar, por nuk është ratifikuar ende nga Parlamenti. Si e tillë, Konventa nuk mund të konsiderohet pjesë përbërëse e korpusit të brendshëm ligjor dhe nuk është drejtpërsëdrejti e zbatueshme. Gjithsesi, nënshkrimi dhe miratimi i dispozitave, sipas të cilave shteti njeh dhe respekton normat dhe parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare, na udhëzon të kuptojmë, interpretojmë dhe të zbatojmë drejt dispozitat e KPP-së në fjalë.

(...)

Në rast të njohjes dhe të zbatimit të një vendimi penal të huaj, referenca dhe zgjidhja e çështjes në përputhje me pikën (e) të nenit 514 të KPP-së, në kohën materiale, nuk ka kuptim. Nëse gjykata e konsideron pëlqimin e personit të dënuar si thelbësor, ky pëlqim do të çonte në interpretimin *ad literam* të dispozitës, ashtu siç është zbatuar nga gjykata e rrethit dhe gjykata e apelit. Por, interpretimi i një dispozite ligjore është shumë kompleks. Në rast se një interpretim *ad literam* çon në absurditet [situatë pa kuptim], mbizotëron interpretimi logjik dhe sistematik. Sipas këtij interpretimi, dispozita në fjalë do të interpretohet në mënyrë të arsyeshme. Kjo do të thotë se

nocioni “i pëlqimi të personit të dënuar”, nuk mund të interpretohet gjerësisht. Ai duhet të interpretohet ngushtë në mënyrë që të mos çojë në absurditet, siç do të ishte rasti ku ankuesi duhet të japë pëlqimin për të vuajtur dënimin penal në vendin e tij. Siç rrjedh nga aktet, ankuesi është gjykuar *in absentia* pasi i fshihej drejtësisë italiane.

(...)

Pëlqimi i një personi të dënuar nga një gjykatë e huaj është *sine qua non* për caktimin e çështjes, nëse dënimi vuhet në shtetin dënues ose në shtetin e origjinës së personit të ndaluar, çfarë do të thotë në burgjet e vendit të të cilit ai është qytetar [është theksuar më shumë teksti origjinal].

(...)

Ky vendim i Gjykatës së Lartë, Kolegjet e Bashkuara, e zgjidh përfundimisht problemin, sipas së cilit mungesa e pëlqimit të personit të dënuar për njohjen dhe zbatimin e një vendimi të huaj penal nuk është pengesë për gjykatat shqiptare për të vijuar me pranimin dhe njohjen [është theksuar teksti origjinal].

Gjatë shqyrtimit të çështjes, avokati i ankuesit deklaroi se nuk ka marrëveshje dypalëshe ndërmjet Shqipërisë dhe Italisë në lidhje me njohjen dhe zbatimin e vendimeve penale. Ai tha se një akt i tillë cenon sovranitetin e shtetit shqiptar, i cili ushtrohet nga Parlamenti nëpërmjet ratifikimit të një marrëveshjeje ndërkombëtare ose dypalëshe. Ky pretendim ishte i pabazuar. Parlamenti shqiptar e manifestoi dëshirën e tij sovranë nëpërmjet miratimit të KPP-së, dispozitat e së cilës duhet të zbatohen në përputhje me kuptimin e tyre dhe me interpretimin e unifikuar të Gjykatës së Lartë, siç theksohet më lart.

Duhet të theksohet se në mungesë të instrumenteve të nënshkruara dhe të ratifikuara, normat përgjithësisht të njohura të së drejtës ndërkombëtare mund të zbatohen në përputhje me parimin e dëshirës së mirë dhe të reciprocitetit. Në përputhje me KPP-në, Ministria e Drejtësisë është përgjegjëse për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja, duke përfshirë dhe italianët.

Sipas nenit 512 të KPP-së, është brenda kompetencës së ministrisë përkatëse, si manifestim i dëshirës politike të shtetit shqiptar, të kërkojë njohjen nga gjykata të një vendimi të huaj. Këtë lloj diskrecioni nuk e shqyrton gjykata. Gjykata shqyrton vetëm nëse kërkesa është bërë nga autoriteti kompetent në përputhje me ligjin dhe nëse dokumentacioni është i plotë.”

3. Proceset e rigjykimit

408. Në proceset e rigjykimit para gjykatës së rrethit, ankuesi pretendoi se nuk kishte pasur asnjë kërkesë nga autoritetet italiane për njohjen dhe zbatimin e vendimit penal italian kundër tij, duke pasur parasysh dhe letrën e autoriteteve italiane të datës 28 mars 2000 (shih paragrafin 393 më lart). Për më tepër, ai shtoi se nuk kishte marrëveshje dypalëshe ndërmjet të dy shteteve për bërjen efektive të kësaj njohjeje. Ankuesi u bazua gjithashtu në faktin se ai nuk kishte dhënë pëlqimin e tij për njohjen.

409. Më 20 maj 2003, gjykata e rrethit, me trup gjykues prej tre gjyqtarësh, u bazua tërësisht në vendimin e Gjykatës së Lartë të 30 janarit 2003. Ajo vendosi se dënimi i dhënë nga Gjykata e Apelit të Milanos ishte në përputhje me dispozitat e KPP-së së Shqipërisë, të ndryshuar nga ligji nr. 8813 i datës 13 qershor 2002. Ajo vendosi që ankuesi të vuante dënimin kumulativ të burgimit të përjetshëm në Shqipëri për vrasje dhe për armëmbajtje pa leje.

410. Gjyqtari drejtues E.K. shprehu një opinion pjesërisht të kundërt për gjykimin e lartpërmendur, duke i kujtuar gjykatës se dispozitat përkatëse statutoare parashikojnë një dënim maksimal prej 25 vjet heqje lirie në vend të burgimit të përjetshëm, siç ishte vendosur në çështjen e ankuesit.

411. Sipas parashtrimeve të ankuesit në proceset aktuale përpara gjykatës, gjykata e rrethit zbatoi ato pjesë të ligjit nr.8813 të 13 qershorit 2002 që kontribuan për përkeqësimin e situatës së tij. Për më tepër në përputhje me nenin 13 të KPP-së, siç është ndryshuar në ligjin e lartpërmendur, gjykata, në rastin e tij, duhet të kishte formacionin e gjyqtarit të vetëm. Për më tepër, ai tha se, duke pasur parasysh dhe mendimin ndryshe të gjyqtarit E.K, formacioni i trupit gjykues mund të kishte pasur ndikim mbi rezultatet e proceseve.

412. Në një datë të paspecifikuar në vitin 2003, ankuesi bëri apel duke përdorur të njëjtën

arsyetim kur çështja ishte në gjykatën e rrethit.

413. Më 10 shtator 2003, Gjykata e Apelit rrëzoi ankesën dhe la në fuqi vendimin e gjykatës së rrethit, duke u bazuar tërësisht në gjykimin e Gjykatës së Lartë të 30 janarit 2003.

414. Ankuesi theksoi se në seancën e fundit të proceseve të apelit, gjyqtari Sh. B., i cili kishte qenë drejtues procesi deri në atë moment, ishte zëvendësuar nga gjyqtari D. B., pa vendim zyrtar.

415. Ankuesi i ofroi gjykatës dy vendime të gjykatës së apelit që kishin ekzaktësisht të njëjtin tekst, por ishin dhënë nga dy trupa të ndryshëm gjykues: i pari ishte dhënë nga një trup gjykues i drejtuar nga Sh. B. dhe i dyti nga një trup gjykues i drejtuar nga D. B.

416. Më 9 tetor 2003 ankuesi apeloj në Gjykatën e Lartë. Ai u bazua thujtë në të njëjtat baza apeli siç kishte bërë kur kishte dërguar çështjen para gjykatës së rrethit dhe gjykatës së apelit. Për më tepër, ankuesi e konsideroi zbatimin e normave përgjithësisht të njohura të së drejtës ndërkombëtare si të papërshtatshme dhe joprecize.

417. Më 30 janar 2004, Gjykata e Lartë rrëzoi apelin e ankuesit, pasi baza e apelit ishte jashtë objektit të neneve 432 dhe 448 § 2 të KPP-së (shih paragrafët 455 dhe 456 më poshtë).

418. Në prill 2004, ankuesi apeloj në Gjykatën Kushtetuese kundër vendimeve të Gjykatës së Lartë të datës 30 janar 2003 dhe 30 janar 2004. Ai pretendoi se proceset kishin qenë të padrejta në shumë aspekte. Në veçanti, ai u ankua se proceset penale kishin qenë në kundërshtim me kërkesat e KPP-së të parashikuara në nenin 13 (përbërja e gjykatave), 514 (pëlqimi i personave të dënuar) dhe 512 (njohja dhe zbatimi në Shqipëri të një vendimi të lëshuar nga një gjykatë e huaj, kërkesa që bëhet nga një autoritet i huaj dhe një marrëveshje e vlefshme ndërkombëtare dhe/ose dypalëshe duhej të ishte në fuqi ndërmjet të dyja vendeve). Ankuesi tha se autoritetet italiane nuk kishin bërë asnjë kërkesë për njohje vendimi për Ministrinë e Drejtësisë së Shqipërisë, dhe nuk kishte asnjë konventë ndërkombëtare në fuqi ndërmjet të dy vendeve në atë kohë.

419. Më 12 korrik 2004, Gjykata Kushtetuese rrëzoi apelin e ankuesit. Ajo u shpreh se vendimet e Gjykatës së Lartë të datave 30 janar 2003 dhe 30 janar 2004 ishin kushtetuese. Për më tepër, ajo vendosi se megjithëse përbërja e trupit gjykues të gjykatës së rrethit të datës 20 maj 2003 ishte në kundërshtim me ligjin, kjo gjë nuk e bën procesin jokushtetues në tërësi. Në lidhje me praninë e dy gjyqimeve të dhëna nga dy trupa të ndryshëm gjykues të gjykatës së apelit të datës 10 shtator 2003, Gjykata Kushtetuese theksoi se kishte vetëm një gjykim në dosjen e çështjes, që i korrespondonte trupit gjykues që kishte vendosur për çështjen.

420. Në vendim, në pjesët përkatëse, thuhej:

“Gjykata Kushtetuese është e mendimit se argumentet e ngritura në vendimin e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë [i 30 janarit 2003] nuk janë në kundërshtim me Kushtetutën ose konventat [ndërkombëtare]. Njohja [vlefshmëria] e ndërsjellë e vendimeve të gjykatës shërben për të forcuar bashkëpunimin juridik ndërmjet shteteve dhe për të arritur objektiva të caktuara në lidhje me lirinë, sigurinë dhe drejtësinë. Parimi i reciprocitetit presupozon përdorimin e instrumenteve të ndërsjella dhe ligjore në marrëdhëniet ndërshtetërore. Në të drejtën ndërkombëtare, reciprociteti përkufizohet si e drejta e barazisë dhe e respektit të ndërsjellë ndërmjet shteteve. Doktrina dhe jurisprudenca ndërkombëtare penale kanë konfirmuar se bashkëpunimi ndërmjet vendeve mund të ndodhë dhe në mungesë të traktateve dypalëshe, mbi bazën e parimi të reciprocitetit.

Si rregull, parimi i reciprocitetit zbatohet në instrumente ndërkombëtare, si në traktate dhe në marrëveshje, që parashikojnë të drejta dhe detyrime të ndërsjella. Por, në raste përjashtimore, në mungesë të marrëveshjeve të ndërsjella, shtetet nuk janë të përjashtuara nga zbatimi i drejtpërdrejtë i parimit të reciprocitetit, nga normat përgjithësisht të njohura të së drejtës ndërkombëtare dhe nga vullneti i mirë. Zbatimi i tyre është në interes të forcimit të bashkëpunimit të shteteve për të luftuar krimin e organizuar dhe kriminalitetin.

Gjykata Kushtetuese thekson se vendimi i Gjykatës së Lartë, Kolegjet e Bashkuara, në lidhje me nenet 512 dhe 514 nuk është jokushtetues. Ajo [Gjykata e Lartë] me të drejtë arriti në përfundimin se nuk kishte konflikt ndërmjet këtyre dispozitave dhe ndërmjet dispozitave të konventave ndërkombëtare. Dispozitat e brendshme zbatohen në përputhje me interpretimin e bërë nga Kolegjet e Bashkuara [të Gjykatës së Lartë].

(...) Mund të kuptohet (...) se kërkesa për njohje të një vendimi të një gjykate të huaj mund të bëhet dhe në mungesë të një marrëveshjeje mbi bazën e vullnetit të mirë, normat e njohura gjerësisht dhe parimit të reciprocitetit.”

D. Trajtimi mjekësor

421. Më 24 shtator 2003, 13 janar 2004 dhe 16 shkurt 2004, duke marrë shkas nga përkeqësimi i shëndetit të ankuesit, përfaqësuesi i tij ligjor dhe babai i tij i kërkuan Ministrisë së Drejtësisë dhe autoriteteve të burgut ta lejonin atë të vizitohej nga mjekët e duhur.

422. Nga data 23 gusht 2004 deri më 31 gusht 2004 ankuesi iu nënshtrua trajtimit dhe ekzaminimeve në spitalin e burgut të Tiranës. Gjatë kësaj periudhe atij u bë një skaner me rezonancë magnetike (MRI). Ai u diagnostikua se vuante nga multi skleroza (MS). Mjekët raportuan se, dhe kur sëmundja zbulohet dhe trajtohet menjëherë, ajo ishte në gjendje të shkaktonte gjendje shoku, dëmtim organesh, paaftësi të përhershme ose vdekje.

423. Më 29 shtator 2004 u krye një skaner i dytë me rezonancë magnetike (MRI).

424. Më 5 tetor 2004 përfaqësuesi ligjor i ankuesit e informoi sekretarinë se gjendja shëndetësore e ankuesit ishte përkeqësuar dhe se, si rrjedhim, nevojitej trajtim i mëtejshëm dhe një vizitë mjekësore e domosdoshme nga specialistë neurologë. Ai depozitoi dy raporte në lidhje me gjendjen shëndetësore të ankuesit, e cila, sipas mjekëve, ishte përkeqësuar.

425. Më 7 janar 2005, burgu i sigurisë së lartë në Tiranë kërkoi autorizim nga prokuroria e Tiranës për ekzaminime mjekësore në spitalin e burgut të Tiranës për ankuesin dhe për tetë bashkëvuajtës të tij të tjerë në burg.

426. Në një datë të paspecifikuar në janar të 2005-ës, zyra e prokurorisë së Tiranës dha miratimin e saj në lidhje me tetë të burgosurit e tjerë, ndërsa nuk pranoi kërkesën në lidhje me ankuesin, duke thënë se nuk ishte organi kompetent për të vendosur për transferimin e tij nga burgu. Ajo caktoi zyrën e Prokurorisë së Përgjithshme si autoritetin përkatës për të vendosur.

427. Më 13 janar 2005 burgu i sigurisë së lartë në Tiranë e përsëriti kërkesën e tij për zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm në lidhje me trajtimin mjekësor të ankuesit, por nuk mori përgjigje. Më 17 janar 2005, burgu i kërkoi Njësisë së Përgjithshme të Burgjeve në Ministrinë e Drejtësisë të caktonte organin kompetent për të vendosur për transferimin e ankuesit për qëllime mjekësore.

428. Më 16 shkurt 2005, ankuesi filloi proceset penale kundër zyrës së prokurorisë së Tiranës, duke u ankuar për neglizhencë të kësaj të fundit për të siguruar kujdesin e tij mjekësor, gjë e cila kishte çuar në përkeqësimin e shëndetit të tij, që përbënte diskriminim krahasuar me ato të burgosur, të cilët ishin lejuar të përfitonin trajtim mjekësor.

429. Më 26 shkurt 2005, ankuesi u transferua në burgun e Peqinit, një burg i sigurisë së lartë, rreth 100 km larg spitalit të burgut të Tiranës dhe u vendos nën regjimin e burgimit të sigurisë së lartë.

430. Nga shkurti i vitit 2005 e në vijim, ankuesit i ishte mohuar mundësia të takohej me avokatët e tij apo të kishte ndonjë kontakt tjetër me ta.

431. Më 15 prill 2005, pas kërkesave të përsëritura nga mjekët e burgut të Peqinit, ankuesi u dërgua në spitalin e burgut të Tiranës për trajtim mjekësor. Pas konsultimeve ndërmjet mjekësh të atij spitali dhe të spitalit civil të Tiranës më 19 prill 2005, u konfirmua diagnoza e ankuesit dhe prej tyre u tha se ishte e domosdoshme për shëndetin e tij që të trajtohej me interferon-beta.

432. Në një letër të datës 23 maj 2005, përfaqësuesi ligjor i ankuesit e informoi sekretarinë se prej prillit të vitit 2005 autoritetet e burgut e kishin pezulluar trajtimin mjekësor të ankuesit, në kundërshtim me opinionet e mjekëve, dhe se ai ishte trajtuar me vitamina dhe me medikamente kundër depresionit.

433. Në një letër të datës 28 qershor 2005, përfaqësuesi ligjor i ankuesit e informoi sekretarinë se pa një vendim gjykate ankuesi ishte vendosur nën një regjim të posaçëm burgu, të parashikuar në seksionin 43 të Aktit të Regjimit të të Burgosurve, që ishte përjashtim nga kushtet për burgim të zakonshëm, të parashikuar në Akt.

434. Më 4 nëntor 2005, pas kërkesave të vazhdueshme të ankuesit, Drejtoria e

Përgjithshme e Burgjeve e vlerësoi atë dhe raportoi për trajtimin mjekësor që kishte marrë, e gjeti se ai ishte trajtuar kryesisht me medikamente për të kuruar reumatizëm.

435. Në vitin 2005, ankuesi filloi shumë procese penale kundër shefit të spitalit të burgut të Tiranës, duke u ankuar për neglizhencë në dhënien e kujdesit mjekësor për të. Në data të paspecifikuara, zyra e Prokurorit të Përgjithshëm, rrëzoi aplikimin e tij, ndërsa apelet nga ankuesi kundër vendimeve të prokurorit janë ende pezull në gjykatat e brendshme.

436. Nga data 21 deri më 24 shkurt 2006, mjekët konfirmuan se ankuesi vinte nga multi skleroza. Ata raportuan përkeqësim të shëndetit të ankuesit nga mungesa e plotë e trajtimit mjekësor për mbi dy vjet. Të frikësuar për jetën e tij, ata rekomanduan në mënyrë të prerë që ankuesi të merrte trajtimin e duhur mjekësor.

E. Masa të përkohshme të dhëna nga gjykata

437. Në lidhje me kërkesën e ankuesit të datës 3 janar 2008, kryetari i dhomës vendosi, më 10 janar 2008, ta njoftonte qeverinë shqiptare për një masë të përkohshme sipas nenit 39 të rregullores së gjykatës, që thotë: “ankuesi duhet të transferohet menjëherë në një spital civil në mënyrë që të kryhen ekzaminimet e duhura mjekësore mbi situatën e tij, dhe në mënyrë që të marrë trajtimin e nevojshëm për gjendjen e tij.” Kryetari vendosi gjithashtu t’i kërkonte qeverisë të informonte menjëherë gjykatën për çdo vendim për të ritransferuar ankuesin në burgun e sigurisë së Lartë të Peqinit, duke bashkëngjitur çdo certifikatë përkatëse mjekësore që mbështeste ritransferimin e tij.

438. Në pasditen e datës 10 janar 2008, duke qenë se ishte hera e parë që zbatohet një masë e përkohshme në lidhje me Shqipërinë, sekretaria e seksionit të katërt (sekretaria), foli me agenten e qeverisë në telefon dhe e njoftoi zyrtarisht për përmbajtjen e masës së përkohshme dhe për rëndësinë e përmbushjes së saj. Agjentja e qeverisë u informua se një kopje e njoftimit për aplikimin e nenit 39 do t’i dërgohej më pas me faks.

439. Mjaft përpjekje për të dërguar njoftimin me faks ishin të pasuksesshme në mbrëmjen e datës 10 janar 2008. Në mëngjesin e datës 11 janar 2008, duke pasur parasysh problemet e vazhdueshme me dërgimin me faks, iu dërgua një kopje e skanuar e njoftimit me postë elektronike agentes së qeverisë, e cila konfirmoi marrjen (nëpërmjet postës elektronike) e njoftimit. Të njëjtin mëngjes, agjentja e qeverisë e informoi gjykatën me anë të një bisede telefonike se ajo kishte kontaktuar në mënyrë urgjente me Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Shëndetësisë, me zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm dhe me institucione të tjera shtetërore në mënyrë që të përmbushej masa e përkohshme e gjykatës. Në parashtrimet e saj me shkrim, qeveria konfirmoi deklaratën e lartpërmendur.

440. Nga 11 janari deri më 22 janar 2008, qeveria nuk dha asnjë informacion në lidhje me informacionin që kishte të bënte me masat e marra për të zbatuar masën e përkohshme të gjykatës të datës 10 janar 2008.

441. Më 23 janar 2008, ankuesi informoi gjykatën se ai ende nuk ishte transferuar.

442. Më 24 janar 2008, letra e ankuesit iu dërgua qeverisë, duke i tërhequr vëmendje për faktin se mosrespektimi i një mase të ndërmjetme mund të çonte në cenimin e nenit 34 të Konventës.

443. Më 25 janar 2008, pas një vendimi të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, ankuesi u transferua në burgun e spitalit të Tiranës me mendimin e çuarjes në spital për kryerjen e ekzaminimeve mjekësore. Të njëjtën ditë ankuesi refuzoi të transferohej në spital dhe hyri në grevë urie. Ai pretendonte se autoritetet duhet t’i ofronin atij trajtimin e duhur në vend të kryerjes së ekzaminimeve mjekësore.

444. Më 28 janar 2008, sekretaria i bëri shumë telefonata përfaqësuesit të ankuesit dhe agentes së qeverisë. Sekretaria i bëri thirrje ankuesit të përfundonte grevën e urisë dhe të respektonte masën e ndërmjetme të gjykatës për transferimin e tij në spital, ku do të kryhej një ekzaminim mjekësor për gjendjen e tij shëndetësore. Sekretaria u bëri thirrje gjithashtu dhe autoriteteve të respektonin masën e ndërmjetme dhe të mos përdornin asnjë lloj force, siç pretendohet nga ankuesi.

445. Në të njëjtën ditë, ankuesi u transferua në pavijonin e neurologjisë të Qendrës Spitalore Universitare, ku iu kryen ekzaminime të specializuara mjekësore.

446. Më 29 janar 2008, pas një letre të Qendrës Universitare Spitalore (QUT), sipas së cilës prania e ankuesit nuk ishte më e nevojshme, ankuesi u transferua sërish në spitalin e burgut të Tiranës.

447. Më 30 janar 2008, qeveria i dërgoi gjykatës një kopje të dosjes mjekësore pas ekzaminimeve mjekësore të datës 28 janar 2008. Një grup mjekësh kishin arritur në përfundimin se ankuesi vuante nga multi skleroza. Grupi i mjekëve rekomandoi që ankuesi të trajtohej me interferon beta për të stabilizuar shëndetin e tij dhe për të parandaluar zhvillimin e sëmundjes. Mjekët nuk ishin në gjendje të përshkruanin me saktësi zhvillimin e sëmundjes me kalimin e viteve, pasi ankuesi nuk kishte qenë nën kujdesin mjekësor. Ata shprehën mendimin e tyre se shëndeti i ankuesit nuk paraqiste ndonjë urgjencë, dhe, në këto rrethana, pacientët në përgjithësi trajtoheshin jashtë, pa qenë nevoja të shtroheshin në spital.

448. Më 14 korrik 2008, qeveria konfirmoi se trajtimi i ankuesit me interferon beta kishte filluar më 17 qershor 2008 në përputhje me përfundimet e konsultës së mjekëve. Ky trajtim administrohej çdo ditë dhe dukej se shëndeti i ankuesit që prej asaj kohe ishte i qëndrueshëm.

449. Më 16 shtator 2008, kryetari i dhomës vendosi të rrëzonte kërkesën e ankuesit për rizbatimin e nenit 39. Gjithsesi, qeverisë iu kërkua “ta informonte gjykatën rregullisht për gjendjen shëndetësore të ankuesit dhe t’i dërgonte asaj prova mjekësore për gjendjen e ankuesit, duke pasur parasysh se kushtet shëndetësore të ankuesit mund të bënin të nevojshme ndihmë të specializuar mjekësore ndërkohë që ai ishte në burg.”

450. Më 12 mars 2009, qeveria e informoi gjykatën se ankuesi ishte pajisur rregullisht me interferon beta dhe me medikamente të tjera të përshtatshme për shëndetin e tij.

II. LEGJISLACIONI I BRENDSHËM PËRKATËS

A. Kushtetuta

451. Neni 4 §§ 1 dhe 2 i Kushtetutës parashikon se e drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit dhe se Kushtetuta është ligji më i lartë në Republikën e Shqipërisë.

452. Neni 5 i Kushtetutës parashikon se Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të.

B. Kodi i Procedurës Penale

453. Pjesët përkatëse të Kodit të Procedurës Penale (KPP) që ishin në fuqi në atë kohë, parashikojnë si më poshtë:

1. Neni 13 § 2

454. Neni 13 § 2, pika (ç) i KPP-së, i ndryshuar nga seksioni 1 i ligjit nr. 8813, datë 13 qershor 2002 (në fuqi që prej 11 qershorit 2002), parashikon se “... gjykatat e rrethit mbledhen me formacion me një gjyqtar të vetëm në rastet e bashkëpunimit me autoritetet e huaja...”.

2. Nenet 432 dhe 448

455. Neni 432 parashikon se rekurs në Gjykatën e Lartë bëhet për: a) mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit penal; b) për shkelje që kanë si pasojë pavlefshmërinë absolute të vendimit të gjykatës, sipas nenit 128 të KPP-së; c) për shkelje procedurale që kanë ndikuar në dhënien e vendimit.

456. Neni 448 § 2 parashikon se vendimi i gjykatës së rigjyimit mund të ankimohet vetëm për shkaqet që nuk lidhen me pikat e vendosura nga Gjykata e Lartë.

3. Neni 512

457. Neni 512, për njohjen në Shqipëri të vendimeve të huaja, parashikon se Ministria e Drejtësisë, kur informohet për një vendim të dhënë nga një autoritet i huaj në lidhje me qytetarë shqiptarë, i dërgon zyrës së prokurorisë një kopje të vendimit dhe dokumentet e tjera përkatëse. Ministria e Drejtësisë kërkon njohjen e një vendimi penal të huaj edhe kur çmon se në bazë të një marrëveshjeje ndërkombëtare ky vendim duhet të ekzekutohet ose t’i njihen efekte të tjera në shtetin shqiptar.

4. Neni 514

458. Neni 514 i Kodit të Procedurës Penale, para se të ndryshohej me ligjin nr. 8813 të

datës 13 qershor 2002, parashikonte se vendimi i gjykatës së huaj nuk mund të njihej kur:

a) vendimi nuk ka marrë formë të prerë sipas ligjeve të shtetit ku është dhënë; b) vendimi përmban dispozita në kundërshtim me parimet e rendit juridik të shtetit shqiptar; c) vendimi nuk është dhënë nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme ose i pandehuri nuk është thirrur të paraqitet në gjykim ose nuk i është njohur e drejta që të pyetet në një gjuhë që e kupton dhe të ndihmohet nga një mbrojtës; ç) ka arsye të bazuara për të menduar se kanë ndikuar në përfundimin e procesit çështje lidhur me racën, fenë, seksin, gjuhën apo bindjet politike; d) fakti për të cilin është dhënë vendimi nuk parashikohet si vepër penale nga ligji shqiptar; dh) për të njëjtin fakt dhe ndaj të njëjtit person, në shtetin shqiptar është dhënë një vendim i formës së prerë ose zhvillohet një procedim penal ose e) personi i dënuar ose përfaqësuesi i tij nuk e kanë dhënë pëlqimin e tyre.

459. Seksioni 64 i ligjit nr. 8813, datë 13 qershor 2002 (në fuqi që prej 11 qershorit 2002) parashikon: “Neni 514 § 1, pika e) e KPP-së shfuqizohet.”

C. Kodi Penal, ndryshuar me ligjin nr. 8204, datë 10 prill 1997, ligji nr. 8279, datë 15 janar 1998 dhe ligji nr. 8733, datë 24 janar 2001

460. Neni 78 i Kodit Penal që ishte në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, në vitin 1997, parashikonte se një person i dënuar për vrasje me paramendim dënohet me pesëmbëdhjetë deri në njëzet vjet heqje lirie, dhe, në rast të rrethanave rënduese, me burgim të përjetshëm ose me vdekje.

461. Duke marrë parasysh rigjallërimin e hakmarrjeve në rajonet veriore dhe verilindore të Shqipërisë, ligji nr. 8733, datë 24 janar 2001, që hyri në fuqi më 13 mars 2001, ndryshoi, *inter alia*, dhe nenin 78 të Kodit Penal duke shtuar një paragraf të ri që rregullon vrasjet për hakmarrje në mënyrë që të ndalohej shkatërrimi i plotë i familjeve. Dispozita e re, në fuqi në kohën kur vendimi italian u konvertua nga gjykatat shqiptare, lexon si më poshtë:

Neni 78

“1. Një person i dënuar për vrasje me paramendim dënohet me pesëmbëdhjetë deri në njëzet e pesë vjet heqje lirie.

2. Një person i dënuar për vrasje me paramendim për shkak të një interesi ose/dhe hakmarrjes dënohet nga njëzet vjet burgim deri me burgim të përjetshëm.”

D. Akti për të Drejtat dhe Trajtimin e të Burgosurve (Ligji nr. 8328, datë 16 prill 1998, ndryshuar me ligjin nr. 9888, datë 10 mars 2008 – “Akti i të Drejtave të të Burgosurve”)

462. Seksioni 33 i Aktit të të Drejtave të Burgosurve, në fuqi në kohën në fjalë, parashikon se, në mungesë të trajtimit mjekësor në njësinë shëndetësore të spitalit, dhe, kur është e nevojshme, i burgosuri transferohet në një spital burgu ose në një institucion tjetër mjekësor, me urdhër të prokurorit. I burgosura ka të drejtë të ankimojë brenda pesë ditësh në gjykatën e rrethit kundër refuzimit të prokurorit [për ta transferuar atë në spital].

III. MATERIALET NDËRKOMBËTARE PËRKATËSE

A. Konventa Ndërkombëtare për Njohjen Ndërkombëtare të Vendimeve Penale (Seritë e Traktatit European (ETS) nr. 70)

463. Konventa ka hyrë në fuqi në Shqipëri më 23 janar të vitit 2004. Ajo u nënshkruan nga Italia më 4 shkurt të vitit 1971, dhe as sot e kësaj dite nuk është ratifikuar. Pra, ajo nuk ishte në fuqi në lidhje me vendin tjetër më 20 maj 2003, kur ankuesi u dënua nga Gjykata e Rrethit të Tiranës. Dispozitat përkatëse të saj parashikojnë si më poshtë:

Neni 3

“1. Një Shtet Kontraktues është kompetent në rastet dhe në kushtet e parashikuara në këtë Konventë për të zbatuar një vendim të dhënë në një tjetër Shtet Kontraktues që është i zbatueshëm në këtë shtet.

2. Kjo kompetencë mund të ushtrohet pas një kërkesë nga Shteti tjetër Kontraktues.”

B. Konventa për Transferimin e Personave të Dënuar (ETS nr. 112) dhe Protokolli Shtesë i saj (ETS nr. 167)

464. Objektivat e Konventës së Transferimit të vitit 1983, duke përfshirë dhe Protokollin e saj Shtesë të vitit 1997, janë që të zhvillohet bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën e së drejtës penale dhe të çohen më tej qëllimet e drejtësisë dhe të rehabilitimit shoqëror të personave të dënuar. Preambula e Konventës së Transferimit thotë se objektivat kërkojnë që të huajt, të cilëve u është mohuar liria si rezultat i kryerjes së një vepre penale prej tyre, duhet t'u jepet e drejta të vuajnë dënimin e tyre brenda shoqërisë së tyre. Dispozitat e saj, të lidhura me çështjen, parashikojnë si më poshtë:

Neni 1 **Përkufizime**

“Në kuptimin e kësaj Konvente:

(...)

c. “Shteti dënues” është shteti në të cilin është marrë vendimi për personin që mund të transferohet ose është transferuar;

d. “Shteti administrues” është shteti tek i cili personi i dënuar mund të transferohet ose është transferuar në mënyrë që të vuajë dënimin”.

Neni 3 **Kushtet e transferimit**

“1. Një person i dënuar mund të transferohet sipas kësaj Konvente, vetëm në kushtet e mëposhtme:

nëse ky person është nënshtetas i shtetit administrues;

(...)”

465. Konventa e Transferimit ka hyrë në fuqi në Shqipëri më 1 gusht 2000, dhe në Itali më 1 tetor 1989. Protokollin e saj Shtesë nuk është ratifikuar as sot e kësaj dite nga asnjë nga shtetet.

C. Raportet e Komitetit Europian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Dënimin Çnjerëzor ose Degradues (“CPT-ja”)

466. CPT-ja ka vizituar Shqipërinë në vitin 2005, 2006 dhe 2008. Në 2005-en, delegacioni vizitoi, inter alia, dhe spitalin e burgut të Tiranës.

1. Gjetjet përkatëse të raportit të 2005-ës (të bëra publike në 12 korrik 2006)

467. Në këtë raport (CPT/Inf (2006) 24) CPT-ja identifikoi se ambientet e kujdesit shëndetësor, “ishin të një cilësie shumë të varfër në të gjitha qendrat e vizituara. Për shembull, kudo mungonte dhe një pajisje bazë, si peshoret. Megjithatë është e panevojshme të thuhet, një gjendje e tillë pune pengon edhe kontrollin e përshtatshëm të ushqimit të ofruar në burg, dhe mbikëqyrjen e grevave të urisë që ndodhnin herë pas here. Është gjithashtu shqetësuese që në dhomën e kirurgjisë dentare në burgun e Tiranës-Vaqarr, nuk kishte ujë. Më tej, si në burgun e Tepelenës dhe në burgun 313 të Tiranës, gjendja e pastërtisë dhe e higjienës në dhomat e konsultimit të mjekëve linte shumë për të dëshiruar.”

468. CPT-ja vë re më tej “disa mangësi serioze në lidhje me kontrollin mjekësor në pranim të të burgosurve në burgjet e vizituara (në veçanti, ekzaminime që nuk kryheshin në mënyrë sistematike ose që kryheshin vetëm sa për të kaluar radhën).” Ajo shpreh gjithashtu shqetësimin e saj se “personat e ardhur rishtazi në pritje të dënimin, nuk kontrolloheshin në mënyrë sistematike për sëmundje të transmetueshme (të tilla si hepatiti B dhe C, HIV, sifilizi dhe turbekulozi), dhe se të burgosurve nuk u jepej asnjë informacion në lidhje me parandalimin e këtyre sëmundjeve”.

469. CPT-ja vuri re se në burgjet nr. 302 dhe 313 disa nga dosjet mjekësore nuk ekzistojnë. Dhe kur “gjendeshin”, dosjet nuk përmbanin asgjë përveç emrave të të dënuarve përkatës.

470. Në lidhje me trajtimin e pacientëve me kushte serioze mjekësore, CPT-ja vuri re një numër rastesh individuale që ilustronin mangësi alarmante në disa prej qendrave të vizituara. Fragmentet përkatëse deklarojnë:

“Në burgun e Tepelenës dhe të Tiranës, në Vaqarr, delegacioni u takua me dy të burgosur, të cilët, si rezultat i gjendjes së tyre shëndetësore (njëri me psikozë të rëndë dhe tjetri në gjendje të avancuar kanceri), kishin nevojë urgjente për trajtim të specializuar në ambiente spitalore. Gjithsesi,

nuk ishte marrë asnjë iniciativë për t'i transferuar të burgosurit në spitalin përkatës të burgut. Gjatë bisedave në fund të vizitës, delegacioni u kërkoi autoriteteve shqiptare të merrnin masa urgjente në lidhje me këto dy raste. Në letrën e tyre të datës 14 korrik 2005, autoritetet shqiptare konfirmuan se të dy të burgosurit ishin transferuar në spitalin e burgut.

Në burgun e Vaqarrit në Tiranë, delegacioni u takua me një të burgosur që vuante nga diabeti, i cili nuk merrte një dietë të veçantë. CPT-ja duhet të theksojë se një nivel i tillë pune çon në mohimin e trajtimit. Më tej, në rastin e një të burgosuri tjetër në Vaqarr, Tiranë, i cili vuante nga tuberkulozi, delegacioni vuri re se kishte pasur një vonesë të konsiderueshme në transferimin e të burgosurit përkatës në spitalin e burgut. Më tej, gjatë transferimit të tij në spital nuk ishte marrë asnjë masë mbrojtëse në mënyrë që të shmangej infektimi i të burgosurve ose i të dënuarve të tjerë nga sëmundja.”

471. CPT-ja u rekomandoi autoriteteve shqiptare të rishikonin dispozitat e kujdesit shëndetësor në qendrat e vizituara prej tyre.

2. Gjetjet përkatëse në raportin e 2006-ës (të bëra publike më 6 shtator 2007)

472. Në këtë raport (CPT/Inf (2007) 35) të CPT-së u theksua mosrespektimi nga ana e autoriteteve vendore i rekomandimeve të tyre, në veçanti në lidhje me ekzaminimet mjekësore në pranimet në qendrat e paraburgimit.

473. CPT-ja vuri re se “nuk janë bërë përmirësime në lidhje me dispozitën e përgjithshme të kujdesit shëndetësor në asnjë nga ambientet e vizituara, pavarësisht nga rekomandimet e ndryshme të bëra nga CPT-ja në raportet e saj pas vizitave të 2003-it dhe të 2005-ës”.

474. Në lidhje me një ndër ambientet e paraburgimit të vizituar nga CPT-ja, ajo vuri re se “kushtet në ambientet e kujdesit shëndetësor ishin alarmante. Delegacioni dëgjoi shumë ankesa nga të burgosurit rreth vonesave për t'u vizituar nga doktori dhe rreth cilësisë së kujdesit shëndetësor të ofruar; vetë delegacioni, qe dëshmitar i një të burgosuri që kishte nevojë për ndihmë mjekësore urgjente i cili ishte lënë në një gjendje neglizhence të plotë”.

475. CPT-ja ngriti çështjen e vonesave të gjata të vëna re në transferimin e të burgosurve që kishin nevojë urgjente të shtroheshin në spital. “Vizita e vitit 2006 demonstroi se ky problem nuk ishte zgjidhur ende. Delegacioni u informua se spitalet e përgjithshme ngurronin të pranonin të dënuar në qendrat e paraburgimit për shkak të arsyeve të sigurisë, ndërsa transferimi në spitalin e burgut të Tiranës raportohet si i vështirë pasi spitali i burgut është nën kompetencën e Ministrisë së Drejtësisë”.

Gjetjet përkatëse në raportin e 2008-ës (të bëra publike më 21 janar 2009)

476. Në këtë raport (CPT/Inf (2009) 6) CPT-ja evidenton se ofrimi i kujdesit të përgjithshëm shëndetësor në tërësi duket i përshtatshëm në pjesën më të madhe të qendrave të vizituara, pavarësisht nga situatat që çonin në shqetësime të caktuara. Ai vuri re dhe disa përmirësime në lidhje me ekzaminimet shëndetësore në pranim, megjithëse kjo “mbetet një fushë veçanërisht problematike në sistemin e burgjeve në Shqipëri”.

477. CPT-ja deklaroi se kishte pasur mangësi në ofrimin e kujdesit të specializuar shëndetësor, në veçanti në ofrimin e kujdesit dentar dhe të kujdesit psikiatrik.

LIGJI

I. CENIM I PRETENDUAR i nenit 3 TË KONVENTËS

478. Ankuesi u ankua për mungesë të trajtimit të duhur mjekësor në burg që çon në keqtrajtim, në kundërshtim me nenin 3 të Konventës, i cili parashikon si më poshtë:

“Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës ose dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose degraduese.”

A. Pranueshmëria

479. Qeveria e kontestoi argumentin e ankuesit. Ajo parashtroi se ankuesi kishte marrë të gjithë trajtimin e nevojshme në spitalin e burgut dhe u ishte nënshtruar disa ekzaminimeve mjekësore. Gjithsesi, ajo tha se përderisa ankuesi nuk e ka ngritur çështjen në gjykatën e brendshme kompetente, në përputhje me Aktin e të Drejtave të të Burgosurve, ankesa e tij në lidhje me nenin 3 ishte e papranueshme për mos shterim të burimeve të brendshme.

480. Ankuesi vijoi me pretendimet e tij. Ai parashtroi se ndihma mjekësore e marrë në

spitalin e burgut ishte e papërshtatshme. Autoritetet ishin plotësisht të ndërgjegjshme për sëmundjet e tij (shih paragrafët 425 dhe 431 më lart). Babai i tij kishte pyetur për shëndetin e të birit në disa raste. Por, të gjitha përgjigjet e marra nga administrata e burgjeve kishin qenë të një natyre të përgjithshme dhe nuk kishin përfshirë asnjë informacion të detajuar në lidhje me trajtimin e marrë prej tij. Ankuesi theksoi në veçanti faktin se autoritetet e burgjeve e kishin trajtuar atë me medikamente jo të duhura, duke i shkaktuar atij dhimbje dhe duke e përkeqësuar gjendjen e tij shëndetësore. Së fundmi, ankuesi pretendoi se qeveria kishte dështuar në të provuarin e përshtatshmërisë së masave që kërkoheshin të merreshin, pasi të gjitha ankesat e tij kundër mjekëve të spitalit të burgut ishin rrëzuar nga prokurori si të pabaza.

481. Gjykata përsërit se rregulli i shterimit të mjeteve të brendshme juridike i detyron ata që kërkojnë të ngrenë çështjen e tyre kundër një shteti në një organ ndërkombëtar gjyqësor ose arbitrazhi të përdorin së pari mjetet e parashikuara nga sistemi ligjor kombëtar. Rregulli bazohet në supozimin se ka mjete efektive të disponueshme në lidhje me shkeljen e pretenduar në sistemin e brendshme, pavarësisht nëse dispozitat e Konventës janë ose jo të inkorporuara në të drejtën e brendshme. Në këtë mënyrë, ky është një aspekt i rëndësishëm i parimit që makineria e mbrojtjes e parashikuar në Konventë është plotësuese për sistemet kombëtare që ruajnë të drejtat e njeriut (shih Handyside k. Mbretërisë së Bashkuar, 7 dhjetor 1976, § 48, Seritë A nr. 24). Në të njëjtën kohë, është detyrim i qeverisë të ofrojë një mjet efektiv të disponueshëm në teori dhe në praktikë për gjykatën në kohën në fjalë, pra një mjet që ishte i aksesueshëm, i aftë për të trajtuar pretendimet e ankuesit dhe që ofron mundësi të arsyeshme suksesi (shih Selmouni k. Francës [GC], nr. 25803/94, § 76, ECHR 1999-V, dhe Mifsud k. Francës (vend.), nr. 57220/00, § 15, ECHR 2002-VIII).

482. Gjykata vëren se ankuesi ka depozituar shumë ankesa tek autoritetet përgjegjëse, duke i sjellë shqetësimet e tij në vëmendje të autoriteteve kombëtare në një kohë që pritej në mënyrë të arsyeshme që ata të kishin marrë masat e nevojshme. Përshkrimi i problemeve shëndetësore nga ankuesi në ankesat e tij ishte i detajuar dhe koherent. Autoritetet kishin një dosje të historisë së tij mjekësore dhe ishin të informuara për rekomandimet e bëra nga mjekët civilë në lidhje me trajtimin mjekësor të nevojitur. Gjithsesi, ankesat u rrëzuan të gjitha nga prokurori, si të pabazuara.

483. Gjykata vë re se qeveria ka dështuar në të provuarin se mjetet e ofruara do të kishin qenë praktikisht efektive. Ajo nuk dorëzoi asnjë vendim të asnjë gjykate të brendshme për të mbështetur pozicionin e saj. Nuk ka prova se një mjet i tillë do të kishte qenë i aftë të trajtonte pretendimin e ankuesit dhe të ofronte perspektiva të suksesshme suksesi. Si rezultat, gjykata rrëzon kundërshtimin e qeverisë.

484. Duke pasur parasysh konsideratat e sipërpërmendura, gjykata është e mendimit se kjo ankesë nuk është shprehimisht e pabazuar në kuptimin e nenit 35 § 3 të Konventës. Gjykata vë re më tej, se ajo nuk është e papranueshme për asnjë arsye tjetër. Si rezultat, ankesa duhet të deklarohet e pranueshme.

B. Themeli i çështjes

1. Parashtrimet e palëve

485. Ankuesi pretendon se autoritetet nuk i kanë dhënë trajtimin mjekësor të kërkuar prej tij, sipas mendimit dhe recetave të mjekëve civilë, duke çuar në keqtrajtim. Ai u bazua në raportet mjekësore për gjendjen e tij shëndetësore, dhe në veçanti në raportet mjekësore të datës 19 prill 2005 dhe 12 dhjetor 2006, që theksojnë mungesën e trajtimit mjekësor të marrë nga ankuesi për një periudhë të zgjatur kohore dhe ndikimet e kësaj gjëje mbi përkeqësimin e shëndetit të tij.

486. Qeveria insistoi se ankuesi kishte marrë trajtimin e saktë dhe të duhur mjekësor. Në parashtrimet e saj, tregohet se nga koha e arrestimit në vitin 2001 e në vijim se ankuesi kishte marrë trajtim spitalor në spitalin e burgut të Tiranës nëntë herë, ku i ishte ofruar trajtimi dhe ekzaminimet e duhura mjekësore. Qeveria përfundoi se pretendimi i ankuesit sipas nenit 3 ishte i pabazuar.

487. Pas njoftimit të Gjykatës për masë të përkohshme sipas nenit 39 të rregullores së gjykatës, qeveria parashitroi se dhënia e interferon beta për ankuesin kishte një kosto shumë të lartë për administratën e burgjeve. Por, gjithsesi, Qeveria pranoi se ky mjekim është i disponueshëm pa pagesë për publikun e përgjithshëm në spitale.

2. Vlerësimi i gjykatës

488. Gjykata vë re se palët paraqitën të dhëna të ndryshme në lidhje me ndihmën mjekësore të marrë nga ankuesi në burg. Si rrjedhim, gjykata do të fillojë ekzaminimin e saj për pretendimet e ankuesit në lidhje me nenin 3 me kërkimin e fakteve përkatëse.

a) Përcaktimi i fakteve

489. Në çështjen në fjalë, ankuesi pretendon se ai nuk ka marrë trajtimin ose ekzaminimin e duhur mjekësor, në përputhje me gjendjen e tij, ndërkohë që ishte i ndaluar.

490. Nuk diskutohet nga palët që pas arrestimit të tij në vitin 2001 e deri në gusht të 2004-ës ankuesi ka marrë trajtim spitalor në spitalin e burgut për simptoma dhe sindroma të ndryshme. Pavarësisht nga mosha e tij e re, ankuesi vuante, përveç të tjerash, nga vështirësi në lëvizje dhe dhimbje të fortë në ekstremitetet e poshtme, probleme në urinim dhe kapsllëku. Vetëm në gusht të 2004-ës, pas një ekzaminimi të hollësishëm, ankuesi u diagnostikua se vuante nga multiskleroza (shih paragrafin 422 më lart).

491. Nga janari deri në shtator 2005, ankuesi u dërgua në spitalin e burgut për trajtim dhe ekzaminime vetëm në një rast, pavarësisht nga kërkesat e tij të përsëritura. Kështu, më 19 prill 2005, një grup mjekësh e vizituan, konfirmuan diagnozën e multisklerozës dhe i dhanë trajtim të vazhdueshëm me interferon-beta në përputhje me protokollet mjekësore (shih paragrafin 431 më lart).

492. Gjykata vë re, me shqetësim, se gjatë ndalimit të tij nga prilli i vitit 2005 deri më 28 janar 2008, data në të cilën ankuesi i nënshtrohet një ekzaminimi mjekësor si rezultat i marrjes së masës së përkohshme nga gjykata për qeverinë përkatëse, ankuesi ishte lënë për periudha të gjata kohore pa trajtimin e duhur mjekësor. Raporti i fundit mjekësor për gjendjen shëndetësore të ankuesit konfirmoi se zhvillimi i sëmundjes me kalimin e viteve ishte si rezultat i mungesës së kujdesit mjekësor (shih paragrafin 447 më lart).

493. Në të paktën dy raste, babai i ankuesit i ka kërkuar administratës së burgut një kontroll të pavarur mjekësor të shëndetit të ankuesit dhe trajtim të duhur mjekësor për të (shih paragrafin 421 më lart). Gjithsesi, këto kërkesa u refuzuan: siç del nga certifikata mjekësore e dhënë nga qeveria, ekzaminimet mjekësore të mëparshme për ankuesin ishin të munduara vetëm pas miratimit të prokurorit. Është alarmuese që çështja e ekzaminimit mjekësor të ankuesit i është lënë për të vendosur prokurorit, jo mjekëve, nëse ankuesi kishte nevojë për ekzaminime të tjera mjekësore.

494. Në përmbledhje, faktorët e sipërpërmendur duken se mbështesin pretendimet e ankuesit se kujdesi i tij mjekësor në burg ishte i papërshtatshëm. Në rrethana të tilla, i takon qeverisë të kundërshtojë këtë gjetje. Gjithsesi, qeveria nuk ofroi asnjë dokument për të justifikuar arsyet pse autoritetet refuzuan t'i jepnin ankuesit trajtimin mjekësor të dhënë nga mjekët civilë, ose të shpjegojë si trajtimi me vitamina dhe antidepressantë mund të konsiderohet i përshtatshëm (shih paragrafin 432 më lart), (shih, mutatis mutandis, Ostrovar k. Moldavisë, nr. 35207/03, § 86, 13 shtator 2005). Qeveria, thjesht, dhe shumë sipërfaqësisht, pretendon, pa shpjeguar ose pa ofruar argumente të mtejshme, se ankuesi i është nënshtroar “trajtimin spitalor disa herë në ambientet e spitalit të burgut”. Si rezultat, gjykata është e mendimit se qeveria nuk ka dhënë një shpjegim të arsyeshëm për përkeqësimin e shëndetit të ankuesit në burg.

495. Si rezultat, gjykata e pranon versionin e ankuesit për problemet e tij shëndetësore dhe ndihmën mjekësore të marrë gjatë burgimit. Në veçanti, gjykata pranon se nga tetori i vitit 2004 e deri në prill 2005, ankuesit i është refuzuar marrja e ekzaminimit mjekësor dhe trajtimi në spitalin e burgut, dhe se trajtimi mjekësor i dhënë në burg nuk ishte në përputhje me kushtet e tij shëndetësore. Gjatë të gjithë ndalimit të tij nga tetori i vitit 2004 e në vijim, autoritetet dështuan në monitorimin e sëmundjes së tij dhe ofrimin e trajtimit të duhur mjekësor, gjë që përkeqësuan kushtet e tij shëndetësore. Nga maji i vitit 2005 deri në 28 janar të vitit 2008, ankuesi u konsiderua se nuk kishte nevojë për trajtim mjekësor shtesë, pavarësisht nga raportet e mjekëve civilë për të. Vetëm më 17 qershor 2008 ankuesit iu ofrua trajtimi i nevojshëm, si rezultat i ekzaminimeve mjekësore të 28 janarit 2008.

496. Gjykata tani do të shqyrtojë nëse këto fakte, të marra së bashku me rrethanat përkatëse të çështjes, çojnë në “trajtim çnjerëzor dhe degradues”, siç sugjerohet nga ankuesi.

b) Shqyrtimi i ankesës

497. Gjykata thekson se neni 3 i Konventës flet për një ndër vlerat më themelore të një shoqërie demokratike. Ai ndalon në mënyrë absolute torturën ose trajtimin ose dënimin çnjerëzor dhe degradues, pavarësisht nga rrethanat dhe sjellja e viktimës (shih *Labita k. Italisë*, nr. 26772/95, § 119, ECHR 2000-IV).

498. Gjykata thekson më tej se, sipas jurisprudencës së saj, keqtrajtimi duhet të ketë një nivel minimal ashpërsie për t'u konsideruar se bien në objektin e nenit 3. Vlerësimi i këtij minimumi është relativ; ky minimum varet nga tërësia e rrethanave të çështjes, efektet e saj fizike dhe mendore, dhe, në disa raste, seksi, mosha, gjendja shëndetësore e viktimës (shih, ndërmjet autoriteteve të tjera, *Ireland k. Mbretërisë së Madhe*, vendim i 18 janarit 1978, Seritë A nr. 25, f. 65, § 162). Megjithëse qëllimi i një trajtimi të tillë është faktor për t'u marrë parasysh, në veçanti pyetja nëse ai kishte si qëllim të poshtëronte ose të degradonte viktimën, mungesa e një qëllimi të tillë nuk të çon në mënyrë të paevitueshme në përfundimin se nuk ka pasur shkelje të nenit 3 (shih *Peers k. Greqisë*, nr. 28524/95, § 74, ECHR 2001-III).

499. Në raste përjashtimore, kur gjendja shëndetësore e të ndaluarit është absolutisht e papërputhshme me burgimin, neni 3 mund të kërkojë nxjerrjen e një personi të tillë në kushte të caktuara (shih *Papon k. Francës* (nr. 1) (dec.), nr. 64666/01, ECHR 2001-VI, dhe *Priebke k. Italisë* (vend.), nr. 48799/99, 5 prill 2001). Ka tre elemente të veçanta që duhen shqyrtuar në lidhje me përputhshmërinë e shëndetit të ankuesit me qëndrimin e tij në burgim: (a) kushtet mjekësore të të burgosurit, (b) përshtatshmëria e ndihmës mjekësore dhe kujdesi i ofruar në burgim; dhe (c) këshillimi i vuajtjes së masës së dënimit në kushtet e gjendjes shëndetësore të ankuesit (shih *Mouisel k. Francës*, nr. 67263/01, §§ 40-42, ECHR 2002-IX).

500. Gjithsesi, neni 3 nuk mund të interpretohet sikur parashikon një detyrim të përgjithshëm për lirin e të burgosurve për arsye shëndetësore. Ai, në fakt i vendos detyrimin shtetit të mbrojë mirëqenien fizike të personave të cilëve u është mohuar liria. Gjykata e pranon se ndihma mjekësore e disponueshme në spitalet e burgut jo gjithmonë mund të jetë në të njëjtin nivel si ndihma e ofruar në institucionet më të mira mjekësore për publikun e gjerë. Gjithsesi, shteti duhet të sigurojë se ruhen siç duhet shëndeti dhe mirëqenia e të burgosurve nëpërmjet, ndër të tjerash, ofrimit të ndihmës së nevojshme mjekësore (shih *Kudła k. Polonisë* [GC], nr. 30210/96, § 94, ECHR 2000-XI; shih gjithashtu *Hurtado k. Zvicrës*, vendimi i 28 janarit 1994, Seritë A nr. 280-A, opinion i Komisionit, faqe. 15-16, § 79; dhe *Kalashnikov k. Rusisë*, nr. 47095/99, §§ 95 dhe 100, ECHR 2002-VI). Në *Farbtuhs k. Letonisë* (nr. 4672/02, § 56, 2 dhjetor 2004). Gjykata theksoi se nëse autoritetet do të kishin vendosur të çonin dhe të mbanin një person të sëmurë rëndë në burg, ata duhet të tregojnë kujdes të posaçëm për garantimin e kushteve të burgimit që u përkojnë nevojave të veçanta të të burgosurit që vijnë si rezultat i paaftësisë së tij (shih gjithashtu *Paladi k. Moldavisë*, nr. 39806/05, § 81, 10 korrik 2007).

501. Gjykata mban parasysh raportet e CPT-së, të cilat, ndonëse nuk përmbajnë informacion që lidhet drejtpërsëdrejti me kushtet aktuale të ndalimit të ankuesit dhe gjendjes së tij shëndetësore, gjithsesi e informojnë gjykatën duke i ofruar një panoramë të plotë të situatës së përgjithshme në burgjet në Shqipëri gjatë periudhës në fjalë (shih, për shembull, I.I. k. Bullgarisë, nr. 44082/98, § 71, 9 qershor 2005).

502. Duke iu kthyer çështjes në fjalë, gjykata vë re se provat nga burimet e ndryshme mjekësore konfirmojnë se ankuesi kishte probleme të shumta mjekësore që kërkonin ndihmë të rregullt mjekësore. Gjithsesi, asgjë nuk sugjeronte se sëmundjet e tij ishin në parim të papërputhshme me burgimin. Burgu kishte një njësi mjekësore, ku ankuesi ishte vizituar në shumë raste, dhe sëmundja e tij prezumohet të mund të ishte trajtuar në atë njësi.

503. Në të njëjtën kohë, gjykata i referohet vëzhgimeve të saj se ankuesi nuk e kishte marrë ndihmën e nevojshme ligjore (shih paragrafët 494 dhe 495 më lart). Edhe ndërsa ishte në spitalin e burgut, ai vuante qartë nga efektet fizike të kushteve të tij mjekësore. Në lidhje me efektet mendore, ai mund të ketë ditur se ishte në rrezik të një emergjence mjekësore në çdo moment, emergjencë me pasoja serioze dhe se nuk kishte ndihmë të kualifikuar mjekësore të disponueshme. Ankuesit jo

vetëm që iu refuzua ndihma e nevojshme mjekësore nga autoritetet, por ai u vendos në një regjim të sigurisë së lartë, duke iu mohuar mundësia për të kontaktuar me përfaqësuesin e tij (shih paragrafin 429 dhe 430 më lart). Kjo mund të ketë çuar në një ankth të konsiderueshëm në anën e tij.

504. Gjykata nuk mund të pranojë argumentin e qeverisë se trajtimi i ankuesit me interferon beta do të ngarkonte rëndë Buxhetin e Shtetit. Ndërsa gjykata nuk nënvlerëson vështirësitë financiare të qeverisë, ajo thekson se ky medikament ofrohet pa pagesë për publikun në spitale. Qeveria nuk dha asnjë arsye legjitime për të justifikuar heqjen e së drejtës së ankuesit, ndryshe nga anëtarët e tjerë të publikut, për t’iu përmbushur kostot e medikamenteve të tij plotësisht nga shteti përkatës të.

505. Ankuesi vuante nga një sëmundje shumë e rëndë, nga multiskleroza. Edhe nëse zbulohet dhe trajtohet shpejt, kjo sëmundje është e aftë të shkaktojë paaftësi (njohëse, gjykuese, dhe çrregullime kujtese, probleme në lëvizje, dhimbje, kushte të varfra dhe mosfunksionim të muskujve unazorë) dhe vdekje. Rreziku i sëmundjes, i shoqëruar me mungesën e trajtimit të përshtatshëm mjekësor dhe kohëzgjatja e kohës së burgimit, e intensifikuan frikën e tij. Në këto rrethana, mungesa e ndihmës mjekësore në kohën e duhur, që i shtohet refuzimit të autoriteteve për t’i ofruar atij trajtimin e duhur mjekësor të dhënë nga mjekët civilë, krijuan një ndjenjë kaq të fortë mungese sigurie, e cila, e kombinuar me vuajtjet fizike, çojnë në trajtimin degradues të parashikuar në kuptimin e nenit 3.

506. Si rezultat, ka pasur shkelje të nenit 3 të Konventës në këtë aspekt.

II. SHKELJE E PRETENDUAR E NENIT 5 § 1 TË KONVENTËS

507. Ankuesi pretendon se burgimi i tij nga data 30 prill 2001 e në vijim ka qenë i paligjshëm dhe se autoritetet nuk kanë mundur të justifikojnë arrestimin dhe ndalimin pasues të tij sipas ndonjëres nga arsyet specifike të parashikuara në nenin 5 § 1 dhe se kjo ishte pasojë e proceseve arbitrare.

508. Gjykata është e mendimit se pretendimi i ankuesit duhet të shqyrtohet sipas nenit 5 § 1 (a) dhe (c) të Konventës, e cila, në pjesët përkatëse, parashikon:

“1. Çdokush ka të drejtën e lirisë e të sigurisë personale. Askujt nuk mund t’i hiqet liria, me përjashtim të rasteve që vijnë dhe në përputhje me procedurën e parashikuar

a. kur burgoset ligjërisht, pas një dënimi të dhënë nga një gjykatë kompetente;

c. kur është arrestuar dhe paraburgosur për t’u çuar përpara autoritetit gjyqësor kompetent, kur ka arsye të besueshme për të dyshuar se ai ka kryer një vepër penale ose kur ka motive të arsyeshme për të besuar se është e nevojshme që të pengohet të kryejë një vepër penale ose të largohet pas kryerjes së saj;

...”

A. Pranueshmëria

1. Parashtrimet e palëve

509. Qeveria pretendoi se arrestimi dhe ndalimi i ankuesit ishin bërë në përputhje me dispozitat e nenit 5 § 1 të Konventës. Qeveria nuk ka parashtruar asnjë kundërshtim në lidhje me pranueshmërinë e kësaj ankese.

510. Ankuesi kontestoi argumentin e qeverisë.

2. Vlerësimi i gjykatës

511. Gjykata vë re se ankuesi u ndalua fillimisht më 30 prill 2001 me fuqinë e padisë penale që lidhej me përfshirjen e tij të pretenduar në trafikim droge. Del nga kërkesat e palëve se thelbi i vëzhgimeve të tyre ka lidhje me ndalimin e ankuesit që prej 15 majit 2002 për sa i përket proceseve që kanë të bëjnë me njohjen dhe me zbatimin e gjykimit të Gjykatës Italiane.

512. Mbi këtë kuptim, gjykata do të shqyrtojë ligjshmërinë e ndalimit të ankuesit nga data 15 maj 2002. Gjykata është e mendimit se datë përfundimtare do të jetë 29 dhjetori 2003, data në të cilën ankuesi ishte dënuar për trafikim droge në grupin e parë të proceseve. Pas asaj date, kishte një bazë ligjore për ndalimin e tij sipas nenit 5 § 1 (a) të Konventës.

513. Për më tepër, Gjykata është e përgatitur të trajtojë ndalimin e ankuesit që prej 15 maj të 2002-it sikur të bjerë nën objektin e nenit 5 § 1 (a) të Konventës. Për gjykatën, në lidhje me proceset që lidhen me njohjen e vlefshmërisë dhe zbatimit të vendimeve të lëshuara nga një gjykatë e huaj, prezumimi është që ndalimi i një individi është “ndalimi i ligjshëm ... pas dënimit nga një

gjykatë kompetente”.

514. Gjykata është e mendimit se kjo ankesë nuk është shprehimisht e keqbazuar brenda kuptimit të nenit 35 § 3 të Konventës. Ajo vë re më tej se ankesa nuk është e papranueshme mbi asnjë bazë tjetër. Si rezultat, gjykata e deklaroi ankesën të pranueshme.

B. Themeli i çështjes

1. Parashtrimet e palëve

515. Qeveria pretendoi se ndalimi i ankuesit është në përputhje me nenin 5 § 1 të Konventës. Ajo parashittoi se më 15 maj 2002, autoritetet kishin urdhëruar ndalimin e tij në burg, pavarësisht nga fakti se ai mbahej në mënyrë strikte në ruajtje mbi bazën e një tjetër grupi procesesh kundër tij. Ndalimi ishte bazuar në dispozitat përkatëse të brendshme, siç interpretohet nga Gjykata e Lartë në vendimin e saj të datës 30 janar 2003. Si rezultat, ajo ka përmbushur gjithashtu dhe kërkesat e nenit 5.

516. Ankuesi i kontestoi argumentet e qeverisë.

517. Për sa i përket referencës së bazës ligjore për ndalimin e tij, ankuesi theksoi se, sipas parashtrimeve të qeverisë, ndalimi ishte bazuar në dispozitat e përgjithshme të Konventës Europiane mbi Transferimin e Proceseve në Çështjet Penale, megjithëse Konventa nuk ishte ratifikuar nga Shqipëria në kohën në fjalë, ndërsa, sipas vendimeve të gjykatës, ndalimi i tij ishte bazuar në dispozitat e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare. Si rezultat, asnjë nga dispozitat e lart-përmendura nuk mund të konsiderohet se plotëson kërkesën e “ligjshmërisë” që kërkohej nga neni 5 § 1 i Konventës. Së fundi, ankuesi pretendon se ndalimi i tij ishte i paligjshëm, pasi ai nuk ishte bazuar në asnjë dispozitë ligjore në fuqi në kohën në fjalë dhe ishte pasojë e proceseve arbitrare.

518. Ai iu referua jurisprudencës së Gjykatës dhe në veçanti vendimit në çështjen Bozano (Bozano k. Francës, vendim i datës 18 dhjetor 1986, Seritë A nr. 111, f. 25-26, §§ 58-59).

2. Vlerësimi i gjykatës

(a) Parimet e përgjithshme

519. Neni 5 i Konventës garanton të drejtën themelore të lirisë dhe të sigurisë. Kjo e drejtë ka një rëndësi thelbësore në një “shoqëri demokratike” brenda kuptimit të Konventës (shih De Wilde, Ooms dhe Versyp k. Belgjikës, vendimi i datës 18 qershor 1971, Seritë A nr. 12, f. 36, § 65 dhe Winterwerp k. Holandës, vendimi i datës 24 tetor 1979, Seritë A nr. 33, f. 16, § 37).

520. Të gjithë njerëzit kanë të drejtë të gëzojnë mbrojtjen e kësaj të drejte, çfarëdo të thotë, të mos u mohohet, ose të vazhdohet t’u mohohet, liria e tyre (shih Weeks k. Mbretërisë së Madhe, vendim i datës 2 mars 1987, Seritë A nr. 114, f. 22, § 40), dhe në përputhje me kushtet e specifikuar në paragrafin 1 të nenit 5. Lista e përjashtimeve të parashikuara në nenin 5 § 1 është shteruese (shih Labita k. Italisë [GC], nr. 26772/95, § 170, ECHR 2000-IV, dhe Quinn k. Francës, vendim i datës 22 mars 1995, Seritë A nr. 311, f. 17, § 42) dhe vetëm një interpretim i ngushtë i këtyre përjashtimeve është në përputhje me qëllimin e kësaj dispozite, përkatësisht për t’u siguruar se askujt nuk i mohohet në mënyrë arbitrare liria e tij ose e saj (shih Engel dhe të tjerët k. Holandës, vendim i datës 8 qershor 1976, Seritë A nr. 22, f. 25, § 58, dhe Amuur k. Francës, vendim i datës 25 qershor 1996, Reportet 1996-III, f. 848, § 42).

521. Gjykata përsëriti se “kur bëhet fjalë për mohim të lirisë, është në veçanti e rëndësishme të plotësohet parimi i përgjithshëm i sigurisë ligjore. Pra, si rezultat, është shumë e rëndësishme që të përcaktohen qartë kushtet e mohimit të lirisë në të drejtën e brendshme dhe që ligji vetë të jetë i parashikueshëm në zbatimin e tij, në mënyrë që ai të plotësojë standardin e “ligjshmërisë” së parashikuar nga Konventa, një standard që kërkon që i gjithë legjislacioni të jetë mjaftueshëm i saktë që t’i lejojë personit, - nëse nevojitet, me këshillim përkatës - të parashikojë, deri në një nivel që është i arsyeshëm për rrethanat, pasojat që mund të japë një veprim i caktuar” (shih Baranoëski k. Polonisë, nr. 28358/95, § 52, ECHR 2000-III).

522. Gjykata thekson më tej se autoritetet duhet të plotësojnë gjithashtu dhe kërkesat e parashikuara nga legjislacioni i brendshëm në proceset që lidhen me ndalimin (shih Van der Leer k. Holandës, vendimi i datës 21 shkurt 1990, Seritë A nr. 170-A, §§ 23-24; Wassink k. Holandës, vendimi i 27 shtatorit 1990, Seritë A nr. 185-A, § 27; Erkalo k. Holandës, vendimi i datës 2 shtator 1998, 1998-VI, § 57).

523. Së pari u takon autoriteteve kombëtare, pa dyshim gjykatave, të interpretojnë dhe të zbatojnë legjislacionin e brendshëm. Gjithsesi, përderisa nën nenin 5 § 1 mospërputhshmëria me të drejtën e brendshme përbën një shkelje të Kushtetutës, del si rezultat, që gjykata të mund, dhe të ushtrojë një kompetencë të caktuar për rishikimin e një përputhshmërie të tillë (shih Benham k. Mbretërisë së Madhe, vendimi i datës 10 qershor 1996, Raportet 1996-III, § 41).

b) Zbatimi i parimeve të përgjithshme në çështjen në fjalë

524. Gjykata vë re se ankuesi u ndalua më 15 maj 2002 në pritje të rezultatit të proceseve të njohjes dhe të zbatimit në Shqipëri të një vendimi të dhënë nga Gjykata e Apelit të Milanos (Milan Assize Court of Appeal).

525. Gjykata duhet të sigurohet nëse kishte një bazë ligjore për ndalimin e ankuesit në setin e dytë të proceseve.

526. Gjykata vë re se në kohën e ndalimit të ankuesit më 15 maj 2002, proceset për njohjen dhe zbatimin e një dënimi të dhënë nga një gjykatë e huaj drejtoheshin nga nenet 512 dhe 514 të Kodit të Procedurës Penale ("KPP"). Sipas këtyre dispozitave, proceset duheshin çuar para gjykatave të rrethit pas një kërkesë nga Ministria e Drejtësisë "pasi të ishte njoftuar për zbatimin e një vendimi të huaj në lidhje me një qytetar shqiptar". Për më tepër, vlefshmëria dhe zbatimi i një vendimi të huaj ishin të kushtëzuar, *inter alia*, në pëlqimin e dhënë nga personi në fjalë (neni 514 (e) – shih paragrafin 72 më lart).

527. Gjykata e rrethit dhe gjykata e Apelit, në vendimet e tyre të 20 qershorit 2002 dhe 24 korrikut 2004, gjetën që natyra e domosdoshme e pëlqimit të lartpërmendur nuk i linte asnjë të drejtë gjykatave të zbatonin nenin 512 dhe 514 pa pëlqimin e ankuesit. Këto gjykata ishin të mendimit se çdo rast i mosdhënies së pëlqimit nga ankuesi e bënte vendimin italian të pazbatueshëm në Shqipëri, dhe, si rezultat, nuk kishte bazë ligjore për ndalimin e tij (shih paragrafët 402 dhe 403 më lart).

528. Ndërsa proceset para Gjykatës së Apelit të Tiranës ishin pezull, ligji nr. 8813 i datës 13 qershor 2002 (i cili hyri në fuqi më 11 qershor 2002) i bëri disa ndryshime KPP-së, inter alia, duke shfuqizuar pëlqimin e lartpërmendur të përfshirë në nenin 514 (e). Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm apeloj në Gjykatën e Lartë, duke kërkuar zbatimin e ligjit të ndryshuar rishtazi në çështjen në fjalë. Gjykata e Lartë i jep juridiksion Kolegjeve të Bashkuara, duke e njohur atë si organizëm kompetent për të siguruar unifikimin e jurisprudencës.

529. Në vendimin e saj të 30 janarit 2003, Gjykata e Lartë, Kolegjet e Bashkuara, vendosën të mos merrnin parasysh dispozitat e nenit 514 (e) pa referencë zyrtare në zbatueshmërinë e ligjit të ri. E njëjta qasje u mor dhe nga Gjykata Kushtetuese, në proceset e rigjykitimit, që ishte organi kompetent gjyqësor për të vlerësuar përputhshmërinë e dispozitave të brendshme me Kushtetutën, e cila, në vendimin e saj të datës 12 korrik 2004, pranoi arsyetimin e Gjykatës së Lartë (shih paragrafët 419 dhe 420 më lart).

530. Gjykata e Lartë dhe Gjykata Kushtetuese e kufizuan veten në konsiderimin e dispozitës së KPP-së "së vjetër" në nenin 514, si të papërshtatshme dhe u shprehën se mund të parashikohej një bazë ligjore nga normat gjerësisht të njohura të së drejtës ndërkombëtare në përputhje me parimin e vullnetit të mirë dhe të reciprocitetit. Ato iu referuan të dy traktateve, përkatësisht Konventës Europiane për Njohjen Ndërkombëtare të Vendimeve Penale dhe Konventës për Transferimin e Personave të Dënuar dhe Protokollit Shtesë të tij.

531. Gjithsesi, Konventa Europiane për Njohjen Ndërkombëtare të Vendimeve Penale nuk kishte hyrë në fuqi në asnjërin nga vendet në kohën në fjalë (shih paragrafin 90 më lart). As Gjykata e Lartë dhe as Gjykata Kushtetuese nuk sugjeruan se ndonjëra nga konventat ishte në fuqi në Shqipëri.

Në fakt, kërkitimi i Gjykatës së Lartë për një bazë ligjore më të përshtatshme për ndalimin e ankuesit, e çoi atë në importimin në dispozitat e së drejtës së brendshme të dispozitave të instrumenteve të së drejtës ndërkombëtare të cilat nuk kishin hyrë ende në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

532. Duke pasur parasysh vendimin e mësipërm, ndalimi i ankuesit nuk u bazua në dispozitat e KPP-së, të ndryshuar nga dispozita e re që shfuqizonte kërkesën për pëlqimin. Në të

vërtetë, gjykatat kombëtare në vetvete ishin të pasigurta në lidhje me çështjen se kë version të KPP-së të zbatonin në rastin e ankuesit. Në çdo rast, nëse gjykatat kombëtare do të kishin vendosur për përdorimin e dispozitës së re, kjo do të kishte çuar në vlefshmërinë prapavepruese të ndalimit të ankuesit.

533. Për gjykatën, baza ligjore e gjetur më në fund nga Gjykata e Lartë zor se mund të thuhet se plotëson komponentët cilësorë të kërkesës së “ligjshmërisë” në lidhje me ndalimin e ankuesit dhe konvertimit të dënimit të dhënë nga gjykatat italiane.

534. Si rezultat, nuk mund të thuhet se ankuesi ishte në gjendje të parashikonte, deri në një shkallë që ishte e arsyeshme për rrethanat, se ndalimi i tij që prej 15 majit 2002 dhe konvertimi në Shqipëri i dënimit të dhënë nga gjykatat italiane, ishte në përputhje me një procedurë të parashikuar nga e drejta e brendshme.

535. Si rezultat, ka pasur shkelje të nenit 5 § 1 të Konventës.

III. SHKELJE E PRETENDUAR E NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS

536. Ankuesi pretendon paligjshmërinë e proceseve që lidhen me njohjen dhe zbatimin në Shqipëri të dënimit me burgim të dhënë nga gjykatat italiane. Ai u bazuar në nenin 6 § 1 të Konventës, i cili parashikon si më poshtë:

“Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet ... brenda një kohe të arsyeshme nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e krijuar me ligj...”

537. Gjykata vlerëson se kjo ankesë nuk është shprehimisht e pabazuar brenda kuptimit të nenit 35 § 3 të Konventës. Si rezultat, ajo duhet të deklarohet e pranueshme. Gjithsesi, duke pasur parasysh gjetjet e mësipërme, sipas nenit 5 § 1, Gjykata mendon se ajo nuk duhet të shqyrtojë veçmas nëse faktet çojnë në shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës.

IV. SHKELJE E PRETENDUAR E NENIT 7 § 1 TË KONVENTËS

538. Ankuesi u ankua më tej se gjykatat e brendshme, duke mos zbatuar një dispozitë më të lehtësuar, të prezantuar menjëherë për veprën në fjalë dhe duke parashikuar një kohë më pak të rëndë burgimi, kanë shkelur dispozitat e nenit 7 të Konventës, e cila në pjesët përkatëse parashikon si më poshtë:

“1. Askush nuk mund të dënohet për një veprim ose një mosveprim, që në momentin kur është kryer nuk përbënte vepër penale, sipas të drejtës së brendshme ose ndërkombëtare. Po ashtu, nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ishte i zbatueshëm në momentin kur është kryer vepra penale.”

539. Qeveria e kundërshtoi këtë argument, duke thënë se kjo dispozitë nuk ishte e aplikueshme në rrethanat e çështjes.

540. Sipas jurisprudencës së gjykatës, neni 7 i Konventës përqafon në përgjithësi parimin se vetëm ligji mund të përkufizojë një krim dhe të parashikojë një dënim (nullum crimen, nulla poena sine lege) dhe ndalon në veçanti zbatimin prapaveprues të ligjit penal, kur kjo gjë është në dëm të të akuzuarit (shih Kokkinakis k. Greqisë, vendimi i datës 25 maj 1993, Seritë A nr. 260-A, f. 22, § 52).

541. Duke iu kthyer çështjes në fjalë, Gjykata vë re se gjykatat shqiptare zbatuan dënimin me burgim të përjetshëm për ankuesin, siç parashikohet nga ligji në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, pavarësisht nga fakti se, dënimi i zbatueshëm për të njëjtën vepër penale në kohën e dënimit nga gjykatat shqiptare ishte shumë më i favorshëm për të.

542. Gjykata thekson se rregulli i shterimit të mjeteve të brendshme të cilave iu referua neni 35 i Konventës i detyron ata që kërkojnë ta çojnë çështjen kundër shtetit para gjykatës të përdorin së pari mjetet e parashikuara nga sistemi i brendshëm ligjor (shih Handyside k. Mbretërisë së Madhe, 7 dhjetor 1976, § 48, Seritë A nr. 24). Ankesat duhet të ishin bërë në organin përkatës të brendshëm, të paktën në thelb dhe në përputhje me kërkesat zyrtare dhe afatet kohore të parashikuara në të drejtën e brendshme, dhe, më tej, duhet të ishte përdorur çdo mjet procedural që mund të parandalojë shkeljen e Konventës (shih Cardot k. Francës, 19 mars 1991, § 34, Seritë A nr. 200).

543. Në rastin në fjalë, Gjykata vë re se ankuesi nuk ngriti ndonjë ankesë rreth dënimit të zbatueshëm penal në apelet e tij në Gjykatën e Apelit, Gjykatën e Lartë ose Gjykatën Kushtetuese. Është për këtë arsye që asnjëra nga gjykatat më të larta nuk e shqyrtoi një ankesë të tillë.

544. Gjykata përfundon se ankuesi ka dështuar në shterimin e mjeteve të brendshme juridike, siç parashikohen në sistemin e brendshëm ligjor. Ajo, si rezultat, e rrëzon këtë ankesë, në përputhje me nenin 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës.

V. SHKELJE E PRETENDUAR E NENIT 34 TË KONVENTËS

545. Sipas ankuesit, transferimi i vonuar për në spital, pavarësisht nga masa e përkohshme që iu vu qeverisë sipas nenit 39 të Rregullores së Gjykatës, ka cenuar të drejtat e tij, të parashikuara në nenin 34 të Konventës.

546. Neni 34 i Konventës parashikon si më poshtë:

“Gjykata mund të marrë kërkesat nga çdo person, organizatë joqeveritare ose grup individësh që pretendojnë të jenë viktimat të një shkeljeje nga një prej Palëve të Larta Kontraktuese të të drejtave të parashtruara në Konventë ose protokolleve të saj. Palët e Larta Kontraktuese zotohen të mos pengojnë në ndonjë mënyrë ushtrimin efektiv të kësaj të drejte.”

547. Neni 39 i rregullores së Gjykatës thotë:

“1. Dhoma, ose, kur është e nevojshme, Kryetari i saj, me kërkesë të një pale ose të çdo personi tjetër të lidhur, ose me mocionin e saj, i njofton palët për masa paraprake që ajo i mendon se duhet të merren në interesa të palëve ose të kryerjes së duhur të proceseve para saj.

2. Për këto masa njoftohet Komiteti i Ministrave.

3. Dhoma mund të kërkojë informacion nga palët për çdo çështje që lidhet me zbatimin e çdo mase të përkohshme që ka dhënë ajo.”

A. Parashtrimet e palëve

1. Qeveria

548. Qeveria parashtroi se masa e përkohshme e Gjykatës e datës 10 janar 2008 u është nisur menjëherë autoriteteve përgjegjëse shtetërore më 10 janar 2008 (Ministritë së Drejtësisë, Ministritë së Shëndetësisë, zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm dhe Drejtorisë së Burgjeve), të cilat shfaqën angazhimin e tyre për të përmbushur vendimin e Gjykatës. Nga data 22 deri më 24 janar 2008, drejtuesit e lartë të autoriteteve përgjegjëse shtetërore bënë disa takime me qëllimin e marrjes së masave të nevojshme për të siguruar transferimin e ankuesit në spital.

549. Qeveria deklaroi se transferimi i ankuesit nga një burg i sigurisë së lartë, si ai i Peqinit, në një spital, ishte një sipërmarrje delikate, e cila bënte të nevojshme marrjen e masave të posaçme të sigurisë për mbrojtjen e jetës së ankuesit dhe të rendit publik në spital.

550. Qeveria theksoi refuzimin e ankuesit për t’u transferuar në spital më 25 janar 2008 me arsyetimin që ai kërkonte trajtim mjekësor me interferon beta, në vend të kryerjes së një ekzaminimi mjekësor. Sipas qeverisë, ankuesi refuzonte të hante atë ditë dhe kërkojë transferimin sërish në burgun e Peqinit. Më tej, qeveria parashtroi se vendimi për të administruar interferon beta duhej të merrej nga një grup mjekësh të specializuar. Nuk ishte mbledhur një grup i tillë mjekësh për të diskutuar çështjen e ankuesit.

551. Gjatë transferimit të tij në spital, qeveria vuri re se ankuesi ishte në gjendje të mirë fizike. Ai komunikonte lirshëm dhe lëvizte pa vështirësi.

2. Ankuesi

552. Ankuesi pretendonte se qeveria kishte dështuar plotësisht në marrjen e masave për zbatimin e masës së përkohshme të dhënë nga Gjykata. Sipas tij, nuk janë dhënë urdhra për ta transferuar atë në një spital.

553. Sipas pikëpamjes së ankuesit, qeveria ka dështuar në depozitimin e dokumenteve mbështetëse që justifikon argumentet e saj në lidhje me rrezikun e mundshëm të jetës së tij apo prishjes së rendit publik në spital si rezultat i transferimit. Ai kundërshtoi gjithashtu dhe mënyrën në të cilën ishin kryer ekzaminimet mjekësore dhe për procedurat e ndjekura. Ankuesi pretendon se nuk i janë bërë disa teste dhe se disa dokumente i ishin hequr nga dosja mjekësore.

B. Vlerësimi i Gjykatës

1. Parimet e Përgjithshme

554. Neni 34 i Konventës u kërkon shteteve anëtare të mos pengojnë në asnjë mënyrë ushtrimin efektiv të së drejtës së ankuesit për të pasur akses në Gjykatë (shih Mamatkulov dhe Askarov k. Turqisë [GC], nr. 46827/99 dhe 46951/99, § 100, ECHR 2005-I).

555. Detyrimi në nenin 34 për të mos ndërhyrë në ushtrimin efektiv të së drejtës së individit për të bërë dhe për të ndjekur një ankesë para Gjykatës i jep individit një të drejtë me natyrë procedurale– që mund të pohohet në proceset e Konventës – të ndryshme nga të drejtat substantive të parashikuara në seksionin I të Konventës dhe të Protokolleve të saj (shih, për shembull, Shamayev e të Tjerë k. Gjeorgjisë dhe Rusisë, nr. 36378/02, § 470, ECHR 2005-III).

556. Në çështjen Mamatkulov dhe Askarov (e cituar më lart, §§ 104, 125 dhe 128), Gjykata vendosi se mospërputhshmëria me një masë të përkohshme e parashkruar në nenin 39 të rregullores së Gjykatës mund të çojë në shkelje të nenit 34 të Konventës.

557. Në Paladi k. Moldavisë ([GC], nr. 39806/05, 10 mars 2009) Gjykata deklaroi:

“87. Gjykata rithekson detyrimin e parashikuar në nenin 34 in fine që u kërkon Shteteve Kontraktuese të tërhiqen jo vetën nga ushtrimin e presionit ndaj ankuesit, por dhe nga çdo veprim ose mosveprim i cili, duke shkatërruar objektin e aplikimit, do ta bënte pa vlerë ose do të shmange Gjykatën nga shqyrtimi i çështjes në procedurë normale (në të njëjtin vend., § 102). Është e qartë nga qëllimi i këtij neni, që është siguri i efektivitetit të së drejtës së individit për të kërkuar (shih paragrafin 86 më lart), se qëllimet ose arsyet që lidhen me veprimet ose mosveprimet në fjalë kanë pak lidhje kur vlerësohet nëse është respektuar neni 34 i Konventës (shih paragrafin 78 më lart). Ajo çfarë është e rëndësishme është nëse situata e krijuar si rezultat i veprimit ose mosveprimit të autoriteteve është në përputhje me nenin 34.

88. E njëjta gjë është e vërtetë në lidhje me përputhshmërinë me masat e përkohshme të parashikuara në nenin 39, pasi masa të tilla jepen nga Gjykata për qëllime të të siguruarit të efektivitetit të së drejtës së kërkesës së individit (shih paragrafin 86 më lart). Pra, neni 34 shkelet nëse autoritetet e një shteti Kontraktues nuk marrin masa të cilat mund të ishin marrë në mënyrë të arsyeshme në mënyrë që të përmbushen masat e dhëna nga Gjykata.

89. Më tej, Gjykata thekson se kur ka arsye të forta për rrezikun e një dëmi të pandreqshëm për gëzimin e njëres nga të drejtat themelore nga ankuesi, sipas Konventës, subjekti i masës së përkohshme është të ruhen dhe të mbrohen të drejtat dhe interesat e palëve në mosmarrëveshje para Gjykatës, në pritje të vendimit përfundimtar. Del nga natyra e masave të përkohshme se vendimi nëse ato duhet të jepen në një çështje të caktuar shpesh bëhet brenda një kohe të shkurtër, me qëllimin e shmangies së ndodhjes së dëmit të mundshëm të përnjëhershëm. Si rezultat, faktet e plota të çështjes shpesh mbeten të papërcaktuara derisa të vendosë Gjykata për themelin e çështjes të ankesës me të cilën lidhet masa. Pikërisht për qëllim të ruajtjes së aftësisë së Gjykatës për të dhënë një vendim të tillë pas një shqyrtimi efektiv të ankesës janë arsye pse jepen masa të tilla. Deri në atë kohë, mund të jetë e pashmangshme për Gjykatën të japë masa të përkohshme mbi bazën e fakteve, të cilat, pavarësisht nga bërja e një çështje *prima facie* në favor të rasteve të tilla, rrjedhimisht i shtohen ose sfidohen deri në pikën sa vënë në pyetje justifikimin e masave.

Për të njëjtat arsye, fakti që dëmi për të cilin masa e përkohshme është projektuar të parandalojë, rrjedhimisht del se nuk ka ndodhur pavarësisht nga paaftësia e shtetit për të vepruar në përputhje të plotë me masën e përkohshme është po aq jo e përshtatshme për të vlerësuar nëse ky shtet i ka plotësuar detyrimet e tij sipas nenit 34.

90. Si rrjedhim, nuk është e hapur për një Shtet Kontraktues të zëvendësojë vendimin e tij me vendimin e Gjykatës në verifikimin nëse ka ekzistues ose jo një rrezik i menjëhershëm dhe një dëm i pandreqshëm për një ankues në kohën kur jepet masa e përkohshme. Po ashtu, nuk u takon as autoriteteve të brendshme të vendosin për kufijtë kohorë për plotësimin e një mase të përkohshme ose për pikën deri në të cilën duhet të përmbushet masa. I takon Gjykatës të verifikojë përputhshmërinë me masën e përkohshme, ndërsa një shtet që mendon se ka materiale të afta për të bindur Gjykatën për të anuluar masën e ndërmjetme, e informojnë Gjykatën për këtë gjë (shih, *mutatis mutandis*, Olachea Cahuas k. Spanjës, nr. 24668/03, § 70, ECHR 2006-X; Tanrikulu k. Turqisë [GC], nr. 23763/94, § 131, ECHR 1999-IV; dhe Orhan k. Turqisë, nr. 25656/94, § 409, 18

qershor 2002).

91. Pika e nisjes për të verifikuar nëse një shtet i akuzuar ka përmbushur masën është vetë formulimi i vetë masës (shih, *mutatis mutandis*, analizën e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për formulimin e masave të saj të brendshme dhe përputhshmërinë aktuale me të në LaGrand, cituar në paragrafin 62 më lart). Si rezultat, Gjykata shqyrton nëse shteti i akuzuar ka respektuar formulimin dhe frymën e masës së përkohshme që i është dhënë.

92. Në shqyrtimin e ankesës sipas nenit 34 në lidhje me dështimin e pretenduar të një Shteti Kontraktues për të respektuar masën e përkohshme, Gjykata, si rezultat, nuk do ta shqyrtojë nëse vendimi i saj për të zbatuar masa të përkohshme ishte i saktë. I takon qeverisë së akuzuar t'i dëshmojë Gjykatës së është respektuar masa e përkohshme, ose, në raste përjashtimore, se kishte një pengesë objektive që e pengoi qeverinë të merrte të gjitha hapat e arsyeshme të heqë pengesat dhe të mbajë të informuar Gjykatën rreth situatës.”

2. Zbatimi i primeve të sipër-përmendura në çështjen në fjalë

a) A kishte mospërputhshmëri në plotësimin e masës së përkohshme

558. Gjykata vë re se qeveria e akuzuar u informua zyrtarisht për masën e përkohshme të parashikuar nga neni 39 i rregullores së Gjykatës më 10 janar të 2008-ës me anë të një bisede telefonike ndërmjet sekretarit dhe agjentit të qeverisë. Mesazhi u dërgua me anë të postës elektronike në mëngjesin e datës 11 janar 2008, pas disa përpjekjeve të pasuksesshme për ta dërguar atë me faks në mbrëmjen e datës 10 janar 2008 dhe në mëngjesin e datës 11 janar 2008.

559. Përmbajtja e masës së përkohshme përfshinte udhëzime për autoritetet e brendshme për ta transferuar ankuesin në spital për ekzaminime mjekësore dhe trajtimin e duhur. Pavarësisht nga njoftimi për masën e përkohshme jo më vonë se mëngjesin e datës 11 janar 2008, autoritetet vendore e transferuan ankuesin në spital për ekzaminime mjekësore vetëm me datën 28 janar 2008.

560. Del se masa e përkohshme nuk u respektua për një periudhë kohore prej shtatëmbëdhjetë ditësh.

b) Justifikimi për mosplotësimin e masës së përkohshme

561. Gjykata tani do të përcaktojë nëse ka pasur pengesa objektive që e penguan qeverinë të përmbushte masën e përkohshme dhe nëse qeveria mori të gjitha masat e arsyeshme për të hequr pengesat dhe për të mbajtur Gjykatën të informuar rreth situatës (shih Paladi, cituar më lart, § 92.) Gjykata do të marrë parasysh sjelljen e ankuesit dhe kushtet e tij mjekësore në lidhje me veprimet e qeverisë për të përmbushur masën e përkohshme.

562. Qeveria parashtroi se transferimi i ankuesit në spital kërkonte marrjen e masave të sigurisë dhe koordinim ndërmjet institucioneve të ndryshme të brendshme.

563. Gjykata rithekson se masat e përkohshme duhet të respektohen si në rastet e çështjeve emergjente (shih Paladi, të cituar më lart, § 98). Në këtë aspekt, ajo vë re se nuk ka asgjë në dosjen e çështjes që dëshmon se autoritetet vendase ndërmorën ndonjë veprim nga data 11 janar deri në datën 24 janar 2008. Pavarësisht nga argumenti i qeverisë në lidhje me masat e sigurisë që duhet të merren në rast të një transferte të tillë, Gjykata dyshon se ishte e pamundur për autoritetet e brendshme të organizonin takime urgjente menjëherë pas njoftimit të masës së përkohshme për qeverinë e akuzuar. Që kur autoritet kryesore ishin informuar nga agjenti i qeverisë rreth masës së përkohshme të Gjykatës në mëngjesin e datës 11 janar 2008 (shih paragrafin 439 më lart), Gjykata nuk sheh asnjë justifikim për vonesën për të kryer takimet e nevojshme. Ajo vë re me shqetësim se takimet e para janë mbajtur vetëm nga data 22 deri më 24 janar 2008. Për më tepër, qeveria dështoi në mbajtjen e Gjykatës të informuar rreth përputhshmërisë me masën e përkohshme gjatë gjithë kësaj periudhe.

564. Si rezultat, dhe pavarësisht nga urgjenca dhe serioziteti i masës së përkohshme të datës 10 janar 2008, autoritetet e brendshme treguan mungesë angazhimi për të ndihmuar Gjykatën në parandalimin e ndodhjes së dëmeve të pariparueshme. Sjellje të kësaj natyre janë të papërputhshme me detyrat që parashikohen për Shtetet Kontraktuese sipas nenit 34 në lidhje me kapacitetin e tyre për të respektuar masat e përkohshme me shpejtësinë e kërkuar (shih Paladi, cituar më lart, § 97).

565. Në lidhje me sjelljen e ankuesit, Gjykata vlerëson se ai ishte përgjegjës për një vonesë prej maksimumit prej tri ditësh (shih paragrafin 443 më lart). Gjykata e sheh me keqardhje sjelljen e

ankuesit në kohën kur masa e përkohshme ishte marrë në mënyrë që të verifikohet niveli i vërtetë i gjendjes së tij. Gjithsesi, ajo nuk e gjen të bazuar asnjë vonesë tjetër për shkak të fajit të tij.

566. Në vëzhgimet e saj, qeveria parashtroi se gjendja e mirë fizike e ankuesit tregoi se nuk kishte asnjë rrezik aq të madh sa ishte menduar më parë.

567. Gjykata thekson se nuk ka shpjegim të pranueshëm për paaftësinë e autoriteteve të brendshme për të marrë veprime të menjëhershme për të respektuar masën e përkohshme. Ajo kujton se dëmi që masa e përkohshme është projektuar të parandalojë del rrjedhimisht se nuk ka ndodhur, pavarësisht nga paaftësia e shtetit për të vepruar në përputhje të plotë me masën e përkohshme, është i pavlerë në vlerësimin nëse Shteti i akuzuar i ka plotësuar detyrimet e tij sipas nenit 34 (shih Paladi, cituar më lart, § 89).

568. Gjykata përfundon se vonesa e autoriteteve të brendshme në përmbushjen e masës së ndërmjetme në fjalë, në mungesë të çdo justifikimi objektiv, përben shkelje të nenit 34 të Konventës.

VI. SHKELJE TË TJERA TË PRETENDUARA TË KONVENTËS

569. Së fundmi, ankuesi pretendon se në deklarin e apelimit të tij për proceset e rigjykimit si të papranueshme *de plano* më 30 janar 2004, pa dhënë arsye, Gjykata e Lartë ka shkelur nenin 2 të protokollit nr. 7 të Konventës, i cili parashikon:

“1. Çdo person i shpallur fajtor për një vepër penale nga një gjykatë ka të drejtë të paraqesë për shqyrtim përpara një gjykate më të lartë deklarin e fajësisë ose dënimit. Ushtrimi i kësaj të drejte, duke përfshirë shkaqet për të cilat ajo mund të ushtrohet, përcaktohet me ligj.

2. Nga kjo e drejtë mund të ketë përjashtime për vepra të lehta penale, siç përcaktohen me ligj, ose kur i interesuari ka qenë gjykuar në shkallë të parë nga gjykata më e lartë, ose shpallur fajtor dhe dënuar në vijim të një apeli kundër pafajësisë së tij.”

570. Gjykata, në fund, është e mendimit se ankuesi, në thelb po ankohet për paaftësinë e gjykatave të brendshme për të dhënë arsye për vendimin e tyre, një ankesë e shqyrtuar më drejt në nenin § 1 të Konventës sesa në nenin 2 të protokollit nr. 7.

571. Gjykata rithekson se e drejta që i garantohet një ankuesi sipas nenit 6 të Konventës përfshin të drejtën për të pasur arsye për vendimet e dhëna nga një gjykatë e brendshme në çështjen e tij. Gjithsesi, detyrimi korrespondues për një gjykatë të brendshme për të dhënë arsye për vendimet e tij nuk mund të kuptohet se kërkon një përgjigje të detajuar për çdo argument të dhënë nga një ankues. Shkalla në të cilën zbatohet detyra për të dhënë arsye mund të ndryshojë sipas natyrës së vendimit në fjalë (shih, për shembull, Helle k. Finlandës, vendimi i datës 19 dhjetor 1997, Raportet 1997-VIII, f. 2929, § 56).

572. Gjykata vë re se në këtë aspekt ankuesi apeloj në Gjykatën e Lartë mbi bazën se vendimet e gjykatave më të ulëta ishin të paplota në bazë ligjore. Gjykata është e mendimit se arsyet e kufizuara të dhëna nga Gjykata e Lartë në formulën e vendimit të saj *de plano*, gjithsesi, dëshmojnë në mënyrë të pashprehur se ankuesi nuk kishte përdorur njërin nga pikat e ligjit që bie brenda objektit të lënies së procesit të apelimit. Gjykata vëren se, kur Gjykata e Lartë refuzon të pranojë një çështje me arsyetimin se arsyet ligjore për një çështje të tillë nuk ekzistojnë, një arsyetim shumë i kufizuar mund të plotësojë kërkesat e nenit 6 të Konventës (shih, *mutatis mutandis*, Nerva k. Mbretërisë së Madhe (dhjet.), nr. 42295/98, 11 qershor 2000).

573. Për arsyet e sipërpërmendura, Gjykata është e mendimit se ankesa është shprehimisht e keqbazuar brenda kuptimit të nenit 35 § 3, dhe si rezultat është e papranueshme në përputhje me nenin 35 § 4.

VII. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

574. neni 41 i Konventës parashikon:

“Kur Gjykata konstaton se ka pasur një shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj, dhe nëse e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese lejon të bëhet vetëm një ndreqje e pjesshme, Gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar.”

A. Dëmi

575. Ankuesi pretendoi 50 000 euro (EUR) për dëme jomateriale.

576. Qeveria e kundërshtoi pretendimin e ankuesit, por nuk parashtroi asnjë argument të lidhur me shumën e pretenduar prej tij.

577. Gjykata thekson se, në kuadrin e zbatimit të vendimeve në përputhje me nenin 46 të Konventës, një vendim në të cilin identifikohet shkelje, i ngarkon shtetin të akuzuar një detyrim ligjor nën dispozitën e përfundimit të shkeljes dhe të ndreqjes së pasojave në mënyrë të tillë që të ndreqet sa më shumë të jetë e mundur situata që ekzistonte para shkeljes. Nëse, nga ana tjetër, e drejta kombëtare nuk lejon – ose lejon pjesërisht – riparim për pasojat e shkeljes, neni 41 i jep kompetenca Gjykatës t'i japë palës së dëmtuar atë shumë që konsiderohet prej saj si e kënaqshme. Rezulton, *inter alia*, se një vendim në të cilin Gjykata identifikon një shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj dhe vendos për shtetin e akuzuar një detyrim ligjor jo vetëm për të paguar palët e lidhura me shumat e kërkuara si mënyra për të realizuar kënaqësinë e drejtë, por dhe të për zgjedhur, në varësi të mbikëqyrjes së Komitetit të Ministrave, masat e përgjithshme, dhe/ose, nëse nevojiten, masat specifike që duhen zbatuar në rendin e brendshëm ligjor për t'i dhënë fund shkeljes së identifikuar nga gjykata dhe për të bërë tërë ndreqjen e nevojshme të pasojave në mënyrë të tillë që të ndreqë aq sa është e mundur situatën e ta kthejë atë në nivelin e situatës që ekzistonte para shkeljes (shih *Ilaşcu* dhe të *Tjerë k. Moldavisë dhe Rusisë* [GC], nr. 48787/99, § 487, ECHR 2004-VII; *Assanidze k. Gjeorgjisë* [GC], nr. 71503/01, § 198, ECHR 2004-II; *Maestri k. Italisë* [GC], nr. 39748/98, § 47, ECHR 2004-I; *Mentes dhe të Tjerët k. Turqisë* (Neni 50), vendimi i datës 24 Korrik 1998, Raportet 1998-IV, f. 1695, § 24; dhe *Scozzari dhe Giunta k. Italisë* [GC], nr. 39221/98 dhe 41963/98, § 249, ECHR 2000-VIII).

578. Gjykata thekson se ka gjetur shkelje të disa dispozitave të Konventës nga shteti i akuzuar. Ankuesit i është dhënë trajtim i papërshtatshëm mjekësor, në kundërshtim me nenin 5, në lidhje me grupin e dytë të proceseve që lidheshin me njohjen dhe zbatimin në Shqipëri të vendimit të Gjykatës Italiane. Gjykata ka vendosur gjithashtu se është shkelur neni 34 i Konventës.

579. Në lidhje me shkeljen e nenit 5 të Konventës, Gjykata vë re se ankuesi kërkon dëme jomateriale vetëm në lidhje me periudhën nga 15 maji 2002 deri më 29 dhjetor 2003, datë nga e cila burgosja e tij drejtohej nga vendimi i gjykatës së rrethit në lidhje me proceset penale.

580. Gjykata vë re se ankuesi kërkon dëmshpërblim vetëm për dëme jomateriale. Në këtë mënyrë, ajo nuk i jep ankuesit dëmshpërblim për dëme materiale. Në lidhje me dëmin jomaterial të pretenduar, Gjykata është e mendimit se është e arsyeshme të mendohet se ankuesi ka pësuar stres, ankth dhe frustrim, të shkaktuar nga përkeqësimi i gjendjes së tij shëndetësore, që u përkeqësua më tej me burgimin e tij të paligjshëm për më shumë se një vit dhe shtatë muaj. Duke vendosur mbi një bazë të barabartë, Gjykata i jep ankuesit EUR 8 000 në lidhje me dëmtimin jomaterial.

B. Kostot dhe shpenzimet

581. Ankuesi pretendoi edhe 7,550 euro për kostot dhe shpenzimet për marrjen e një vlerësimi mjekësor të specializuar dhe për shpenzimet e Gjykatës. Ai parashtroi një ndarje të detajuar sipas zërave për të mbështetur pretendimet e tij.

582. Qeveria e kontestoi pretendimin e ankuesit pa parashtuar asnjë argument.

583. Sipas jurisprudencës së Gjykatës, ankuesi ka të drejtë të rimbursohet për kostot dhe shpenzimet e tij vetëm për aq kohë që këto shpenzime dëshmohen se janë kryer aktualisht dhe domosdoshmërisht dhe janë të arsyeshme në masë. Në rastin në fjalë, në lidhje me informacionin në dispozicion dhe të kriterëve të sipërpërmenduar, Gjykata e mendon të arsyeshme të vendosë t'i japë ankuesit 7 000 euro për të mbuluar kostot sipas zërave.

C. Niveli i interesit

584. Gjykata është e mendimit se është e drejtë që niveli i interesit për mospagimin të bazohet në kufirin marxhinal të nivelit të huasë të Bankës Qendrore Evropiane, mbi të cilën duhet të shtohen tre për qind.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA NË MËNYRË UNANIME:

1. Deklaron ankesat në lidhje me nenin 3 të Konventës, nenin 5 § 1 të Konventës dhe nenin 6 § 1 të Konventës të pranueshme dhe pjesën tjetër të aplikimit të papranueshme;

2. Vendos se ka pasur shkelje të nenit 3 të Konventës në lidhje me trajtim të papërshtatshëm mjekësor për ankuesin gjatë burgimit të tij;

3. Vendos se ka pasur shkelje të nenit 5 § 1 të Konventës në lidhje me ndalimin e ankuesit nga data 15 maj 2002 deri më 29 dhjetor 2003;

4. Vendos se nuk është e nevojshme të shqyrtohet veçmas nëse ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje me proceset që kanë të bëjnë me njohjen dhe zbatimin në Shqipëri të një vendimi të marrë nga një vendim i Gjykatës së Apelit të Milanos;

5. Vendos se ka pasur shkelje të nenit 34 të Konventës;

6. Vendos

a) që shteti i akuzuar t'i paguajë ankuesit, brenda tre muajve nga data e daljes së vendimit përfundimtar, në përputhje me nenin 44 § 2 të Konventës, 8,000 euro (tetë mijë euro) për dëme jo materiale dhe 7,000 euro (shtatë mijë euro) për kosto dhe shpenzime, të konvertuara në monedhën e shtetit të akuzuar, në kursin e këmbimit në datën e pagesës, plus çdo taksë që mund të vihet;

b) që prej skadimit të periudhës prej tre muajsh të përmendur më lart deri në pagim, mbi shumat e mësipërme paguhen interesa të thjeshtë të barabartë me kursin marxhinal të huasë së Bankës Qendrore Europiane gjatë periudhës së mospagimit, plus tre për qind;

7. Rrëzon pjesën tjetër të pretendimit të ankuesit.

Bërë në anglisht dhe e njoftuar me shkrim më 7 korrik 2009, në përputhje me nenin 77 §§ 2 dhe 3 të rregullores së Gjykatës.

Lawrence Early
Sekretar

Nicolas Bratza
Kryetar

GJYKATA EUROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

1959. 50. 2009

SEKSIONI I KATËRT

VENDIM

NË LIDHJE ME PRANUESHMËRINË E

Ankimit nr.58915/08

Nga Ali Telhai

kundër Shqipërisë

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (seksioni i katërt), mbledhur në seancë më 17 nëntor 2009, e përbërë nga:

Nicolas Bratza, kryetar,

Giovanni Bonello,

David Thor Björgvinsson,

Ján Šikuta,

Päivi Hirvelä,

Ledi Bianku,

Nebojsa Vučinić, gjyqtarë,

dhe Lawrence Early, sekretar,

pasi analizoi ankimin e mësipërm paraqitur më 11 korrik 2007,

pasi diskutoi çështjen, vendos si vijon:

FAKTET

Ankuesi, z. Ali Telhai, është shtetas shqiptar, i cili ka lindur në vitin 1945 dhe jeton në Berat.

A. Backgroundi i çështjes

Më 15 prill 1993 ligji i kthimit dhe kompensimit të pronave (ligji i pronësisë, 1993) hyri në fuqi. Qëllimi i këtij legjislacioni ishte t'u kthehej pasuria e paluajtshme, e cila ishte shtetëzuar nga autoritetet ish-komuniste ish-pronarëve të saj ose kompensimi *in lieu* i tyre.

Ndryshimet kryesore të ligjit të pronësisë të vitit 1993 ndodhën si rezultat i dy ligjeve që kanë hyrë në fuqi, respektivisht, në vitet 2004 dhe 2006 (shih, për më shumë detaje, Gjonbocari dhe të tjerë k. Shqipërisë, nr.10508/02, 23 tetor 2007; Driza kundër Shqipërisë, nr.33771/02, 13 nëntor 2007 dhe Ramadhi dhe 5 të tjerë kundër Shqipërisë, nr. 38222/02, 13 nëntor 2007).

Ligji i pronësisë i vitit 2004, i cili shfuqizoi ligjin e pronësisë të vitit 1993, parashikonte që një ligj i ri do të miratohej në lidhje me kthimin dhe kompensimin e pronave të luajtshme që kishin qenë të shtetëzuara. Megjithatë, asnjë ligj i tillë nuk ka hyrë në fuqi deri më tani.

B. Rrethanat e çështjes

Faktet e çështjes, paraqitur nga ankuesi, mund të përmbliken si më poshtë:

Në vitin 1956 Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Përmetit (Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Rrethit Përmet) vendosi ta konfiskonte pasurinë e luajtshme të familjes së ankuesit, pasuri e cila përbëhej nga bagëti (*bagëti*) dhe materiale të tjera, të tilla si: ari, bakri, argjendi dhe kallaji.

Kur sundimi komunist mori fund, ankuesi u dërgoi letra të shumta institucioneve të shtetit duke kërkuar kompensim për pronat e konfiskuara të familjes së tij. Më 29 gusht 1996 Ministria e Financave ka njoftuar ankuesin mbi përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave për të përcaktuar procedurat për kompensimin e ish-të përndjekurve politikë në lidhje me pronën e luajtshme të shpronësuar. Nëpërmjet një shkrese tjetër të datës 9 qershor 1998, Ministria e Financave i ka bërë të ditur ankuesit se informacioni që ai kishte paraqitur ishte i paplotë dhe se ata nuk ishin në gjendje për të shqyrtuar pretendimet e tij ose për të përcaktuar një mjet pagese.

Në një datë të pacaktuar ankuesi duket të ketë bërë një kërkesë jozyrtare pranë Gjykatës së Rrethit të Përmetit. Nëpërmjet një shkrese të datës 18 janar 2006 kryetari i Gjykatës së Rrethit Përmet ka informuar ankuesin se pritej të miratohej një ligj i ri për kthimin dhe kompensimin e pronave të luajtshme. Kryetari këshilloi ankuesin se nëse ai dëshironte të ngrinte një padi civile, ai duhej ta bënte këtë në përputhje me kriteret e përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile.

C. E drejta e brendshme përkatëse

Ligji i pronësisë i vitit 2004 (ligji nr.9235 i datës 25 korrik 2004)

Paragrafi 5 i ligjit të pronësisë të vitit 2004, i cili është ende në fuqi, parashikon:

“Kthimi dhe kompensimi i pasurisë së luajtshme do të rregullohet nga një ligj i veçantë (me ligj të veçantë)”.

Dispozita të tjera përkatëse të ligjit të pronësisë janë përshkruar në vendimet e Gjonbocari dhe të tjerë, Driza dhe Ramadhi dhe të tjerë, të gjitha të cituara më lart.

ANKESA

Ankuesi ankohet në bazë të nenit 1 të protokollit 1 të Konventës se i është privuar e drejta e kompensimit për shkak të dështimit të shtetit për të miratuar ligjet e brendshme përkatëse.

LIGJI

Ankuesi pohonte që dështimi i shtetit për t'i siguruar atij kompensimin mbi shtetëzimin e pasurisë së tij të luajtshme, i cenonte atij të drejtën për gëzimin paqësor të pasurisë së tij, garantuar nga neni 1 i protokollit nr.1, ku thuhet se:

“Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga pasuria e tij përveç rasteve në interes publik dhe subjekt i kushteve të parashikuara në ligj dhe në parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Sidoqoftë, dispozitat e mëparshme nuk duhet, në asnjë mënyrë, të pengojnë të drejtën e një shteti për të zbatuar ligje të tilla që i konsideron të nevojshme për të kontrolluar përdorimin e pronës në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagesën e taksave apo kontrinuteve të tjera ose gjoha.”.

Gjykata përsërit se një ankues mund të pretendojë shkelje të nenit 1 të protokollit nr.1 vetëm në rast kur vendimet e kundërshtuara kanë të bëjnë me "pasurinë" e tij apo saj në kuptim të kësaj dispozite. Koncepti i "pasurisë" ka një kuptim autonom, i cili është i pavarur nga klasifikimi formal në të drejtën e brendshme (Ish-Mbreti i Greqisë dhe të tjerë k. Greqisë [GC], nr. 25701/94, § 60, ECHR 2000-XII). "Pasuri" mund të jenë "pasuritë ekzistuese" ose asetet, duke përfshirë pretendimet në lidhje me të cilat ankuesi mund të argumentojë se ai ka të paktën një "pritshtëri legjitime" (e cila duhet të jetë më shumë konkrete sesa një shpresë e thjeshtë) se ato do të realizohen, që do të thotë se ai ose ajo do të fitojë gëzimin efektiv të së drejtës së pronësisë (shih Gratzinger dhe Gratzingerova k. Republika Çeke (dhjetor) [GC], nr. 39794/98, ECHR 2002-VII, § 69, dhe Kopecký k. Sllovakia [GC], nr.44912/98, § 35, ECHR 2004-IX). Një pretendim mund të konsiderohet si një aset vetëm kur ai në mënyrë të mjaftueshme vendoset të jetë i zbatueshëm (shih Kopecký, cituar më sipër, § 49; dhe Stran Greek refineries dhe Stratis Andreadis k. Greqisë, vendim i datës 9 dhjetorit 1994, seria A nr. 301 -B, f. 84, § 59). Krahimisht, shpresa e njohjes së ekzistencës së një të drejte të vjetër të pronësisë, e cila për një kohë të gjatë ka qenë e pamundur të ushtrohej efektivisht, nuk mund të konsiderohet si një "pasuri" në kuptim të nenit 1 të protokollit nr.1 dhe as një pretendim i kushtëzuar, i cili bie si rezultat i mospërmbyshjes së kushtit (shih Prince Hans-Adam II of Liechtenstein v. Germany [GC], nr.42527/98, § 83, ECHR 2001 VIII). Sipas mendimit të Gjykatës, një pretendim është i kushtëzuar, kur ai varet nga një ngjarje e ardhme e pasigurt. Asnjë "pritshtëri legjitime" nuk mund të hyjë në veprim në mungesë të një pretendimi, i cili në mënyrë të mjaftueshme të përbëjë një aset.

Për më tepër, neni 1 i protokollit nr.1 nuk mund të interpretohet si caktim i ndonjë detyrimi të përgjithshëm mbi shtetet kontraktuese për të kthyer pronat, të cilat u ishin transferuar atyre para se ato të ratifikonin Konventën. Neni 1 i protokollit nr.1, gjithashtu, nuk imponon kufizime në lirinë e shteteve kontraktuese për të përcaktuar qëllimin e kthimit të pronave dhe për të zgjedhur kushtet nën të cilat ata bien dakord për të rivendosur të drejtat pronësore të ish-pronarëve. Nga ana tjetër, sapo shteti kontraktues, pas ratifikimit të Konventës duke përfshirë protokollin nr.1, miraton legjislacionin që parashikon rikthimin e plotë ose të pjesshëm të pasurisë së konfiskuar nga një regjim i mëparshëm, një legjislacion i tillë mund të konsiderohet si krijues i një të drejte pronësore të re mbrojtur nga neni 1 i protokollit nr.1 për personat që plotësojnë kërkesat për të drejtën (shih, ndërmjet shumë autoritetesh të tjera, Beshiri dhe të tjerë k. Shqipërisë, nr.7352/03, § § 80-82, 22 gusht 2006).

Në çështjen aktuale padia e ankuesit nuk kishte të bënte me "pasuri ekzistuese" dhe ankuesi nuk kishte statusin e një pronari, por ishte thjesht një pretendues, ashtu si dhe ankuesit në çështjen e Gratzinger dhe Grantzingerova, cituar më lart.

Si rrjedhim, mbetet për të përcaktuar nëse ankuesi mund të konsiderohet që ka “pritshtëri legjitime”, sipas së cilës pretendimi aktual, i zbatueshëm, duke marrë vlerën e një aset, i mund të përcaktohet në favor të tij.

Gjykata vëren se pretendimi, siç deklaroi ankuesi, është bazuar në paragrafin 5 të ligjit 2004 të pronësisë. Deri më tani qeveria nuk ka miratuar ndonjë ligj mbi kthimin dhe kompensimin e pronës shtetërore të luajtshme. As nuk duket që gjykatat e brendshme kanë plotësuar ndonjë pretendim për kthimin dhe kompensimin e pronave të luajtshme të shtetëzuara nga regjimi i mëparshëm komunist.

Kërkesa e ankuesit kushtëzohet nga legjislacioni i ardhshëm që mund të miratohet nga qeveria në një datë të pacaktuar. Besimi se një ligj për kthimin dhe kompensimin e pasurive të luajtshme do të jetë në fuqi nuk mund të konsiderohet si një shpresë legjitime për qëllim të nenit 1 të protokollit nr.1. Gjykata mendon se ka një dallim ndërmjet një shprese të thjeshtë të kthimit dhe kompensimit, sado e kuptueshme ajo shpresë mund të jetë, dhe një pritshtërie legjitime, e cila duhet të jetë më shumë konkrete sesa thjesht një shpresë dhe të bazohet në një dispozitë ligjore apo akt ligjor të tillë, si p.sh. një vendim gjyqësor (shih Pressos Compania Naviera SA dhe të tjerë k. Belgjikës, 20 nëntor 1995, § 31, seria A nr. 332).

Rezulton se ankuesi nuk ka as të drejtën, e as pretendimin për të arritur në një pritshtëri legjitime në kuptimin e vendimit gjyqësor të Gjykatës për të siguruar kthimin e pronës në fjalë, dhe rrjedhimisht nuk ka “pasuri” në kuptim të nenit 1 të protokollit nr.1.

Si përfundim, kjo pjesë e ankesës është *ratione materiae* e papajtueshme dhe duhet të refuzohet në përputhje me nenin 35 § § 3 dhe 4 të Konventës.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, UNANIMISHT:

- Deklaron ankimin të papranueshëm.

Lawrence Early
Sekretar

Nikolas Bratza
Kryetar

GJYKATA EUROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT
1959. 50. 2009
SEKSIONI I KATËRT

VENDIM
Ankimet nr.41670/04 dhe 2469/05
Nga Ali dhe Shkëlqim Sufja
kundër Shqipërisë

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (seksioni i katërt), mbledhur në seancë më 10 nëntor 2009, e përbërë nga:

Nicolas Bratza, kryetar,
Giovanni Bonello
David Thor Björgvinsson
Ján Šikuta
Päivi Hirvelä
Ledi Bianku
Nebojsa Vučinić, gjyqtarë,
dhe Lawrence Early, sekretar,
duke vlerësuar ankesat e mësipërme të paraqitura më 16 nëntor 2004,
duke vlerësuar vëzhgimet e paraqitura nga qeveria e paditur,
duke diskutuar çështjen, vendos si vijon:

FAKTET

Ankuesit, z.Ali Sufja dhe z.Shkëlqim Sufja, janë shtetas shqiptarë, që kanë lindur respektivisht në vitin 1970 dhe 1969. z.Ali Sufja (ankuesi i parë) mendohet se jeton në Lezhë, Shqipëri dhe z.Shkëlqim Sufja (aplikanti dytë) mendohet se aktualisht vuan dënimin në një burg në Shqipëri. Ata janë përfaqësuar pranë Gjykatës nga znj. F. Mavilla, një avokate, e cila ushtron profesionin në Bolonjë.

A. Rrethanat e çështjes

Faktet e çështjes, paraqitur nga ankuesit, mund të përmbliidhen si më poshtë:

Më 25 shkurt 2003 ankuesit u arrestuan në Shqipëri në bazë të një urdhërndalimi, lëshuar nga një gjyqtar hetues i Bolonjës më 21 janar 2003, sipas të cilit ata ishin akuzuar për trafikim ndërkombëtar të drogës. Ndalimi i tyre u konfirmua me vendim të formës së prerë të Gjykatës së Lartë të datës 28 maj 2003.

Në një datë të pacaktuar autoritetet shqiptare refuzuan ekstradimin e aplikantëve për në Itali në përputhje me nenin 491 (f) të Kodit të Procedurës Penale (KPP), i cili ndalon ekstradimin e shtetasve shqiptarë. Ata më tej i akuzuan ankuesit për krijimin dhe drejtimin e një organizate kriminale.

1. Paraburgimi i ankuesit të parë nga data 28 korrik 2003 deri më 4 mars 2004

Më 17 qershor 2003, pas një ankimi nga ankuesi i parë, Gjykata e Rrethit Bolonjë urdhëroi lirimin e tij nga burgu në pritje të gjykimit (urdhër lirimi).

Më 28 korrik dhe 3 tetor 2003 ambasada italiane në Shqipëri (ambasada) informoi Ministrinë Shqiptare të Drejtësisë (Ministrinë), nëpërmjet një note verbale mbi urdhrin e lirimit.

Më 17 nëntor 2003 ankuesi i parë paraqiti një kërkesë pranë Gjykatës së Rrethit Lezhë, (gjykata e rrethit), duke kërkuar të lirohet në dritën e rrethanave të reja. Së bashku me kërkesën e tij, ai ka paraqitur një kopje të urdhërlirimit dhe dokumente të tjera mbështetëse.

Nga data 17 nëntor 2003 deri më 20 shkurt 2004 autoritetet shqiptare kanë bërë përpjekje për të konfirmuar vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura nga aplikuesi i parë. Ndërkohë, më 16 shkurt 2004 Gjykata e Rrethit të Bolonjës hoqi akuzat kundër ankuesit të parë, bazuar në argumentin se ai nuk kishte kryer shkeljen e dyshuar (*per non aver Comesso il fatto*).

Më 4 mars 2004 gjykata e rrethit ka lëshuar urdhrin për gjykimin në pritje të ankuesit. Ajo gjithashtu i është referuar urdhrin të lirimit dhe ka bërë lirimin e ankuesit të parë me kusht paraqitjen e tij në komisariatet e policisë.

Më 3 tetor 2005 Gjykata e Krimeve të Rënda të Rrethit Tiranë ka liruar ankuesin nga akuzat kundër tij.

2. Paraburgimi i ankuesit të dytë nga data 30 gusht 2004 deri më 3 tetor 2005

Më 18 gusht 2004 gjyqtari hetues ka urdhëruar lirimin e ankuesit të dytë në pritje të gjykimit, në bazë të nenit 303 të KPP-së italiane, i cili përcakton periudhat maksimale të lejuara të paraburgimit në pritje të gjykimit.

Më 30 gusht 2004 ambasada ka informuar Ministrinë me një notë verbale për urdhrin e lirimit.

Më 4 tetor 2004, ankuesi i dytë kërkoi të lirohet në dritën e rrethanave të reja. Mendohet se së bashku me kërkesën e tij, ai ka paraqitur një kopje të urdhërlirimit.

Mendohet se nga data 13 tetor 2004 deri më 3 tetor 2005 autoritetet shqiptare janë përpjekur të konfirmojnë vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura nga ankuesi i dytë.

Më 3 tetor 2005 Gjykata e Krimeve të Rënda të Rrethit Tiranë (Gjykata e Krimeve të Rënda të Rrethit Tiranë) shpalli ankuesin e dytë fajtor për krijimin dhe drejtimin e organizatave kriminale të përfshira në trafikun ndërkombëtar të drogës dhe e dënoi atë me dymbëdhjetë vjet burgim. Gjykata nuk arriti të bëjë referim ndaj vendimit të datës 18 gusht 2004 të gjyqtarit të Bolonjës.

Ankuesi i dytë nuk arriti të informojë sekretaren, nëse ai kishte apeluar kundër vendimit të Gjykatës së Krimeve të Rrethit Tiranë të datës 3 tetor 2005, si dhe kundër paligjshmërisë së arrestimit të tij nga data 30 gusht 2004 deri më 3 tetor 2005.

ANKESAT

Ankuesit kryesisht u ankuan sipas nenit 5 § 1 të Konventës se ishin arrestuar në mënyrë të paligjshme ndërmjet datave 28 korrik 2003 dhe 4 mars 2004 në lidhje me ankuesin e parë dhe ndërmjet datave 30 gusht 2004 dhe 3 tetor 2005 në lidhje me ankuesin e dytë. Ato gjithashtu kanë argumentuar se ka pasur shkelje të nenit 5 § 3 dhe 4 të Konventës.

LIGJI

Nëpërmjet shkresave të datës 18 shtator 2008 dhe 8 korrik 2009, dërguar me postë, përfaqësuesi i ankuesve ishte njoftuar se periudha e lejuar për dorëzimin e vëzhgimeve të ankuesve kishte skaduar më 17 korrik 2008 dhe se nuk ishte kërkuar zgjatje e kohës. Përfaqësuesit të ankuesve i ishte tërhequr vëmendja në nenin 37 § 1 (a) të Konventës, i cili parashikon që Gjykata mund të heqë çështjen nga lista e saj e çështjeve kur rrethanat të çojnë në përfundimin se ankuesi nuk synon të ndjekë ankimin. Përfaqësuesi i ankuesve ka marrë shkresën e fundit më 16 korrik 2009. Megjithatë, nuk ka marrë përgjigje.

Gjykata konsideron se, në këto rrethana, ankuesit mund të konsiderohen se nuk dëshirojnë më të ndjekin ankimet e tyre, në kuptim të nenit 37 § 1 (a) të Konventës. Për më tepër, në përputhje me nenin 37 § 1 *in fine*, Gjykata nuk vlerëson rrethana të veçanta në lidhje me respektimin e të drejtave të njeriut siç është përcaktuar në Konventë dhe protokollet e saj, të cilat kërkojnë shqyrtimin e vazhdueshëm të çështjeve. Sa më lart, është me vend të hiqen çështjet nga lista.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, UNANIMISHT:

-Vendos heqjen e ankesave nga lista e çështjeve.

Lawrence Early
Sekretar

Nicolas Bratza
Kryetar

GJYKATA EUROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT
1959. 50. 2009
SEKSIONI I KATËRT

ÇËSHTJA BUSHATI DHE TË TJERËT K. SHQIPËRISË
(Ankimi nr.6397/04)

VENDIMI
(meritat)
STRASBURG
8 dhjetor 2009

Ky vendim merr formë të prerë në rrethanat e përcaktuara në nenin 44 § 2 të Konventës. Mund të jetë subjekt i rishikimit redaktues.

Në rastin e Bushatit dhe të tjerët k. Shqipërisë,
Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (seksioni i katërt), mbledhur në seancë, e përbërë nga:

Nicolas Bratza, kryetar,
Lech Garlicki
Giovanni Bonello
Liljana Mijovic
Päivi Hirvelä
Nebojsa Vučinić, gjyqtarë,
Markelian Koca, gjyqtar *ad hoc*,
dhe Lawrence Early, sekretar i seksionit,
pasi diskutoi me dyer të mbyllura me 17 nëntor 2009,
jep vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua në atë datë.

PROCEDURA

1. Çështja e ka zanafillën në ankimin (nr.6397/04) kundër Republikës së Shqipërisë, paraqitur në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa) nga znj. Ixhlale Bushati, z. Skënder Bushati dhe z. Genc Bushati, shtetas shqiptarë (ankuesit), më 8 janar 2004.

2. Ankuesit, i parë dhe i dytë, u përfaqësuan pranë Gjykatës nga z. Genc Bushati (aplikanti i tretë), i cili, në kohën e paraqitjes së kërkesës, u përfaqësua nga z.L. Bianku dhe D. Gjata dhe, i cili aktualisht përfaqësohet nga z. P. Kalo, avokatë me veprimtari në Tiranë. Qeveria shqiptare (qeveria) u përfaqësua nga përfaqësuesit e saj të atëhershëm, z. S. Puto dhe znj. S. Meneri.

3. Ankuesit u ankuan sipas nenit 6 § 1 të Konventës për shkelje të parimit të sigurisë ligjore, kohëzgjatje të procedurave ligjore dhe moszbatim të vendimit të gjykatës. Ata gjithashtu argumentuan se autoritetet kishin cenuar të drejtën për gëzimin paqësor të pronës së tyre, siç garantohet nga neni 1 i protokollit nr.1 të Konventës.

4. Kërkesa iu caktua seksionit të katërt (rregulla 52 § 1 e rregullores së Gjykatës). Brenda këtij seksioni, juria që do të shqyrtonte çështjen (neni 27 § 1 i Konventës) u strukturua, në përputhje me rregullën 26 § 1 të rregullores së Gjykatës. z. Ledi Bianku, gjyqtar i zgjedhur në lidhje me Shqipërinë, u tërhoq nga pjesëmarrja në këtë çështje (rregulli 28). Për rrjedhojë, në vendin e tij, qeveria emëroi z. Markelian Koca të veprojë si një gjyqtar *ad hoc*, (neni 27 § 2 i Konventës dhe rregulli 29&1).

5. Më 16 shtator 2005 kryetari i seksionit të katërt të Gjykatës vendosi t'i bëjë të njohur ankimimin qeverisë. Sipas dispozitave të nenit 29 § 3 të Konventës, u vendos për të shqyrtuar meritat e ankimimit në të njëjtën kohë, ashtu si edhe pranueshmërinë e tij.

6. Më tej, ankuesit dhe qeveria paraqitën vërejtjet e tyre me shkrim (rregulla 59 § 1).

FAKTET

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

7. Ankuesit kanë lindur përkatësisht në vitet 1918, 1939 dhe 1944, dhe jetojnë në Shkodër.

8. Pas përfundimit të një kontrate blerjeje më 10 korrik 1940, një i afërm i ankuesve u bë pronar i një trualli me sipërfaqe 5.000 m² dhe ndodhet në bregdetin e Durrësit. E drejta e kushëririt të ankuesve mbi pronën u përfshi më pas në regjistrin e tokës Durrës.

9. Në vitin 1946 shteti shtetëzoi pa kompensim të gjithë tokën të vendosur në bregdetin shqiptar, duke përfshirë truallin e të afërmit të ankuesve.

A. Kthimi i pronës

10. Më 3 shkurt 1994 komisioni i kthimit dhe kompensimit të pronave Durrës (komisioni i kthimit dhe kompensimit të pronave – këtej e tutje “komisioni”) rivendosi të drejtat pronësore të ankuesve mbi pronën e të afërmit të tyre në përputhje me ligjin e vitit 1993 mbi pronën (kthimin dhe kompensimin) (shih ligjin e brendshëm përkatës, paragrafi 53 më poshtë). Më 22 shkurt 1994 e drejta e ankuesve mbi pronën u përfshi në regjistrin e tokës Durrës.

11. Ndërmjet viteve 1994 dhe 1995, përpjekjet e ankuesve për të rimarrë pronën dëshmuar të pasuksesshme, sepse godinat janë ndërtuar në mënyrë të paligjshme në tokën e tyre nga zotëruesit e paligjshëm.

B. Procedurat e gjykatave të brendshme

1. Procedurat e zakonshme

12. Në një datë të pacaktuar në vitin 1995, duke mos arritur të rifitojnë pronësinë mbi pronën e tyre, ankuesit filluan procedurat pranë Gjykatës së Rrethit Durrës (gjykata e rrethit), duke kërkuar një urdhër për tre zotëruesit (M., R. dhe D.), për të pushuar zotërimin e pronës së tyre dhe për të prishur ndërtimet pa leje.

13. Më 11 prill 1995 gjykata e rrethit konfirmoi të drejtat pronësore të ankuesve mbi truallin caktuar atyre nga komisioni dhe urdhëroi që zotëruesit të largohen nga prona e ankuesve. Ky vendim mori formë të prerë më 23 maj 1995.

2. Rishikimi mbikëqyrës

14. Më 1 gusht 1995 njëri nga zotëruesit, M., i paraqiti një kërkesë kryetarit të atëhershëm të Gjykatës së Kasacionit për rishikim mbikëqyrës të vendimit të gjykatës së rrethit të datës 11 prill 1995, për shkak se ai nuk kishte dijeni për procedurat. Më 23 shtator 1995 kryetari i Gjykatës së Kasacionit miratoi kërkesën e tij duke e paraqitur pranë seksionit civil.

15. Më 2 shkurt të vitit 1996 Gjykata e Kasacionit shfuqizoi vendimin e gjykatës së rrethit të datës 11 prill 1995, bazuar në faktin që asnjë nga tre zotëruesit nuk ishte informuar në kohën e duhur mbi procesin gjyqësor pranë gjykatës së rrethit, dhe ia kaloi çështjen së njëjtës gjykatë për shqyrtim të ri.

16. Ankuesit as nuk u informuan mbi procesin gjyqësor, dhe as nuk u ftuan për të marrë pjesë në seancat dëgjimore pranë Gjykatës së Kasacionit.

17. Më 21 qershor të vitit 1996 gjykata e rrethit vendosi që të pushojë çështjen, meqenëse asnjëra nga palët nuk kishte marrë pjesë në seancë dhe asnjëra nuk kishte dhënë arsyet legjitime mbi dështimin e tyre për të marrë pjesë.

3. Rihapja e procesit gjyqësor

18. Ka të ngjarë që procedurat u rihapën në një datë të pacaktuar. Këto procedura gjithashtu u drejtuan kundër zotëruesit tjetër të paligjshëm, B. Më 20 janar 1997 gjykata e rrethit konfirmoi të drejtën e ankuesve mbi truallin e të afërmit të tyre dhe urdhëroi katër zotëruesit (M., R., D. dhe B.) të pushojnë zotërimin.

19. Në shkurt 1997 ankuesit i kanë shitur një truall me sipërfaqe 500 m² një pale tjetër. Ky transaksion u përfshi në regjistrin e tokës.

20. Në një datë të pacaktuar zotëruesit e pasurisë së ankuesve apeluan kundër vendimit të gjykatës së rrethit të datës 20 janar 1997, duke kundërshtuar ligjshmërinë e së drejtës së ankuesve mbi truallin e caktuar. Më 1 prill 1998 Gjykata e Apelit Durrës (gjykata e apelit) e hodhi poshtë ankesën e tyre dhe mbështeti vendimin e gjykatës së rrethit.

21. Më 10 nëntor 1998 Gjykata e Kasacionit shfuqizoi vendimin e gjykatës së apelit, duke argumentuar që kjo e fundit nuk kishte shqyrtuar të drejtën mbi pronën të të afërmit të ankuesve. Ajo ia kaloi çështjen gjykatës së apelit për shqyrtim të ri.

22. Më 24 nëntor 1999 gjykata e apelit vlerësoi se më 30 gusht 1994 komisioni i kishte caktuar R.-së (i cili më pas ia kishte dhuruar pasurinë e tij G.-së) një truall që mbivendosej me një sipërfaqe prej 720 m² dhënë ankuesve nga i njëjti komision më 3 shkurt 1994. Për më tepër, gjykata e shpalli të pavlefshëm vendimin e komisionit të datës 3 shkurt 1994 në lidhje me truallin me sipërfaqe 720 m², duke vendosur që kontrata e blerjes e datës 10 korrik 1990 e të afërmit të ankuesve ishte e pavlefshme. Për rrjedhojë, ajo e anuloi të drejtën e ankuesve mbi gjithë truallin me sipërfaqe 5.000 m².

23. Më 2 prill 2001, pas ankesave të bëra nga ankuesit dhe nga tre prej katër zotëruesve (M., B. dhe D.), Gjykata e Lartë, e cila kishte zëvendësuar Gjykatën e Kasacionit pas hyrjes së Kushtetutës shqiptare në fuqi më 28 nëntor 1998, anuloi pjesërisht vendimin e gjykatës së apelit. Gjykata hodhi poshtë ankesat e zotëruesve bazuar në faktin që, meqenëse ato zotëruan tokën pa të drejtë, nuk mund të kundërshtonin të drejtën e ankuesve mbi pronën. Prandaj Gjykata e Lartë nxori urdhër që ato të pushonin zotërimin e tokës prej tyre. Për më tepër, gjykata mbështeti të drejtën e G.-së mbi truallin me sipërfaqe prej 720 m² e cila mbivendosej me truallin që u është caktuar ankuesve dhe konfirmoi të drejtën e ankuesve mbi pronën për pjesën e mbetur prej 4,280 m².

24. Më 11 mars të vitit 2003, ankuesit paraqitën një ankesë pranë Gjykatës Kushtetuese në bazë të nenit 131 (f) të Kushtetutës, duke argumentuar se vendimi i Gjykatës së Lartë i datës 2 prill 2001, që rezultoi vetëm në njohje të pjesshme të pasurisë së tyre, ishte jokushtetues. Ata u ankuan se ndërsa Gjykata e Lartë ka vlerësuar dëshmitë në mënyrë të gabuar, paanshmëria e saj linte vend për dyshime.

25. Gjykata Kushtetuese konstatoi se ankesa kushtetuese e ankuesve kishte të bënte me vlerësimin e provave, të cilat ishin brenda juridiksionit të gjykatave më të ulëta dhe ishte jashtë juridiksionit të saj. Prandaj ajo e deklaroi ankimin të papranueshëm nëpërmjet një vendimi të datës 10 korrik 2003, i cili u ka shërbyer ankuesve më 14 korrik 2003.

4. Procedurat e zbatimit në lidhje me vendimin e Gjykatës së Lartë të datës 2 prill 2001

26. Më 28 qershor 2001, gjykata e rrethit urdhëroi përmbaruesit për të zbatuar vendimin e Gjykatës së Lartë të datës 2 prill 2001.

27. Më 31 korrik 2001, përmbaruesi i dërgoi tri letra të veçanta M.-së D.-së dhe B.-së për të vepruar në përputhje me vendimin brenda 10 ditëve nga njoftimi i tij. Përmbaruesi u tërhoqi vëmendjen zotëruesve për zbatimin e detyrueshëm të vendimit, nëse ata nuk vepronin vullnetarisht në përputhje me vendimin.

28. Më 25 shtator 2001, ankuesi i tretë ka kërkuar pezullimin e urdhrit të vendimit deri më 15 tetor për arsye që ai nuk i bëri të ditur. Nga të dhënat dëshmohet se ankuesi do të paraqitej në zyrën e përmbaruesit për të kërkuar vazhdimin e procedurave të zbatimit.

29. Më 26 tetor 2001, ankuesi dhe zotëruesit M. dhe D. u paraqitën pranë përmbaruesit. Sipas të dhënave thuhet se palët ranë dakord për të shtyrë ekzekutimin e vendimit deri në 15 nëntor 2001.

30. Më 16 janar 2002 ankuesi i tretë i ka kërkuar përmbaruesit që të heqë të drejtën e ankuesve për zbatimin e vendimit kundër B.-së, pasi të dyja palët do ta zgjidhnin çështjen me mirëkuptim. Duket se në një datë të pacaktuar në vitin 2002 ankuesit i kanë shitur B.-së një truall me sipërfaqe 164 m².

Në të njëjtën ditë ankuesi i tretë ka kërkuar zbatimin e vendimit kundër M.-së dhe D.-së për të prishur ndërtimet e tyre. Përmbaruesi ka rënë dakord për të kërkuar ndihmën e policisë për këtë qëllim.

31. Më 22 janar 2002 M. dhe D. janë informuar se përmbaruesi do të procedojë me ekzekutimin e detyrueshëm të vendimit më 4 shkurt, në prani të oficerëve të policisë.

32. Më 4 shkurt 2002 përmbaruesi vendosi të shtyjë ekzekutimin deri në një datë të pacaktuar për shkak të mungesës së ankuesve. Kjo rezultoi dhe nga të dhënat se përmbaruesi nuk shkoi në vend për të ndërmarrë ndonjë masë me qëllim që të shkatërrohen ndërtimet e M.-së dhe D.-së.

33. Më 9 shtator 2002 ankuesi i tretë i kërkoi përmbaruesit të procedojë me ekzekutimin e vendimit, duke pasur parasysh dështimin e M.-së dhe D.-së për t'iu përmbajtur marrëveshjes mbi shumën e kompensimit në lidhje me trojet që ato kishin zënë.

34. Më 10 shtator 2002 përmbaruesi dërgoi dy letra të veçanta M.-së dhe D.-së duke u kërkuar atyre që brenda 10 ditëve t'i përmbahen marrëveshjes që ato kishin bërë me ankuesit. Përmbaruesi u tërhoqi vëmendjen zotëruesve mbi zbatimin e detyrueshëm të vendimit, nëse ata nuk do t'i përmbahen vullnetarisht vendimit.

35. Më 16 shtator 2002 përmbaruesi kishte një takim me M. dhe D., të cilët e informuan atë se ata nuk ishin në gjendje të paguanin çmimin e kërkuar nga aplikantët. Zotëruesit dëshmuan se ata do të lironin truallin me kusht që ankuesit t'i kompensojnë ato për ndërtimin që ata kishin ngritur ose me kusht

që t'u ofronin atyre një banesë të ndërtuar në mënyrë të ligjshme në një tjetër vend. Përmbauesi vendosi të informojë ankuesin e tretë mbi kërkesat e zotëruesve.

36. Më 4 nëntor 2002 ankuesi i tretë ka kërkuar ose lirimin e truallit, ose pagesën e kompensimit nga zotëruesit me çmimin e treguar. Ankuesi i tretë ka rënë dakord që çmimi të paguhej me këste për një periudhë dyvjeçare. Ai do të arrinte një marrëveshje me zotëruesit lidhur me shumën e kësteve dhe mënyrën e pagesës. Nëse marrëveshja do të dështonte, ankuesi i tretë pohoi se ai do të kërkonte që truallin t'i lirohej.

37. Procesverbali i përmbaimit në një takim më 14 shkurt 2003 midis ankuesit të tretë dhe dy zotëruesve, thekson se:

"Pas një sërë diskutimesh palët nuk ranë dakord për çmimin e ofruar nga kreditori [ankuesi i tretë], i cili kërkon [shuma e kompensimit për m²] për një periudhë trevjeçare.

Debitorët ofruan të paguajnë një çmim [më të ulët] prej (...).

Duke pasur parasysh këtë mosmarrëveshje, u vendos që kreditori do të kërkonte zbatimin e detyrueshëm të vendimit, kur ai të ishte i gatshëm (kur të jetë gati) ".

38. Në të njëjtën ditë përmbaimit vendosi të pezullojë zbatimin e procedurave. Pjesët përkatëse të vendimit shprehin:

"Kreditori [ankuesi i tretë] është përpjekur pa sukses për të zgjidhur problemin mbi baza miqësore, përveçse me debitorin B.

Në këto rrethana, kreditori ka kërkuar pezullimin e zbatimit të procedurave deri në një paraqitje të mëvonshme pranë përmbaimit ku ai do të kërkonte ekzekutimin e detyrueshëm përse i përket lirimit të truallit të zënë nga M. dhe D. Kjo është pasqyruar edhe në procesverbalin e datës 14 shkurt 2003."

5. Procedurat në lidhje me heqjen e sipërfaqes prej 255 m² nga regjistri i tokës

39. Regjistri i tokës Durrës (regjistri i tokës) përfshiu në regjistrin e tokës, ndër të tjera, të drejtën e G.-së mbi truallin me sipërfaqe 975 m², pavarësisht nga fakti se vendimi i Gjykatës së Lartë i datës 2 prill 2001 i kishte njohur të drejtën e saj të pronësisë mbi një truall me sipërfaqe 720 m² (shih paragrafin 23 më sipër).

40. Në një datë të pacaktuar ankuesit kanë filluar procedurat pranë gjykatës së rrethit duke kërkuar heqjen e sipërfaqes prej 255 m² nga e drejta e G.-së mbi pronën që ka hyrë në regjistrin e tokës Durrës.

41. Më 24 dhjetor 2003 gjykata e rrethit ka vendosur që të pezullojë procesin gjyqësor në pritje të rezultatit të procesit gjyqësor për rifitimin e pasurisë (shih paragrafin 50 më poshtë).

42. Më 20 prill 2004, pas një ankimi nga ankuesit, gjykata e apelit anuloi vendimin e gjykatës së rrethit të datës 24 dhjetor 2003, duke u bazuar në faktin se nuk kishte lidhje ndërmjet dy proceseve gjyqësore, meqenëse në secilin prej tyre mund të merreshin vendime në mënyrë të pavarur, dhe ia kaloi çështjen së njëjtës gjykatë për vazhdimin e procesit gjyqësor.

43. Më 7 janar 2005 gjykata e rrethit vendosi që të pezullojë procesin gjyqësor deri kur palët të siguronin kopje të përditësuara të certifikatave hipotekore lëshuar nga regjistri i tokës.

44. Më 30 maj 2005, pas një apelimi nga ankuesit, gjykata e apelit anuloi vendimin e gjykatës së rrethit të datës 7 janar 2005 dhe ia kaloi çështjen së njëjtës gjykatë për vazhdimin e procesit gjyqësor.

45. Më 16 janar 2006, gjykata e rrethit, pasi ka marrë certifikatat hipotekore të përditësuara dhe planimetritë e pronës, vendosi se nuk kishte asnjë mbivendosje midis pronës së ankuesve dhe atë të G.-së. Ky vendim u miratua nga gjykata e apelit më 20 nëntor 2006.

6. Procedurat e urdhrave të gjykatës kundër punimeve të ndërtimit kryer nga G.

46. Në një datë të pacaktuar G. ka filluar punimet e ndërtimit, të cilat dyshohet se cenonin një truall që i përkiste ankuesve. Më 17 qershor 2003, pas procesit gjyqësor filluar nga ankuesit, gjykata e rrethit ka nxjerrë një vendim, sipas të cilit G. urdhërohet të pezullojë punimet e ndërtimit meqenëse ndërtesat cenonin pronën e ankuesve.

47. Më 20 qershor 2003 gjykata e rrethit urdhëroi përmbauesit për të zbatuar vendimin e gjykatës të datës 17 qershor 2003. Më 30 tetor 2003 përmbauesit kanë vendosur të mos e zbatojnë atë, sepse G. nuk kishte cenuar pronën e ankuesve.

48. Më 16 dhjetor 2003, pas një padie të inicuar nga ankuesit, në përputhje me nenin 610 të Kodit të Procedurës Civile, gjykata e rrethit anuloi vendimin e përmbaimit të datës 30 tetor 2003. Ajo zbuloi se përmbauesit kishin tejkaluar kompetencat e tyre pasi ata nuk ishin të autorizuar të anulojnë një vendim gjykatë. Vendimi u miratua nga gjykata e apelit më 20 prill 2004.

49. Në një datë të pacaktuar në vitin 2004, G. ka paraqitur një padi pranë gjykatës së rrethit, duke kërkuar që urdhri i ekzekutimit i datës 20 qershor 2003 të anulohet nën dritën e vendimit të gjykatës së rrethit të datës 20 maj 2004 (shih paragrafin 51 më poshtë). Më 18 mars 2005 gjykata e rrethit e hodhi poshtë kërkesën e saj në bazë të vendimit të gjykatës së apelit të datës 24 nëntor 2004, sipas të cilit meritat e çështjes do të dëgjoheshin nga një juri e ndryshme e gjykatës së rrethit (shih paragrafin 52 më poshtë).

7. Procedurat në lidhje me rifitim të pasurisë së zënë nga G.

50. Duke pasur parasysh punimet e ndërtimit të G.-së, të cilat me sa dukej kishin cenuar pronën e ankuesve, në një datë të pacaktuar në vitin 2003 ankuesit filluan procesin gjyqësor për rimarrjen e pasurisë së tyre. Ndërkohë G. ka paraqitur një kundërkërkesë civile, duke i kërkuar ankuesve të lirojnë truallin e saj, që supozohej se ishte zënë nga ndërtesat e tyre.

51. Më 20 maj 2004 gjykata e rrethit arriti në përfundimin, në bazë të një vlerësimi ekspert, lidhur me mbivendosjen e pronave, që ankuesit kishin zënë një truall me një sipërfaqe prej 172.12 m² nga prona e G.-së. Gjykata gjithashtu konkludoi se G. kishte zënë një truall me sipërfaqe prej 200.52 m² nga prona e ankuesve. Gjykata e rrethit urdhëroi G.-në të kompensonte ankuesit në vlerën prej 2.556 United States Dollars (USD) për një truall prej 28,4 m², e cila përbënte diferencën midis trojeve të zëna nga secila palë në procesin gjyqësor. Si rrjedhim, ajo e hodhi poshtë kërkesën civile të ankuesve dhe gjithashtu vendosi të heqë urdhrin e gjykatës që ishte lëshuar më 17 qershor 2003 (shih paragrafin 46 më lart).

52. Më 24 nëntor 2004, pas një apelimi nga ana e ankuesve, gjykata e apelit vendosi që gjykata e rrethit nuk kishte shqyrtuar të drejtat e rinovuara mbi pronën të palëve, veçanërisht nën dritën e disa ndryshimeve që u kishin ndodhur pronave të tyre gjatë viteve. Kështu, ajo anuloi vendimin e gjykatës së rrethit dhe ia kaloi çështjen së njëjtës gjykatë për një shqyrtim të ri nga një juri tjetër.

53. Më 10 qershor 2005 Gjykata e Lartë shpalli apelimin e G.-së të papranueshëm në përputhje me nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile (pa arsye të vlefshme për apelim). Për rrjedhojë ajo mbështeti vendimin e gjykatës së apelit.

54. Më 25 prill 2006, mbi bazën e një vlerësimi ekspert, gjykata e rrethit zbuloi se pronat mbivendoseshin në lidhje me një truall prej 255 m². Ajo arriti në përfundimin se ky truall i përkiste ankuesve. Gjykata e rrethit nuk zbuloi ndonjë zënie të pronës së G.-së nga ankuesit, por vendosi që G. kishte zënë një truall me një sipërfaqe prej 347 m² që i përkiste ankuesve. Ajo e hodhi poshtë kërkesën e G.-së për të paguar kompensim për zënie të atij trualli meqenëse nuk parashikohej në ligj. Gjykata urdhëroi G.-në që të lironte dhe t'u kthente ankuesve truallin prej 347 m². Vendimi u mbështet nga gjykata e apelit më 5 mars 2007.

55. Më 25 prill 2007 gjykata e rrethit urdhëroi përmbaruesit të zbatojnë vendimin e saj të datës 25 prill 2006. Nëpërmjet një shkrese të datës 7 qershor 2007 ankuesi i bëri të ditur gjykatës se urdhri i ekzekutimit të datës 25 prill 2007 nuk kishte të ngjarë të zbatohet duke pasur parasysh ekzistencën e dy blloqeve apartamentesh në truallin e zënë.

56. Në një datë të pacaktuar G. ka paraqitur një padi pranë gjykatës së rrethit, duke kërkuar pezullimin e urdhrin të ekzekutimit në lidhje me njërën prej ndërtesave të paligjshme, statusin e së cilës ajo po përpiqej që ta legalizonte. Asnjë informacion i mëtejshëm lidhur me zbatimin e procesit gjyqësor, nuk është paraqitur në gjykatë.

II. E DREJTA E BRENDASHME PËRKATËSE

A. Kushtetuta e Shqipërisë

57. Pjesët përkatëse të Kushtetutës së Shqipërisë janë përcaktuar në Beshiri dhe të tjerët k. Shqipërisë (nr.7352/03, § 20, 22 gusht 2006).

B. Kodi i Procedurës Civile

58. Neni 171 i Kodit të Procedurës Civile të vitit 1981 (KPC), i cili ishte në fuqi deri më 1 qershor 1996, parashikonte që vendimet mund të anuloheshin për shkelje të rënda procedurale, ndër të tjera, kur çështja gjykohej në mungesë të palëve të tjera pa i njoftuar ato për datat e seancave gjyqësore.

59. Neni 9 i ligjit nr.7574 i datës 24 qershor 1992, i cili ndryshoi Kodin e Procedurës Civile të vitit 1981 në fuqi në atë kohën, parashikonte që Gjykata e Kasacionit ishte e autorizuar për të shqyrtuar ligshmërinë e vendimeve të gjykatës, nëpërmjet një kërkesë për shqyrtim mbikëqyrës (kërkesë për mbrojtje ligjshmërie) paraqitur nga kryetari i Gjykatës së Kasacionit ose Prokurori i Përgjithshëm. Dispozita nuk përcaktonte afatin për aplikim për një shqyrtim të tillë.

60. Siç parashikohet nga KPC i vitit 1996, i cili shfuqizonte Kodin e Procedurës Civile të vitit 1981, shqyrtimi mbikëqyrës (rekurs në interes të ligjit) përbënte një mjet ligjor të jashtëzakonshëm që mundësonte Gjykatën e Lartë (emri i ri për Gjykatën e Kasacionit) për të rihapur procesin gjyqësor për vendimet që kishin marrë formën e prerë. Ndërmjet vitit 1996 dhe shfuqizimit të tij në vitin 2001, në bazë të ligjit nr.8812 të datës 17 maj 2001 procedura e rishikimit mbikëqyrës pësoi disa ndryshime legjislative.

61. Neni 451/a i KPC-së parashikon që një vendim gjykate i formës së prerë është i detyrueshëm për palët, trashëgimtarët e tyre, gjykatën që miratoi vendimin, si dhe gjykatat e tjera dhe institucionet.

62. Neni 510 i KPC-së përcakton se një vendim mund të zbatohet vetëm mbi bazën e një të drejte ekzekutive, i cili përfshin, ndër të tjera, një vendim gjykate të formës së prerë. Në bazë të nenit 511 të KPC-së, e drejta e ekzekutimit ekzekutohet me kërkesë të kreditorit. Për këtë qëllim është lëshuar një urdhër ekzekutimi. Në formulimin e nenit 515 të KPC-së, një urdhër ekzekutimi zbatohet nga përmbaruesit, ndër të tjera, me kërkesën e kreditorit. Përmbaruesi fton debitorin t'i përmbahet vullnetarisht urdhrat të ekzekutimit në përputhje me afatet e përcaktuara në nenin 517 të KPC-së. Nëse debitori nuk i përmbahet zbatimit vullnetarisht brenda afateve të parashkruara, përmbaruesi procedon me një zbatim të detyrueshëm në përputhje me nenin 519 të KPC-së.

63. Në bazë të nenit 610 të KPC-së, palët mund të ankohen në gjykatë për një veprim ose dështim për të vepruar nga ana e përmbaruesit brenda pesë ditësh të veprimit të lartpërmendur ose mosveprimit. Ekziston e drejta e ankimit kundër vendimit të gjykatës, në përputhje me nenin 611 të KPC-së. Ankimet nuk kanë efekt pezullues mbi ekzekutimin.

64. Përmbaruesi mund të vendosë të pezullojë ekzekutimin me kërkesën e kreditorit në përputhje me nenin 615 të KPC-së. Palët mund të kundërshtojnë vendimin e përmbaruesit për të pezulluar zbatimin në gjykatën e rrethit në përputhje me nenin 617 të KPC-së.

C. Ligji i pronësisë

65. Pjesët përkatëse të ligjit të pronësisë (kthimin dhe kompensimin) janë përcaktuar në Beshiri dhe të tjerë k. Shqipërisë (nr.7352/03, § § 21-29, 22 Gusht 2006); Driza k. Shqipërisë (nr. 33771 / 02, § § 36-43, ECHR 2007 ... (ekstrakte) dhe Ramadhi dhe të tjerë k. Shqipërisë (nr. 38222/02, § § 23-30, 13 nëntor 2007).

LIGJI

66. Ankuesit u ankuan sipas nenit 6 § 1 të Konventës për shkelje të parimit të sigurisë ligjore si rezultat i anulimit të vendimit të formës së prerë, të moszbatimit të një vendimi të formës së prerë të gjykatës dhe kohëzgjatjes së procedurave.

Pjesët përkatëse të nenit 6 § 1 të Konventës parashikojnë:

“Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ..., çdokush ka të drejtën e një seance gjyqësore ...të rregullt brenda një afati të arsyeshëm ... nga [një] ... gjykatë ...”

67. Ata gjithashtu u ankuan se pas njëmbëdhjetë vjetesh të proceseve gjyqësore ato ende nuk janë në gjendje të rimarrin pronat e tyre që u janë caktuar nëpërmjet vendimit të Gjykatës së Lartë të datës 2 prill 2001.

Neni 1 i protokollit nr.1 të Konventës parashikon:

“Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga pasuria e tij përveç rasteve në interes publik dhe subjekt i kushteve të parashikuara në ligj dhe në parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk duhet, në asnjë mënyrë, të pengojnë të drejtën e një shteti për të zbatuar ligje të tilla nëse ai i gjykon të nevojshme për të kontrolluar përdorimin e pronës në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagesën e taksave apo kontributeve të tjera ose gjoba.”.

I. PRANUESHMËRIA E ANKESAVE

A. Siguria ligjore: anulimi i vendimit të formës së prerë të Gjykatës së Rrethit Durrës të datës 11 prill 1995

68. Ankuesit u ankuan se, sipas procedurës së shqyrtimit mbikëqyrës, vendimi i atëhershëm i Gjykatës së Kasacionit i datës 2 shkurt 1996 anuloi vendimin e formës së prerë të Gjykatës së Rrethit Durrës të datës 11 prill 1995, duke shkelur kështu parimin e sigurisë ligjore.

69. Qeveria argumentoi që kjo ankesë ishte *ratione temporis* e papajtueshme me dispozitat e Konventës për aq kohë sa vendimi i Gjykatës së Kasacionit i datës 2 shkurt 1996 është miratuar në një kohë kur Konventa nuk kishte hyrë në fuqi në lidhje me Shqipërinë.

70. Në këtë lidhje Gjykata përsërit se ajo është kompetente për të shqyrtuar ngjarjet që nga 2 tetori 1996 e në vazhdim, kur njohja nga Shqipëria e së drejtës për petition individual hyri në fuqi. Prandaj, Gjykata konstaton se ankesa e sipërpërmendur, në lidhje me faktet përpara datës 2 tetor 1996, është e papajtueshme *ratione temporis* me dispozitat e Konventës dhe duhet të refuzohet në përputhje me nenin 35§4.

B. Moszbatimi i vendimeve të formës së prerë të gjykatës

71. Gjykata vëren se procedurat e zbatimit në lidhje me vendimin e gjykatës së rrethit të datës 25 prill 2006 janë ende në pritje. Më tej ajo vëren që ankuesit nuk kanë ngritur asnjë ankesë specifike në lidhje me kryerjen e këtyre procedurave. Gjykata nuk sheh ndonjë arsye për ta bërë këtë me lëvizjen e saj.

72. Gjykata vëren se ankesa e aplikantit gjithashtu ka të bëjë me moszbatimin e vendimit të Gjykatës së Lartë të datës 2 prill 2001. Ajo gjykon se ankuesit në mënyrë legjitime mund të pretendojnë se janë viktimë në dritën e shkeljes së vazhdueshme të Konventës, duke pasur parasysh moszbatimin e zgjatur të vendimit të Gjykatës së Lartë të datës 2 prill 2001. Për rrjedhojë rregullorja gjashtëmuajshe nuk zbatohet në këtë situatë (shih Karpova k. Ukrainës, nr. 12884/02, § 23, 29 nëntor 2005). Kjo ankesë nuk është haptazi e pabazuar në kuptim të nenit 35 § 3 të Konventës. Gjykata vëren më tej se kjo nuk është e papranueshme për ndonjë arsye tjetër. Pra, ajo duhet të deklarohet e pranueshme.

C. Kohëzgjatja e procesit gjyqësor

73. Gjykata vëren se një numër procesesh gjyqësore kanë të bëjnë me të drejtën e ankuesve mbi të njëjtën pronë. Ndërsa autoritetet gjyqësore mund të kenë marrë pjesë në proceset gjyqësore, ata megjithatë ishin të ndryshme, duke përfshirë palë të ndryshme dhe në lidhje me argumente të ndryshme ligjore.

74. Gjykata vëren më tej se argumentet e palëve u përqendruan në kohëzgjatjen e rihapjes së proceseve gjyqësore e cila përfundoi më 14 korrik 2003, datë në të cilën ankuesit janë informuar për vendimin e Gjykatës Kushtetuese.

75. Gjykata mendon se kjo ankesë nuk është haptazi e pabazuar në kuptim të nenit 35 § 3 të Konventës. Për më tepër kjo tregon se nuk ka arsye të tjera për të deklaruar këtë ankesë të papranueshme dhe për këtë arsye e deklaron atë të pranueshme.

D. Ankesa e ankuesve sipas nenit 1 të protokollit nr.1 të Konventës në lidhje me moszbatimin e vendimit të Gjykatës së Lartë të datës 2 prill 2001

76. Gjykata mendon se kjo ankesë nuk është haptazi e pabazuar në kuptim të nenit 35 § 3 të Konventës. Për më tepër kjo tregon se nuk ka arsye të tjera për të deklaruar këtë pjesë të ankesës të papranueshme dhe për këtë arsye e deklaron atë të pranueshme.

II. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 6§1 TË KONVENTËS

A. Moszbatimi i vendimit të Gjykatës së Lartë të datës 2 prill 2001

1. Paraqitjet e palëve

77. Kandidatët vërejtën se vendimi i Gjykatës së Lartë i datës 2 prill 2001 ende nuk ka hyrë në fuqi. Megjithatë në shkresa ato kanë në pronësi sipërfaqen prej 3.616 m², ata nuk e ushtronin posedimin efektiv të pronës së tyre meqenëse ishte akoma e zënë.

78. Qeveria mbështeste që zbatimi i procedurave të vendimit të Gjykatës së Lartë të datës 2 prill 2001 ishte shtyrë në disa raste me kërkesën e ankuesve. Pavarësisht negociatave të kryera ndërmjet palëve private në lidhje me shumën e kompensimit, me kërkesën e ankuesve, përmbaruesi kishte vendosur të pezullojë zbatimin e procedurave deri në një njoftim të mëtejshëm. Kështu, qeveria arriti në përfundimin se vonesat në zbatimin e procedurave mund t'u atribuoheshin ankuesve, të cilët vazhduan të negociojnë mbi shumën e kompensimit me zotëruesit dhe nuk ngritën asnjë ankesë kundër vendimit të përmbaruesit.

2. Vlerësimi i Gjykatës

79. Gjykata përsërit se ekzekutimi i një vendimi të formës së prerë dhënë nga ndonjë gjykatë duhet të konsiderohet si një pjesë integrale e "gjykimit" për qëllime të nenit 6 të Konventës (shih Hornsby k. Greqisë, 19 mars 1997, § 40, Raportet 1997-II). Shteti ka një detyrim pozitiv për të organizuar një sistem për zbatimin e vendimeve, i cili është efektiv si në ligj, dhe në praktikë, dhe

siguron zbatimin e tyre pa ndonjë vonesë të panevojshme (shih Ruianu k. Rumani, nr. 34647/97, §66, 17 qershor 2003). Kur autoritetet janë të detyruara të veprojnë në mënyrë që të zbatojnë një vendim dhe ata nuk arrijnë të veprojnë kështu, pasiviteti i tyre mund të angazhojë përgjegjësinë e shtetit në bazë të nenit 6§1 të Konventës (shih Scollo k. Itali, 28 Shtator 1995, § 44, Seria A nr. 315-C).

80. E drejta e "aksesit në gjykatë" nuk cakton një detyrim për një shtet që të zbatojë çdo vendim të një karakteri civil, pa pasur lidhje me rrethanat e veçanta të një çështjeje (shih Sanglier k. Francës, nr.50342/99, § 39, 27 maj 2003). Përgjegjësia e shtetit për zbatimin e një vendimi kundër një personi privat, nuk shtrihet më tej se përfshirja e organeve të shtetit në procedurat e zbatimit (shih Fuklev k. Ukrainë, nr.71186/01, § 67 dhe § § 90-91, 7 qershor 2005). Detyra e vetme e Gjykatës është të shqyrtojë nëse masat e marra nga autoritetet ishin të përshtatshme dhe të mjaftueshme. Në raste të tilla si ky i pranishmi, ku debitori është person privat, shteti duhet të veprojë me kujdes në mënyrë që të ndihmojë një kreditor në ekzekutimin e një vendimi (shih Fociac k. Rumani, nr.2577/02, § 70, 3 shkurt 2005).

81. Gjykata vëren se qëndrimi i aplikuesit ndaj zbatimit duket se është ndikuar nga negociatat me zotëruesit mbi shumën e kompensimit. Ata kërkuar një vonesë të zbatimit në shtator dhe tetor të vitit 2001. Pas një ngërçi në negociatat me zotëruesit, më 16 janar 2002 ankuesit i kërkuar përmbaresit për të proceduar me zbatimin e vendimit në lidhje me M. dhe D. Më 4 shkurt 2002 përmbaresi vendosi që të shtyjë ekzekutimin e detyrueshëm për shkak të mungesës së ankuesve.

82. Gjykata dyshon nëse vendimi i përmbaresit i datës 4 shkurt 2002, ishte i arsyeshëm. Në radhë të parë, kuptohet nga të dhënat se përmbaresi nuk ka shkuar në vend për të ndërmarrë ndonjë veprim për prishjen e godinave të zotëruesve me qëllim që të sigurohet zbatimi. Së dyti, Gjykata nuk e konsideron arsyetimin e përmbaresit për mungesë të ankuesve si një justifikim të rëndësishëm: nuk ka bazë ligjore për të kërkuar praninë e ankuesve gjatë zbatimit të detyrueshëm të procedurave.

Së treti, nuk janë paraqitur nga qeveria kufizime të tjera objektivisht të justifikuara mbi aftësinë e përmbaresit për të vepruar.

83. Më 9 shtator 2002 ankuesit përsëritën dëshirën e tyre për të vazhduar me zbatimin e vendimit të formës së prerë. Gjykata e konsideron të paefektshëm vendimin e përmbaresit të datës 10 shtator 2002 për t'u përpjekur për një tjetër zbatim vullnetar. Një masë e tillë kishte rezultuar më parë e pasuksesshme. Më saktë, përmbaresi duhet të kishte proceduar me masa detyruese për të zbatuar vendimin.

84. Për më tepër, Gjykata vendos që kërkesat e zotëruesve të datës 16 shtator 2002 ishin të paarsyeshme, duke qenë se ishte vendosur me vendim të Gjykatës së Lartë të datës 2 prill 2001 se ata kishin zënë në mënyrë të paligjshme pronën e ankuesve. Ekzistenca e një vendimi të zbatueshëm dhe të formës së prerë në favor të ankuesve është tregues i faktit që padia e tyre ishte e meritueshme (shih Cebotari dhe të tjerë k. Moldavia, nos. 37763/04, 37712/04, 35247/04, 35178/04 dhe 34350/04, § 45, 27 janar 2009). Ankuesit nuk mund të mbahen përgjegjës për çfarëdo shpenzimesh që mund të kenë rezultuar nga, ose shoqëruar, me dëbimin e zotëruesve. Gjykata vëren se që më 16 janar 2002 deri më 14 shkurt 2003 ankuesit janë konsistentë në kërkesat e tyre për zbatimin e vendimit të Gjykatës së Lartë të datës 2 prill 2001.

85. Ballafaquar me kërkesat e paarsyeshme të zotëruesve, përmbaresi duhet të kishte marrë hapa të menjëhershëm për të siguruar zbatimin e detyrueshëm. Në të kundërt, më 14 shkurt 2003 ai vendosi që të pezullojë përsëri zbatimin. Vendimi i datës 14 shkurt 2003, nga i cili ankuesit fituan njohje duke e nënshkruar, përbënte një akt që mund të ishte kundërshtuar pranë gjykatave të brendshme (shih paragrafët 48 dhe 64 më lart). Në rastin konkret, ankuesit nuk arritën ta bëjnë këtë dhe, si rrjedhim, ata nuk mund të konsiderohet se kanë shteruar mjetet ligjore të brendshme në dispozicion të tyre sipas ligjit shqiptar.

86. Në lidhje me gjykimet e mësipërme, Gjykata konstaton se ka pasur shkelje të nenit 6§1 të Konventës për shkak të moszbatimit të vendimit të Gjykatës së Lartë të datës 2 prill 2001 ndërmjet datës 28 qershor 2001 dhe 14 shkurt 2003.

B. Kohëzgjatja e procedurave

1. Paraqitjet e palëve

87. Ankuesit u ankuan për kohëzgjatjen e paarsyeshme të procedurave të brendshme, të cilat kanë filluar në një datë të pacaktuar në vitin 1995 dhe përfunduan me vendimin e Gjykatës Kushtetuese të datës 10 korrik 2003. Ato zgjatën mbi tetë vjet për tetë nivelet e juridiksionit. Ankuesit pretendonin se,

duke marrë parasysh se çfarë ishte në rrezik për ta, domethënë pushimin e posedimit të pronës së tyre, gjykatat e brendshme nuk kanë dëgjuar çështjen e tyre brenda një kohe të arsyeshme.

88. Qeveria argumentoi se në dritën e kompleksitetit të çështjes, qëndrimin dhe sjelljes së autoriteteve, sjelljes së ankuesve dhe elemente të tjera, procedurat janë kryer brenda një kohe të arsyeshme. Qeveria gjithashtu vuri në dukje pushimin e çështjes nga gjykata e rrethit më 21 qershor 1996 për shkak të dështimit të ankuesve për t'u paraqitur, gjë që kishte kontribuar në kohëzgjatjen e procedurave (shih paragrafin 17 më sipër).

2. Vlerësimi i Gjykatës

89. Gjykata përsërit se ajo është kompetente për të shqyrtuar ngjarjet që nga data 2 tetor 1996 e në vazhdim, kur njohja nga ana e Shqipërisë e së drejtës së peticionit individual hyri në fuqi. Megjithatë, mund të ketë lidhje me faktet para ratifikimit, meqenëse ato mund të konsiderohen se kanë krijuar një situatë që shtrihet përtej kësaj date, ose mund të kenë lidhje mbi të kuptuarit e fakteve që ndodhin pas kësaj date (shih Broniowski k. Poloni (dhjetor)

[GC], nr. 31443/96, & 74, ECHR 2002 X).

90. Megjithatë, në dritën e konkluzionit të saj për shkelje sipas nenit 6 § 1 të Konventës për moszbatimin e vendimit të Gjykatës së Lartë të datës 2 prill 2001 ndërmjet datës 28 qershor 2001 dhe 14 shkurt 2003, ajo nuk duhet të vendosë më vete mbi meritat e kohëzgjatjes të ankesës së procedurave (shih Lizanets k. Ukrainë, nr.6725/03, § 48, 31 maj 2007).

III. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 1 TË PROTOKOLLIT NR.1 TË KONVENTËS

A. Paraqitjet e palëve

91. Ankuesit kanë paraqitur se ata kishin arritur të rimarrin në pronësi të tyre një truall me sipërfaqe 664 m² nëpërmjet shitjes së saj palëve të tjera. Ata pohonin se moszbatimi i vendimit të Gjykatës së Lartë i datës 2 prill 2001 ka ndikuar negativisht në të drejtën e tyre për gëzimin efektiv të pronave të tyre, të cilat ishin zënë nga palët e tjera.

92. Qeveria, duke iu referuar sjelljes së ankuesve gjatë zbatimit të procedurave në lidhje me vendimin e Gjykatës së Lartë të datës 2 prill 2001, pretendonte se e drejta e tyre mbi pronën nuk ishte shkelur në mënyrë të shpërpjestuar. Procedurat e brendshme kanë qenë të drejta dhe ankuesit kanë përftuar një vendim mbi të drejtën e tyre të pronës në vendimin e Gjykatës së Lartë.

B. Vlerësimi i Gjykatës

93. Gjykata vëren se ajo ka krijuar tashmë, në vendimet me fuqi ligjore, parimet në lidhje me shkeljen e pretenduar të të drejtave të pronës së ankuesit për shkak të dështimit të shtetit për të siguruar zbatimin e një vendimi të formës së prerë lëshuar kundër një pale private. Në veçanti, në rastin e Fuklev k. Ukrainë, Gjykata vlerësoi si më poshtë:

“89. Gjykata përsërit se në bazë të nenit 1 të Konventës, secila palë kontraktuese do të sigurojë për të gjithë brenda [juridiksionit] të saj të drejtat dhe liritë e përcaktuara në ... [] Konventë. Detyrimi për të siguruar ushtrimin efektiv të të drejtave të përcaktuara në atë instrument mund të rezultojnë në detyrime pozitive për shtetin. Në këto rrethana, shteti nuk mund të mbetet thjesht pasiv dhe ... nuk ka vend për të dalluar ndërmjet ligjeve dhe mosveprimeve....”

91. Përsa i përket të drejtës së garantuar nga nenin 1 i protokollit nr.1, obligimet pozitive mund të paraqesin disa masa të nevojshme për të mbrojtur të drejtën e pronës edhe në çështjet që përfshijnë proceset gjyqësore ndërmjet individëve ose kompanive private. Kjo do të thotë, në veçanti, se shtetet janë nën një detyrim për të siguruar që procedurat e sanksionuara në legjislacionin për zbatimin e vendimeve të formës së prerë ... janë në përputhje me të.

92. Gjykata konsideron se dështimi i përmbauesve për të vepruar dhe dështimi i gjykatave të brendshme për të ushtruar kontrollin e duhur mbi situatën, kanë krijuar pasiguri të përhershme, përsa i përket zbatimit të një vendimi në favor të ankuesit, si dhe pagimit të borxhit që i detyrohet atij. Rrjedhimisht, ankuesit i duhej të përballej me atë pasiguri gjatë një periudhe të gjatë kohe ...

93. Duke pasur lidhje me arsyetimet e mëparshme dhe me konkluzionet e saj në lidhje me nenin 6 § 1 të Konventës, Gjykata është e mendimit se mënyra në të cilën janë kryer procedurat e zbatimit, kohëzgjatja e tyre totale dhe pasiguria në të cilin ka mbetur ankuesi, trondit “ekuilibrin e drejtë” që duhej arritur ndërmjet kërkesave të interesit publik dhe nevojës për të mbrojtur të drejtën e ankuesit për një gëzim paqësor të pronës së tij. Si rrjedhim, shteti nuk arriti të pajtohet me obligimet e tij për t'i siguruar ankuesit gëzimin efektiv të të drejtës së tij të pasurisë, të garantuar nga neni 1 i protokollit nr.1 “(nr.71186/01, 7 qershor 2005)”.

94. Duke aplikuar këto parime, si dhe duke pasur parasysh rezultatet e caktuara në paragrafët 79-86 më sipër, Gjykata vlerëson se për shkak të dështimit të përmbarimit për të marrë masa të përshtatshme dhe të mjaftueshme, me qëllim që të sigurojë zbatimin e vendimit të Gjykatës së Lartë të datës 2 prill 2001 në favor të ankuesve nga data 28 qershor 2001 deri më 14 shkurt 2003, ata u lanë në një situatë pasigurie dhe nuk kanë qenë në gjendje të gëzojnë plotësisht pasuritë e tyre. Si rrjedhim, ka pasur shkelje të nenit 1 të protokollit nr.1.

IV. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

95. Neni 41 i Konventës parashikon:

“Nëse Gjykata konstaton se ka pasur shkelje të Konventës ose protokolleve për këtë qëllim, dhe në qoftë se ligji i brendshëm i palës së lartë kontraktuese të interesuar lejon të bëhet vetëm dëmshpërblim i pjesshëm, Gjykata duhet, nëse është e nevojshme, të përballojë dëmshpërblimin e drejtë të palës së dëmtuar.”.

A. Dëmtimi, kostot dhe shpenzimet

96. Ankuesi pretendoi 2,036,211 € (euro) në lidhje me dëmin monetar dhe 10,000 euro në lidhje me dëmin jomonetar. Përsa i përket pretendimit për dëmin në para, ankuesi vlerësoi vlerën e pronës në 236,211 euro dhe humbjen e investimeve që ai do të kishte bërë në 1,800,000 euro.

97. Përveç kësaj, ankuesit kanë pretenduar 650,000 lekë (rreth 5.542 €) dhe 334,600 lekë (rreth 2,853 €) për kostot dhe shpenzimet e bëra pranë gjykatave të brendshme dhe atyre të bëra pranë kësaj Gjykate. Ata nuk arritën të paraqesin dokumentet mbështetëse në lidhje me shpenzimet e kryera në procedimet e brendshme.

98. Qeveria nuk ka paraqitur asnjë koment.

99. Gjykata konsideron se çështja e zbatimit të nenit 41 nuk është gati për vendim. Për rrjedhojë pyetja duhet të jetë e rezervuar dhe procedura e mëtejshme e përcaktuar me vëmendjen e duhur në lidhje me mundësinë e arritjes së marrëveshjes ndërmjet qeverisë shqiptare dhe ankuesve.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, UNANIMISHT:

1. I deklaron të papranueshme ankesat në lidhje me shfuqizimin e vendimit të formës së prerë sipas nenit 6§1 të Konventës dhe moszbatimin që nga data 14 shkurt 2003 e në vazhdim të vendimit të Gjykatës së Lartë të datës 2 prill 2001, si dhe pjesën e mbetur të ankimit të pranueshëm.

2. Vlerëson se ka pasur shkelje të nenit 6§1 të Konventës përsa i përket moszbatimit të vendimit të Gjykatës së Lartë të datës 2 prill 2001 ndërmjet datës 28 qershor 2001 dhe 14 shkurt 2003.

3. Vlerëson se nuk e konsideron të nevojshme për të shqyrtuar ankesën në lidhje me kohëzgjatjen e procedurave sipas nenit 6§1 të Konventës.

4. Vlerëson se ka pasur shkelje të nenit 1 të protokollit nr.1 të Konventës lidhur me dështimin për të zbatuar vendimin e Gjykatës së Lartë të datës 2 prill 2001 ndërmjet datës 28 qershor 2001 dhe 14 shkurt 2003.

5. Vlerëson se çështja e zbatimit të nenit 41 nuk është gati për vendim. Rrjedhimisht:

a) rezervon pyetjen e mësipërme si një e tërë;

b) fton qeverinë dhe ankuesit të paraqesin, brenda tre muajve të ardhshëm nga data në të cilën vendimi merr formë të prerë, në përputhje me nenin 44§2 të Konventës, vëzhgimet e tyre me shkrim për çështjen dhe, në veçanti, për të njoftuar Gjykatën për çdo marrëveshje që ata mund të arrijnë.

c) rezervon procedurën e mëtejshme dhe ia delegon kryetarit të jurisë autoritetin për të caktuar të njëjtën, nëse është e nevojshme.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 8 dhjetor 2009, në përputhje me rregullën 77 § 2 dhe 3 të rregullores së Gjykatës.

Lawrence Early
Sekretar

Nicolas Bratza
Kryetar

GJYKATA EUROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT
SEKSIONI I KATËRT

VENDIM

Ankimet nr.9870/06

Nga Qemal GURGAJ dhe të tjerë
kundër Shqipërisë

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (seksioni i katërt), mbledhur në seancë më 13 nëntor 2009, e përbërë nga:

Sir Nicolas Bratza, kryetar,

Z. J. Casadevall

Z. G. Bonello

Z. K. Traja

Z. S. Pavlovski

Z. L. Garlicki

Ms L. Mijovic, gjyqtarë,

dhe z. F. ARACI, zv / sekretar seance,

pas vlerësimit të ankesës së mësipërme paraqitur më 4 mars 2006,

pas vlerësimit të vendimit për të zbatuar nenin 29 § 3 të Konventës dhe për të shqyrtuar pranueshmërinë dhe meritat e çështjes së bashku,

pas vlerësimit të vëzhgimeve paraqitur nga qeveria e paditur më 19 shkurt 2007,

pasi diskutoi çështjen, vendos si vijon:

FAKTET

Ankuesit, z. Qemal Gurgaj, znj. Gjyslime Çelo, znj. Fatmiroshe Gurgaj, znj. Aferdita Shehu dhe z. Pëllumb Gurgaj, janë shtetas shqiptarë, që kanë lindur respektivisht në vitet 1922, 1930, 1923 dhe 1928, dhe jetojnë në Piacenza, Itali. Ata nuk janë përfaqësuar pranë Gjykatës.

Qeveria shqiptare (qeveria) u përfaqësua nga përfaqësuesja e tyre, znj. S. Mëneri e Ministrisë së Punëve të Jashtme.

A. Rrethanat e çështjes

Faktet e çështjes, paraqitur nga palët, mund të përmbledhen si më poshtë:

Babai i ankuesve ka qenë pronar i disa trojeve në Shqipëri, me sipërfaqe 324.7 hektarë.

Gjykata e Rrethit Fier, me vendim të datës 15 mars 1996, u ka njohur ankuesve të drejtën mbi truallin e babait të tyre.

Më 10 qershor 2000, sipas ligjit të pronësisë të vitit 1993, komisioni për kthimin dhe kompensimin e pronave u ka dhënë ankuesve kompensim për vlerën e pronës fillestare, duke qenë e pamundur për t'u rikthyer atyre pronën fillestare. Vendimi mori formë të prerë më 10 korrik të vitit 2000 në kuadrin e dështimit të autoriteteve për të paraqitur një ankesë pranë gjykatave të brendshme kundër vendimit.

Në datën e komunikimit të fundit të ankuesve pranë Gjykatës, autoritetet nuk ishin pajtuar ende me vendimin e komisionit të datës 10 qershor 2000.

B. E drejta e brendshme përkatëse

E drejta e brendshme përkatëse përmbledhet në vendimin "Beshiri dhe të Tjerë k. Shqipërisë, nr. 7352/03, && 20-29, 22 gusht 2006".

ANKESAT

1. Pas vlerësimit të shumës së kompensimit të dhënë, ankuesit u ankuan sipas nenit 6§1 të Konventës për padrejtësi të procedimeve të çështjes.

2. Ankuesit kanë pretenduar gjithashtu shkelje të nenit 6§1 (kohëzgjatje e procedurave civile), duke pohuar se gjashtë vite përbëjnë një kohë të paarsyeshme për zgjatjen e procedurës.

3. Në bazë të nenit 6§1 (dështimi për të vepruar në përputhje me një vendim të formës së prerë) të Konventës, ankuesit u ankuan për dështimin e autoriteteve për të vepruar në përputhje me vendimin e komisionit të datës 10 qershor 2000.

4. Së fundi, ankuesit u ankuan për shkelje të të drejtave të tyre mbi pronën, të garantuara nga neni 1 i protokollit nr.1 të Konventës.

LIGJI

Nëpërmjet një shkresë të datës 8 mars 2007 vëzhgimet e qeverisë iu dërguan ankuesve, të cilëve iu kërkua të paraqesin ndonjë vërejtje në përgjigje, së bashku me pretendimet për shpërblim të drejtë deri më 19 prill 2007.

Nëpërmjet shkresës së datës 2 korrik 2007, dërguar me postë, pas kërkesës së ankuesve, kryetari i jurisë, mbi bazë të veçantë, vendosi që të shtyjë deri më 13 korrik 2007 kohën e lejuar për paraqitjen nga ana e ankuesve të vërejtjeve të tyre mbi pranueshmërinë dhe meritat e ankesës së tyre. Për më tepër, ankuesve iu kërkua për të caktuar një avokat që do t'i përfaqëson ata pranë Gjykatës në të njëjtën datë. Së fundi, ata u njoftuan se në rast të skadimit të afatit të lartpërmendur nuk do t'u caktohej më zgjatje e afatit. Ankuesve iu tërhoq vëmendja në nenin 37§1 (a) të Konventës, i cili parashikon që Gjykata mund të heqë çështjen nga lista e çështjeve kur rrethanat të çojnë në konkluzionin se ankuesi nuk ka si qëllim të ndjekë ankimin. Ankuesit e kanë marrë këtë shkresë, më 6 korrik 2007. Megjithatë, asnjë përgjigje nuk është marrë.

Gjykata vlerëson se, në këto rrethana, ankuesit mund të konsiderohet se nuk dëshirojnë më të ndjekin ankimet e tyre, në kuptim të nenit 37§1 (a) të Konventës. Për më tepër, në përputhje me nenin 37§1 *in fine*, Gjykata nuk vlerëson rrethana të veçanta në lidhje me respektimin e të drejtave të njeriut siç është përcaktuar në Konventë dhe protokollet e saj të cilat kërkojnë shqyrtimin e vazhdueshëm të çështjeve.

Kështu, është e nevojshme që të ndërpresë zbatimin e nenit 29§3 dhe të heqë ankimin nga lista e çështjeve.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, UNANIMISHT:

-Vendos të heqë ankimin nga lista e çështjeve.

Fatos Araci
Zv/sekretar

Nikolas Bratza
Kryetar

**GJYKATA EUROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT
SEKSIONI I KATËRT**

VENDIM MBI PRANUESHMËRINË E

Ankimit nr.11186/03

nga Qerim Jakupi

kundër Shqipërisë

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (seksioni i katërt) e mbledhur më 1 dhjetor 2009 si trup gjykues i përbërë nga:

Nicolas Bratza, kyetar

Giovanni Bonello,

David Thor Bjorgvinsson,

Jan Sikuta,

Paivi Hirvela,

Ledi Bianku,

Nevojsa Vucinic, gjykatës

dhe Fatos Araci, zëvendëssekretar i seksionit

duke marrë në konsideratë ankimin e mësipërm të depozituar më 17 mars 2003,

duke marrë në konsideratë vërejtjet e paraqitura nga qeveria e paditur dhe vërejtjet në përgjigjen e paraqitur nga ankuesi,

pasi kanë shqyrtuar çështjen, vendosi si më poshtë:

FAKTET

Ankuesi, z.Qerim Jakupi, është një shtetas shqiptar i lindur në vitin 1937 dhe banues në Lushnjë. Ai përfaqësohet në Gjykatë nga z. A. Shehu, avokat që ushtron profesionin e tij në Tiranë. Qeveria shqiptare (Qeveria) u përfaqësua nga personat e autorizuar në atë kohë, z. S. Puto dhe znj.B. Bulica.

A. Rrethanat e çështjes

Faktet e çështjes të paraqitura nga palët, mund të përmbliidhen si më poshtë:

Më 16 prill 1992, këshilli bashkiak i Lushnjës i dha ankuesit një leje ndërtimi për të ngritur një godinë të përkohshme. Ankuesi e përdori këtë leje për të hapur një bar-kafe. Megjithatë, leja nuk përcaktonte kohëzgjatjen e vlefshmërisë së saj.

Në 1993, u dekretua ligji mbi planifikimin urban (ligji i vitit 1993). Ai parashikonte se lejet e ndërtimit për godinat e përkohshme kishin vlefshmëri për një vit. Ligji i vitit 1993 u shfuqizua nga ligji i planifikimit urban i vitit 1998 (ligji i vitit 1998) që mori të njëjtat masa për vlefshmërinë e lejeve të ndërtimit në lidhje me godinat e përkohshme.

Më 23 dhjetor 1999, policia ndërtimore e rrethit Fier (policia ndërtimore- PN) vendosi të fillonte procedime administrative kundër ankuesit për shkeljet e pretenduara të dispozitave të ligjit të vitit 1998. Rrjedhimisht, më 2 shkurt 2000, PN konstatoi se periudha e vlefshmërisë prej një viti e lejes së ndërtimit të ankuesit kishte skaduar prej një kohe të gjatë, në shkelje të ligjit të vitit 1998. Ajo gjithashtu konstatoi se vendndodhja e godinës ishte brenda një zone publike të gjelbër, në shkelje të ligjit të vitit 1998. Së fundi, PN urdhëroi prishjen e godinës së ankuesit.

Në një datë të papërcaktuar në shkurt 2000, ankuesi bëri një mocion kundër vendimit të PN-së me Policinë Ndërtimore Kombëtare (PNK)-organi më i lartë administrativ kompetent. Ai argumentoi se leja e ndërtimit e lëshuar në 1992 ishte për një kohëzgjatje të papërcaktuar. Për më tepër, ai kundërshtoi se ndërtimi ishte i ligjshëm dhe se drejtimi i pandërprerë i biznesit duhet të konsiderohet si rinovim i hapur i lejes nga autoritetet.

Më 23 shkurt 2000, PN i kërkoi ankuesit të shkatërronte godinën vullnetarisht brenda 5 ditëve nga data e vendimit të saj, në përputhje me ligjin e vitit 1998.

Më 1 mars 2000, PNK hodhi poshtë mocionin e ankuesit dhe mbështeti urdhrin e shkatërrimit të PN-së. Ankuesi u urdhërua të shkatërronte lokalit e bar-kafesë brenda pesë ditëve. Qeveria e paditur pohoi se urdhri i ishte dorëzuar ankuesit në një datë të papërcaktuar me postë.

Sipas parashtrimit të ankuesit, ai qëndroi nga 1 deri 14 mars 2000 në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë për arsye familjare dhe nuk iu dërgua apo njoftua asnjë vendim apo urdhër i PNK-së.

Më 10 mars 2000, ndërsa ankuesi ishte në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, PN e shkatërroi lokalit e bar-kafesë së tij. Procesverbali i policisë, në masën e përshtatshme, deklaronte:

“PN (...) ndoqi nga afër [dhe inspektoi] ekzekutimin vullnetar të punëdhënësve [të urdhrin të shkatërrimit].”

Procesverbali i policisë nuk u nënshkrua nga punëdhënësit e ankuesit. Gjithashtu, dokumenti nuk i referohej ndonjë inventarizimi të pajisjeve që ishin brenda lokalit të bar-kafesë para, gjatë ose pas shkatërrimit të tij.

Procedimet gjyqësore në lidhje me të drejtat e pronësisë së ankuesit

Në një datë të papërcaktuar në vitin 2000, ankuesi depozitoi një ankim pranë Gjykatës së Rrethit Lushnjë (gjykata e rrethit). Ai kundërshtoi ligjshmërinë e urdhrin të shkatërrimit të PNK-së dhe u ankua për arbitraritetin nga ana e forcave policore, pasi nuk ishte informuar për shkatërrimin. Për më tepër, ankuesi kërkoi kompensim për humbje financiare në lidhje me pajisjet e lokalit të bar-kafesë që shkonte deri në 3 milionë lekë shqiptare (rreth 24,032 euro).

Më 30 mars 2001, gjykata e rrethit pohoi se urdhri i shkatërrimit ishte i ligjshëm për sa kohë që ankuesi nuk kishte mundur të aplikonte pranë një autoriteti kompetent për rinovimin e lejes së ndërtimit për të ngritur një godinë të përkohshme. Gjykata konstatoi se nuk ishte njohur asnjë rinovim automatik nga ligji i vitit 1998 dhe se shkatërrimi i godinës gjithashtu ishte në përputhje me ligjin e Policisë Ndërtimore. Për më tepër, gjykata e rrethit i rrëzoi si të pabazuara pretendimet e tij në lidhje me arbitraritetin e forcave policore dhe përgjegjësinë e tyre për dëmin e pretenduar të shkaktuar nga shkatërrimi i lokalit të bar-kafesë. Për sa i përket humbjes së pajisjeve të lokalit të bar-kafesë, ajo konstatoi se ankuesi ishte pjesërisht përgjegjës. Duke mos respektuar urdhrin e policisë, ai kishte kontribuar në dëmin e shkaktuar ndaj pronës së tij. Së fundi, gjykata konstatoi se përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga humbja e pajisjeve të lokalit të bar-kafesë qëndronte tek punonjësit të cilët kishin kryer shkatërrimin.

Në një datë të papërcaktuar në vitin 2001, ankuesi apeloj në Gjykatën e Apelit Fier (gjykata e apelit).

Më 8 qershor 2001, gjykata e apelit mbështeti vendimin e gjykatës së rrethit. Ajo konstatoi se ankuesi kishte qenë përgjegjës për shkaktimin e dëmit në shkallën që ai kishte vendosur të shkonte jashtë shtetit më 1 mars 2000 në kohën kur ai kishte marrë njoftim për shkatërrimin brenda një kohe të shpejtë të barit. Për më tepër, gjykata pohoi që ankuesi nuk kishte treguar përgjegjësi të drejtpërdrejtë në lidhje me forcat policore për dëmin financiar.

Ankuesi apeloj në Gjykatën e Lartë. Ai pretendoi se godina e tij ishte ngritur në bazë të autoritetit të një lejeje ndërtimi të një godine të përkohshme që nuk përcaktonte periudhën e vlefshmërisë. Për rrjedhojë, ai kishte qenë pronar në mirëbesim dhe përdorues i lokalit të bar-kafesë gjatë kësaj kohe. Ankuesi pretendoi se Policia Ndërtimore kishte tejkaluar kompetencat e saj, pasi ata kishin vepruar në vend të këshillit për planifikimin e territorit në lidhje me nxjerrjen e një urdhri shkatërrimi për godinën. Ankuesi gjithashtu parashtrroi se gjykatat e shkallëve më të ulëta nuk kishin shqyrtuar nëse urdhri i shkatërrimit i ishte njoftuar atij siç duhet. Së fundi, ankuesi vuri në dyshim veprimet e Policisë Ndërtimore që çuan në heqjen e pronësisë së tij ndaj pajisjeve të lokalit të bar-kafesë dhe mungesën e plotë të kompensimit.

Më 20 maj 2002, Gjykata e Lartë vendosi të rrëzonte apelin, duke deklaruar se arsyet e apelit ishin jashtë fushës së veprimt të nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile (KPP).

Më 23 korrik 2002, ankuesi apeloj në Gjykatën Kushtetuese. Ai u mbështet në të njëjtat arsye apeli si para Gjykatës së Lartë.

Më 27 shtator 2002, ankimi u deklarua i papranueshëm nga një trup gjykues prej tre gjykatësish të Gjykatës Kushtetuese për mosrespektim të nenit 131 (f) të Kushtetutës.

B. Praktika përkatëse dhe ligji i brendshëm
Dispozitat ligjore përkatëse të brendshme janë si më poshtë:
1. Kushtetuta

Neni 41

“1. E drejta e pronës private është e garantuar.

...”

Neni 42

“1. Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor.

2. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetuese dhe ligjore ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

Neni 131

“ Gjykata Kushtetuese vendos për:

f) gjykimin përfundimtar të ankimeve të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave.”

Neni 134 §§ 1 (f) dhe 2

“1. Gjykata Kushtetuese mund të vihet në lëvizje vetëm me kërkesë të:

....

f) partive politike dhe organizatave të tjera;

g) individëve.

2. Subjektet e parashikuara nga nënparagrafët “dh”, “e”, “ë”, “f” dhe g të paragrafit 1 të këtij neni mund të bëjnë ankesë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre.”

Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese mbi të drejtën për gjykim të drejtë

Një individ mund të bëjë ankim pranë Gjykatës Kushtetuese në bazë të nenit 131(f) të Kushtetutës duke pretenduar një shkelje të së drejtës së tij për seancë të drejtë. Gjykata Kushtetuese e ka interpretuar të drejtën për gjykim të ndershëm sikur përfshin të drejtën e aksesit në gjykatë (shihni për shembull, vendimet nr.4/05, 10/07, 7/08); të drejtën për të gëzuar barazinë e palëve dhe të drejtën e njoftimit të akteve të një gjykate (shihni për shembull, vendimet nr.11/05, 12/05, 8/06, 5/07, 6/07, 80/07, 1/08); të drejtën për një gjykim të pavarur dhe të paanshëm (shihni për shembull vendimet nr.16/05, 36/05, 12/ 07); dhe të drejtat për vendime të arsyetuara (shihni për shembull, vendimin nr.33/05). Në rast se Gjykata Kushtetuese konstaton një shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë, ajo rrëzon vendimet e gjykatave të shkallëve më të ulëta dhe e kaloi çështjen për rishqyrtim.

2. Kodi i Procedurës Civile

Nenet 324-333 rregullojnë gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative pas shterimit të të gjitha mjeteve administrative. Neni 324 parashikon që një palë mund të ngrejë një padi pranë një gjykate me synim revokimin ose ndryshimin e një vendimi administrativ. Sipas nenit 325, një palë duhet të argumentojë se vendimi është i paligjshëm dhe se interesat dhe të drejtat e tij ose të saj janë shkelur drejtpërdrejt ose jo, individualisht ose bashkërisht.

Për sa i përket procedurës së apelit para Gjykatës së Lartë, Kodi i Procedurës Civile, në masën e përshtatshme, lexohet si më poshtë:

Vendimet e shpallura nga gjykata e apelit dhe ato të gjykatës së shkallës së parë, në rastet që përcaktohen nga ky Kod, mund të ankimohen në rekurs në Gjykatën e Lartë vetëm kur: a) nuk është respektuar ose është zbatuar keq ligji; b) ka shkelje të rënda të normave procedurale (neni 467 i këtij Kodi); c) për shkelje procedurale që kanë ndikuar në dhënien e vendimit.

Kundërshtimi i vendimit në Gjykatën e Lartë bëhet brenda 30 ditëve nga data e dhënies së vendimit. Kur palët janë në mungesë, ky afat fillon nga data e njoftimit.

Rekursi pranohet në qoftë se bëhet për shkaqe të ndryshme nga ato që i lejon ligji. Mospranimi i rekursit vendoset nga kolegji i Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit pa pjesëmarrjen e palëve.

3. Kodi i Procedurës Administrative (KPA)

Nenet 78 dhe 79 të KPA-së rregullojnë miratimin e masave të përkohshme. Neni 78 i KPA-së parashikon që organi administrativ përgjegjës për marrjen e vendimit të formës së prerë mund të vendosë masa të përkohshme kur çmon se pamundësia për të marrë masa të caktuara do të shkaktonte dëm serioz dhe të pariparueshëm ndaj interesave publike. Masat e përkohshme mund të miratohen me iniciativën e organit administrativ ose me kërkesë të ankuesit. Vendimi duhet të arsyetohet dhe të përmbajë një kuadër të përcaktuar kohor.

Neni 79 i KPA-së parashikon bazën ligjore mbi të cilën është ngritur masa e përkohshme.

4. Ligji për planifikimin urban i 1998 (ligji nr.8405 i 17 shtatorit 1998 i amenduar nga ligji nr.8501 i 16 qershorit 1999, ligji nr.8991 i 23 janarit 2003 dhe së fundi nga ligji nr.9843 i 17 dhjetorit 2007) (ligji i 1998)

Ligji i vitit 1998, i cili shfuqizoi ligjin e vitit 1993 hyri në fuqi, më 25 tetor 1998. Ai parashtron rregullat e përgjithshme që rregullojnë vendosjen dhe arkitekturën e ndërtimeve në Shqipëri. Ai parashikon krijimin e këshillit të rrethit për planifikimin e territorit (KPT-ve) dhe KPT-së Kombëtare.

Seksioni 58 parashikon që lejet për ngritjen e ndërtesave të përkohshme të kenë vlefshmëri për 1 vit. Këto leje lëshohen vetëm në rastet e fatkeqësive natyrore ose ngjarjeve të ngjashme. Seksioni 62 parashikon që CTA-të e rrethit nuk kanë kompetenca për të autorizuar ndërtime të përkohshme në zonat publike të gjelbra.

Sipas seksionit 75, Policisë Ndërtimore i jepen kompetenca për të vendosur gjoba dhe për të urdhëruar shembjen e ndërtesave të paligjshme. Për më tepër, ligji parashikon shkatërrimin e menjëhershëm të ndërtesave të paligjshme në zona publike.

Seksioni 82 në fuqi në kohën fizike, shprehet se vendimi i PN-së mund të apelohe brenda pesë ditëve në PNK, e cila ishte e detyruar të vendoste brenda dhjetë ditëve. Vendimi i PNK-së mund të apelohe në gjykatën e rrethit brenda pesë ditëve nga njoftimi i tij. Seksioni 83 parashikonte se apelimi në gjykatë nuk kishte efekt pezullues për ekzekutimin e vendimeve administrative.

Ligji i 1998 nuk përmban një dispozitë me qëllim që të jetë e zbatueshme për rastet para hyrjes në fuqi të tij.

Praktika ligjore e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë mbi ligjin për planifikimin urban

Në vendimin e saj nr.2 të 25 janarit 1999 për moskushtetutshmërinë e disa neneve të ligjit për planifikimin urban të vitit 1998, Gjykata Kushtetuese konstatoi, ndër të tjera, se nenet 58 dhe 75 nuk ishin jokushtetuese dhe nuk shkelnin parimet kushtetuese.

Me vendim nr.32 të 24 nëntorit 2003, lidhur me pezullimin e ekzekutimit të ligjeve administrative të, ndër të tjera, Policisë Ndërtimore, siç parashikohet në ligjin e vitit 1998, Gjykata Kushtetuese konsideronte se pezullimi i ekzekutimit të ligjeve administrative mund të ndryshohej nga rishikimi gjyqësor. Gjykatat vendase mund të vendosin për pezullimin e ekzekutimit të ligjeve administrative me kusht që kërkuar të ngrëjë padi kundër aktit administrativ dhe të kërkojë njëkohësisht pezullimin e ekzekutimit të tij, në përputhje me dispozitat përkatëse (nenet 324-326 dhe 329) të KPC.

5.Ligji i Policisë Ndërtimore i vitit 1998 (ligji nr.8408 i 25 shtatorit 1998)

Ligji i Policisë Ndërtimore i vitit 1998 krijoi Policinë Ndërtimore e cila ishte përgjegjëse për shqyrtimin e pajtueshmërisë dhe ligjshmërisë së legjislacionit për planifikimin urban. Policia Ndërtimore kishte kompetenca për të vendosur gjoba dhe për të vendosur mbi pezullimin e punimeve të ndërtimit dhe për të urdhëruar shembjen e ndërtimeve të paligjshme (seksioni 3 dhe 5).

Ligji i Policisë Ndërtimore i vitit 1998 u shfuqizua në vitin 2007.

ANKIMET

Ankuesi ka bërë ankim kundër nenit 6 § 1 të Konventës, se procedimi para gjykatave vendase ka qenë i padrejtë deri tani pasi ato nuk kanë trajtuar arsyet e tij të apelimit dhe nuk kanë dhënë vendime të arsyetuara. Sipas nenit 1 të protokollit nr.1 të Konventës, ankuesi ka bërë ankim ndaj shkeljes së të drejtës së tij për gëzimin paqësor të pronave të tij duke marrë parasysh humbjen e pajisjeve nga lokali i tij i bar-kafesë.

LIGJI

1. Ankuesi pretendoi një shkelje të nenit 6 §1 të Konventës, për shkak të mosshqyrtimit të kërkesave të tij dhe mungesës së arsytimit të mjaftueshëm në vendimet e gjykatave vendase.

Pjesa përkatëse e nenit 6 § 1 të Konventës lexon:

“Në përcaktimin e të drejtave civile dhe detyrimeve të tij..... çdo person ka të drejtë të një seance dëgjimore ...të drejtë..... nga [një]gjykatë ...”

Qeveria ka argumentuar se apelimi kushtetues i ankuesit përmban kryesisht çështje fakti, që mbështeten në vlerësimin e provave. Ajo nuk i referohet ndonjë çështjeje për seancë të drejtë siç parashikohet në nenin 42 § 2 të Kushtetutës ose sipas nenit 6 § 1 të Konventës. Për këto arsye, Gjykata Kushtetuese e deklaroi apelimin kushtetues të ankuesit si të papranueshëm, duke qenë “jashtë juridiksionit të saj”. Si rrjedhojë, vendimi përfundimtar i gjykatave vendase është vendimi i Gjykatës së Lartë i 20 majit 2002. Për pasojë, ata konsiderojnë që ankimi duhet të deklarohet i papranueshëm, pasi është paraqitur jashtë afatit gjashtëmujor, duke pasur datën për paraqitje më 17 mars 2003.

Ankuesi parashtroi se, në përputhje me legjislacionin e brendshëm, ai ishte i detyruar të konsumonte të gjitha mjetet ligjore të brendshme para rekursit në këtë gjykatë. Në këto rrethana, ai apeloi në Gjykatën Kushtetuese për shkeljen e së drejtës së tij për një seancë të drejtë. Vendimi i papranueshmërisë së Gjykatës Kushtetuese, sipas mendimit të ankuesit, nuk mund të ndryshojë datën e vendimit përfundimtar të gjykatës vendase më 20 maj 2002.

Gjykata duhet të përcaktojë më parë nëse Gjykata Kushtetuese përbën një mjet ligjor të vlefshëm dhe efektiv për qëllim të nenit 6 të Konventës.

Gjykata vëren se sipas nenit 131 (f) të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese thirret për të shqyrtuar shkeljet e pretenduara të së drejtës për një seancë të drejtë në lidhje me të drejtat kushtetuese të ankuesit. Ky mjet ligjor është përjashtues në faktin se Gjykata Kushtetuese nuk thirret për të shqyrtuar themelin e një të drejte të Konventës, por për të shqyrtuar shkeljen e pretenduar të së drejtës për një seancë të drejtë mbi një të drejtë kushtetuese të caktuar. Brenda kësaj fushe veprimi të kufizuar, Gjykata Kushtetuese thirret për të shqyrtuar tërësinë e procedimit, nga procedimi i gjykatës së shkallës së parë deri në procedimin e Gjykatës së Lartë. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese, e cila ka kompetencë të prishë vendimet e gjykatave të shkallëve më të ulëta, është ligjërish detyrues dhe i zbatueshëm (shih Balliu k. Shqipërisë (dhjetor) nr. 4727/01, 30 shtator 2004). Gjykata, si rrjedhojë, konkludon se për qëllime të nenit 35 §1 të Konventës, një apelim kushtetues është një mjet efektiv dhe prandaj kërkohet për qëllime konsumimi në lidhje me të drejtën e ankuesit për një seancë të drejtë sipas nenit 6 të Konventës.

Gjykata rithekson se, gjithsesi, nuk është brenda kompetencës (specialitetit) së saj për të zëvendësuar vlerësimin e gjykatave vendase me vlerësimin e vet për faktet dhe, si rregull i përgjithshëm, u takon këtyre gjykatave të vlerësojnë provat e paraqitura para tyre. Detyra e Gjykatës

është të konstatojë nëse procedimi, në tërësinë e tij, duke përfshirë mënyrën në të cilën u morën provat, ishte i drejtë (shih, për shembull Grayson dhe Barnham k. Mbretërisë së Bashkuar, nr. 19955/05 dhe 15085/06 § 42, 23 shtator 2008).

Duke vlerësuar rrethanat e kësaj çështjeje në tërësi, Gjykata nuk gjen asnjë tregues se procedimi i kundërshtuar ishte kryer padrejtësisht.

Nga dosja e çështjes rezulton se ankuesi kishte përfitimin e procedimit kundërshtues. Ai ka bërë parashtrimet e tij në gjykatat vendase personalisht dhe gjykatat kombëtare vendosën mbi themelet e çështjes pas shqyrtimit dhe vlerësimit të të gjitha provave para tyre. Për atë kohë sa ankuesi kundërshton se nuk i është dhënë një kopje e urdhrit të shembjes, Gjykata vëren se ai ishte informuar për urdhrin e PN-së të 2 shkurtit 2000, si rezultat i të cilit ai apeloj pranë PNK-së. Meqë një apelim në PNK nuk ka efekt automatik pezullues për ekzekutimin e urdhrit të shembjes, ankuesi duhet të ishte në gjendje të parashikonte rrjedhën e veprimit që pritej në vend të largimit të pretenduar nga vendi. Për më tepër, ankuesi nuk kërkoi që PNK të miratonte masën e përkohshme në përputhje me nenin 78 të KPA-së, si rezultat i së cilës PNK do të ishte nxitur të vlerësonte dhe të shqyrtonte ekzistencën e “një dëmi serioz dhe të pariparueshëm”.

Gjykatat vendase interpretuan dhe aplikuan ligjin e vitit 1998 në lidhje me ndërtimet e përkohshme siç konsiderohej në atë kohë. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se, sipas rrethanave, vendimet e gjykatave vendase që trajtojnë paligjshmërinë e pretenduar të ndërtimit të përkohshëm ishin në përputhje me kërkesat e legjislacionit për planifikimin urban, duke përfshirë detyrimin për të marrë një leje ndërtimi të vlefshme për një vit. Mund të thuhet se vendimet e gjykatave vendase në çështjen e ankuesit u shërbenin interesave të së drejtës ligjore, e cila është një nga parimet themelore të shoqërisë demokratike dhe është e qenësishme në të gjitha nenet e Konventës (shih Amuur k Francës, 25 qershor 1996, § 50 raportet e gjytimeve dhe vendimeve 1996-III).

Gjykata vlerëson se arsyet faktike dhe ligjore për konkluzionet e gjykatave kombëtare u parashtruan në vendimet e gjykatës së rrethit të 30 marsit 2001 dhe gjykatës së apelit të 8 qershorit 2001. Arsyet e kufizuara të dhëna nga Gjykata e Lartë në vendimin e saj të 20 majit 2002, sidoqoftë, tregonin pa dyshim se ankuesi nuk ka ngritur një nga çështjet e ligjit të parashikuar nga dispozitat e brendshme përkatëse, e cila është një kërkesë e pranueshmërisë për dhënien e miratimit për apelim. Gjykata konstaton se kur Gjykata e Lartë refuzon të pranojë një çështje mbi bazat se arsyet ligjore për një çështje të tillë nuk janë paraqitur, një arsyetim mjaft i kufizuar mund të përmbushë kërkesat e nenit 6 të Konventës (shih *mutatis mutandis*, Nerva k Mbretërisë së Bashkuar (dhjetor) nr.42295/98, 11 korrik 2000). Për më tepër, meqë apelimi kushtetues i ankuesit përmbante të njëjtën bazë ligjore për apelim, si atë mbi të cilën ishte mbështetur para Gjykatës së Lartë, i njëjti arsyetim mund të thuhet se aplikohet në lidhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese të 27 shtatorit 2002.

Së fundi, Gjykata vëren se ankuesi nuk mundi të ngrinte para gjykatave kombëtare, të paktën në thelb, ndonjë ankim lidhur me retrospektivitetin e ligjit të vitit 1998.

Për arsyet e mësipërme, Gjykata vlerëson se ankimi i ankuesit sipas nenit 6 të Konventës është dukshëm i pabazuar brenda kuptimit të nenit 35 § 3 dhe, si rrjedhojë, i papranueshëm në përputhje me nenin 35 § 4 të Konventës.

2. Sipas nenit 1 të protokollit nr.1 të Konventës, ankuesi u ankua për shkelje të së drejtës së tij për gëzimin paqësor të pronës së tij, duke marrë në konsideratë humbjen e pajisjeve nga lokali i bar-kafesë së tij.

Neni 1 i protokollit nr.1 i Konventës lexon:

“Çdo person fizik dhe juridik ka të drejtë të gëzojë në mënyrë paqësore pronën e tij. Askush nuk do të privohet nga prona e tij përveç kur ka interes publik dhe është subjekt i kushteve të parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të ligjit ndërkombëtar.

Dispozitat pararendëse, sidoqoftë, nuk cenojnë në asnjë mënyrë të drejtën e një shteti për të zbatuar këto ligje siç e çmon të nevojshme për të kontrolluar përdorimin e pronës në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagesën e taksave ose kontributeve të tjera ose penaltiteve”.

Duke marrë parasysh konkluzionet sipas nenit 6 & 1 të Konventës, Gjykata përsërit se, për qëllime të nenit 35 § 1 të Konventës, një apelim kushtetues nuk është një mjet ligjor efektiv dhe

prandaj nuk kërkohet për qëllime konsumimi në lidhje me të drejtën e ankuesit për gëzim paqësor të pronës së tij. Vendimi i Gjykatës së Lartë do të konsiderohet përfundimtar për qëllime të nenit 35 § 1 të Konventës. Si rrjedhojë, ankimet mund të paraqiten brenda gjashtë muajve nga data e këtij vendimi.

Gjykata vlerëson se vendimi përfundimtar i gjykatës vendase në lidhje me ankimin e ankuesit sipas nenit 1 të protokollit nr.1 është vendimi i Gjykatës së Lartë të 20 majit 2002. Ankuesi e paraqiti këtë ankim më 17 mars 2003, që është më shumë se gjashtë muaj pas këtij vendimi. Rrjedhimisht, ai duhet të deklarohet i papranueshëm në përputhje me nenin 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës, pasi është paraqitur jashtë afatit.

Për këto arsye, Gjykata, njëzëri:

E deklaron ankimin të papranueshëm.

Fatos Araci
Zëvendësekretar

Nicolas Bratza
President

GJYKATA EUROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT
SEKSIONI KATËRT

ÇËSHTJA CAKA K. SHQIPËRISË

(Ankimi nr. 44023/02)

VENDIMI

STRASBOURG

8 dhjetor 2009

Ky vendim merr formë përfundimtare në rrethanat e parashikuara në nenin 44§ 2 të Konventës. Vendimi mund të jetë objekt rishikimesh redaktimi.

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (seksioni katërt), me trup gjykues të përbërë nga:

Nicolas Bratza, kryetar,

Lech Garlicki,

Giovanni Bonello,

Ljiljana Mijović,

Päivi Hirvelä,

Ledi Bianku,

Nebojša Vučinić, gjyqtarë,

and Lawrence Early, sekretar i seksionit,

pas shqyrtimit me dyer të mbyllura, më 17 nëntor 2009,

merr në këtë datë vendimin e mëposhtëm:

PROCEDURA

1. Çështja e ka zanafillën në një ankim (nr.44023/02) kundër Republikës së Shqipërisë depozituar pranë Gjykatës sipas nenit 34 të Konventës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore (Konventa) nga nënshtetasi shqiptar, z. Lulzim Caka (ankuesi), më 28 nëntor 2002.

2. Ankuesi i cili kishte përfituar ndihmë ligjore u përfaqësua nga z. P. Rama dhe z. B. Rusi, avokatë që ushtrojnë profesionin e tyre në Tiranë. Qeveria shqiptare (Qeveria) u përfaqësua nga agjentët e atëhershëm të saj znj. B. Bullica dhe znj. S. Meneri.

3. Ankuesi pretendonte shkelje të nenit 3 të Konventës për mungesë të ndihmës mjekësore të domosdoshme dhe të mjaftueshme në kohën që ai ishte i arrestuar, duke pasur parasysh dëmtimet serioze që ai kishte pësuar. Ai gjithashtu është ankuar sipas nenit 5 § 3 të Konventës, për kohëzgjatjen e periudhës së tij të paraburgimit. Sipas nenit 6 § 3 (c) dhe (d) të Konventës, ai është ankuar se i ishte mohuar e drejta e një procesi të rregullt gjyqësor.

4. Më 9 shkurt 2006, kryetari i seksionit të katërt të Gjykatës vendosi ta njoftojë Qeverinë për ankimin. Sipas dispozitave të nenit 29 § 3 të Konventës, u vendos që meritat e ankimit të shqyrtoheshin në të njëjtën kohë me pranueshmërinë e tij.

5. Secila nga palët, ankuesi dhe qeveria paraqitën vëzhgimet e tyre me shkrim (rregulli 59 § 1).

FAKTET

1. RRETHANAT E ÇËSHTJES

6. Ankuesi, z. Lulzim Caka, ka lindur në 1970 dhe aktualisht vuan dënimin në një burg në Tiranë, Shqipëri.

A. Ngjarjet që i paraprijnë arrestimit të ankuesit

1. Vrasja e P.

7. P. u vra më 21 korrik 1997. Në një datë të pacaktuar në 1997 kundër ankuesit u filluan hetimet penale. Gjatë këtyre hetimeve motra e viktimës, A., megjithëse nuk kishte qenë e pranishme në vendin e ngjarjes, ka deklaruar se ankuesi kishte vrarë vëllanë e saj. Ajo e bazonte dëshminë e saj në shpjegimet e tre dëshmitarëve, B., C. dhe D., të cilët rezultuan se u pyetën në një datë të pacaktuar.

8. Më 6 tetor 1998 policia gjyqësore, organi përgjegjës për drejtimin e hetimeve penale dhe identifikimin e autorit, propozoi që të pezulloheshin hetimet penale, meqenëse autori i krimit nuk

mund të identifikohet. Megjithatë, më 15 tetor 1998 prokurori depozitoi një padi kundër ankuesit pranë Gjykatës së Rrethit Berat (shiko paragrafin 17 më poshtë).

2. Vrasja e mbetur në tentativë e punonjësve të policisë

9. Në 1997 Shqipëria u godit nga trazirat civile, si rezultat i rënies së skemave piramidale. Depot e armëve u plaçkitën dhe një numër i konsiderueshëm armësh ranë në duart e popullsisë civile. Rivendosja graduale e rendit publik bënë të domosdoshme kontrolle të vazhdueshme të policisë. Rrjedhimisht, më 18 mars 1998 forcat policore të Beratit ngritën pika kontrolli për të ushtruar kontrolle për armëmbajtje pa leje. Pasdite herët në të njëjtën ditë, nëpunësit e policisë në detyrë, në pikën e kontrollit të vendosur në rrugën kryesore ndërmjet qyteteve Berat dhe Fier, qëlluan me armë ankuesin dhe X., një tjetër person që po ngiste motoçikletën bashkë me të. Si rezultat, X. vdiq dhe ankuesi u plagos rëndë.

10. Sipas të dhënave të policisë mbi incidentin, dy personat që po ngisnin një motoçikletë (të identifikuar më vonë si ankuesi dhe X.), nuk ndaluan kur në pikën e parë të kontrollit policia i urdhëroi të ndalonin. Policia në pikën e dytë të kontrollit, dëshmoi se ankuesi, i cili kishte qenë duke ngarë motoçikletën, ka qëlluar në drejtim të punonjësve të policisë me automatik dhe revolver njëkohësisht. Policia i është përgjigjur zjarrit dhe ka qëlluar për vdekje X.,-in, pasagjerin në ndenjësën e pasme të motoçikletës. Pavarësisht faktit që ankuesi ishte plagosur, ai ka vazhduar të qëllojë derisa është dorëzuar. Policia raportoi se ka mbledhur në vendngjarje dy automatikë “Kaleshnikov”, dy pistoleta, plumba dhe gëzhoja, motoçikletën, një maskë, një kapelë, një palë këpucë tenisi dhe gjëra të tjera që mendohet të jenë përdorur nga ankuesi dhe X. Rezulton që armët automatike, pistoletat, plumbat dhe gëzhojat janë dërguar për ekzaminim balistik.

B. Arrestimi i ankuesit

11. Më 18 mars 1998 ankuesi dhe një tjetër i dyshuar, E., u arrestuan në lidhje me ngjarjen e mësipërme (shih paragrafin 9-10 më lart).

12. Ankuesi u dërgua në spital, ku ai qëndroi për disa orë për trajtim mjekësor meqenëse ishte plagosur. Pas lirimit nga spitali, në të njëjtën ditë, ai u mbajt në arrest në Berat. Më 19 mars 1998 ankuesi u ekzaminua nga një mjek, i cili e vlerësoi gjendjen e tij shëndetësore përgjithësisht të kënaqshme. U konkludua se plagët që kishte marrë ankuesi ishin nën nivelin e plagëve të lehta të trupit që kërkonin jo më shumë se 9 ditë pushim.

13. Më 19 mars 1998 prokurori akuzoi ankuesin për vrasje të mbetur në tentativë në bashkëpunim me të tjerë dhe armëmbajtje pa leje. Gjatë marrjes në pyetje në të njëjtën ditë, ankuesi nuk ka dhënë asnjë të dhënë në lidhje me akuzat kundër tij. Ankuesi ka kërkuar prezencën e avokatit të tij, F.

14. Më 20 mars 1998 Gjykata e Rrethit Berat konfirmoi ligjshmërinë e arrestimit të ankuesit.

15. Më 8 prill 1998 prokurori vendosi të ndërpriste hetimet penale kundër E., duke vlerësuar që ai nuk kishte kryer asnjë vepër penale.

16. Më 9 qershor 1998, 22 shtator 1998 dhe 15 tetor 1998, i pyetur nga prokurori, ankuesi është mbrojtur dhe përfaqësuar nga G., një tjetër avokat i zgjedhur nga ai vetë.

17. Më 15 tetor 1998 prokuroria e Beratit depozitoi aktakuzën pranë Gjykatës së Rrethit Berat, duke e akuzuar ankuesin për vrasjen me paramendim të P. dhe vrasjen e mbetur në tentativë të punonjësve të policisë më 18 mars 1998. Rezultoi që u bashkuan të dy procedimet penale kundër ankuesit.

C. Procedurat e gjykimit

1. Procesi gjyqësor pranë Gjykatë së Rrethit Berat

18. Gjykata e Rrethit Berat filloi gjykimin kundër ankuesit më 17 nëntor 1998. Trembëdhjetë seanca gjyqësore janë mbajtur ndërmjet datave 17 nëntor 1998 dhe 13 prill 1999, datë në të cilën procesi gjyqësor iu kalua Gjykatës së Rrethit Fier (shih transferimi i procesit gjyqësor seksioni më poshtë). Shtatë seanca gjyqësore janë shtyrë për shkak të mungesës së prokurorit, ankuesit apo avokatit të tij mbrojtës. Në gjashtë seancat gjyqësore të mbetura, ankuesi është përfaqësuar nga avokati i tij, G.

19. Ankuesi ka kontestuar faktet e paraqitura nga prokuroria. Ai ka dëshmuar se ka qenë i paarmatosur duke ngarë motoçikletën kur forcat e policisë në pikën e dytë të kontrollit kanë hapur zjarr, pa e urdhëruar atë të ndalojë. Gjithashtu ai i ka kërkuar gjykatës të thërrasë dëshmitarët që, në momentin e incidentit, kanë qenë duke udhëtuar në të njëjtën rrugë.

20. Në seancat gjyqësore më 23 dhjetor 1998 dhe 6 janar 1999, katër dëshmitarë të cilët kanë qenë duke udhëtuar në të njëjtën rrugë dhe e kanë parë ankuesin kur po ngiste motoçikletën, kanë dëshmuar se ankuesi nuk kishte asnjë armë me vete.

2. Transferimi i procesit gjyqësor

21. Më 15 shkurt 1999 prokurori depozitoi një kërkesë pranë Gjykatës së Lartë për transferimin e procesit gjyqësor nga Gjykata e Rrethit Berat, kundër ankuesit. Ai argumentoi se për arsye të gjendjes së pasigurisë në Berat, dëshmitarët nguronin për të dëshmuar në gjyq. Gjithashtu ai përmendi ekzistencën e presionit të formave të ndryshme, madje edhe kërcënime për jetë të prokurorit në lidhje me rezultatin e procesit gjyqësor.

22. Më 5 mars 1999 Gjykata e Lartë lejoi transferimin e procesit gjyqësor nga Gjykata e Rrethit Berat në Gjykatën e Rrethit Fier, në përputhje me nenin 94 të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

23. Sipas nenit 97 § 3 të KPP-së, Gjykatës së Rrethit Fier iu kërkuar të merrte një vendim në lidhje me vlefshmërinë e veprimeve të kryera nga Gjykata e Rrethit Berat. Një vendim i tillë nuk është përfshirë në dosjen e çështjes. Qeveria ka parashtruar se dosja e çështjes dhe veprimet e kryera nga Gjykata e Rrethit Berat janë konsideruar të vlefshme mbi bazën e një vërtetimi të datës 9 mars 1999 të nxjerrë nga sekretarja e Gjykatës së Rrethit Fier.

3. Procesi gjyqësor pranë Gjykatës së Rrethit Fier

24. Më 25 maj 1999 ankuesi caktoi një tjetër avokat mbrojtës me zgjedhjen e tij, H.-në.

25. Më 26 maj 1999 Gjykata e Rrethit Fier filloi gjykimin e ankuesit. Njëzet e katër seanca gjyqësore janë kryer ndërmjet datave 26 maj 1999 dhe 11 maj 2000, datë në të cilën ankuesi u shpall fajtor për veprat penale dhe u dënua me burgim.

26. Nga data 26 maj deri më 27 nëntor 1999 janë planifikuar dhjetë seanca gjyqësore, por janë shtyrë për arsye të mungesës së ankuesit apo përfaqësuesit të tij. Asnjë dëshmitar nuk u dëgjua dhe asnjë masë tjetër procedurale nuk është marrë. Më 9 nëntor 1999 gjykata njoftoi ankuesin që ai mund të caktonte një avokat tjetër mbrojtës duke pasur parasysh mungesën e përsëritur të avokatit tij H.

27. Më 8 dhjetor 1999 ankuesi revokoi prokurën e H.-së. Nga 8 dhjetor 1999 deri më 7 shkurt 2000, periudhë gjatë së cilës u mbajtën pesë seanca gjyqësore, ankuesi u përfaqësua vetë. Asnjë dëshmitar nuk u paraqit apo nuk u pyet në këto seanca gjyqësore, si rezultat i të cilave ato u shtynë. Më 7 shkurt 2000 prokuroria lexoi dëshmitë e dëshmitarëve që ishin marrë gjatë hetimeve penale. Ankuesi kundërshtoi deklaratat e dëshmitarëve B. dhe D. Në të njëjtën ditë ankuesi ricaktoi avokatin e tij mbrojtës të mëparshëm, H. Gjykata vendosi të pyesë dëshmitarin A. në seancën tjetër gjyqësore më 21 shkurt 2000 në prani të avokatit të ankuesit.

28. Më 21 shkurt 2000 gjyqi dëgjoi dëshminë e A., e cila deklaroi që ankuesi ishte vrasësi i vëllait të saj P. Ajo u bazua në deponimin e dëshmitarëve B., C. dhe D. Ajo nuk ka qenë dëshmitare në vendin e ngjarjes. As ankuesi dhe as avokati i tij, H., nuk e kanë pyetur A. Më tej me kërkesë të ankuesit, Gjykata e Rrethit Fier ka lëshuar disa fletëthirrje për paraqitjen e B., C dhe D. Megjithatë dëshmitarët nuk u paraqitën asnjëherë në gjyq.

29. Në seancën gjyqësore më 23 shkurt 2000 ankuesi caktoi I. si avokatin e tij mbrojtës bashkë me H.-në. Tre punonjës të policisë K., L. dhe M. dëshmuan në gjyq. Bazuar në mospërputhjen nga dëshmia e M.-së në fazën hetimore dhe procesin gjyqësor, prokurori kërkoi leje për të kundërshtuar dëshminë në përputhje me nenin 362 të KPP-së duke lexuar deklaratën e tij bërë gjatë hetimeve penale.

Ndërsa ankuesi dhe avokati I. nuk pyetën fillimisht M., ato kërkuar që ai të pyetej pas leximit të dëshmisë së tij. Gjykata e Rrethit refuzoi kërkesën e tyre meqenëse ato fillimisht kishin hequr dorë nga e drejta e tyre për të pyetur dëshmitarin.

30. Më 1 mars 2000 avokati I. i ankuesit i kërkoi gjykatës të thërriste M. për ta pyetur. Ai e përsëriti kërkesën në seancën gjyqësore më 6 mars. Në të njëjtën datë gjykata refuzoi kërkesën si të pabazuar. Megjithatë ajo lejoi kërkesën e avokatit për të thirrur katër punonjës të tjerë policie N., O., Q. dhe S.

31. Më 15 dhe 21 mars avokati i ankuesit ka përsëritur kërkesën e tij për të thirrur dhe pyetur M.-në. Më 21 mars gjykata ka refuzuar kërkesën si të pabazuar. Ajo gjykoi që M. ka ndjekur një seancë gjyqësore në të cilën i akuzuari dhe avokati i tij kanë pasur mundësinë t'i bënin pyetje atij. Në të njëjtën datë, gjykata ka dëgjuar punonjësën e policisë N. Ankuesi është përfaqësuar nga avokati i tij I. Dëshmitarët O., Q. dhe S. nuk janë paraqitur, si dhe nuk janë pyetur asnjëherë në gjyq, megjithë thirrjet e përsëritura dhe njoftimin dërguar nga gjykata autoriteteve përkatëse, si Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Brendshme dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë.

32. Më 18 prill 2000 avokati mbrojtës I. i ankuesit u tërhoq nga përfaqësimi i tij. Avokati tjetër mbrojtës H. i ankuesit, mungonte. Gjykata vendosi të shtyjë seancën gjyqësore më 3 maj 2000.

33. Më 26 prill 2000 avokati mbrojtës H. i ankuesit u tërhoq nga përfaqësimi i ankuesit. Arsyet kishin të bënin me përfshirjen e tij në çështje të tjera penale. Ai gjithashtu përmendi parregullsitë procedurale të kryera nga Gjykata e Rrethit Fier, e cila nuk i kishte dërguar thirrje me shkrim atij për t'u paraqitur në seancat gjyqësore. Ai ka pretenduar se gjykata nuk ka shfaqur paanshmëri. Ai i ka kërkuar gjykatës të procedojë në përputhje me seksionin 49 § 5 i KPP-së.

34. Më 3 maj 2000 ankuesi ka caktuar një tjetër avokat mbrojtës me zgjedhjen e tij, J. Gjykata vendosi të shtyjë procesin gjyqësor deri më 11 maj 2000.

35. Më 11 maj 2000 gjykata ka lexuar një faks të marrë nga avokati mbrojtës J., i ankuesit, i cili deklaronte se përfshirja e tij në biznese të tjera nuk mundësonte mbrojtjen nga ana e tij të ankuesit. J. ka deklaruar se ai nuk kishte marrë asnjë kërkesë për të përfaqësuar ankuesin. Bazuar në procesverbalin e seancës gjyqësore, ankuesi dëshironte të bënte vetë mbrojtjen e tij. Ai ka deklaruar se ai nuk ka pasur asnjë armë më 18 mars 1998. Ai ka rënë dakord që të lexohen dëshmitë e dëshmitarëve Q., R. dhe S. të marra gjatë hetimeve penale, si dhe ka hequr dorë nga e drejta për të pyetur dëshmitarin O. Prokurori ka proceduar me leximin e dëshmiave të dëshmitarëve të sipërpërmendur. Më tej ai ka konkluduar me parashtrimet e tij përfundimtare. Ankuesi për rrjedhojë ka deklaruar se ai nuk i pranonte akuzat meqenëse as nuk kishte vrarë P.-në, dhe as nuk kishte qëlluar punonjësën e policisë.

36. Në të njëjtën ditë Gjykata e Rrethit Fier ka dhënë dënimin, duke e shpallur ankuesin fajtor sipas akuzave dhe e dënoi me njëzet e pesë vjet burgim.

37. Në lidhje me akuzën e vrasjes së mbetur në tentativë të punonjësve të policisë, Gjykata e Rrethit Fier e ka bazuar vendimin e saj në dëshmitë e katër punonjësve të policisë K., L., M. dhe N. dhënë në seancat gjyqësore më 23 shkurt dhe 6 mars 2000 (shih 29 dhe 31 më lart), si dhe në deklaratat e dy dëshmitarëve të dhëna gjatë hetimeve penale. Gjykata mori parasysh raportin hetimor të vendit të ngjarjes, raportin e arrestimit të ankuesit, si dhe raportin balistik.

38. Në lidhje me këtë, gjykata gjithashtu shpalli ankuesin fajtor për armëmbajtje pa leje mbi bazën e raportit balistik, duke shtuar që gëzhojat e gjetura në vendin e ngjarjes janë qëlluar nga armët e gjetura pranë të akuzuarit. Megjithatë, në vendimin e marrë nuk është përmendur nëse armët ishin në posedimin aktual të ankuesit.

39. Në lidhje me vrasjen e P.-së, më 21 korrik 1997, Gjykata e Rrethit Fier e bazoi arsyetimin e saj në dëshminë e A.-së dhënë në gjyq, si dhe në deklaratat e dëshmitarëve B., C., dhe D. dhënë gjatë hetimeve penale (shih paragrafët 7, 27 dhe 28 më lart).

D. Procedimet e apelimit

40. Më 16 maj 2000 ankuesi bëri apel kundër dënimit të tij pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, duke pretenduar shkelje të së drejtës së tij për një proces të rregullt gjyqësor. Në veçanti, ai ka argumentuar se mungesa e ndihmës ligjore gjatë gjyqimit dhe fakti që gjykata e shkallës së parë ka pranuar deklaratat e dëshmitarëve pa dhënë mundësinë e pyetjeve nga pala kundërshtare, përbënte shkelje të së drejtës së procedurave kundërshtuese. Për më tepër, atij i është privuar e drejta për të pyetur dëshmitarin M., i cili ka dëshmuar në seancën gjyqësore më 23 shkurt 2000. Gjithashtu ai ka

argumentuar se, gjatë fazës kur palët kanë bërë parashtrimet e tyre përfundimtare, ai nuk është ndihmuar nga avokati mbrojtës. Ankuesi është përfaqësuar në Gjykatën e Apelit nga I., i cili më parë ishte tërhequr nga çështja më 18 prill 2000 (shih paragrafin 32 më lart).

41. Më 20 tetor 2000 Gjykata e Apelit Vlorë hodhi poshtë kërkesën e ankuesit dhe miratoi vendimin e Gjykatës së Rrethit Fier. Meqenëse apelimi drejtohej kundër refuzimit të gjykatës së Rrethit për të lejuar ankuesin të pyesë dëshmitarin M., gjykata e apelit vërejti që gjatë seancës gjyqësore më 23 shkurt 2000 avokati mbrojtës i ankuesit ka dëshmuar se nuk kishte pyetje për të bërë. Ankuesi i ka bërë dëshmitarit vetëm një pyetje, së cilës ky i fundit i është përgjigjur. Gjykata e Apelit ka rrëzuar ankesën e ankuesit për mungesë të ndihmës ligjore në seancën gjyqësore përfundimtare, bazuar në deklaratën e tij se ai dëshironte të bënte vetë mbrojtjen e vet.

42. Më 6 mars 2001 ankuesi i bëri apel Gjykatës së Lartë, bazuar në të njëjtat argumente që kishte bërë pranë Gjykatës së Apelit. Ai shtoi se procesverbali i seancës gjyqësore datë 11 maj 2000 ishte falsifikuar nga Gjykata e Rrethit Fier, duke argumentuar se kërkesa e tij për t'u mbrojtur nga një avokat ishte shtrembëruar për t'u lexuar se ai dëshironte të mbrohej vetë.

43. Më 16 tetor 2001 Gjykata e Lartë deklaroi ankimin e tij të papranueshëm, meqenëse argumentet e tij ishin jashtë fushës së nenit 432 të KPP-së.

44. Më 22 tetor 2003 ankuesi depozitoi një ankesë pranë Gjykatës Kushtetuese për parregullsinë e procedimeve. Ai u ankua për kohëzgjatjen e periudhës së paraburgimit të tij dhe u bazua në nenin 6§ 3 “b” dhe “c” dhe “d” të Konventës.

45. Më 18 nëntor 2003 Gjykata Kushtetuese, mbledhur në trup gjykues, e përbërë nga tre gjyqtarë, deklaroi ankimin të papranueshëm. Ajo argumentoi se ankimi i ankuesit nuk ngrinte çështje të një procesi të rregullt ligjor, por lidhej me vlerësimin e provave, gjë që kishte të bënte me gjykatat më të ulëta.

E. Parashtrime të mëtejshme

46. Më 6 janar 2003 ankuesi depozitoi pranë Gjykatës një deklaratë të noterizuar nga B.H., gjyqtari që kishte kryesuar trupin gjykues në Gjykatën e Rrethit Berat në procesin gjyqësor. Sipas B.H., procedimet janë transferuar në Gjykatën e Rrethit Fier, në dëm të ankuesit, në një kohë kur Gjykata e Rrethit Berat ishte pranë mbylljes së shqyrtimit të çështjes dhe dukej se po arrinte në përfundimin se nuk kishte prova të mjaftueshme kundër tij. Për më tepër, B.H. mbron mendimin se Gjykata e Rrethit Fier kishte pranuar deklaratat e dëshmitarëve të marra në komisariatet e policisë më shumë se deklaratat e marra gjatë gjykimit pranë Gjykatës së Rrethit Berat. Gjithashtu ai argumentonte se Gjykata e Rrethit Fier nuk kishte marrë në konsideratë raportin balistik të paraqitur gjatë gjykimit pranë Gjykatës së Rrethit Berat, nga ku vërtetohej që armët automatike që pretendoheshin se ishin përdorur nga ankuesi, në fakt, i përkisnin forcave të policisë Berat. Për më tepër, ai deklaroi se avokatët mbrojtës të ankuesit ishin tërhequr nga mbrojtja e tij gjatë gjykimit pranë Gjykatës së Rrethit Fier për shkak të kërcënimeve të jetëve të tyre, si dhe familjeve të tyre.

47. Gjithashtu ankuesi depozitoi katër deklarata të noterizuara bërë nga dëshmitarë okularë që kishin qenë prezent disa minuta para incidentit dhe kishin parë ankuesin të paarmatosur duke ngarë motoçikletën dhe kishin dëgjuar të shtënat e policisë. Të njëjtët dëshmitarë okularë dëshmuuan pranë Gjykatës së Rrethit Berat, më 23 dhjetor 1998 dhe 6 janar 1999 (shih paragrafin 20 më lart).

48. Më 28 prill 2008 Gjykata i kërkoi Qeverisë të paraqiste të gjithë dosjen hetimore dhe raportet e lexueshme të të gjitha seancave gjyqësore pranë gjykatave të rretheve. Më 31 korrik 2008 Qeveria paraqiti raportet e të gjitha seancave gjyqësore të mbajtura pranë gjykatave të rretheve. Asnjë dokument nga dosja hetimore nuk është paraqitur.

II. E DREJTA E BRENDSHME PËRKATËSE

A. Kushtetuta

49. Dispozitat përkatëse të Kushtetutës shqiptare parashikojnë:

Neni 31

Gjatë procedimit penal, kushdo ka të drejtë:

- a) të vihet në dijeni menjëherë dhe hollësisht për akuzat e ngritura kundër tij, të drejtat e tij, si dhe t'i krijohet mundësia për të njoftuar familjen ose të afërmit;
- b) të ketë kohën dhe mjetet e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e vet;
- c) të ketë ndihmën pa pagesë të një përkthyesi, kur nuk flet ose nuk kupton gjuhën shqipe;
- ç) të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij, të komunikojë lirshëm dhe privatisht me të; si dhe t'i sigurohet mbrojtja falas, kur nuk ka mjete të mjaftueshme;
- d) t'u bëjë pyetje dëshmitarëve të pranishëm dhe të kërkojë paraqitjen e dëshmitarëve, ekspertëve dhe personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.

Neni 32

1. Askush nuk mund të detyrohet të dëshmojë kundër vetvetes ose familjes së vet dhe as të pohojë fajësinë e tij.
2. Askush nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme.

Neni 33

1. Kushdo ka të drejtë të dëgjohet para se të gjykohej.
2. Nga kjo e drejtë nuk mund të përfitojë personi që i fshihet drejtësisë.

Neni 42 § 2

Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave ligjore dhe kushtetuese, lirive dhe interesave ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

Neni 131

Gjykata Kushtetuese vendos:...

f) gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt gjyqësor, pasi të jenë ezauruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

B. Kodi i Procedurës Penale

50. Kur kërkohet prania e mbrojtësit ligjor dhe mbrojtësi i zgjedhur ose i caktuar nuk është i siguruar, nuk është paraqitur ose ka lënë mbrojtjen, gjykata ose prokurori cakton si zëvendësues një mbrojtës tjetër, i cili ushtron të drejtat dhe merr përsipër detyrimet e mbrojtësit.

51. Nenet 94 deri 97 përcaktojnë transferimin e procedimeve. Sipas formulimit të nenit 94, në fuqi në kohë materiale, në ç'do fazë dhe nivel gjatë gjykimit, kur siguria publike apo vullneti i lirë i njerëzve për të marrë pjesë në një gjykim dëmtohen nga ngjarje lokale të rënda të cilat mund të ndikojnë në kryerjen e gjykimit dhe që nuk mund të shmanget nga mënyra të tjera, Gjykata e Lartë, me kërkesë të arsyeshme të prokurorit ose të pandehurit, mund t'ia transferojë çështjen një gjykate tjetër.

Neni 97 parashikon që Gjykata e Lartë vendos në fshehtësi. Vendimi për të lejuar që një kërkesë për çështjen që do transferohet, i bëhet i ditur gjykatës në të cilën janë kryer procedimet, si dhe gjykatës së cilës do t'i transferohen procedimet. Gjykata e cila i ka kryer procedimet më parë duhet t'i transferojë menjëherë dokumentet procedurale gjykatës së caktuar dhe urdhëron njoftimin e vendimit të Gjykatës së Lartë prokurorit, të pandehurit dhe palëve private. Neni 97 § 3 deklaron që gjykata e caktuar nga Gjykata e Lartë jep vendimin nëse veprimet e kryera janë të vlefshme, si dhe shtrirjen e vlefshmërisë së tyre.

52. Sipas nenit 362 § 1 në fuqi në kohë materiale, me qëllim që pjesërisht apo tërësisht të kundërshtohet përmbajtja e dëshmisë ose kur dëshmitari refuzon të dëshmojë, palët mund të përdorin

deklaratat që janë dhënë paraprakisht nga dëshmitarët pranë prokurorit apo policisë gjyqësore, deklarata të cilat gjenden në dosjen e çështjes, por vetëm pasi dëshmitari ka dëshmuar për faktet dhe rrethanat që mund të kontestohen. Neni 362 § 2 përcakton se këto deklarata nuk përbëjnë të dhëna për faktet në lidhje me këtë rast, por ato mund të shqyrtohen nga gjykata me qëllim që të përcaktohet besueshmëria e personit në fjalë dhe janë pjesë përbërëse e dosjes së çështjes.

53. Neni 425 përcakton fushën e shqyrtimit të apelimit nga gjykata e apelit. Ai parashikon që shqyrtimi i çështjes nga gjykata e apelit nuk kufizohet në argumentet e apelit, por shtrihet në tërë çështjen.

54. Sipas nenit 427, me kërkesën e palës, gjykata e apelit ka autoritetin të rishqyrtojë drejtpërdrejt të dhëna të mëparshme dhe materiale të reja shtesë, nëse e quan të domosdoshme.

55. Neni 428 përcakton vendimet që mund të merren nga gjykata e apelit. Ai parashikon që gjykata e apelit mund të vendosë të pezullojë apelimin dhe të miratojë vendimin, të ndryshojë vendimin, të shfuqizojë vendimin dhe të përfundojë procedimet penale, ose të shfuqizojë vendimin dhe ta kalojë çështjen për gjykim të ri.

56. Vendimet e gjykatës së apelit mund të ankimohen pranë Gjykatës së Lartë në përputhje me një nga kërkesat e mëposhtme të nenit 432: a) e drejta penale nuk është respektuar apo është zbatuar gabimisht; b) ka pasur shkelje, të cilat kanë rezultuar në deklarimin e vendimit të gjykatës të pavlefshëm në përputhje me nenin 128 të këtij Kodi; c) ka pasur shkelje të rregullave procedurale, të cilat kanë ndikuar në marrjen e vendimit.

57. Neni 434 parashikon që Gjykata e Lartë shqyrton apelimin në rastet kur pikat e së drejtës janë ngritur për këtë problem.

E DREJTA

58. Ankuesi ka ankuar sipas nenit 3 të Konventës për pamjaftueshmërinë e trajtimit mjekësor që ai ka marrë gjatë periudhës së paraburgimit. Ai i është referuar plagëve që ka pësuar në konfrontimet me policinë, më 18 mars 1998. Neni 3 shprehet si më poshtë:

“Askush nuk duhet t’i nënshtrohet torturës ose trajtimit çnjerëzor e degradues apo dënimit”.

59. Ankuesi gjithashtu u ankua për kohëzgjatjen e mbajtjes së tij në arrest. Gjykata shqyrton kërkesën e tij sipas nenit 5 § 3 të Konventës që lexohet si më poshtë:

“Çdokush i arrestuar apo i ndaluar në përputhje me dispozitat e paragrafit 1 (c) të këtij neni ka të drejtën ... e gjyqësorit brenda një periudhe kohe të arsyeshme apo të lirohet në pritje të gjyqësorit. Lirimi mund të kushtëzohet me garancitë për t’u paraqitur për gjykim”.

60. Ankuesi u ankua më tej sipas nenit 6 § 3 (c) dhe (d) të Konventës se atij i ishte mohuar e drejta e një procesi të rregullt ligjor, meqë ai nuk ishte mbrojtur siç duhet nga një avokat dhe që nuk kishte mundur të pyeste dëshmitarët apo të siguronte paraqitjen e dëshmitarëve në emër të tij. Pjesa përkatëse e nenit 6 të Konventës lexohet si më poshtë:

1. Në përcaktimin e çdo akuze penale kundër tij çdo kush ka të drejtën e një procesi ...të rregullt ...gjyqësor nga ...gjykata...;

3. Çdokush i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:

c) të mbrojë veten privatisht apo nëpërmjet ndihmës ligjore, me zgjedhjen e tij ose, nëse nuk ka mjetet e nevojshme për të paguar ndihmën ligjore t’i paguhet falas, nëse e kërkojnë interesat e drejtësisë;

d) të pyesë apo të ketë pyetur dëshmitarët kundër tij dhe të sigurojë ndjekjen dhe pyetjen e dëshmitarëve në emër të tij në të njëjtat kushte me ato të dëshmitarëve kundër tij.

...

PRANUESHMËRIA E ANKIMEVE

A. Ankimi rreth mungesës së trajtimit mjekësor të mjaftueshëm gjatë periudhës së paraburgimit

61. Qeveria parashitroi se ankuesi nuk kishte mundur të paraqiste ankimet e tij në gjykatat e brendshme sipas nenit 3 të Konventës dhe se kjo pjesë e ankimit për rrjedhojë duhet të shpallet e papranueshme për mosezaurim të mjeteve të brendshme ligjore.

62. Në vëzhgimet e tij ankuesi pohoi se atij nuk i ishte siguruar trajtim mjekësor i mjaftueshëm në qelitë e paraburgimit në Berat.

63. Gjykata rithekson se rregulli i shterimit të mjeteve të brendshme ligjore i përmendur në nenin 35 të Konventës, detyron ata që kërkojnë të paraqesin çështjen e tyre kundër shtetit para Gjykatës, të përdorin fillimisht mjetet e parashikuara nga sistemi ligjor kombëtar (shih Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar, 7 dhjetor 1976, § 48, seria A nr. 24). Ankimet duhet të ishin depozituar pranë organit përkatës të brendshëm, të paktën në thelb dhe në përputhje me kërkesat formale dhe afatet kohore të përcaktuara në ligjin e brendshëm dhe më tej, që duhet të ishte përdorur çdo mjet procedural, i cili mund të parandalonte shkeljen e Konventës (shih Cardot kundër Francës 19 mars 1991, § 34, seria nr. 200).

64. Gjykata vëren se nuk ka informacion që ankuesi të ketë bërë ankime kundër policisë pranë autoritetit përkatës të brendshëm administrativ, për shembull prokurorisë, rreth pamundësisë për t'i siguruar atij trajtim mjekësor të mjaftueshëm gjatë periudhës së paraburgimit. Ajo vëren më tej se ankuesi nuk paraqiti ndonjë ankim të ngjashëm, të paktën në thelb, në procedimet e gjyqimit dhe apelit.

65. Duke marrë parasysh sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se ankuesi nuk arriti të ezauronte mjetet e brendshme ligjore të parashikuara nga sistemi i brendshëm ligjor. Rrjedhimisht, ajo rrëzon ankimin e ankuesit në përputhje me nenin 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës.

B. Ankimi rreth kohëzgjatjes së paraburgimit

66. Qeveria argumentoi se kohëzgjatja e paraburgimit të ankuesit ka qenë në përputhje me afatet kohore të parashikuara në legjislacionin e brendshëm dhe nenin 5 § 3 të Konventës. Ata këmbëngulën se kundërshtimi i ankuesit ndaj kohëzgjatjes së paraburgimit të tij ishte rrëzuar nga gjykatat e brendshme të të gjitha niveleve.

67. Ankuesi pohoi se paraburgimi i tij kishte zgjatur më shumë se afatet kohore të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale dhe ishte në shkelje të nenit 5 § 3 të Konventës.

68. Gjykata rithekson se paraburgimi përfundon për qëllimet e Konventës me shpalljen e fajësisë dhe dënimin e vendosur në shkallën e parë (shih B. kundër. Austrisë, 28 mars 1990, §§ 34 – 40, seria A nr. 175; Solmaz kundër Turqisë, nr. 27561/02, § 26, ECHR 2007-....., (ekstrakte).

69. Gjykata vëren se paraburgimi i ankuesit filloi më 18 mars 1998. Ai zgjati deri në 11 maj 2000, datë në të cilën Gjykata e Rrethit Fier dha vendimin e saj, duke e dënuar ankuesin. Pas asaj date, ankuesi nuk u përfshi në ndonjë mjet ligjor efektiv të synuar për kundërshtimin e kohëzgjatjes së paraburgimit të tij. Apeli i tij kushtetues nuk mund të konsiderohet si një mjet ligjor efektiv për qëllim të nenit 5 të Konventës (shih, në të kundërt, paragrafin 74 më poshtë në lidhje me nenin 6).

70. Ankimi i ankuesit u depozitua në Gjykatë më 28 nëntor 2002, më shumë se gjashtë muaj pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Fier.

71. Në këto rrethana, Gjykata çmon se ankuesi ka dështuar të respektojë rregullin e gjashtëmujorit. Rezulton që kjo pjesë e kërkesës duhet të hidhet poshtë sipas nenit 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës.

C. Ankimet rreth mungesës të së drejtës për avokat dhe pamundësia e marrjes në pyetje të dëshmitarëve

72. Qeveria këmbënguli se ky ankim ishte i papranueshëm pasi ishte depozituar më vonë se periudha gjashtëmujore sipas nenit 35 § 1 të Konventës. Kështu, për shkak të vendimit të Gjykatës Kushtetuese mbi papranueshmërinë të datës 18 nëntor 2003, mjeti ligjor përfundimtar efektiv në kuptim të asaj dispozite ishte në fakt vendimi i Gjykatës së Lartë i datës 16 tetor 2001, ndërsa ankuesi kishte bërë kërkesën e tij më 28 nëntor 2002.

73. Ankuesi parashtroi në përgjigje, duke iu referuar nenit 131 (f) të Kushtetutës dhe praktikës së Gjykatës Kushtetuese, se me qëllim që të ezauronte të gjitha mjetet ligjore të brendshme, ankimet individuale duhet të depozitoheshin pranë Gjykatës Kushtetuese nëse dhe kur ata dyshonin për një shkelje të të drejtës për gjykim të drejtë. Për më tepër, ai u mbështet në vendimin e Gjykatës mbi pranueshmërinë, të marrë në çështjen Balliu kundër Shqipërisë (vendimi), nr. 74727/01.

74. Gjykata rithekson përfundimet e saj në çështjen Balliu kundër Shqipërisë. (vendimi) nr. 74727/01), i konfirmuar më pas në vendimin Beshiri etj., kundër Shqipërisë, (nr. 7352/03, § 32, 22 gusht 2006), ku ajo vendosi se një ankim pranë Gjykatës Kushtetuese konsiderohet mjet ligjor efektiv që duhet të përdoret për qëllime të nenit 35 të Konventës, ku lindën çështje të gjykimit të drejtë. Ajo vëren se e drejta e të paditurit për avokat, duke përfshirë të drejtën për të thirrur dhe marrë në pyetje dëshmitarët, përbën një element të rëndësishëm dhe thelbësor të gjykimit të drejtë të garantuar sipas nenit 6 të Konventës (shih paragrafin 60 më lart dhe 77 në vijim më poshtë). Ajo çmon se nuk ka arsye për të devijuar rrethanat e çështjes në fjalë nga përfundimi i saj në çështjen Beshiri etj.

75. Ankuesi në fakt përfitoi nga ky mjet ligjor. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese është i datës 18 nëntor 2003 dhe ankuesi e depozitoi ankimin e tij më 28 nëntor 2002. Gjykata çmon se nuk lind asnjë problem në lidhje me respektimin e afatit kohor gjashtëmuor të parashikuar në nenin 35 në lidhje me ankimet e tij rreth padrejtësisë së gjykimit të tij. Për këto arsye, Gjykata hedh poshtë kundërshtimin e Qeverisë.

76. Gjykata çmon se ankimet e ankuesit sipas nenit 6 § 3 (c) dhe (d) ngrenë çështje të faktit dhe ligjit që janë mjaft serioze që përcaktimi i tyre duhet të varet nga shqyrtimi në themel. Nuk është paraqitur asnjë arsye tjetër për shpalljen e tyre të papranueshme. Rrjedhimisht, Gjykata i shpall këto ankime të papranueshme. Në përputhje me vendimin e saj për të zbatuar nenin 29 § 3 të Konventës (shih paragrafin 4 më lart), Gjykata tashmë do t'i shqyrtojë këto ankime në themel.

II. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 6 TË KONVENTËS

77. Gjykata në fillim rithekson se kërkesat e paragrafit 3 (c) dhe (d) të nenit 6 duhet të shihen si aspekte të veçanta të së drejtës për gjykim të drejtë të garantuara nga paragrafi 1. Për këtë arsye, Gjykata e çmon të nevojshme të shqyrtojë ankimet e ankuesit nga pikëpamja e paragrafit 3, të marra së bashku me parimet e mishëruara në paragrafin 1. Gjykata shqyrton, në përputhje me praktikën e saj normale, nëse procedimet ishin në tërësi të drejta (shih Van Geyseghe kundër Belgjikës [GC], nr. 26103/95, § 27, ECHR 1999-I, dhe Balliu kundër Shqipërisë, nr. 74727/01, § 25, 16 qershor 2005).

A. Shkelja e pretenduar e nenit 6 § 1 në lidhje me nenin 6 § 3 (c)

1. Parashtrimet e palëve

78. Ankuesi fillimisht pretendoi se në procedimet ligjore ai nuk ishte përfaqësuar nga një avokat gjatë fazave të gjykimit të tij, siç kërkohej nga nenet 6 §§ 1 dhe 3 (c) të Konventës.

79. Ankuesi kundërshtoi vërtetësinë e procesverbalit të seancës gjyqësore të datës 11 maj 2000 që supozohej të deklaronte se ai kishte rënë dakord “të vetëmbrohej”. Ai shtoi se, meqë parashtrimet përfundimtare ishin bërë në gjykatën e rrethit në atë seancë gjyqësore, ai nuk kishte njohurinë minimale ligjore për t'u vetëmbrojtur personalisht dhe për të nxjerrë përfundime të formës së prerë mbi akuzat penale të ngritura kundër tij.

80. Ankuesi vërejti se gjykata e rrethit nuk garantoj caktimin e një avokati tjetër me zgjedhjen e saj, sipas seksionit 49 § 5 të Kodit të Procedurës Penale. Gjykata e brendshme gjithashtu nuk kishte marrë masa disiplinore në lidhje me avokatin mbrojtës të ankuesit për pamundësinë e tyre të vazhdueshme për t'u paraqitur në seanca gjyqësore gjatë gjykimit.

81. Qeveria rrëzoi pretendimet e ankuesit. Ata këmbëngulën se që nga koha kur filloi hetimi, ankuesi kishte pasur mjetet ligjore për t'u përfaqësuar nga një avokat. Gjykata e rrethit kishte shtyrë seancat gjyqësore në disa raste për shkak të mungesës së avokatëve të ankuesit, duke i dhënë kështu ankuesit mundësinë të përfaqësohej dhe të vetëmbrohej në nivel të mjaftueshëm.

82. Për më tepër, ankuesi nuk kishte bërë kërkesë për marrjen e masave disiplinore kundër këtyre avokatëve. Ai gjithashtu nuk i kishte kërkuar gjykatës të caktonte një avokat me zgjedhjen e saj, sipas seksionit 49 § 5 të Kodit të Procedurës Penale.

83. Qeveria pohoi se ankuesi, në seancën përfundimtare të datës 11 maj 2000 në gjykatën e rrethit, kishte deklaruar se dëshironte “të vetëmbrohej”.

84. Në parashtrimet e Qeverisë, këmbëngulja e ankuesit për t'u përfaqësuar nga avokatë që kishin munguar pa arsye ose që ishin tërhequr nga mbrojtja, kombinuar me miratimin e tij për t'u vetëmbrojtur personalisht në seancën përfundimtare, nuk çon në një shkelje të të drejtave të tij kushtetuese.

2. Vlerësimi i gjykatës

85. Gjykata rithekson se ndërsa neni 6 § 3 (c) i jep çdo të akuzuari për një vepër penale të drejtën “për t'u vetëmbrojtur personalisht ose përmes ndihmës ligjore...”, ajo nuk përcakton mënyrën e ushtrimit të kësaj të drejte. Kështu, ajo i lë shteteve kontraktuese zgjedhjen e mjeteve të sigurimit që garantohej në sistemet e tyre ligjore, pra detyrën e Gjykatës vetëm për të përcaktuar nëse metoda që ata kanë zgjedhur është e pajtueshme me kërkesat e një gjykimit të drejtë (shih vendimin e Quaranta kundër Zvicrës të datës 24 maj 1991, seria A nr. 205, fq. 16, § 30). Në lidhje me këtë, duhet pasur parasysh se Konventa synon të “garantojë jo të drejtat që janë teorike ose të gabuara, por të drejtat që janë praktike dhe efektive” dhe se caktimi i një avokati mbrojtës nuk garanton në vetvete efektivitetin e ndihmës që ai mund t'i japë një të padituri (shih vendimin e Imbrioscia kundër Zvicrës, të datës 24 nëntor 1993, seria A nr. 275, fq. 13, § 38, dhe vendimin e Artico kundër Italisë, të datës 13 maj 1980, seria A nr. 37, fq. 16, § 33).

86. Më tej, Gjykata rithekson se as forma, as përmbajtja e nenit 6 të Konventës nuk ndalon një person të heqë dorë me vullnetin e tij të lirë ose shprehimisht, ose në mënyrë të heshtur, nga e drejta për garanci për një gjykim të drejtë (shih Hermin kundër Italisë [GC], nr. 18114/02, § 73, ECHR 2006-...). Megjithatë, kjo dorëheqje, për të qenë efektive për qëllimet e Konventës, duhet të vendoset në mënyrë të qartë dhe të shoqërohet me garanci minimale në raport me rëndësinë e saj (shih Poitrimol kundër Francës, 23 nëntor 1993, § 31, Seria A nr. 277-A). Për më tepër, ajo nuk duhet të bjerë ndesh me interesa të rëndësishme publike (shih Håkansson dhe Stureson kundër Suedisë, 21 shkurt 1990, § 66, seria A nr. 171-A, dhe Sejdivic kundër Italisë [GC], nr. 56581/00, § 86, ECHR 2006-II).

87. Në çështjen në fjalë, ankuesi kishte të drejtë për avokatë sipas zgjedhjes së tij, që kundërshtonin argumentet e prokurorit dhe merrnin në pyetje dëshmitarët. Nuk ka të dhëna se ankuesi, duke zgjedhur pesë avokatë, nuk kishte mjete të mjaftueshme për të paguar për ndihmën ligjore në procedimet e gjykimit (shih, në të kundërt, Artico kundër Italisë, 13 maj 1980, seria A nr. 37). Përfaqësuesit ligjorë të ankuesit ishin në gjendje të merrnin pjesë efektivisht në gjykim. Në asnjë moment, ankuesi nuk i kishte njoftuar autoritetet për ndonjë vështirësi të ndeshur në përgatitjen e mbrojtjes së tij dhe nuk ka asnjë të dhënë që të tregojë se gjykata e shkallës së parë duhet të ishte angazhuar ndaj situatës së ankuesit me kërkesën e saj si administratore përfundimtare të drejtësisë së procedimeve (shih Cuscani kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 32771/96, § 39, 24 shtator 2002).

88. Gjykata e shkallës së parë garantoj që ankuesi u përfaqësua dhe u mbrojt në nivel të mjaftueshëm, duke shtyrë pothuajse të gjitha seancat gjyqësore kur avokatët e ankuesit nuk ishin të pranishëm. Në një rast, gjykata e shkallës së parë informoi kërkuesin për të drejtën e tij për të caktuar një avokat tjetër, duke marrë parasysh mungesën e vazhdueshme të përfaqësuesit të tij (shih paragrafin 26 më sipër).

89. Vetëm në dy raste gjykata e shkallës së parë procedoi në mungesë të avokatit të ankuesit, për shkak të dëshirës së hapur të ankuesit për t'u vetëmbrojtur personalisht. Para kësaj periudhe, nga data 8 dhjetor 1999 deri në 7 shkurt 2000 ankuesi e revokoi prokurën e avokatit të tij. Ai nuk i kërkoi gjykatës të caktonte një avokat sipas rregullave të vendosura nga gjykata. Duhet të vërehet se deri në 7 shkurt 2000, janë shtyrë pesë seanca gjyqësore dhe nuk u shqyrtua asnjë provë dhe nuk u pyetën dëshmitarët.

90. Më 7 shkurt 2000 prokurori, me miratimin e ankuesit, procedoi me leximin e deklaratave të dëshmitarëve B. dhe D. Ankuesi nuk i pranoi ato deklarata. Nuk u mor në pyetje asnjë dëshmitar, megjithëse dëshmitari A. ishte paraqitur në gjykatë për të dëshmuar (shih paragrafin 27 më sipër).

91. Së dyti, nga procesverbali i seancës së fundit të datës 11 maj 2000, rezulton se ankuesi në të vërtetë ra dakord të vetëmbrohej personalisht. Ankuesi ishte në dijeni për procedimet dhe

akuzat kundër tij. Megjithatë, Gjykata vëren se në këtë rast ishte bërë një dorëheqje e hapur. Nuk ka asgjë në dosjen e çështjes që të tregojë se në ditën e seancës gjyqësore, kur ai pranoi që të vetëmbrohej personalisht, ankuesi protestoi ndaj autoriteteve të brendshme dhe kërkoi shtyrje të afatit.

92. Është e vërtetë se në apelin e tij, ankuesi shprehu kundërshtime dhe kundërshtoi pa sukses vërtetësinë e procesverbalit. Megjithatë, sipas Gjykatës, ai kundërshtim i bërë në një fazë të mëvonshme dhe i pambështetur nga prova të tjera, nuk mund të mbizotëronte mbi qëndrimin në dukje të prerë të ankuesit më 11 maj 2000.

93. Deklaratat e tre dëshmitarëve u lexuan në seancën gjyqësore të datës 11 maj 2000 (shih paragrafin 25 më sipër). Prokurori dhe ankuesi proceduan me vëzhgimet e tyre përmbyllëse. Gjykata vëren se nuk ka të dhëna që deklaratat e dëshmitarëve të lexuara në seancën gjyqësore të datës 11 maj 2000 kishin rëndësi për provën e fajësisë dhe dënimin e ankuesit. Në të vërtetë, gjykatat e brendshme e konfirmuan këtë. Asnjë provë tjetër nuk u shqyrtua në atë datë ndërsa gjykata e shkallës së parë konstatoi se ka prova të mjaftueshme për të provuar fajësinë dhe dënuar ankuesin. Rrjedhimisht, ajo vendosi të përfundonte procedimet e gjykimit.

94. Është e vërtetë se vëzhgimet përmbyllëse në emër të ankuesit, që padyshim kërkonin njohuri dhe ekspertizë ligjore, nuk u bënë nga avokati i tij. Megjithatë, në procedimet e apelit, ankuesi u përfaqësua nga një avokat sipas zgjedhjes së tij, i cili, gjë që nuk ishte kundërshtuar nga palët, bëri vëzhgime përmbyllëse duke ripohur pafajësinë e tij për akuzat penale të ngritura kundër tij (shih, midis shumë autoriteteve të tjera, Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, 16 dhjetor 1992, § 39, seria A nr. 247-B).

95. Duke pasur parasysh përfundimet e mësipërme, Gjykata çmon se fakti që ankuesi nuk u përfaqësua nga një avokat në dy seanca gjyqësore gjatë procedimeve të gjykimit, nuk çoi në një shkelje të nenit 6 § 3 (c) të Konventës në lidhje me nenin 6 § 1 të Konventës.

B. Shkelja e pretenduar e nenit 6 § 1 në lidhje me nenin 6 § 3 (d)

1. Parashtrimet e palëve

96. Ankuesi u ankua se refuzimi nga Gjykata e Rrethit Fier e kërkesës së tij për ta lejuar të marrë në pyetje dëshmitarin M. shkeli të drejtën e tij sipas nenit 6 § 3 (d). Ai gjithashtu u ankua se Gjykata e Rrethit Fier nuk ishte e gatshme të urdhëronte dëshmitarët e tij të mbrojtjes të paraqiteshin pranë asaj gjykate. Për më tepër, sipas mendimit të ankuesit, Gjykata e Rrethit Fier nuk mund të merrte parasysh provat e shumë dëshmitarëve që kishin dëshmuar në favor të ankuesit para Gjykatës së Rrethit Berat (shih paragrafin 20 më lart).

97. Ankuesi parashtroi se prova e fajësisë dhe e dënimit të tij për vrasjen e P-së, kryesisht bazoheshin në deklaratat e dëshmitarëve B., C. dhe D., që u morën gjatë hetimit penal. Asnjë prej këtyre dëshmitarëve nuk u paraqit në Gjykatën e Rrethit Fier. Për më tepër, dëshmitari A, nuk kishte qenë i pranishëm në vendin e krimit.

98. Qeveria parashtroi se më 23 shkurt 2000, M. u dëgjua para Gjykatës së Rrethit Fier. Avokatit të ankuesit iu dha mundësia për të marrë në pyetje dëshmitarin, por ai refuzoi të përfitonte nga kjo mundësi. Për rrjedhojë, Gjykata e Rrethit Fier refuzoi kërkesat e mëtejshme të avokatit të ankuesit për marrjen në pyetje të M.

99. Qeveria nuk bëri ndonjë vëzhgim mbi ankimet e mëtejshme të ankuesit sipas këtij kreu.

2. Vlerësimi i Gjykatës

a) Parime të përgjithshme

100. Gjykata në fillim rithekson se pranueshmëria e provave kryesisht rregullohet nga rregullat e ligjit të brendshëm dhe, si rregull, gjykatat e brendshme duhet të vlerësojnë provat e paraqitura pranë tyre. Detyra e Gjykatës sipas Konventës nuk është të japë vendim nëse deklaratat e dëshmitarëve u pranuan siç duhet si prova, por më tepër të përcaktojnë nëse procedimet në tërësi, duke përfshirë mënyrën në të cilën u morën provat, ishin të drejta (shih vendimin e Balliu, cituar më sipër, § 42).

101. Provat normalisht duhet të paraqiten në një seancë me dyer të hapura, në prani të të paditurit, me qëllim argumentin kundërshtues. Ka përjashtime ndaj këtij parimi, por ato nuk duhet të shkelin të drejtat e mbrojtjes. Si rregull i përgjithshëm, paragrafët 1 dhe 3 (d) të nenit 6 kërkojnë që

të paditurit t'i jepet mundësi e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të kundërshtuar dhe marrë në pyetje një dëshmitar kundër tij, qoftë kur ai bën deklaratat e tij ose në një fazë të mëvonshme të procedimeve (shih Lüdi kundër Zvicrës, 15 qershor 1992, § 47, seria A nr. 238, dhe Van Mechelen etj kundër Holandës, 23 prill 1997, § 51, procesverbalet 1997-III). Normalisht, gjykatat kombëtare duhet të vendosin nëse është e nevojshme ose e këshillueshme të dëgjojnë një dëshmitar të caktuar. Neni 6 § 3 (d) nuk kërkon pjesëmarrjen dhe marrjen në pyetje të çdo dëshmitari në emër të të paditurit: qëllimi i tij kryesor, siç tregohet nga fjalët “ nën të njëjtat kushte ”, është një “barazi e plotë procedurale e prokurorisë dhe mbrojtjes” në çështje (shih, për shembull, Polufakin dhe Chernyshev kundër Rusisë, nr. 30997/02, § 205, 25 shtator 2008).

102. Nën rrethana të caktuara mund të jetë e nevojshme për gjykatat që të kenë rekurs ndaj deklaratave të bëra gjatë fazës së hetimit penal. Nëse i pandehuri kishte mundësi të mjaftueshme për të kundërshtuar këto deklarata, në kohën kur ato janë marrë ose në një fazë të mëvonshme të procedimeve, përdorimi i tyre nuk bie ndesh me garancitë e nenit 6 §§ 1 dhe 3 (d). Të drejtat e mbrojtjes janë të kufizuara në një shkallë që është e papajtueshme me kërkesat e nenit 6 nëse dënimi bazohet vetëm, ose në mënyrë përfundimtare, në dëshmitë nën besim të një dëshmitari, të cilin i padituri nuk kishte asnjë mundësi për ta marrë në pyetje ose ta kishte marrë në pyetje gjatë hetimit, apo në gjykim (shih Vozhigov kundër Rusisë, nr. 5953/02, § 51, 26 prill 2007; Lucà kundër Italisë, nr. 33354/96, § 40, ECHR 2001-II; dhe Solakov kundër “Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë”, nr. 47023/99, § 57, ECHR 2001-X).

b) Ankimi për çështjen në fjalë

103. Gjykata vëren se ankuesi pretendon për një shkelje të nenit 6 §§ 1 dhe 3 (d) të Konventës, kryesisht për dy arsye: (i) në lidhje me akuzën e vrasjes së mbetur në tentativë të punonjësve të policisë, ai nuk kishte mundur të merrte në pyetje dëshmitarin M., disa dëshmitarë mbrojtjeje nuk ishin paraqitur para Gjykatës së Rrethit Fier dhe kjo e fundit nuk kishte marrë parasysh dëshmitë e disa dëshmitarëve të dhëna në favor të ankuesit para Gjykatës së Rrethit Berat; dhe, ii) në lidhje me vrasjen e dyshuar të P., ai nuk kishte mundur të merrte në pyetje dëshmitarët, mbi fuqinë e deklaratave të të cilëve ai ishte dënuar.

i) Akuza e vrasjes së mbetur në tentativë të punonjësve të policisë më 18 mars 1998

104. Gjykata vëren se dënimi i ankuesit për vrasjen e mbetur në tentativë të punonjësve të policisë më 18 mars 1998 ishte bazuar, ndër të tjera, në dëshmitë e katër punonjësve të policisë K., L., M. dhe N. (shih paragrafin 37 më lart).

a) Dëshmitarët e akuzës

105. Në seancat gjyqësore të datave 23 shkurt dhe 1 e 21 mars 2000, ankuesi kërkoi pa sukses të lejohej të merrte në pyetje M. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se dënimi i ankuesit nuk ishte bazuar në “një shkallë vendimtare” ose vetëm në dëshminë e M. në gjykatën e shkallës së parë. Kur autoritetet e brendshme gjyqësore përballen me disa versione kontradiktore të së vërtetës të ofruara nga i njëjti person, preferenca e tyre përfundimtare për një deklaratë të dhënë autoriteteve hetimore ndaj një deklarate të dhënë në një gjyq me dyer të hapura, nuk ngre në vetvete një çështje sipas Konventës kur kjo preferencë është e bazuar dhe vetë deklarata ishte dhënë me dëshirën e personit (shih Lutsenko kundër Ukrainës, nr. 30663/04, § 49, 18 dhjetor 2008). Ndërsa dëshmia e M. ishte e rëndësishme, u vërtetua nga prova të tjera materiale, si për shembull raporti hetimor i vendit të krimit, raporti i arrestimit të ankuesit dhe raporti balistik dhe, kryesisht, dëshmitarë, si K., L. dhe N., që u morën në pyetje nga ankuesi. Për më tepër, ankuesi nuk parashtroi asnjë argument bindës që të shpjegonte se marrja në pyetje e M. do të kishte qenë thelbësore për krijimin e fakteve të çështjes dhe përfshirjen e tij në veprën penale.

106. Rezulton që nuk ka pasur asnjë shkelje të nenit 6 § 1 në lidhje me 6 § 3 (d) të Konventës për shkak të refuzimit të Gjykatës për të lejuar ankuesin të marrë në pyetje M.

B) Dëshmitarët e mbrojtjes

107. Në seancën gjyqësore të 1 marsit 2000, në vijim të kërkesës së ankuesit, Gjykata e Rrethit Fier lëshoi disa fletëthirrje për paraqitjen e tre punonjësve të policisë O., Q. dhe S. Megjithatë, këta dëshmitarë të mbrojtjes nuk u paraqitën asnjëherë para gjykatës së shkallës së parë.

108. Ndërsa më 11 maj 2000 ankuesi duket të ketë hequr dorë nga e drejta e tij për të marrë në pyetje dëshmitarin O. dhe lejoi leximin e deklaratave të dëshmitarëve Q. dhe S., ky ishte rezultati i zhgënjimit të tij mbi përpjekjet e vazhdueshme dhe të pasuksesshme nga autoritetet për t'i thirrur ata. Gjykata vëren se dëshmitë e tre punonjësve të policisë përbënin prova me, të paktën, rëndësi *prima facie* për mbrojtjen e ankuesit. Pamundësia e shtetit që është paditur (domethënë Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Policisë) për të siguruar pjesëmarrjen e punonjësve të policisë që veprojnë si depozitues të autoritetit publik përgjegjës për mbrojtjen e interesave të përgjithshme të shtetit, kombinuar me pamundësinë e gjykatës së shkallës së parë për të siguruar zbatimin e fletëthirrjes së saj, nuk arrin të sigurojë vullnetin që shtetet kontraktuese duhet të ushtrojnë me qëllim që të sigurojnë që të drejtat e garantuara nga neni 6 të gëzohen në mënyrë efektive (shih Sadak etj kundër Turqisë, nr. 29900/96, 29901/96, 29902/96 dhe 29903/96, § 67, ECHR 2001-VIII, dhe vendimin e Barberà, Messegué dhe Jabardo kundër Spanjës, të datës 6 dhjetor 1988, seria A nr. 146, fq. 33, § 78). Gjykatat e apelit nuk e rregulluan këtë shkelje, megjithëse ankuesi e kërkoi këtë në arsyet e tij të apelit. Qeveria nuk dha shpjegime për këtë ose nuk u përpoq të justifikonte përse punonjësit e policisë nuk mund të paraqiteshin në gjykatë.

109. Rezulton se në këtë drejtim ka pasur një shkelje të nenit 6 § 1 në lidhje me nenin 6 § 3 (d) të Konventës.

110. Gjykata vëren se katër dëshmitarët dëshmuuan në favor të ankuesit para Gjykatës së Rrethit Berat (shih paragrafin 20 më sipër). Meqenëse të gjitha aktet e Gjykatës së Rrethit Berat ishin transferuar në mënyrë të arsyetuar në Gjykatën e Rrethit Fier, ankuesi mund të mos kërkonte paraqitjen e tyre. Gjykata e Rrethit Fier përjashtoi dëshmitë e tyre kur dha vendimin e saj, pa dhënë arsye mbi këtë. Qeveria nuk parashtroi argumente që justifikonin këtë përjashtim. Ndërsa Gjykata nuk mund të spekulojë në lidhje me rëndësinë e elementeve faktikë, gjykata e shkallës së parë nuk mori në konsideratë, pa justifikim, të gjitha provat e dëshmitarëve në favor të ankuesit, dhe këto prova sigurisht ishin të rëndësishme për çështjen dhe rrjedhimisht për vendimin.

111. Rezulton që në këtë drejtim ka pasur një shkelje të nenit 6 § 1 në lidhje me nenin 6 § 3 (d) të Konventës.

ii) Akuza e vrasjes së P. më 21 korrik 1997

112. Gjykata vëren se vendimi i Gjykatës së Rrethit Fier që dënonte ankuesin për vrasjen e P. ishte bazuar tërësisht në dëshminë e A. dhe deklaratat e dëshmitarëve B., C. dhe D. të dhëna gjatë hetimit penal. Ky arsyetim u mbështet në apel.

113. Gjykata vëren se në procedurën penale shqiptare, gjykata e apelit ka juridiksionin të trajtojë jo vetëm çështje të ligjit, por edhe çështje të faktit në lidhje me tërësinë e çështjes. Gjykata e apelit është e autorizuar të shqyrtojë provat dhe materialet e reja shtesë të paraqitura nga palët, siç e çmon të nevojshme. Si rezultat i shqyrtimit, gjykata e apelit mund të rrëzojë apelin dhe të mbështesë vendimin, të ndryshojë vendimin ose të shfuqizojë vendimin dhe të përfundojë procedimet penale ose të shfuqizojë vendimin dhe të paraqesë çështjen për rigjykim. Gjykata e Lartë trajton çështjet e ligjit të ngritura në apelin e ankuesit.

114. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se A. nuk ishte as dëshmitarë okulare, as e pranishme në vendin e krimit. Dëshmia e saj u bazua në deklaratat e dëshmitarëve B., C. dhe D., që ishin bërë gjatë hetimit penal. As ankuesi, as avokati i tij nuk mund të përballeshin me këta dëshmitarë kryesorë ose të bënin pyetje ose komente në lidhje me ato deklarata, meqë në atë kohë nuk ishte ngritur asnjë akuzë kundër tij (shih paragrafin 7 më sipër).

115. Për më tepër, Gjykata çmon se ankuesi nuk hoqi dorë nga e drejta e tij për të marrë në pyetje ata dëshmitarë. Më 7 shkurt 2000 ai kundërshtoi leximin e deklaratave të tyre dhe kërkoi paraqitjen e tyre para Gjykatës së Rrethit Fier. Gjykata sërish rithekson përfundimet e saj në paragrafin 108 më sipër. Gjykata nuk është e bindur se autoritetet ishin të zellshme në përpjekjet e tyre për të sjellë dëshmitarët para gjykatës së shkallës së parë. Mosparaqitja e këtyre dëshmitarëve, deklaratat e të cilëve ishin vendimtare për dënimin e ankuesit, e parandaloi ankuesin nga marrja e tyre në pyetje ose nga marrja e tyre e mëparshme në pyetje. Ky mosveprim nuk u rregullua as nga gjykata e apelit që ishte e autorizuar të shqyrtonte çështjet e faktit dhe të ligjit, as nga Gjykata e Lartë.

116. Duke marrë në konsideratë faktorët e mësipërm, Gjykata rrjedhimisht nxjerr përfundimin se në këtë drejtim ka pasur një shkelje të nenit 6 § 1 në lidhje me nenin 6 § 3 (d) të Konventës.

III. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

117. Neni 41 i Konventës parashikon:

“Nëse Gjykata konstaton se ka pasur një shkelje të Konventës ose protokolleve të saj dhe nëse ligji i brendshëm i palës së lartë kontraktuese përkatëse lejon vetëm kryerjen e një kompensimi të pjesshëm, nëse është e nevojshme, Gjykata do t’i japë kompensim të drejtë palës së dëmtuar.”

118. Ankuesi theksoi se ai kishte qenë në burg për të paktën 114 muaj ose 3,400 ditë deri në kohën që parashitroi vërejtjet e tij në Gjykatë. Ai kërkoi pagesën e 136,000 euro në lidhje me dëmin financiar që kishte pësuar. Ankuesi nuk përcaktoi ndonjë shumë në lidhje me dëmin jofinanciar, megjithëse specifikoi se sipas ligjit të brendshëm, kishte të drejtë për kompensim. Ai gjithashtu specifikoi se në raste të ngjashme gjykatat e brendshme kishin kompensuar dëme jofinanciare në shumën prej 100,000 eurosh.

119. Qeveria rrëzoi pretendimin e ankuesit për kompensim të drejtë.

A. Dëmi

120. Për sa i përket dëmit financiar që pretendohet të jetë shkaktuar, Gjykata rithekson se duhet të ketë një lidhje të qartë shkakësore midis dëmit të pretenduar nga ankuesit dhe shkeljes së Konventës (shih, ndër të tjera, Dybeku kundër Shqipërisë, nr. 41153/06, § 65, 18 dhjetor 2007).

121. Gjykata, duke marrë parasysh përfundimet e saj në lidhje me ankimet e ankuesit sipas nenit 6 §§ 1 dhe 3 (c) dhe (d), çmon se nuk është vendosur asnjë lidhje shkakësore midis dëmit të pretenduar dhe shkeljeve që ka konstatuar. Gjykata nuk mund të spekulojë se cili mund të kishte qenë rezultati i procedimeve penale kundër ankuesit nëse nuk do të kishte ndodhur shkelja e Konventës (shih Polufakin dhe Chernyshev, cituar më sipër, § 216). Rrjedhimisht, Gjykata e çmon të papërshtatshme që t’i japë ankuesit kompensim për dëmin e pretenduar financiar.

122. Në shkallën që pretendimi i ankuesit lidhet me rezultatet e shkeljeve të nenit 6 § 3 (d) në lidhje me neneve 6 § 1, Gjykata rithekson se kur një kërkues është dënuar, pavarësisht një shkeljeje të mundshme të të drejtave të tij, siç garantohet nga neni 6 i Konventës, ai duhet, sa më shumë të jetë e mundur, të vihet në një pozicion në të cilin do të kishte qenë, nëse kërkesat e asaj dispozite nuk do të ishin marrë parasysh dhe që forma më e përshtatshme e kompensimit, në parim, do të ishte gjykimi *de novo* ose rifillimi i procedimeve, nëse do të kërkohej (shih Salduz kundër Turqisë [GC], nr. 36391/02, § 72, 27 nëntor 2008; Polufakin dhe Chernyshev, cituar më sipër, § 219; Öcalan kundër Turqisë [GC], nr. 46221/99, § 210 në gjobë, ECHR 2005-IV; dhe Popov kundër Rosisë, nr. 26853/04, § 263, 13 korrik 2006).

123. Për sa i përket pjesës së mbetur të pretendimit për dëm jofinanciar, duke vendosur mbi baza të barabarta, Gjykata i jep ankuesit 3,000 EURO plus çdo taksë që mund të vendoset mbi këto shuma.

B. Kostot dhe shpenzimet

124. Ankuesi i cili mori 850 euro në ndihmën ligjore nga Këshilli i Europës në lidhje me paraqitjen e çështjes së tij, përveç kësaj kërkoi 500 euro në muaj për kostot e udhëtimit të anëtarëve të familjes së tij për ta vizituar atë në mjediset e paraburgimit dhe për shpenzimet ushqimore të shkaktuara ndërsa ishte në paraburgim. Nuk u ngrit asnjë pretendim tjetër në lidhje me kostot dhe shpenzimet e shkaktuara pranë gjykatave të brendshme dhe kësaj Gjykate.

125. Gjykata e hodhi poshtë pretendimin.

126. Gjykata vëren se asaj nuk i është dhënë dokumentacioni përkatës që tregon se shpenzimet e pretenduara në fakt ishin shkaktuar. Rrjedhimisht, Gjykata nuk do të bëjë një kompensim sipas këtij kreu.

C. Kamatëvonesa

127. Gjykata e çmon të nevojshme që kamatëvonesa të bazohet në normën marzhinale të huadhënies të Bankës Qendrore Europiane, së cilës duhet t’i shtohen tri pikë në përqindje.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, NJËZËRI:

1. Shpall ankimet në lidhje me nenin 6 të Konventës të pranueshme dhe pjesën e mbetur të kërkesës të papranueshme.

2. Vendos se nuk ka pasur asnjë shkelje të nenit 6 § 1 në lidhje me nenin 6 § 3 (c) të Konventës mbi mungesën e së drejtës së ankuesit për avokat gjatë fazave të gjykimit të tij.

3. Vendos se nuk ka pasur asnjë shkelje të nenit 6 § 1 në lidhje me nenin 6 § 3 (d) të Konventës mbi refuzimin e gjykatës së shkallës së parë për të lejuar ankuesin të marrë në pyetje dëshmitarin M.

4. Vendos se ka pasur një shkelje të nenit 6 § 1 në lidhje me nenin 6 § 3 (d) të Konventës mbi pamundësinë për të garantuar paraqitjen në gjykimin e ankuesit të dëshmitarëve O., Q. dhe S.

5. Vendos se ka pasur një shkelje të nenit 6 § 1 në lidhje me nenin 6 § 3 (d) të Konventës mbi pamundësinë e gjykatës së shkallës së parë për të marrë në konsideratë dëshmitë e katër dëshmitarëve të dhëna në favor të ankuesit para Gjykatës së Rrethit Berat.

6. Vendos se ka pasur një shkelje të nenit 6 § 1 në lidhje me nenin 6 § 3 (d) të Konventës mbi pamundësinë për të garantuar paraqitjen në gjykimin e ankuesit të dëshmitarëve B., C. dhe D.

7. Vendos:

a) se shteti i paditur duhet t'i paguajë ankuesit brenda tri muajve nga data në të cilën vendimi ka marrë formë të prerë, në përputhje me nenin 44 § 2 të Konventës 3,000 euro (tre mijë euro) në lidhje me dëmin jofinanciar, plus çdo taksë që mund të vendoset, e cila duhet të konvertohet në monedhën kombëtare të shtetit të paditur në normën e zbatueshme në datën e pagesës.

b) se nga skadimi i tre muajve të lartpërmendur deri në shlyerje, interesi i thjeshtë do të paguhet në shumën e mësipërme në një normë të barabartë me normën marzhinale të huadhënies të Bankës Qendrore Europiane gjatë periudhës së mospagimit të detyrimeve financiare, plus tri pikë në përqindje.

8. Rrëzon pjesën e mbetur të pretendimit të ankuesit për kompensim të drejtë.

Hartuar në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim, më 8 dhjetor 2009, sipas nenit 77 §§ 2 dhe 3 të rregullores së Gjykatës.

Lawrence Early
Sekretar

Nicolas Bratza
Kryetar

SEKSIONI I KATËRT
ÇËSHTJA MULLAI DHE TË TJERË KUNDËR SHQIPËRISË
(Ankimi nr.9074/07)

VENDIM
(themeli)
STRASBURG
23 mars 2010

Ky vendim do të marrë formë të prerë në rrethanat e përcaktuara në nenin 44 § 2 të Konventës. Ai mund t'i nënshtrohet rishikimit redaktues.

Në çështjen Mullai dhe të tjerë kundër Shqipërisë,
Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (seksioni i katërt), duke gjykuar si dhomë e përbërë nga:

Nicolas Bratza, kryetar

Lech Garlicki

Giovanni Bonello

Ljiljana Mijović

Päivi Hirvelä

Ledi Bianku

Nebojša Vučinić, gjyqtarë

dhe Fatoş Aracı, zëvendësregjistrues i seksionit,

pas shqyrtimit me dyer të mbyllura më 2 mars 2010, shpall vendimin e mëposhtëm të miratuar po në atë datë.

PROCEDURA

585. Çështja e ka zanafillën në ankimin (nr.9074/07) kundër Republikës së Shqipërisë, e depozituar në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore (Konventa) nga shtatë shtetas shqiptarë znj. Nesime Mullai, z Astrit Daci, znj. Mediha Hoti, Znj. Suzana Zereliu, znj. Nermin Daci, znj. Etleva Mullai dhe znj. Eva Pinguli (ankues individualë) dhe nga Teknoprojekti sh.p.k. (shoqëria ankuese), një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, në datën 1 dhjetor 2006.

586. Ankuesit u përfaqësuan nga z. S. Puto, avokat që ushtron aktivitetin e tij në Tiranë. Qeveria Shqiptare (Qeveria) u përfaqësua nga agentja e atëhershme e saj, Znj. S. Meneri.

587. Ankuesit pretendonin shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës dhe të nenit 1 të protokollit nr.1 të Konventës për arsye të shfuqizimit të vendimit të formës së prerë, moszbatimit nga ana e autoriteteve të vendimit të formës së prerë të gjykatës, si dhe tejzgjatjes së procedurave.

588. Më 12 shtator 2007 kryetari i seksionit të cilit i ishte caktuar çështja vendosi t'ia komunikonte ankimin Palës Shqiptare. Në zbatim të nenit 29 § 3 të Konventës, Gjykata vendosi të shqyrtonte themelin e ankimit, si dhe njëkohësisht pranueshmërinë e tij. Në të njëjtën datë ankimit iu dha prioritet sipas rregullit 41 të rregullores së Gjykatës.

589. Të dyja palët, ankuesit dhe Pala Shqiptare, depozituan me shkrim vëzhgimet e tyre (rregulli 59 § 1).

FAKTET

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

590. Ankuesit kanë lindur përkatësisht në 1938, 1938, 1926, 1963, 1942, 1970 dhe 1954 dhe banojnë në Shqipëri, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Itali.

591. Shoqëria ankuese është e krijuar sipas ligjit shqiptar dhe është e regjistruar në Tiranë.

A. Procedurat në lidhje me kthimin e pronës

592. Ankuesit janë trashëgimtarë të Z. M. i cili, në vitin 1947 ishte pronar i një vile trikatëshe dhe një parcele toke afër saj të vendosur në qendër të Tiranës. Në një datë të pacaktuar në vitin 1947 autoritetet kanë konfiskuar pronën, e cila mbeti në zotërim të tyre deri në vitin 1994.

593. Më 30 dhjetor 1994, me kërkesë të ankuesve në përputhje me aktin e pronësisë 1993, Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave në Tiranë pranoi pretendimin e tyre për vilën dhe parcelën e tokës prej 1 100 metrash katrorë. Komisioni ndryshoi vendimin më 8 gusht 2002, duke i njohur ankuesve të drejtën e pronës për parcelën e tokës me sipërfaqe prej 1 515 metrash katrorë, e cila i korrespondonte pronës origjinale. E drejta e pronës u përfshi në regjistrin e tokës.

594. Nga viti 1996 deri në vitin 1998 ankuesit i kanë dhënë me qira pronën në fjalë ambasadës libaneze në Tiranë.

B. Procedurat në lidhje me lejen e ndërtimit

1. Procedurat administrative

595. Më 30 prill 1998 ankuesit hynë në marrëveshje me shoqërinë ankuese për ndërtimin e një blloku kullash në pronën e tyre. Sipas marrëveshjes, shoqëria ankuese kishte kompetencën për të marrë autorizimet administrative të domosdoshme për ndërtimin. Kontrata përfundimtare ishte vendosur që të përmbylej pas marrjes së lejes.

596. Më 23 tetor 1998 dhe 22 dhjetor 1998 Këshilli i Rregullimit të Territorit të Bashkisë së Tiranës (KRT bashkiak) i dha shoqërisë ankuese një leje planifikimi dhe leje ndërtimi duke e autorizuar atë të ngrinte një ndërtesë gjashtëmbëdhjetë katëshe në atë pronë. Për rrjedhojë, më 15 korrik 1999 këshilli teknik i Bashkisë së Tiranës autorizoi shoqërinë ankuese të shkatërronte vilën trikatëshe ekzistuese dhe të ngrinte një ndërtim të ri në vend të saj.

597. Në një datë të pacaktuar në vitin 1999 shoqëria ankuese shkatërroi vilën dhe ndryshoi truallin sipas lejeve dhe planeve të aprovuara nga Bashkia e Tiranës (Bashkia).

598. Më 31 gusht 1999, ndërsa puna ndërtimore vazhdonte, Prefekti i Tiranës (Prefekti) nxori njoftimin për pezullimin e punimeve. Sipas këtij njoftimi, leja e ndërtimit duhej të ishte dhënë nga Këshilli Kombëtar për Rregullimin Territorial (KKRT) dhe Bashkia kishte kaluar kompetencat e saj duke lejuar ndërtimin e një ndërtese kaq të madhe në qendër të Tiranës (shih paragrafin 59 më poshtë).

599. Më 6 shtator 1999 Bashkia njoftoi Prefektin se leja e ndërtimit ishte e rregullt dhe se ajo ishte dhënë mbi bazën e dispozitave ligjore përkatëse. Megjithatë, më 4 tetor 1999, Policia Ndërtimore e Tiranës zbatoi njoftimin e Prefektit dhe ndërpreu punimet në sheshin e ndërtimit.

600. Më 12 janar 2000, me kërkesë të shoqërisë ankuese, Prefekti anuloi njoftimin e tij të mëparshëm dhe puna ndërtimore filloi sërish.

601. Më 22 janar 2000 Ministri i Punëve Publike (Ministri) urdhëroi ndërprerjen e punës ndërtimore, duke u bazuar në faktin që vendimet e KRT bashkiake (shih paragrafin 12 më lart) duhej të shqyrtoheshin dhe të aprovoheshin nga KKRT-ja. Në të njëjtën ditë Policia Ndërtimore e Tiranës zbatoi urdhrin e Ministrit duke i ndërprerë përsëri punimet.

602. Më 26 janar 2000 shoqëria ankuese depozitoi pa sukses një ankesë pranë Drejtorit të Policisë Ndërtimore Kombëtare, duke kërkuar heqjen e urdhrin të ndërprerjes së ndërtimeve.

603. Më 9 shkurt 2000 KKRT vendosi që të kërkohej interpretim ligjor mbi vlefshmërinë e lejes së ndërtimit, duke deklaruar që leja ishte miratuar mbi bazën e aktit të planifikimit urban 1993, i cili ishte shfuqizuar në kohë materiale. KKRT-ja nuk revokoi urdhrin e ndërprerjes së punimeve. Po kështu vendimi nuk tregonte qartë se cili ishte organi përgjegjës për interpretimin ligjor. Megjithatë, duket se vendimi i adresohet Bashkisë, duke i kërkuar të nxjerrë një plan të ri urban të zonës dhe për rrjedhojë të njoftojë KKRT-në.

604. Më 13 mars 2000 dhe 3 maj 2000 Ministria e Punëve Publike i kërkoi Bashkisë së Tiranës të respektojte vendimin e KKRT-së.

605. Sipas ankuesve dhe shoqërisë ankuese, në një datë të pacaktuar në vitin 2000 Bashkia konfirmoi vlefshmërinë e vendimeve të saj të datave 23 tetor 1998 dhe 22 dhjetor 1998. Megjithatë, nuk u paraqit asnjë dokument bindës.

2. Procedurat gjyqësore në lidhje me ligjshmërinë e urdhrin të Ministrin dhe padinë e Policisë Ndërtimore të datës 22 janar 2000

606. Në një datë të pacaktuar në vitin 2000, shoqëria ankuese kundërshtoi vlefshmërinë e akteve të mësipërme (shih paragrafin 601 më lart).

607. Më 11 korrik 2000 gjykata e rrethit e hodhi poshtë ankimimin e tyre. Ajo argumentoi

që leja e ndërtimit ishte e pavlefshme, meqenëse ishte lëshuar në bazë të Aktit të Planifikimit Urban 1993, i cili nuk ishte në fuqi në kohë materiale. Pjesa aktive e vendimit nuk shprehte që leja e ndërtimit ishte e pavlefshme.

608. Më 4 janar 2001 Gjykata e Apelit të Tiranës shfuqizoi vendimin e Gjykatës së Rrethit. Ajo aprovoi argumentet e apelit të shoqërisë ankuese, si dhe anuloi urdhrin e Ministrit dhe padinë e Policisë Ndërtimore.

609. Më 29 mars 2001, në bazë të apelit të Policisë Ndërtimore, Gjykata e Lartë shfuqizoi vendimin e Gjykatës së Apelit dhe miratoi vendimin e Gjykatës së Rrethit. Gjykata e Lartë konstatoi që vendimi i Prefektit i datës 12 janar 2000 ishte *ultra vires* për sa kohë që procedurat në KKRT ishin lënë pezull. Në këto rrethana, Ministri dhe Policia Ndërtimore e Tiranës kishin ndërprerë punimet më 22 janar 2000. Vendimi shprehte si më poshtë:

“(…) Gjykata vëren që vendimi i KKRT nuk është i formës së prerë. Ajo nuk vendos mbi themelin e çështjes në fjalë, por nënkupton që ato do të vendosen pasi të jenë përfunduar detyrat që rrjedhin nga vendimi. Pika (a) e vendimit të KKRT [Interpretimi ligjor i vendimit të KRT bashkiake më 22 Dhjetor 1998] vë në dyshim ligjshmërinë e lejes së ndërtimit të nxjerrë nga KRT bashkiake. Megjithatë ajo nuk merr një vendim përfundimtar mbi çështjen, megjithëse duhej ta kishte marrë. Është e paqartë se ndaj kujt duhet bërë interpretimi ligjor i vendimit të KRT-së bashkiake. (…)

Përmbajtja e pikës (b) [përgatitja e një plani të ri urban të zonës] dhe (c) [detyrimi i Bashkisë për të respektuar vendimin e KKRT-së dhe informuar atë] i vendimit të KKRT-së përforcojnë konkluzionin që vendimi nuk është i formës së prerë.

Vendimi përfundimtar do të merret pasi KRT-ja bashkiake të nxjerrë një plan të ri urban të zonës, i cili do t'i nënshtrohet shqyrtimit nga KKRT-ja.

(…)

Është e detyrueshme që sipas KKRT-së të zgjidhen në mënyrë të plotë joekuivoke dhe përfundimtare çështjet e mësipërme. Vetëm pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet ligjore administrative, me ndihmën e KKRT-së (…), çështja mund t'i referohet gjykatave për mbrojtjen e të drejtave mbi pronën dhe të drejtave të tjera *in rem* të palëve në kufi të parcelës së tokës (…).

Prefekti përfaqëson Këshillin e Ministrave [pushteti qendror] në pushtetin lokal. Atij i janë dhënë kompetencat me ligj. Megjithatë kur një çështje transferohet në pushtetin qendror, edhe me propozimin e tij, ai nuk mund të ushtrojë asnjë të drejtë tjetër. Përndryshe një gjë e tillë do të konsiderohej tejkalim i kompetencave.”

610. Megjithatë në të njëjtin vendim Gjykata e Lartë deklaroi lejen e ndërtimit të pavlefshme për arsyet e mëposhtme:

“(…) Rezulton që në periudhën kur është dhënë leja e ndërtimit, Akti i Planifikimit Urban 1993, i cili ripërcaktonte përbërjen e KRT-së bashkiake, ishte shfuqizuar. Neni 19 i aktit të ri [të Planifikimit Urban] i vitit 1998 përcakton përbërjen e re të KRT-së bashkiake, të përbërë nga 21 anëtarë, duke përcaktuar funksionet dhe detyrat përkatëse që duhet të zbatohen.

(…) Akti i ri [1998] hyri në fuqi më 25 tetor 1998.

Duke pasur parasysh që Akti i ri nuk përmban asnjë dispozitë kalimtare që do ta bënte legjitim vazhdimin e punës së KRT-së bashkiake mbi bazën e Aktit 1993, KRT-ja e re [bashkiake] duhej të ishte përcaktuar në përputhje me përbërjen dhe kriteret e përzgjedhjes së anëtarëve të saj përcaktuar në Aktin e ri [1998].

Për rrjedhojë çdo vendim i marrë nga KRT i mëparshëm [mbi bazën e Aktit të Planifikimit Urban 1993] konsiderohet i pavlefshëm. Një vendim i marrë nga një organ që është shfuqizuar me ligj dhe në bazë të ligjit të shfuqizuar është i pavlefshëm, si i tillë nuk mund të sjellë pasoja ligjore.

Në këtë mënyrë leja e ndërtimit e [shoqërisë ankuese] e datës 22 dhjetor 1998 konsiderohet e pavlefshme.

Sa më sipër, trupi gjykues i Gjykatës së Lartë arrin në përfundimin se vendimi i Gjykatës së Rrethit nuk ishte *ultra vires* kur e konsideronte lejen e ndërtimit të pavlefshme, megjithëse nuk ishte objekt i procedurave përkatëse.

[Gjykata e Rrethit] nuk ka shqyrtuar të drejtën e [shoqërisë ankuese] për të vazhduar punën ndërtimore meqenëse do të ishte jashtë fushës së shqyrtimit të çështjes administrative pranë kësaj

gjykate.”

611. Pjesa vepruese e vendimit të Gjykatës së Lartë nuk përmendte vlefshmërinë e lejes së ndërtimit. Në të njëjtën ditë vendimi mori formë të prerë, meqenëse asnjëra nga palët nuk depozitoi ankesë pranë Gjykatës Kushtetuese.

C. Procedimet gjyqësore të filluara nga ambasada zvicerane në Tiranë (Ambasada)

612. Më 19 mars 2001 ambasada, ambientet e së cilës janë afër sheshit të ndërtimit, kundërshtoi vlefshmërinë e lejes së ndërtimit. Ankuesit u përfshinë në procedimet gjyqësore si palë e tretë (ndërhyrës dytësor).

613. Më 28 maj 2002 Gjykata e Rrethit deklaroi të pavlefshme lejen e ndërtimit. Pa iu referuar vendimit të Gjykatës së Lartë të datës 29 mars 2001 (shih paragrafin 610 më lart), sipas gjykimit të Gjykatës së Rrethit leja e ndërtimit ishte dhënë duke u bazuar në Aktin e Planifikimit Urban 1993, i cili ishte shfuqizuar në kohë materiale.

614. Ankuesit dhe shoqëria ankuese apeluan. Më 3 mars 2003 Gjykata e Apelit i kërkoi KKRT-së të vendosë mbi vlefshmërinë e lejes së ndërtimit duke u bazuar në vendimin e Gjykatës së Lartë të datës 29 mars 2001, sipas të cilit duhej të shteroheshin të gjitha mjetet ligjore administrative (shih paragrafin 609 më lart).

615. Më 18 qershor 2003 KKRT-ja ka miratuar vlefshmërinë e lejes së ndërtimit të dhënë nga Bashkia. Në shkresën drejtuar Gjykatës së Apelit, Kryetari i Rregullimit Territorit, në cilësinë e zëvendëskryetarit të KKRT-së, njoftoi që procesi gjyqësor në pritje për shqyrtim pranë Gjykatës së Apelit do të bëjë vlerësimin dhe do të zgjidhë përfundimisht konfliktin e paraqitur në lidhje me këtë objekt.

616. Më 3 tetor 2003 Gjykata e Apelit shfuqizoi vendimin e Gjykatës së Rrethit dhe refuzoi çështjen. Sipas gjykimit të saj ambasada ka depozituar padinë e saj jashtë afateve kohore të parashkuara në Kodin e Procedurës Civile. Duket se leja e ndërtimit është deklaruar e ligjshme, megjithëse nuk është përmendur në pjesën aktive të vendimit. Gjykata e Apelit nuk i është referuar gjykimit të vendimit të Gjykatës së Lartë të datës 29 mars 2001, e cila e kishte shpallur lejen e ndërtimit të pavlefshme (shih paragrafin 26 më lart). Vendimi nuk përmbante urdhër për fillimin e punës ndërtimore.

1. Zhvillimet sipas vendimit të Gjykatës së Apelit të datës 3 tetor 2003

617. Më 15 shtator 2003 shoqëria ankuese i ka kërkuar Policisë Ndërtimore anulimin e urdhrit për ndërprerjen e punës ndërtimore mbi bazën e vendimit të KKRT-së të datës 18 qershor 2003 (shih paragrafin 615 më lart).

618. Policia Ndërtimore i ka kërkuar shoqërisë ankuese rinovimin e dosjes në lidhje me punimet duke paraqitur *ex novo* dokumentet e duhura me qëllim që të analizojë çështjen. Shoqëria ankuese i ka paraqitur dokumentet sipas kërkesës. Nga policia nuk është marrë asnjë përgjigje.

619. Më 29 dhjetor 2004, me kërkesë të shoqërisë ankuese për të ndërmjetësuar, Avokati i Popullit në Shqipëri ka njoftuar se leja e ndërtimit është deklaruar e pavlefshme me vendim të Gjykatës së Lartë të datës 29 Mars 2001 dhe ka refuzuar të ndërmjetësojë.

2. Procedurat pranë Gjykatës së Lartë

620. Më 20 prill 2005, pas apelit të bërë nga ambasada, Gjykata e Lartë ka miratuar vendimin e Gjykatës së Apelit të datës 3 tetor 2003. Ajo konstatoi që ambasada nuk kishte *locus standi* për të kundërshtuar lejen e ndërtimit të kundërshtuar dhe gjykoi, në lidhje me këtë çështje si më poshtë.

“Leja e ndërtimit ka të bëjë me marrëdhënien administrativo-ligjore ndërmjet shoqërisë ndërtuese [shoqërisë ankuese], si dhe KKRT-së. Padia e depozituar nga kërkuesi [ambasada] nuk mund të dalë jashtë kontekstit të një padie në lidhje me pushimin e ndërmjetësimit në të drejtën e pronës (...)

Neni 32 (a) i Kodit të Procedurës Civile përcakton: “Padia civile ligjore depozitohet me qëllim që të kërkohej rivendosja e së drejtës apo interesit legjitim që është shkelur.” (...)

Në rastin konkret, nuk është kërkuar asnjë interes legjitim në kuptim të dispozitës së cituar më lart. [Ambasada] nuk ka sjellë argument për shkelje apo mohim të së drejtës shkaktuar asaj drejtpërdrejt si pasojë e lejes ndërtimit të palës së paditur. Që me depozitimin e padisë civile, dhe

gjatë gjithë procedurave [të gjykatës], [Ambasada] thjesht ka dërguar disa shkelje procedurale të shoqëruara me dhënien e lejes së ndërtimit. Ekzistenca apo diçka tjetër e këtyre shkeljeve nuk mund të cenojë të drejtën subjektive të palës pretenduese. Pala pretenduese do të kishte locus standi nëse ajo do të pretendonte që puna ndërtimore e shoqërisë rezultonte në shkelje të të drejtave të saj mbi pronën. Megjithatë [ambasada] ka paraqitur fillimisht një pretendim të tillë, më tej ajo e ka tërhequr atë dhe si rrjedhim nuk e ka dërguar çështjen në gjykatë.

(...) gjykata konstaton se [ambasada] nuk ka interes ligjor dhe për rrjedhojë i mungon *locus standi* për të depozituar padi civile.

(...)

Pala pretenduese argumentonte që Gjykata e Apelit ka gjykuar gabim pranimin e vendimit të KKRT-së mbi vlefshmërinë e lejes së ndërtimit meqenëse nga ai autoritet nuk është dhënë asnjë vendim. Ky ankim lidhet me përcaktimin e themelit të çështjes, të cilin gjykata, e quan pa vend për të vendosur në një mënyrë apo tjetër.

Mbështetur në konkluzionet e mësipërme, nuk ka argumente të tjera ligjore për të kundërshtuar vendimin e Gjykatës së Apelit.”

621. Në vendimin e saj, Gjykata e Apelit nuk ka shqyrtuar ligjshmërinë e lejes së ndërtimit. Vendimi ka marrë formë të prerë në të njëjtën ditë, meqenëse asnjëra nga palët nuk ka depozituar ankesë pranë Gjykatës Kushtetuese.

3. Zhvillimet sipas vendimit të Gjykatës së Lartë të datës 20 prill 2005

622. Më 22 qershor 2005 shoqëria ankuese, duke pasur parasysh që leja e ndërtimit ishte miratuar me vendim të datës 20 prill 2005 nga Gjykata e Lartë dhe duke pasur parasysh pasivitetin e Policisë Ndërtimore, ka njoftuar Bashkinë se ajo ka vendosur të rifillojë ndërtimin pavarësisht faktit se një urdhër pezullimi ishte akoma në fuqi.

623. Më 23 qershor 2005 Policia Bashkiake ka kontrolluar sheshin e ndërtimit dhe ka urdhëruar ndërprerjen e punimeve deri në një kohë kur të vëzhgoheshin siç duhej masat e sigurisë.

624. Më 29 qershor 2005 Policia Bashkiake e shtyu urdhrin e pezullimit për arsye të disa shkeljeve të rregullave të planifikimit urban. Në një shkresë të datës 4 korrik 2005 shoqëria ankuese ka paraqitur shpjegime në lidhje me shkeljet e pretenduara.

625. Më 30 nëntor 2005, pasi shoqëria ankuese ka kërkuar leje për të rifilluar punën ndërtimore, Policia Ndërtimore e ka informuar atë që kërkesa në lidhje me konfliktin ndërmjet shoqërisë ankuese dhe Policisë Bashkiake ishte jashtë juridiksionit të saj.

D. Seria e dytë e procedimeve gjyqësore të filluara nga ambasada

626. Në një datë të pacaktuar në vitin 2005 ambasada ka filluar një tjetër seri procedimesh gjyqësore pranë Gjykatës së Rrethit duke pretenduar shkelje të të drejtave të pronës për arsye të ndërtimit të ri.

627. Më 14 dhjetor 2005 Gjykata e Rrethit dha vendimin e saj, sipas të cilit ndërtimi i ri nuk i përmbahej distancave të planifikimit urban dhe për rrjedhojë shkelte të drejtën e pronës së ambasadës. Gjykata e Rrethit urdhëroi pezullimin e punës ndërtimore deri në zgjidhjen përfundimtare të konfliktit. Ajo u mbështet në vendimin e Gjykatës së Lartë të datës 29 mars 2001, i cili e kishte shpallur lejen ndërtimore të pavlefshme.

628. Në një datë të pacaktuar midis viteve 2005 dhe 2006 shoqëria ankuese kundërshtoi ligjshmërinë e vendimit të Gjykatës së Rrethit pranë Gjykatës së Apelit duke sjellë argumente që vendimi i Gjykatës së Apelit i datës 3 tetor 2003, i cili kishte marrë formë të prerë, konfirmonte vlefshmërinë e lejes ndërtimore (shih paragrafin 32 më lart). Vendimi i Gjykatës së Rrethit i datës 14 Dhjetor 2005 shfuqizoi vendimin përfundimtar, duke shkelur si rrjedhim parimin e sigurisë juridike.

629. Dy muaj më vonë, vendimi i Gjykatës së Rrethit akoma nuk i ishte dërguar shoqërisë ankuese. Më 15 mars 2006, pas ankesave nga shoqëria ankuese, Këshilli i Lartë i Drejtësisë informoi atë që çështja i ishte dërguar Ministrisë së Drejtësisë me qëllim që të ndërmerreshin procedime të rregullta disiplinore kundër gjykatësve të Gjykatës së Rrethit të cilët nuk kishin dhënë vendimin. Në një shkresë të datës 5 prill 2006, shoqëria ankuese ka ankimuar pranë Gjykatës së Apelit se asaj nuk i ishte dërguar një kopje e vendimit të Gjykatës së Rrethit. Sipas dosjes së çështjes

310

vendimi i është dërguar asaj diku pas datës 5 prill 2006.

630. Më 13 qershor 2007 Gjykata e Apelit shfuqizoi vendimin e Gjykatës së Rrethit. Ajo zbuloi se nuk ka pasur ndërhyrje në të drejtën e pronës së ambasadës meqenëse ndërtimi sapo kishte filluar, kështu që nuk kishte ndërtesë që të respektonte distancat e planifikimit urban. Më tej ajo vendosi që meqenëse Gjykata e Lartë kishte vendosur më 20 mars 2001 që leja e ndërtimit nuk ishte e vlefshme, për rrjedhojë nuk mund të kishte ndërhyrje në të drejtën e pronës së Ambasadës. Përfundimisht ajo e rrëzoi çështjen.

631. Në një datë të pacaktuar në vitin 2007 ambasada ka apeluar pranë Gjykatës së Lartë. Më 14 korrik 2009 Gjykata e Lartë e ka shpallur apelimin të papranueshëm sipas nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile (pa argument të vlefshme apelimi).

Zhvillimet pas vendimit të Gjykatës së Apelit të datës 13 qershor 2007

632. Më 1 gusht 2007 Policia Ndërtimore e Tiranës njoftoi Ambasadën dhe Ministrinë e Punëve Publike që ajo do të zbatonte, vendimin e Gjykatës së Apelit të 3 datës qershor 2007 i cili, sipas saj, konfirmonte ligjshmërinë e lejes së ndërtimit të shoqërisë ankuese.

633. Më 21 gusht 2007, me kërkesë të shoqërisë ankuese, Gjykata e Rrethit nxori një urdhër ekzekutimi në lidhje me vendimin e Gjykatës së Apelit të datës 13 qershor 2007.

634. Në një datë të pacaktuar në vitin 2007 shoqëria ankuese rifilloi punën ndërtimore, e cila më tej u pezullua nga Policia Ndërtimore më 1 shtator 2007 në bashkëpunim me policinë.

635. Më 3 shtator 2007 inspektorati bashkiak i ndërtimit (IBN) i kërkoi shoqërisë ankuese të sillte dokumentet teknike që mungonin.

636. Më 19 shtator 2007, me kërkesë të shoqërisë ankuese, Prokuroria e Tiranës hetoi mbi ligjshmërinë e padisë së Policisë Ndërtimore të datës 11 shtator 2007 në mungesë të njoftimit me shkrim mbi pezullimin e punës ndërtimore. Shoqëria ankuese deklaroi që vlefshmëria e lejes së ndërtimit i ishte e bërë e njohur nga KKRT-ja dhe ishte konfirmuar me vendim të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës së Lartë respektivisht më datë 3 tetor 2001 dhe 20 prill 2005.

637. Më 24 Shtator 2007 IBN ka urdhëruar pezullimin e punës ndërtimore meqenëse në dosje mungonin disa dokumente teknike. Më 1 tetor 2007 shoqëria ankuese ka apeluar pranë Inspektoratit Kombëtar të Ndërtimit (IKN). Më 30 tetor 2007 IKN-ja njoftoi shoqërinë ankuese që ajo duhej t'ia paraqiste problemet e saj IBN-së.

638. Më 5 janar 2008, pasi vërejti që disa dokumente teknike mungonin, IBN-ja vendosi të pezullonte punimet. Nuk ka të dhëna që kundër këtij vendimi është depozituar ndonjë ankesë. Më 16 janar 2008 IBN-ja e shtyu urdhrin e pezullimit për një periudhë prej gjashtëdhjetë ditësh.

639. Më 8 mars 2008 IBN vendosi të ndalonte punën ndërtimore krejtësisht dhe të prishte atë çfarë ishte ndërtuar. Nuk ka të dhëna që kundër këtij vendimi është depozituar ndonjë ankesë. Gjithashtu nuk ka të dhëna që ndërtimi ekzistues është prishur.

II. E DREJTA DHE PRAKTIKA E BRENDSHME PËRKATËSE

A. Kushtetuta

640. Kushtetuta e Shqipërisë parashikon:

Neni 131

“Gjykata Kushtetuese vendos për: ... (f) gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave.”.

B. Akti i Planifikimit Urban 1998 (ligji nr.8405, datë 17 shtator 1998 i ndryshuar nga ligji nr.8501 datë 16 qershor 1999, ligji nr.8991, datë 23 janar 2003 dhe, së fundmi, ligji nr.9843 datë 17 dhjetor 2007) (Akti 1998)

641. Akti 1998 përcakton rregullat e përgjithshme që drejtojnë vendndodhjen dhe arkitekturën e ndërtimeve në Shqipëri. Akti ka hyrë në fuqi më 25 tetor 1998. Neni 7 parashikon përcaktimin e KKRT-së, të kryesuar nga Kryeministri. Përbërja e tij përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave (neni 8). Ministria përgjegjëse për rregullimin e territorit koordinon punën e KKRT-së (neni 12). Seksioni 14 parashikon përcaktimin e KRT bashkiake.

642. Akti 1998 ka krijuar një procedurë dy nivelesh për marrjen e lejeve të domosdoshme. Kërkesa për shesh ndërtimi fillimisht duhet të paraqitet për shqyrtim dhe aprovim pranë KRT-së

bashkiake sipas nenit 39. Leja e ndërtimit më pas duhet marrë sipas nenit 45. Ky përbën dokumentin e vetëm ligjor mbi bazën e të cilit mund të fillojë puna ndërtimore.

643. Neni 9 i aktit 1998 autorizonte KKRT-në, ndërmjet të tjerash të aprovonte studimin urban, si dhe lejet e ndërtimit në lidhje me ndërtimet në qendrat e qytetit. Sipas nenit 10 të aktit 1998, KKRT-ja ishte e autorizuar të shfuqizonte vendimet e miratuara nga KRT bashkiake. Me vendim nr.29 të datës 21 dhjetor 2006 Gjykata Kushtetuese i ka shpallur jokushtetuese këto pjesë të nenit 9 dhe seksionit 10, meqenëse ato shkelin parimin kushtetues të decentralizimit dhe autonomisë së pushtetit vendor.

C. Akti i Policisë Ndërtimore 1998 (Akti i Policisë 1998) ndryshuar nga akti i kontrollit ndërtimor 2007 (akti i Policisë 2007) (ligji nr.8408, datë 25 shtator 1998, shfuqizuar nga ligji nr.9780, datë 16 korrik 2007)

644. Akti i Policisë 1998 përcaktonte Policinë Ndërtimore përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatueshmërinë e legjislacionit të planifikimit urban. Policia Ndërtimore është autorizuar të caktojë gjoba, të vendosë mbi pezullimin e punës ndërtimore dhe të urdhërojë prishjen e ndërtimeve pa leje.

645. Akti i Policisë 2007 ka shfuqizuar Aktin e Policisë 1998 dhe ka përfshirë Inspektoratin e Ndërtimit dhe Planifikimit Urban, i cili funksionon në nivel bashkie/komune (inspektorati bashkiak i ndërtimit – IBN), në nivel qarku dhe nivel kombëtar (Inspektorati Kombëtar i Ndërtimit – IKN) (nenet 3, 7 dhe 8).

646. Detyrat e IBN-së përfshijnë caktimin e gjobave, pezullimin e punës ndërtimore, si dhe prishjen e ndërtimeve pa leje (neni 5). Inspektorët kanë të drejtë hyrjeje dhe kontrolli në sheshet e ndërtimit (neni 12 dhe vendimi i Këshillit të Ministrave nr.862, datë 5 dhjetor 2007).

647. Vendimet e IBN-së mund të apelojnë pranë IKN-së. Një palë e interesuar mund të ngrejë padi kundër një vendimi të IKN-së. Padia në gjykatë nuk ka efekt pezullues mbi ekzekutimin e vendimit administrativ të kundërshtuar (neni 14).

D. Akti i organizimit dhe funksionimit të policisë bashkiake dhe komunës (akti i policisë bashkiake) (ligji nr.8224, datë 15 maj 1997, i ndryshuar nga ligji nr.8335, datë 23 prill 1998)

648. Akti i Policisë Bashkiake parashikon krijimin e Policisë Bashkiake, e cila i përgjigjet kryetarit të bashkisë dhe funksionon nën mbikëqyrjen e prefektit. Sipas seksionit 8, Policia Bashkiake siguron zbatimin efektiv të akteve dhe vendimeve të kryetarit të bashkisë dhe këshillit të qytetit në lidhje me rendin publik dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës publike. Ajo parandalon, ndalon apo prish ndërtimet pa leje, si dhe ndalon zotërimet pa leje të ngastrave të tokës, ndërtesave të pronave që i përkasin bashkisë dhe siguron evakuimin e tyre të menjëhershëm (neni 8 § 6).

E. Kodi i Procedurës Civile

649. Nenet 189-201 rregullojnë pjesëmarrjen e palëve të treta në procedimet civile. Neni 195 parashikon që pala e tretë ka të drejtë të ndërmarrë të gjithë hapat procedurale ashtu si edhe palët kryesore në procedime, me përjashtim të hapave që kanë të bëjnë me vendosjen e objektit të padisë civile. Neni 196 parashikon që efekti i vendimit të marrë pas ndërhyrjes së një pale të tretë ndikon në mënyrë të barabartë në marrëdhënien ndërmjet palës së tretë dhe palës ankuese ose palës së paditur.

E DREJTA

I. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS

650. Ankuesit kanë pretenduar një numër shkeljesh të nenit 6 § 1 të Konventës, duke përfshirë mosekzekutimin e vendimit përfundimtar të Gjykatës së Apelit të datës 3 tetor 2003, shkelje të parimit të sigurisë juridike si rezultat i shfuqizimit të vendimit përfundimtar dhe tejzgjatjes së procedimeve gjyqësore.

Neni 6 § 1 i Konventës, në pjesën që lidhet me këtë ankesë, parashikon si më poshtë:

“Në përcaktimin e të drejtave të tij civile dhe detyrimeve ... çdokush ka të drejtë të ketë një proces ... të drejtë ... nga (një) gjykatë ... ”.

A. Pranueshmëria

1. Parashtrimet e palëve

651. Ankuesit u ankuan për moszbatim të vendimit të datës 3 tetor 2003 të Gjykatës së Apelit, i cili sipas pretendimeve të tyre kishte vendosur që leja e ndërtimit ishte e vlefshme dhe që

puna ndërtimore duhej të vazhdonte.

652. Pala Shqiptare ka parashtruar se ankuesit nuk janë ankuar pranë gjykatave të rretheve për moszekzekutim të vendimit përfundimtar të gjykatës dhe që nuk ka pasur shkelje për shkak të moszbatimit nga ana e autoriteteve të vendimit përfundimtar të gjykatës.

653. Ankuesit kanë argumentuar që vendimi i Gjykatës së Apelit i datës 3 tetor 2003 ishte vendim i formës së prerë, por ishte shfuqizuar me vendim të datës 14 dhjetor 2005 të gjykatës së rrethit, duke shkelur parimin e sigurisë juridike.

654. Pala Shqiptare argumentonte që objekti i serisë së dytë dhe të tretë të procedimeve ndryshonte. Vlefshmëria e lejes së ndërtimit ishte përcaktuar përfundimisht me vendim të datës 29 mars 2001 të Gjykatës së Lartë. Seria e dytë e procedimeve ishte pezulluar nga gjykata e rrethit, meqenëse ambasada nuk kishte *locus standi*.

655. Sipas ankuesve, procedimet gjyqësore vendore e kishin tejkaluar afatin e arsyeshëm kohor në kuptim të nenit 6 § 1 të Konventës.

656. Pala Shqiptare nuk ka ngritur asnjë kundërshtim për sa i përket pranueshmërisë së kësaj ankese.

2. Vlerësimi i Gjykatës

a) Mungesa e sigurisë juridike në lidhje me vendimet e gjykatave vendore

657. Gjykata rithekson se ajo është gjykatëse në cilësimin ligjor që bëhet mbi faktet e çështjes. Ajo nuk e konsideron veten të lidhur nga cilësimi që i kanë dhënë fakteve një ankues apo një palë qeveritare (shih Guerra dhe të Tjerë kundër Italisë, 19 shkurt 1998, § 44, raporte të gjykimeve dhe vendimeve 1998-I).

658. Gjykata vëren se palët nuk kanë kundërshtuar zbatueshmërinë e nenit 6 të Konventës. Sipas gjykatës, në lidhje me rrethanat e çështjes, ankesat e ankuesve për moszbatimin e vendimit të Gjykatës së Apelit të datës 3 tetor 2003 dhe shfuqizimin e tij të pretenduar janë thelbësisht të lidhura me ligjshmërinë e lejes së ndërtimit, e cila përbën thelbin kryesor të ankesave. Për rrjedhojë ajo mendon se është e nevojshme që të shqyrtohen të dyja ankesat mbi bazën e parimit të sigurisë juridike, veçanërisht nëse gjykatat vendase kanë ndjekur një linjë të njëtrajtshme arsyetimi në lidhje me ligjshmërinë e lejes së ndërtimit.

659. Gjykata gjykon se kjo ankesë nuk është haptazi e pabazuar në kuptim të nenit 35 § 3 të Konventës. Ajo vëren më tej se nuk ka arsye të tjera për ta deklaruar këtë pjesë të ankesës si të papranueshme dhe, si rezultat, e deklaron atë të pranueshme.

b) Zgjatja e procesit

660. Gjykata gjykon se kjo ankesë nuk është haptazi e pabazuar në kuptim të nenit 35 § 3 të Konventës. Ajo konstaton më tej se nuk ka arsye të tjera për ta deklaruar këtë pjesë të ankesës si të papranueshme dhe, si rezultat, e deklaron atë të pranueshme.

B. Themeli

1. Në lidhje me mungesën e sigurisë juridike për sa i përket vendimeve të gjykatave vendore

a) Parashtrimet e palëve

661. Pala Shqiptare vlerësonte se leja e ndërtimit është shpallur e pavlefshme me vendim të Gjykatës së Lartë të datës 29 mars 2001, vendim i cili kishte fuqinë *res judicata*. Ajo argumentonte që rasti ishte kompleks, ashtu siç paraqitej nga nevoja për tri seri të ndryshme procedurash.

662. Ankuesit argumentuan se ligjshmëria e lejes së ndërtimit është miratuar me vendim të Gjykatës së Apelit të datës 3 tetor 2003, i cili ka marrë formë të prerë. Ato mbronin mendimin se çështja nuk ishte komplekse dhe sipas tyre autoritetet duhej të fajësoheshin për ndërlikimin e panevojshëm të procedurave.

b) Vlerësimi i Gjykatës

663. E drejta për një proces të rregullt ligjor, garantuar nga neni 6 § 1 i Konventës, duhet të interpretohet sipas preambulës së Konventës, e cila, në pjesën përkatëse, deklaron që respektimi i ligjit duhet të jetë pjesë e trashëgimisë së përbashkët të shteteve kontraktuese. Një nga pjesët thelbësore të respektimit të ligjit është parimi i sigurisë juridike, i cili kërkon, ndërmjet të tjerash, që në rastet kur gjykatat kanë vendosur përfundimisht mbi një çështje, vendimi i tyre nuk duhet vënë në dyshim (shih Brumărescu k. Romania [GC], nr. 28342/95, § 61, ECHR 1999-VII).

664. Duke iu kthyer çështjes aktuale, kjo gjykatë duhet të përcaktojë nëse është marrë një vendim i formës së prerë dhe i detyrueshëm në lidhje me ligjshmërinë e lejes së ndërtimit. Ajo rithekson se i përket autoriteteve kombëtare dhe veçanërisht gjykatave, të interpretojnë dhe zbatojnë të drejtën e brendshme. Nuk është detyrë e gjykatës t'i vlerësojë faktet mbi bazën e të cilave gjykatat kombëtare marrin vendimin e tyre, me kusht që ky vendim të jetë në përputhje me nenet e Konventës. Në kuadrin e nenit 6 të Konventës, gjykata shqyrton kërkesat që pretendojnë shkelje të garancive specifike procedurale ose pretendojnë që drejtimi i procedurës, si i tërë, nuk ka siguruar garancitë e së drejtës për një proces të rregullt ligjor të ankuesit (shih *Schwarzkopf dhe Taussik k. the Czech Republic* (dec.), nr. 42162/02, 2 dhjetor 2008).

665. Gjykata vëren që tri seritë e procedurave gjyqësore janë përfshirë në kërkesën aktuale, dhe janë kryer në një hapësirë kohore prej pothuaj dhjetë vjetësh. Ndërsa objekti i secilës seri të procedurave gjyqësore në një farë mase ndryshonte, thelbi i të gjitha serive të marra së bashku, duke pasur parasysh vendimet e gjykatave vendore, kishte të bënte me ligjshmërinë e lejes së ndërtimit të shoqërisë ankuese.

666. Seria e parë e procedurave gjyqësore, e cila shqyrtoi ligjshmërinë e urdhrin të Ministrin dhe padinë e Policisë Ndërtimore, trajtonte ligjshmërinë e lejes së ndërtimit. Gjykata e vlerëson arsyetimin e Gjykatës së Lartë në vendimin e datës 29 mars 2001 inkoherent. Gjykata e Lartë deklaroi që vendimi i prefektit i datës 12 janar 2000 ishte *ultra vires* për arsye të mosshterimit të mjeteve ligjore administrative vendore në lidhje me vlefshmërinë e lejes së ndërtimit. Në të njëjtin vendim, Gjykata e Lartë e kundërshtoi këtë përfundim duke deklaruar lejen e ndërtimit të pavlefshme.

667. Gjykata vlerëson se kundërshtitë të tilla brenda të njëjtit vendim të Gjykatës së Lartë janë të papajtueshme me funksionin e saj gjyqësor. Roli i një Gjykate të Lartë në një Palë Kontraktuese është pikërisht të zgjidhë konfliktet, të shmangë divergjencat dhe të jetë e njëtrajtshme. Në të vërtetë, në çështjen aktuale, vetë Gjykata e Lartë është bërë burim i pasigurisë duke cenuar besimin publik në sistemin e drejtësisë dhe shtetin ligjor (shih, *mutatis mutandis*, *Beian k. Romania* (nr. 1), nr. 30658/05, §§ 37-39, ECHR 2007-...).

668. Si rezultat, procedurat gjyqësore kanë ndikuar në mënyrë të konsiderueshme në këtë klimë të përgjithshme të pasigurisë juridike. Pikërisht gjatë këtyre procedurave, ambasada ka kërkuar në thelb heqjen e lejes së ndërtimit. Fakti që gjykata e rrethit ka shqyrtuar padinë e ambasadës nënkuptonte që vlefshmëria e lejes së ndërtimit nuk ishte përcaktuar përfundimisht në serinë e parë të procedurave gjyqësore. Për më tepër, siç duket, vendimi i Gjykatës së Apelit i datës 3 tetor 2003 ka njohur ligjshmërinë e lejes së ndërtimit, ndërkohë që vendimi i Gjykatës së Lartë i datës 20 maj 2005 ka lënë pa përgjigje çështjen e ligjshmërisë së saj. (shih paragrafët 616 dhe 620–621 më lart).

669. Në serinë e tretë të procedurave gjyqësore, gjykatat vendase e kanë njohur ligjshmërinë e lejes së ndërtimit.

670. Gjykata vëren që shtetet kontraktuese janë të detyruara të organizojnë sistemin e tyre ligjor në mënyrë që të lejojnë gjykatat të identifikojnë procedurat gjyqësore dhe, kur është e nevojshme, të shmangin miratimin e vendimeve të papajtueshme. Ajo vlerëson që problemi themelor në çështjen aktuale ka rezultuar nga shumëfishtësia e procedurave gjyqësore, të cilat duhet të ishin menaxhuar më mirë për të kontribuar në sqarimin e shpejtë të çështjes në fjalë. Për gjykatën, ekzistenca e procedurave gjyqësore paralele të shumta dhe të ndërlydhura duke shtruar në thelb të njëjtën çështje ligjore nuk mund të konsiderohet në përputhje me shtetin e së drejtës. Autoritetet shqiptare duke dhënë një sërë vendimesh kontradiktore në disa nivele të juridiksionit të tyre kanë demonstruar mangësi në sistemin gjyqësor, fakt për të cilin ato janë përgjegjëse (shih, *mutatis mutandis*, *Gjonbocari dhe të Tjerë k. Shqipërisë*, nr. 10508/02, §§ 66-67, 23 tetor 2007; *Marini k. Shqipërisë*, nr. 3738/02, § 145, ECHR 2007-... (ekstrakte); dhe *Driza k. Shqipërisë*, nr. 33771/02, § 69, ECHR 2007-XII (ekstrakte)).

671. Për më tepër, mënyra në të cilën autoritetet e tjera vendase kanë proceduar nuk ka qenë aspak në përputhje me detyrimin e Palës Shqiptare për të trajtuar situatën e ankuesve në mënyrën më të qartë dhe koherente të mundshme dhe me qëndrueshmëri të plotë (shih *Beyeler k.*

Italisë [GC], nr.33202/96, § 120, ECHR 2000-I). Shkresat e autoriteteve vendore, të datave 1 gusht dhe 19 shtator 2007, i kanë shtuar konfuzion mungesës së vazhdueshme të qartësisë dhe sigurisë (shih paragrafët 632 dhe 636 më lart). Më tej, asnjë nga urdhrat e pezullimit të dhënë pas datës 29 mars 2001 nuk kanë përmendur pavlefshmërinë e lejes së ndërtimit si shkak justifikimi në argumentimin e tyre (shih paragrafët 623–624 dhe 637–639 më lart).

672. Nisur nga arsyetimet e ndërlidhura të përmendura më lart, Gjykata vlerëson që ka pasur shkelje të parimit të sigurisë juridike sa i përket arsyetimit të njëtrajtshëm në vendimet e gjykatave vendase lidhur me ligjshmërinë e lejes së ndërtimit.

2. Në lidhje me zgjatjen e procedimeve gjyqësore

673. Gjykata vlerëson se bazuar në konkluzionet e saj për shkeljet e nenit 6 § 1 të Konventës mbi shkeljen e parimit të sigurisë juridike, ajo nuk vendos veçmas mbi themelin e ankesës për zgjatje të procedurave ligjore.

II. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 1 TË KONVENTËS

674. Ankuesit dhe shoqëria ankuese kanë pretenduar që është shkelur e drejta e tyre për gëzimin paqësor të pronës së tyre. Më tej ato janë ankuar se në mënyrë të paligjshme janë privuar nga përdorimi i pronës së tyre për një periudhë të gjatë kohore.

Neni 1 i protokollit nr. 1 të Konventës parashikon:

“çdo person fizik apo juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të zotërimeve të tij. Asnjë person nuk do të privohet nga prona e tij me përjashtimin e interesave të publikut dhe kur u nënshtrohet kushteve të parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Dispozitat pararendëse, sidoqoftë, nuk do të cenojnë në asnjë mënyrë të drejtën e një shteti për të zbatuar këto ligje në mënyrën që e gjykon të nevojshme për të kontrolluar përdorimin e pronës në përputhje me interesin e përgjithshëm apo për të siguruar pagimin e taksave ose kontribute apo gjobave.”.

A. Pranueshmëria

1. Parashtrimet e palëve

675. Palët Shqiptare argumentojnë se shoqëria ankuese nuk ka pasur “pasuri” sipas kuptimit të nenit 1 të protokollit nr.1 meqenëse vendimi i Gjykatës së Lartë i datës 29 mars 2001 e ka shpallur lejen e ndërtimit të pavlefshme. Ajo i ka kërkuar Gjykatës të vlerësojë këtë ankesë të papajtueshme *ratione materiae*.

676. Pala Shqiptare parashtroi që e drejta e pronës e ankuesve është kufizuar nëpërmjet marrëveshjes kontraktuale që ato kishin përfunduar me shoqërinë ankuese. Ankesa e ankuesve për shkelje të së drejtës mbi pronën duhej t’i ishte drejtuar shoqërisë ankuese në kuadrin e marrëveshjes që ato kishin përfunduar me të. Si rezultat, sipas gjykimit të Palës Shqiptare, shtatë ankuesit nuk mund të konsideroheshin viktimë sipas kuptimit të nenit 34 të Konventës. Për më tepër, ankuesit nuk kishin filluar asnjë procedurë gjyqësore në lidhje me shkeljen e pretenduar të së drejtës së tyre mbi pronën.

677. Ankuesit argumentuan që ato ishin “viktimë” sipas kuptimit të nenit 34 të Konventës. Ata pohonin që neni 1 i protokollit nr.1 i njihte pronarëve të drejtën e gëzimit paqësor të pronës së tyre, gjë që sillte, *inter alia*, të drejtën për të përfunduar marrëveshje me palë të treta, me qëllim që të administrojnë pronën e tyre lirisht duke e shitur dhe e dhënë me qira apo duke bërë ndërtime në përputhje të plotë me dispozitat përkatëse të së drejtës së brendshme. Ankuesit kishin përfunduar një marrëveshje me shoqërinë ankuese si një nga kërkesat për të marrë leje ndërtimi. Sipas mendimit të ankuesve, fakti që bashkia kishte dhënë leje ndërtimi për punë ndërtimore në pronën e tyre, në parim, nuk mjaftonte për t’i privuar ato nga statusi i viktimës.

678. Shoqëria ankuese argumentoi që leja e ndërtimit përbënte pronë sipas kuptimit të nenit 1 të protokollit nr.1.

2. Vlerësimi i Gjykatës

679. Pyetja e parë që ngrihet është nëse shoqëria ankuese dhe ankuesit kishin një “pronë” sipas kuptimit të nenit 1 të protokollit nr.1 të Konventës.

680. Gjykata kujton që nocioni “pasuri” në nenin 1 të protokollit nr.1 ka kuptim autonom, i

cili sigurisht nuk është i kufizuar me pronësinë e mallrave fizike dhe është i pavarur nga klasifikimi formal në të drejtën e brendshme: të drejta dhe interesa të tjera që përbëjnë asete mund të konsiderohen, gjithashtu si “e drejta mbi pronën”, pra si “pasuri”. Çështja që duhet të shqyrtohet në secilin rast është nëse rrethanat e çështjes, të konsideruara si një e tërë, i japin ankuesve të drejtën e interesit thelbësor të mbrojtur nga neni 1 i protokollit nr.1 (shih Beyeler [GC], cituar më lart, § 100, ECHR 2000-I; Bronioëski k. Polonisë [GC], nr. 31443/96, § 129, ECHR 2004-V dhe Anheuser-Busch Inc. k. Portugalisë [GC], nr. 73049/01, § 63, ECHR 2007-...).

681. Në rastin e aseteve jofizike Gjykata ka shqyrtuar, në veçanti, faktin nëse pozicioni ligjor në fjalë ka ngritur çështjen e interesave dhe të drejtave financiare dhe kështu ka vlerë ekonomike (shih, për shembull, Anheuser-Busch Inc., cituar më lart, ku pronësia intelektuale përbënte pasuri; Paeffgen GMBH k. Gjermanisë (dec.), nr. 25379/04, 21688/05, 21722/05 dhe 21770/05, 18 shtator 2007, në të cilin e drejta për të përdorur apo vendosur fusha interneti përbënte pronë; Pine Valley Developments Ltd dhe të Tjerë k. Irlandës, 29 nëntor 1991, seria A nr. 222, ku dhënia e licencës vepruese tregtare nga autoritetet përbënte pronë; dhe Tre Traktörer AB k. Suedisë, 7 korrik 1989, seria A nr. 159, në të cilën licencat për të shërbyer pije alkoolike përbënin pronë).

682. Gjykata do shqyrtojë nëse rrethanat e çështjes, të konsideruara si një e tërë, japin shoqërisë ankuese dhe ankuesve një interes të mbrojtur nga neni 1 i protokollit nr.1. Në këtë drejtim, ajo vëren që kërkesa për leje ndërtimi nuk mund të krijojë një interes të mirëpërcaktuar të pronësisë. Një interes i tillë do të materializohet nëse kërkesa, pas shqyrtimit dhe përfundimit që përmbush kushtet formale dhe procedurale përkatëse, do të pranohej nga autoritetet përkatëse duke dhënë leje ndërtimi.

683. Në çështjen aktuale, Gjykata vëren se shoqërisë ankuese i është dhënë një leje ndërtimi nga Bashkia e Tiranës më 22 dhjetor 1998 për të ndërtuar në parcelën e tokës së ankuesve. Si rrjedhim, leja e ndërtimit përbënte “zotërim” për shoqërinë ankuese. Në këtë drejtim kundërshtimi i Palës Shqiptare në lidhje me mungesën e “pronës” të shoqërisë ankuese duhet të mos pranohet.

684. Në vetvete, leja e ndërtimit ka sjellë gjithashtu përfitime nga kontrata e negociuar ndërmjet shoqërisë ankuese dhe ankuesve për ndërtimin e bllokut të kullave. Prandaj ajo krijoi aset kapital dhe kishte vlerë ekonomike të përcaktuar për ankuesit. Pikërisht për arsye të lejes së ndërtimit vila ekzistuese trikatëshe e ankuesve u shkatërrua. Për më tepër, nuk ka pasur kundërshtim që ankuesit kanë vazhduar të kenë të drejtën e pronës mbi parcelën e tokës, e cila është “pronë ekzistuese” sipas kuptimit të nenit 1 të protokollit nr.1 të Konventës. Prandaj parashtrimet e Palës Shqiptare bazuar në mungesën e statusit të viktimës të ankuesve duhet të mos pranohet.

685. Përsa i përket parashtrimeve të Palës Shqiptare sipas së cilës ankuesit nuk kanë shteruar mjetet ligjore të brendshme, Gjykata thekson që në kontekstin e mekanizmit të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, vendimi për shterimin e mjeteve ligjore të brendshme duhet të zbatohet me njëfarë shkalle fleksibiliteti dhe pa formalizëm të tepruar. Në të njëjtën kohë ajo kërkon në parim që ankesat të cilat më tej synoheshin të ngriheshin në nivel ndërkombëtar, duhej që më parë të diskutoheshin pranë gjykatave [të brendshme të duhura], të paktën në thelb dhe në përputhje me kërkesat formale dhe afatet kohore të përcaktuara në të drejtën e brendshme (shih, ndërmjet shumë autoriteteve të tjera, Azinas k. Qipros [GC], nr. 56679/00, § 38, ECHR 2004-III, dhe Fressoz dhe Roire k. Francës [GC], nr. 29183/95, § 37, ECHR 1999-I).

686. Shoqëria ankuese ishte partnere me të cilën shtatë ankuesit kanë rënë dakord të përdorin interesin e tyre të pronësisë. Shoqëria ankuese ishte pala kryesore në procedurat e brendshme, ku ankuesit kanë vepruar si ndërmjetës, kryesisht në serinë e parë të procedurave të iniciuara nga ambasada zvicerane, e cila sipas mendimit të tyre, rezultoi në njoftimin e vlefshmërisë së lejes së ndërtimit. Sipas gjykimit të Gjykatës, procedurat e brendshme gjyqësore duhet të konsiderohen si një shqyrtim i së drejtës së pronësisë përkatëse të ankuesve dhe shoqërisë ankuese, meqenëse ligjshmëria e lejes së ndërtimit ndërlihej me faktin që ankuesit gëzonin interesin e pronësisë. Si rezultat, duhet të mos pranohet kundërshtimi i Palës Shqiptare bazuar në mosshterimin e mjeteve ligjore të brendshme nga ankuesit.

687. Gjykata vëren se kjo ankesë nuk është haptazi e pabazuar sipas kuptimit të nenit 35 § 3 të Konventës. Ajo konstaton më tej se nuk ka arsye të tjera për ta deklaruar këtë pjesë të ankesës si

të papranueshme dhe, si rezultat, e deklaroi atë të pranueshme.

B. Themeli

1. Parashtrimet e palëve

688. Pala Shqiptare argumentoi që sjellja e shoqërisë ankuese i pengonte autoritetet për shqyrtimin e ligjshmërisë së lejes së ndërtimit. Ajo argumentoi që në vendimin e saj nr. 1 të datës 27 prill 2004 KKRT ka parashikuar ndërtimin e ndërtesave jo më të larta se trikatëshe në qendër të qytetit.

689. Ankuesit dhe shoqëria ankuese mbrojnë mendimin që autoritetet kanë ndërhyrë në pronën e tyre duke e penguar shoqërinë ankuese të ndërtojë një ndërtesë në parcelën e tokës së ankuesve.

690. Ankuesit parashtruan se thelbi i ankesës së tyre lidhej me moszbatimin e vendimit të gjykatës së apelit të datës 3 tetor 2003. Ata argumentuan se pasiguria juridike që karakterizonte ngurrimin e autoriteteve ekzekutive për të zbatuar lejen e vlefshme të ndërtimit, si dhe mungesa e mjeteve ligjore të brendshme efektive, të kombinuara me mungesën e çdo lloji kompensimi, do të thoshte që atyre do t'u krijohej një barrë e tepërt.

691. Gjithashtu, ato pretenduan se ndërhyrja e autoriteteve në ndërtimin e një ndërtese afër pronës së një ambasade të huaj nuk përbënte interes të përgjithshëm, dhe as nuk krijonte një ekuilibër të drejtë. Ato gjithashtu përmendën që ndërtesat e larta ekzistonin tashmë në afërsi të pronës së tyre.

2. Vlerësimi i Gjykatës

a) Nëse ka pasur ndërhyrje

692. Neni 1 i protokollit nr.1 përfshin tri rregulla të qarta. Rregulli i parë, i cili ka natyrë të përgjithshme, formulon parimin e gëzimit paqësor të pasurive ai përcaktohet në fjalinë e parë të paragrafit të parë. Rregulli i dytë mbulon privimin e zotërimeve dhe ia nënshton atë kushteve të caktuara. Rregulli i tretë i njeh shteteve, ndërmjet të tjerash, të drejtën për të kontrolluar dhe përdorur pronën në përputhje me interesin e përgjithshëm, duke zbatuar ligje që ato i gjykojnë të nevojshme për këtë qëllim (shih Sporrong dhe Lönnroth k. Suedisë, 23 shtator 1982, § 61, seria A nr. 52).

693. Gjykata vëren që për vite ankuesit dhe shoqëria ankuese nuk kanë arritur të gëzojnë dhe përdorin lirshëm përfitimet e tyre kontraktuale për arsye të pezullimit të punës ndërtimore si rezultat i kundërshtimit të ligjshmërisë së lejes së ndërtimit. Shumëllojshmëria e procedurave ligjore ka dështuar në zgjidhjen e situatës. Si rrjedhim ka pasur ndërhyrje në të drejtën e pronës.

694. Sipas mendimit të Gjykatës nuk ka pasur shpronësim formal të pronës në fjalë, që do të thotë transferim i pronësisë dhe as mund të thuhet që ka pasur *de facto* privim të së drejtës pronësore. Masat e kundërshtuara kanë vënë kufizime në të drejtën e ankuesve dhe shoqërisë ankuese për të gëzuar interesat e pronës së tyre.

695. Gjykata konstaton se ndërhyrja duhet të konsiderohet si një kontroll i përdorimit të pronës së ankuesve që përbën objektin e paragrafit të dytë të nenit 1 të protokollit nr.1 (shih, për shembull, Sporrong dhe Lönnroth, cituar më lart, §§ 62 – 64; Tre Traktörer AB, cituar më lart, § 55; dhe Allan Jacobsson k. Suedisë (nr. 1), 25 tetor 1989, § 54, seria A nr. 163).

b) Nëse ndërhyrja ka qenë e ligjshme

696. Gjykata thekson se kushti i parë dhe më i rëndësishëm i nenit 1 të protokollit nr.1 është që çdo ndërhyrje nga një autoritet publik në gëzimin paqësor të pasurisë së dikujt duhet të jetë e ligjshme (Iatridis k. Greqisë [GC], nr. 31107/96, § 58, ECHR 1999-II).

697. Gjykata shpreh që kur përmendet “e drejta”, neni 1 protokollit nr.1, nënkupton që i njëjti koncept ndeshet kudo në Konventë, një koncept i cili përfshin të drejtën dhe praktikën gjyqësore. Ai i referohet cilësisë të së drejtës në fjalë, duke kërkuar që të jetë e prekshme për personat e interesuar, e saktë dhe e parashikueshme (shih Špaček, s.r.o., k. Republikës Çeke, nr. 26449/95, § 54, 9 nëntor 1999; Carbonara dhe Ventura k. Italisë, nr. 24638/94, § 64, ECHR 2000-VI; Baklanov k. Rusia, nr. 68443/01, §§ 40-41, 9 qershor 2005).

698. Gjykata pranon që kompetenca e saj është e kufizuar për të shqyrtuar zbatueshmërinë e së drejtës së brendshme, meqenëse së pari është detyrë e autoriteteve vendase për të interpretuar dhe

zbatuar të drejtën në fjalë. Në çështjen në shqyrtim, Gjykatës i kërkohet të verifikojë nëse mënyra në të cilën ishte interpretuar dhe zbatuar e drejta e brendshme sjell pasoja që janë në pajtim me parimet e Konventës.

699. Gjykata vëren që kjo ankesë lidhet ngushtë me ankesën sipas nenit 6 § 1 të Konventës në të cilën ajo konstatoi shkelje të parimit të sigurisë juridike (shih paragrafët 663–672 më lart). Në këtë kuptim, Gjykata vëren që praktika gjyqësore e Gjykatave të brendshme ka sjellë vendime inkohërente mbi ligjshmërinë e lejes së ndërtimit. Praktika gjyqësore nuk kishte saktësinë e kërkuar për të mundësuar shoqërinë ankuese dhe ankuesit të parashikojnë, në masë të arsyeshme në ato rrethana, pasojat e padive të tyre, si dhe ndërhyrjen e shtetit. (shih, *mutatis mutandis*, Sierpiński k. Polonisë, nr. 38016/07, §§ 74–76, 3 nëntor 2009 dhe Plechanoë k. Polonisë, nr. 22279/04, § 105–107, 7 korrik 2009). Një konfuzion i tillë dhe mungesa e parashikueshmërisë, gjë që shkakton arbitraritet, vazhdon të mbizotërojë edhe sot e kësaj dite.

700. Ndërhyrja në të drejtën e shoqërisë ankuese dhe të drejtën e pronësisë së ankuesve të cilët prishën vilën e tyre trikatëshe për arsye të lejes së ndërtimit të dhënë nga autoritetet, nuk mund të konsiderohet e ligjshme sipas kuptimit të nenit 1 të protokollit nr.1. Sipas këtij konstatimi është e panevojshme të sigurohet nëse është vënë një ekuilibër i drejtë ndërmjet kërkesave të interesit të përgjithshëm të komunitetit dhe nevojave për mbrojtjen e të drejtave themelore të ankuesve (shih Iatridis, cituar më lart, § 62).

701. Për rrjedhojë, ka pasur shkelje të nenit 1 të protokollit nr.1.

III. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

702. Neni 41 i Konventës parashikon:

“Nëse Gjykata konstaton se ka pasur shkelje të Konventës dhe të protokolleve të saj, dhe nëse e drejta e brendshme e palëve të larta kontraktuese lejon vetëm riparim të pjesshëm, Gjykata, nëse është e nevojshme akordon dëmshpërblim të drejtë për palën e dëmtuar.”.

A. Dëmi

703. Ankuesit pretenduan 1,547,037.4 euro në lidhje me dëmet materiale dhe 270 000 euro në lidhje me dëmet jomateriale. Shoqëria ankuese pretendoi 10 297 947 euro në lidhje me dëmet materiale dhe 1 650 000 euro në lidhje me dëmet jomateriale. Në mbështetje të pretendimit të tyre për dëmet materiale ato paraqitën një raport vlerësimi të ekspertit.

704. Pala Shqiptare parashitroi që ankuesi dhe shoqëria ankuese nuk ka shteruar mjetet ligjore të brendshme në lidhje me pretendimet e tyre për dëme material dhe jomateriale. Sidoqoftë, Gjykata thekson se vendimi për shterimin e mjeteve ligjore të brendshme nuk zbatohet në lidhje me pretendimet e nenit 41 (shih Matache dhe të Tjerë k. Rumanisë (shpërblim i drejtë), nr. 38113/02, § 16, 17 qershor 2008).

705. Gjykata konsideron që çështja e zbatimit të nenit 41 nuk është gati për vendim. Si rrjedhim çështja duhet të rezervohet dhe procedurat e mëtejshme duhet të caktohen me kujdesin e duhur mbi mundësinë e arritjes së marrëveshjes ndërmjet Qeverisë Shqiptare dhe shoqërisë ankuese e ankuesve.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, NJËZËRI:

1. Deklaron ankimin të pranueshëm.
2. Vendosi se ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje me shkeljen e parimit të sigurisë juridike.
3. Vendosi se ajo nuk e konsideron të nevojshëm shqyrtimin e ankesës për zgjatjen e procedurave sipas nenit 6 § 1 të Konventës.
4. Vendosi se ka pasur shkelje të nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës.
5. Vendosi që çështja e zbatimit të nenit 41 nuk është gati për vendim.

Si rezultat:

- a) Rezervon tërësisht çështjen e mësipërme.
- b) Fton Qeverinë dhe ankuesit të parashitrojnë, brenda tri muajve në vijim nga data kur vendimi bëhet përfundimtar në përputhje me nenin 44 § 2 të Konventës, vëzhgimet e tyre me shkrim

për çështjen, dhe në veçanti, të njoftojë Gjykatën për çdo marrëveshje që mund të arrihet prej tyre.

c) Rezervon procedurën e mëtejshme dhe i delegon Kryetarit të Dhomës Gjykuese autoritetin e zgjidhjes së kësaj çështjeje nëse është e nevojshme.

Bërë në anglisht dhe njoftuar më shkrim më datë 23 mars 2010, në përputhje me nenin 77 §§ 2 dhe 3 të rregullores së Gjykatës.

Fatos Araci
Zëvendësregjistruar

Nicolas Bratza
Kryetar

SEKSIONI I KATËRT
ÇËSHTJA LASKA DHE LIKA KUNDËR SHQIPËRISË
(Ankimet nr. 12315/04 dhe 17605/04)

VENDIM

STRASBURG
20 prill 2010

Ky vendim do të marrë formë të prerë në rrethanat e përcaktuara në nenin 44 § 2 të Konventës. Ai mund t'i nënshtrohet rishikimit redaktues.

Në çështjen Laska dhe Lika kundër Shqipërisë,
Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Katërt), duke gjykuar si dhomë e përbërë nga:

Nicolas Bratza, president
Lech Garlicki,
Giovanni Bonello,
Ljiljana Mijović,
Päivi Hirvelä,
Ledi Bianku,
Nebojša Vučinić, gjyqtarë,
dhe Fatoş Aracı, zëvendësregjistrues i Seksionit,
pas shqyrtimit me dyer të mbyllura, më 12 janar 2010 dhe 23 mars 2010,
shpall vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua në datën e fundit të përmendur:

PROCEDURA

706. Çështja e ka zanafillën në dy ankime (nr. 12315/04 dhe 17605/04) kundër Republikës së Shqipërisë, depozituar pranë Gjykatës sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa) nga dy shtetas shqiptarë, z. Vladimir Laska dhe z. Artur Lika (ankuesit), më 8 mars 2004.

707. Ankuesit u përfaqësuan nga z. A. Dobrush i Qendrës Europiane për të Drejtat e Romëve dhe më pas u bashkëpërfaqësuan nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit. Qeveria Shqiptare (Qeveria) u përfaqësua nga agjentja e asaj kohe, znj. S. Meneri, dhe, në vijim të parashtrimit të komenteve të saj mbi pretendimin e ankuesit për një dëmshpërblim të drejtë, nga agjentja e saj, znj. E. Hajro.

708. Ankuesit u ankuan sipas nenit 3 të Konventës se ata i ishin nënshtruar keqtrajtimit gjatë marrjes në pyetje nga ana e policisë për t'i detyruar të pranonin shkeljet e supozuara. Gjithashtu bazuar në nenin 6 § 1 të Konventës ata u ankuan për padrejtësi të procedimeve gjyqësore.

709. Më 10 tetor 2007 zëvendëspresidenti i Seksionit, të cilit i ishte caktuar çështja, vendosi ta njoftojë Qeverinë për ankimet. Sipas dispozitave të nenit 29 § 3 të Konventës, u vendos të shqyrtohej themeli i ankimeve në të njëjtën kohë me pranueshmërinë e tyre.

710. Secila nga palët, ankuesit dhe Qeveria, parashtruan vërejtjet e tyre me shkrim (rregulli 59 § 1).

FAKTET

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

711. Të dy ankuesit kanë lindur në vitin 1980 dhe aktualisht vuajnë dënimin me burgim në burgun e Burrelit, në Shqipëri.

A. Arrestimi i ankuesve

712. Më 31 mars 2001 në mëngjes, tre persona të veshur me kapuç me ngjyrë blu dhe të bardhë, grabitën një mikrobus në linjën ndërmjet Tiranës dhe Kukësit. Ata ishin të armatosur me dy kallashnikovë dhe një thikë. Pasi kanë marrë paratë dhe stolitë e pasagjerëve, ata janë larguar nga

320

vendi i ngjarjes pa shkakuar viktimë.

713. Disa orë pas ngjarjes, policia kontrollon shtëpitë pranë vendngjarjes, duke përfshirë edhe atë të z. Lika (ankuesi i dytë), ku ai po hante drekë me babain e tij, vëllain e tij, B.L., dhe shokun e tij, z. Laska (ankuesi i parë).

714. Oficerët e policisë kanë kryer kontrollin e mësipërm në mungesë të avokatit të ankuesve.

715. Sipas raportit të kontrollit të policisë, policia gjeti në xhepin e xhakës së ankuesit të parë dy bluza pambuku dhe një cohë ngjyrë blu, të bëra në kapuçë. Për më tepër, në afërsi të shtëpisë ata gjetën disa granata, por nuk arritën të gjejnë mallra të vjedhura apo armë që kishin qenë në posedim të agresorëve.

716. Ankuesit, B.L. dhe babai u shoqëruan në polici për t'u pyetur. Ankuesi i parë kërkoi, por iu refuzua prania e avokatit të tij (H.B). Ai kundërshtoi të ketë pasur në zotërim të tij një kapuç apo lloj tjetër maske, si dhe akuzoi policinë për manipulimin e provave.

717. Në të njëjtën ditë, oficerët e policisë të ngarkuar me hetimin vazhduan me identifikimin e personave dhe sendeve të viktimave të grabitjes, sipas neneve 171 dhe 172 të Kodit të Procedurës Penale (KPP). Avokati i ankuesve nuk ishte i pranishëm.

718. Në lidhje me identifikimin e personave, ankuesit dhe B.L., të veshur me kapuçë blu dhe të bardhë të bëra në shtëpi, dhe dy persona të tjerë të veshur me kapuçë të zinj, janë vendosur në rresht në të njëjtën dhomë në mënyrë që të identifikoheshin. Pavarësisht nga fakti se policia ndryshoi pozicionin e personave në dhomë, viktimat identifikuan vazhdimisht personat me kapuçë blu dhe të bardhë si agresorë, që do të thotë ankuesit dhe B.L.

719. Në lidhje me identifikimin e objekteve, viktimave iu kërkua të identifikojnë kapuçat e përdorur nga agresorët, duke zgjedhur ndërmjet dy kapuçave të zinj, dy kapuçave të bardhë dhe një blu. Viktimat identifikuan kapuçat e bardhë dhe blu njëllor me ato të veshur nga agresorët.

720. Në orën 21.30 në të njëjtën ditë, ankuesit dhe B.L. u arrestuan me dyshimin për grabitje të armatosur. Ata u pyetën nga policia në mungesë të një avokati, pavarësisht nga fakti se B.L. ishte i mitur në atë periudhë dhe se ankuesit kishin kërkuar haptazi praninë e një avokati. Ankuesi i parë pranoi se kishte në zotërim të tij një bluzë pambuku të bardhë, të shndërruar nga F.N, një oficer policie i ngarkuar me hetimet, në një kapuç të bërë në shtëpi. Ankuesi i dytë deklaroi se bluza prej pambuku e bardhë që ishte gjetur në posedim të ankuesit të parë nuk ishte e tij.

721. Më 2 prill 2001 ankuesit dhe B.L. u akuzuan për grabitje të armatosur dhe për armëmbajtje pa leje. Ata u pyetën nga prokurori në të njëjtën ditë. Ankuesi i parë kërkoi të përfaqësohej nga H.B. Ankuesi i dytë kërkoi të mbrohej nga një avokat.

B. Procedimet gjyqësore kundër ankuesve

722. Më 29 qershor 2001 Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm (ZPP) kërkoi të inspektojë dosjen penale të hetimit në lidhje me ankuesin e dytë. Më 10 shtator 2001 ZPP pranoi çështjen duke u angazhuar për gjykimin e saj.

723. Më 11 shtator 2001, prokurori dërgoi ankuesit dhe B.L. për gjykim me akuzën e grabitjes së armatosur dhe armëmbajtje pa leje.

724. Gjatë seancës gjyqësore të datës 26 nëntor 2001 pranë Gjykatës së Rrethit Pukë, (Gjykata e Rrethit), ankuesit kundërshtuan akuzat kundër tyre dhe i kërkuan gjykatës vendase ta deklaronte të pavlefshëm identifikimin e kryer nga policia të personave dhe objekteve, meqenëse përbënte shkelje të dispozitave përkatëse të KPP. Për më tepër, ata akuzonin oficerët e policisë të ngarkuar me hetimin për manipulimin e provave kundër tyre, për këtë arsye ankuesit i kërkuan gjykatës të thërrasë oficerët e policisë si dëshmitarë dhe të paraqesin në gjyq sendet e konsideruara nga policia si kapuçë, por të cilat ishin, sipas mendimit të tyre, bluza pambuku të thjeshta. Ankuesit i kërkuan gjykatës vendase për të përjashtuar provat e paligjshme kundër tyre. Në lidhje me akuzën për armëmbajtje pa leje, ankuesit pohuan se hetimi nuk kishte arritur të gjente armët e përdorura nga shkelësit e ligjit gjatë grabitjes, si dhe nuk ishte provuar që granatat e gjetura ishin në posedim të tyre. Të dy ankuesit u përfaqësuan nga i njëjti mbrojtës, P.Gj.

725. Më 24 maj 2002 gjykata e rrethit rrëzoi kërkesën e ankuesve për të thirrur si

dëshmitarë oficerët e policisë, pa dhënë arsytet. Pavarësisht faktit që gjykata konstatoi disa parregullsi gjatë fazës së hetimeve (si mungesa e avokatit gjatë pyetjes së ankuesve dhe gjatë identifikimit të personave dhe objekteve), gjykata i shpalli ankuesit fajtorë për grabitje të armatosur bazuar në identifikimin e dëshmitarëve okularë të ankuesve si shkelës të ligjit. Për më tepër, gjykata i shpalli ankuesit fajtorë për armëmbajtje pa leje të dy kallashnikovëve, si dhe B.L. fajtor për posedim të një thike. Meqenëse nuk janë gjetur armë, dënimi i ankuesve është bazuar në deklaratat e dëshmitarëve okularë. Gjykata i dënoi ankuesit me trembëdhjetë vjet burg dhe B.L. me pesë vjet burg. Ankuesit janë urdhëruar të vuajnë dënimin e tyre në një burg të sigurisë së lartë.

726. Më 29 maj 2002 ankuesit iu drejtuan Gjykatës së Apelit Shkodër (Gjykata e Apelit), për arsye se vendimi i gjykatës së rrethit ishte rezultat i procedurave të padrejta. Ata argumentuan që identifikimi është kryer në shkelje flagrante të neneve 171-175 të KPP meqenëse ata mbanin veshur të njëjtët kapuçë gjatë paradës së identifikimit. Kërkesa e avokatëve të tyre mbi pavlefshmërinë e veprimeve në lidhje me identifikimin, ishte refuzuar nga gjykata. Gjithashtu ata deklaruan që asnjë nga provat materiale (kapuçat), siç u kërkua nga ata vetë, nuk u paraqitën në procedimet gjyqësore. Për më tepër, autoritetet nuk kanë arritur të gjejnë paratë dhe armët që janë përdorur gjatë grabitjes.

727. Më 9 shtator 2002, gjykata e apelit la në fuqi vendimin e gjykatës së rrethit.

728. Më 7 tetor 2002 ankuesit apeluan pranë Gjykatës së Lartë. Ata u bazuan në të njëjtat argumente të ankimit si para gjykatës së apelit. Gjithashtu ata pretenduan që të dy janë përfaqësuar nga i njëjti mbrojtës para gjykatave më të ulëta, në një kohë kur në dëshmitë e tyre kishte mospërputhje gjatë hetimeve penale.

729. Më 26 dhjetor 2002 Gjykata e Lartë e shpalli ankimin të papranueshëm meqenëse argumentet e tij ishin jashtë fushës së veprimit të nenit 432 të KPP.

730. Në një datë të pacaktuar ankuesi i parë depozitoi një ankesë pranë Gjykatës Kushtetuese mbi padrejtësinë e procedimeve gjyqësore. Ai u bazua në të njëjtat argumente të ngritura pranë gjykatës së apelit dhe Gjykatës së Lartë.

731. Më 17 shtator 2004 Gjykata Kushtetuese, me trup gjykues prej tre gjyqtarësh, e deklaroi ankimin të papranueshëm. Ajo vendosi që ankimet e ankuesve nuk ngrinin çështje që lidhen me gjykimin e drejtë, por kryesisht kishin të bënin me vlerësimin e provave, gjë që ishte funksion i gjykatave më të ulëta.

C. Pretendimi për keqtrajtim nga policia

732. Ankuesit pretenduan që janë keqtrajtuar nga F.N. dhe oficerë të tjerë të policisë gjatë marrjes në pyetje. Ata pretendonin se janë lidhur me litarë, rrahur dhe lagur me ujë të ftohtë gjatë hetimeve.

733. Në seancën gjyqësore të datës 26 nëntor 2001 pranë gjykatës së rrethit, ankuesit pretenduan se janë keqtrajtuar nga oficerët e policisë të ngarkuar me hetimet, në atë që ky i fundit ishte përpjekur të detyronte ata të pranonin grabitjen dhe të tregonin vendndodhjen e mallrave të vjedhura dhe armëve të përdorura. B.L. dhe ankuesit kanë dhënë të njëjtin përkthim për keqtrajtimin e pretenduar.

734. Më 24 maj 2002 Gjykata e Rrethit rrëzoi kërkesat e ankuesve duke argumentuar që ato janë parashtruar përtej afatit gjashtëmuor. Në vendim nuk është përmendur asnjë bazë ligjore.

II. E DREJTA NDËRKOMBËTARE DHE E BRENDSHME PËRKATËSE DHE PRAKTIKA

A. E drejta e brendshme përkatëse dhe praktika

1. Kodi i Procedurës Penale

735. Kodi shqiptar i Procedurës Penale (KPP) në pjesët përkatëse vijon si më poshtë:

Neni 171: Identifikimi i personave

1. Kur lind e drejta për identifikimin e një personi, autoriteti procedues fton personin që duhet të bëjë identifikimin që të përshkruajë personin (që do të identifikohet), në lidhje me të gjitha shenjat që ai/ajo kujton dhe personi pyetet nëse ai/ajo është thirrur më parë për të bërë identifikimin dhe për rrethana të tjera, të cilat mund të ndihmojnë në saktësinë e identifikimit.

2. Veprimet e parashikuara në paragrafin 1 dhe deklaratat e bëra nga personi që bën

identifikimin shënohen në regjistër.

3. Moszbatimi në përputhje me dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 përbën shkak për pavlefshmërinë e identifikimit.

Neni 172: Kryerja e identifikimit

1. Autoriteti procedues, pasi largon personin që do të bëjë identifikimin, siguron praninë e të paktën dy personave, të cilët të duken mundësisht sa më të ngjashëm, me personin që do të identifikohet. Më pas fton këtë të fundit për të zgjedhur vendin e tij/saj në lidhje me të tjerët, duke u kujdesur që t'i duket portreti, sa më shumë që të jetë e mundur, në të njëjtat rrethana në të cilat ai/ajo do të ishte parë nga personi i thirrur për të bërë identifikimin. Pasi shfaqet personi që do të bëjë identifikimin, gjykata e pyet këtë të fundit nëse ai/ajo njih ndonjërin prej personave të pranishëm për identifikim, dhe nëse po, të tregojë personin që ai/ajo njih, si dhe të përcaktojë nëse ai/ajo është i sigurtë.

2. Kur ka arsye të besohet se personi i thirrur për të bërë identifikimin mund të jetë i frikësuar ose i ndikuar nga prania e personit që do identifikohet, autoriteti procedues urdhëron kryerjen e veprimit pa e parë ky i fundit të parin.

3. Regjistrimi duhet të përshkruajë mënyrën e kryerjes së identifikimit. Nëse kjo gjë nuk mundësohet, identifikimi bëhet i pavlefshëm. Për qëllime regjistrimi, autoriteti procedues mund të urdhërojë që kryerja e identifikimit të fotografohet apo filmohet.

Neni 173: Identifikimi i objekteve

1. Kur duhet të kryhet identifikimi i provave materiale apo objekteve të tjera në lidhje me veprën penale, autoriteti procedues vepron në përputhje me rregullat për identifikimin e personave në masën që ato janë të zbatueshme.

2. Pas zbulimit, nëse është e mundur, e të paktën dy objekteve të ngjashme me atë që do të identifikohet, autoriteti procedues pyet personin e thirrur për të identifikuar nëse ai/ajo njih ndonjë prej tyre dhe, nëse përgjigja është po, e fton atë të deklarojë cilin prej objekteve ai/ajo njih, si dhe të përcaktojë nëse është i/e sigurt.

3. Regjistrimi duhet të përshkruajë mënyrën e kryerjes së identifikimit. Nëse kjo gjë nuk mundësohet, identifikimi bëhet i pavlefshëm.

Neni 175: Identifikimi nga disa persona

1. Kur disa persona thirren për të dëshmuar për të njëjtin person apo objekt, autoriteti procedues e kryen atë duke i marrë një nga një në veçanti, duke ndaluar komunikimin ndërmjet personit që ka bërë identifikimin dhe atyre që do të bëjnë identifikimin më vonë.

2. Kur një person duhet të identifikojë disa persona ose objekte, autoriteti procedues urdhëron që personi apo objekti që do identifikohet të vendoset ndërmjet personave apo objekteve të tjera.

3. Dispozitat e neneve 171, 172 dhe 173 të KPP janë të zbatueshme.

Neni 205: Kontrolli i ambientit

1. Të pandehurit, kur është i pranishëm, dhe personit i cili posedon ambientet që do t'i nënshtrohen kontrollit, i jepet një kopje e urdhërkontrollit, duke i informuar ata për të drejtën për të kërkuar praninë e një personi tek i cili kanë besim.

2. Kur personat e përcaktuar në paragrafin 1 mungojnë, një kopje i jepet të afërmit, komshiut ose kolegut.

3. Autoriteti procedues mund të kontrollojë personat e pranishëm nëse gjykon që ata mund të fshehin prova materiale ose objekte në lidhje me veprën penale. Ai mund të urdhërojë që personat e pranishëm nuk mund të largohen përpara përfundimit të kontrollit dhe mund të përdorë forcën për t'i mbajtur ata që largohen.

Neni 256: Pyetja e të arrestuarit ose të ndaluarit

Prokurori pyet personin e arrestuar ose të ndaluar në prani të avokatit të zgjedhur apo të caktuar. Ai njofton personin e arrestuar apo të ndaluar mbi faktet për të cilat ai po ndiqet dhe arsyet e hetimit, duke i bërë të njohur informacionin në dispozicion për akuzën dhe, kur hetimi nuk dëmtohet, edhe burimet.

Neni 380: Provat e përdorura nga gjykata

Në marrjen e vendimit gjykata nuk përdor prova të ndryshme nga ato që janë marrë ose konfirmuar gjatë gjykimit.

736. Nenit 449–461 të KPP rregullojnë zbatimin për rishqyrtim të vendimit përfundimtar. Sipas nenit 451, i akuzuari ose prokurori mund të depozitojë një kërkesë për rishqyrtim në përputhje me argumentet e kufizuara për rishqyrtim që gjenden në nenin 450. Kërkesa i parashtrahet Gjykatës së Lartë, e cila mund të vendosë refuzimin ose pranimin e saj (neni 453).

Vendimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 6 i datës 11 tetor 2002

737. Në përpjekje për të harmonizuar praktikën ligjore, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë filluan shqyrtimin gjyqësor të vendimit nr. 6 të datës 11 tetor 2002. Pjesët përkatëse të vendimit vijnë:

“(…) Është e ditur që rishqyrtimi i vendimeve përfundimtare është një mjet ligjor i jashtëzakonshëm, i vetmi, që është parashikuar nga ligjvënësit në KPP për të ndrequr gabimet gjyqësore (në lidhje me vendimet përfundimtare të gjykatës).

Gjykimi i zhvilluar, si rezultat i rishqyrtimit [procedurave], nuk kufizohet me një shqyrtim të thjeshtë (në kuptimin më të ngushtë të fjalës) të gjykimit të mëparshëm. Në përfundimin e saj, gjykata pasi shqyrton faktet, rrethanat dhe provat e parashtruara nga palët, të marra së bashku dhe në bashkërendim me provat, rrethanat dhe faktet e administruara dhe shqyrtuara gjatë gjykimit të mëparshëm, mund të arrijë në një përfundim të ndryshëm, aq sa të shpallë një vendim në kundërshtim të plotë me të mëparshmin. (...).

Kjo është arsyeja pse ligjvënësi lejoi shqyrtimin në raste të përcaktuara qartë, të cilat përcaktohen qartë në një dispozitë të veçantë të KPP, veçanërisht në nenin 450 (...). Sipas kësaj dispozite, shqyrtimi mund të kërkohej nga palët vetëm nëse ekziston një nga kushtet të parashikuara qartë në të.”.

B. E drejta ndërkombëtare përkatëse

1. Rekomandimi nr. R (2000) 2 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës për shtetet anëtare mbi rishqyrtimin apo rihapjen e çështjeve të caktuara në nivel vendi pas vendimeve të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

738. Më 19 janar 2000, në takimin e 694 të zëvendësministrave, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës miratoi Rekomandimin nr. R (2000) 2 mbi rishqyrtimin dhe rihapjen e çështjeve të caktuara në nivel vendi pas vendimeve të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut:

“Komiteti i Ministrave, sipas kushteve të nenit 15.b të Statutit të Këshillit të Europës;

Duke pasur parasysh se qëllimi i Këshillit të Europës është që të sjellë një bashkim më të ngushtë ndërmjet anëtarëve të saj;

Duke pasur parasysh Konventën për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (e njohur më tej Konventa);

Duke vënë në dukje se në bazë të nenit 46 të Konventës për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore (Konventa) Palët Kontraktuese kanë pranuar detyrimin që t'i përmbahen vendimit përfundimtar të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore në çdo çështje në të cilën ata janë palë dhe që Komiteti i Ministrave mbikëqyr zbatimin e tij;

Duke sjellë në mendje se në rrethana të caktuara detyrimi i lartpërmendur mund të sjellë miratimin e masave, të ndryshme nga dëmtshpërblimi i drejtë dhënë nga Gjykata në përputhje me nenin 41 të Konventës dhe/ose masa të përgjithshme, të cilat sigurojnë që pala e dëmtuar është vënë sa është e mundur në të njëjtën situatë që ishte para shkeljes së Konventës (*restitutio in integrum*);

Duke vënë në dukje se i takon autoriteteve kompetente të Shtetit të paditur që të vendosë se çfarë masash janë më të përshtatshme për të arritur *restitutio in integrum*, duke marrë parasysh mjetet në dispozicion sipas sistemit ligjor kombëtar;

Duke sjellë në mendje, megjithatë, që praktika e Komitetit të Ministrave në mbikëqyrjen e ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës tregon që në rrethana të veçanta rishqyrtimi i çështjes apo rihapja e procedurave ka provuar të jetë më efikas, nëse jo, i vetmi mjet për arritjen e *restitutio in integrum*;

I. Fton, Palët Kontraktuese që në dritën e këtyre konsideratave të sigurojnë ekzistencën në nivel kombëtar të mundësive të mjaftueshme për të arritur, sa më shumë të jetë e mundur, *restitutio*

in integrum;

II. Nxit Palët Kontraktuese, në veçanti, që të shqyrtojnë sistemet e tyre kombëtare ligjore me qëllim që të sigurojnë ekzistencën e mundësive të mjaftueshme për rishqyrtimin e çështjes, duke përfshirë rihapjen e procedimeve, në rastet ku Gjykata ka konstatuar shkelje të Konventës, veçanërisht ku:

i) pala e dëmtuar vazhdon të vuajë pasoja shumë të rënda negative si pasojë e rezultatit të vendimit vendas për çështjen, të cilat nuk rregullohen në mënyrë të mjaftueshme nga shpërblimi i drejtë dhe nuk mund të korrigjohen përveçse me rishqyrtim apo rihapje; dhe

ii) vendimi i Gjykatës të çon në përfundimin se

a) vendimi vendas i kundërshtuar është në themel në kundërshtim me Konventën; ose

b) shkelja e konstatuar bazohet në gabime procedurale ose mangësi të një rëndësie të tillë saqë hidhet dyshim serioz mbi rezultatin e procedimeve vendase të ankimuara.”.

739. Memorandumi shpjegues mbi Rekomandimin R (2000) 2 në lidhje me këtë çështje parashikon, se:

“...Paragrafi 1 përcakton parimin bazë sipas rekomandimit që të gjitha viktimave të shkeljeve të Konventës duhet t’u njihet e drejta, sa të jetë e mundur, për një *restitutio in integrum* efektiv. Për rrjedhojë, Palët Kontraktuese duhet të shqyrtojnë sistemet e tyre ligjore me qëllim që të sigurojnë ekzistencën e mundësive të duhura...”.

2. Detyrimet e shteteve sipas të drejtës ndërkombëtare të përgjithshme

740. Neni 35 i projekt neneve të Komisionit të së Drejtës Ndërkombëtare mbi Përgjegjësinë e Shteteve për Akte të Paligjshme Ndërkombëtare (miratuar nga Asambleja e Përgjithshme në sesionin e saj të 53-të (2001), dhe paraqitur në të dhënat zyrtare të Asamblesë së Përgjithshme, Sesioni i 56-të, shtojca nr. 10 (A/56/10)) formulohet si më poshtë:

Neni 35: Dëmshpërblimi

“Një shtet përgjegjës për një akt të paligjshëm ndërkombëtar ka detyrimin të dëmshpërblejë, pra, të ripërcaktojë situatën që ekzistonte përpara kryerjes së aktit të paligjshëm ndërkombëtar, me kusht dhe në masën që dëmshpërblimi:

a) nuk është materialisht i pamundur;

b) nuk përfshin një barrë nga e gjithë pjesa e përfutur që rrjedh nga dëmshpërblimi në vend të kompensimit.”.

E DREJTA

741. Ankuesit u ankuan sipas nenit 3 të Konventës se i janë nënshtruar keqtrajtimit gjatë marrjes në pyetje nga policia për t’i detyruar ata të pranojnë shkeljet e pretenduara.

Neni 3 i Konventës parashikon:

“Askush nuk duhet t’i nënshtrohet torturës ose trajtimit çnjerëzor ose degradues ose dënimit.”.

742. Gjithashtu, ata u ankuan për padrejtësi të procedimeve gjyqësore kundër tyre sipas nenit 6 § 1 të Konventës.

Neni 6 § 1 i Konventës, në lidhje me këtë çështje, vijon:

“Në përcaktimin e ... çdo akuze penale kundrejt tij, çdo person ka të drejtën e një procesi ... të drejtë ligjor ... nga [një] ... gjykatë ...”.

I. BASHKIMI I ANKIMEVE

743. Duke pasur parasysh se dy ankimet kanë të bëjnë me të njëjtat fakte, ankesa dhe procedime gjyqësore, Gjykata vendos që ato duhet të bashkohen sipas rregullit 42 § 1 të rregullores së Gjykatës.

II. PRANUESHMËRIA E ANKESAVE

A. Ankesa për keqtrajtim të pretenduar nga oficerët e policisë

744. Pala Shqiptare parashittoi që ankuesit nuk i kanë raportuar autoriteteve pretendimet e tyre për keqtrajtim gjatë hetimit penal. Ata nuk kanë shprehur këtë ankese as gjatë apelimeve të tyre në Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën e Lartë.

745. Ankuesit pohuan që, në rrethanat e çështjes, një referencë e thjeshtë e mosshterimit nuk mund të lirojë Qeverinë Shqiptare nga detyrimi i saj sipas Konventës apo të paraqitet si një

argument i besueshëm para kësaj Gjykate.

746. Gjykata thekson se rregulli i shterimit të mjeteve ligjore vendase sipas nenit 35 të Konventës detyron ata që kërkojnë të paraqesin çështjen e tyre kundër shtetit para Gjykatës, të përdorin së pari mjetet ligjore të parashikuara nga sistemi ligjor kombëtar (shih Handyside k. Mbretërisë së Bashkuar, 7 dhjetor 1976, § 48, seria A nr. 24). Ankesat duhej t'i ishin bërë organeve vendase të duhura, të paktën në thelb dhe në përputhje me kushtet formale dhe afatet e përcaktuara në të drejtën vendase dhe, më tej, mund të përdorej çdo mjet procedural që mund të pengonte shkeljen e Konventës (shih Cardot k. Francës, 19 mars 1991, § 34, seria A nr. 200).

747. Gjykata konstaton se më 24 maj 2002 gjykata e rrethit rrëzoi kërkesën e ankuesve për keqtrajtim të pretenduar duke argumentuar se ishte e ndaluar në atë periudhë. Nga dosja e çështjes nënkuptohet që ankuesit nuk apeluan kundër këtij vendimi. Gjithashtu ata nuk e ngritën këtë ankesë, të paktën në thelb, në apelimet e tyre pranë gjykatës së apelit dhe Gjykatës së Lartë. Gjykata arrin në përfundimin që ankuesit nuk shteruan mjetet ligjore vendase të ofruara nga sistemi ligjor vendas. Si rrjedhim, ajo rrëzon ankesën e ankuesve në përputhje me nenin 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës.

B. Ankesa për padrejtësinë e procedimeve gjyqësore

1. Mosshterimi i mjeteve ligjore vendase

a. Për sa i përket mosparaqitjes nga ankuesi i dytë të një apeli kushtetues.

748. Qeveria parashtroi që ankuesi i dytë nuk ka apeluar pranë Gjykatës Kushtetuese në lidhje me ankesën e tij për padrejtësi të procedimeve gjyqësore. Ajo i kërkoj Gjykatës të deklarojë ankesën e tij të papranueshme për mosshterim të mjeteve ligjore vendase.

749. Ankuesi i dytë parashtroi që nuk kishte mundësi të arsyeshme për sukses pranë Gjykatës Kushtetuese duke pasur parasysh faktin që apeli i ankuesit të parë ishte rrëzuar.

750. Gjykata konstaton që sipas nenit 35 një ankues duhet të bëjë rekurs normal për mjete ligjore, të cilat janë të vlefshme dhe të mjaftueshme për të siguruar rishqyrtimin në lidhje me shkeljet e pretenduara. Ekzistenca e mjeteve ligjore në fjalë duhet të jetë mjaft e sigurt, jo vetëm në teori por edhe në praktikë, mungesa e të cilave sjell edhe mungesën e aksesit dhe efektivitetit të domosdoshëm (shih Aksoy k. Turqisë, 18 dhjetor 1996, § 51, raporte të gjykimeve dhe vendimeve 1996-VI). Një ankues nuk mund të konsiderohet se nuk ka shteruar mjetet ligjore vendase nëse ai ose ajo mund të tregojë, duke paraqitur praktikën ligjore vendase përkatëse ose çdo dëshmi tjetër përkatëse, se një mjet ligjor i vlefshëm të cilin ai ose ajo nuk e ka përdorur, ishte i detyruar të dështojë (shih Kleyn dhe të tjerë k. Holandës [GC], nr. 39343/98, 39651/98, 43147/98 dhe 46664/99, § 156, GJEDNJ 2003-VI).

751. Gjykata vëren që ankuesi i parë depozitoi një ankesë pranë Gjykatës Kushtetuese. Ai u bazua në të njëjtat argumente apeli që të dy ankuesit kishin depozituar pranë gjykatës së apelit dhe Gjykatës së Lartë. Ankesa e ankuesit të parë u deklarua e papranueshme nga Gjykata Kushtetuese (shih paragrafët 730–731 më lart).

752. Duke pasur parasysh përfundimin e apelimet të ankuesit të parë në Gjykatën Kushtetuese, Gjykata konsideron se çdo apel i depozituar nga ankuesi i dytë në Gjykatën Kushtetuese, i cili do të bazohej në të njëjtat argumente apeli si ato të ngritura nga ankuesi i parë, do të kishin pak ose asnjë perspektivë të arsyeshme për sukses. Si rrjedhim, ankesa e ankuesit të dytë nuk mund të refuzohet për mosdepozitim të saj në Gjykatën Kushtetuese në kuptim të nenit 35 § 1 të Konventës.

753. Për rrjedhojë Gjykata rrëzon kundërshtimin e Qeverisë.

b) Për sa i përket mundësisë që ankuesit të kërkojnë rishqyrtim të vendimit të tyre përfundimtar.

754. Në komentet e tyre të mëtejshme për vërejtjet e ankuesve, Qeveria paraqiti një shkresë të GPO të datës 16 prill 2008 duke deklaruar që “pas verifikimeve të dosjes hetimore penale të [ankuesve], janë konstatuar parregullsi procedurale në kryerjen e disa veprimeve hetimore.” Qeveria pretendonte që ankuesit duhej të kërkonin rishqyrtim të vendimit të tyre përfundimtar në përputhje me nenin 450 të KPP, sipas shkresës së prokurorit.

755. Gjykata thekson se një ankesë për rigjykim ose mjet ligjor të jashtëzakonshëm të ngjashëm, si rregull, nuk mund të merret në konsideratë me qëllim zbatimin e nenit 35 § 1 të

Konventës (shih gjithashtu, Williams k. Mbretërisë së Bashkuar (dec.), nr. 32567/06, 17 shkurt 2009).

756. Gjykata vëren se shqyrtimi i vendimit përfundimtar të gjykatës sipas nenit 450 të KPP përbën një mjet ligjor të jashtëzakonshëm (shih paragrafin 737 më lart). Në këto rrethana, Gjykata konsideron që ankuesve nuk u është kërkuar të shterojnë këtë mjet ligjor.

757. Nëse parashtrimi i Qeverisë do të interpretohej me efektin se ankuesit nuk kishin statusin e “viktimës”, Gjykata konstaton se një vendim ose masë në favor të një ankuesi, në parim, nuk është e mjaftueshme për të privuar atë nga statusi i tij si një “viktimë” në qoftë se autoritetet shqiptare nuk e kanë njohur, shprehimisht ose në thelb, dhe pastaj kanë ofruar rishqyrtim për shkelje të Konventës (shih, për shembull, Eckle k. Gjermanisë, vendimi i datës 15 korrik 1982, seria A nr. 51, p. 32, §§ 69 e në vazhdim; dhe Dalban k. Rumanisë [GC], nr. 28114/95, § 44, GJEDNJ 1999-VI). Në çështjen në fjalë, Qeveria nuk parashtoi asnjë deklaratë për të njohur ndonjë shkelje të Konventës. Po kështu shkresa e autoriteteve e datës 16 prill 2008, për shkaqet e përmendura në paragrafët e mësipërm, nuk mund të caktojë rishqyrtimin e duhur dhe të kërkuar.

758. Si rrjedhim, Gjykata rrëzon kundërshtimin e Qeverisë.

c) Përfundimi

759. Gjykata konsideron se ankesat e ankuesve sipas nenit 6 të Konventës ngrejnë çështjet e faktit dhe të drejtës të cilat janë mjaft serioze që përcaktimi i tyre të varet në shqyrtimin e themelit. Nuk janë përcaktuar argumente të tjera për t'i deklaruar ato të papranueshme. Si rrjedhim Gjykata i deklaron ato të pranueshme. Në përputhje me vendimin e saj për të zbatuar nenin 29 § 3 të Konventës (shih paragrafin 709 më lart), Gjykata do të shqyrtojë menjëherë themelin e këtyre ankesave.

III. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS

A. Parashtrimet e palëve

760. Ankuesit përsëritën pozicionin e tyre që procedurat e ndjekura nga gjykatat vendase përbënin një mohim të së drejtës së tyre për gjykim të drejtë. Ata deklaruan se refuzimi nga ana e gjykatave për të paraqitur prova, mbi bazën e të cilave ata ishin dënuar (kapuç), përbënte shkelje të dispozitave vendase. Gjithashtu ata kundërshtuan rregullsinë e procedurës së identifikimit që është përdorur nga autoritetet vendase.

761. Qeveria parashtoi që procedura e identifikimit është kryer në përputhje me procedurat e përcaktuara në ligj dhe që gjykatat vendase kanë vlerësuar saktë të gjitha provat.

B. Vlerësimi i Gjykatës

1. Parimet e përgjithshme të aplikueshme në këtë çështje

762. Si rregull i përgjithshëm i takon gjykatave vendase të vlerësojnë provat para tyre, si dhe lidhjen e provave që i akuzuari kërkon të paraqesë. Megjithatë, Gjykata duhet të përcaktojë nëse procedimet gjyqësore të konsideruara si një e tërë, duke përfshirë edhe mënyrën në të cilën janë marrë provat, kanë qenë të drejta sipas nenit 6 § 1 të Konventës (shih Balliu k. Shqipërisë, nr. 74727/01, § 42, 16 qershor 2005).

763. Një aspekt themelore të së drejtës për gjykim të drejtë është që procedimet gjyqësore penale, duke përfshirë elementët të procedimeve të tilla që lidhen me procedurën, duhet të jenë kundërshtuese dhe që duhet të ketë barazi të krahëve ndërmjet prokurorisë dhe mbrojtjes (shih Jasper k. Mbretërisë së Bashkuar [GC], nr. 27052/95, § 51, 16 shkurt 2000).

764. E drejta për gjykim kundërshtues nënkupton në parim mundësinë që palët në gjykimin penal të kenë njohuri dhe të komentojnë të gjitha provat e paraqitura ose vëzhgimet e depozituara për të influencuar në vendimin e gjykatave (shih Vermeulen k. Belgjikës, 20 shkurt 1996, § 33, raportet e gjyqësorëve dhe vendimeve 1996-I).

765. Parimi i barazisë së krahëve kërkon “një balancë të drejtë ndërmjet palëve”, ku secilës palë duhet t'i jepet mundësia e arsyeshme për të paraqitur çështjen e saj në kushte që nuk e vendosin atë në disavantazh të konsiderueshëm *vis-à-vis* kundërshtarit të saj (shih Batsanina k. Rusisë, nr. 3932/02, § 22, 26 maj 2009).

766. Përveç sa përmendur në nenin 6 § 2 të Konventës, e drejta e personit në një çështje penale për t'u konsideruar i pafajshëm dhe për t'i kërkuar prokurorisë se i takon asaj të provojë

pretendimet kundër tij ose saj, formon pjesë të nocionit të përgjithshëm për një seancë gjyqësore të drejtë sipas nenit 6 § 1 (shih Phillips k. Mbretërisë së Bashkuar, nr. 41087/98, § 40, GJEDNJ 2001-VII).

767. Edhe nëse qëllimi kryesor i nenit 6, në lidhje me procedimet gjyqësore penale, është të sigurojë një gjykim të drejtë nga një “gjykatë” kompetente për të përcaktuar “çdo akuzë penale”, kjo nuk do të thotë që neni nuk zbatohet në procedimet para-gjyqësore (shih Imbrioscia k. Zvicrës, 24 nëntor 1993, § 36, Seria A nr. 275). Me qëllim që e drejta për një gjykim të drejtë të qëndrojë sa duhet “praktike dhe efektive” neni 6 § 1 kërkon që, si rregull, avokatit t’i jepet akses që në hetimin e parë të të dyshuarit nga policia, përveç nëse është e demonstruar nën dritën e rrethanave të veçanta të çdo çështjeje që ka arsye bindëse për të kufizuar këtë të drejtë (shih Salduz k. Turqisë [GC], nr. 36391/02, §§ 50 dhe 55, 27 nëntor 2008).

2. Zbatimi i parimeve të mësipërme në çështjen aktuale

768. Në çështjen aktuale, ankuesit u ankuan se mënyra në të cilën është bërë rreshtimi i identifikimit ishte e padrejtë. Më tej ata pretenduan që gjykatat vendase nuk kanë pranuar asnjëherë kërkesat e tyre për të paraqitur për shqyrtim provat materiale (kapuçat) në seancat gjyqësore publike në çështjet e tyre. Gjykata do të shqyrtojë sipas radhës dy arsyet e kërkesës para saj.

769. Gjykata konstaton se ankuesit u shpallën fajtorë kryesisht në bazë të parashtrimeve të dëshmitarëve okularë të marra gjatë paradës së identifikimit. Ajo vëren se dëshmia e dëshmitarëve okularë që rezultoi nga identifikimi ishte prova kryesore që mbështeste çështjen e prokurorit kundër ankuesve.

770. KPP i Shqipërisë rregullon qartë organizimin e paradës së identifikimit. Gjykata do të shqyrtojë nëse mënyra në të cilën është kryer para e identifikimit në çështjen e ankuesve është në përputhje me kushtet e drejtësisë së nenit 6.

771. Në fillim, ankuesve dhe B.L. iu kërkuan të qëndronin në rresht duke mbajtur veshur kapuçat të bardhë dhe blu, të ngjashëm në ngjyrë me ato të veshur nga autorët e krimit. Dy personat e tjerë në rresht mbanin kapuçat të zinj, në kontrast të qartë me kapuçat bardhë e blu të veshur nga ankuesit dhe B.L. të cilët akuzoheshin për kryerjen e krimit. Ndryshimi i pozicionit të personave në rresht nuk rezultoi në ndonjë rezultat të ndryshëm për ankuesit, meqenëse atyre vazhdimisht u kërkoheshin të vishnin të njëjtën ngjyrë kapuçi (bardhë dhe blu) (shih paragrafin 718 më lart). Gjykata konstaton se para e identifikimit ishte e barasvlershme me një ftesë të hapur për dëshmitarë për të vënë gishtin e fajit mbi të dy ankuesit dhe B.L. si autorë të krimit.

772. Për më tepër, para e identifikimit u mbajt në mungesë të avokatëve të ankuesve. Nga dosja e çështjes nuk kuptohet që ankuesit kanë hequr dorë me vullnetin e tyre të lirë, shprehimisht ose heshturazi, nga e drejta për asistencë ligjore në momentin e paradës së identifikimit (shih, në kontrast, Kwiatkowska k. Italisë (dec.), nr. 52868/99, 30 nëntor 2000).

773. Gjykata vëren në këtë lidhje se megjithëse gjykata e rrethit pranoi që ka pasur parregullsi në fazën e hetimit, në dënimin e ankuesve ajo u bazua në identifikimin pozitiv të ankuesve bërë nga dëshmitarët okularë në paradën e identifikimit. Megjithatë, as ndihma e siguruar më tej nga avokati, as natyra kundërshtuese e procedimeve gjyqësore të rezultuara nuk mund të kuronin defektet që kishin ndodhur gjatë hetimit penal (shih Salduz, cituar më lart, § 58).

774. Nuk kishte mbikëqyrje të pavarur të drejtësisë së procedurës ose mundësisë për të protestuar kundër parregullsive të qarta. Gjykata konstaton se mosrespektimi i dukshëm i të drejtave të mbrojtjes në këtë fazë, gjithmonë do të paragjykonte drejtësinë e gjykimeve penale të mëvonshme.

775. Përfundimisht, Gjykata vëren që asaj nuk i është shpjeguar se përse janë refuzuar kërkesat e ankuesve për të paraqitur në gjyq kapuçat e përdorur gjatë paradës së identifikimit. Ndërsa është e vërtetë se e drejta për zbulimin e provave përkatëse nuk është absolute. Gjykata duhet të shqyrtojë procedurën e vendimmarrjes për të siguruar që, sa është e mundur, procedura t’i përmbahej kushteve për të siguruar procedime kundërshtuese, barazi të palëve, si dhe mbrojtje të mjaftueshme për të mbrojtur interesin e të akuzuarit (shih Jasper, cituar më lart, §§ 52-53).

776. Gjykata konsideron se në rrethanat e çështjes së ankuesve, drejtësia kërkonte që ata të mund të argumentonin se kapuçat që u ishin kërkuar atyre të vishnin në paradën e identifikimit, të

cilët përbënin provën vendimtare për dënimin e ankuesve, ishin krejtësisht të ndryshëm nga ato të veshur nga grabitësit. Megjithatë, në gjyq atyre iu mohua mundësia të rivendosnin parregullsitë që kishin ndodhur në paradën e identifikimit. Në këtë drejtim, Qeveria nuk iu referua ndonjë arsyeje të interesit publik për të fshehur prova të tilla, dhe arsye të tilla nuk janë të dukshme nga procedimet gjyqësore vendase.

777. Në përfundim, duke pasur parasysh konstatimet e mësipërme, Gjykata arrin në përfundimin që procedimet gjyqësore në fjalë nuk përmbushnin kushtet e një gjykimi të drejtë. Për rrjedhojë, ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 në çështjen aktuale.

IV. ZBATIMET E NENEVE 46 DHE 41 TË KONVENTËS

A. Neni 46 i Konventës

778. Neni 46 parashikon se:

“1. Palët e Larta Kontraktuese marrin përsipër që t’i përmbahen vendimit përfundimtar të Gjykatës në çdo rast ku ata janë palë.

2. Vendimi përfundimtar i Gjykatës do t’i njoftohet Komitetit të Ministrave, i cili do të mbikëqyrë ekzekutimin e tij.”.

779. Në çështjen në fjalë, Gjykata konstatoi se ishte shkelur rëndë nga autoritetet vendase e drejta e ankuesve për një gjykim të drejtë. Gjykata vëren se kur një ankues është dënuar në shkelje të të drejtave të tij të garantuara në nenin 6 të Konventës, ai duhet, sa të jetë e mundur, të vendoset në pozicionin në të cilin ai do të kishte qenë nëse kushtet e asaj dispozite nuk do të shkeleshin, dhe që në parim, forma më e duhur e rishqyrtimit, do të gjykohej *de novo* apo rihapja e procedimeve, nëse kërkohej (shih Caka k. Shqipërisë, nr. 44023/02, § 122, 8 Dhjetor 2009; Salduz, cituar më lart, § 72; Xheraj k. Shqipërisë, nr. 37959/02, § 82, 29 Korrik 2008; Öcalan k. Turqisë [GC], nr. 46221/99, § 210 me gjobë, GJEDNJ 2005-IV).

780. Gjykata konsideron se, në çështjen në fjalë, një rigjykim ose rihapje e çështjes, nëse kërkohet nga ankuesi, në parim përfaqëson mënyrën e duhur të rregullimit të shkeljes. Kjo është në përputhje me udhëzimet e Komitetit të Ministrave, që në Rekomandimin nr. R (2000) 2 i kërkonte Shteteve anëtare të Konventës futjen e mekanizmave për rishqyrtimin e çështjes dhe rihapjen e procedimeve gjyqësore në nivelin e brendshëm, duke zbuluar që masa të tilla përfaqësonin “mjetin më efikas, nëse jo të vetmin për arritjen e dëmshpërblimit *in integrum*” (shih paragrafin 738 më lart). Gjithashtu kjo reflekton parimet e së drejtës ndërkombëtare ku një shtet përgjegjës për një akt të paligjshëm është i detyruar të bëjë dëmshpërblimin, që konsiston në rivendosjen e situatës që ekzistonte para se të kryhej akti i paligjshëm (neni 35 i projektneve të Komisionit të së Drejtës Ndërkombëtare mbi Përgjegjësitë e Shteteve për Aktet e Paligjshme Ndërkombëtare – shih paragrafin 740 më lart, dhe, *mutatis mutandis*, Verein gegen Tierfabriken Schöeiz (VgT) k. Zvicrës (nr. 2) [GC], nr. 32772/02, §§ 85-86, GJEDNJ 2009-...).

781. Gjykata vëren se sistemi ligjor penal i shtetit të paditur nuk parashikon mundësinë e rishqyrtimit të çështjeve, duke përfshirë rihapjen e procedimeve të brendshme, në rast se kjo Gjykatë konstaton shkelje të rëndë të së drejtës së ankuesit për gjykim të drejtë. Nuk është detyrë e Gjykatës të tregojë se si mund të sigurohet një mundësi e tillë dhe çfarë forme duhet të marrë ajo. Shteti i paditur mbetet i lirë, nën monitorimin e Komitetit të Ministrave, për të zgjedhur mjetet me të cilat do të kryejë detyrimin e tij për të vendosur ankuesin, sa është e mundur, në pozicionin që ai do të kishte qenë nëse kërkesat e Konventës nuk do të ishin shkelur (shih Piersack k. Belgjikës (neni 50), 26 tetor 1984, § 12, seria A nr. 85), me kusht që mjete të tilla të jenë në përputhje me përfundimet e përcaktuara në vendimin e Gjykatës, si dhe me të drejtat e mbrojtjes (shih Lyons dhe të tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar (dec.), nr. 15227/03, GJEDNJ 2003-IX).

782. Megjithatë, Gjykata konsideron që është detyrë e shtetit të paditur që në sistemin e tij ligjor të brendshëm të heqë pengesat që mund të pengojnë rregullimin e mjaftueshëm të situatës së ankuesit (shih, ndërmjet autoriteteve të tjera, Karanović k. Bosnjës dhe Hercegovinës, nr. 39462/03, § 28, 20 nëntor 2007) ose të propozojë një mjet të ri ligjor, i cili do t’i mundësonte ankuesit të rregulloste situatën. Për më tepër, shtetet kontraktuese janë të detyruara të organizojnë sistemet e tyre gjyqësore në mënyrë të tillë që gjykatat e tyre të plotësojnë kërkesat e Konventës. Gjithashtu ky parim zbatohet për rihapjen e procedimeve gjyqësore dhe rishqyrtimin e çështjeve të ankuesve.

(shih, mutatis mutandis, Verein gegen Tierfabriken Schöeiz (VgT) (nr. 2), cituar më lart, § 97.)

B. Neni 41 i Konventës

783. Neni 41 i Konventës parashikon se:

“Nëse Gjykata konstaton se ka pasur shkelje të Konventës dhe të protokolleve të saj, dhe nëse legjislacioni i brendshëm i Palëve të Larta Kontraktuese lejon vetëm riparim të pjesshëm, Gjykata, nëse është e nevojshme, akordon dëmshpërblim të drejtë për palën e dëmtuar.”.

784. Ankuesit kërkuan secili një pagesë prej 12 000 eurosh në lidhje me dëmin pasuror që ata pretendonin. Kjo shumë është llogaritur duke u bazuar në fitimet e humbura në përputhje me pagën minimale në Shqipëri. Ata kërkuan secili 20 000 euro në lidhje me dëmin jopasuror.

785. Qeveria i kërkoj Gjykatës të rrëzojë pretendimin e ankuesve për shpërblim të drejtë.

A. Dëmi

786. Përsa i përket dëmit pasuror të pretenduar se është shkaktuar, Gjykata ritheksoi se duhet të ketë një lidhje shkakësore të dukshme ndërmjet dëmit të pretenduar nga ankuesi dhe shkeljes së Konventës (shih, ndërmjet të tjerash, Dybeku k. Shqipërisë, nr. 41153/06, § 65, 18 dhjetor 2007).

787. Gjykata, duke pasur parasysh konstatimet e saj në lidhje me ankimet e ankuesit sipas nenit 6 § 1, vlerëson se nuk ka lidhje shkakësore ndërmjet dëmit të pretenduar dhe shkeljes së konstatuar. Gjykata nuk mund të spekulojë me faktin se cili mund të ishte rezultati i procedimit penal kundër ankuesit nëse shkelja e Konventës nuk do të kishte ndodhur (shih Polufakin dhe Chernyshev k. Ruisë, nr. 30997/02, § 216, 25 shtator 2008). Prandaj, Gjykata e sheh të papërshtatshme për t'i dhënë ankuesit kompensim për dëmin pasuror të pretenduar.

788. Përsa i përket dëmit jopasuror, duke vendosur mbi baza të arsyeshme, Gjykata i cakton secilit ankues 4 800 euro, plus ndonjë taksë që mund të jetë në ngarkim të këtyre shumave.

B. Kosto dhe shpenzime

789. Ankuesit nuk parashtruan pretendim për kostot dhe shpenzimet. Si rrjedhim, Gjykata vlerëson se nuk ka arsye për t'i caktuar atyre ndonjë shumë për këtë qëllim.

C. Interesi i munguar

790. Gjykata e mendon të arsyeshme se interesi i munguar duhet të bazohet në kursin marxhinal të huasë së Bankës Qendrore Europiane, mbi të cilën duhet të shtohen 3 për qind.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, NJËZËRI:

1. Vendos të bashkojë ankimet;
 2. Deklaron ankimin e ankuesve sipas nenit 3 të Konventës të papranueshëm dhe pjesën tjetër të ankimit të pranueshëm;
 3. Vendos se ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës;
 4. Vendos
 - a) që shteti i paditur duhet të paguajë secilin ankues, brenda tre muajve nga data kur vendimi bëhet përfundimtar në përputhje me nenin 44 § 2 të Konventës, 4 800 euro (katër mijë e tetëqind euro) në lidhje me dëmin jopasuror, të konvertuar në monedhën e shtetit të paditur, me normë të aplikueshme në datën e pagimit, plus çdo tatim që mund të vendoset;
 - b) që prej skadimit të periudhës prej tre muajsh të përmendur më lart deri në pagim, mbi shumën e mësipërme paguhet interes i thjeshtë i barabartë me kursin marxhinal të huasë së Bankës Qendrore Europiane gjatë periudhës së mospagimit, plus tre për qind;
 5. Rrëzon pjesën tjetër të pretendimit të ankuesit për shpërblim të drejtë.
- Bërë në anglisht, dhe njoftuar me shkrim më 20 prill 2010, në përputhje me nenet 77 §§ 2 dhe 3 të rregullores së Gjykatës.

Fatoş Aracı
Zëvendësregjistrues

Nicolas Bratza
Kryetar

VENDIM
MBI PRANUESHMËRINË

(seksioni i katërt)

Ankimet nr. 11546/05, 33285/05 dhe 33288/05

Nga z. Vezir Plepi, znj. Fersilet Plepi dhe znj. Miaftoni Zeka
kundër Shqipërisë dhe Greqisë

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (seksioni i katërt), duke gjykuar si dhomë e përbërë nga:

Nicolas Bratza, Kryetar,

Christos Rozakis,

Giovanni Bonello,

Ljiljana Mijović,

Päivi Hirvelä,

Ledi Bianku,

Nebojša Vučinić, gjykatës,

dhe Fatoş Aracı, zëvendësregjistrues i seksionit,

Duke marrë parasysh ankimet e mësipërme të depozituara më 13 dhe 17 mars 2005,

Duke marrë parasysh vendimin për të bashkuar ankimet e datës 20 nëntor 2007,

Duke marrë parasysh vëzhgimet e paraqitura nga qeveritë e paditura dhe vëzhgimet në përgjigje të tyre të paraqitura nga ankuesit,

Pas shqyrtimit, vendos si më poshtë:

FAKTET

Ankuesit, z. Vezir Plepi, znj. Fersilet Plepi dhe znj. Miaftoni Zeka janë shtetas shqiptarë, lindur respektivisht në 1957, 1962 dhe 1969 dhe aktualisht janë duke vuajtur dënimin me burgim në Greqi. Ankuesi i parë dhe i dytë janë të martuar dhe ankuesja e tretë është motra e ankueses së dytë. Fëmijët e çiftit jetojnë në Shqipëri qëkur ankuesit janë arrestuar në Greqi. Ankuesit janë përfaqësuar në Gjykatë nga znj. A. Stavri, avokate që ushtron profesionin në Athinë.

Pala Shqiptare është përfaqësuar nga agjentja e saj e atëhershme, Znj. S.Meneri. Pala Greke është përfaqësuar nga agjenti i saj i atëhershëm, z. Bakalis, Kryetar i Këshillit Ligjor të Shtetit.

A. Rrethanat e çështjes

Faktet e çështjes, të parashtruara nga palët, mund të përmbliidhen si më poshtë:

Në një datë të pacaktuar në vitin 1998 ankuesit janë arrestuar në Greqi.

Më 8 shtator 1998 ankuesit janë akuzuar nga autoritetet greke për hyrje të paligjshme në territorin grek, krijim dhe pjesëmarrje në një organizatë kriminale dhe trafikim të drogës.

Më 9 dhjetor 1999 Gjykata e Apelit Athinë, duke gjykuar si gjykatë e shkallës së parë me një juri të përbërë nga tre gjyqtarë, i shpalli ankuesit fajtorë dhe i dënoi ata me burgim të përjetshëm, si dhe me shlyerjen e një gjobe që arrinte shumën 10 milionë dhrahmi.

Në një datë të pacaktuar në vitin 2000, meqenëse fëmija i tyre i vogël dhe familja jetonin në Shqipëri, ankuesit depozituan një kërkesë pranë Ministrisë së Drejtësisë së Greqisë sipas Marrëveshjes Bilaterale të vitit 1993 ndërmjet Shqipërisë dhe Greqisë për transferimin e personave të dënuar (marrëveshja bilaterale), duke kërkuar të vuajnë dënimin e tyre me burgim në një burg shqiptar. Sipas ankuesve, me qëllim që të përmbushnin kërkesat për transferimin e tyre në Shqipëri, ato hoqën dorë nga e drejta e tyre për të apeluar kundër vendimit që kishte çuar në dënimin e tyre.

Më 7 prill dhe 4 maj 2000 Ministria e Drejtësisë së Greqisë iu kërkoi autoriteteve shqiptare fillimin e procedurave për transferimin e ankuesve në Shqipëri. Teksti standard i kërkesave, në lidhje me çështjen në fjalë, vijon si më poshtë:

“I. Me anë të këtij dokumenti, ju informojmë se [emri i ankuesit], nënshtetas shqiptar që vuan dënimin në [emri i burgut], ka kërkuar të transferohet në Shqipëri për të vuajtur pjesën e mbetur të dënimit.

II. Pala Greke nuk ka kundërshtim për transferimin e personit të dënuar.

III. Për informacionin tuaj janë bashkëngjitur dokumentet e mëposhtme:

1. Formulari i aplikimit i personit të dënuar që kërkon transferimin.

2. Kopje të procesverbalit dhe vendimit të Gjykatës së Apelit Athinë të datës 9 dhjetor 1999.

3. Kopje të dorëheqjes së ankuesve nga e drejta për të apeluar kundër vendimit të përmendur më lart.

Në një datë të pacaktuar, Ministria e Drejtësisë së Greqisë i ka kërkuar Ministrisë së Drejtësisë së Shqipërisë, sipas nenit 6 të Konventës për transferimin e personave të dënuar (Konventa për transferim), t'u sigurojë atyre informacion mbi pasojat ligjore të transferimit të personave të dënuar sipas së drejtës penale të këtij vendi.

Sipas procedurës së parashikuar nga Konventa për transferim dhe marrëveshja bilaterale, më 24 tetor 2000, Prokuroria e Përgjithshme e Shqipërisë filloi procedurat në Gjykatën e Rrethit Lushnjë për vlefshmërinë dhe zbatimin në Shqipëri të vendimit të dhënë nga Gjykata e Apelit Athinë.

Më 15 nëntor 2000 Gjykata e Rrethit Lushnjë, bazuar në Konventën për transferim dhe Marrëveshjen Bilaterale, konsideroi se dënimet e caktuara nga gjykata greke ishin në përputhje me të drejtën penale shqiptare dhe konstatoi se ankuesit duhet të vuajnë dënimet e mëposhtme në Shqipëri: njëzet vjet burgim për ankuesin e parë dhe tetëmbëdhjetë vjet burgim për ankuesit e dytë dhe të tretë, sipas neneve 283 dhe 297 të Kodit Penal. Së fundi, gjykata vendosi që ankuesit duhet të paguajnë shpenzimet e procedurave. Vendimi mori formë të prerë më 27 nëntor 2000.

Rezulton se më 6 prill 2001 Ministria e Drejtësisë Shqiptare informoi homologen e saj greke se ekzistonin mundësitë e lirimit me kusht për ankuesit pas vuajtjes së gjysmës së dënimit të tyre, me kusht që ato të kishin shfaqur sjellje të mirë në burg. Për pasojë, më 8 qershor 2001 Ministria e Drejtësisë Greke informoi ankuesit dhe Ministrinë e Drejtësisë Shqiptare mbi refuzimin e saj për të transferuar ankuesit me argumentin që dënimet e ndryshuara nga gjykata shqiptare ishin të ulëta në krahasim me ato të caktuara nga gjykata greke dhe në këtë mënyrë të papajtueshme me rëndësinë e veprës së tyre dhe kohën e shkurtër që ato kishin kaluar në burgjet greke.

Në vitin 2003 dhe 2004 ankuesit kërkuan pa sukses që autoritetet greke t'i transferonin ato në Shqipëri në përputhje me procedurën e transferimit.

Rezultonte se më 25 shkurt 2003 ankuesi i dytë dhe i tretë kërkuan leje për të apeluar jashtë afatit kundër vendimit të datës 9 dhjetor 2009. Më 8 qershor 2005 Gjykata e Kasacionit (Areios Pagos) rrëzoi apelet kundër vendimit që kishte çuar në dënimin e tyre duke i konsideruar jashtë afatit.

Në data të pacaktuara ankuesit kërkuan që Ministria e Drejtësisë Shqiptare të zbatonte vendimin e Gjykatës së Rrethit Lushnjë e cila kishte konvertuar vendimin e tyre grek dhe të procedonte me transferimin e tyre në Shqipëri.

Më 29 dhjetor 2005 Ministria e Drejtësisë Shqiptare informoi familjen e ankuesve, pa dhënë arsytet, se ishte pezulluar procedura për transferimin e tyre në Shqipëri.

Më 3 shkurt 2006 prokurori pranë Gjykatës së Rrethit Lushnjë informoi familjen e ankuesve mbi refuzimin e Ministrisë së Drejtësisë Greke për të transferuar ankuesit në Shqipëri.

Rezulton se në vitin 2009 ankuesit kërkuan pa sukses që autoritetet greke t'i transferonin ato në Shqipëri në përputhje me procedurën e transferimit.

B. E drejta e brendshme dhe ndërkombëtare përkatëse

1. Kushtetuta e Shqipërisë

Neni 5 i Kushtetutës parashikon se Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare që është e detyrueshme për të.

2. Kodi Penal i Shqipërisë

Neni 64, në fuqi në kohë materiale, shprehte që një i burgosur mund të lirohej me kusht pasi vuante gjysmën e dënimit, me kusht që sjellja e mirë dhe puna të kishin arritur qëllimin e edukimit të tij.

Neni 283, në fuqi në kohë materiale, parashikonte se organizimi dhe fillimi i trafikimit të narkotikëve ishte i dënueshëm me dënimin maksimal prej njëzet vjetësh burgim.

Neni 297, në fuqi në kohë materiale, parashikonte se kalimi i paligjshëm i kufirit ishte i dënueshëm me dënimin maksimal prej dy vjetësh burgim.

3. Kodi Penal i Greqisë (GCC)

Neni 105 i Kodit Penal Grek parashikon lirimin me kusht për një të burgosur të përjetshëm, pasi ka vuajtur të paktën njëzet vjet burgim.

4. Marrëveshja bilaterale e vitit 1993 (Marrëveshje e datës 17 maj 1993 ndërmjet Shqipërisë dhe Greqisë mbi transferimin e personave të dënuar)

Marrëveshja bilaterale e vitit 1993 është miratuar në kohën kur Shqipëria nuk ishte palë kontraktuese e Konventës për transferim dhe në shumë pjesë pasqyron përmbajtjen e atij instrumenti. Për sa i përket Shqipërisë, ajo hyri në fuqi më 29 tetor 1993. Preambula e Marrëveshjes vijon: “Republika e Shqipërisë dhe Republika Helene, me dëshirën për të zhvilluar më tej bashkëpunimin në fushën e së drejtës penale, kanë rënë dakord për të përfunduar një Marrëveshje për transferimin e personave të dënuar (...)

Sipas nenit 2, “të dyja vendet marrin përsipër të ndihmojnë në mënyrë reciproke me transferimin e personave të dënuar në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje”. Krejtësisht ndryshe nga Konventa për transferim, neni 3 i marrëveshjes bilaterale 1993 parashikon se personi i dënuar gjithashtu mund të kërkojë transferimin e tij, përveç shtetit dënues apo shtetit administrues pritës.

Sipas neneve 4 dhe 8, një person i dënuar mund të transferohet nëse plotësohen kushtet e mëposhtme: (a) shkelja penale është e dënueshme nga e drejta penale e shtetit dënues dhe administrues; (b) vendimi dënues është përfundimtar; (c) personi i dënuar është mendërisht i shëndetshëm; (d) personi i dënuar ka akoma të paktën një vit nga dënimi për të vuajtur; dhe (e) personi i dënuar ka dhënë miratimin e tij për transferimin.

Nenet 6 dhe 7 parashikojnë arsyet për të cilat mund të refuzohet transferimi, për shembull nëse personi i dënuar nuk ka përmbushur detyrimet e tij në lidhje me paratë, tarifat, shpenzimet apo gjoba të tjera për të cilat ai është i detyruar, dhe, nëse dënimi maksimal i caktuar nga shteti administrues është shumë më i ulët se dënimi i caktuar nga shteti dënues.

5. Konventa për transferim (Konventa për transferimin e personave të dënuar, CETS nr.112, dhe protokolli shtesë, CETS nr.167)

Konventa për transferim hyri në fuqi në lidhje me Shqipërinë më 1 gusht 2000 dhe në lidhje me Greqinë më 1 prill 1988. Protokolli shtesë nuk është nënshkruar dhe ratifikuar deri më sot nga Shqipëria dhe është në fuqi në lidhje me Greqinë që prej datës 1 janar 2006.

Preambula e Konventës për transferim, në pjesët që lidhen me këtë çështje, parashikon si më poshtë:

“Me dëshirën për të zhvilluar më tej bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e së drejtës penale;

Duke marrë parasysh që një bashkëpunim i tillë duhet të mbështesë synimin e drejtësisë dhe rehabilitimit shoqëror të personave të dënuar;

Duke marrë parasysh që këto objektiva kërkojnë që të huajve të cilët janë të privuar nga liria e tyre si rezultat i kryerjes së një vepre penale, duhet t’u jepet mundësia të vuajnë dënimet brenda shoqërisë së tyre; ...”

Dispozitat përkatëse të Konventës për transferim parashikojnë si më poshtë:

Neni 3

Kushtet për transferim

“Një person i dënuar mund të transferohet sipas kësaj Konvente vetëm në kushtet e mëposhtme:

- a) nëse ky person është shtetas i shtetit administrues;
- b) nëse vendimi është përfundimtar;
- c) nëse, në kohën e marrjes së kërkesës për transferim, personi i dënuar ka akoma të paktën gjashtë muaj të dënimit për të vuajtur ose nëse dënimi është i pacaktuar;

d) nëse transferimi pranohet nga personi i dënuar ose, duke pasur parasysh moshën e tij apo kushtet e tij fizike dhe mendore njëri nga dy shtetet e konsideron të nevojshme, nga përfaqësuesi ligjor i personit të dënuar;

e) nëse aktet ose mosveprimet për arsye të cilave është caktuar dënimi, përbëjnë një veprë penale sipas ligjit të shtetit administrues ose do të përbënin një veprë penale nëse do të kryheshin në territorin e tij; dhe

f) nëse shtetet dënuese dhe administruese bien dakord për transferimin.”

Neni 6

Dokumentet mbështetëse

“...

2. Nëse kërkohet një transferim, shteti dënues i siguron shtetit administrues dokumentet e mëposhtme nëse secili shtet nuk ka deklaruar se nuk është dakord me transferimin:

a) një kopje e vërtetuar e vendimit dhe ligjit mbi të cilin bazohet vendimi;

b) një relacion që tregon pjesën e dënimit që është vuajtur, përfshirë informacionin për periudhën e paraburgimit, uljen e dënimit dhe çdo faktor tjetër në lidhje me zbatimin e dënimit;

c) një deklaratë që përmban miratimin për transferim siç referohet në nenin 3.1.d; dhe

d) kur është e nevojshme, çdo raport mjekësor dhe social për personin e dënuar, informacion për trajtimin e tij në shtetin dënues, dhe çdo rekomandim për trajtimin e tij të mëtejshëm në shtetin administrues.”

Neni 9

Efektet e transferimit për shtetin administrues

“1. Autoritetet kompetente të shtetit administrues duhet:

a) të vazhdojnë zbatimin e vendimit menjëherë ose nëpërmjet një urdhri të gjykatës apo administrativ, sipas kushteve të përcaktuara në nenin 10, ose

b) të konvertojnë dënimin, nëpërmjet një procedure gjyqësore ose administrative, në një vendim të këtij shteti, pra duke zëvendësuar sanksionin e caktuar në shtetin dënues në sanksion të përcaktuar me ligj në shtetin administrues për të njëjtën veprë, sipas kushteve të përcaktuara në nenin 11.

2. Shteti administrues, nëse kërkohet, duhet të informojë shtetin dënues përpara transferimit të personit të dënuar në lidhje me procedurat që do të ndjekë.

3. Zbatimi i dënimit rregullohet sipas ligjit të shtetit administrues dhe vetëm ky shtet ka kompetencën për të marrë të gjitha vendimet e duhura....”

Neni 11

Konvertimi i dënimit

“1. Në rastin e konvertimit të një dënimi, zbatohen procedurat e parashikuara në ligjin e shtetit administrues. Në konvertimin e dënimit, autoriteti kompetent:

a) duhet të kufizohet nga konstatimet e fakteve siç paraqiten në mënyrë të qartë ose të nënkuptuar në vendimin e caktuar në shtetin dënues;

b) nuk mund të konvertojë një sanksion që përfshin privimin e lirisë me një sanksion në para;

c) duhet të zbresë periudhën e plotë të privimit të lirisë të vuajtur nga personi i dënuar; dhe

d) nuk duhet të rëndojë pozicionin penal të personit të dënuar, si dhe nuk duhet të kufizohet nga ndonjë minimum që ligji i shtetit dënues mund të parashikojë për veprën apo veprat e kryera.

2. Nëse procedura e konvertimit kryhet pas transferimit të personit të dënuar, shteti administrues duhet të mbajë personin në paraburgim ose duhet të sigurojë praninë e tij në shtetin administrues në pritje të përfundimit të kësaj procedure. ”

Neni 22

Marrëdhënia me konventa dhe marrëveshje të tjera

“ ...

2. Nëse dy apo më shumë palë kanë përfunduar një marrëveshje ose traktat mbi transferimin e personave të dënuar apo kanë përcaktuar marrëdhëniet e tyre në këtë çështje, ose do t'i përcaktojnë në të ardhmen, për rrjedhojë atyre u njihet e drejta të zbatojnë këtë marrëveshje apo traktat, në vend të Konventës në fjalë.”

Neni 23

Zgjidhja miqësore

“Komiteti Europian mbi Probleme të Krimit i Këshillit të Europës duhet të informohet në lidhje me zbatimin e kësaj Konvente dhe duhet të bëjë çdo gjë që lehtëson zgjidhjen miqësore të ndonjë vështirësie që mund të lindë gjatë zbatimit.”

Paragrafi 10 i raportit shpjegues shpreh se “Konventa kufizohet me sigurimin e kuadrit procedural për transferimet. Ajo nuk përmban detyrime ndaj shteteve kontraktuese për të përmbushur kërkesën për transferim; për këtë arsye, nuk ishte e domosdoshme të renditeshin arsyet e refuzimit, apo t'i kërkohej shtetit të kërkuar të japë arsyet e refuzimit nga ana e tij të transferimit të kërkuar.”

ANKIMET

Ankuesit pretendonin se refuzimi i autoriteteve greke për t'i transferuar ato në Shqipëri, me qëllim që të vuanin pjesën e mbetur të dënimit në vendin e tyre të origjinës, pasi fillimisht kanë pranuar transferimin, shkaktonte *de facto* një periudhë më të gjatë burgimi në krahasim me periudhën që ato do të kishin vuajtur nëse do të bëhej transferimi. Ankuesit u ankuan se të dyja qeveritë nuk kanë ndërmarrë hapat e mjaftueshëm për të garantuar të drejtat e tyre dhe për të përfunduar procedurat e transferimit. Gjithashtu, ato u ankuan sipas nenit 6 § 1 të Konventës, se atyre nuk u është bërë gjykim i drejtë në Greqi, meqenëse gjykatat vendase nuk u kishin siguruar përkthyes të saktë. Sipas nenit 8 të Konventës, ato argumentonin se mostransferimi i tyre ishte një ndërhyrje e pajustificuar me të drejtën e tyre për të respektuar jetën familjare.

E DREJTA

1. Ankuesit u ankuan sipas nenit 6 § 1 të Konventës se autoritetet shqiptare nuk kanë vepruar në përputhje me vendimin e Gjykatës së Rrethit Lushnjë të datës 15 nëntor 2000.

Neni 6 § 1 i Konventës, në pjesët që lidhen me këtë çështje, parashikon si më poshtë:

“Në ushtrimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile, ... çdo person ka të drejtën e një procesi të rregullt ligjor ... nga [një] ... gjykatë...”

Qeveria Shqiptare argumentoi se ankuesit nuk hynë në juridiksionin e saj. Vendimi i gjykatës vendase shqiptare, i cili do të kishte efekt, nëse ankuesit do të transferoheshin nga Greqia, vleftësoi vendimin e gjykatës greke dhe konvertoi dënimet e ankuesve.

Gjykata vëren se lidhja ndërmjet ankuesve dhe Shqipërisë është vendimi i Gjykatës së Rrethit Lushnjë, i datës 15 nëntor 2000. Ajo vlerëson se çështja thelbësore për t'u shqyrtuar në lidhje me këtë ankim është nëse, si rezultat i vendimit të gjykatës, ankuesit mund të përfshiheshin në juridiksionin e Shqipërisë në kuptim të nenit 1 të Konventës.

Ankuesit janë proceduar dhe dënuar nga autoritetet greke, ku për rrjedhojë ato vuajnë dënimin e tyre në Greqi. Gjykata konsideron që nuk ka të dhëna se autoritetet shqiptare ushtruan juridiksionin mbi ankuesit në kuptim të nenit 1 të Konventës (shih, për shembull, Bankovic dhe të Tjerë k. Belgjikës dhe 16 Shteteve të Tjera Kontraktuese (dec.) [GC], nr. 52207/99, §§ 61-63, ECHR 2001-XII). Gjithashtu, nuk mund të konsiderohet mbi faktet se Shqipëria ndërmori ndonjë përgjegjësi për ankuesit. Procedurat në Shqipëri ndodhën si rezultat i kërkesës për transferim parashtruar nga autoritetet greke dhe u planifikuan vetëm për të vlerësuar dhe zbatuar vendimin e gjykatës greke.

Gjykatat shqiptare vepruan në zbatim të së drejtës penale vendase dhe në përputhje me konventat ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria. Detyrimi i Konventës për të vepruar në përputhje me vendimin e gjykatës vendase shqiptare do të lindte në rastin e transferimit të ankuesve në Shqipëri. Ndërsa ankuesit ankohen pikërisht për mostransferimin, në rrethanat e çështjes nuk ka asnjë element që të lejojë Gjykatën të arrijë në përfundimin nëse ankuesit mund të kishin aftësinë të përfshiheshin në juridiksionin shqiptar në kuptim të nenit 1 të Konventës (shih për shembull Drozd dhe Janousek k. Francës dhe Spanjës, 26 Qershor 1992, §§ 91-98, Seria A nr. 240; Loizidou k. Turqisë (kundërshtimet paraprake), 23 Mars 1995, §§ 59-64, Seria A nr.310; Bankovic dhe të Tjerë, cituar më lart, §§ 74-82; Ilascu dhe të Tjerë k. Moldavisë dhe Rusisë [GC], nr. 48787/99, §§ 300-394, ECHR 2004- VII).

Për rrjedhojë ankimi duhet të deklarohet i papajtueshëm *ratione personae* me dispozitat e Konventës dhe si i tillë, i papranueshëm në përputhje me nenin 35 §§ 3 dhe 4 të Konventës.

2. Pa iu drejtuar ndonjë neni të veçantë të Konventës, ankuesit u ankuan gjithashtu kundër Greqisë se mostransferimi i tyre nga kjo e fundit nënkuptonte se ato duhej të vuanin një periudhë më të gjatë burgimi. Më tej ato pretenduan shkelje të së drejtës së tyre të respektimit të jetës familjare sipas nenit 8 të Konventës si rezultat i refuzimit të autoriteteve greke për t'i transferuar ato në Shqipëri.

Neni 8 i Konventës parashikon:

“1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, shtëpisë dhe korrespondencës së tij.

2. Autoriteti publik nuk duhet të ndërhyjë më ushtrimin e kësaj të drejte, me përjashtim të rasteve kur në përputhje me ligjin është e domosdoshme në një shoqëri demokratike në interes të sigurisë kombëtare, sigurisë publike apo mirëqenies ekonomike të vendit, për parandalimin e prishjes së qetësisë publike ose krimit, për mbrojtjen e shëndetit apo..., ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.” .

Qeveria greke parashittoi se autoritetet greke, thjesht kanë filluar procedurat duke informuar autoritetet shqiptare mbi synimet e tyre. Ato kanë kërkuar parashtrimin e dokumenteve suplementare, me marrjen e të cilave ato kanë refuzuar transferimin, pa e aprovuar ndonjëherë. Më tej ajo argumentoi se qëllimi i Konventës për transferim nuk ishte për të mundësuar personat e dënuar të kthehen në vendin e tyre të origjinës dhe të lirohen nga pasojat e pafavorshme të vuajtjes së dënimit të caktuar nga shteti dënues. Transferimi dhe marrëveshja e palëve në lidhje me të nuk ishin të detyrueshme për shtetin dënues.

Gjykata konsideron se çështja thelbësore e ngritur nga ankuesit është nëse refuzimi nga Greqia për transferimin e tyre përfshihet në fushën e veprimit të ndonjë neni të Konventës.

Së pari, Gjykata vëren se nuk ka të dhëna që ligji grek i njeh ankuesve ndonjë të drejtë për t'u transferuar në Shqipëri dhe ankuesit nuk iu referuan ndonjë dispozite ligjore përkatëse që do të tregonte ekzistencën e ndonjë të drejte të tillë. Gjithashtu nuk ka asnjë urdhër transferimi të gjykatës vendase në favor të tyre. Rrjedhimisht, nuk mund të pretendohet se ato kanë ndonjë të drejtë thelbësore sipas ligjit grek për t'u transferuar në vendin e tyre të origjinës.

Gjykata gjithashtu vëren se, ndërsa dispozitat e marrëveshjeve ndërkombëtare mund të krijojnë të drejta individuale të mbrojtura nga Konventa ose kur dispozita është drejtpërdrejt e aplikueshme (shih S.A Dangeville k. Francës, nr.36677/97, §§ 46-48, ECHR 2002-III, në lidhje me mosvendosjen e të drejtës së brendshme në përputhje me direktivën e Komunitetit) ose kur është shpallur legjislacioni i brendshëm i domosdoshëm që e zbaton atë (shih Beaumartin k. Francës, 24 nëntor 1994, §§ 27-28, seria A nr. 296-B, në lidhje me të drejtën e kompensimit që rrjedh nga traktati franko-maroken dhe legjislacioni vijues francez që krijon një komitet përgjegjës për shpërndarjen e dëmshpërblimit maroken), dispozitat e Marrëveshjes Bilaterale dhe Konventa për transferim i kufizon ato për të siguruar kuadrin procedural ndërshtetëror për transferimin e personave të dënuar dhe nuk krijon asnjë të drejtë thelbësore individuale *per se*. Në çdo rast, këto instrumente ndërkombëtare nuk përmbajnë një detyrim për shtetet nënshkruese për të vepruar në përputhje me kërkesën për transferim (shih Passaris k. Greqisë (dec.), nr. 53344/07, 4 shtator 2009). Megjithatë marrëveshja bilaterale përmbante argumente mbi të cilat mund të refuzohej transferimi,

ajo nuk detyronte autoritetet greke të gjente kërkesat e transferimit në favor të ankuesve. Në mënyrë specifike, marrëveshja bilaterale përjashton çdo detyrim të tillë për të kryer një transferim edhe nëse janë përmbushur kushte të tilla.

Së fundi, duhet të ritheksohet se, për sa i përket refuzimit grek për të autorizuar transferimin e ankuesve në Shqipëri, Konventa nuk i njeh të burgosurve të drejtën për të zgjedhur vendin e vuajtjes së dënimit dhe se ndarja dhe largësia nga familja e tyre janë një pasojë e pashmangshme e vuajtjes së dënimit të tyre sipas ushtrimit nga shteti grek i prerogativave të tij në fushën e sanksioneve penale (shih Selmani k. Zvicrës (dec.) nr. 70258/01, 28 qershor 2001; Venetucci k. Italisë, vendimi i Komisionit i datës 2 mars 1998; Hacısuleymanogly k. Italisë, nr. 23241/94, vendimi i Komisionit i datës 20 tetor 1994).

Për pasojë ky ankim është i papajtueshëm *ratione materiae* me dispozitat e Konventës në kuptim të nenit 35 § 3 dhe duhet të rrëzohet në përputhje me nenin 35 § 4 të Konventës.

3. Ankuesit gjithashtu u ankuan sipas nenit 6 §§ 1 dhe 3 (e) se procedimet që kishin çuar në dënimet e tyre në Greqi ishin të padrejta.

Neni 6 §§ 1 dhe 3 (e) i Konventës, në pjesët që lidhen me këtë çështje, parashikon si më poshtë:

“Në përcaktimin e çdo akuze, ... çdo person ka të drejtën e një procesi të rregullt ligjor ... nga [një] ... gjykatë...”

...

“Në përcaktimin e çdo akuze, ... çdo person ka të drejtën e një procesi të rregullt ligjor ... nga [një] ... gjykatë...”

3. Çdo i akuzuar ka, së paku, të drejtat e mëposhtme:

...

(e) të ketë ndihmë të lirë të një përkthyesi nëse ai nuk mund të kuptojë ose flasë gjuhën e përdorur në gjyq.

Edhe nëse supozohet se ka pasur shkelje të nenit 6 §§ 1 dhe 3 (e) për arsye të mungesës së interpretimit, gjykata vëren se ankuesit hoqën dorë nga e drejta e tyre për të apeluar kundër vendimit të Gjykatës së apelit Athinë të datës 9 dhjetor 1999. Në këtë kuptim, Gjykata vëren se as Marrëveshja Bilaterale dhe as Konventa për transferim nuk përmbajnë ndonjë dispozitë që do të kushtëzonte transferimin me dorëheqjen e ankuesve nga e drejta e apelimt dhe prandaj Gjykata nuk mund të pranojë argumentimin e ankuesve se një dorëheqje e tillë ishte një kusht për fillimin e procedurave të transferimit. Apelimet vijuese të ankuesve u konstatuan se ishin jashtë afatit. Prandaj Gjykata konsideron se ankuesit nuk zbatuan kërkesat procedurale të brendshme formale, duke përfshirë afatet kohore. Si rrjedhim ajo e deklaroi këtë ankim të papranueshëm për mosshërim të mjeteve ligjore të brendshme sipas nenit 35 § 1 dhe e rrëzon atë sipas nenit 35 § 4 të Konventës.

Për këto arsye, Gjykata, njëzëri:

I deklaroi ankimet të papranueshme.

Fatoş Aracı
Zëvendësregjistruar

Nicolas Bratza
Kryetar

Çështja “Gjonboçari etj. kundër Shqipërisë” (pranueshmëria)
Botuar në Fletoren Zyrtare Ekstra korrik 2007

Çështja “Gjonboçari etj. kundër Shqipërisë”
Botuar në Fletoren Zyrtare Ekstra nr.31, datë 3.10.2008

Çështja “Dhoma Kombëtare e Noterisë kundër Shqipërisë” (pranueshmëria)
Botuar në Fletoren Zyrtare Ekstra nr.31, datë 3.10.2008

Çështja “Nikolaus dhe Jurgen Treska kundër Shqipërisë dhe Italisë”
Botuar në Fletoren Zyrtare Ekstra korrik 2007

Çështja “Agim Hysi kundër Shqipërisë”
Botuar në Fletoren Zyrtare Ekstra nr.31, datë 3.10.2008

Çështja “Qufaj Co. shpk kundër Shqipërisë” (pranueshmëria)
Botuar në Fletoren Zyrtare Ekstra korrik 2007

Çështja “Qufaj Co. shpk kundër Shqipërisë”
Botuar në Fletoren Zyrtare Ekstra korrik 2007

Çështja “Naumov kundër Shqipërisë”
Botuar në Fletoren Zyrtare nr.22, datë 13.4.2005

Çështja “Beshiri etj. kundër Shqipërisë”
Botuar në Fletoren Zyrtare Ekstra korrik 2007

Çështja “Bajrami kundër Shqipërisë” (themeli)
Botuar në Fletoren Zyrtare Ekstra korrik 2007

Çështja “Bajrami kundër Shqipërisë” (rishikimi)
Botuar në Fletoren Zyrtare Ekstra nr.38, datë 18.11.2009

Çështja “Ramadhi dhe të tjerë kundër Shqipërisë”
Botuar në Fletoren Zyrtare Ekstra nr.32, datë 10.10.2008

Çështja “Driza kundër Shqipërisë”
Botuar në Fletoren Zyrtare Ekstra nr.32, datë 10.10.2008

Çështja “Marini kundër Shqipërisë”
Botuar në Fletoren Zyrtare Ekstra nr.34, datë 23.1.2009

Çështja “Hamzaraj kundër Shqipërisë” (Nr.1)
Botuar në Fletoren Zyrtare Ekstra nr.35, datë 14.5.2009

Çështja “Nuri kundër Shqipërisë”
Botuar në Fletoren Zyrtare Ekstra nr.35, datë 14.5.2009

Çështja “Dauti kundër Shqipërisë”
Botuar në Fletoren Zyrtare Ekstra nr.35, datë 14.5.2009

Çështja “Vrioni dhe të tjerët kundër Shqipërisë”
Botuar në Fletoren Zyrtare Ekstra nr.35, datë 14.5.2009

Çështja “Vrioni e të tjerë kundër Shqipërisë dhe Italisë”
Botuar në Fletoren Zyrtare Ekstra nr.37, datë 5.11.2009

Çështja “Gjyli kundër Shqipërisë”
Botuar në Fletoren Zyrtare Ekstra nr.37, datë 5.11.2009

Çështja Aferdita Hamzaraj kundër Shqipërisë (nr.2)
Botuar në Fletoren Zyrtare Ekstra nr.38, datë 18.11.2009

Çështja “Zyfli kundër Shqipërisë”
Botuar në Fletoren Zyrtare Ekstra korrik 2007

Çështja “Balliu kundër Shqipërisë” (pranueshmëria)
Botuar në Fletoren Zyrtare Ekstra korrik 2007

Çështja “Balliu kundër Shqipërisë”
Botuar në Fletoren Zyrtare Ekstra korrik 2007

Çështja “Dybeku kundër Shqipërisë”
Botuar në Fletoren Zyrtare Ekstra nr.31, datë 3.10.2008

Çështja “Xheraj kundër Shqipërisë”
Botuar në Fletoren Zyrtare Ekstra nr.35, datë 14.5.2009

Çështja “Groni kundër Shqipërisë”
Botuar në Fletoren Zyrtare Ekstra nr.36, datë 11.8.2009

Çështja “Ali Telhai kundër Shqipërisë”
Botuar në Fletoren Zyrtare Ekstra nr.39, datë 8.1.2010

Çështja “Ali dhe Shkëlqim Sufja kundër Shqipërisë”
Botuar në Fletoren Zyrtare Ekstra nr.39, datë 8.1.2010

Çështja “Bushati dhe të tjerët kundër Shqipërisë”
Botuar në Fletoren Zyrtare Ekstra nr.39, datë 8.1.2010

Çështja “Qemal Gurgaj dhe të tjerë kundër Shqipërisë”
Botuar në Fletoren Zyrtare Ekstra nr.39, datë 8.1.2010

Çështja “Qerim Jakupi kundër Shqipërisë”
Botuar në Fletoren Zyrtare Ekstra nr.40, datë 27.1.2010

Çështja “Caka K. kundër Shqipërisë”
Botuar në Fletoren Zyrtare Ekstra nr.40, datë 27.1.2010

Çështja “Mullai dhe të tjerë kundër Shqipërisë”
Botuar në Fletoren Zyrtare Ekstra nr.41, datë 4.5.2010

Çështja “Laska dhe Lika kundër Shqipërisë”

Botuar në Fletoren Zyrtare Ekstra nr.42, datë 20.5.2010

Çështja “Vezir Plepi, Fersilet Plepi dhe Miaftoni Zeka kundër Shqipërisë dhe Greqisë”

Botuar në Fletoren Zyrtare Ekstra nr.55, datë 21.7.2010